RENET PËR LIRI NUK VDES KURRË

Duhet t'na vijë mirë për të mirat e popullit tonë, por nga ana tjetër, duhet t'na vijë shumë keq dhe të turpërohemi nga të zezat e popullit tonë, sepse herët a vonë çdo dobësi paguhet, dhe këto dobësi neve na kanë kushtuar më shtrenjtë se asnjë populli tjetër…

I padituri e ka FAJIN më të madh dhe të pafalshëm...dhe goditjet e para i marrin ata që nuk kanë mësuar sa duhet e çka duhet...”

LIBRI është ARMË E DITURISË, dhe vlera e tij është më e madhe se e çdo kapitali tjetër



Profesor QAZIM BERISHA
(20 prill 1924 - 6 prill 1999)

“Duhet të na vijë TURP që ne sot jemi me vetëdije më të ulët se rilindësit, se Pashko Vasa...

Mbretëria e Ahmet Zogut ishte shtet formal, shtet kukull, sepse i likuidoi bijtë më të mirë, si Avni Rrustemin, Bajram Currin, Luigj Kurakuqin, Hasan Prishtinën..., Ndërsa Shqiperia e sotme, që 30 vjet është supërfuqi botërore...
(Ligjetatë, 17.08.1988)

Besa e cila i jepet secilit është besë e QENIT, e jo e njeriut. Prandaj, njeriu mund të bëhet besnik si NJERI vetëm kur bëhet vërtetë NJERI, kur bëhet i ditur, kur është vigjilent, dhe besën ia jep vetëm atij që e meriton

Për ligjin dialektik – mohimi i mohimit, është kur ne ngrihemi që të tërë dhe e bëjmë sakrificën sublime, e bëjmë vdekjen si me le, dhe duke e mohuar vetveten, e MOHOJMË edhe armikun kolonizator, por nuk mjafton vetëm kjo, sepse ata që mbetën gjallë pas luftës, pas revolucionit, duhet ta bëjnë një luftë edhe më të madhe, ta çojnë amanetin e të rënëve në vend, pra ta bëjnë POHIMIN E MOHIMIT TË MOHIMIT. Dhe nëse nuk arrihet ky pohim, atëherë edhe sakrificat shkojnë kot…

BAJRAM KURTI • PROFESOR QAZIM BERISHA – YLL I PASHUAR NË PLEJADËN E HERONJVE TË ARSIMIT DHE EDUKATËS

PROFESOR QAZIM BERISHA-YLL I PASHUAR NË PLEJADËN E HERONJVE TË ARSIMIT DHE EDUKATËS

(Ligjërime-shkreptima diturie-shkëndija filozofike)

PRIZREN 2009

BAJRAM KURTI

PROFESOR QAZIM BERISHA – YLL I PASHUAR NË PLEJADËN E HERONJVE TË ARSIMIT DHE E DUKATËS

(Ligjërime-shkreptima diturie-shkëndija filozofike)



„... Unë jam i gjallë s'mund të vdes,
mes jush këtu kam mbetur,
në radhën tuaj ju bëj zë,
unë barot i padjegur... "

(Musa Kraja)

AUTORI:
BAJRAM KURTI

Konsulentë:
Ali Aliu-Kelmendi
Ali Kurti

Lektor:
Bislim Elshani

Realizimi kompjuterik:
Adil Beqaj

Ideja për kopertinën:
Ali Kurti –Ylber Ismani

Shtypi:
Shtypshkronja "BERATI" - Prizren

BAJRAM KURTI

PROFESOR QAZIM BERISHA – YLL I PASHUAR NË PLEJADËN E HERONJVE TË ARSIMIT DHE EDUKATËS

(Ligjërime-shkreptima diturie-shkëndija filozofike)

Prizren, 2009

Monumenti " Nënë Shqipëri" në Tiranë

Nëna ju kish rritur
Për një bot' të re,
Lule more trima
Që ratë për atdhe.

B I O G R A F I A

PROFESORI HERO – QAZIM BERISHA, FLAKADAN I PASHUAR QË LA GJURMË TË PASHLYERA NË MENDJEN DHE ZEMRËN E POPULLIT MARTIR

Fushë e kuqe, shkabë e zezë
Me dy krerë,
Yll i zjarrtë, rrezendezë,
Shqipëri moj lulekezë,
Shkëmb lerë!

Tokë e larë djersë e lot,
Gjak vaditë,
Buzë detit rrahur shqotë,
Shqipëri kala në botë!
Shpatëzhveshur duke qarë
Historinë,
Popull trimash luftëtarë,
Lapidarët ngre pishtarë
Për Lirinë!

(Vehbi Bala: SHQIPËRI)

U bënë dhjetë vite nga dita kur u nda nga jeta profesori i shquar i shumë gjeneratave, Qazim Berisha. Vitet ndjekin njëri-tjetrin, por emri dhe vepra e mësuesit Hero Qazim Berisha s'fshihet nga kujtesa. Ai është gjithmonë pranë nesh, na ngrohë me veprën e tij, na jep forcë me heroizmin e tij. Data 6 prill 1999 nuk është ditëvdekja e tij, por ditëlindja e tij, sepse heronjtë e kombit kurrë nuk vdesin, por kanë vetëm ditëlindje. Djepi ku

formohen heronjtë janë historia e popullit dhe jeta e vendlindjes. Një shtrat të tillë të gdhendur nëpër rrebeshet e kohëve e pati edhe Qazim Berisha, biri i denjë i Separantit antik, Pejës martire, që ka dhënë heronj si Ali Kelmendi, Xhemail Kada, Emrush Miftari, Ramiz Sadiku e shumë të tjerë. Duart e tij u bënë shtizë Flamuri! Gjaku i tij u bë këngë! Jetën e tij ai e firmosi me veprën e tij heroike duke folur me gjuhën e pandryshueshme në shekuj – me gjuhën e mosnënshtrimit, ashtu siç kishin folur stërgjyshërit pararendës të martirizuar në fushën e nderit kundër pushtuesve të ndryshëm. Zemra e tij ndjek shembullin e **Prometheut** që ua vodhi zjarrin perëndive nga qielli që të ndriçojë njerëzit gjeneratë pas gjenerate duke i armatosur me dritën e diturisë. Ai e mbaroi misionin e tij të shenjtë me përkushtim e heroizëm si militant i orëve të para të Lëvizjes Antifashiste, por e vazhdoi edhe më vonë këtë detyrë të shenjtë kur kauza e revolucionit u tradhtua, kur Kosova me vise sërish u rikolonizua, duke i treguar popullit të tradhtuar udhën e shpëtimit, me zë alarmi dhe me zjarr:

NGREHU TI QË FLE,
ZHVISH RROBAT E
ROBËRISË!

Dhe këto fjalë të zjarrta, këto rreze drite e frymëzimi, si **YJE NË MESNATË**, u bënë himn, i ndezën zemrat e mijëra luftëtarëve të UÇK-së së lavdishme në fushëbeteja kundër hordhive gjakpirëse kolonizatore jugosllave vetëm për t'ia sjellë Kosovës martire lirinë e shumëpritur. Dhe për të gjitha këto merita në shenjë mirënjohjeje e falënderimi, kur një ditë të lartësohet busti i derdhur në bronz i heroit Qazim Berisha, mu para ndërtesës së Gjimnazit të Prizrenit, aty ku ligjëroi rreth 30 vite me radhë, ai sikur do t'u thotë të rinjve tanë:

„... Unë jam i gjallë s'mund të vdes,
mes jush këtu kam mbetur,
në radhën tuaj ju bëj zë,
unë barot i padjegur... "

(Musa Kraja)

ꝏ

Profesor Qazim Berisha u lind më 24 prill 1924 (në pasaportën e tij shkruan – u lind më 25 prill 1925) në Pejë. Rrjedh nga një familje atdhetare dhe liridashëse. Të parët e familjes Berisha kishin ardhur nga Gucia e Malësisë së Madhe e Shqipërisë Veriore (sot nën juridiksionin e Malit të Zi). Familja Berisha ishte familje me gjendje të mesme ekonomike. Gjyshi Kurtesh Berisha, një atdhetar dhe dashamirës i madh i shkollimit, e kishte krye shkollën e mesme ekonomike në Shkup. Para vitit 1900 familja Berisha ishte shpërngulur nga Gucia dhe ishte vendosur në qytetin e Pejës. Gjyshi Kurtesh Berisha kishte vdekur në vitin 1902 duke lënë të birin, Ahmetin, dy vjeç.

Prindërit Ahmet Berisha dhe Umihane – Hanë Berisha, të cilën e thërrisnin Hazlije, ishin martuar më 1917, dhe kishin lindur tetë fëmijë, katër djem e katër vajza: fëmija i parë ishte vajzë, dhe kishte lindur më 1918, por kishte vdekur pas disa muajsh; fëmija i dytë ishte Jashari, i cili u lind më 1920, por edhe ky vdes posa i kishte mbushur dy vjet; në vitin 1922 lind fëmija i tretë, motra Jakute, e cila vdes më 1943, në moshën 21 vjeç; në vitin 1925 u lind Qazim Berisha, dhe pas tij u lind Jashari i Dytë, por edhe ky vdes në vitin 1928; në vitin 1930 u lind vëllai, Fahriu, i cili vdes ende pa i mbushur 3 vjet, dhe që të gjithë këta fëmijë të mitur vdesin në mungesë të ushqimit dhe në kushte të vështira ekonomike të asaj kohe. Në vitin 1934 u lind fëmija i shtatë, Shahzadja, ndërsa në vitin 1937 u lind Shyqerija, të cilën e thërrisnin Sheqerja (e cila është gjallë).

Babë Ahmeti tërë jetën u robtua për të pasur një familje plot me kalamaj, por pothuaj të gjithë i vdiqën në moshë të vogël, dhe kjo ishte brenga e tij e madhe. Si punëtor i shkathët që ishte, në profesionin e zdrukthëtarit, kurrë nuk arriti të bëhej i pasur, por vetëm sa për të mbetur gjallë. Por babë Ahmeti kishte një dritë shprese tek i biri, Qazimi, i cili qysh në moshë të fëmijërisë jepte shenjat e një fëmije

inteligjent dhe të guximshëm. Qazimi kishte një trup të hajthëm dhe të imët, por të shkathët, me një zhdërvjelltësi të jashtëzakonshme. Ai ishte i thjeshtë, i dashur e gojëmbël me të gjithë, dinte të gjente gjuhën e përbashkët me ata që i përkrahnin bindjet e tij, idealet e tij.

Në vitin 1929 Qazimin e vogël e regjistruan në shkollën fillore në gjuhën serbe (sepse shkollat shqipe nuk i lejonte okupatori serb). Shkolla fillore zgjaste katër vite, ndërsa për nxënësit shqiptarë pesë vite, sepse një vit mësohej gjuha serbe. Qazim Berisha u dallua ndër nxënësit më të mirë, dhe në vitin 1935 e mbaroi shkollën fillore. Mësuesi i tij i parë ka qenë **Pal Lumezi**, i cili u kishte dhënë mësim vetëm disa javë. Mësuesin **Pal Lumezi** e kishte zëvendësuar mësuesi malazez Miliçko Marjanoviq, i cili ishte treguar i sjellshëm dhe korrekt me nxënësit shqiptarë, dhe lejonte që mësimi të shpjegohej në gjuhën shqipe. Por kjo gjë i kushtoi shumë mësuesit Marjanoviq, të cilin autoritetet shoviniste të shkollës e përjashtuan nga procesi mësimor.

Babë Ahmeti mezi priste ta regjistronte të birin në shkollën e mesme, në Gjimnazin e Pejës, meqë i biri i tij, Qazimi, e kishte kryer me sukses të shkëlqyeshëm shkollën fillore. Këtu në këtë mjedis të ri Qazim Berisha bie në kontakt me nxënës tjerë të pajisur me ide përparimtare (në tërë Gjimnazin kishte vetëm 16 nxënës shqiptarë, ndërsa në paralelen e tij, Qazimi ishte i vetmi shqiptar). Në vitin 1938, në shtëpinë e Ukë Gashit, Qazimi bie në kontakt me studentin e Fakultetit Juridik të Beogradit, **Ramiz Sadikun**, por më vonë bashkëvepron edhe me **Milladin Popoviqin**, i cili kishte diplomuar në Fakultetin Juridik në Beograd. Ende sa ishte nxënës Qazimi militon në lëvizjen ilegale të rinisë komuniste të Pejës, bashkë me Ramiz Sadikun dhe të tjerë. Rregullisht mbanin mbledhje me skojistët e rinj, sepse secila paralele e gjimnazit e kishte celulën ilegale. Në ato tubime diskutohej dhe lavdërohej lufta antifashiste e popullit

spanjoll kundër fashizmit, dhe dënohej pushtimi nazifashist i Austrisë nga Gjermania.

Në vitin 1940, pas një sëmundjeje të shkurtër, brenda gjashtë ditësh, vdes babë Ahmeti, duke lënë bashkëshorten e sëmurë me katër fëmijë jetimë. Por kësaj mynxyre i shtohet edhe tjetra edhe më e rëndë, kur vdes edhe nënë Umihanja, pas një lëngimi prej 2-3 vjetësh. Tani barra e rëndë e familjes i mbetet në mbikëqyrje motrës Jakute dhe hallës (motra e babë Ahmetit), por më 1943 edhe Jakutja vdes papritmas. Kështu mynxyrë pas mynxyre po përjetonte familja Berisha. Kishte mbetur barra e rëndë e kryefamiljarit mbi supet e Qazimit të mitur, ende pa i mbushur 16 vjeç.

Më 1941, derisa po i ndiqte mësimet në vitin e pestë të Gjimnazit, dy muaj para përfundimit të vitit shkollor, shpërtheu lufta botërore. Tani Peja ishte nën pushtimin e fashistëve italianë. Në nëntor të vitit 1941 u hap në Prishtinë Gjimnazi në gjuhën shqipe, në të cilin u regjistruan nxënësit që kishin mësuar në gjuhën serbokroate. Drejtor i Gjimnazit ishte Rexhep Krasniqi nga Mitrovica (i cili kishte doktoruar në Universitetin e Vjenës), ndërsa drejtor i konviktit të nxënësve ishte Vasil Andoni nga Elbasani. Pas dy vitesh drejtor i Gjimnazit u emërua Dr. Ahmet Gashi (i cili poashtu kishte doktoruar në Vjenë). Pas kapitullimit të Italisë në shtator të vitit 1943, në vend të Vasil Andonit vjen Ibrahim Kelmendi nga Presheva, student i historisë, i diplomuar në Zagreb. Shkollimi në këtë gjimnaz zgjati deri në verën e vitit 1944. Në shtator të vitit 1944 Gjimnazi u kthye në llogor gjerman ku i sillnin gjithë të burgosurit antifashistë, dhe prej andej i dërgonin në kampet e Austrisë.

Shqipërinë përherë e kishte në zemër, dhe nga kureshtja për ta parë këtë vend të bukur, gjatë pushimeve verore, bashkë me Vasil Andonin dhe disa shokë (njëri nga Gjilani dhe dy të tjerë nga Tivari) u nisën për në Tiranë.

Në Shqipëri, për të parën herë me një nderim të amshuar ngjiten në altarin e Atdheut, me një nevojë të

brendshme për t'u përulur para kombit, racës dhe dëshmorëve të rënë për çlirimin e mëmëdheut. Zëri i Shqipërisë, aroma e mëmëdheut, po e prisnin me dashuri birin e saj të paepur, Qazim Berishën. Këtu në këtë vend të shenjtë mbi errësira të robërisë lartësoheshin epopetë e lavdishme të qëndresës së burrave trima të mëmëdheut. Aty ishte dielli i jetës dhe gjysma e mëmëdheut të copëtuar. Ëndrra e amshuar për nxënësin Qazim Berisha dhe shokët e tij ishte që sa më parë të bashkoheshin gjithë pjesët e copëtuara me dhunë në një Shqipëri të vërtetë si vëllezër të një gjaku, të një race dhe të një flamuri. Në thellësi të shpirtit të tij po bashkoheshin malli dhe dhembja, loti dhe kënga, ngrohtësia e gjakut, dashuria e vëllait për vëllain dhe motrën, dhe mbi të gjitha, ziente ndjenja e një idealisti të cilit po i ndizej kraharori nga gjaku liridashës, dhe urrejtja për padrejtësitë e Evropës e cila e kishte gjymtuar padrejtësisht një komb të vogël heroik. Shpirti kryengritës marshonte bashkë me idealistin Qazim Berisha i cili kurrë nuk do t'ia falte këtë krim politik Evropës plakë. Gurët e bardhë të radhitur në kufi, rojet e shpërndara, pushkët dhe bajonetat e ushtarëve në kufi, si zinxhirë të hekurt ende po i ndanin nga njëra-tjetra dy copat e një mëmëdheu. Fati na kishte dënuar me durim skëterre që nga 1912-ta, dhe ja tani Shqipëria e Vjetër po priste çastin të shkallmonte kufijtë politikë, artificialë, të vizatuar nga të huajt, po priste dasmën e madhe të bashkimit me Kosovën martire, të cilën do ta shijonin gjithë malet, pyjet dhe ujërat e Shqipërisë.

Këta nxënës të dalluar të Kosovës i vendosin në konviktin e shkollës së mesme të Tiranës, dhe përballë konviktit ishte libraria e madhe e Lumo Skendos (Mithat Frashërit), dhe aty për herë të parë Qazim Berisha takohet me Mithat Frashërin. Përmes një arsimtari Qazimi lidhet me celulat komuniste të Tiranës, dhe menjëherë e ngarkojnë me një detyrë të rrezikshme: marrjen e armëve në një shtëpi e cila gjendej afër stacionit të policisë së kuesturës ushtarake italiane. Por gjatë këtij aksioni të

rrezikshëm Qazimi arrestohet nga policia ushtarake e cila po bënte roje, dhe menjëherë dërgohet në burgun e Tiranës. Në burg ai bie në kontakt me shumë militantë të burgosur për idetë e tyre antifashiste. Në burgun e Tiranës e mbajnë për tre javë, por falë shkathtësisë së tij dhe guximit të madh arrin të arratiset, duke shpëtuar kështu nga pushkatimi. Sërish kthehet në konviktin e Tiranës ku qëndron edhe për një muaj e gjysmë. Pastaj kthehet me autobus për në Pejë, përmes rrugës së Shkodrës. Por kur arrin në Pejë sërish e arreston xhandarmëria e Xhafer Devës. Fashistët kishin instaluar rrjetat e spiunazhit në çdo kënd, dhe kësaj radhe jeta e tij ishte në rrezik për t'u pushkatuar. Por derisa xhandarët i kishin rreshtuar të burgosurit dhe po i dërgonin për pushkatim, për çudi edhe kësaj radhe, për fatin e tij, duke iu falënderuar një polici zemërmirë, i cili ishte prekur në shpirt për këtë djalosh që ishte më i riu në rresht, dhe kur kishte kuptuar se Qazimi ishte i vetmi djalë në familje, ia bëri të mundshme të arratiset nga radha e të rreshtuarve që po i dërgonin për pushkatim. Polici kishte zbrazur një breshëri plumbash gjoja në drejtim të militantit Qazim Berisha.

Atë natë **u pushkatuan 215 vetë** në mullirin e Haxhi Zekës në Pejë. Por kur arriti në shtëpi Qazimi mori lajmin kobzi se i kishte vdekur edhe motra Jakute, në moshë 21 vjeç.

Të gjitha këto mynxyra dhe peripeci nuk e kishin zhgënjyer militantin Qazim Berisha. Përkundrazi, ai nuk pushoi se vepruari në celulën e partisë komuniste. Shtëpia e tij ishte kthyer në një bazë ilegale ku ishin vendosur gjithë teknika ilegale: radiostacioni, radioja, makina e shkrimit, dhe gjithë kjo ishte në një afërsi prej 7-8 metrash nga komanda e karabinierisë italiane. Lajmet dhe komunikatat që i vinin në bazë Qazimi i përkthente në gjuhën shqipe, i shtypte në makinë, dhe pastaj i shpërndante. Sa e sa herë kishte bashkëvepruar me **Emin Durakun, Ramiz Sadikun,** etj.

Në vitin 1945, gjatë muajve mars, prill dhe maj, Qazimi po i ndiqte mësimet në seminarin pedagogjik për mësues në Prizren. Në muajt shtator, tetor dhe nëntor të 1945-ës punon si mësues në fshatin Gadime të Lypjanit. Në këtë detyrë e kishte caktuar Sekretari Krahinor i Arsimit, Mita Milkoviq. Gjatë shërbimit në Gadime mësuesi i ri, plot emulacion e dashuri përhap rrezet e dritës së diturisë te vogëlushët e kësaj ane. Mësuesi Qazim ishte i vetmi mësues në atë shkollë, dhe banonte në shtëpinë e kryeplakut dhe myezinit të fshatit Gadime.

Në fund të nëntorit të vitit 1945 po mbahej referendumi për t'u deklaruar për Republikë apo për Monarki jugosllave. Mësuesin Qazim Berisha e kishin emërtuar sekretar të njësisë zgjedhore për Han të Elezit. Në fillim të dhjetorit 1945, duke parë se elementët shovinistë dhe kolaboracionistë po uzurponin pushtetin, Qazim Berisha e lëshon detyrën e mësuesit në Gadime dhe shkon për të studiuar.

Idenë për studime e kishte pasur edhe para se të punonte si mësues. Në Beograd ishin ndarë njëzetë bursa nga shteti i Francës për të studiuar në Paris. Prej këtyre bursave një i takonte Kosovës. Sekretariati i Arsimit të Kosovës , Mita Milkoviqi, ia kishin dhënë lajmin Qazim Berishës se ai ishte caktuar për të shkuar në studime në Paris. Ky vendim ishte marrë në verën e vitit 1945. Mirëpo, pas këtyre votimeve që u mbajtën në nëntor, sipas marrëveshjes Tito-Shubashiq, Qazim Berisha kishte pasur mosmarrëveshje me njëfarë Hasanin (nga Elbasani), sekretar i arsimit në Ferizaj, i cili kishte ardhur si sekretar i Brigadës së Pestë Shqiptare, bashkë me Spiro Llullën, Liri Shuperkën, Antigona Shuperkën etj. , dhe si aktivistë kishin qëndruar në Kosovë. Këto mosmarrëveshje u reflektuan edhe te Mita Milkoviqi dhe si pasojë Qazim Berisha refuzohet për të shkuar në studime në Paris. Por Qazimi nuk u thye në bindjet e veta dhe vendosi të shkojë për të studiuar në Universitetin e Zagrebit. Në ndërkohë merr lajmin nga një shok i ilegales nga Deçani se të gjithë

shokët e luftës iu kishin likuiduar në mënyra të ndryshme. Ishte ky edhe një motiv më tepër që Qazim Berisha të largohej me çdo kusht nga Kosova, përndryshe e priste fati i shokëve revolucionarë. Pa u hamendur merr rrugën për në Shkup dhe paraqitet në Ministrinë e Arsimit. Aty takohet me një ministër shqiptar i cili e pret shumë mirë, por i thotë se e vetmja mundësi e tij është se mund t'i jap të holla sa për rrugë, dhe e porosit të bëjë si të mundet. Dhe nga Shkupi Qazim Berisha mori rrugën për në Zagreb dhe vendoset te vëllai i Mikel Markut, Zef Marku, anëtar i Shtabit Kryesor për Kroaci. Me Mikel Markun, ish-sekretar i Prefekturës së Pejës, Qazimi njihej qysh herët, sepse e kishte shok të luftës, dhe kishin jetuar në të njëjtën lagje.

Në vitin 1945-1946 Qazim Berisha shkon ta regjistrojë Fakultetin Ekonomik, por regjistrohet në Fakultetin e Astronomisë, ku qëndroi vetëm një semestër. Aty jepte mësim profesori i vjetër Dr. Hautmen (slloven), dhe Dr. Opitt dhe të tjerë. Në semestrin e dytë Ministria e Arsimit të Kroacisë i largoi dy profesorët e njohur, me motivacion se i takonin pikëpamjeve të regjimit të vjetër borgjez. Këtu në këtë fakultet nuk kishte kushte eksperimentale në observatorium, kishte shumë teori. Aty mësonin edhe historinë e Mesjetës në grupin e Historisë të cilën e ligjëronin Dr. Hautmen dhe Dr. Opitt. Një interesim të veçantë e kishte për të studiuar Medicinën, por Atlasi i Anatomisë, botimi i Parisit, kishte një çmim shumë të lartë për studentin e ri, dhe shumë studentë nuk mund ta blinin, dhe i lëshonin studimet. Pas mbarimit të semestrit të parë në Astronomi Qazimi i ndërpreu studimet dhe u regjistrua në Fakultetin Filozofik, dega e Romanistikës, ku studioheshin këto lëmi:

a) gjuha mesjetare frënge me letërsi (8 semestra);

b) psikologjia, logjika, historia e filozofisë dhe

c) gjuha latine (e cila mësohej në katër semestra).

Në këtë fakultet frëngjishten e vjetër e ligjëronte linguisti i njohur Dr. Petar Skok, albanolog i njohur,

specialist i rumanishtes dhe gjuhës shqipe. Aty punonin edhe tre lektorë: **Henriett Coutant** (femër), e cila pas Luftës së Parë Botërore kishte punuar në Shqipërinë Jugore, në shkollën e mesme në Gjirokastër, dhe pastaj edhe në gjimnazin francez në Korçë, ku i kishte dhënë mësim edhe **Enver Hoxhës**. Profesoresha Coutant kishte një konsideratë të veçantë për studentin inteligjent Qazim Berisha.

Në fillim të studimeve Qazim Berisha banonte në konviktin e studentëve në Zagreb, ku kishte edhe shumë shokë nga Shqipëria, ndër të cilët ishte edhe Vehbi Bala (nga Shkodra), me të cilin u shoqërua deri në vitin 1948. Që nga viti 1948 e deri më 1953 Qazimi banon në familjen e njohur Pauliq. I zoti i shtëpisë ishte inxhinier me profesion, ndërsa bashkëshortja e tij ishte profesoreshë e pianos (në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për dijet enciklopedike të Qazimit kjo familje kurrë nuk i mori asnjë qindarkë, sepse Qazimi ua kursente kohën për të gjetur cilindo libër që atyre u duhej në bibliotekën e tyre të madhe). Në vitin 1949 Qazimi absolvoi, ndërsa në vitin 1950 u diplomua me notën më të lartë.

Pas mbarimit të studimeve Qazimi punësohet në Radio Zagreb, si gazetar i Radio Zagrebit, në sektorin e lajmeve, si spiker i frëngjishtes, dhe i përgatiste lajmet e mëngjesit. Këtu punon deri në fillim të vitit 1953, dhe pastaj inkuadrohet si profesor i lëndës së matematikës dhe frëngjishtes në Gjimnazin e Ogulinit (Kroaci). Në muajn qershor të vitit 1953 kthehet sërish në Zagreb për të ligjëruar në një shkollë private.

Prirjet dhe talentit i jashtëzakonshëm i Qazim Berishës në fushën e linguistikës e shtyjnë gjuhëtarin e njohur Dr. Petar Skok t'i propozojë Qazimit për t'iu përveshur punës në hartimin e një **fjalori Etimologjik** të gjuhës shqipe për të cilin ndihej një nevojë shumë e madhe në atë kohë. Profesor Qazimi e mori këtë punë me seriozitet të madh dhe filloi të mbledhë sa më shumë material arkivor. Në Bibliotekën Universitare të Zagrebit, çdo ditë, me orë të

těra po mblidhte materiale për çdo dokument të shkruar në gjuhën shqipe. Por në vlugun e këtij angazhimi serioz në fushën e etimologjisë, të cilën e lëvroi me kompetencë i madhi **Eqrem Çabej**, Qazimi detyrohet ta lëshojë Zagrebin, sepse dy motrat jetime, Shahzadja dhe Sheqerja, që po jetonin në konviktet e jetimëve në Pejë dhe Prizren, kishin ngelur pa përkujdesjen e duhur. Por një pjesë të Fjalorit Etimologjik të Gustav Majerit e ka ende. Kështu, përkundër dëshirës së madhe për t'i dalë në krye kësaj pune kaq me vlerë, profesori i paepur detyrohet që në vjeshtën e vitit 1953 të kthehet në Kosovë. Ministria e Arsimit të Kroacisë ia kishte dhënë karakteristikat dhe propozimin më superlativ, dhe kjo bëri efektin e duhur që edhe Sekretariati komunal i Arsimit në Prizren ta jepte pëlqimin dhe ta pranonte Qazim Berishën në detyrën e profesorit në Gjimnazin e Prizrenit, në shtator të vitit 1953. Në atë kohë Gjimnazi ishte i ndarë në tri pjesë: në gjimnazin shqiptar, gjimnazin serb dhe gjimnazin me paralele turke, dhe secili prej këtyre gjimnazeve kishte drejtorin e veçantë. Por për çudi në atë Gjimnaz shqiptar nuk kishte asnjë profesor të diplomuar. Gjenerata e parë në të cilën ligjëronte profesor Qazim Berisha ishin maturantët në mesin e të cilëve ishte edhe Gazmend Zajmi (Akademiku i mëvonshëm). Në fillim profesor Qazimi ligjëronte lëndën e frëngjishtes në të tria nacionalitetet. Më vonë filloi të ligjërojë edhe lëndën e latinishtes, psikologjisë dhe logjikës. Në Gjimnaz detyrën e drejtorit e kryente profesor Rakoqeviq, i cili kishte ardhur me detyrë speciale të Sigurimit Shtetëror nga Beogradi. Profesor Qazimi e dinte mirë se ishte i përndjekur dhe i survejuar në çdo hap nga arsimtarët kolaboracionistë (M. O, Sh. Th, R. Z, Sh. S, K. A etj.). Më vonë në Gjimnaz vjen me detyrë speciale nga Beogradi edhe profesori i gjuhës frëngjishte, Ristiq, i cili edhe vetë e kishte pranuar se ka ardhur me detyrë speciale për ta përcjellë veprimtarinë e profesor Qazimit. Por është mjaftë sinjifikative se në atë kohë pothuajse të gjithë ish-shokët e Pejës po punonin në

Shërbimin e Sigurimit Shtetëror (UDB) të Prizrenit. I vetëdijshëm se në çfarë rrethanash dhe me çfarë spiunësh është i rrethuar, profesori Qazim ishte tepër vigjilent dhe konspirativ, kur dihej fakti se çdo vit dënoheshin nga 100 arsimtarë. Që nga viti 1948 e deri më 1960 deri në Qafën e Duhlës ishte zonë kufitare dhe kishte një kontroll policor të veçantë. Asnjë autobus nuk mund të kalonte këtë zonë pa u kontrolluar secili udhëtar. Kjo gjendje e nderë vazhdoi deri në Plenumin e Brioneve më 1966 kur ra klika e Aleksandër Rankoviqit. Profesori Qazim jepte mësim, përveç në Gjimnaz, edhe në Shkollën Normale, në Shkollën e Muzikës, në Shkollën e Medicinës, në Shkollën e natës, por edhe në paralelet e Gjimnazit në Sharr (ish-Dragash). Kështu me një orar kaq të ngjeshur, me 52 orë mësimi në javë, ishte kjo një stërngarkesë të cilën mund ta përballonte vetëm një gjeni i përmasave të Qazim Berishës. Në vitin 1971 dekanati i Fakultetit Ekonomik në Prishtinë i ofron të mbajë ligjërata në këtë fakultet, por profesori ishte shumë i ngarkuar me orë mësimi, dhe nuk pranon. Vetëm në vitin 1972 pranoi të ligjëronte në **Katedrën e gjuhës frënge në Fakultetin Filozofik** në Prishtinë, dhe këtë e bëri vetëm një semestër, në semestrin veror. Në gusht të vitit 1981, profesori që ishte bërë legjendë e gjallë, u pensionua në moshën 57 vjeçare, kur ende mund të jepte kontributin e tij të madh, në kohën kur Kosova ishte nën administrimin ushtarak të soldateskës jugosllave, kur re të zeza e kishin mbuluar Kosovën e larë në gjak, dhe fushata e egër e diskriminimit i kishte përfshirë në radhë të parë profesorët dhe pedagogët, mësuesit dhe arsimtarët më të zotë dhe më atdhetarë. Në mënyrën më të sofistikuar kjo fushatë e kishte përfshirë edhe profesorin e mirënjohur, filozofin dhe pedagogun e shkëlqyeshëm, Qazim Berisha.

Profesor Qazim Berisha në vitin 1954 martohet me mësuesen Nefize Rexhep Merakun nga Peja me të cilën i lindën pesë fëmijë: Tringa (diplomoi në Fakultetin e Medicinës), Florina (diplomoi në Fakultetin e

Elektroteknikës), Noli (diplomoi në Fakultetin Filozofik, drejtimi filozofi-sociologji), Afërdita (diplomoi në Fakultetin e Arkitekturës) dhe Luani (diplomoi në Fakultetin Juridik).

Për shkak të punës tejet aktive dhe privacioneve të shumta, shëndeti i profesorit që në vitin 1982 filloi të shkatërrohej , me ç'rast pëson goditjen e parë të infarktit. Dërgohet në spitalin e Prishtinës ku qëndron një javë. Infarktin e dytë e përjetoi më 1984 në Zagreb. Në pranverë të vitit 1985 i nënshtrohet operacionit për t'i evituar pengesat të cilat i kishte gjatë ecjes. Në verën e vitit 1986 sëmundja i përkeqësohet dhe sërish i nënshtrohet operacionit në spitalin e Prishtinës. Sërish përkeqësohet gjendja shëndetësore, sepse i vështirësohet qarkullimi i gjakut në këmbë, dhe detyrohet t'i nënshtrohet intervenimit kirurgjik në bark, nën pjesën e zemrës. Në shtator të vitit 1987 i paralizohet pjesa e djathtë e trupit (Himipare). Në vitin 1992 i komplikohet sërish gjendja dhe i paraqitet gangrena në gishtin e madh të këmbës së djathtë. Me ndihmën e Agim dhe Besim Mullafetahut shkon në spitalin e Prishtinës nën mbikëqyrjen e Dr. Sadri Bajraktarit. Pas një muaji sërish i komplikohet gjendja, dhe pas qëndrimit për një javë në spitalin e Prishtinës, sipas udhëzimit të Dr. Sadri Bajraktari, profesor Qazimi dërgohet në Beograd ku edhe operohet më 4 maj 1992. Operacioni ishte shumë i ndërlikuar dhe zgjati gjashtë orë. Me këtë rast iu bë një bajpas. Më 26 maj 1992 kthehet në Prizren. Kah fundi i vitit 1996 gjendja shëndetësore sërish i keqësohet, dhe për shkak të dhembjeve të padurueshme iu nënshtrua operacionit në spitalin e Prishtinës nën drejtimin e Dr. Sadri Bajraktari, në fundin e dhjetorit të vitit 1996, me ç'rasë iu amputua këmba e djathtë. Për dy vite me radhë iu përmirësua gjendja, por në mars të vitit 1999, kur po mbaheshin seancat përfundimtare në Rambuje, pësoi sulm cerebral. Jetoi duke luftuar me vdekjen deri më **6 prill 1999,** kur nën flakët e bombardimeve të NATO-s objektet e kazermës ushtarake

të armatës jugosllave u bënë copë e thërrime, dhe xhamat e dritareve të banesës ku jetonte profesori Qazim u thyen tërësisht nga presioni i madh (Shtëpia e profesorit ishte 50-60 metra larg kazermës). Pranë profesorit Qazim në çastet e fundit ishin fëmijët e tij, bashkëshortja dhe motra Shahzade (e cila pas 40 ditësh ndërroi jetë). Në këtë atmosferë tmerri e lufte u bë varrimi i profesorit të lavdishëm Qazim Berisha. Nën ushtimën e topave dhe granatimeve trupin e profesorit Qazim Berisha e lëshuan në shtratin e shenjtë të tokës mëmë shtatë vetë të familjes së ngushtë, sepse vetëm këta i kishte lejuar policia fashiste: profesor Hamdi Bardhi (dhëndri), të bijtë – Noli dhe Luani, dhëndurët: Mensuri, Agimi dhe Shemsedini, dhe nipi, Edoni.

Profesor Qazim Berisha nuk ka lënë shkrime autobiografike, as ditar të jetës, përveç një video-incizim prej një orësh të udhëhequr nga disa shokë në dhjetor të viti 1997.

Në vitin 1959 ai e përktheu nga frëngjishtja në gjuhën shqipe veprën e shkrimtarit **Andre Zhid – UDHËTIMI NË KONGO,** ndërkaq në vitin 1966 e përktheu nga frëngjishtja romanin e shkrimtarit francez për fëmijë **Rene Gijo (1900-1969) "GJOKU".** Ka bërë edhe përkthime tjera nga lëmi i teknikës dhe agronomisë. Por thesarin më të madh që na ka lënë trashëgim për jetë të jetëve është drita e mendimeve të tij të arta, fjalët e urta, porositë e mëdha për të parë më larg e më mirë skenat dhe prapaskenat në teatrin e kësaj kohe me plot të papritura; porosinë për të qëndruar kurdoherë ballëlartë e të papërkulur para sfidave të kohës.

Në vijim po ia lëmë në dispozicion lexuesit të nderuar këto pak shënime ligjërimesh të profesorit të cilat i kisha marrë prej tij brenda shumë vitesh, e të cilat i kishin shpëtuar zjarrit të luftës së fundit, dhe të cilat autori i këtij libri e pa të udhës t'i titullonte me emrin:

LIGJËRIME PARAVAJTËSE - SHKREPTIMA DITURIE-SHKËNDIJA FILOZOFIKE.


ANDRE ZHID
UDHTIMI
NË KONGO

Faksimil nga libri i Andre Zhidit UDHËTIMI NË KONGO përkthyer nga gjuha frengjishte nga profesor Qazim Berisha

lluese, mbushë me kokrra të forta, dhe ngjitë në nji bisht të shkurtë që lejon me i tunolë ritmikisht. Ritma të shkathtë, të koordinuem; grupe dhetëtaktesh (pesë edhe pesë) mandej, në të njajtën gjatsi kohe, rradhitet nji grup katër taktesh — përcjellë me të dyfishtë apo kastanjetë metalike[1]). Midis ndodhen muzikantat. Pranë tyne, ballafaqas, grupi prej katër valltorësh, dy nga dy. Në rrethin e valles rreshtohen gjindja simbas madhsis së shtatit, së pari mâ të mëdhejt, mandej kalamajt deri te fëmit katër pesë vjeçarë, mâ në fund vijnë gratë. Secili përdridhet tue i lëvizë krahët, duert, dhe tue ecë kështu shum ngadalë nga e majta djathtas, trishtueshëm dhe njikohsisht me zemrim. Kur e ven dorën mbi krahun e ndonji fëmije, ky e len lojën dhe vjen e truset afër meje. Njerzit që i shiqojnë vallet, tue pa këtë, thërrasin nji tjetër që poashtu vjen në krahun tim tjetër. Kur ndalet loja, këta dy fëmij s'ndahen prej meje. Do të rrijnë në tokë pranë selis sime derisa të hamë bukë. Do të dojshin me hy në shërbimin tanë. Kanë ardhë edhe tjerë e janë bashkue me këta. N'errsinën e natës dallohen vetëm syt e tyne që na shiqojnë dhe kur qeshin, dallohen dhambët e bardhë si bora. Nëse e lëshoj të më varet dora, ma kapin, e mbështetin për krahnorin e vet; ose për faqe, dhe e puthin pa prâ. Përbri meje, mbi selin time, flen „përtacja" e vogël. Në ndishkun tim e ndiej nxehtësin e saj të kandshme. Tashmâ po e quej *Dindiki*, me emën që i japin vendasit.

Duhet shënue pritja e keqe, pothuejse anmiqsija e këtij katundi (edhe atij katundit të përparshëm) ndaj ardhjes sonë; anmiqsi kjo që për së shpejti zbutet dhe zhduket para sjelljes sonë, dhe kështu shndërrohet në simpati të madhe që shpallet me dashuni të përzemërt. Vetë prisi, që në fillim tërhiqej, tue na thanë se si gjoja s'ishte në gjendje me gjetë vè për ne, maniok për njerzit tanë, ngutet tash dhe na afron mâ tepër se sa kërkohej nga ai.

22 nanduer.

Shkojmë nga Bakisa-Bugandyi (çfarë emni për nji lagje!) para orës gjashtë; të gjithë fëmijt ngasin dhe na përcjellin deri sa dalim nga katundi. Zhytemi në nji mjegull të dendun; pamja rritej, kodrinat e ulta zanë me u naltsue. Ecim për nji kohë të gjatë „vijës së kreshtave", mandej zbresim në nji luginë të thellë. Ecim gjatë krejt mëngjesit, pothuejse

[1]) Kangë jashtëzakonisht e çuditshme (sidomos kori i fëmijvet) në të cilën përdoret vetëm e katërta e tonit, aq mâ e ndieshme sa mâ tepër zanet janë të përpikta, gjâ që ban efekt të dhimbshëm, pothuejse të paduueshëm. Zakonisht të gjitha kangët bazohen mbi notat e shkallës sonë.

deri në drekë (me nji orë pushim), pa u lodhë asnji herë; tue ecë kështu, do të kemi kalue afër 25 kilometra, e vetëm shiu, që pat zanë me ra me të madhe, na detyroi me hypë në tipojë, para se me e kalue krejt kët pjesë të rrugës. Deri tash i patëm evitue tornadat; këto shpërthejshin vetëm natën ose tue ngranë na bukë. Kjo tash s'âsht furtunë; qielli âsht njitrajtsisht i vranët dhe shihet se si shiu do të zgjasi shum kohë. Shiu dyfishohet ndërsa na mbërrijmë në katundin e parë; kjo gjâ s'pengon aspak që të ndihet tam-tami. Porse tashmâ s'ka kore bakantesh; sidomos mungon ajo që na e quejmë „plakë e marrë" e që na dukej se si gjoja gjithnji na përcjellte katund më katund.

Mbasi patëm pritë nji orë pak si të merzitun, pushoi shiu; e vazhdojmë rrugën. E mora Dindikin me vedi në tipojë, gjâ që më ban me pushue aty nji ças. Nji orë e gjymës mâ larg, Sesana, katund i randsishëm (edhe ky na priti porsi Bakisa-Bugandyi, sikurse të gjitha ato të kësaj krahine); ku ndalemi për të ngranë sillë. Mandej menjihërë përsëri marrim nji rrugë të gjatë; mirëpo kësohere në tipojë. Arrijmë n'Abo-Bojafe, kah ora katër, të molisun. Në kët katund, pra, na thonte administratori se si gjoja do të mundeshim ditën e parë me ra me fjetë. Pothuejse gjithmonë informatat që na jepshin Europianët delshin të gabueshme[1]).

23 nanduer.

Nga friga se mos po e teproj, e nënçmova gjatsin e rrugës, dje. Ecëm plotë dhetë orë, me nja dy orë pushim, dhe nji orë e gjymës në tipojë. Pra gjashtë orë e gjymës kambë, tue bâ afër gjashtë kilometra n'orë; sepse ecshim shum shpejt. Tepër i lodhun, mezi bana pak gjumë. Ajri âsht njikohsisht i freskët dhe i randë. Na kanë thanë se rruga që do ta kalojshim të nesërmen ishte shum e shkurtë. Duhet të pranojmë fatkeqsisht se kjo informatë, edhepse na e japin vendasit, s'âsht mâ e saktë se ato të përparshmet. N'Aba, ku duhej të mbërrijshim kah dreka, s'do të mund të hyjmë para orës katër të mbramjes, megjithse u nisëm pa u bâ ora gjashtë e tue ecë pa u ndalë. Duhet të pranojmë se si kjo rrugë na u ka dukë mâ e lodhshme. Po e njajta savanë

[1]) Megjithatë qe se me çka spjegohen: sa për këtë, s'âsht kurr fjala për largsi, por vetëm e vetëm për kohë që zgjat tue kalue. Mirëpo shum Europianë s'zbresin fare nga tipoja. Nji ekipë e dyfishtë (e nganjiherë e trefishtë) hamajsh u lejon këtyne që të ndërrohen, dhe i lejon të bardhit që mos t'i dhambi kryet për lodhjen e këtyne, që të kërkojë nga këta me ecë mâ shpejt, e në saje të kësaj kalohet rruga shum mâ shpejtë. Sa për shokët tjerë të karavanit, këta nisen përpara dhe mbërrijnë mâ parë — ose wijnë mbrapa e na zânë me siguri.



Faksimil nga libri GJOKU të autorit Rene Gijo përkthyer nga gjuha frengjishte nga profesor Qazim Berisha

KAPITULLI VI

KUR ENDRRAT BËHEN ZHGENDRRA

Të oesërmen në mëngjes si gjithmonë, Folko e poq kafenë. Mandej, para se ta zgjonte gjyshin, i dha shpejt një fshisë të rrastë dhomës.

Kondisur mbi një arkë me rrathë të renta, përmbi krye të mikut të moçëm, flinte lauresha e vogël e Euzebios me pendla të shprishura.

— Qenke çuar, Folko! . . .

— Dielli ka dalë moti, babëgjysh.

— Po plakem, e sheh. Ja edhe këmbët më dhëmbin, si Antonios. Prapë edhe sot në mëngjes të duhet të shkosh në peshkim pa mua. Do të të mjaftojë rrjeta e vogël. Tjetra është duke u bërë copë — copë. Do të duhej të arnohej pothuajse vegëz për vegëz.

— Kur Antonio do të shkojë në Arl, tha Folko, mund t'i themi ndoshta të na bjerë një të re.

— Rrjeta e re ben shtrenjtë, çun. Më në fund do të shohim.

— Kafeja është gati. Ta lëmë voglushin të fleje?

— Po, lere.

— Sot ndoshta do të shkojë përtej kënetës së madhe, tha Folko.

— Ke të drejtë, andej ka peshq më shumë. Por atëherë s'do të mund të kthehesh për sillë.

— Po e marr strajcën, tha Folko.

— Mirë . . . E punë të mbarë!

Folko e hodhi rrjetën në krah dhe doli nga kasolija.

Barka ishte mbushur plot me ujë gjatë natës. Folko e hoq ujin. Mandej u shkëput nga bregu dhe zuri të vozisë.

Sigurisht do të kishte peshq të zënë në kosha, lënë një ditë më parë. Për dy orë, me pak fat në fushën e madhe, kova do të ishte plot peshq. E atëherë, Folko do të ishte i lirë deri në mbrëmje. Dhe do të ngjitej deri në fushën e gjerë me kullosa. Do të shkonte ta shohë Gjokun.

Djalit as s'ia merrte mendja se do të takohej me mikun e vet jo dhe aq larg kasolles.

Folko ecte pa bërë zhurmë, duke e shtyrë barkëzën në mes të luleve të bardha që i mbulonë kënetat. Gëzohej në të menduar se krejt kjo ditë e gjatë ishte e tij.

Arriti deri te ujdhesat me baltë. U ndal për të nxjerrë dy kosha ku lëvizte peshku. Një ngjalë e bukur, barkbardhë, për pak i shpëtoi nga dora. Për fat, ra poshtë në barkë, ku u fut në një zgavër dërrase.

Folko i hodhi koshat pak më larg. Duke kaluar përmbi trup të kaltër, e hodhi rrjetën dy herë: të dy herët rrjeta plot.

Dhe kështu dita fillonte me të mbarë.

Folko preu me barkë nëpër fushë të gjerë uji të lulëzuar. Njeriu do të kishte menduar se kunora të imta kishin qenë mbjellë aty porsi flokë bore.

Një zog fluturoi. Duke e kërkuar me sy, Folko pa befas hijen e lartë që dallohej dukshëm nga kacubat.

Gjoku! . . .

Faksimil nga libri GJOKU

(FRAGMENTE NGA SHËNIMET QË I KA MARRË AUTORI NGA PROFESORI QAZIM BERISHA QË NGA VITI 1982, NJË PJESË E TË CILAVE (RRETH 90%) Të KONFISKUARA NGA POLICIA JUGOSLLAVE BASHKË ME TËRË FONDIN E BIBLIOTEKËS DHE DORËSHKRIMEVE E DOKUMENTEVE TJERA, MË 5 QERSHOR 1999, KUR AUTORI I KËTIJ LIBRI U ARRESTUA DHE U PERSEKUTUA NË BURGUN E PRIZRENIT NGA OKUPATORI FASHIST JUGOSLLAV)

LIGJËRIME, 12 mars 1987:

Në librin – BORBA PEÇKIH KOMUNISTA 1918-1941 (Lufta e komunistëve të Pejës 1918-1941), të autorëve Pavle Joviçeviq dhe Mita Milkoviq, veç tjerash shkruan; ”Ne as që do të mundnim ta merrnim me mend fare asnjë krismë pushke në Kosovë kundër nazifashistëve gjermanë pa adutin e mirënjohur të KONFERENCËS SË BUJANIT, e cila u mbajt më 31 dhjetor 1943 dhe me 1 e 2 janar 1944”. Nga kjo shihet mirëfilli se Pavël Joviqeviqi, edhe vetë pjesëmarrës në Konferencën e Bujanit, vetëm 31 ditë pas KAÇKJ-së (AVNOJ-it), të mbajtur në Jajcë më 29 nëntor 1943), po e pranonte se kjo ishte vetëm një TAKTIKË, një mashtrim, me çka po kompromet ohej AVNOJ-i, sepse asnjë shqiptar nuk kishte marrë pjesë në të…

Pra kjo ishte vetëvrasje, por e kujt?

Ishte kundërrevolucion, por në anën e kujt?

Atyre u duhej vetëm nënshkrimi, aprovimi për të hyrë në luftën antifashiste, sepse shqiptarëve nuk mund t’u premtonin më pak sesa u kishin dhënë nazifashistët italianë e gjermanë (përdorimin e gjuhës amtare, flamurin kombëtar, shkollat në gjuhën amtare etj.), të drejta këto të cilat shqiptarët nuk i kishin gëzuar gjatë regjimit të diktaturës monarkiste të Karagjorgjeviçëve…

(Ja se ç'na thotë lidhur me këtë veterani i Lëvizjes për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar, i burgosuri me shumë vite vuajtjesh e persekutimesh mizore në burgjet e Goli Otokut, Nishit, Mitrovicës së Sremit etj. , martiri i gjallë, Ali Aliu – Kelmendi, në librin – **PËRTEJ FERRIT** (Bisedë me Ali Aliun), Prishtinë 2008, f. 24, të autorit Skënder Latifi:

„Pas mbledhjes së Jajcës në nëntor të vitit 1943, në të cilën s'qe ftuar delegacioni i Kosovës (megjithëse, si para, ashtu edhe gjatë luftës, Kosova është trajtuar e barabartë me njësitë tjera, të cilat më vonë do të shpallen republika me të drejtën e VETËVENDOSJES deri në shkëputje), në bisedë me Qazim Berishën, nxënës, një klasë para meje, në shkollën e mesme "Sami Frashri" në Prishtinë (një intelektual shumë i zgjuar dhe shok i Ramiz Sadikut (Heroit të luftës antifashiste – BK), dhe Kadri Halimit në Gjilan – aktivist i dalluar i Lëvizjes revolucionare që nga Medreseja e Madhe, me shumë dëshpërim që të dytë më patën thënë se me vendimet e Jajcës çështja jonë kombëtare ishte TRADHTUAR. Mirëpo pas mbledhjes dhe miratimit të REZOLUTËS së Bujanit të nënshkruar edhe nga përfaqësuesit serbo-malazezë na u përtëri shpresa se parimi i vetëvendosjes me të drejtën e shkëputjes dhe bashkimit me Shqipërinë do të realizohej. (Reagimet e pakënaqësisë me këtë rezolutë të Gjillasit dhe Titos do të dalin në pah disa vjet pas mbledhjes së Prizrenit, e cila tradhtisht u mbajt më 8-10 korrik 1945)…"

ꕥ

Azem Galicës ia kishin vrarë austriakët tre vëllezërit, dhe ky mori pushkën dhe doli në mal, në një luftë guerile, ku iu bashkuan shumë vullnetarë, dhe u bë aleat me çetnikun Kosta Peçanac, dhe me flamurin shqiptar kombëtar, (hyri triumfalisht si i pari kryengritës në qytetin e Pejës më 1918 kundër forcave austro-hungareze. Por

Peçanci ishte edhe kundër Austro-Hungarisë, edhe kundër Shqipërisë…

ꕥ

Që nga viti 1912-1941 ka qenë paraparë me ligjin shtetëror që shqiptarët të zhduken dhe të mos ekzistonin si komb, ndërkaq i njëjti avaz vazhdon edhe sot e kësaj dite, kur edhe me ligj edhe në praktikë po punohet në këtë drejtim… së pari me e mbyllë Universitetin e Kosovës, dhe kjo është një terror ligjor diskriminues dhe racist…

Që nga viti 1912-1941 ne në Kosovë nuk kemi pasur të drejtë për ta përdorur gjuhën shqipe as në administratë, as në shkollat fillore… Por, përkundër konventave shtetërore për të na dëbuar me dhunë në shkrepat e Anadollisë (në Turqi), këta kolonizatorë nuk arritën as t'na shfarosin, as t'na pakësojnë si popull (këtë e vërtetoi regjistrimi i popullsisë në vitin 1921-1931, kur përkundër të gjitha masave diskriminuese e represive, popullsia shqiptare në Kosovë mbizotëronte me mbi 60%). Pra terrori e neutralizoi anën negative të dijes, riaktivizoi mekanizmin e vetëmbrojtjes ekzistenciale, dhe shtimi natyror i popullsisë nuk u zbrit në përputhje me parametrat e standardeve evropiane… Edhe sot neo-maltuzianët jugosllavë, sidomos ata të Akademisë serbe, po parashikojnë se brenda 50-60 viteve në Serbi do të ketë më shumë shqiptarë se jugosllavë…

ꕥ

ËSHTË MËKAT ME PASË AI QË TUTET…

ꕥ

I vetmi njeri, përveç F. Engelsit, është një anglez, i cili ia la Marksit në testament shtëpinë me vlerë prej 1000 lirash angleze, me të cilat ai e ka paguar qiranë dhe

ushqimin. Marksit i vdiq edhe djali 12 vjeç, dhe kur e pyeti Marksi se çfarë i kishte ndodhur, ai i tregoi se meqë ishte i uritur e rrëmbeu një bukë, por meqë nuk kishte të holla për ta paguar, furrtari iu vu prapa derisa djaloshi u rrëzua dhe mori plagë, nga pasojat e të cilave iu shkaktua sharlahu dhe vdiq. Vëllai i bashkëshortes së Marksit, Eleonorës, ishte ministër në qeverinë gjermane, por ajo kurrë nuk u kthye në atdheun e saj, sepse e donte Marksin pa hile. Marksi u arratis nga Gjermania në Francë, e pastaj në Angli ku bashkëpunoi me Engelsin deri në vdekje. **Ata e sakrifikuan vetveten për çështjen e madhe të njerëzimit.**

ꕥ

BLANKU vuajti dënimin me 30 vjet burg, edhe pse komunarët e Parisit i dhanë 12 gjeneralë për ta nxjerrë nga burgu...

ꕥ

Jakobinët thonë se – ÇDO TEPRIM ËSHTË TURP… Kemi pabarazi të shanseve për ta trashëguar, fituar dhe gëzuar një gjë… Duhet t'i përgatisim fëmijët, t'i edukojmë që të mësohen se si duhet të fitohet kafshata, pra me ua lënë të vetmin TRASHËGIM – TË VETMËN PASURI – **VIRTYTIN E PUNËS**…

ꕥ

Ndërkaq, thënia se BAZA MATERIALE E PËRCAKTON NDËRGJEGJEN E NJERIUT, ishte një taktikë për luftë, por u shpërdorua, u vulgarizua (si Bujani, se gjoja Konferenca historike u mbajt në tokën e huaj, se pjesëmarrësit ishin shtetas të Shqipërisë, dy atu këto me të cilat jugosllavët dëshirojnë të distancohen nga Konferenca e Bujanit)…

ꕥ

Religjioni po e luan rolin e vet në dy mënyra:

1. Ndërtimi i xhamive, dhe

2. Kultivimi permanent i të ashtuquajturve – myslimanë AKTIVË, në vend të – **SHQIPTARËVE AKTIVË**. Sa janë këto të rrezikshme? Për aq sa shiten me të madhe librat fetarë me çmime shumë të lira, të sponsorizuara nga jashtë, të beneficuara, pa censurë, si mbrojtje pasive, që do të thotë – **NËNSHKRIM I DISFATËS**, kur dihet se librat e tillë, me përmbajtje religjioze, janë kontra-produktivë dhe minim flagrant i çështjeve jetike, sepse duke e ringjallur ndjenjën fetare mesjetare, kontribohet kështu në zgjerimin e hendekut në mes shqiptarëve në Kosovë dhe shqiptarëve në Shqipëri, se gjoja shqiptarët atje nuk janë të ngjashëm me ne as me standard as me ideologji, dhe kështu të realizohet **"MURI KINEZ"** ideologjik dhe ekonomik në mes shqiptarëve në shtetin amë dhe shqiptarëve nën okupimin jugosllav…

ꕥ

Maqedonët kanë qenë fis trakas, e sllavët u dyndën në këto treva pas 1000 vjetëve, dhjetë shekuj pas Lekës së Madh. Ata dallojnë nga bullgarët siç dallojnë serbët nga malazezët. Në shekullin XVIII bëhet diferencimi i Malit të Zi nga Serbia, duke u bërë principatë 100 vjet para Serbisë, me një popullsi prej 40-50.000 banorë. Edhe sot kemi malazezë të cilët së pari e ndjejnë veten serbë, e pastaj malazezë. Të njëjtën gjë e kemi edhe te maqedonët: babai është deklaruar bullgar, ndërsa djali – maqedon! Ose – njëri vëlla maqedon, e tjetri bullgar!

ꕥ

Edhe te ne është bërë regjistrimi me dhunë (më 1953) me ultimatum: **regjistrohu turk ose u vrave**. Pra diskriminim flagrant, më i zi se në kohën e mbretërisë së Karagjorgjeviçëve (dhe kjo gjendje bëri që më 1948-1967

mbi 500.000 shqiptarë të braktisin vatrat e tyre shekullore. Më 1924 Mirosllav Kërlezha dënonte gjenocidin serb ndaj shqiptarëve të Kosovës… Ndërkaq, kryeçetniku Dragisha Vasiq shkruan librin e tij – DVA MESECA NA JUGOSLOVENSKOM SIBIRU (1924) – DY MUAJ NË SIBIRIN JUGOSLLAV (d.m.th. në Luftën e Drenicës kundër forcave kaçake të Azem Galicës, BK), duke potencuar se me çfarë heroizmi luftuan trimat e çetës së Azem e Shotë Galicës kundër trupave ushtarako-policore të mbretërisë së Karagjorgjeviqëve, dhe çfarë disfate pësoi kjo ushtri pushtuese në trevën e Drenicës, e cila më vonë u bë shkrumb e hi nga ekspeditat ndëshkimore jugosllave…

ꕥ

TRIMI U FROGOHET TË ZEZAVE, NDËRSA I LIGU U FRIGOHET TË MIRAVE...

ꕥ

Po ç'domethënie apo ç'vend i duhet dhënë SHPRESËS?

Nëse është në suaza të arsyes, në dozë të caktuar, për aq sa përgatitemi për jetë, pra ta mbjellësh, ta punosh dhe ta detyrosh për prodhim, pra kjo është **SHPRESË AKTIVE**, jo shpresë e KOTË, ëndërrimtare, imagjinare, pasive… Pra një shpresë e mbështetur në punë, një shpresë REVOLUCIONARE.

ꕥ

Vetëm PRAKTIKA është KRITER i të VËRTETËS... Por, pse duhet me i "fry kosit", siç thotë populli? Sepse me këtë tregojmë se kemi DYSHIM NJOHËS, kognitiv (Cogito ergo sum – **MENDOJ, prandaj jam),** dyshim revolucionar dhe shkencor sipas Dekartit…

LIGJËRIME, 17 mars 1987:

Po si ta vlerësojmë gjendjen e tanishme nën këtë okupim barbar?

Gjendja është e tillë çfarë jemi neve, sepse gjendja e tanishme është pasqyrë e nivelit tonë, përkundër faktit se pjesa më e ndritur e kombit, inteligjencia e mirëfilltë kombëtare, e kishte ëndërr shekullore ribashkimin e pjesëve të copëtuara e të kolonizuara të Shqipërisë… Por, shtrohet pyetja: **si të realizohet kjo ëndërr shekullore?** Dihet se kësaj ëndrre për çlirim dhe bashkim i kundërpërgjigjet ëndrra e kolonizatorëve jugosllavë për të dalë në detin Adriatik. Për shembull, në gazetën "Danas" të Beogradit (17 mars 1987) shqipfolësi Josip Gjergja shkruan: „Kurdo qoftë duhet të realizohet ëndrra jonë për të dalë në Durrës dhe Vlorë…. "

ꕥ

Pra, nuk ka të vërtetë pa gënjeshtër, dhe s'ka gënjeshtër pa ndonjë të vërtetë.

Gënjeshtra fillestare – pa dashje;

Gënjeshtra e dytë – me qëllim, dhe

Gënjeshtra e tretë – me statistikë, me shkencë, sepse një nga shtyllat e shkencës është edhe statistika.

Çdo padituri duhet të paguhet:

50% falet, dhe së paku 50% paguhet.

ꕥ

Në bazë të statistikës, Vietnami do të duhej të kapitullonte përballë epërsisë numerike dhe ushtarake të SHBA-ve, por më 1975, pas një lufte heroike mbarëkombëtare, për të cilën u shfaqen edhe filma dokumentarë, të gjithë ishim dëshmitarë se si po iknin ushtarët amerikanë nga fushëbetejat e Vietnamit heroik…

Prandaj, asgjë nuk duhet të absolutizohet, sepse gënjehemi, meqë momenti racional përbën një pjesë shumë të vogël (90% **të aktiviteteve trunore** janë irracionale dhe 10% racionale).

ꕥ

Çdo gjë që teprohet kalon në të kundërtën e vet, bëhet e rrezikshme, nga primitivizmi, nga prapambeturia etj. Sa më i informuar që të jetë njeriu, aq më i sigurt do të jetë… P.sh. Millosh Cërnjanski, Sllobodan Millosheviqi, Drazha etj. , dolën haptas me idenë që shqiptarëve të shkolluar t'u hiqet koka, ndërsa të pashkolluarve të mos u jepet shkollë, sepse ata për çdo të shkolluar thonin se është një armik më shumë për Jugosllavinë… (Shih Mirosllav Jançiç: KAKO SAM IZDAO SVOJU NACIJU – Si e tradhtova kombin tim, Sarajevë 1984) Pra qëllimi ishte që përmes AUTONOMISË FORMALE(TË GËNJESHTËRT) të vitit 1974 t'ia nxjerrin zorrët AUTONOMISË së vërtetë, **në përputhje me programin e Dushan Kanazirit (akademik i ASSH S), Ivan Stamboliqit, Sllobodan Millosheviqit etj.**

Esat Toptani – Tradhtari, mori miliona lira për t'ua dorëzuar Shkodrën malazezve, pa rënë në fushëbetejë asnjë ushtar malazez… (Shih romanin e **Skënder Drinit – VRAJE TRADHTINË**), prandaj duhet të merremi edhe me MYKUN TONË POLITIK.

ꕥ

Sajrusi gjatë provave për të zbuluar vaksinën kundër MENINGITISIT (pezmatimi i kores së trurit) , **i mbyti dy fëmijët e vet.**

ꕥ

Në shekullin XIV në shtetin e Car Dushanit u zyrtarizua skllavëria, sepse lejohej edhe nxjerrja e syve,

edhe prerja e gjuhës, e dorës etj., ndërkaq në Kanunin e Lekë Dukagjinit nuk lejoheshin këso mizorish e banalitetesh çnjerëzore … Pra Car Dushani e ripërtërini skllavërinë 800 vjet pasi ajo kishte dalë nga moda, ndërsa sot po e festojnë 600-vjetorin e autoqefalisë së kishës ortodokse serbe në krye me Shën Savën, një marroq i ngjashëm me Cezare Borgjian, një papë skandaloz, e këta s'kanë lënë gjë pa bërë 200 vjet para Cezare Borgjias, 200 vjet para Makiavelit…

ꕥ

550 vjet pas Sveti Savës (Nemaniçit), **Fan Noli** bëri përpjekje t'i shpëtojë shqiptarët përmes kishës… Ajo që ishte shkruar nëpër librat fetare greke pretendohej se është tokë greke, deri në trevat e Elbasanit, deri në lumin Shkumbin… Thanas Tashko e dërgoi Nolin në Amerikë për t'u bërë prift, për t'u ndihmuar shqiptarëve duke e siguruar autoqefalinë e kishës ortodokse shqiptare… Mirosllav Kërlesha kishte thënë se Fan Noli është Shtrosmajeri shqiptar, sepse ishte takuar rastësisht me të në Vjenë dhe ishte magjepsur nga inteligjenca dhe aftësitë e tij të jashtëzakonshme… Noli ishte rilindësi i fundit, por më i fortë se Naim Frashri. Mirëpo vetëm pse kishte pasur lidhje me V. I. Leninin, e anatemuan dhe e futën në listën e zezë të reaksionit evropian, dhe e quajtën – PRIFTI I KUQ, kryeprift, kryepeshkop, **Holderi i Brazilit.** Tërë reaksioni evropian u ngrit në këmbë… Noli e quajti **Bajram Currin – baba**, sepse i dinte vlerat e tij kombëtare…

ꕥ

Robespjeri, Garibaldi, ishin në Lëvizjen masone… Shumica e arsimtarëve më 1945, 1946 dhe 1947 ishin në Universitetet masone, sepse masonizmi ishte njëfarë mode, siç ishin roku, xhazi etj.

ꕥ

Mustafa Kemal Ataturku e pranoi planin racist të V. Çubrilloviqit, I. Andriqit etj. F. Krispi ishte shovinist e fashist më i madh se Musolini, ai e fliste gjuhën shqipe, kishte prejardhje shqiptare…

ꕥ

Më 1981 e identifikuan përdorimin e gjuhës shqipe me **IRREDENTIZMIN**. Më 1941-1944 Kosova e Dibra ishin të bashkuara, por nën okupimin fashist, nën thundrën e huaj e jo në një shtet (siç ishin nga koha e Pirros e deri te Teuta)…

IRREDENTIZMI nënkupton – BASHKIMIN E PJESËVE TË OKUPUARA ME SHTETIN AMË. Këto sulme që po zhvillohen kundër nesh sot kanë për të na zgjuar nga gjumi, kanë për t'na çelur sytë, sepse veprime të tilla kishte bërë Hitleri më 1934…

ꕥ

Fan Noli thotë: FEJA ËSHTË E KEQE E PËRGJITHSHME, ndërsa te ne kemi 4 (katër) FE, dhe kjo **është PANDEMI e jo EPIDEMI** (2000-3000 vjet i kemi kaluar pa asnjë fe, sepse **secila fe na ka ardhur bashkë me pushtuesin...**), pra duhet përfituar nga FATKEQËSIA…

RELIGJIONIN e flakën dhe e ndaluan JAKOBINËT më 1792, por vetëm 3 vjet. Robespjeri e ndau shtetin nga kisha vetëm 14 vjet, ndërsa Shqipëria socialiste, që nga 17 shkurti i vitit 1967 e deri më sot po e bën një gjë të tillë, sepse është nevojë e domosdoshme për atë vend, sepse edhe kur tërmeti i rrafshon me tokë, nuk pranojnë në emër të "ndihmave humanitare" asnjë ndihmë, asnjë batanije nga UNHCR-ja… **Dhe gjatë tërë ditës e shajnë SHBA-në, por edhe BRSS-në, për 24 orë...**

ꕥ

Nëse gishtin e ke me gangrenë trupi është i shëndoshë… dhe nuk duhet të merret PJESA PËR TËRËSI (PARS PRO TOTO). Populli nuk ka kohë të mendojë keq për popullin tjetër, sepse kur janë të robtuar nga 16 orë në ditë nga shfrytëzuesit, s'kanë kohë të mendojnë keq, por helmimin ua sjell BUROKRACIA… elita sunduese. Sepse ndërgjegjja e pastër nuk mund ta identifikojë tërë një popull me SHOVINIZËM. Pra kurrsesi nuk guxojmë të biem në pozitat e reaksionit, sepse neve kemi qenë në situatë edhe më të rrezikshme më 1912, por sërish e mbijetuam golgotën dhe masakrat dhe ende jemi gjallë… I LIGU lemeriset, vajton, bën gjëmën… Sot këta sundues tiranikë po thonë se romët, turqit etj. , janë më të mirë, vetëm sepse nuk janë shqiptarë… E me veprime të tilla këta po shkojnë drejtë **GREMINËS,** sepse nuk po mundin ta përmbajnë veten…

ꕥ

Roma i ka internuar çifutët sepse ishin monoteistë, dhe nuk i kanë njohur perënditë romake… Dora e parë ishte Judaizmi, ndërsa krishterimi erdhi më vonë, ndërkaq dora e tretë erdhi me abdes, me KURANIN. Krishterimi i akuzon hebrenjtë se gjoja ata e tradhtuan birin e tyre më të mirë, Jezu Krishtin, ndërsa këtë të fundit hebrenjtë e konsiderojnë si tradhtar të besimit të tyre… Hebrenjtë thonë se profesioni më njerëzor është – TREGTIA, pra sinonim i fesë çifute. Jehovai ishte zoti i çifutëve…

ꕥ

Një dorë njerëzish janë të prirur për disa sëmundje të caktuara, dhe nuk ngopen me të mirat e sotme jetësore, por i duan ato të mira edhe përtej varrit… E pushtuesi na thotë: po ç'doni ju shqiptarët më shumë, kur jeni të lirë të

shkoni në Gjermani, Zvicër etj. Pra ne jemi RREZIKU MË I MADH PËR VETVETEN, ne jemi falanga, eshaloni i parë, e keqja e parë, pra jemi **VARRTARË POTENCIALË**, sepse ia bëjmë varrin vetes për hatër te të tjerëve, që nga viti 1945 e këtej (1987) …

ꕥ

Si do ta shpjegonit kontradiktën midis gjeneratave?

Armikut nuk i konvenon që gjenerata e vjetër të jetë në një zë dhe monolite me gjeneratën e re, të ketë shkëmbim përvojash mes tyre, që e vjetra ta bartë përvojën e saj te gjenerata e re, që të ikë nga eksploatimi i përhershëm shekullor. Pra duhet një bashkëpunim i ngushtë në mes dy faktorëve:

1. Faktorit individual, si katalizator, si shtytës, i cili i arsimon, i ndriçon, i bën masat të ndërgjegjshme për fatin e tyre, i zgjon nga gjumi, nga letargjia, dhe
2. Faktori vendimtar – populli.

Sepse siç thoshte T. S. Elioti, NEVE DO TU DUKEMI BREZAVE NË TË ARDHMEN ASHTU SIÇ NA DUKEN NEVE SOT LEMURËT E GIBONËT (lloje majmunësh – BK), pra e keqja do ta bëjë punën e vet, por gjenerata e ardhme do ta shkallmojë, do ta bëjë pluhur e hi të vjetrën, anakroniken…

ꕥ

Jan Husin, kur e hodhën mbi turrën e druve për ta djegur për së gjalli, ai iu drejtua masës me këto fjalë: O SANKTA SIMPLICITAS(O marrëzi e shenjtë)…

ꕥ

LIGJËRIME, 21 mars 1987:

Nuk mjafton vetëm të bëhet lufta për liri…, por

1. LUFTA E PARË BËHET VETËM KUR TË SHKON MENDJA TA LUFTOSH ARMIKUN...
2. LUFTA EDHE MË E MADHE ËSHTË NË ÇASTIN KUR POPULLI I RROK ARMËT DHE E DËBON ARMIKUN NGA TROJET E VETA...
3. POR EDHE MË E MADHE SE KJO LUFTË ËSHTË LUFTA KUR I KËRKON ARMIKUT LLOGARI PËR TË GJITHA DËMET E SHKAKTUARA MATERIALE DHE NJERËZORE... (Shih: Franc Fanoni: TË MALLKUARIT E BOTËS)...

ꕥ

LIGJËRIME, 27 mars 1987:

Po ç'vend i duhet lënë LAKMISË?

Në radhë të parë duhet ditur se për çka lakmojmë – është ajo LAKMI POZITIVE APO NEGATIVE. Nëse lakmojmë të mirat njerëzore – të VËRTETËN, TË DREJTËN, TË MIRËN, LIRINË… **këtu s'ka asgjë të keqe.**

ꕥ

Duhet t'na vijë mirë për të mirat e popullit tonë, por nga ana tjetër, duhet t'na vijë shumë keq dhe të turpërohemi nga të zezat e popullit tonë, sepse herët a vonë çdo dobësi paguhet, dhe këto dobësi neve na kanë kushtuar më shtrenjtë se asnjë populli tjetër…

ꕥ

Pa pasur mikrobe nuk mund të bëhet kosi, pra së pari duhet të prishet tambli, dhe pastaj me farë kosi, me baktere, kryhet procesi i fermentimit…

ꕥ

Kinezët flasin me ironi, për ata ngjyra e bardhë është SIMBOL I ZISË, te ata të qeshurit ka tjetër kuptim, dhe sistemi dhe mënyra e të menduarit është tjetër fare…

ꕥ

Filmat memecë janë më me efekt se filmat me zë, sepse zëri mund ta dezorientojë shikuesin…

ꕥ

Nils Borit ia dhanë gjysmë litre lëng DEUTERIUMI (Uji i rëndë), e prej tij e morën amerikanët, dhe prej deuteriumit u bë BOMBA HIDROGJENIKE (ATOMIKE).

ꕥ

Profesor, çfarë vendi i jepni fatit të njeriut?

FATI I SECILIT VARET NË RADHË TË PARË NGA VETJA E TIJ, e pastaj nga rrethanat shoqërore, grupit të cilit i takon etj. Për shembull – FËMIJA e ka fatkeqësinë më të madhe nëse e ka **nënën e paditur**, dhe mjafton një rrymim – ftohje kur është duke u larë, dhe ai fëmijë për tërë jetën do vuajë pasojat e këtij çasti fatal, duke mbetur invalid i përjetshëm… Kështu është edhe me fatin dhe fatkeqësinë e popujve…

ꕥ

Paniku – frika kolektive, të cilën e mbjell armiku, e dezorjenton njeriun e zakonshëm, dhe kështu baza e

ligështisë – frika, arrin të rrënjoset në popull, që ai pastaj të frikohet p.sh. edhe nga intonacioni i këngës së këngëtares **Fatime Sokoli** ose **Dervish Shaqa**, me qëllim që masat të çarmatosen, të demobilizohen dhe të mos e duan Flamurin kombëtar, të mos i duan heronjtë e kombit, si Bajram Currin, Hasan Prishtinën, Isa Boletinin, Shote Galicën, Luigj Gurakuqin etj.

ꕥ

Po kush mund të konsiderohet i lig, i dobët?

I lig është ai njeri i cili nuk e duron **bashkëjetesën**, ai i cili është i ngarkuar me komplekse negative, në radhë të parë për **të zezën e vetvetes** …

Deri më 1966 vetëm çdo i 17-ti shqiptarë ishte i punësuar në ndonjë organizatë, ndërkaq pothuaj secili serbo-malazez ishte i inkuadruar, e kjo do të thoshte se diskriminimi i shqiptarëve ishte flagrant, i pashembullt në botë… Dhe sot shovinistët që erdhën në pushtet po lypin rikthimin e gjendjes së paraluftës, d.m.th, kohën e Karagjorgjeviçëve, kur shqiptarëve nuk u lejohej as shkollimi fillor në gjuhën amtare. Pra po kërkojnë të paguhet kamata për ato 21 vjet "vuajtje" (sepse **serbo-malazezët barazinë e konsiderojnë diskriminim** – pabarazi), por gjërat e pamundshme i kërkon vetëm ai që nuk është në rregull psiqikisht …

ꕥ

Ne duhet të kemi kujdes dhe të mos i edukojmë fëmijët me hipokrizi, sjellje dyfytyrëshe, kur, p.sh. babai flet keq për mësuesin e fëmijës, dhe pastaj fëmija është në dilemë: se cilit t'i besojë, mësuesit a prindit!

ꕥ

Edhe Gjergj Fishta, edhe Mark Milani i kanë idealizuar vetëm të mirat e kombit shqiptar, dhe kjo më vonë do na kushtojë, sepse nëse i mbulojmë të zezat tona ose të kombit tonë, herët a vonë do t'ua shohim sherrin. P.sh. në librin "LUGU I BARANIT" (i autorit M. Krasniqi – BK), shqiptari është idealizuar, por vetë rezultatet tregojnë se nuk kemi qenë aq të fortë si komb përballë sfidave të kohës…

ꕥ

Fillimisht duhet të dihet se shteti nuk ka miq, por vetëm **INTERESA**, dhe kurrsesi nuk duhet të thuhet – NA KANË PREMTUAR, NA KANË DHËNË BESËN etj. , gjë që do të thotë: PRANOJENI JU KONOPIN, se ne po ua japim BESËN, pranojeni bashkëpunimin në luftën partizane, dhe ne po ua japim besën që pas luftës do ta gëzoni të **DREJTËN E VETËVENDOSJES DERI NË SHKËPUTJE**… Kjo tregon më së miri se ne nuk kemi qenë ende të PJEKUR POLITIKISHT. Të derdhësh gjakun për liri dhe asgjë në dritë të mos qesësh?!

ꕥ

Po kush e shfrytëzoi atë gjak të 113.000 të rënëve për lirinë e Kosovës ?

E shfrytëzuan ata të cilët më së paku e kanë merituar, pra kanë korrë ata që fare nuk kanë mbjellë! Pra gjithmonë duhet të kemi guximin qytetar dhe **në radhë të parë t'ia lëmë fajin vetvetes, e jo tjetrit...**

ꕥ

Pas kasaphanës së vitit 1912-1914, me ç'rast u masakruan mijëra shqiptarë nga dora gjakatare serbo-malazeze, më 1915 serbët morën ikën para ushtrive austro-

hungareze dhe u tërhoqën nëpër Shqipëri dhe arritën në bregdetin Adriatik dhe Korfuz, dhe këtyre refugjatëve të gjorë nuk u ndodhi asnjë e keqe nga shqiptarët, të cilët vetëm po ta zinin një shteg malor të Alpeve shqiptare do t'i shfarosnin të gjithë. Dhe asnjëri nuk mori plumba në ballë, por vdiqën vetëm ata që nuk mundën ta përballonin rrugën e gjatë dhe urinë. Nga kjo del se çdo propagandë e serbëve është false, bie në ujë… Pra as për vete mirë, as për neve mirë, sepse po ringjallen atavizmat e para 75 viteve. Sot në Kosovë një shqiptar **nuk guxon të çojë dorë as në vetëmbrojtje kundër qenit serb**, e lere më kundër kolonizatorëve, sepse merr dënime të rënda, me akuzën – **IRREDENTIST**. Ndërsa policët shqiptarë në Fushë Kosovë morën dënime, sepse gjoja na i paskan frikësuar serbo-malazezët …. Por, siç dihet, deri më sot atyre u kanë dalë llogaritë gabim, mbrapsht. Puna është se ne jemi pikë STRATEGJIKE në zemër të Evropës, e këto janë sot lojëra politike – PAZARLLËQE të dy superfuqive, pazarllëqe të Regan-Gorbaçovit, në Maltë më 1989.

ꕥ

Më 15 janar 1945 u mbajt Konferenca e Jaltës, ndërkaq më 1975 u mbajt KONFERENCA E HELSIKIT, vazhdimi i Jaltës, që u ndërmor me iniciativën e Brezhnjevit me qëllim që në të te merrte pjesë Shqipëria, por Shqipëria nuk mori pjesë, sepse nuk pajtohej me gjendjen e status-qo-së, me gjendjen e **copëtimit në pesë pjesë**, me gjendjen e robërisë së mbi 2/3 të trojeve shqiptare nga jugosllavët dhe grekët, sepse vetëm SHQIPËRIA sot është i vetmi subjekt, e jo OBJEKT, në kontinentin e Evropës… Dhe sot vetëm Republika e Vietnamit po pajtohet me sistemin UNIK botëror të SHQIPËRISË… Sot ardhmëria e Shqipërisë varet edhe nga ne, sepse ne hë për hë jemi edhe më të RREZIKSHMIT si **VARRTARË POTENCIALË** (varrtarë të dyfishtë – edhe për vete edhe për vëllain), por edhe si SHPËTIMTARË të sigurt të saj. Dhe mu për këtë

ne duhet të bëhemi të fortë, që të tjerët t'mos mund t'i nxjerrin me duart tona gështenjat nga zjarri për interesa të veta, dhe ai që bëhet vegël e tillë është ose i pamend ose i pandjenja kombëtare, sepse me vetë dëshirë bëhet instrument për t'ua bërë varrin bashkëkombësve të vet. E disa shkojnë në kishë e xhami, por edhe në Qabe, e ne duhet t'i hapim sytë më shumë se kurrë, sepse kësaj gjenerate i takon të sakrifikohet, e jo të ngrihen kisha e xhamia – **varri ynë i parë**, se hoxha e luan rolin e gomarit, instrument, artileri e rëndë në duart e REAKSIONIT **(Marksi: Feja – opium për popullin – psherëtimë e një bote pa shpirt, pa zemër...).**

Edhe viti 1912 duke i falënderuar fesë na zuri të papërgatitur në pikëpamje kombëtare, na zuri në gjumë, por edhe Lidhja e Prizrenit më 1878 **(kujtojeni poemën e Bashko Vasës: Oj Shqipni e mjera Shqipni, dhe fjalët – Mos shikoni kisha dhe xhamia, se FEJA e shqiptarit asht SHQIPTARIA...)** edhe Lufta e Dytë Botërore na zuri të papërgatitur si duhet e sa duhet… **Fetari i shkolluar është 100 herë më i rrezikshëm, sepse bën operime duke ia nxjerrë sytë shkencës, ndërsa sot këta ZJARRFIKËSA TË REVOLUCIONIT po e bëjnë punën e tyre të ndyrë aq me devotshmëri dhe intensitet duke ngritur me dhjetëra e qindra xhami e objekte tjera fetare, bile po punohet të ngrihet edhe një Fakultet Teologjik në Shkup dhe një tjetër në Prishtinë...**

ꕥ

Po pse po na ndodhin këto dukuri anakronike?

Këto dukuri negative po na ndodhin sepse njerëzit janë katandisur në terrin e paditurisë, e kjo është pasojë e shtypjes së egër ekonomike, mjerimit të madh, e varfërisë materiale e shpirtërore, sepse njerëzit sot po **PRITOJNË TË MENDOJNË** me kokën e tyre, dhe e konsiderojnë FENË si shtyllën më të fortë e më të sigurt, dhe kështu pushtuesit nuk i kushton as 10% e investimeve për ta shuar kryengritjen, demonstratat, protestat, dhe kjo taktikë

perfide e pushtuesit është me efekte shumë të tmerrshme. Por një gjë e tillë vetëm e shtyn për më vonë, e ngadalëson procesin e REVOLUCIONARIZIMIT të masave, që ato sa më pak të bëhen të vetëdijshme për gjendjen e tyre të mjerë nën zgjedhën e robërisë, e dihet se REAKSIONI ËSHTË UNIK, është një, sepse të gjitha këto janë çështje ekonomike, kur dihet se për reaksionin, për okupatorin, barazia është TERROR. Mirëpo të gjitha këto kontradikta e komprometojnë gjithnjë e më shumë okupatorin, e demaskojnë, ia çjerrin maskën çdo ditë e më shumë në përpjesëtim të drejtë me rritjen e hendekut të kundërthënieve në mes të pushtuesit dhe të shtypurve, sepse pushtuesi të jep përparësi dhe të privilegjon vetëm kur ti nuk e konsideron veten se je shqiptar. Me ligje të aprovuara do të fitoni përshtypjen se çdo gjë është në rregull, por kriter i së vërtetës është PRAKTIKA, e cila po ua nxjerr të palarat në sipërfaqe… Sot Millosheviqi po kërkon që gjuha shqipe të përdoret vetëm në FAMLJE, brenda katër mureve, pra të përdoret privatisht e jo zyrtarisht, kërkesa këto të cilave u ka perënduar koha, sepse historia na mëson se as Hitleri nuk ka arritur ta restaurojë epokën e mesjetës, edhe pse për 13 vjet ai e zëvendësoi INKUIZICIONIN e shekullit VIII dhe IX me furra elektrike, KREMATORIUME, dhe kjo kasaphanë botës i ka kushtuar hiç më pak se mbi 50.000.000 jetë njerëzish të te gjitha moshave dhe gjinive, të te gjitha kombeve. Ndërkaq paraardhësit e Millosheviqit këto furra e këto kasaphane i përdoren 24 vjet para Hitlerit, në Luftërat Ballkanike (1912-1913), por edhe më parë, më 1877-1878, kur që nga Molla e Kuqe e Toplica, Sanxhaku i Nishit e deri në Kurshumli e Prokupje, mbi 713 fshatra e 8 qytete u bënë shkrumb e hi nga hordhitë barbare serbe të knjaz Obrenoviqit, dhe kështu doli se këta barbarë ishin mësuesit pararendës të Hitlerit e Musolinit…

ꕥ

Rexhep Qoses sot po ia ndajnë çmimin e Dhjetorit, pra fajin e kanë ata të cilët e kanë përgatitur **(Shkëlzen Maliqi, druri i gdhendur me teknikën moderne, më perfid se babai i tij, Mehmet Çikuli – Qorri , bukëpjekës).** Qosja sa herë e ka hapur gojën e kanë sulmuar, dhe kjo ishte vetëm fillimi. Deri në shtator 1988 duhej t'i vihej njëfarë kapaku këtyre lemerisjeve, porse në të mirë të kujt, kjo mund të dihet më vonë, me kalimin e kohës. Por ne dhe vetëm ne duhet të përballemi me problemet, për ta kapërcyer hendekun e madh në mes të pushtuesit dhe të pushtuarit, dhe jo të shohim ëndrra. Kjo nuk mund të bëhet duke i shikuar gjerat në mënyrë subjektive, të njëanshme dhe partiake, por vetëm nëpërmjet të një ANALIZE OBJEKTIVE të thellë, sa më shkencore dhe të plotë, të kohës, të njerëzve dhe të rrethanave, pra përmes një metodologjie shkencore dialektike e jo metafizike. Historia shkruhet nga historianë të mirëfilltë në bazë të kritereve të caktuara profesionale dhe jo nga politikanë diletantë, të cilët nuk bazohen në fakte. Dhe nuk thoshin kot të moçmit latinë: HISTORIA EST MAGISTRA VITE- HISTORIA ËSHTË MËSUESJA E JETËS.

ꕥ

Mirë profesor, po dihet se si qëndron gjendja në Kosovë, po në Vojvodinë si qëndrojnë gjërat?

Vojvodina është BASTION i fortë, më i fortë se Kosova, sepse ata nuk mundën me e marrë me mend kthimin mbrapa, prapavajtjen. Para lufte në Vojvodinë kishte vetëm 35% popullatë serbe, ndërsa 65% ishin gjerman dhe të tjerë, por pas kapitullimit të Gjermanisë më 1945, dhe shpërnguljes me dhunë dhe gjenocid ndaj gjermanëve, në ato vise u bë popullimi me serbo-malazezë, nga viset e varfra të Likës dhe Dalmacisë, dhe në këtë mënyrë atje u ndërrua raporti demografik në të

mirë të serbo-malazezve, me një mbipopullim prej 55%. Por atje nuk thonë se ne jemi – SERBE, por se jemi serbë të Vojvodinës. Pra ata nuk pranojnë si Azem Vllasi me qenë kukulla, marioneta të dirigjuara, për të folur dhe për të heshtur siç ia do qejfi padronit… Pra elementi i Vojvodinës serbe është zhvilluar për 200 vjet në rrethana tjera ekonomiko-kulturore. Bile edhe shovinisti më i madh, Millosh Cërnjanski, i quan – serbë të Vojvodinës. Por edhe në Serbi kurrë nuk thonë për Vojvodinën – atje në Serbi. Bile as para lufte. E njëjta gjë vlen edhe për Kosovën, dhe p.sh. thuhet: "Vajza është martuar në Serbi, ndërsa ne jetojmë në Kosovë… "

ꕥ

Në librin – KNJIGA O MILLUTINU, të autorit D. Popoviq, është satirizuar dhe përqeshur gjendja në Serbi, ngjashëm me satirat e Radoje Domanoviqit, që populli serb të mos jetojë me ëndrra, në jerm.

ꕥ

Më 1918 – 1920 u bë plebishiti në Korushkën sllovene, dhe prej 40.000 banorëve 50% u deklaruan për Jugosllavinë (Sllovenínë) dhe 50% për Austrinë. Pra këta donin të merrnin 3.000.000 banorë gjermanë për 20.000 banorë sllovenë (si sot në Kosovë kur mbi 2.000.000 shqiptarë jetojnë nën sundimin e 200.000 serbo-malazezve). Dhe shkojnë deri aty sa të propozojnë autonomi kulturore për shqiptarët, autonomi formale, autonomi e rrejshme që gjuha shqipe të hiqet nga përdorimi në administratë dhe shkolla…

ꕥ

LIGJËRIME, 8 prill 1987:

Çfarë mendoni për BESËN SHQIPTARE?

Nuk duhet të jeni besnik si qeni, sepse qeni nuk është kritik ndaj vetes, nuk e din se kujt ia ka dhënë besën, ka shkuar për të bërë keq dhe ia ka parë sherrin. Ose: a e vrave, a e tradhtove filanin? – PO. Po pse bre e bëre këtë? Sepse më thanë vraje! Dhe ky është ai besniku pa kriter. Ndërsa më vonë vjen pendimi banal: "Për besë nuk e kam ditur", dhe pikërisht këtu qëndron esenca: se për vetë faktin që ti je i paditur, **FAJIN e ke edhe MË TË MADH**, dhe më të pafalshëm… Pra je fajtor sepse nuk ke MËSUAR, dhe goditjet e para i marrin pikërisht ata që nuk kanë mësuar sa duhet e çka duhet. Dhe shtrohet pyetja: kush mund të quhet i **FORTË?** I fortë mund të quhet ai që i kupton mirë gjërat, dhe ai e di se kujt duhet t'ia japë **BESËN**. Dhe nëse dikush të ka PRE NË BESË, ai duhet konsideruar ORTAK – ALEAT ME ARMIKUN. Nëse të tradhton për herë të parë, 50% të falet, se nuk e ke njohur, por për gjysmën tjetër, 50%, duhet të paguash gabimin, dhe kështu do të vuani aq sa meritoni për të VUAJTUR. Dhe fajin më të madh e kanë ata që pranojnë të bëhen mashë, instrument i armikut. Pra fajin e ka ai që shkon te ujku dhe bëhet kafshatë e tij… Edhe Njegoshi në "Kurorën e Maleve "shkruante: Vu NAD ovcem svako pravo ima, Ko tiranin NAD sllabija çovjeka, Al tirjanstu nogom na vrat stati,To je ljudska duzhnost najsvijetija(Ujku para deles ka çdo të drejtë, ashtu siç e ka TIRANI para njeriut të dobët, por që t'ia vësh tiranit këmbën në qafë, kjo është detyra njerëzore më e shenjtë. **Dhe pikërisht kjo detyrë e shenjtë na detyron neve si komb që tiranisë jugosllave t'ia japim dënimin e merituar, t'ia vënë këmbën në zverk dhe t'i kërkojmë llogaritë një për një për ato një milionë viktimat që pësuan nga kolonizatorët jugosllavë.**

Sot në secilën shtëpi kemi një ose më shumë persona që dinë shkrim e lexim. Për t'i gëzuar të mirat duhet të punojmë pa hile, sepse të MIRAT, si të voglat, ashtu edhe të mëdhatë, nuk falen, por FITOHEN, me mund e me sakrifica të mëdha. Dhe nëse një punë e ke nisur përnjëmend, përnjëmend do të dalë.

ꕥ

Në religjion e kemi botimin e parë – BIBLËN.
botimin e dytë e kemi – UNGJILLIN, dhe
botimin e tretë e kemi – KURANIN.
Kështu, botimi më i ri i ka përfshirë edhe ato gjëra të cilat nuk i kanë dy botimet pararendëse.

ꕥ

Të gjithë e dinë se **BUKA NUK GATUHET ME FJALË**, por me miell, dhe pastaj duhet të piqet, dhe në fund të hahet, dhe sërish nuk mjafton, sepse çdo gjë do të shkojë në rregull vetëm atëherë kur atë që e kemi ngrënë do të na bëjë mirë.

ꕥ

Në vendet borgjeze TREGTIA është **mashtrim LEGAL**, dhe mund të pyesim – a është e mundur me **SHITË** dhe me **BLE** dhe me shpëtua pa e HUMBUR shpirtin? Dhe si mund të bëhej PEJGAMBER Muhamedi, i cili bënte tregti, dhe pas 40 vjetësh u bë pejgamber, profet, iu hap qielli… Që të kesh shpirt, së pari duhet të kemi trup, sepse syri ynë nuk mund të funksionojë, nuk mund të shohë asgjë nëse nuk ka zorrë e plëndës, eshtra etj. Pra SHPIRTI është gjë abstrakte, është **mashtrim**, nëse e veçojmë, nëse e ndajmë nga **TRUPI**.

Edhe shkolla nuk është gjithçka, nuk mund t'i shpjegojë të gjitha gjërat. Dhe gjërat që nuk janë shkencore, janë irracionale, janë BRUMI I PARË, sepse fjala abstrakte siç është BESA, MIQËSIA, SINQERITETI etj. , nuk mund të maten me peshore, por e plotësojnë njëra-tjetrën, ashtu siç

janë fytyra dhe astari i një palltoje: pra njëra si fytyra që shihet, e tjetra si astari që nuk shihet (vdekja, hidhërimi, gëzimi etj), por përjetohet. Pra botën nuk e kuptojmë në tërësinë e saj, se cilët ishin tradhtarë dhe ujqër për kombin e tyre me mend e me zemër (shpirti – simpatia, urrejtja, janë të pashtershme – në magjen e irracionales)

ꕥ

Po cila është rruga dialektike e njohjes?

Prej të vërejturit të gjallë kah mendimi abstrakt, dhe prej tij kah PRAKTIKA, kjo është rruga dialektike e NJOHJES, thoshte Lenini. Prandaj, ata që i frikohen shkencës se ajo po i bën njerëzit të pa fe, ateistë, të tillët nuk janë askund, sepse duhet pajtuar që të dyja: edhe racionalja edhe irracionalja, pra fytyrën dhe astarin, të dukshmen dhe të padukshmen, konkreten dhe abstrakten… Por te ne duhet ta pranojmë se jemi shumë mbrapa, **se atë që e kanë zënë ethet dhe ka temperaturë mbi 40 gradë, ai sheh çdo gjë, halucinacione, flet jerm, flet gjëra të paqena**. Atëherë si bën që këta të tjerët rreth e rrotull tij t'ia marrin për të vërteta ato halucinacione?! Edhe ëndrra është realitet subjektiv, pra jo realitet objektiv, mirëpo rrënjët i ka në OBJEKTIVITET. Dikush mund të bëhet shkencëtar, por jo edhe njeri, nëse shkollimin nuk e ka të vërtetë. Ndërkaq shkolla socialiste nënkupton që çdo individ të arrijë sa më shumë dije dhe të bëhet sa më shkencëtar, por njëherësh edhe sa më **NJERI...** Shkollë ka pasur edhe Esat pashë Toptani – Tradhtari, pastaj Halit Tërnavci, Hasan Kaleshi e shumë pashallarë shqiptarë të cilët ishin tradhtarë dhe ujqër për kombin e tyre dhe u shërbenin armiqve të Shqipërisë. Edhe këta 130 shkencëtarët e vetëquajtur të Akademisë së Shkencave serbe po veprojnë si ujqër, sepse tërë një popull të pafajshëm po e shpallin – KRIMINEL, BARBAR dhe FASHISTË…, dhe kjo është argumenti më i mirë që na

tregon se ata e kanë humbur LUFTËN, sepse SHARJET, FYERJET, FJALORI ARROGANT është vetëm ARMË E TË LIGUT… Por duhet ta dimë se **i mbrapshti, kur shkollohet, bëhet 100 herë më i rrezikshëm se i pashkolluari**, sepse ai të VRET PËRMES TELEFONIT, dhe e vret tërë një popull. Niçe kishte thënë se: TË DREJTËN TË CILËN MUND TA RRËMBESH, MOS LEJO TË TA FALIN… E sot shqiptarët e mjerë po vrapojnë pas kolltukëve, pas karrierës, pas gradave boshe, dhe pushtuesi ta jep një herë një post, një gradë, dhe pastaj **tërë jetën të tërheq zvarrë për hunde si zagarin...**

ꕥ

A duhet t'i jepet BESA gjithkujt?

Jo, kurrsesi, sepse besa e cila i jepet secilit **është besë e QENIT, e jo e njeriut. Prandaj, njeriu mund të bëhet besnik si NJERI vetëm kur bëhet vërtetë NJERI**, kur bëhet i ditur, kur është vigjilent, dhe besën ia jep vetëm atij që e meriton, që është njeri. Mineralin e nxjerrin minatorët nga thellësitë e tokës, e pastaj farkëtarët e shkrijnë dhe prej tij mbarojnë veglat e punës: sëpatën, çekanin, draprin etj. , ndërkaq **MËSUESI** ua mëson fëmijëve historinë, të kaluarën e lavdishme, dhe kështu i vetëdijeson dhe i frymëzon me ndjenjën e atdhedashurisë, dhe poashtu i mëson si të ushqehen, me çka të ushqehen, dhe me një fjalë, i mëson për t'u bërë të dobishëm për vetveten dhe për shoqërinë…

ꕥ

Çfarë qëndrimi duhet të kemi ndaj LIBRIT?

Nuk duhet harruar se **LIBRI është ARMË E DITURISË**, dhe vlera e tij është më e madhe se e çdo kapitali tjetër, por ka rëndësi se cili libër përdoret si armë, dhe nuk duhet

harruar se LIBRI të VERBON nëse nuk shikon asgjë tjetër përveç librit, nuk shikon përtej librit, d.m.th. nuk e shikon REALITETIN OBJEKTIV, sepse disa libra janë si **MORTAJA!** Por t'mos harrojmë se nëse dikush e studion virusin e mortajës, kolerës, variolës, kjo nuk do të thotë se është i sëmurë nga mortaja ose kolera.

ꕥ

Këtu tani i sëmuri ka dalë mbi jorgan, dhe po shihet publikisht. Akoma më keq – atij tani po ia heqin edhe këmishën dhe po i shihen të gjitha të ZEZAT. Kështu siç po shkruajnë sot gazetat qendrore të Beogradit, kështu shkruanin edhe më **1924**, para 80 vitesh, dhe para 90 vitesh. Dhe vetëm nëse ua heq datën e botimit këtyre botimeve, aty do shohësh se si është derdhur njëlloj tërë mllefi shovinist, tërë helmi, tërë vreri, tërë urrejtja raciste serbomadhe. Tani plaga ka dalë mbi lëkurë, dhe do zgjasë më shkurt sesa kur ishte nën lëkurë, si një mish i egër, si kancer.

ꕥ

Por duhet ta dimë se nuk ka gjë më poshtëruese dhe më jonjerëzore se kur dikush e PËSHTYN VETVETEN NË FYTYRË, pra akuzon vetveten, dhe lejon për ta mashtruar të tjerët. Edhe foshnja që posa ka lindur e nuk ka bërë asnjë shkollë se si duhet thithur gjirin e mëmës, instinktivisht e kërkon ushqimin, reagon me zë të lartë, qan. Ndërkaq, kur një popull i tërë hesht, nuk reagon me zë, me alarm, me zjarr, atëherë ai popull është i vdekur, sepse e duron barrën e rëndë të robërisë **(Çajupi thoshte: SI S'TË LODHI ROBËRIA O SHQIPTAR! Mjaftë durove nën të tjerë mor fatkeq...)** Pra njeriu, sa më i moshuar të jetë, aq më shumë duhet t'ia shohë për të madhe vetes se pse po lejon të mashtrohet, pse po e lejon zgjedhën e robërisë, dhe pse nuk di ta dallojë **ROBËRINË NGA LIRIA**. Për

shembull thuhet: kam pasur besim te pushteti! Ose: kam rënë në gjumë e nuk e kam mbyllur derën. Edhe për këtë do ta paguash kamatën, sepse do të futet hajni brenda e do të t'i nxjerrë sytë…

ꕥ

Disa **sëmundje** shoqërore janë **kultivuar me shekuj, prandaj dhe me shekuj duhet të shërohen**, që do të thotë se terapia është shumë e ndërlikuar, me afat të gjatë, sepse zanafilla është shumë e moçme. Prandaj edhe mjekimi kërkon shumë kohë të gjatë…

ꕥ

Bomba atomike qe 42 vjet nuk ka rënë mbi kokat e njerëzve, që nga 6 e 7 gushti 1945 mbi Hiroshima e Nagasaki të Japonisë. Por edhe te një popull i vyeshëm e punëtor, siç janë gjermanët, aq të fortë, mu aty ndodhi hataja, mu aty u ndërtuan furrat – **krematoriumet**, ku digjeshin njerëzit pa mëshirë… Hitleri e mbajti pushtetin13 vjet, po mos vallë vetëm gjermanët ishin fajtor për këtë? Faj kemi edhe ne, popujt tjerë, që nuk i dolëm përpara nazifashistëve të tërbuar hitlerianë, siç ndodhi në Spanjë me Republikën spanjolle, sepse disa mendonin se gjermanët në ato furra do t'i digjnin vetëm rusët ose çifutët e jevgjit etj. Nga ana tjetër rusët mendonin se në ato furra Hitleri do t'i fuste anglezët, dhe kështu të dyja palët ia mundësuan Hitlerit ta bëjë botën shkrumb e hi duke përpirë rreth 60. 000. 000 viktima. Ndërkaq sot Gjermania e ka monedhën më stabile, 1 dollar – 2 marka gjermane.

ꕥ

Çfarë vlere ka muzika për njeriun?

Arti muzikor ka vlera të mëdha në kultivimin e vlerave njerëzore. Muzika e bën punën tonë më të lehtë, ajo na mobilizon, na çlodh. Për shembull kosari, gjatë tërë ditës, me atë ritëm si në balet. BALETI i bujkut është RITMI, si ai i kovaçit. Edhe Japodët (ilirët), në Likë, vallëzonin pa muzikë tingëlluese, por vetëm me ritëm, pra është muzikë origjinale, ku nuk dëgjohet instrumenti, por vetëm ritmi, ashtu siç është edhe FILMI PA ZË, ku Çarli Çaplini u dëshmua artist më i mrekullueshëm i epokës. Po cicërima e zogjve, e dallëndysheve, kënga e bylbylit, na jep forcë dhe kurajë për t'i përballuar punët e vështira, jetën dhe peripecitë e saj të përditshme…

ꕥ

Duhet t'mos e MBIÇMOJMË, por as ta NËNÇMOJMË vetveten, por të jemi të arsyeshëm, të jemi korrekt ndaj vetvetes, dhe përmes vetvetes ndaj të tjerëve, që sa më shumë t'i kristalizojmë anët negative dhe pozitive…

Ne jemi vonuar shumë për sa i takon çështjes së ARSIMIMIT të gjeneratave. Për shembull, në Gjermani, Suedi, Francë, Zvicër etj., mësuesi është trashëgues i kulturës së tri gjeneratave, gjyshi – mësues, babai – mësues dhe i biri – mësues. Pra një trashëgimi permanente kulturore. Por këtu nuk duhet harruar faktin se pushtetit okupator nuk i konvenon që të bëjë **seleksionimin – përzgjedhjen pozitive të kuadrove arsimore**, të mësuesve (p.sh. në Lypjan mësuesit po bëjnë grevë pse rrogat e tyre janë dy herë më të vogla se rroga e një shërbëtori në një organizatë ekonomike…). Por nëse duhet dikujt t'ia shohim për të madhe për gabimet që bëhen, atëherë më së paku kanë faj fëmijët tanë për mospunën, mossuksesin, mosdijen, për sjellje të çoroditura etj. Në këtë pikëpamje më së paku 50% e fajit i takon prindit të fëmijës, dhe më së paku 50% i takon mësuesit të fëmijëve. Atentatin e parë mbi mësuesin, plumbin e parë, ia jep vetë prindi, kur thotë – kush po të mëson? – Filan Filani. E po nënën, se ai është

i poshtër, ai është gomar! Pra mësuesi dhe prindi duhet t'i bashkërendojnë punët në procesin edukativo-arsimor, e jo njëri thumbit, e tjetri patkoit, dhe fëmija i vuan pastaj pasojat e këtyre konflikteve. Por edhe kur prindi shkon e i lutet arsimtarit, që fëmijës së tij t'ia falë një notë, kjo është njësoj e dëmshme sikundër të shkoni te kirurgu dhe t'i thoni: shoku mjek, ky sy po i pengon tjetrit, **ju lutemi t'ma nxirrni këtë sy?!** Një mësues i tillë i cili punon me hatër, dhe i privilegjon ose i ndëshkon nxënësit e tij sipas bindjeve të tij subjektive, është **MËSUES KRIMINEL,** sepse i verbon nxënësit e tij, dhe ai duhet të konsiderohet **hajni më i madh i një shoqërie**. Nga ana tjetër, mësuesi i devotshëm dhe pedagogu i vërtetë është njeriu me më shumë vlerë në një shoqëri. Por duhet ditur se prapa ARSIMIMIT TË DOBËT është shteti obskurantist dhe i dobët të cilit i duhet kthyer pushkën. Prandaj, NOTA, ashtu si edhe LIRIA, kurrë nuk FALEN, por FITOHEN, meritohen, me mund e sakrifica të mëdha, sepse kur ta falë dikush një gjë të cilën nuk e meriton (nuk thuhet falma LIRINË nja gjashtë orë), herët a vonë do t'ia shohësh sherrin. **PADITURIA** është ai "bishti" i gjatë në KOKËN tonë, atavizmi i njeriut të shpellës, prandaj duhet të luftojmë pa kursyer asgjë që ta heqim këtë "bisht", që pastaj t'mos na heqin të tjerët për veshi…

ꕥ

A harxhohet dija?

Po, harxhohet, sepse një gjë të cilën e kemi mësuar dje, sot mund ta harrojmë, sepse edhe harresa është proces. Sidomos mësuesi, i cili duhet t'i mësojë të tjerët, patjetër duhet të mësojë edhe vetë pa pushim, dhe të jetë edhe vetë **NXËNËS** i përhershëm, sepse mësuesi i mirë mëson edhe nga nxënësi i klasës së parë fillore. Po ç'mund të ndodhë me fëmijën i cili katër orë është në shkollë, ndërsa 14 orë

qëndron i gozhduar para ekranit televiziv? Ai fëmijë bëhet person i tjetërsuar, i humbur…

Njeriut është faktor përcaktues për ndryshimin e një epoke, të cilës nuk i ka hije të ekzistojë… Pas 13 vjetësh Hitleri me hu e me konop, me furra e krematoriume tmerroi botë, por më në fund u detyrua që me plumb në gojë ta likuidojë vetveten, dhe si rezultat i kësaj kemi MURTAJËN KOLEKTIVE: NDARJEN E GJERMANISË NË KATËR SEKTORË E PASTAJ NË DY GJERMANI, në Gjermaninë Lindore dhe Gjermaninë Perëndimore, dhe që 42 vjet në tokën gjermane lëvrojnë trupat amerikane dhe trupat ruse, për t'i ardhur puna një Gjermanie, si rasti i J. Shtrausit, ta vizitojë Shqipërinë dhe t'ia ketë LAKMI për PAVARËSINË e saj të vërtetë…

Po mirë, a kishte faj populli gjerman për fatin e tij?

Po, si nuk kishte, sepse e lejoi ardhjen në pushtet të një partie naziste, dhe në krye të kësaj partie të zgjedhë Adolf Hitlerin!

LIGJËRATË, 27 prill 1987:

Filosofi Rene Dekart ka thënë: **DYSHO DERI SA TA NJOHËSH NJË GJË.**

ꕥ

1500-2000 vjet para epokës sonë te shqiptarët kremtohet Dita e Shën Mitrit. Mitra – masa e çdo gjëje, rendi i përgjithshëm, rendi i jetës, pastaj tërë një sistem – rrymë helenistike, u quajt MITRAIZMI, që nga Leka i Madh e këtej, ndërsa nga grekët e marrin romakët. Shën Gjergji, Shën Mitri, relacion ekuivalent kohor…

ꕥ

Padituria – vakum, ZBRAZTËSI. Duhet plotësuar me FANTAZI, me ëndrra, halucinacione...

ꕥ

Po, ç'mund t'na thoni për VDEKJEN?

VDEKJA ËSHTË ÇMIM I JETËS, ndërsa çfarë çmimi do t'i japim varet nga vetja jonë. Këtë çmim do e paguajnë vetëm heronjtë dhe dëshmorët, të cilët u sakrifikuan për të mirën e njerëzimit, pra jo të gjithë.

ꕥ

Xhozefina, gruaja e Napoleonit, ishte prostitutë, e përdalë, siç ishte edhe Hatixheja e Muhamedit, dhe Xhozefina e bëri Napoleonin Napoleon, ndërsa Hatixheja e bëri Muhamedin – Muhamed - profet... Jakobinët ishin antifetarë...

ꕥ

Kur mund të quhemi të FORTË?

I fortë je kur di ta nisësh dhe kur di të ndalosh. I fortë është ai i cili në radhë të parë e fajëson vetveten për çdo dështim. Merreni p.sh. vozitësin! Ç'është këtu rastësi e ç'është domosdoshmëri në fatkeqësi? Ose, ç'ishte në fillim Linkolni? Ai ishte një punëtor që mbante fenerin në hekurudhë, dhe zotësinë e tij si burrë shteti e pagoi me plumb në ballë…

ꕥ

SHPRESA është kategori pozitive psikologjike, përbrenda masës, arsyes, sepse po të shpresoni jashtë masës nuk mund t'ju shpëtojë as klinika psikiatrike…

ꕥ

Si ndikon faktori i rrethanave shoqërore? **Shopeni** nuk do të bëhej Shopen në Poloni, por në ambientin francez, sepse ia mundësoi Zhorzh Sandi. Edhe **Nikolla Teslla**, po të qëndronte në ambientin e Likës, kurrë nuk do të arrinte të bëhej ai që u bë në Amerikë.

LIGJËRIME, 16 qershor 1987:

Te kinezët fëmijëve ua mbështjellin këmbët, bile edhe ua deformojnë, që këmba të jetë sa më e vogël, sepse sipas traditës së tyre **këmba e vogël e ka fatin e madh?!** Por edhe të ne duke ndjekur modën disa arsimtarë janë detyrua të shkojnë te ortopedi në Shkup e Beograd për t' i mjekua këmbët e deformuara me këpucë të ngushta-shpic.

Nataliteti logaritet punë shumë e vështirë, sepse fëmijët duhet t'i rritësh fizikisht dhe shpirtërisht, që do të thotë se rriten edhe gajlet...Nataliteti është produkt i realitetit objektiv, sepse kanë munguar zgjidhjet e mirëfillta ekonomike dhe politike, përndryshe nuk do të kishim këto raporte të pabarabarta siç i kemi sot-4:1...Për nënën e vërtetë është program IN VIVO(i gjallë), kur fëmija qanë tërë natën, është program më i këndshëm se sa programi televiziv, teatri etj.

ꕥ

Në Kinë është bërë qysh në fillim kodifikimi i interesave pluraliste, vetëqeverisëse , kur thuhet-le të lulëzojnë 100 lule, 100 shkolla etj. Shpenzimi i tepërt i energjisë e rraskapitë njeriun, e lodhë, dhe pastaj ai njeri kompleksohet dhe nuk din kah t'ia mbajë...Duhet të jemi të vetëdishëm se jemi vonuar shumë, sepse nuk jemi përgatitur me kohë për sfida...Nëse **lejojmë t'na qesin litarin në qafë,** atëherë ne e meritojmë litarin...Tani po

punohet me të madhe që sa më shumë me e shty, me e vonua zgjidhjen e problemit të kërkesave të shqiptarëve edhe **për 20-30 vjet**, por në këtë krizë botërore duhet gjetur miliarda dollarë për sanimin e gjendjes, sepse Jugollavia është RAST KLINIK...Dhe dihet se as Jugollavia e Aleksandër Karagjorgjeviqit nuk arriti ta ndryshoi strukturën e popullsisë në viset e okupuara shqiptare dhe të arrijë në përpjesëtimin 50%:50%(Shih-regjistrimin e vitit 1931, kur përkundër gjithë atyre masave raciste të kolonizimit dhe detyrimit me dhunë të shpërnguljes së shqiptarëve, Jugosllavia nuk arriti të ketë 50% të popullsisë serbo-malazeze në Kosovë). Por ky proces i shpopullimit u ndërpre me okupimin nazifashist të Jugosllavisë më 1941. Por ne kur nuk i njohim shkaktarët negativ të këtyre gjerave , atëherë kapemi për din e iman?! Në çastin kur ne do t'i merrshim të drejtat e barabarta me popujt tjerë në federatën jugosllave, atëherë mbaroi Shqipëria, sepse ne në Kosovë do **bëhemi varrtarë potencial...**Këta neve po na hapin sytë me zor, sepse puna jonë është çështje ekzistenciale e jo pallavër. Puna jonë është si puna e **Dardaneleve** që të mëdhenjtë nuk kanë arritur ta ndajnë...**DOBËSIA** është faji më i madh i joni, sepse e drejta shkon me fuqinë, dmth. **sa më i FORTË, aq më shumë të drejta realizon...**Populli po dëshiron me pa ëndrra, nuk po donë me ia prish vetvetes GJUMIN shumëshekullor ?!

ꕥ

Kur ndaj natyrës veprojmë egërsisht, ajo na kthen edhe më egërsisht, me kamatë. Për shembull si guxojmë të **ndërtojmë në mënyrë të egër dhe ta mbulojmë sipërfaqen e tokës së bukës me beton? Kjo është një VETVRASJE e ngadaltë,** por e tmerrshme...

ꕥ

Elementi hungarez në Vojvodinë ishte modernizua dhe e pagoi me Bačkë e Banat, ndërsa ne aq sa jemi mbrapa në modernizim, për aq e paguajmë edhe kamatën e këtij modernizimi nëse kemi vetëm një ose dy fëmijë, sepse egoizmi nuk i lejon për ta ndarë kafshatën me shumë fëmijë, me jetua vetëm. Neve pa të drejtë po na akuzojnë pse kemi shumë fëmijë, ndërsa serbo-malazezët kanë më pak...Të mirat materiale duhet me i pagua me botëkuptim, me SHPIRT, Do kemi shumë pak HUMANIZËM nëse nuk humanizohet modernizimi...Dehumanizimi, çnjerëzimi, parakupton vetëm anën komerciale, duke e harruar jetën e gjallë, duke i dhënë rëndësi një aparati kasetofon, diskotekë, videorekorder, dhe thotë-**më mirë t'i kem dy videorekordera se sa dy fëmijë**, dhe kështu u jep përparësi gëzimeve teknike e jo gëzimeve të gjalla fëmijëve, të cilëve duhet me ua pastrua pelenat çdo ditë...

ꕥ

Nëse gazetat e përditshme dhe javore **botojnë 99% rrena dhe 1% të vërteta**, dhe kjo vetëm për t'i mbuluar marrinat, atëherë në ato gazeta nuk ia vlen as të urinojmë...S. Riza erdhi nga misticizmi dhe pranoj të bëhej instrument, dhe përkundër faktit se ka aftësi të merret me gjëra shkencore, po merret me ideologji joshkencore,dhe shkencën po e përdor për gjëra tjera,joshkencore, si urithi, ka elemente të shumëfishta si Fadil Hoxha,por me platformë tjetër(Vëllezërit myslimanë?!). Edhe lopa e mbushë enën me qumësht, por nëse i mëshon shkelëm enës, qumështi merr fund...Punëtori i cili punon tërë ditën dhe në mbrëmje gjithë fitimin me djersë e len në kafe, lirisht mund ta quajmë - **LOPË ME DY KËMBË**...Kështu janë edhe ata të cilët e studiojnë shkencën për të mundur pastaj me e shkatërrua shkencën... Përmes Hasan Kaleshit me eliminua universitetin, sepse është dhëndër i tyre, por edhe djalë i hoxhës nga Kërçova...Këta nuk janë marrë me emancipimin kombëtar... Kjo është fatamorgana

(mashtrimi optik-BK) i Skënder Rizës, sepse po kalon në MISTICIZËM; shumë shkencëtar, por shumë larg nga populli. Te ne po programohet që edhe 50% me shkua huq, firo, ndërsa ai i cili LUFTON që të mos programohet mbrapshtia-DËNOHET. Po bëhet çmos me i **JUGOSLLAVIZUA shqiptarët**, me i asimilua, duke ua ndaluar edhe ÇIFTELIAT dhe këngën popullore, siç pretendon Ali Shukriu, dhe në këtë drejtim jugosllavët po kërkojnë NDIHMË nga Evropa, siç kërkonin më 1924; stili i njëjtë, kërkesat e njëjta me moton: çështja jonë është çështje edhe e Evropës, si sponsoruese e shtetit fantom jugosllav, duke thënë se-NE PO LUFTOJMË jo vetëm për shpëtimin e civilizimit serb, por po luftojmë edhe për ta shpëtuar Evropën dhe botë nga INFEKTIMI vdekjeprurës shqiptar, por Evropa i kupton shumë mirë këto këlthitje shqiptarofobe...Këto po i thotë D. Qosiqi për misticizëm në shërbim të mesjetës, sepse tërë një popull të lashtë autokton në trojet e veta që nga pellazgo-ilirët po e trajton si LUGAT?!

ꕥ

100.000 vjet kanë sunduar gratë, nënat, gjatë epokës së MATRIARKATIT (Kujtoje mbretëreshën nëna TUTË), ndërsa para 2000-3000 vjetësh, si të thuash dje a pardje, filloi epoka e PATRIARKATIT, sundimi i burrave, dhe **për kaq kohë ne ju kemi borxh të madh nënave tona**. Tani jemi në fazën e ndarjes së sundimit të burrit me gruan, në epokë e barazisë gjinore...Dhe siç po shihet në jetën e përditshme ne ende nuk po arrijmë të shkëputemi nga tradita mijëvjeçare...Ne s'mund të dalim jashtë lëkurës duke i kërkuar gjerat e pamundshme, sepse gratë ende e kanë në gjak për të qenë të nënshtruara, dhe nuk mburren me ata burra që janë të dëgjueshëm, shmoklana...P.sh. gratë e Zvicrës po kërkojnë mos me u marrë me politikë, mos me i gëzua të drejtat e barabarta me burrat, sepse nuk po kanë hesap. E drejta e votës është e drejtë e madhe e ato gra zvicerane nuk po kërkojnë me e gëzua të drejtën e

votës, por nga ana tjetër në asnjë vend të botës nuk kemi respekt të ndërsjellët në mes të burrit dhe gruas siç e kemi në Zvicër. Punët e shtëpisë atje i kryejnë gratë, pa një orar të caktuar për 24 orë, dhe kur këtyre ua shtojmë edhe aktivitetet politike, atëherë ato nuk po kanë hesap...Nga kjo po del se Zvicra **është vendi më patriarkal** në Evropë, por pa terror, pa nënshtrim, nën ndikimin e kishës PROTESTANE (Kalviniste), pa mbisundim të burrit ndaj gruas...Kështu FEJA në botën moderne u zëvendësua me ideologjinë politike, sepse edhe vet shteti ka nevojë për funksionin e fesë në shërbim të shtetit, duke e për gatitur popullin se si të jenë sa më të dëgjueshëm ndaj pushtetit shtetëror...Tani klerin politik nuk e thërrasin kler politik, **por POLIC**, SPB, UDB-ja etj. Kështu ideologjia religjioze u diferencua në ideologji politike...

ꕥ

Askush nuk mundet me jetua pa ZOT. Po çka është ZOTI? **Periudha INFANTILE** (foshnjore) e shoqërisë njerëzore, periudhë e zhvillimit primitive që tenton me e mbajtur popullin në stadin e FOSHNJËRISË, që do të thotë se nuk ke hesap me u marrë me atë ideologji-me magjen plot ideologji iracionale, me **GATUA ËNDRRA?!** Kjo **psherëtimë e një bote pa shpirt,** siç thoshte Marksi... E dihet mirë se me çfarë QELBI është mbushur shpirti i individit borgjez...Njerëz sadistë, me tipare të tmerrshme morale, mjeshtër të TIRANISË që po ia pinë gjakun popullit...Në këtë kontekst as vetë nuk mund ta dimë shkallën e varfërimit INTELEKTUAL të borgjezisë dhe mbi domosdoshmërinë e **likuidimit të saj si një MBETURINË HISTORIKE**, e cila duke u kalbur çdo ditë e çdo orë, po e helmon botën me helmin e kufomës së saj...Proletariati duhet të bëhet një herë e përgjithmonë i vetëdishëm për domosdoshmërinë e **zhdukjes së shkakut kryesor të te gjitha të KËQIJAVE dhe mjerimeve të jetës-TË PRONËS PRIVATE.** Bota punëtore duhet të bëhet e ndërgjegjshme mbi domosdoshmërinë e

REVOLUCIONIT! Ne duhet të jemi në anën e moralit të **ATIJ QË NGRE KRYE**, kryengritësve, çlirimtarëve, e jo në anën e moralit të SKLLËVËRVE që durojnë zgjedhën e robërisë! Dhe nëse është e nevojshme të flasim për gjera të "SHENJTA", atëherë , siç thoshte Maksim Gorki, **e SHENJTË është vetëm PAKËNAQËSIA e njeriut me vetveten dhe dëshira e tij për të qenë më i mirë se ç'është në të vërtetë;**

e shenjtë është URREJTJA e tij kundër gjithë rrangallave të jetës, të krijuara prej tij;

e shenjtë është DËSHIRA e tij për të zhdukur nga toka ZILINË, PANGOPËSINË,KRIMET,

SËMUNDJET,LUFTËRAT dhe çdo armiqësi midis njerëzve;

e shenjtë është PUNA e tij... Por shtrohet pyetja-po si po qëndron ende e fortë godina e shoqërisë kapitaliste? Dhe duhet të themi shkurt se mbahet nga pesha e saj, nga INERCIONI dhe levat që ndihmojnë ngadalësimin e kalbëzimit të saj siç janë-

POLICIA,

USHTRIA,

KISHA-RELIGJIONI dhe

SISTEMI I ARSIMIT. Prandaj për ta shkatërruar këtë piramidë të madhe ndyrësirash, gënjeshtrash dhe gjithë të ligat tjera, duhet një goditje e ashpër mjaftë e organizuar dhe jo veç e veç, por bashkërisht dhe nga të gjithë...

Një poet kishte thënë se: **NUK KA VUAJTJE MË TË MADHE SE VUAJTJA E FJALËS**, dmth. kur nuk arrijmë të themi atë që duhet thënë me fjalë të goditura, dhe artisti i vërtetë i popullit duhet të jetë **SYRI, VESHI dhe ZEMRA e POPULLIT**, zëri i epokës së tij...Por për ta arritur këtë aftësi duhet të jemi shumë të armatosur me armën e dijes-**LIBRIN**, të cilin më pak se gjithë sendet tjera mund ta quajmë SEND, sepse ai është NJË QENIE E GJALLË QË FLET! Por a dimë ne të komunikojmë me këtë send të gjallë, pikësëpari a dimë të LEXOJMË? Gëte një herë

kishte pas thënë: **i mbusha 80 vjet dhe ende nuk mësova të LEXOJ?!**

ꕥ

Ne duhet t'ia ndijmë erën (aromën) PERSPEKTIVËS, ardhmërisë...sepse edhe më trimi atrofohet, degjenerohet, shteret...Këto marioneta po punojnë natë e ditë që të realizohen objektivat e tyre ogurzeza, që asgjë të mos MENDOHET SHQIP, por SERBISHT, dmth. Shqiptarët edhe kur flasin shqip, **të mendojnë serbisht**, që do të thotë-të mos ekzistojnë si shqiptarë, por si SERBË që flasin shqip...Dhe kjo mbështetët në tezën raciste se-**SHQIPTARËT JANË POPULL SERB I SHQIPTARIZUAR** (POARBANASHENI SERBI). Kjo tezë lindi nga filli i shekullit XX, themelues i të cilës ishte Dr. Jovan Cvijiq. Kështu problemi i shtruar në këtë mënyrë absurde, jo dialektike, dhe efekti është NEGATIV, sepse problemi është shtruar negativisht, dhe pasojat i kemi negative... Ideologjia e kombit serb nuk mund të jetojë pa IDEOLOGJINË KISHTARE orthodokse serbe. E kundërta ndodh me ne shqiptarët ku FEJA e luan rolin **ANTIKOMBËTAR**, përçarës, dispërziv, shkatërrues, reaksionar, kundërrevolucionar...Kishën katolike (98%) në Francë e ndaluan jakobinët, ndërsa 2% e ebrejve dhe protestanëve nuk e ndaluan. Robespjeri dhe vetë borgjezia në fillim e pranuan, sepse kishin interes, derisa nuk arritën ta minojnë jakobinët, por ky sundim ateist nuk zgjati më shumë se tre vjet... Kjo është një leksion historik shumë domethënës për shoqërinë e sotme shqiptare përballë sfidave të rrethimit të egër, dhe këtu e 20 vjet më parë po **e mban pushtetin ATEIST, sepse ideologjia KOMBËTARE e zëvendësoi ideologjinë fetare**. Një hap ky shumë i vështirë, por i mundshëm dhe shumë revolucionar...De Rada, Naimi, Samiu, Hasan Tahsini dolën nga lëkura fetare, ndërsa sot alamet doktorë, të mendermethënshëm, po kultivojnë ideologji mistiko-fetare. Rektorin e parë të UNIVERSITETIT të Stambollit, i cili iu ligjëronte

studentëve lëndën e Fizikës dhe Astronomisë, **Hoxhë Hasan Tahsinin**, pushteti obskurantist turk e shpallën ATEIST, sepse ishte atdhetar, dhe ishte anëtar i shoqërisë shqiptare të Stambollit...

ꕥ

Në asnjë pikëpamje nuk jemi kah shkojmë hë për hë kah bashkimi, sepse sikur të bëhemi SHTET, atëherë MBAROJMË SI KOMB. Për këtë Kosova është preokupim themelor, gur PROVE, sepse kjo republikë mundet me ia sjellë të mirën Jugosllavisë, **dhe përmes saj me e hëngër edhe Shqipërinë?!** Salvador Alendën e solli në pushtet borgjezia e Kilit, por kur ky filloi nacionalizimin e minierave të shalitrës dhe bakrit, erdhi në skenë diktatori fashist Pinoçeti, dhe ky fashist i tërbuar përmes amerikanëve e likuidoi mizorisht Aliendën (ky gjeneral vetë e kishte sjellë Aliendën në pushtet) duke e shpallur **marksist**. Por amerikanët edhe pse Pinoçeti nuk ua ktheu monopolet e minierave të bakrit, u përcaktuan për Pinoçetin, sepse reaksioni ndërkombëtar është unik dhe përherë e zgjedh të keqën më të vogël, për të mos rrezikua edhe një vatër të re të komunizmit në Kil. Në këtë kontekst **edhe në rastin e Kosovës reaksioni ndërkombëtar është shumë UNIK, dhe po e zgjedh të keqën më të vogël, me ia dhënë Kosovës të drejtat**, dhe përmes saj në një të ardhme të afërt me e gllabërua edhe Shqipërinë dhe duke e bërë restaurimin e rendit shtetëror kapitalist , në vend të socializmit. Por mekanizmi i vetëmbrojtjes në Shqipëri u aktivizua me tërë intensitetitin dhe potencialin e forcave duke ndërtua 800.000 bunkerë për t'u vetëmbrojtur nga ndonjë sulm eventual nga ajri dhe nga toka, si dhe nga varrtarët potencial shqiptarë...Por të gjitha këto janë koncepcione të klikës tiranike në pushtet, e jo të popullit serb, sepse policët më 1981 erdhën në Kosovë dhe u shpërblyen me nga dy rroga, për ndarje familjare, sepse populli po e kupton qëllimin e klikës e cila po synon ta

fusë edhe një herë populli me derdh gjak gjoja për mbrojtjen e Kosovës, **"djepit të Serbisë"...**Dhe peshkaqenët e superfuqive po sa të krisë pushka e ndiejnë erën e gjakut kafshojnë edhe më keq, sepse secili peshkaqen vrapon me e marrë copën e vet...Në Shoqatën e shkrimtarëve serbë , në Francuska 7 në Beograd, D.Qosiqi po thotë se shqiptarët u egërsuan edhe më shumë kur bënë shkollë e universitet, sepse ata pa shkollë ishin GJYSËM të egër, e këta me fakultet janë stërbarbar, por asnjë shkrimtar nuk po distancohet prej tij...aty në atë shoqatë po mbahet mesha liturgjike si në manastirin e Studenicës, por nuk duhet harrua se faji ynë është më i vogël, sepse ata më së shumti sherr po i bëjnë vetvetes, sepse ata po manipulojnë me popullin serbë, po e shtrydhin si brumin, e populli e ka parë policinë si po vepron, tri orë ecje këmbë, dhe po i ndalë në çdo 15 minuta, e populli nuk po përzihet në demonstratë, sepse nuk po donë me derdhë gjak. Pra, me ekzistua Jugosllavia, por jo aq e fortë sa me e rrezikua Shqipërinë, ndërsa ne duhet ta shfrytëzojmë këtë primitivizëm, PLEHUN, me e dërgua në arë, me e bërë bukë...Ne duhet të investojmë shumë mund e sakrifica që të këqijat me i shndërrua në të mira, **e ne po kërkojmë REPUBLIKË, e prej kujt? Prej shtetit i cili e ka në program me na ZHDUKUR NGA FAQJA E DHEUT?!** Federata jugosllave po fiton dyfish e nuk po humb asgjë, vetëm po e sakrifikon SHOVINIZMIN serb, por këta nuk po pranojnë.

LIGJËRATË, 1 korrik 1987:

Dikur kemi qenë ndër popujt më të vetëdishëm për përkatësinë e gjakut, të te njëjtës përkatësi kombëtare, e tani kemi paradoksin kur thuhet-na jemi të një gjaku, por shyqyr që nuk jemi fanë apo katolikë. Kështu flet edhe prifti për hoxhën, por edhe shehu për popin. Për përkatësinë e gjakut janë të vetëdishëm, por jo edhe për

përkatësinë e kombit. Më 1912 gjysma e shqiptarëve u pavarësuan, ndërsa gjysma tjetër u gllabërua nga pushtuesit. Feja katolike është universale-Papati...Të paktën 150 milionë kinezë janë katolikë, në lindje të Pekinit, kinezë myslimanë...

ꕥ

Një udbash, autoritet pushtetar serb, më 1956 gjatë aksionit të armëve, kur e shqoi çiftelinë e varur në mur të shtëpisë së një shqiptari iu duk sikur e pa Hitlerin, krematoriumin, dhe tha-to je vrazhji instrument, divljaçki instrument (Kjo është vegël e djallit, vegël e egërsirës)

ꕥ

S'ka jetë pa hile, por a me qëllim a pa qëllim, me plan e program. Në praktikë hileja e krimi janë pjesë e të vërtetës, pjesë e praktikës...Edhe Millosh Cërnjanski , një shovinist i tërbuar, është njëri nga ata studiuesit e historisë së Skënderbeut. Në librin e M. Jançiçit-Kako sam izdao svoju naciju **(Si e tradhtova kombin tim)** shqiptarët aty konsiderohen si një sëmundje, si dergjë, dhe pasi nuk kemi arritur t'i likuidojmë me teoritë tona, prandaj duhet me marrë masa që sa më tepër me u ruajt prej tyre, e ne kemi pritë që Jugosllavia të merr masa, por Jugosllavia po gabon, e më së shumti ka gabuar kur e ka lejuar hapjen e Universitetit në Prishtinë dhe me këtë atyre iu është dhënë ARMA kundër Jugosllavisë (i time dato im je oruzhje protiv Jugosllavije). "Svaki shkollovani shiptar predstavlja jedan potenciallni grobar Jugosllavije**..."Çdo shqiptar i shkolluar për ne është një VARRTAR potencial për Jugosllavinë")**.Ujku ia ka dhënë besën qengjit se nuk do ta hajë para Shëngjergjit...Shteti është aparat dhunë, por varet se në duart e kujt është, në duart e klasës punëtore apo në duart e klasës kapitaliste...

OMNIS HOMO FORTUNA FABER EST
(Çdo njeri është farkëtar i fatit të vet)

PLAKU iu ndihmon të tjerëve duke u dhënë KËSHILLA. Nastradin Hoxha thuhet se ishte nga Uzbekistani i sotëm(1280).

Vetëm pse ishte nën nivelin e detit e quajnë DETI I VDEKUR...Lumi Jordan, si Bistrica e Pejës, derdhët në të, por avullimi shumë i madh bën që aq sa hyn ujë në të aq edhe avullohet, dhe kështu ngelë niveli detar i ulët...

Aftësia e njeriut shpenzohet me inteligjencë, ndërsa te kafshët kjo aftësi është instiktive, e nënvetëdijshme, iracionale. P.sh. Bletët, rosat e egra etj. shumë më herët e parandjenjë katastrofën e vullkaneve, tërmeteve etj. Pra sjellja e tyre e veçantë na paralajmëron katastrofën që do t'na godet. Por në raste shumë të rralla këto aftësi telepatike, të nënvetëdijshme, i kanë edhe disa njerëz të cilët na paralajmërojnë për katastrofën.

ꕥ

VATIKANI është superfuqia e tretë për kah potenciali ekonomik?!

ꕥ

Nëse nuk dimë me e përdor KURANIN , BIBLËN e UNGJILLIN do të digjemi.

Në shumë sure të KURANIT shkruan se **tradhtarin e vendit duhet me e mbyt me gurë...**Marksi më së miri e njohtë BIBLEN dhe TALMUDIN, sepse ka qenë i familjes së priftërinjve,tipik jahudi, dhe është konvertua nga feja hebreje në fenë krishtere. Mjekra ia ka mbulua vijat fizionomisë hebreje semite, dhe për arsyen ekonomike e ka studiuar Biblën. Feja shërben si DROGË kur interpretohet keq, dhe shteti ka nevojë për një funksion

të tillë të religjionit si njëra nga levat kyçe për mbajtjen e pushtetit (Funksioni i xhelatit dhe funksioni i priftit, funksioni i kërbaçit dhe kulaçit)...

Në kohën e pushtimit bullgar(1917) hoxha i Breshancit të Therandës i porosit xhematin që të vijnë në xhami të premten për ta bërë një dua-lutje për ta hequr qafe armikun bullgar. Njëri prej djemve të fshatit u nis për në xhami dhe po i thotë të atit se jemi duke shkuar të gjithë në xhami për të bërë lutje me na u hequr qafe armiku, por babai i urtë ia kthen të birit-hiqu mor budalla, kapi qetë dhe **shko me punua në arë se nuk hiqet armiku me lutje të hoxhës së Breshancit, por duke ia kthye gjylet e topit.** Pak më vonë u dëgjuan nga larg krismat e topave të bullgarit. Babai iu drejtua sërish të birit me këto fjalë-dëgjoje mirë krismën e topave, këta e detyrojnë armikun të largohet nga ky vend...

ꕥ

Lufta, varfëria dhe epidemia janë ilaçi më i mirë për ta mbuluar korrupsionin e pushtetmbajtësve...Xhonatan Suift në librin**-Përralla e fuqisë dhe satira tjera**, i shembi vlerat false të fesë, reaksionit, klerit, edhe pse ndonjë herë ishte tregua eklektik ndaj saj... PËRRALLA E FUQISË është një satirë e fuqishme kundër fesë dhe shtetit aristokratik –borgjez të shekullit XVII-XVIII. Në këtë vepër satirike stigmatizohen qeveria angleze, pseudoshkencëtarët, pseudokritikët e shkrimtarucët e kohës me një histori në formë përralle nëpërmjet së cilës autori ironizon me forcë realiste rrënjët e zhvillimit të sekteve kristiane. Autori u tregon, veç tjerash lexuesve për një zakon të vjetër të detarëve **kur janë të rrezikuar dhe ndiqen nga ndonjë balenë, ata hedhin në ujë një fuçi boshe për t'i shmangur vëmendjen balenës nga anija...** Kuptimi alegorik i përrallës ka këtë kuptim: FUQIA BOSHE-simbolizon **FENË** që përdoret si mjet nga shteti (anija) **për të gënjyer popullin**, për t'ia larguar vëmendjen

popullit nga domosdoshmëria për t'u përpjekur për të drejtat e tij...Veçanërisht tronditëse janë rreshtat plot zemërim që përshkruaj mjerimin ekstrem të fshatarit të varfër irlandez, në gjoksin e uritur e të leckosur të te cilit është shkruar me dhembje:

NOSTRA MISERIA MAGNA EST (lat. Mjerimi ynë është i madh)...

ꕥ

LIGJERATË, 12 korrik 1987:

Kur poeti(Çajupi) thotë - **Ku është balta më e ëmbël se mjalta?** Këto fjalë romantike e kanë efektin patriotik vetëm në epokën dhe rrethanat e caktuara...

Fjala e parë në luftë ka qenë **IDEALI,** fjalë kjo e cila nuk mund të matet në peshore, por vetëm me peshoren e PRAKTIKËS me dëshminë e luftës, gatishmërisë për sakrificën sublime për Atdhe...Në mesjetë realistët kanë qenë IDEALISTA. Nocioni i realitetit përfshin edhe idealitetin edhe materialitetin. Çdo gjë që bën efekt ekziston. Çdo përgjithësim më tepër se sa duhet sjell dëm. Nuk duhet me u hidhura, me ia pa për të madhe pse dikush vuan nga GANGRENA, e dihet se gangrena nuk zhduket me lutje, por me sharrë e bisturi(skalpel) të mjekut specialist, kirurgut... **Këto gangrena religjioze nuk eliminohet vetvetiu edhe sikur të prisnim edhe 3000 vjet, por me revolucion...**

Sot shkenca e medicinës ka arritur deri aty sa që në epruvetë, në laborator po shihet zhvillimi embrional i fëmijës, dhe cilës gjini i takon, dhe kështu kleri e ka argumentin gjenetik për t'i bindur besimtarët se Shën Mëria është mbarsur me perëndinë pa pasur kontakt me të, e jo siç është në të vërtetë me hasreti Isufin(Zefin,Josifin)...

M. Renovica po thotë se ne mund t'i sakrifikojmë këta udhëheqësa, siç i presim thonjtë e duarve kur na

pengojnë, nëse kjo shkon në dobi të shtetit...Këto referate nuk janë sintezë e punës shumëvjeçare të një individi, por e një armate të tërë specialistësh, sepse këtu nuk është fjala për një selektor individual (Mos ta harrojmë rolin vendimtar të Shërbimit informativ në Armatën Jugosllave-KOS-i, të cilët kishin në dispozicion edhe avionët, dhe çdo gjë që u duhej...)

Mësuesi vjen prej Shumadije, e mëson gjuhën shqipe me kurse me na i mësua fëmijët tanë, që ata të mësojnë për festën kombëtare 1 dhjetorin (1918) e jo për **Ditën e Flamurit, 28 Nëntorin e 1912-ës...**

Zbuluesi i fosfateve, plehrave kime, sa edhe zbuluesi i traktorit dhe kombajnës, sepse e ka trefishua rendimentin e drithërave të bukës...Për këtë në disa vende nëse e ke shkrua me shkronjë të vogël fjalën MIKROB, PLEH, Jezu Krisht, Perëndi etj. të konsiderojnë se je analfabet, injorant...

ꕥ

Gjerat më të mira paguhen me çmimin më të lartë, dhe nuk është imorale nëse kërkon gjera më të lira, por nëse kërkon falas, atëherë ti je IMORAL, sepse edhe në bukën që hamë, edhe në fasule, patate, domate etj. ne duhet ta shohim djersën e dikujt, mundin e punëtorit...Nuk është morale me qenë injorant, por IMORALE, sepse injoranti kërkon gjera të gatshme, pa djersë, falas...

Komunën e Parisit e pushtuan drejtpërdrejtë punëtorët. Komunarët trima i zunë robër lufte 12 gjeneralë të armatës, dhe po e pyesin **Marksin** në Londër se çfarë të bëjnë me ata 12 gjeneralë. Marksi i pyeti punëtorët-po çka po lypni ju? Dhe punëtorët i thonë se duam ta këmbejmë L. Blankun që ishte në burg me ata 12 gjeneralë, dhe Marksi u pajtua i bindur se një gjë e tillë mbush shumë hesap për moralin e punëtorëve kryengritës...Nga ana tjetër borgjezisë franceze i erdhi në ndihmë ushtria gjermane me Bizmarkun në krye dhe e mbyti në gjak masën e punëtorëve kryengritës (30.000 njerëz u

masakruan në mënyrën më mizore) të cilët e mbajtën pushtetin proletar vetëm 71 ditë... Nga gjithë ajo masë e komunarëve kishte **vetëm 30-35 komunistë**, ndërsa të tjerët ishin anarkista etj. Socialdemokracia bëri kompromise, lëshoi pe ndaj klasës borgjeze, dhe kështu dështoi revolucioni i parë proletar...

ꕥ

DIKUSH SHKRUAN ME BARK E JO ME KOKË.

F.Engelsi:.Mësova edhe prej orëtarit, punëtorit etj. Ai e kishte krye me sukses të lartë Akademinë ushtarake, dhe nuk u përcaktua për karrierën ushtarake në armatën angleze, por u orientua për **marksizmin.**

Nuk mund të kuptojmë asgjë nga populli nëse nuk e kuptojmë LUFTËN KLASORE, dhe duhet me i hap sytë se mos po të kushton dyfish a trefish më shtrenjtë, kur ta japin një gjë **FALAS...**Xhaviti(Nimani-BK), një karikaturë e gjallë, kish me t'i humbur edhe derrat, e sot ai e përfaqëson popullin, është në majën e pushtetit...

Serbët e Vojvodinës u edukuan për 300 vjet me radhë në një realitet tjetër nën pushtetin e perandorisë Austrohungarireze, dhe dallonin si në veshje, në këngë, si në folklor dhe sjellje nga serbët në jug të Danubit. Danko Popoviçi në librin e tij:KNJIGA O MILLUTINU, libër ky që përjetoi 19 ribotime, e stigmatizon sjelljen anakronike mesjetare të serbëve duke e quajtur Shën Savën LUGAT, MORTAJË edhe më 1914, edhe më 1918 dhe më 1941, dhe populli i ekzaltuar pas prijave anakronikë , të cilët brohorisnin:IDEMO DA OBNOVIMO DUSHANOVO CARSTVO - **Po shkojmë ta përtërijmë Mbretërinë e Car Dushanit...** Renovica nuk ka nevojë me shkurtua dru, se ia shkurtojnë **Maliqi, Qosja, Zajmi**, etj., dhe ju thotë-ju folni, por keni kujdes se në çfarë toni...Kjo është më shumë një monolog, sepse çështjet janë shumë më të thella, **janë çështje KLASORE...**

Këto që po i bën sot shtypi ditor janë striptiz, nudizëm politik...

Ai që din është më pak fajtor, ndërsa injoranti është më fajtor, dhe si fajtor më i madh grihet më së pari, sepse as nëna, as babai nuk iu kanë përzie në politikë, e ai që nuk përzihet në politikë e donë çdo gjë të gatshme, dhe mu për këtë duhet më së pari me e gri, me e likuidua...Këta çetnikët e lagjes Francuska 7, duan që me pikëpamjet anakronike të shekullit XIII me hy në shekullin XXI?! E kjo do të thotë me u kthye 800 vjet mbrapa. Rusët i konsiderojnë këta serbë anakronikë si mashë, si vegla, për interesat e tyre ekspansioniste pansllaviste... Shkrimtari slloven Kermanuer në shkrimin- **Letër një mikut serb, me ironi iu drejtohet - "me çfarë metodash doni t'i ç'farosni shqiptarët, me furra, krematoriume me gas cianidi, me varje apo me tredhje?!"** Çfarë ka vendos "shkenca" juaj moderne lidhur me këtë ç'farosje?!

ꕥ

Që nga viti 1962 Amerika nuk e kritikon fare Shqipërinë, sepse pas largimit të bazave ruse nga Pashalimani e Karaboruni amerikanëve iu bë një shërbim kolosal, duke kursye në investime për mbajtjen e bazave ushtarake në Aviano etj. së paku 3-4 miliardë dollarë në vit?! Rusët kurrë nuk kishin me ikë me dëshirë nga bazat shqiptare për të cilat kishin investua miliarda, por e dinin mirë se Shqipëria e ka fitua lirinë me shumë gjak e sakrifica, me forcat e veta, dhe asnjë ushtar i huaj nuk e ka derdhë një pikë gjak për çlirimin e Shqipërisë, siç ndodhi me Jugosllavinë, Greqinë, Bullgarinë, Hungarinë, Rumaninë etj. Dhe ky ishte ADUTI dhe leva kryesore e pikëmbështetjes së shqiptarëve për një **ULTIMATUM** aq të rreptë e të pa kompromis ndaj rusëve...

Në vitin 1958 një jurist i diplomuar, D.Koçina, u pranua në vendin e punës kurir, me e bartur postën, në Komunën e Prizrenit, por nuk e pranuan në vendin

adekuat, sepse nuk kishte pranua me u bë spiun..., por më 1966 u zgjodh kryetar i Gjyqit të Qarkut...Kjo do të thotë se **VIQI kur shkollohet bëhet më e shumta viç i shkolluar?! E sa të tillë kemi sot në Kosovë?!**

ꕥ

Tani është duke u zbatuar **SOCIALIZMI i SVETI SAVËS** (Svetosavski socializam), socializëm i shartuar, sepse tërë kultura e një populli identifikohet me frymën e Shën Savës (Nemaniçit). Dhe ne për aq sa lidhemi me Xhaminë dhe kishën **për aq jemi lidhur me taborin e socializmit të Shën Savës**, që do të thotë se jemi duke çuar ujë në mullirin e armikut pa vetëdije apo edhe me vetëdije?! Tani ka hyrë në fuqi ligji (më 1985) racist sipas të cilit shqiptari nuk guxon as me i ble as me i shitë serbomalazezëve...Dhe një ligj i tillë diskriminues është zbatuar më 1918-1941(në Jugosllavinë e Karagjorgjeviqëve), si në apartheidin e Afrikës Jugore... Kështu veproi edhe Adolf Hitleri më 19344-35 ndaj Çifutëve, dhe tani këta çetnikët e sotit po e mbajnë flamurin e racistëve të Ballkanit, dhe njëkohësish rrahin gjoks se janë shtet juridik...

ꕥ

Të gjitha këto janë dallavere politike, dhe ne duhet të kthjellohemi e të zgjohemi nga gjumi sa nuk është bërë vonë, se këta kolonizatorë me planet e tyre raciste kanë për qëllim me na zhdukur, sepse e dinë se e ardhmja është në anën tonë, sepse me këtë ritëm të rritjes demografike ne pas 50 vitesh në Kosovë do t'i kemi 4-5 milion banorë shqiptarë , ndërsa Serbia 2-3 milionë?! Dhe nisur nga këto fakte akademikët e Beogradit po na quajnë terroristë, dhe lindshmërinë e nenave shqiptare-demografski terrorizam **(Terrorizëm demografik)?!**

Është turp i madh për neve sot që edhe pas 100 vjetëve ne të jemi nën nivelin e vetëdijes së Vaso Pashës,

Hasan Tahsinit, Sami Frashërit, Naim Frashërit, De Radës, Çajupit, A.Xhuvanit (të cilin pata fatin ta shoh e të bisedoj me të në Tiranë më 1943, kur i kishte 93 vjeç) etj. Dhe duhet të pështirosemi e të neveritemi nga këta të vetëquajtur njerëz me shkollë të cilët japin kontributin e tyre për ndërtimin e xhamive e mejtepeve(si në Grykoc)...dhe sa më shumë që bëjnë HATME(provim përfundimtar fetar) aq më shumë janë "ÇLIRUA" nga rreziku i SHQPTARIZMËS... sepse me vdes e me të shti në varr pa të larë hoxha as xhehenemi(FERRI) nuk të pranon, thoshte hoxha fanatik(Edhe mua më zuri taksirati të kem punë me një hoxhë të tillë i cili m'i kërkonte 120.000 dinarë në emër të borxhit ndaj xhamisë, dhe m'u kërcënua me këto fjalë: **mbaje mend se nesër kur të vdesësh askush nuk guxon me radhë e me të larë... Nuk ia vlente të harxhoja fjalë me atë hoxhë injorant, dhe iu përgjigja me heshtje...**dhe thash vetmevete - O tempora o mores!

NATA E MADHE PËR NE DUHET TË JETË 28 NËNTORI, DITA E FLAMURIT!

LIGJËRIME, 20 gusht 1987:

Si shpjegohet ligji dialektik i MOHIMIT TË MOHIMIT?

P.sh. sasia e madhe e borxheve të një vendi e lind INFLACIONIN, devalvimin, mykjen e parave. GABIMET, të këqijat e grumbulluara, një ditë shpërthejnë, dhe kthehen në cilësi, në kualitet, në REVOLUCION. Ku qëndron fuqia e Geringut, Himlerit, Paveliqit? Pikërisht në atë se i mbronte Vatikani. Po ku qëndron sot fuqia e SHEHUT, HOXHËS, DERVISHIT, PRIFTIT? Pikërisht në atë se i mbron reaksioni, dhe kjo i ka rrënjët në padituri e masave, në budallallëkun e atyre që u shkojnë prapa si grigja. Pra **feja është opium për popullin**. Po për ligjin dialektik – **mohimi i mohimit**, është

kur ne ngrihemi që të tërë dhe e bëjmë sakrificën sublime, e bëjmë vdekjen si me le, dhe duke e mohuar vetveten, e MOHOJMË edhe armikun kolonizator, por nuk mjafton vetëm kjo, sepse ata që mbetën gjallë pas luftës, pas revolucionit, duhet ta bëjnë një luftë edhe më të madhe, ta çojnë amanetin e të rënëve në vend, pra ta bëjnë **POHIMIN E MOHIMIT TË MOHIMIT**. Dhe nëse nuk arrihet ky pohim, atëherë edhe **sakrificat shkojnë kot**…

ꕥ

Sot po manipulohet me shifra, me statistikë. Për shembull kur të pyesin se çka je, **mysliman apo shqiptar?** Dhe kur horizonti i vetëdijes kombëtare është aq i ngushtë sa të regjistrohesh si MYSLIMAN, atëherë nuk duhet të çuditemi se çfarë po na bëjnë, por duhet të themi se këtë që po na bëjnë, pikësëpari **ne po ia bëjmë vetvetes...**

ꕥ

Si shpjegohet APROVIMI I NDRYSHIMEVE KUSHTETUTARE në Kosovë, kur Vojvodina po i kundërshton me këmbëngulje?

Mos harroni se këta kuislingët dhe marionetat tona nuk mund të krahasohen as me **PLEHUN**, sepse po të kishin qenë vetëm pak më të fortë, atëherë neve kurrë nuk do të mundnin t'na i kalbnin nëpër burgje me mijëra djem e vajza, lulja e ardhmërisë së kombit. Rreth 65% e gjithë të burgosurve politikë në Jugosllavi janë shqiptarë!?

ꕥ

A jemi duke iu afruar zgjimit nga ky gjumë i rëndë?

Tani për tani jemi duke u zhvilluar me një ritëm të pamjaftueshëm për zgjim, dhe ja ku jemi katandisur: këtu

tërë ditën dëgjohen kambanat e kishave, altoparlantët me zërin shurdhues të hoxhallarëve, ndërkaq në Shqipëri është ndaluar me ligj **IDEOLOGJIA FETARE**, që nga shkurti i vitit 1967. Dhe ata që marrin guxim ta transmetojnë këtë ideologji tek fëmija mund të dënohen me 20 vjet burg (nëse e mësojnë fëmijën të falet, të bëjë kryq etj.). Te ne, mjerisht, është një obskurantizëm i madh. Por ky obskurantizëm ka pasur sukses edhe te gjermanët, të cilët i bashkoi Hitleri me grykën e topave, sepse austriakët ende e konsiderojnë veten katolikë (Austria dhe një pjesë e Bavarisë janë katolikë), ndërsa pjesa tjetër i përkasin fesë PROTESTANE, Luterianë, rreth 50 milionë banorë, dhe kjo ishte pengesa kryesore që gjermanët të bashkoheshin në një shtet unik, qysh në kohën e Bizmarkut. Austria ngeli jashtë Rajhut të Tretë (UNIONIT – BASHKIMIT) me ndërhyrjen e Vatikanit.

ꕥ

Po si qëndron puna me ne shqiptarët në këtë kontekst?

Të marrim si shembull punimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 10 qershor 1878 kur asnjë dokument nuk është shkruar në gjuhën shqipe?! Çfarë dobësish po përjetonim! Sepse po të kishim qenë më të FORTË, qysh atëherë do ta kishim fituar së paku një AUTONOMI, siç e fituan BULLGARIA dhe SERBIA. Edhe në vitin 1912 këto përçarje FETARE e kanë shpartalluar unitetin kombëtar, ato katër ferrat në kopshtin kombëtar, siç do t'i quante Fan Noli katër komunitetet fetare në Shqipëri, dhe ky është një fenomen evropian. Në Gjermani çdo lagje e ka kishën e vet. Gjatë negociatave të fuqive evropiane Rusia, Franca e Anglia ishin për KANTONIN SHQIPTAR – Elbasan – Tiranë – Shijak, e deri në Peshkopi e Mat, por mbizotëruan idetë e Austro-Hungarisë, Gjermanisë e Italisë, pra raporti ishte 3:3, ndërsa versioni i dytë na linte

pa Shkodrën e Gjirokastrën. Më në fund u arrit ujdia për KUFIJTË E SOTËM, por nuk duhet harruar se kurrë, asnjë shqiptar nuk mori pjesë në asnjë komision për caktimin e kufijve të Shqipërisë. Për fatin e shqiptarëve po vendosnin të tjerët. Pra ishin ndasitë fetare, ishte terri i obskurantizmit që po pengonte depërtimin e dritës për zgjimin e shqiptarëve…

ꕥ

Fadil Hoxha hyri dhëndër me të bijën e kolaboracionistit, e cila më 1941 nëpër rrugët dhe sheshin e Shatërvanit në Prizren brohoriste bashkë me të tjerë – BABA HITLER, DAJA MUSOLIN! Ajo (Vahide Kabashi) ishte e vetmja vajzë shqiptare që mësonte në gjuhën serbokroate në Gjimnazin e Prizrenit më 1941, e dihet se ai që është regjistruar në gjimnaz është dashur të deklarohet se është serb… E sot po thuhet se që 12 vite serbët nuk janë sundimtarë të Kosovës (që nga viti 1974). Qazim Bllaca ka qenë student i drejtësisë në Beograd…

ꕥ

PERS – Zonë e Persisë ku është formuar religjioni lidhur me zjarrin, NURIN – DRITËN, kulti i ZJARRIT, qirinjtë (kandilat), sepse ndizen për mijëra vjet në ato vende ku kishte burime nafte. Perandoria Persiane – 2500 vjet, perandori në tri kontinente – Azi, Evropë dhe Afrikë (Egjipt), dhe që nga ajo kohë Persia e mbante Kurdistanin për të cilin kanë pretendime irakianët… Postat e para i kemi në Persi, gjuha e parë klasike – gjuha persiane, pastaj vjen greqishtja dhe e treta është latinishtja, ndërsa e katërta vjen arabishtja.

ꕥ

Më 1939 u vendos diktatura fashiste italiane… ata nuk mbaruan furra e krematoriume si gjermanët…

ꕥ

Vetëm njerëzit kanë RELIGJION – Negacion i vetëdijes. Pra për ta kuptuar se ekziston dita, duhet të ekzistojë nata. Përulja të çon domosdoshmërisht në hipokrizi – dyfytyrësi, ndjenjë shumë e rrezikshme, si dergja, por duhet të jemi shumë të vetëdijshëm për t'i kuptuar pasojat negative të RELIGJIONIT. Kur thuhet p.sh. se unë jam një hiç, një asgjë para Jezu Krishtit, para Muhamedit. Nga kjo del se pak na ka gjetur çka duhet të na gjejë. Sepse ty po të vjen turp të jesh DIÇKA, se je i gjallë. Dhe kështu, duke e mohuar vetveten, ai e mohon njëkohësisht edhe PERENDINË. Prandaj FANATIZMI nuk është kurrfarë religjioni. JEZUITËT janë priftërinjtë më të fortë të kishës katolike, të cilët ishin mjeshtër të sofizmave. Ne e kemi pas një JEZUIT, NDRE MJEDËN, i cili aq shumë i ndihmoi punimeve në KONGRESIN E ALFABETIT më 14-22 nëntor 1908 në Manastir.

ꕥ

Sipas MEMORANDUMIT të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve në Beograd, atdhetari shqiptar konsiderohet si MORTAJA, dergja më e rrezikshme, sepse të gjithë të tjerët janë njerëz, ndërsa shqiptarët konsiderohen krijesa njerëzore të paplota (nepotpuna ljudska biça)…

ꕥ

Edhe i thati rritet në bark, stomak, dhe pas 30 vjetësh shpërthen. Çdo ditë përmes valëve të radiotelevizionit dhe shtypit ditor e javor po flitet për shqiptarët, por edhe kjo e ka domethënien e vet, është një punë e madhe, serioze, **VULLKAN I GJALLË**, tregues i sigurt se situata është e komplikuar.

A mund ta marrim me mend ekzistencën e fëmijës pa ekzistencën paraprake të prindërve të tij? Ai që i bën të ligat, **ai meriton edhe t'i vuajë pasojat e tyre...**

ꕥ

Kultura greke është sintezë e kulturës persiane dhe arabe…

SOKRATI çdo natë bënte ndeja me të rinjtë aristokratë, dhe 55 ditë përpara e ka pasur terminin e caktuar se te cili nxënës do të jetë mysafir (Heterat – gratë e shumë burrave)… kjo ishte një shkollë e veçantë… SOKRATI ishte dembel, përtac, dhe asgjë nuk ka shkruar. Me profesion ishte gurgdhendës, dhe të mos ishte PLATONI, as për Sokratin nuk do dinim shumë gjëra të cilat i dimë sot për të (Unë shpesh i drejtohesha profesorit Qazim me fjalët se edhe ai është një SOKRAT për ne me gjithë atë potencial diturie enciklopedike, dhe se është mëkat i madh të mos kemi asnjë shkrim filozofik nga dora e tij…)

ꕥ

Gjashtë vjet pas LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT (më 1878), më 1884, **në Kalemegdan u hoq FLAMURI TURK, dhe u shpall MBRETËRIA SERBE**, sepse perandoria turke nuk kishte hesap për t'i mbajtur më tutje nën sundim. Në Luftën e Parë Ballkanike (më 1912) u derdh gjaku rrëke, dhe shtrohet pyetja – pse u derdh tërë ai gjak? Sepse ishin orekset ekspansioniste të fqinjëve, prapa të cilëve qëndronte ekspansionizmi pansllavist rusomadh për t'i gllabëruar tokat shqiptare, deri në Selanik, dhe kështu për të dalë në Detin Egje dhe Detin Adriatik…

Kosova dhe Dibra, me 17.000 km. katrorë, dhe gjithë viset tjera të okupuara, me mbi 80.000 km. katrorë sipërfaqe, kjo është një kockë e fortë, një asht që s'kapërdihet për cilindo okupator; pastaj erdhi Lufta e Parë Botërore dhe për 14 muaj Serbia i bëri ballë austro-

hungarezëve, por më në fund u detyrua të tërhiqet nëpër Alpet shqiptare nëpër acar e dëborë, dhe është çudi e çudirave se si nuk u vra asnjë ushtar serbo-malazez. Mirëpo ky është një INVESTIM AFATGJATË, sepse si popull kemi bërë shumë mirë: **nëna histori të gjitha i shënon**, dhe sidomos krimet dhe njollat e zeza të secilit popull.

ꕥ

Kur flasim për drejtësi duhet të dimë se për cilën drejtësi e kemi fjalën:

- për drejtësinë FEUDALE,
- për drejtësinë BORGJEZE,
- për drejtësinë SOCIALISTE
- për drejtësinë KOMUNISTE?

Padrejtësia FEUDALE është më e madhe se sa padrejtësia BORGJEZE.

Përpara njeriu dënohej me burg të rëndë ose vritej, nëse në shtëpinë e tij do gjendej një **ABETARE** në gjuhën shqipe. Pra neve na duhej më shumë se buka – abetarja, dituria, gjuha shqipe… Por pa djersë, pa mund, pa gjak nuk mund të fitohet LIRIA…

ꕥ

Gjërat e LIGA i bën vetëm ai që është duke HUMBUR, që është duke KAPITULLUAR... Por kush duhet ta paguajë kamatën për masakrat e viteve 1912-1914, po për ato të viteve 1877-78, dhe sidomos ato të viteve 1941-1945 e këtej?

PROTESTA serbo-malazeze në Fushë Kosovë nuk është FORCË, por LIGËSHTI, sepse aty u provua se sa e madhe është LIGËSHTIA e pushtuesve jugosllavë, të cilët nuk kishin guxim as me gisht të këmbës t'i prekin demonstruesit e tërbuar, ndërsa policia e Kosovës kishte urdhër e shumta vetëm të gjuante me armë zjarri nën gjunjë e poshtë, dhe kështu të bëhej alarmi për të pasur

pretekstin për masakrimet në masë të shqiptarëve… dhe për të gjitha gjakderdhjet të mos pësonin asgjë. Por çfarë thotë sot Çubrilloviçi kur i sheh vëllezërit e tij që nuk patën guxim as të pësojnë ndonjë plagë të vogël në këmbë, ndërsa rinia shqiptare më 1981 (mars-prill) në përleshje fyt më fyt me xhelatët e armatës jugosllave mësynin mbi tanket dhe bajonetat e armikut, dhe rrugët dhe sheshet e Prishtinës u lanë me gjakun e rinisë heroike. Çubrilloviçi i kishte vetëm 17 vjet kur bashkë me Gavrillo Principin bënë atentat mbi Franc Ferdinandin më 1914, ndërsa sot Akademia e Shkencave dhe Arteve Serbe flet me gjuhën e Vlladan Gjorgjeviqit se gjoja "Shqiptarët na qenkan i VETMI POPULLL I EGËR NË BOTË?!" Asnjë njeri normal nuk guxon ta akuzojë një popull të tërë në mënyrë të tillë raciste.

ꕥ

ORGANI MË I URITUR ËSHTË – SYRI I NJERIUT, sepse barku ngopet 1000 herë, ndërsa syri asnjëherë. Pra LAKMIA – ekspansionizmi, dhe luftërat ballkanike ishin pazarllëqe…

Noli iu përkushtua RELIGJIONIT **nga motivet INTELEKTUALE e jo religjioze**, sepse shkencëtari i vërtetë e studion një lloj **VIRUSI** tërë jetën vetëm për ta ZBULUAR KUNDËRILAÇIN, e jo pse ai është dashuruar në ato VIRUSE. Pra e studion për ta zhdukur atë helm, atë rrezik, si p.sh. VARIOLA. Pra Noli nën petkun fetar veproi si patriot, si politikan, dhe bëri ribotimin e Dhiatës së Re dhe Dhiatës së Vjetër në gjuhën shqipe…

ꕥ

LIGJËRATË,18 tetor 1987:

Sot në Serbi "Politika" është më e dobët se para luftës, sepse Serbia po thotë: NE DUHET TË BASHKOHEMI EDHE SIKUR TË GABOJMË! Edhe sikur të paraqitet

nevoja të derdhim gjak për këtë bashkim. Dragisha Pavlloviqi (Sekretar i Komitetit të Partisë në Serbi) po thotë: Neve duhet ta kemi parasysh faktin historik se më tepër se asnjë popull tjetër e kemi paguar shumë shtrenjtë çmimin e GABIMEVE TË SË KALUARËS, ndërsa Akademia Serbe e Shkencave po thotë: Ne e kemi tërë popullin prapa, ai po na përkrah, sepse brenda ditës po shiten mbi 400.000 ekzemplarë të gazetës, dmth. nisen nga ky fakt banal dhe tirazhin e gazetës e marrin si kriter të besnikërisë së popullit. Millosheviqi, bashkë me 7-8 vetë, po u thotë: Ju po manipuloni me interesat e popullit, dhe ua mori anën atyre 90 deputetëve në Plenum. Ata po e trullosin masën me demagogji, me gënjeshtra, ndërkaq masa amorfe po i gëlltit këto rrena banale…

Dihet se mbi 50% të serbëve jetojnë jashtë Republikës së Serbisë: 15% në Kroaci, 40% në Bosnjë e Hercegovinë, 52% në Vojvodinë, dhe vetëm rreth 50% në Serbi. Republikat tjera jashtë Serbisë janë **shtete FORMALE, sepse një shtet që nuk e ka ministrinë e jashtme, nuk e ka ushtrinë e vet, nuk është i pranuar ndërkombëtarisht (në OKB) dhe nuk ka marrëdhënie me shtetet tjera, nuk e ka ministrinë e mbrojtjes dhe të punëve të brendshme, atëherë ai shtet është hajgare, është shtet për mahi, është karikaturë e shtetit…**

ꕥ

E drejta është RELATIVE, ajo nuk mund të jetë më e lartë se RENDI EKZISTUES, thoshin kolosët e marksizmit, ndërsa e drejta formale është e barabartë me zero të drejtë – me kurrfarë të drejte…

ꕥ

Në dy luftërat botërore janë vrarë mbi dy milionë serbë, dhe pikërisht për shkak të gabimeve në politikën e aparatit shtetëror udhëheqës. Pavlloviqi sot është më i forti për kah shkollimi, sepse e ka fakultetin e makinerisë, fakultetin e

ekonomisë dhe është doktor i shkencave të filozofisë, dhe ai mendon seriozisht për një situatë joserioze…

Edhe **Karl Marksi** mendonte se **klasa punëtore angleze**, si më e ngritura me vetëdije klasore, mund ta çlirojë vetveten vetëm nëse i BASHKOHET DHE **E NDIHMON LUFTËN E DREJTË TË POPULLIT IRLANDEZ** PËR LIRI DHE PAVARËSI (mendoni analogjinë me çlirimin e KOSOVËS).

Nikolla Pashiqi (kryeministri serb më 1920) ishte socialist gjatë kohës kur ishte student, dhe bashkë me Svetozar Markoviqin kanë mësuar dhe janë frymëzuar me idetë revolucionare të komunarëve të Parisit (1870). Ndërsa më vonë, po ky Nikolla Pashiq u bë kryeideologu i çetnikëve. Gjenerata e dytë e socialdemokratëve serbë i takon Dimitrije Tucoviqit. Populli serb nuk e dinte se cila ishte esenca e programit socialist të Markoviqit dhe Tucoviqit, përndryshe, po ta dinin, do të bënin atentat mbi ta. Ata i flisnin popullit ashtu siç ia donte zemra fshatarit. Tucoviqi ishte i biri i priftit, njeriu i parë i Valevës. Ai u fliste fshatarëve për çlirimin e tyre nga tatimet e shtetit, e jo për atë se ata do të kolektivizohen dhe do të ngelin pa tokë. Ndërsa sot, po të fliste dikush siç ka folur Tucoviqi në atë kohë, menjëherë do ta burgosnin. Për këtë shkak socialdemokracia serbe e viteve 1910-1912 formalisht dukej më demokratikja në Evropë.

Pas vrasjes së Milan Obrenoviqit më 1903 çetnikët e sollën në pushtet Aleksandër Karagjorgjeviqin, që ai ta zbatonte programin e shtetit të Nemanjidve. Sot Millosheviqi po kërkon gjera të pamundshme, po tenton ta gllabërojë Kosovën nëse e han pazari, sepse populli po përdoret si instrument, si mashë. Përkundër falimentimeve galoponte në ekonomi, klasa punëtore në Serbi është shumë e paorganizuar, e ç'thurur, dhe anon kah ata të cilët ua sigurojnë punën, anon kah reaksioni i cili po i premton gjëra të kota, të parealizueshme, fjalë boshe. Realiteti atje është i tmerrshëm: rënia e standardit jetësor, inflacioni galopant, dhe të gjitha këto kriza po e bëjnë punën e tyre

dhe sot mijëra punëtorë po demonstrojnë rrugëve për të realizuar të drejtat e tyre elementare… **Punëtorët hë për hë nuk po e shohin leverdinë të çohen në luftë vendimtare, sepse po jetojnë me iluzionin se sot po jetojnë më mirë se sa në kohën kur ishin fëmijë të mitur** (një pjesë e tyre sot disponojnë aparate TV, bojlerë, vetura, telefon etj., dhe nuk po jetojnë si dikur në shtëpi me kashtë). Ata nuk mund ta marrin me mend një kryengritje ku duhet derdhur gjaku kur e dinë se në tregun e të papunëve kemi edhe qindra profesorë, juristë, mjekë etj. Me një fjalë, ai që ka kulm mbi krye dhe bukë në tryezë, nuk po e sheh arsyen të ngrihet në kryengritje për të derdhur gjak (Sot 50% të bukës Jugosllavisë ia siguron SHBA-ja?!). Vetëm për 5 vite Jugosllavia ka paguar 30 miliardë dinarë të rinj (30.000.000.000) vetëm për KAMATAT E BORGJEVE (të cilat kapnin një vlerë prej 22 miliardë dollarë). Dhe merre me mend – **22 miliardë dollarë vetëm për kamata**?! Dhe këtu te **ne nuk kemi fare të bëjmë me REVOLUCION** gjersa në të gjitha anët po ndërtohen kisha dhe xhamia, në vend të shkollave dhe spitaleve.

Në masat e PROGRAMIT AKSIONAL PËR KOSOVËN, në paragrafin 1, thuhet:

„Në çdo mënyrë duhet të zhduket kundërrevolucioni në Kosovë... ", dhe pasi të identifikohet, të etiketohet dikush si kundërrevolucionar, atëherë duhet ta varim publikisht. Deri më 1977, përveç Jovo Shotrës, Kadri Reufit, Sekuliqit, të tjerët e patën pranuar – REPUBLIKËN E KOSOVËS. Kushtetuta e vitit 1974 ishte Kushtetutë liberale, e sot të gjithë ata të cilët e kërkojnë një gjë të tillë i dërgojnë në gjyqin ushtarak. E drejta është në anën e të FORTIT, e për ne shqiptarët, si NGUSHËLLIM, të drejtat mund t'i realizojmë **"PAS VDEKJES"**, meqë **i besojmë Zotit**. Kështu mendon dhe kështu thotë edhe Millosheviqi… Mirëpo serbët që kanë kulturë evropiane, ata të Kroacisë dhe Vojvodinës, nuk i pranojnë këto pikëpamje raciste… Këto veprime

ballkanasit i kanë për të zezën e tyre. Bullgarët nuk po i pranojnë maqedonasit si komb, grekët poashtu nuk po i pranojnë. Deri në vitin 1966 Kosova kishte Autonomi të shkallës së tretë, autonomi regjionale, të lagjes…

ꕥ

Fjala latine **LUPTA – LUFTA** nënkupton çfarëdo lufte, ndërsa beteja është një episod i luftës. Para lufte latinishtja te ne është mësuar si Matematika, gjuha etj. Në fund të MANIFESTIT TË PARTISË KOMUNISTE, Marksi thotë:

Dixi et salvavi animam meam **(E THASHË DHE SHPËTOVA SHPIRTIN TIM!)**

Lufta nuk mund të zhduket sa kohë që popujt do të kenë kushte jetese kaq të ndryshme dhe sa kohë që neveria reciproke do të jetë kaq e thellë, dhe sa kohë që prona private do të jetë mbi mjetet e prodhimit...Latinët e moçëm thoshnin:

"SI VI PACEM, PARA BELLUM -
(NË QOFTË SE DO PAQEN, PËRGATITU PËR LUFTË!)

ꕥ

Faik Konicën babai e dërgoi në gjimnazin jezuit të Shkodrës ku edhe u jezuitizua.

ꕥ

HARRESA, nëse teprohet, është e dëmshme, si gjumi. Për 40 vjet **Ndre Mjeda** nuk e ka pa me sy Shqipërinë, dhe kurrë nuk e harroi vendlindjen, dhe ky ishte i vetmi përjashtim gjatë tërë historisë së ekzistencës së kishës jezuite për 1571 vjet. Mu për këtë shkak edhe e dënuan duke e transferuar sa në një vend sa në një tjetër, dhe mbeti në rangun më të ulët të kishës vetëm pse ishte një rast i pashërueshëm nga NOSTALGJIA për Atdhe, për popullin të cilit i përkiste. Asnjë privilegj nuk e mashtroi.

20 vjet ishte REKTOR universiteti në Itali, pastaj në Spanjë dhe Poloni, dhe në fund e transferuan në Shqipëri. Në Kongresin e Manastirit, më 14-22 nëntor 1908, Mjeda ishte figurë qendrore që kontribuoi për unifikimin e dialekteve shqipe, dhe mund ta quajmë Hazreti (Profeti) Mjeda! Ne edhe sot e kësaj dite nuk kemi një biografi të mirëfilltë për të. Vjershat e tij ai i shkruante në gjuhën shqipe, e jo në latinisht, greqisht apo polonisht. Ai ishte **shkencëtari më i fortë në fushën e linguistikës**, ndërsa **Noli ishte romantiku më i fortë.** Poezitë e Nolit ishin thirrje për LUFTË! Nja gjashtë muaj Noli ishte punëtor i thjeshtë, sharrëxhi, priste dru në pyje. Intelektualët tanë kanë qenë më të varfrit.

ꕥ

Politika e Izraelit është politikë LOBISTE. KNESETI (PARLAMENTI) izraelit është komplet i lobit (i atij në SHBA), dhe Kushtetuta e Izraelit bazohet në librin e tyre fetar, në TALMUDIN. Arabia Saudite, Vatikani, Pakistani etj. janë shtete teokratike. Paraguai në Amerikë ka qenë nja 200 vjet në duart e jezuitëve. Solomoni (Sylejmani), para 3000 vjetëve ka qenë në tokën Palestineze – në JUDE (pjesë e Palestinës). Ajo edhe para 2000 vjetëve ishte e banuar nga palestinezët. Çifutët së pari i dëboi, i përzuri Roma, me pretekstin se gjoja janë duke punuar kundër perandorisë romake, se feja e tyre është kundër fesë katolike, kështu që ata që prej 2000 vitesh po bredhin nëpër botë. Nga ana e djathë e lumit Jordan, më e madhe se gjysma e Kosovës, në kohën romake janë shpërngulur nja 70.000 hebrenj, ndërsa 1500 vjet para epokës së re ata kanë jetuar në JUDE, në Bregun perëndimor të lumit Jordan. Organizimi i hebrenjve para 60 vitesh, ndërsa organizimin nga Jugosllavia e bëri **Teodor Hercogu.** Organizatën sioniste e patën ndihmuar edhe gjermanët, për të depërtuar në fushat vajgurore arabe të Lindjes së Afërme. Edhe në kohën e perandorisë turke çifutët ishin popullata më e shkolluar, edhe këta të sotmit janë si

zviceranë mes arabëve. Kur krahasohen **palestinezët** me neve, po u këndon qyqja, sepse ende janë të përçarë nga brenda. Dhe të gjitha vendet arabe, përveç Algjerisë, e minojnë çdo përpjekje për formimin e SHTETIT TË PAVARUR PALESTINEZ. Ata, palestinezët, që 40 vjet pandërprerë janë në revolucion çlirimtar shoqëroro-politik.

ꕥ

Shqipërisë, sikur t'i kishte prire Balli Kombëtar, kurrë nuk do të ishte kjo që është sot. Më 1942-1943 Balli Kombëtar u lidh pas qerres nazifashiste të Hitlerit, të cilët tanimë e kishin kurrizin e thyer, pas disfatës në Stalingrad e Moskë. Por kush nuk e kishte shansin ta njohë BALLIN KOMBËTAR dje, e ka sot atë shans, si këtu ndër ne, në Kosovë, të gjitha këto kukulla, **MARIONETA**, në shërbim të reaksionit. I pari ia filloi luftës Muharrem Bajraktari më 1939, duke rezistuar kundër Italisë fashiste, ndërsa në aradhen e Legalitetit, zogistët u lidhën me anglezët, Abaz Kupi (Bazi i Canit), Muharrem Bajraktari. Më 1942 Legaliteti u bashkua me Ballin Kombëtar, të cilin e udhëhiqte Vasil Andoni nga Elbasani. Muharrem Bajraktari bashkëpunoi me forcat e reaksionit për ta rrëzuar Qeverinë e Fan Nolit e Bajram Currit. Kur hyni Italia, **ata për 6 javë dolën në mal, jo për të luftuar, por me saç, me lugë e me tepsia, sepse ata nuk ishin mësuar të heqin keq, të derdhin gjak** dhe të përballen me armikun. Dhe kështu ata maskoheshin për ta pritur Gjermaninë, por nuk u doli ashtu siç mendonin, sepse pushtetin e morën nga ata që tanimë po jepnin shpirt, nga ata që tanimë kishin KAPITULLUAR, dmth. ishin kapur për gjethin e vjeshtës…

ꕥ

Një kohë edhe unë u gjeta në burgun e kuesturës gjermane në Tiranë… Në **Shqipëri** fshatarësia ishte

partizane, ndërsa pjesa Veriore ishte kryesisht balliste, ndërsa Kosova ishte pothuajse tërësisht balliste, sepse andej kah shkon zotëria, feudali, andej shkon edhe fshatarësia. Ata nuk e dinin se vetëm lufta revolucionare mund t'ua sillte perspektivën e sigurt. Në vend që të luftonte DJE për ta thyer ZGJEDHËN E ROBËRISË, sot po LUFTON për ta mbajtur këtë ZGJEDHË?! Dhe kështu me punën e vet çoroditëse po ia bën **VARRIN SHQIPËRISË...**

Edhe në zonën e Dibrës kishte ballistë të mëdhenj, por aty vepronte edhe brigada e **Haxhi Lleshit**. 95% e fshatarësisë ishte me luftën partizane. Perspektiva e ballistëve ishte perspektiva e – **VARRIT**.

Me fitimin e ca të drejtave të shqiptarëve në Kosovë në një mënyrë po rritet RREZIKU për Shqipërinë. Populli ende nuk po e kupton se ku qëndron e mira e Shqipërisë, dhe me sjelljet e veta, pa dashje, po e dobëson Shqipërinë. Në Shqipëri e përkrahin kërkesën – KOSOVA REPUBLIKË, por jo edhe REALIZIMIN E SAJ, sepse çdo realizim praktik i kësaj kërkese do të bëhet për t'ia **NGRËNË KOKËN SHQIPËRISË**, nën pretekstin se gjoja po i **ÇLIROJNË** vëllezërit e një gjaku nga vuajtjet e rendit socialist. Duhet të jemi sa më të vetëdijshëm për të mos lejuar mbizotërimin e PABARAZISË e cila tani është në fazën e rritjes (këtu te ne në Kosovë – PRONA PRIVATE, atje – në Shqipëri – Prona Socialiste). Muri më i madh ndarës (Muri i Berlinit) nuk është në vijën kufitare Shqipëri – Kosovë, por në **kokat tona**, në bindjet tona diametralisht të kundërta. Kështu është edhe me dy Gjermanitë. Shqipëria, po të mos hapej me tërë botën (sot ajo ka marrëdhënie me 119 vende të botës), do të mbaronte, sidomos pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Kinën më 1978. Kina e këshillonte Shqipërinë **t'i zgjaste dorën e pajtimit Jugosllavisë**, por kjo nuk e pranoi këtë me asnjë çmim. Dhe të gjitha këto sakrifica shteti amë po i bën për **hir të Kosovës**. Gjithmonë Shqipëria është **dënuar**

për shkak të mbrojtjes së interesave të vëllezërve shqiptarë nën okupimin jugosllav.

Për 10 vjet të hapjes së marrëdhënieve me Shqipërinë kanë ardhur 40 autobusë, pra kurrfarë qarkullimi. Por kjo ishte një hapje e vogël, **por shumë e rrezikshme**, sepse ata persona të cilët lejoheshin të shkonin në Shqipëri po vajtonin për gjoja fatin e zi të vëllezërve nën atë diktaturë proletare, dhe reklamonin se gjoja këndej në Kosovë i kemi të gjitha të mirat, kemi vetura e televizorë, kemi FENË – kemi din e iman, kemi kisha e xhamia, kemi hoxhën, dervishin e priftin… Por nuk e dinin të gjorët se gjëja më e rëndësishme që u mungonte ishte – **LIRIA**, dhe nuk e dinin të gjorët se HOXHA është vetëm **NJË POLIC I MASKUAR, bile më i rrezikshëm se polici me uniformë në rrugë**. Ndërsa në Shqipëri i biri po i mëson prindërit si të shpëtojnë nga opiumi fetar… Vetëm Shqipëria e ka ndaluar FENË, sepse ishte e detyruar ta bënte një gjë të tillë, dhe ua vuri drynin faltoreve, xhamive, kishave dhe teqeve të te katër sekteve fetare.

ꕥ

Këtu kriza nuk është acaruar deri në atë masë sa të shpërthejë REVOLUCIONI. Kur themi se njeriu e ka atë LIRI TË CILËN E MERITON, nëse kjo absolutizohet atëherë është reaksionare, sepse e mohon **luftën** për të shkuar drejt përparimit, drejt përsosmërisë, drejt një rendi më progresiv, ndërsa nëse nuk absolutizohet, atëherë është e VËRTETË kjo thënie .

LIGJËRATË, 26 tetor 1987:

POSTULATI I PARË I ETIKËS:

Ajo që nuk të pëlqen të ta bëjë dikush, mos ia bëj as ti atij! Por nuk duhet harruar edhe parimin dialektik – mohimin e mohimit, negacionin e negacionit, se të gjitha

të mirat janë në të gjitha të zezat. Ne nuk mund të ekzistojmë nëse i kuptojmë të gjitha, sepse prej neve askush nuk ka marrë leje që të FORMOHET KOZMOSI! Dhe nëse i kërkojmë gjërat e pamundshme, kjo do të thotë se e mohojmë vetveten.

Para askujt nuk duhet dekonspiruar, hapur tërësisht, pra gjithsesi duhet qenë i sinqertë, por jo i sinqertë NAIV. Dhe këtu kemi të bëjmë me dyshimin, por jo me dyshimin e sëmurë, por me dyshimin njohës (kogito ergo sum – mendoj, prandaj jam), me i fry kosit, siç thotë populli…

ETIKA KOMUNISTE është vazhdim i ETIKËS BORGJEZE, mos t'ia duash tjetrit të keqën, mos të grumbullosh pasuri, dhe çdo grumbullim individual i pasurisë të konsiderohet antikomunist…

IDEALI i shoqërisë KOMUNISTE është – ASKUSH NUK E SHFRYTËZON TJETRIN, as me dashje as pa dashje. Ndërsa sot komunizmin po e konsiderojnë si **MORTAJËN**, si VDEKJEN, sepse po i lufton të gjitha formacionet shoqërore të derisotme (vetëm 140 vjet nga dita e MANIFESTIT KOMUNIST). Ronald Regani (president i SHBA-ve) thotë: MË E ZEZË SE VDEKJA ËSHTË MORTAJA KOMUNISTE… Por procesi i transformimit revolucionar në shoqërinë komuniste është proces afatgjatë, sepse REVOLUCIONI para së gjithash duhet bërë në **KOKAT e njerëzve. Sinonim i KOMUNIZMIT është sot Shqipëria,** dhe mjafton që atje tanimë nuk e dinë se ç'është DINI e IMANI…

ꕥ

Cila është baza e besimit fetar?

Baza e besimit fetar është së pari **FRIKA**, dhe së dyti – **SHPRESA.** Këto janë dy hallkat kyçe të zinxhirit religjioz, dhe nëse këputen këto dy hallka, këputet edhe zinxhiri i ndjenjave religjioze. Edhe FRIKËN duhet ta kuptojmë, por gjithnjë brenda rrafshit RACIONAL, si kuptimësi jetësore, si element njerëzor, si FRIKË KONSTRUKTIVE

– **T'U FRIKOHEMI TË ZEZAVE.** Dihet se i LIGU u frikohet të MIRAVE, ndërsa i FORTI u frikohet të ZEZAVE – punëve të liga, lakmisë, egoizmit, turpit, marrisë, TRADHTISË etj.

Edhe SHPRESA është KONSTRUKTIVE, si ëndërr konstruktive (ndërtuese – krijuese) jetësore, si ëndrra e Mendeljevit që zbuloi sistemin e elementeve natyrore, ose Zhyl Vernit (Udhëtimi në Hënë etj.). Ndërkaq, e kundërta e shpresës konstruktive është SHPRESA E KOTËSIRAVE – shpresa destruktive, e cila preokupohet me fantazi irracionale, si shpresa e GOMARIT, të durosh si gomari, të durosh zgjedhën e robërisë. Prandaj është e dobishme vetëm fantazia shkencore, si ajo e Leonardo Da Vinçit etj.

Nëse i bëni mirë armikut, nëse keni mëshirë ndaj armikut, atëherë jeni duke i bërë keq mikut, d.m.th, jeni kundër të mirëve, miqve…

DEMOKRITI na mëson se: Nëse dikujt ia ke bërë një të mirë për hir të INTERESIT PERSONAL, përfitimit material ose karrierist, atëherë ajo e mirë nuk konsiderohet e MIRË…

Emanuel Kanti, si gjeolog, duke e studiuar gurin, ka arritur deri te teoria, hipoteza e prejardhjes së TOKËS dhe planetëve, dhe po në këtë mënyrë veproi edhe matematikani dhe astronomi francez Laplasi, dhe që të dy këta shkencëtarë nuk e thyen kokën për gjera abstrakte e irracionale…

Ç'mund t'na thoni për KURANIN?

Kurani është njëri nga botimet e JUDAIZMIT:

1. TALMUDI – 1000 vjet para epokës së re (Haldeizëm – Lindja e Afërt);
2. BIBLA – KRISTIANIZËM, me Jezu Krishtin;
3. KURANI – ISLAMIZËM.

Karl Marksi e ka njohur shumë mirë JUDAIZMIN, sepse gjyshi i tij ishte kryefetar hebre, një kryerabin. Babai

i Marksit, për hir të inkuadrimit në pu8në, për të gjetur një punë, u detyrua të konvertohet në fenë e krishterë. Pra Marksi e ka lexuar Talmudin në gjuhën origjinale – hebraishte, prej nga edhe e shtrydhi, e nxori atë sentencën e njohur se – RELIGJIONI ËSHTË OPIUM PËR POPULLIN – është rreziku më i madh për popujt, dhe – **ARTILERI E RËNDË NË DUART E REAKSIONIT**… Nga kjo del se nuk ka asgjë të mirë që t'mos mund të keqpërdoret. Prandaj gjerat më të PËRSHTATSHME PËR T'U KEQPËRDORUR JANË NDJENJAT RELIGJIOZE.

Edhe Faraonët kanë qenë kryepriftërinj, pra e kanë luajtur rolin e komandantit politik, PRIFTI – FARAONI IDEOLOGJIK.

JUS ROMANUM – E DREJTA ROMAKE. Në bazë të kësaj të drejte, qysh para NERONIT, secili **ka pasur të drejtë ta vrasë çdo njeri i cili e kishte marrë fenë krishtere,** dhe kjo ka zgjatur rreth 300 vjet, deri në kohën e Shën Konstandinit (me prejardhje ilire nga Nishi i Dardanisë) **vitin 324 të epokës së re .** Pra ndjenjat religjioze shërbejnë për t'i MARRË NËQAFË NJERËZIT…

Deri në kohën e Shën Konstadinit ka mbizotëruar POLITEIZMI, ndërsa ky perandor me dekret vendosi: **TANI E TUTJE KRISTIANIZMI ËSHTË RELIGJION UNIK DHE LEGAL...** Dhe që nga ajo kohë peshkopët, priftërinjtë, jetojnë si MINISTRAT. Parimi themelor i tij: nuk është i lumtur ai që ka, por ai që nuk ka, duke predikuar se lumturia e vërtetë arrihet në jetën e **PËRTEJ VARRIT?!**

ꕥ

Ideali i shoqërisë komuniste është-Askush nuk e shfrytëzon tjetrin, as me dashje as pa dashje, ndërsa sot KOMUNIZMIN po e konsiderojnë si **vdekje, si mortajë.** Nuk kanë kaluar vetëm 140 vjet nga dita e MANIFESTIT KOMUNIST, dhe presidenti i SHBA-së, R. Regan thotë-Mortaja komuniste është më e zezë se VDEKJA! Por të mos harrojmë se procesi i transformimit revolucionar deri

në shoqërinë komuniste është proces i gjatë, sepse revolucioni para së gjithash duhet të bëhet në KOKAT e njerëzve (Shih-romanin NËNA të Maksim Gorkit). Sinonim i vendit që po ecën në rrugën drejt shoqërisë komuniste është sot-SHQIPËRIA...

ꕥ

Kurrë nuk duhet të jesh shovinist, ta urresh kombin tjetër, dhe aq më pak ta identifikosh bukën e ligë me serbët e të thuash: **nuk ka bukë të ligë dhe serb të mirë.** Këto bindje janë të rrezikshme, sepse ata konsiderohen simbol i vdekjes, ndërsa BUKA simbol i JETËS… Por edhe ne shqiptarët nën okupimin fashist jugosllav nuk kemi hesap të hapet kufiri me Shqipërinë, sepse ekziston rreziku i **infektimit të rendit shoqëror socialist nga mijëra mikrobe infektuese,** dhe në këto rrethana të dëshirosh hapjen e kufirit d.m.th. t'ia **dëshirosh Shqipërisë VARRIN, KAPITULLIMIN**. Dhe shtrohet pyetja: mos vallë na duhen edhe 40 vjet një kësi izolimi me mur Berlini në mes të te njëjtit popull? Sepse tani për tani **ne jemi RREZIKU më i madh për Shqipërinë, dhe ky rrezik po rritet paralelisht me rritjen e dallimeve ekonomike** në relacionin Kosovë-Shqipëri (sidomos pas vitit 1966-1974 e këtej). Pra duhet të punohet shumë deri në **shpërthimin e revolucionit** te ne në Kosovë(Shih-Letrën e Jusuf Gërvallës dërguar Enver Hoxhës më 20 gusht 1980 nga Gjermania pikërisht për këtë qëllim, për **shpërthimin e Kryengritjes në Kosovë).** Dhe kur gjithë popujt jugosllavë do të futen në luftë dhe do të çlirohen nga oligarkia fashiste serbomadhe, e bashkë me ta edhe shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera, atëherë njëkohësisht duhet të bëhen dy çlirime – **ÇLIRIMI NACIONAL dhe ÇLIRIMI SOCIAL** (tani për tani këto pikëpamje mund të duken utopike). **Patriotizmi** është ta ngushëllosh vetveten, sepse kështu në këtë pus siç jemi, do

jemi shumë të rrezikshëm për shtetin amë – Shqipërinë, ndërsa këto rrahagjokset tona në emër të patriotizmit janë **karikaturë e patriotizmit.**

Kolonizatorët serbomalazezë së pari ikën nga Kosova më 1941, pas kapitullimit të Jugosllavisë së Karagjorgjeviçëve me 6 prill 1941, dhe herën e dytë më 1966, pas rënies së Aleksandër Rankoviçit, sepse ultra-çetnikët nuk mundën ta durojnë edhe atë pakëz autonomi formale – minimale, dhe BARAZIA me shqiptarët për ta kishte kuptimin e TERRORIT, TË VDEKJES, kur dihet se gjithë gjenerata e tyre kishin lindur në Kosovë në kohën e sundimit të mbretërisë së Karagjorgjeviçëve, në atë pabarazi dhe diskriminim racist, më zi se në aparteidin Jugafrikan. Ndërsa kolonët e tillë ishin mësuar në një gjendje të tillë JONORMALE (e për kolonët ishte gjendje normale, e sanksionuar me ligj, dhe ata jetonin si **PARAZITË – si MORRA** në qafën – kurrizin e shqiptarëve të robëruar…Por, të mos harrojmë se-papastërtia jonë ua mundëson zhvillimin morrave...).

Nuk duhet ta harrojmë faktin se për shumicën e shqiptarëve në Jugosllavi SHQIPËRIA është emër ABSTRAKT, sepse **ne ende jemi në një nivel tmerrësisht të ulët të ndjenjave kombëtare sa gjendjen JONORMALE – OKUPIMIN, ta konsiderojmë si gjendje – NORMALE**, ndërsa gjendjen normale në Shqipëri – çlirimin dhe LIRINË E VËRTETË po e konsiderojmë – JONORMALE – **ROBËRI**?! Në këtë amulli siç jemi ne para së gjithash po PRITOJMË të mendojmë, dhe nuk po jemi në gjendje ta kuptojmë se **PESHKU e ndien veten mirë vetëm në UJË**, ndërsa ne po mendojmë se PESHKU (SHQIPËRIA) është i ngulfatur, i mbytur, i robëruar në UJË, ndërsa neve, si shpëtimtarë (VARRTARË) siç jemi, po duam ta SHPËTOJMË, ta qesim në **ZALLË PESHKUN – SHQIPËRINË ?!**

Ne ende po i bëjmë martesat pa u parë të fejuarit, sepse djemtë tanë po punojnë tërë vitin dhe nuk kanë kohë as të shihen as të dashurohen me shoqen e nesërme të jetës, ndërsa për mesitni japin miliona dinarë, por edhe miliona të tjerë për pajën e vajzës …

ꕥ

Cilët faktorë po ndikojnë që kolonizatorët serbo-malazezë të ikin nga Kosova dhe të nguliten dhe riatdhesohen andej nga kanë ardhur, në Serbi?

Faktori ekonomik është vendimtar, sepse prapambetja e madhe në Kosovë ata po i ngulfat, ndërsa ajo pak barazi formale për kolonët ishte vdekje. Mirëpo duket se leverdia e tyre ekonomike është shumë e madhe, sepse serbo-malazezët me një shtëpi që ua shesin shqiptarëve me çmim shumë të lartë, me ato të holla mund t'i blejnë në Vojvodinën e pëlleshme dhe në Shumadi tri shtëpi dhe disa hektarë tokë, ndërsa kur arrijnë në vendlindjen e tyre të kryehershme, çirren duke i sharë me nënë e babë shqiptarët duke thënë: Heu atyre terroristëve nënën, se sikur t'mos iknim patën me na mbytë?!… Pra nuk është e vërtetë se serbo-malazezët po ikin nga presioni i terrorit në Kosovë, sepse tërë aparati i dhunës është në duart e kolonizatorëve serbo-malazezë, por puna qëndron te shkaqet objektive ekonomike, sepse në Kosovë kemi një zhvillim ekonomik tepër ekstensiv, tepër të prapambetur. **D. Tucoviqi**, social-demokrat i njohur serb, thoshte se nuk mund të pretendojmë me apetite kolonialiste duke iu referuar gjoja të drejtës historike **në ato tri kisha – murana të vdekura, të rrethuara me detin e gjallë të shqiptarëve autoktonë** (Sabrana dela, nr. 7, Beograd 1980).

ꕥ

Shumë karakteristik është shembulli i **finlandezëve**, të cilët e habitën botën me kompaktësinë dhe organizimin e tyre unik. Ata deri në shekullin XII vuanin nën zgjedhën e sundimit suedez, ndërsa që nga viti 1912 nën sundimin e rusëve. Kështu finlandezët 5-6 shekuj jetuan nën sundimin suedez, pra niveli i tyre i zhvillimit ishte në nivel të suedezëve, ndërsa për ne që jetuam nën zgjedhën e obskurantizmit turk niveli ynë ngeli në nivelin e osmanlinjve… Suedezët janë më gjermanë se gjermanët… Finlanda 106 vite ishte nën sundimin e carit rus, por me administratën e vet, parlamentin e vet, sepse **as rusët nuk mundën t'u japin finlandezëve më pak liri sesa suedezët,** dhe vetëm u mungonte statusi i shtetit. Pra edhe një Rusi cariste aq primitive është detyruar ta kuptojë arsyen e autonomisë finlandeze. Por nga ana tjetër, edhe vetë finlandezët ishin shumë KOMPAKTË. Ndërsa ne jemi krejtësisht ndryshe, në shumë pikëpamje, edhe nga pozita gjeopolitike, sepse nuk jemi jashtë gardhit, siç është Finlanda, por në epiqendër të strategjisë evropiane…

29 tetor 1988:

Sot masat janë të bombarduara nga dhjetëra mediumet e ndryshme informative, dhe mu për këtë ato nuk mund ta identifikojnë të vërtetën në këtë anarki informative. Në çdo lagje duhet të kemi nga një **Diogjen** me fener në dorë, nga një udhërrëfyes…

ꕥ

Sekvoja, baobabi, lloje druri me moshë deri në 12.000 vjet, janë drurët më çmimin më të lartë. Në dhomën e ndërtuar nga baobabi edhe sikur të çirresh e lemerisesh tingëllon ndryshe, bile edhe zëri i qyqes tingëllon si zë bylbyli… Pallatet në Kinë, Kore, Japoni, Mongoli etj. mbarohen pa asnjë gozhdë, dhe era e drurit është e tillë çfarë është lloji i drurit: pishë, qershi, arrë, mollë, ndërsa

në jemi mbyllur në këto **SHPELLA BETONI,** në këto kazamate. Nëse nuk e thyen qafën në asfalt, do e thyesh shpirtin, sepse çdo ditë e më shumë jeta është më pak origjinale, dhe më shumë artificiale…

ꕥ

Në kohën e sundimit të perandorit **Kaligula**, kali i Kaligulës u zgjodh **kryetar i senatit romak**, i PARLAMENTIT romak, dhe merreni me mend se çfarë senati ka qenë ai. Dhe si rezultat i kësaj dekadence perandoria romake mori tatëpjetën… Dhe merreni me mend: romakëve po u jepnim perandorë, ndërsa vetë nuk ishim askund… Në librin ETNOGRAFIA të autorit Radovanoviq, botim i paraluftës, shkruan se: **Shqiptarët janë i vetmi popull i egër në Evropë**. Ata po thonë: Shqiptarëve (Arnautëve) do ua japim të gjitha të drejtat mundshme, por për vetëzvoglim dhe vetëshfarosje… Edhe i vetëquajturi ”Revolucion” i Millosheviqit u bë në frymën e Sveti Savës…

Ne kemi hyrë në Shkup më 1912 të paorganizuar, me tespihe, me pare, të shitur… Dinastia e Bushatllinjve të Shkodrës sundoi 250 vjet, si dhe dinastia e Ali pashë Tepelenës, por nuk ishin për vetvete, **ishin mercenarë të padishahut...** Ali pashë Tepelena ishte vasal formal, me SHTET PRIVAT… por administratën e mbajti në **gjuhën turke**, dhe **32 vjet e mbajti shtetin në shtet.** Tërë administratën e mbajti në gjuhën e huaj, dhe jo në gjuhën shqipe… Por edhe Skënderbeu tërë administratën e mbante në gjuhën latine. Edhe në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit gjithë administrata u mbajt në gjuhën turke… Ndërsa **sot edhe Gjermania ia ka lakmi sovranitetit dhe PAVARËSISË së vërtetë të Shqipërisë...** Neve jemi të shpartalluar me katër organizata kishtare, dhe kemi katër lloj klerikësh, katër lloj divergjencash fetare, por edhe divergjenca në gjirin e popullit…

ꕥ

MIRDITA – edhe në kohën e Bizantit, por edhe në kohën e Skënderbeut, gëzonte një autonomi kulturore, dhe i pari i Mirditës mbante titullin – PRINC, i pari i Bibdodajve. Kullat kanë ngelë të kishës romake, sepse numerikisht nuk ishin të shumtë, por edhe kur ushtria pushtuese serbe e Pashiqit pushtoi Mirditën, ata donin të kishin një AUTONOMI VASALE, dhe përmes bazës së Mirditës ta pushtojnë edhe Lezhën e Durrësin…

QEVERIA E VLORËS më 1912 ishte një shtet FORMAL, sepse asnjë dokument nuk e kishte në gjuhën shqipe, administrata kishte në përdorim gjuhën turke…, gjersa Flota Ndërkombëtare patrullonte në bregdet me forcat angleze, franceze, italiane etj. , rreth e rrotull livadhisnin bandat serbomalazeze (në Veri), dhe ato greke (në Jug), dhe nuk kishte si të funksiononte normalisht një shtet i tillë i nakatosur dhe i copëtuar nga fqinjët grabitqarë… Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK) administronte çdo gjë… Nga kjo del se duhet të jemi realistë, e jo të shohim ëndrra, dhe të marrim në thua midis qilimit… **TRIM** është ai i cili i ndihmon edhe vetvetes, **dhe i vjen turp të mos u përgjigjet këtyre tri thirrjeve: të mirës, të vërtetës dhe të drejtës, dhe sidomos kur e thërret zëri i Atdheut** për çlirim dhe bashkim kombëtar…

A. Z. Çajupi me poezinë – SHQIPTAR! MOS RRI PO DUKU SHQIPTAR, dhe – KU ËSHTË BALTA MË E ËMBËL SE MJALTA, na ka dhënë gajret, na ka mobilizuar për luftë dhe rezistencë aktive kur thotë:

XHVISH RROBAT E ROBËRISË MËMËDHE,
VISH ARMËT E TRIMËRISË SE KE NE!...

ꕥ

VOJVODINA – u dorëzua para pushtimit serbo-malazez, kolonizimi pas vitit 1945 dhe dëbimit të folks-dojçerëve gjermanë (mbi 500.000). Vojvodina iu aneksua Serbisë më 1918 për herë të parë, dhe serbët e atjeshëm për shumë gjera dallohen nga serbët tjerë, ndërsa për kah mënyra e jetesës, kultura, qëndrimi nuk janë dalluar nga gjermanët. Sipër lumit Sava edhe veshjet ishin ndryshe, me çizme, ndërsa në jug mbathnin opinga gogishte, lëkure. Ndërsa priftërinjtë serbë jetonin njësoj si në Budapest si në Vojvodinë. Pas dëbimit të folks-dojçerëve gjermanë në Vojvodinë u vendosën si kolonë mbi 60.000 familje serbo-malazeze, dhe kështu u bë një ndryshim i madh në strukturën demografike dhe etnike….

Në Kalabri në shekullin 17 ka dalë gazeta në gjuhën shqipe. Kështu ne kemi ngelë prapa tyre për 200 vjet, por edhe këta serbët e Vojvodinës ishin 200 vjet para atyre serbëve që jetonin në jug të lumit Sava …

Më 1981 Boshko Kruniqi i Vojvodinës tha se në Kosovë nuk ka KUNDËREVOLUCION, pra 6 vjet para Branko Horvatit, por duhet ta dimë se kjo është thikë me dy tehe… Të gjitha strukturat e shkencës dhe artit po flasin si sharlatanë me qëllim, se po kanë hesap, po thonë gjera banale, antinjerëzore, dhe kjo është një makiavelizëm i vërtetë, sepse QËLLIMI i tyre i zi i arsyeton mjetet e tyre të zeza, kur një Stipe Shuvar është bërë komandant suprem i Kryesisë Kolektive të Federatës Jugosllave, por edhe këtu në këtë federatë krisi incidenti me përfaqësuesin slloven, Hafnerin, dhe gishti i Hafnerit ishte ATENTAT moral ndaj Millosheviqit dhe klikës së tij, por Millosheviqi këtë sulm nuk e bëri të madhe, sepse e dinte se do të prishte më shumë punë…

Kulmi, kurora e religjionit, qëndron në faktin se njerëzit **nuk kanë asnjë lidhje me SHKENCËN**… Sa më injorant, i padijshëm, të jetë dikush, aq më tepër është i kënaqur me vetveten, dhe u beson SUPOZIMEVE. M. Gorki thoshte:

PREJ 10 SUPOZIMEVE, 9 JANË TË PAVËRTETA.

Cila kafshë miklohet më shumë se qeni? Por, cila kafshë është edhe më besnike se qeni?

Grekët e moçëm mendonin se gjumin e udhëheq Zoti – HIPNOS **(Zoti i gjumit)** shih – Boris Sergejev – Fshehtësitë e kujtesës (Tajne Pamçenja) – Nolit, Beograd, 1976, f. 202.

LIGJËRIME, 30 tetor 1987:

Ç'mund të themi për kauzalitetin e shpirtit dhe materies?

Shpirti është mënyrë e ekzistencës, pjesë e pandashme e MATERIES, pjesë e qenies, pjesë e pandashme e qenies, sepse s'mund të jetojmë pa materie, si abstraksion, jashtë realitetit, kur e ndajmë pjesën nga tërësia, që ta kuptojmë më lehtë. Ne nuk mundemi ta shohim tërë bjeshkën me mikroskop, atëherë e marrim një copë minerali sa për studim, si teori… Po të mos kishim pasur SHPIRT – ide, vullnet, ne nuk do të kishim as shkolla, por çështja e shpirtit është banalizuar, mistifikuar dhe **kompromet**uar. Ne e kemi prejardhjen nga një racë e veçantë majmunësh ANTROPOMORFË, të ngjashëm me majmunët e sotëm, një lloj PRIMATI i cili me kalimin e kohës është **transformuar përmes PUNËS në NJERI**. Ndaj, është më mirë të jesh njeri i mbrapshtë sesa kafsha më e mirë. Pra, shpirti nuk ekziston jashtë kozmosit, jashtë brumit kozmik, substancës kozmike, jashtë kontekstit të vet. Kësisoj, shpirti është IMANENCË e vetë substancës kozmike, ndërsa ne si njerëz e abstragojmë, e veçojmë dhe e nxjerrim jashtë këtij konteksti, se gjoja shpirti ekziston jashtë materies?! Shkenca nuk kishte për t'u zhvilluar sikur ta mohonte dëshirën për ta njohur shpirtin. Nga **pikëpamja religjioze** SHPIRTI ekziston jashtë

NATYRËS, jashtë materies, dhe ky këndvështrim është i rrezikshëm, është spekulim, dhe këta spekulatorë shkojnë deri aty sa të vijmë në përfundim se NATYRA ËSHTË KRIJESË E SHPIRTIT, pa të cilën ngelim pa bukë, pa ekzistencë. Ndërkaq, sipas ligjeve dialektike, nuk ka shpirt pa materie. Irracionalja dhe racionalja nuk kanë fund. Kategoria religjioze është sistem i cili jeton me mijëra vjet, dhe manovron në fushat jashtë shkencës, si ajo e **METAFIZIKËS**, fusha të cilat nuk njihen nga shkenca, në vend se të manovrojë në fushën e prodhimit dhe riprodhimit, prodhimit të zgjeruar, sepse nëse nuk ecim përpara, atëherë do të stagnojmë, sepse shkenca është e mundshme vetëm përmes riprodhimit të zgjeruar. Natyra **është e pashtershme, e pazbuluar, e shpirti është pjesë e pandashme e saj, e materies, dhe shpirti prodhon e riprodhon, prodhohet e riprodhohet**. Feja predikon se PERËNDIA është demiurgu – krijuesi i natyrës, sepse kanë llogari ta thonë këtë. Nuk mund të kemi biologji pa fizikë e kimi. Fitoplanktonët nuk dinë për prindër, por kanë prindër (p.sh. në Opojë pothuaj çdo familje e ka nga një **hoxhë**, dhe për këtë e quajnë – ALBANSKA SVETA GORA – MALI I SHENJTË SHQIPTAR), dhe po të flasësh me ta rreth çështjeve religjioze është e kotë. Nëse e ndajmë jetën nga praktika, atëherë e ndajmë shpirtin nga trupi… Baruh Spinoza ishte PANTEIST, ndërsa Naim Frashëri – PANTEIST MISTIK. Spinoza ishte me arsye – racionalist, e Kanti materialist. Nëse themi vetëm shkenca dhe asgjë tjetër, atëherë as një javë nuk mund të jetojmë me të. **Shkencëtari i vërtetë nuk pohon, as nuk mohon, se ka apo nuk ka ZOT,** sepse nuk është profil i tij, fusha e studimeve të tij – SFERA IDEALISTE, MISTIKO-FETARE.

ꕥ

Vetëm një **FJALË GOJE** në disa situata ka efekt më të madh se sa PLUMBI!

Ngacmimet që vijnë nga valët e zërit – melodia – tregon se një gjë fizike shndërrohet në ndjenjën e gëzimit, haresë, dhe e prek shpirtin, prandaj **NDJENJAT** NUK JANË KATEGORI QË MATEN (Gëzimi, hidhërimi, dashuria, pikëllimi etj.) Pra, derisa është IRRACIONALJA – MAGJJA ËSHTË PLOT – dmth. kemi përherë se çfarë të gatuajmë, por varet se çfarë është dora e asaj që e gatuan bukën… Për shembull, për elektricitetin dimë shumë pak, por është fakt se elektriciteti na sjell DRITËN, ndërsa për ne është e rëndësishme ta shfrytëzojmë këtë të mirë me mençuri – **TË NDRÇOHEMI E TË MOS DIGJEMI!**

Realiteti më i madh në galaktikën tonë është – **Reaktori natyror atomik – DIELLI.** Pra QËLLIMI duhet të synojë kah ajo që SHPIRTIT t'ia shohim sa më shumë hairin. Dhe pikërisht për këtë e studion shkenca SHPIRTIN – **për ta bërë njeriun sa më të LUMTUR!** Pra studiohet **VIRUSI I MORTAJËS** që njerëzimi të shpëtojë nga rreziku i kësaj epidemie. Qysh sot po bëhen prova në fushën e PARAPSIKOLOGJISË dhe komunikimit TELEPATIK, e dihet se sot horizonti i ulët i dijeve të tanishme është ende në një shkallë që shumë gjera për neve janë të pakapshme dhe të pamundshme (**Vetëm 4% të trurit të njeriut janë të përpunuara, e pjesa tjetër është pothuaj shkretëtirë** (shih librin – SUPERPAMÇENJE – SUPERKUJTESA).

Ne së pari duhet t'i fitojmë të hollat, e pastaj ta blejmë një artikull. Ne sot ende jemi si BRUMË – SUBSTRAT, në shërbim të te tjerëve, edhe materialisht, por edhe shpirtërisht, dhe gjithnjë u kemi dhënë BRUMË të tjerëve (Egjiptasve për formimin e shtetit, grekëve formimin e shtetit më 1821 – mbi 50% të parlamentit grek ishin deputetë shqiptarë; turqve u kemi dhënë 40 sadriazema – kryeministra dhe rektorin e parë të Universitetit të Stambollit – Hasan Tahsinin, pastaj enciklopedinë e parë të hartuar nga Sami Frashëri në gjashtë vëllime; romakëve disa dhjetëra perandorë që nga Konstandini e deri te Diokleciani etj., por më së paku i kemi dhënë vetvetes

(Atë që ia jep komshisë, nuk i mbetet shtëpisë), dhe nuk kemi qenë në gjendje të formojmë **SHTET.**

Për shembull, maqedonët deri para 20 vjetëve nuk kishin kishë autonome – autoqefale, të pavarur nga kisha ortodokse serbe. Selia kishtare serbe – Patrikana, gjendet në Pejë dhe Prizren, sepse këtu ka qenë qendra e pushtetit serb të Nemanjidve…

Para lufte, një recetë mjeku paguhej 50 kg. miell ose 50 dinarë, dhe mu për këtë pak kush kishte mundësi që të shkojë te mjeku. Në Pejë kishte 4 mjekë rusë dhe dy serbë. Rroga e një mjeku ishte e barabartë me çmimin e një pendë qeve, sa ç'janë sot 150 milionë dinarë të rinj. Rroga e një mësuesi ishte sa sot 70 milionë dinarë të rinj. Por çdo mësues e kishte të garantuar banimin (në shkollë), dhe ngrohjen. Një ministër e ka pasur rrogën 12.000 dinarë, dmth. sa 9 pendë qe, ose sa ç'janë sot 450 milionë dinarë, edhe pse ishin ma beter se ministrat e sotëm… Këta të sotmit nuk shohin se çfarë vlerash ka Dr. H. Tërnavci, dhe si i tillë, i denjë për klinikë, ai po u hyn në punë. Por edhe ne për shumë pikëpamje jemi si Tërnavci. Këtu ndër ne është një mozaik i tërë me pushkë, me gjak, folklor, muzikë të lloj-llojshme, etnografi, thuajse jemi **70 milionë banorë.** Ne nuk kemi as KISHË as XHAMI autoqefale – **autonome shqiptare**, ndërsa pushtuesit po i konvenon ky vakum, ky boshllëk i yni, kjo ndasi, për t'ia zgjatur jetën okupacionit për interesat e Rusisë… Populli shqiptar nuk është zhvilluar në frymën e organizatave kishtare dhe këtu gjetën truallin dhe u kultivuan katër lloj RELIGJIONESH – (Katër ferra në kopshtin kombëtar, sipas F. Nolit), dhe **formimi i KOMBIT SHQIPTAR** nuk buron nga organizatat kishtare, por përkundrazi, ato organizata e bënë efektin e kundërt, efektin pengues, efektin negativ, që ne të ngelim pa shtet deri në vitin 1912, dhe të fitohet më pak se 50% e territorit etnik, ndërsa pjesa dërmuese e trojeve kombëtare të ngelin nën okupimin serb, malazez, maqedonas dhe grek.

Qe 40 vjet Shqipëria po bën çmos që të mos bashkohet me ne, sepse MBARON edhe vetë.

Një fjalë e ëmbël e gojës ka shumë vlerë psikologjike, ndërsa fjala e rëndë – ofenduese, është më e tmerrshme se dajaku…

Forca jonë nuk është materializuar që 2000 vjet, sepse u kemi shërbyer të tjerëve, pra ende jemi në nivelin e **PJEKURISË FËMIJËRORE,** sepse fëmija më shumë gëzohet t'ia japësh një **çokollatë** se një **shtëpi**, ndërsa shqiptarët e sotëm më shumë i gëzohen një veture, një shtëpie, një kamp-shtëpize se sa **LIRISË?!**

ꕥ

Profesor, pse i jepet vend parësor bazës materiale, si përcaktuese e superstrukturës shoqërore?

Sepse njeriu kurrë nuk mund të bëhet NJERI KOMPLET përderisa robtohet dhe lufton për ta fituar një copë bukë, dhe nuk ka mundësi për vetëarsimim dhe vetëafirmim të vetvetes, e lere më për rekreacion e pushime verore në det. Pra nga punët e shumta dhe shfrytëzimi i egër i djersës së tij, ai nuk arrin t'i shijojë dhe t'i kuptojë të mirat materiale dhe shpirtërore, sepse jeta e tij **është banalizuar nga kjo skllavëri moderne...** Ndërkaq shkenca kurrë nuk e banalizon jetën, por lufton për mirëqenien materiale dhe shpirtërore, lufton për njeriun sa më komplet dhe sa më njerëzor… Ndërkaq qëllimi i njeriut me mentalitet KONSUMATOR është që të jetë sa më i dukshëm, sa më elegant, sa më snob, ta mbushë stomakun sa më shumë, **të bëhet më derr se derri...** Prandaj duhet të na vijë turp nëse u bëjmë KONKURENCË DERRAVE, sepse jetën ekonomike duhet ta bëjmë sa më RACIONALE – sa më të ARSYSHME: prej 12 orëve në 8 orë dhe pastaj në 4 orë, që t'i kemi në dispozicion 20 orë për **HUMANIZIMIN E NJERIUT,** që ai të mund të mendojë sa më shumë me kokën e tij për të MIRAT NJERËZORE, për art, për

letërsi, për filozofi, kinematografi etj. , dhe kështu të ketë sa më shumë mundësi dhe aftësi "të hajë" me SY, ME VESH – ME MEND (siç thoshte Viktor Ygoi në trilogjinë – TË MJERËT), që të mos bëhemi KUFOMA TË GJALLA që e shëmtojnë këtë truall të shenjtë (siç thoshte Fan Noli)…

LIGJËRATË, 10 nëntor 1987:

Në kohën e Luigjit të XVI-të në Paris, në Francë, që ishte vendi më i pasur me drithë në Evropë, shpërtheu protesta e mbi 2000 grave, për shkak se drithi ishte fshehur, dhe kjo ishte një shkëndijë që shkaktoi shpërthimin e REVOLUCIONIT BORGJEZ FRANCEZ. Në VERSAJË, para masës protestuese doli mbretëresha MARI ANTUANETA, dhe u thotë grave ç'kanë që protestojnë? **"S'kemi bukë, duam bukë!"** – ia kthejnë ato. Mirë, ua kthen mbretëresha, atëherë pse nuk hani **ëmbëlsira**?! Këtu plas zemërimi dhe merr fund cinizmi dhe ironia flagrante e mbretëreshës së pashpirt. 2000 gra trimëresha vrapojnë në sheshin e Versajës, **ia hedhin litarin në qafë dhe e ngrehin zvarrë mbretëreshën nëpër rrugët e Parisit.** Pas 16 muajsh, më 1793, Luigjit të XVI iu **pre koka.** Pas tre muajsh koka iu pre edhe mbretëreshës Mari Antuaneta. Kjo ishte dëshmia e parë e pamohueshme se çfarë mrekullie mund të bëjë në një shtet uniteti dhe solidariteti i **GRAVE TRIMËRESHA...**

ꕥ

Këtu te ne e subvencionojnë bukën e zezë me 300% për fukarenjtë. Kjo jo pse ata iu dhimbsen, por pse ua kanë frikën se do të ngritën në protesta, kështu që ata ta kenë

atë minimum ekzistencial, sepse buka e zezë po shitet me çmim më të lartë se e bardha, dhe për tri bukë të duhet të presësh 6 orë, në të ftohtë dhe acar, dhe kjo po paguhet me shëndetin e fëmijëve tanë …

Në të ardhmen, me modernizimin e bujqësisë, do të na teprojë më shumë kohë për humanizimin e jetës shoqërore…

Mungesa e pjesëmarrjes në ndonjë luftë që 200 vjet ua ka bërë të mundur suedezëve që secili punëtor ta ketë banesën e vet…

Pozita jonë strategjike është shumë e ndjeshme, sepse gjendemi në fytin e Evropës (Evropa – koka, ndërsa Azia – trupi, pra 300.000.000 me 2.000.000. 000 banorë).

ꕥ

Në Evropë kemi dy shtete antipode – demokratike, ZVICRA DHE SHQIPËRIA, të cilat po jetojnë si shtete të pavarura, njëra që nga viti 1291 e tjetra që nga viti 1945 e deri më sot. Zvicra është në kërthizë të Evropës, por nuk e ka pozitën strategjike siç e ka Shqipëria, dhe mu kjo pjesë mund të shërbejë si gacë, si shkrepëse…

ꕥ

Ani pse fëmija lind me njëmijë të zeza, së paku 50% janë pasojë e trashëgimisë. **MAKARENKO** e ka absolutizuar rolin **e KOLEKTIVIT** në procesin e edukimit, ani pse kolektivi e luan rolin e vet vendimtar, por jo absolut**. Individi më së shumti respektohet në Zvicër**…

ꕥ

Derisa shkojmë kaq masovikisht në xhami, kishë dhe teqe, shteti tiranik nuk ka frikë nga ndonjë rrezik prej nesh. Poashtu, derisa vjedhim në të katër anët, edhe kjo nuk e pengon fare shtetin tiranik. Por edhe nëse i **PAJTONI**

DY FAMILJE, ndërkaq dhjetëra të tjera janë në ngatërresa, kjo është njësoj si kur e kosit barin gjatë një sezone, ndërsa tjetri del edhe më i shpeshtë, sepse nuk e ke GODITUR SHKAKTARIN E KONFLIKTEVE NË KOKË. Pra duhet të zhduket **PRONA PRIVATE** dhe të bëhet kolektivizimi i saj. 50% e të dënuarve me vdekje në Jugosllavi janë nga Kosova, prandaj pajtimi në këtë formë dhe me këto metoda, përkundër vullnetit më të mirë, është njësoj sikur t'i qethim flokët, rrënjët e të cilave forcohen edhe më shumë… dhe me këtë ne po ia zgjasim jetën **SPONTANITETIT FEMIJËROR, dhe po merremi me PASOJAT...** Njësoj sikundër një NËNË e cila i thotë të birit – ZGJOHU NGA GJUMI, ndërsa ai si përtac që është, vazhdon edhe më tutje gjumin e tij fëmijëror. Prandaj ne duhet domosdo ta tejkalojmë këtë fazë të **FËMIJËRISË...**

ꕥ

Republika e Kinës për tetë vite me radhë në REVOLUCIONIN KULTUROR i terrorizoi klerikët me tërë forcën dhe e demaskoi FENË, por më në fund u dorëzua, i çoi duart, dhe sërish vazhdoi me të vjetrën, ndërsa Shqipëria që nga **6 shkurti 1967** e deri më sot bëri **REVOLUCIONIN MË TË MADH DERI SOT NË BOTË**. Prandaj quhet **shteti i PARË ATEIST NË BOTË,** sepse kishat dhe xhamitë i shndërroi në MUZEUME, depo e salla sportive. Në Shkodër sot **e kemi MUZEUN E VETËM ATEIST NË BOTË,** ndërsa hoxha, prifti, dervishi, shehu, të gjithë u detyruan t'i përvishen punës, sepse e kuptuan se më kurrë nuk mund të jetonin siç kishin jetuar më parë si **PARAZITË,** dhe këto masa demokratike i ka aprovuar populli unanimisht për të mirën e vetvetes… Në Bashkimin Sovjetik LENINI arriti të thotë – MOS TE SUBVENCIONOHEN KISHAT. Edhe STALINI nuk arriti të shkojë më tej, por ndaloi shtypjen e çfarëdo literature religjioze, bile kishte dhënë urdhër që klerit të mos i shitet asnjë gramë letër. Ndërsa sot religjioni në

BRSS po prosperon, sepse interesat janë identike me ato të shtetit burokratik. Prandaj, siç thoshte Karl Marksi- **FILLESA E ÇDO KRITIKE DUHET TË NISET NGA KRITIKA E RELIGJIONIT**, ndërsa Lenini shtonte se – **ABECEJA E ÇDO KRITIKE DUHET TË FILLOJË NGA RELIGJIONI.**

Kështu na del se në kontekstin historik të rrethanave Shqipëria ka qenë e detyruar ta ndalojë religjionin si parakusht i **VETËEKZISTIMIT,** përveç grushtit propagandistik në çdo roman, poezi, dramë, film, radiotelevizion etj. Dhe kështu FESË i është dhënë grushti vendimtar **– NDALIMI ME KUSHTETUTË I ÇDO PROPAGANDE RELIGJIOZE**. Dhe kjo është një risi, sepse klasikët e marksizmit këtë hap nuk e kanë paraparë. Por po bëhet ajo që në rrethana të caktuara do ta bënin edhe Marksi, Engelsi dhe Lenini, pra religjioni u barazua me aktet ligjore me **KUNDËRREVOLUCIONIN**. Ky hap kaq i guximshëm i Shqipërisë e tmerroi sidomos **VATIKANIN**. Por hë për hë nuk kanë çfarë t'i bëjnë, sepse Shqipëria është KALA e pamposhtur...Ajo sot e vetme po e hedh vallen e revolucionit në gojën e kuçedrës imperialisto-rev izioniste, dhe kjo falë unitetit parti-popull...

ꕥ

Rreth çështjes shqiptare ekzistojnë resorët e veçantë të specializuar në Stejt – Departamentin amerikan, në BRSS, Britani të Madhe, në Jugosllavi, Francë etj. , edhe pse Shqipëria mban marrëdhënie diplomatike me 118 vende të botës…

Qendra e CIA-s amerikane për Ballkanin është në Beograd, dhe Jugosllavia gjithmonë ëndërron ta gllabërojë Shqipërinë, duke e luajtur rolin e **KALIT TË TROJËS, për gjoja - BASHKIMI I GJITHË SHQIPTARËVE** , dhe kjo është strategji afatgjatë e Federatës Jugosllave, gjoja për t'i shpëtuar shqiptarët në Shqipëri nga **"ROBËRIA"** e diktaturës së proletariatit…

Por duhet ta dimë se niveli i vetëdijes së Serbisë është shumë i ulët që t'ia pranojë Kosovës STATUSIN E REPUBLIKËS, dhe mu për këtë ata thonë: **më mirë një zog në grusht** (aludohet për Kosovën) sesa 100 duke fluturuar (bashkë me Shqipërinë), pra më mirë ta kemi një mëz (Kosovën), sesa atë bashkë me Pelën (Shqipërinë).

ꕥ

Si e shpjegoni faktin se sot hungarezët nuk po bëjnë zë për të drejtat e vëllezërve të tyre në Vojvodinë?

Sepse pas luftës Hungaria u shpall shtet OKUPUES, dhe me këtë pretekst asaj po i mbyllet goja, ndërsa Shqipëria me pjesëmarrjen e saj në luftën antifashiste u pranua si shtet ALEAT. Meritë e **Stalinit** është pengimi i shpërnguljes së hungarezëve në masë nga Vojvodina, siç u veprua me 500 mijë folks-dojçerët gjermanë. Pra Hungaria si anëtar i Traktatit të Varshavës nuk ka të drejtë t'i trajtojë problemet rreth të drejtave të pakicës hungareze në Jugosllavi.

Sipas vendimeve në Teheran dhe Jaltë, Jugosllavia u nda fifti-fifti (50% me 50%), sepse **armata e kuqe ruse e çliroi Vojvodinën dhe vetë Beogradin,** dhe të gjitha trevat sipër Savës dhe Danubit… Më 1948 Stalini tentoi ta prishte këtë status-kuo, por Tito dhe Kardeli i dërguan 30.000 vetë në **Goli Otok** (burgu më i tmerrshëm në Jugosllavi), përndryshe do të shpërthente lufta. Edhe sot propaganda dhe politika ruse rri pas derës, e shembuj kemi sa të doni, sepse edhe kur erdhi ambasadori rus në Beograd, ai u takua me patriarkun e Kishës Ortodokse – GERMANIN, e pastaj edhe me Dobrivoje Vidiqin, kryetarin e komitetit të Serbisë.

ꕥ

Po për ne sot cilat janë detyrat më parësore në këtë raport forcash?

Së pari duhet të këmbëngulim në kërkimin e të drejtave tona, por hë për hë t'mos i FITOJMË, sepse ende nuk jemi POLITIKISHT TË VETËDIJSHËM...
(Sqarimin për këtë mendim profesori e jep në ligjërimet e mëvonshme,vër.ime, B.K.)

ꕥ

Çfarë do të thotë për ne mospjesëmarrja e Shqipërisë më 1975 në Konferencën e Helsinkit?

Kjo do të thotë shumë. Sikur ta nënshkruante Shqipëria dokumentin e Helsinkit për mosndryshimin e kufijve ekzistues në Evropë, kjo do të ishte e barabartë me nënshkrimin e **KAPITULLIMIT – TRADHTINË**, do të ishte vetëvrasje për Kosovën, dhe problemi i saj kolonial do të mbyllej, kështu që u dëshmua se ne nuk jemi popull TRADHTAR… Unisimi i gjuhës në Kongresin e Drejtshkrimit, në Tiranë më 1972, është arritja më e madhe e shqiptarëve pas Luftës së Dytë Botërore, është një parapërgatitje për **bashkim mbarëkombëtar.**

ꕥ

Filipinasit e flasin gjuhën spanjishte, Meksikanët po ashtu e flasin spanjishten, ndërsa indianët e flasin anglishten… **Abdyl Frashëri** më 1878 e shkroi MEMORANDUMIN në gjuhën frëngjishte, dhe meqë ishte pa çallmën e klerikut, fetarët thoshin: **ishalla na shpëton** – **FEJA, jo ATDHEU**…

ꕥ

Më 1950-1953 u bë agjitacion për shkombëtarizimin e shqiptarëve me masa represive duke i dërguar në zyrat e

UDB-së, e duke u thënë: A E DONI PARTINË? Dhe kur ata thoshin – PO, atëherë u thoshin: **duhet të regjistroheni – TURQ** (Xhemë Voka – Shipkovica kishte thënë: "Po qaj për Muhamedin, sepse nuk paska shkuar në xhenet, pasi nuk ka ditur të flasë turqisht, por arabisht?!").

ꕥ

Pse sot askush nuk e zë në gojë gjendjen e mjerë të klasës punëtore dhe fshatarësisë?

Me din e iman ne po i ndihmojmë Akademisë Serbe të Shkencave, sepse ne me hoxhallarët, me priftërinjtë, me dervishët etj., e kemi LAKUN NË FYT, sepse këta janë KOLONA E PESTË. Si këpuca e ngushtë që ta ndrydh këmbën. Ai person që e merr hoxhën, dervishin, priftin në ceremoninë e vdekjes, dasmës, ai është shumë reaksionar, është shumë i dobët në pikëpamje kombëtare.

ꕥ

Po pse po u shkon masa kaq shumë prapa dhe po u beson këtyre klerikëve reaksionarë?

Po u beson sepse këtë masë **tash e 2000 vjet e kanë trullosur,** dhe këtu vepron ligji i INERCIONIT – ligji i PLOGËTISË… Jezu Krishti nuk ka lindur, siç predikohet në librat fetarë, nga urdhri i ZOTIT, por Mejremja (Maria) Jezuin (Isain) e kishte me burrin e saj, Isufin (Jozefin, Josifin).

Neve pa na ra dergja nuk e kuptojmë sëmundjen, rëndësinë e jetës, dhe pa na ndodhë një e keqe nuk e kuptojmë vlerën e të mirës, ndërsa pa na ndodhur padrejtësia nuk e kuptojmë rëndësinë e drejtësisë… Pra FEJA është një mbeturinë – një **firo radioaktive**, por shumë e **RREZIKSHME,** dhe këto mbetje duhet t'i varrosim sa më thellë, si mbetjet e **Çërnobillit,** që t'mos ua shohim sherrin… Organizata kishtare ekziston që 2000 vjet, kisha

katolike më 1051, **dhe ne e kemi klerin më jokombëtar dhe më të pavetëdijshëm**, klerin MYSLIMAN, dhe derisa kemi kësi beterësh, Beogradi fle rahat… Federata po i dirigjon, po u thotë – flisni, qitni shkelma, nëse doni të ngroheni afër oxhakut të Federatës, dhe këtë po e bën për ta shpëtuar vetveten…

ꕥ

Një dorë njerëzish po thonë – **NE NUK MERREMI ME POLITIKË.** Kjo nuk është e ndershme, është e pamoralshme, sepse po e duan çdo gjë të gatshme, dhe nuk po përpiqen për t'u bërë SUBJEKT, por të ngelin përherë OBJEKT, njësoj si – **DELET**, si bagëtia, sepse edhe ato sikur të mund të flisnin do të thoshin – NE NUK MERREMI ME KASAPIN, ne nuk merremi me UJKUN, por dihet se kasapi e ujku merren me delet…

Më 1912 është bërë vetëm NDARJA FIZIKE E SHQIPTARËVE, sepse gjendja ekonomike në të dy pjesët e Shqipërisë së copëtuar ishte identike, e njëjtë, ndërsa **NDARJA SHPIRTËRORE** vazhdoi që nga viti 1912 e këtej…

Të gjitha të zezat, ngado që na vijnë, janë prodhim i dy faktorëve: faktorëve OBJEKTIVË dhe SUBJEKTIVË. Dhe është absurde kur thua: **më kanë marrë në qafë!** Sepse shtrohet pyetja: **po ti pse ke lejuar me të marrë në qafë dikush?** Pra duhet të punojmë ditë e natë për t'u bërë të FORTË, dhe për t'ia ditur vlerën reale çdo sendi…

ꕥ

SA JEMI TË FORTË NE SHQIPTARËT SOT?

Të fortë jemi për aq sa MËSOJMË! Dhe kur nuk përtojmë t'i mësojmë gjerat e domosdoshme... Një komb mund të zhduket edhe pa fajin e vet, por kryesisht ai mban përgjegjësinë kryesore për FATIN E TIJ (më së

paku 50%)... PRITESA është indikator i SËMUNDJES SHOQËRORE...

Dobrica Qosiqi po thotë se edhe shqiptarët duhet ta gëzojnë LIRINË, por nën dhe, **pasi të vdesin**. Pra serbët ta gëzojnë lirinë mbi tokë, për së gjalli, ndërsa shqiptarët pas vdekjes. Dhe kështu vazhdojnë me avazin e spekulimeve se gjoja nuk bën pa unifikimin e ligjeve, d.m.th., **me lak në qafë e plumb në gojë,** dhe në botën e përtej varrit do e gëzojmë lirinë, xhenetin, kur as nuk do të na dhembë dhëmbi, as veshi, as koka, dhe një gjumë të tillë të rehatshëm na dëshirojnë këta racistë të cilët veten e konsiderojnë tejet "revolucionarë"… Por te kush mund të gjejnë vend këto lajkatime? Vetëm te ata të cilët **PRITOJNË ME MENDUE**, të cilët s'marrin mundimin t'ia vënë gishtin kokës. Në këtë mënyrë ata që mashtrohen nga sofizmat perfide të kësaj burokracie fashiste, ata edhe e paguajnë kamatën më të madhe. Edhe dr. **Milica Gërkoviq** ua dha recetën se si shtimi i lindshmërisë rapide te shqiptarët është rreziku më i madh për serbët, është **terror demografik(Demografski terorizam, thoshte ajo),** edhe pse ajo merret me çështjet tjera të shkencës së arkeologjisë…

ꕥ

Kur mund ta quajmë një fitore – FITORE të PLOTË?

FITOREN E PLOTË mund ta kemi kur fitojmë sa jemi gjallë. Por nuk duhet harruar se kurrë nuk mund të ketë DRITË aty ku nuk digjet asgjë, prandaj **DJEGIA MË NJERËZORE PËR TË CILËN DUHET TA SAKRIFIKOJMË EDHE JETËN ËSHTË – LIRIA**, sepse vetëm atëherë, dhe pasi të sakrifikohesh e të digjesh, ti do të vazhdosh të jetosh përmes të tjerëve, përmes dritës sate që ua ke lënë brezave trashëgim(Shih-N. Frashëri-**FJALËT E QIRIRIT**).

Sot ne i kemi burgjet përplot me të burgosur politikë, mbi 7000 vetë, lulja më e bukur e vendit, vetëm pse

kërkuan **LIRI** dhe të drejta njerëzore, ndërsa në kohën e tiranit Rankoviq u dëbuan me dhunë mbi 400.000 shqiptarë në shkrepat e Anadollisë në Turqi, dhe të gjitha këto janë dëshmi e pamohueshme se shqiptari i këtyre trevave nuk ishte – ZOG SHQIPTARI, siç e paraqet në këngë rapsodi romantik popullor, duke mos besuar se po ai **"zog shqiptari" nesër mund të te qetë para konopit,** ndërkaq kishte shumë të drejtë Pashko Vasa kur vajtonte fatin e Shqipërisë:

Qani ju shpata, qani ju dyfeqe,
Se u zu shqiptari si zog ndër leqe,
Mos shikoni kisha dhe xhamia,
Se feja e shqiptarit asht shqiptaria...

Me këtë poemë – manifest poeti na dëshmon se sa i ndërgjegjshëm ishte ai në kohën e tij për REALITETIN e hidhur të shqiptarëve, dhe me zë të lartë lëshonte alarmin që populli të **zgjohej nga gjumi** dhe ta shkatërronte përgjithmonë robërinë shekullore. **Ne duhet të turpërohemi dhe të skuqemi për realitetin e sotëm, për këtë vonesë kaq të madhe**, për këtë gjumë kaq të rëndë, që edhe sot e kësaj dite po e durojmë zgjedhën e robërisë kur edhe në Afrikën e Jugut erdhi liria.

Grupet e shitësve dhe stërshitësve janë HIPOKRIZI e madhe, edhe pse janë të fortë materialisht, ndërsa ata që e shtrijnë dorën e lypësit, janë të dobët me trup e me shëndet, por edhe me shpirt **– shumë dyfytyrësh**. Por duhet ta kultivojmë dyshimin **NJOHËS** (kognitiv), derisa të mos e kemi kuptuar rrënjësisht një gjë, dhe për këtë shkak ndaj disave duhet **të qëndrojmë në distancë**, dhe mos t'i humbim fjalët kot, ndërsa me dikë njëherë jemi takuar dhe nuk i ruajmë fjalët, ndërsa me tjetrin rrimë pranë tij tërë jetën dhe asnjë fjalë të pamatur nuk ia themi…

ꕥ

Si fitohet SERUMI kundër helmit të gjarprit? Për këtë janë vendet, fermat e posaçme për kultivimin e GJARPËRINJVE, dhe pastaj gjarpërinjve ua marrin helmin, dhe prej atij helmi specialistët e mbarojnë serumin kundër kafshimit të gjarpërinjve. Një fermë e tillë e **gjarpërinjve** është **Federata Jugosllave në Beograd.**

ꕥ

Sa më shumë të na nevojitet një gjë, prej asaj gjëje duhet të ruhemi më së shumti. Për shembull: zjarri është i domosdoshëm dhe na nevojitet shumë, por nëse dëshirojmë t'ia shohim hairin, e jo sherrin, duhet të **mos i afrohemi shumë.** Poashtu edhe elektricitetit, fëmijës, bashkëshortes, shokut, mikut etj. Por disa sëmundje janë të shërueshme, e disa jo, siç janë për shembull – KANCERI, SIDA etj. , ndërsa disa sëmundje janë lëngata që nuk të lënë as të gjallë e as të vdekur…

Edhe SHOVINISTI është prodhim i ambientit, rrethanave, shoqërore të sëmura, sepse **shovinisti është EGOIST i kombit përkatës**, i cili nuk do askënd përveç vetvetes dhe pjesëtarit të kombit të tij. Ai nuk e shikon botën me syrin objektiv, por me syrin e çoroditur, të deformuar, dhe kështu e absolutizon vlerën e popullit të cilit i takon, ashtu sikundër egoisti, i cili i absolutizon të mirat e vetvetes, është i uritur – lakmitar, ai kurrë nuk e sakrifikon interesin personal për hir të interesit shoqëror, për hir të interesit njerëzor. E kundërta e shovinistit është **NACIONALISTI**, ai i cili e do kombin e vet, por nuk e urren kombin tjetër, dhe është **INTERNACIONALIST**. Kjo do të thotë se nuk mund të jesh internacionalist pa qenë PATRIOT i atdheut tënd, por nga ana tjetër nuk mund të jesh patriot i vërtetë i atdheut e i popullit tënd pa qenë njëkohësisht internacionalist...Liridashësit e vërtetë luftojnë gjithashtu kundër **KOZMOPOLITIZMIT**, që është formë e nacionalizmit borgjez, sepse mohon atdheun dhe

çdo vlerë KOMBËTARE, predikon NIHILIZMIN kombëtar, dhe me këtë armë **ideologjike** borgjezia e madhe imperialiste përpiqet t'ua shuaj ndjenjat kombëtare, patriotike dhe luftën e tyre **ÇLIRIMTARE**...Karl Marksi thoshte se:

-NUK MUND TË JETË I LIRË POPULLI I ATIJ KOMBI QË SHTYP KOMBET E TJERA..."

(Shih-K. Marks-**Mbi çështjen irlandeze**).

ꕥ

Po kur mund të themi se e duam vetveten?

Vetveten e duam atëherë kur e duam tjetrin, kur tjetrin e duam për hir të vetvetes, dhe përmes vetvetes, sepse ai që nuk e do kombin e vet nuk mund ta dojë as kombin tjetër, dhe një njeri i tillë është – **SHOVINIST**. Edhe PATRIOTIZMI, edhe SHOVINIZMI janë buzë VARRIT, afër të kundërtës, afër VDEKJES, në sprovën e përditshme. Edhe drejtësia është shumë afër PADREJTËSISË, por nuk është identike me të, prandaj patriotizmi dhe shovinizmi janë nocione të kundërta, d.m.th. dy të kundërta të një realiteti, siç janë edhe **EGOIZMI dhe ALTRUIZMI.** Dhe nëse nuk i kuptojmë këto gjëra, ne mbarojmë, ndërsa populli thotë: **qysh e ka lypë, ashtu e ka gjetur!...**

Ne që 2000 vjet po transformohemi në popuj tjerë, dhe afirmimi ynë ka ardhur përmes kombeve tjera. Jemi rrudhur deri në 28.750 KM katrorë, një rrudhje totale, sepse dihet mirëfilli se as gjyshi, as stërgjyshi ynë nuk e kanë kultivuar ndjenjën e **IDENTITETIT kombëtar** dhe afirmimin e kauzës së shenjtë të **shqiptarisë**. Ne jemi dëshmuar si ANALFABETË POLITIKË… Prandaj ne e kemi një pikënisje të gabuar, **PIKËNISJE NEGATIVE** (si mohues të kombit), ashtu siç është edhe më negative urrejtja ndaj kombit tjetër. Por është interesant se ne gjithmonë e abstragojmë momentin **KLASOR,** sepse

KOMBI mund të ketë kuptim vetëm brenda raportit të KLASAVE, meqë në çdo komb kemi **DY KOMBE – kombin shtypës dhe kombin e shtypur,** kombin shfrytëzues dhe kombin e shfrytëzuar, siç theksohet në MANIFESTIN E PARTISË KOMUNISTE. Një devijim sado i vogël në pikënisje, bëhet i madh në vazhdim, pra miza bëhet buall, sidomos kur thuhet – VETËM POPULLI IM, VETËM KLASA IME BORGJEZE, pra janë synime antinjerëzore. Nga kjo pikëpamje, sa më shumë t'i kuptojmë faktorët objektivë dhe subjektivë, aq më pak do të dëshpërohemi, sepse duke u dëshpëruar nuk mund të ecim përpara drejt lirisë së vërtetë.

Mungesa e gjatë e traditës së shkollimit mbi baza kombëtare po bën që të kemi rregulla, në vend të rasteve, sepse na ka munguar zhvillimi permanent për ta **njohur vetveten,** historinë, të kaluarën, traditën, dhe mu për këtë **neve sot duhet t'na vijë turp prej vetvetes, kur nuk e njohim vetveten...** Nëse nuk e njeh historinë e Skënderbeut, Luigj Gurakuqit, Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Fan Nolit, Hasan Tahsinit, Atë Shtjefën Gjeçovit, Atë Ndre Mjedës etj. , dhe turpërohesh në vend që të krenohesh me virtytet e kombit tënd, për të cilin duhet ta sakrifikosh edhe jetën, gjithë kjo është pasojë e mungesës së vazhdimësisë **në edukimin kombëtar**.

Ata të cilët u kthyen nga Turqia, sepse nuk kanë nënshtetësi jugosllave, ata më shumë na kanë bërë sherr se hair. Kemi dy lloj shovinistësh: **SHOVINISTI SPONTAN dhe SHOVINISTI I ORGANIZUAR** – shih: Trenat e shovinizmit, udhëtimet serbomalazeze të vitit 1986, të organizuara për në Beograd nga të gjitha trevat e Jugosllavisë, dhe gjithë këtyre pelegrinëve u kthenin dreka të majme, dhe kryetari Lazar Mojsovi u thoshte këtyre pjesëmarrësve: PËR ÇDO GJË QË JU DO TË THONI, NUK DO T'JU MUNGOJË ASNJË QIME FLOKU…

Lenini i revoltuar pse themeluesit e marksizmit nuk e shihnin mundësinë e shpërthimit të revolucionit rus, e shkroi veprën – SOCIALDEMOKRACIA GJERMANE,

dhe potencoi se realiteti mund të dëshmojë se revolucioni socialist mund të shpërthejë edhe në një vend të prapambetur siç është Rusia. Pra revolucioni

-së pari duhet të SHPËRTHEJË,

-së dyti, TË FITOJË, dhe

- së treti – TË RRITET – ZHVILLOHET.

Në Francë revolucioni shpërtheu dhe fitoi, por nuk arriti të jetojë më shumë se 72 ditë (**KOMUNA E PARISIT** më 1870), ndërsa në Rusi, shpërtheu, fitoi dhe vazhdoi rritën deri në vitin 1953, kur vdiq **Stalini**, sepse më vonë u bë RESTAURIMI i rendit borgjez, prapavajtja, sepse forcat prodhuese ishin të dobëta, sepse Rusia cariste më parë shiste grurë, edhe pse toka punohej me mjete primitive, ndërsa sot BRSS-ja ka numrin më të madh në botë të traktorëve, kombajnave etj., por nga ana tjetër brenda një viti blen 60 milion tonelata grurë! Dhe kështu revolucioni u degjenerua dhe nuk mund të zhvillohej, sepse **KLASA PUNËTORE** i lëshoi frytet e revolucionit nga dora, e lëshoi **armën** e saj e cila ia garantonte FITOREN – **DIKTATURËN E PROLETARIATIT.**

ꕥ

Engelsi ia dorëzoi dokumentacionin e Marksit Kauckit dhe Bërnshtajnit, e këta të dy, nxënës të Engelsit, si asistentë, vazhduan punën e tyre…

ꕥ

Po pse atëherë Lenini e shkroi veprën – REVOLUCIONI SOCIALIST DHE RENEGATI KAUTSKI... ?

Sepse ata nuk pranuan t'i bashkohen REVOLUCIONIT RUS, sepse mendonin se ai revolucion kurrë nuk do të mund të triumfonte, ashtu siç e paramendonte Marksi dhe Engelsi, sepse Rusia ishte vendi më i prapambetur dhe fitoren e revolucionit e shihnin si – halucinacion…

Edhe më 1789 reaksioni feudal francez u ngrit kundër BORGJEZISË, ndërsa borgjezia ia dorëzoi pushtetin JAKOBINËVE, dhe DY VJET U DERDH GJAK, feudalizmi u mposht, kapitulloi, dhe REVOLUCIONI BORGJEZ FRANCEZ fitoi, por borgjezia ia mori pushtetin nga dora, sepse ishin më të shkolluar, dhe fitorja i takoi Luigj Bonapartit…

LIGJËRIME, 14 nëntor 1987:

FEJA është pjesa irracionale, kategori integrale e natyrës njerëzore, ajo që ekziston jashtë nesh. Për shembull kur thuhet: Moisiu foli me ZOTIN, Muhamedi foli me ZOTIN, kjo është METAFORË, përdorim i një fjale ose shprehjeje me kuptim figurativ, në bazë të krahasimit. Metaforë – nga gjuha greke do të thotë – BARTJE.

ATEISTAT E FORTË nuk janë kundër **ZOTIT**, por kundër **religjionit** i cili është vënë në shërbim të shtetit DESPOTIK. Marksi kishte të drejtë kur thoshte se: **PREMISA E ÇDO KRITIKE DUHET TË NISET NGA KRITIKA E RELIGJIONIT**, ose:

FEJA ËSHTË OPIUM PËR POPULLIN(shkruante K.Marksi më 1844), dhe se ajo s'është gjë tjetër veçse-

"PASQYRIM FANTASTIK NË KOKAT E NJERËZVE I ATYRE FORCAVE TË JASHTME, TË CILAT SUNDOJNË MBI TA NË JETËN E TYRE TË PËRDITSHME,-PASQYRIM, NË TË CILIN FORCAT TOKËSORE MARRIN FORMËN E FORCAVE JOTOKËSORE"...ose edhe më qartë:

"FEJA është psherëtima e krijesës së shtypur, **ZEMRA E NJË BOTE PA ZEMËR**, ashtu sikurse ajo është SHPIRT i një sistemi pa shpirt..."

Por dikush mund t'na thotë se kjo është çështje e imja personale se me gishtin tim, me këmbën time, mund të bëj çfarë të dua. Por nuk duhet harruar se edhe ai gisht mund të bëjë çfarë të dojë me ty. Fasulja duhet kultivuar në

arealin e saj më të përshtatshëm. Sepse nëse e nxjerrim **SYRIN** nga pjesa integrale e trupit, atëherë ai është i vdekur, nuk sheh asgjë, por edhe nëse ia djegim një damar, nerv, syri duket i tëri, por me pa nuk sheh, dhe në mënyrë dialektike duhet kuptuar raportet NATYRË – NJERI – KOZMOS, pra në pikëpamje racionale, shkencore, e jo në pikëpamje irracionale – METAFIZIKE. **Rrënjët e syrit, veshit, mendjes etj**. janë në plëndësin tonë, **në lukthin** tonë, në organin e tretjes.

ꕥ

A mund të pohojmë se është çrrënjosur RELIGJIONI në Shqipëri?

Religjioni në Shqipëri vetëm është hequr **administrativisht**, sepse gjerat të cilat janë kultivuar me shekuj nuk mund të çrrënjosen brenda një gjenerate. Prandaj ky proces i çrrënjosjes duhet të vazhdojë brenda disa gjeneratave dhe vetëm atëherë mund të themi se është pastruar gjaku i popullit nga **HELMI RELIGJIOZ**. Parafytyrojeni për shembull se si do ta pikturonte figurën e zotit një kalë po të ishte piktor? Pa asnjë dyshim se kali do ta pikturonte perëndeshën pelë! Por asgjë nuk duhet absolutizuar, e sidomos gjerat e sferës racionale, sepse mund të rrëshqasim shumë lehtë, e dihet se **fusha më e rrëshqitshme është religjioni.** Për shembull: IRRACIONALJA plus RACIONALJA janë barazi me MAGJEN PLOT, sepse sikur t'i dinim të gjitha, atëherë mund ta përfytyronim veten si **perëndi**. Të moçmit latinë thoshin: **IGNORAMUS ET IGNORAMIBUS (Kurrë nuk kemi ditur dhe kurrë nuk kemi për t'i ditur të gjitha).** Edhe balena sikur t'i hante të gjithë peshqit, do të zhdukej, do të ngordhte. Pra nuk mjafton që një gjë vetëm ta MBJELLIM, sepse kjo do të ishte vetëm LUTJE PËR PRODHIM, por duhet edhe ta drejtojmë dhe ta DETYROJMË PËR PRODHIM!

ꕥ

Po mirë, lumë profesori, mua më thotë mendja se s'ka gjë më të shenjtë se sa të mbjellësh dritën e diturisë, dhe ju jeni ndër të rrallët që keni dhënë tërë jetën maksimumin në arsimimin e mbi 40 gjeneratave të cilat mburren me punën tuaj dhe energjinë që e keni shkrirë për ne?

Jo, jo, kurrë mos e thuaj këtë lavdërim për mua, sepse popullit i kemi aq shumë borxh sa edhe disa jetë po t'i kishim, dhe çdo ditë të sakrifikoheshim, sërish kemi bërë shumë pak për të, në krahasim me mundësitë që kemi pasur për të bërë për të edhe më shumë, dhe më mirë. Kurrë nuk duhet të themi – çfarë bëri atdheu për mua, por – **ÇFARË BËRA UNË PËR ATDHEUN, për popullin, PËR NJERËZIMIN!** (Profesori ishte aq modest sa kurrë nuk lejonte ta lavdëronim për punën kolosale që e bëri për popullin, i cili ia skaliti përmendoren në zemrën e tij të madhe! - BK)

Energjia është imanencë e materies. Asnjë besimtar nuk ka llogari ta pranojë Kuranin ose Biblën si METAFORË, dhe kjo edhe sot po na kushton shumë. P.sh. vajzën nuk ia japim atij personi i cili nuk i përket fesë tonë, edhe sikur ai person t'i kishte 500 lopë e buallica…

Një gjë duhet ta dini: **SHTETI I SHKOLLON NJERËZIT E POSAÇËM** vetëm për ta gënjyer popullin – për të vjedhur dokumente, për të falsifikuar historinë (siç është Akademia Serbe e Shkencave) etj.

Merreni me mend, sikur ne ta qëronim tërësisht mollën, deri te bërthama, atëherë nuk do të kishim çfarë të hamë, do ngelnim pa mollën. Përmes zbulimeve shkencore në epokën e atomit ne çdo ditë e më shumë po e pushtojmë natyrën dhe fshehtësitë e saj, dhe duhet pranuar gabimet e deridjeshme, ashtu siç ishte gabim teoria GJEOCENTRIKE e cila u zëvendësua me teorinë HELIOCENTRIKE të Nikolla Kopernikut. Pra aq sa kemi

ditur, aq edhe kemi mundur… Prandaj është anakronike që në ditët e sotme të zhytemi në terrin e MESJETËS, dhe të themi se ZOTI e ndërtoi planetin tonë – Tokën, **për shtatë ditë?!** Aristoteli thoshte se MATERIA nuk ekziston si realitet, por vetëm energjia e cila shprehet përmes reflektimeve, FORMËS, pamjes së jashtme. Por edhe forma është pjesë e materies, por jo tërë materia.

ꕥ

Kush mund ta mësojë njeriun që ai të mund ta njohë vetveten?

Mund ta mësojë shkolla e vërtetë socialiste… Ai që di, ai duhet të prijë, por nëse i mungon GUXIMI, atëherë edhe dija humb, dhe me këtë dëshmohet se ai person ende nuk e njeh sa duhet vetveten...

Ç'është më e vështirë për një dijetar?

Nuk ka asgjë më të vështirë për një dijetar se sa **kur gjendet në mesin e budallenjve**. Sokrati i madh – i dijshmi, në mesin e budallenjve – **është i çmendur!**

Të marrim si shembull popullin autokton të Indisë – Dravidët, të cilët me dhjetëra herë lejuan të nënshtrohen dhe të jetojnë nën zgjedhën e robërisë së huaj, ndërsa pushtuesit e fundit të tyre ishin anglezët, dhe atje edhe qyqari më i dobët anglez kishte më shumë pushtet se një MAHARAXHË ose RAXHA (udhëheqësit e vendit)… Por edhe me ne shqiptarët pothuaj është e njëjta gjë, sepse më shumë vlerë ka një kolonizator qyqar serbo-malazez se sa Fadil Hoxha si kryetar i Federatës…

ꕥ

Fjala e parë e religjionit është – **RRENA.** Për shembull: nëse dikush nuk ia lan tjetrit borxhin, atëherë thuhet se ai person do ta marrë mallkimin, do ta vrasë ZOTI (një rrenë

shumë e madhe…). Ne jemi pjesë e natyrës, kozmosit (perëndisë)… Pra ne krijojmë, dhe krijohemi nga kozmosi. Për shembull: fëmija krijohet nga NËNA, por nga ana tjetër edhe fëmija e krijon NËNËN (e cila edhe pse ishte një fëmijë, ta zëmë, 15-vjeçe, u bë nënë që ditën kur u martua dhe lindi fëmijën e parë…)

ꕥ

Fëmijët sot janë të bombarduar me lloj-lloj programesh seksi. Flitet vetëm për qenin e butë, në vend që të flitet edhe më shumë për QENIN E ÇARTUR, për dëmin e programeve të ndotura, antidemokratike, antinjerëzore, sepse po të te kafshojë qeni i çartur, më nuk ka jetë për ty, njësoj sikur të te kafshojë virusi i SIDËS.

Shërbimi sekret amerikan ka shkuar aq larg sa ta DRESOJË edhe BALENËN për t'i zbuluar fushat e minuara në Gjirin Persik.

Parimet e Kuranit janë përdorur si emblemë, dhe pak nga pak, është dashur të kalojnë vite derisa janë hartuar ato SURE dhe AJETE kuranore. *Vetëm me shkencën nuk do të mund të jetonim as 24 orë. Njohuritë shkencore janë të përcipta, parciale, sepse kurrë nuk përfundojnë…* Për shembull thuhet: Zoti i krijoi yjet që t'i vrasë shpirtrat e këqij. Pra kjo është një bartje metaforike nga Bibla dhe Kurani se ekziston perëndia dhe anti-perëndia, ora e mirë dhe ora e ligë, minusi dhe plusi, e mira dhe e keqja, shkaku dhe pasoja. Dialektika: pse është ora e ligë? Që ta kuptojmë orën e mirë! Qëllimi edukativ – KURRË T'MOS E BËJMË ATË QË NUK DUHET BËRË!

ꕥ

Ç'kuptim ka MEMORANDUMI i Akademisë së Shkencave të Serbisë?

ꕥ

Memorandumi është ULTIMATUM i reaksionit më të skajshëm serb. Kriza që këtu e shtatë vite më parë ka marrë përmasa shqetësuese, sepse Federata është në grindje, është në kundërshtim me udhëheqjen shoviniste të Serbisë. Vojvodina nuk po lejon ta ngucë askush. Ata po mbahen ashtu si sllovenët dhe kroatët. Serbët në Serbi, Bosnjë dhe Kosovë janë vegla të reaksionit serbomadh, por edhe këtu pjesa më e madhe nuk po përzihen, sepse e dinë se këto janë çështje KLASORE, ekonomike.

ꕥ

Këtu te ne përçarja po çon ujë në mullirin e reaksionit, ndërsa në Shqipëri çdo ditë po bëhet "infuzioni" me gjak të ri, që sa më parë të çrrënjosen shprehitë e mbrapshta, përçarja, dhe në vend të tyre të kultivohen **BOTËKUPTIMET** e reja: dashuria për punën, ndjenja e kolektivitetit, shpirti i sakrificës në bazë të parimit – **NJË PËR TË GJITHË – TË GJITHË PËR NJË!**

ꕥ

Pse V. Çubrilloviçi kërkoi të merren masa ndaj atyre 130 akademikëve?

ꕥ

Sepse ishte i vetëdijshëm se janë duke u kompromet uar shumë keq. Por neve duhet të na vijë keq prej vetvetes, sepse kur merr guxim për mbrapsht një **Halit Tërnavc** e del publikisht para opinionit me gënjeshtra, atëherë sa **akademikë shqiptarë të Kosovës duhet t'i kundërvihen** publikisht dhe t'i dalin zot të VËRTETËS shkencore?

Pse nuk bëjnë zë dhe nuk lajmërohen ata akademikë?

Sepse janë frikacakë, janë mashë, janë vegla, dhe frikohen si pacientët prej inxheksioneve ose operacionit, sepse do t'i **humbin privilegjet...**

ꕥ

DRYNI – DRINI – DRINA – DINARIKE, janë fjalë që përdoren më së shumti. Jovan Cvijiçi, aq sa ishte i fortë në fushën e gjeologjisë dhe gjeomorfologjisë, po aq ishte i dobët në fushën e etnologjisë, politikës, dhe ishte një shovinist i përbetuar. Mirëpo Cvijiqi të paktën e dinte prejardhjen e shqiptarëve, ndërsa këta akademikët e sotëm nuk po kanë hesap ta dinë, dhe haptas po thonë se nëse e pranojmë teorinë e prejardhjes së shqiptarëve prej ILIRËVE, me këto fakte serbët do të humbnin shumë. Pra **së pari duhet të jesh NJERI dhe pastaj shkencëtar**…

Më 1945 tërë komuna e Prizrenit (atëherë Prizreni ishte kryeqyteti i Kosovës) i kishte 70 mësues e arsimtarë, ndërsa sot vetëm fshati Piranë i ka më se 50 mësues e arsimtarë.

ꕥ

Albert Ajnshtajnit më 1948 i ofruan të bëhet kryetar i shtetit të ri – Izraelit, por ky shkencëtar nuk pranoi të bëhet mashë, instrument, me të cilin do të manipulonin. Pra ai nuk pranoi të bëhej PYKË në duart e superfuqisë për të luajtur me fatin e popujve arabë.

Holandezët e pushtuan vendin e 3000 ujdhesave, INDONEZINË, në fillim të shekullit XVIII, dhe e mbajtën këtë koloni 300 vjet pa bërë kurrfarë lufte, deri në vitin 1948. **Ndërsa anglezët që 600 vjet po i vringëllojnë shpatat në Alster (Irlandën e Veriut)**…

ꕥ

Edhe Franc Shetinci po thotë: nëse Kosovës nuk i jepet e drejta e barazisë kombëtare e njerëzore, atëherë ajo do të

bëhet si BASKIJA ose Alsteri… Me këtë po dëshmohet se reaksioni ende është shumë i fortë dhe po arrin ta ngadalësojë rrjedhën e ecjes përpara, por nuk është ende aq i fortë sa ta kthejë ecjen MBRAPA – prapavajtje.

ꕥ

Po cilat janë interesat jashtë Jugosllavisë në këtë kontest?

ꕥ

Këtu po polarizohen dy palë interesash:

1. Të shkatërrohet Jugosllavia, dhe
2. **Të mos shkatërrohet Jugosllavia**.

Shqipëria i takon grupit të dytë, dhe njëherë përnjëherë nuk ka leverdi të shkatërrohet Jugosllavia, ndërsa blloku i parë është tejet i interesuar për ta ndarë dhe shkatërruar Jugosllavinë, po ashtu dhe Shqipërinë. Pra që nga viti 1962 Shqipëria është në grupin e atyre vendeve që nuk e dëshirojnë shkatërrimin e Jugosllavisë, dhe për 26 vjet me radhë po e ruan integritetin e Jugosllavisë.

ꕥ

Të përkujtojmë se çfarë rëndësie ka në situata krize FAKTORI I BRENDSHËM; më 1925 u vranë **Bajram Curri, Luigj Gurakuqi**, e më vonë edhe **Hasan Prishtina**, dhe shumë patriotë tjerë, dhe populli ishte shumë i përçarë sa kishte mjaftuar vetëm një batalion i formuar nga mercenarët bjellogardistë rusë të gjeneral Vrangelit, me nja 600 veta, dhe e sollën Ahmet Zogun nga Beogradi në Tiranë. E tillë është situata sot brenda në Kosovë…

Dhe si u ruajt UNITETI në Shqipëri? Vetëm me ndihmën e **hunit dhe konopit**, vetëm me **diktaturën e proletariatit**, dhe ndryshe as që do kishin mundur. Për shembull analfabeti Koçi Xoxe nuk e ka ditur se po e shet Shqipërinë te jugosllavët, ndërsa Esat Toptani i ka ngrënë

lirat, pra ai e ka ditë. Por këto pazarllëqe janë bërë pa u çliruar Shqipëria, pra u bënë hesapet pa hanxhiun. Pra Jugosllavia e ka menduar Shqipërinë si gjahun, si "lepurin në vegsh", **si harrën,** sepse Kosovën me vise i kishte brenda Federatës, sepse edhe në Teheran dhe në Jaltë më 1945 u miratua integriteti territorial i shteteve, pra **paprekshmëria e kufijve të paraluftës.** Më 1948 BRSS mendonte që Shqipërinë t'ia jepte Jugosllavisë, duke e prishur marrëveshjen e Jaltës, por kjo gjë nuk u arrit… Konferenca e **Helsinkit më 1975** është edhe një vulosje, është edhe një vërtetim dhe riaprovim i Jaltës. Fatmirësisht Shqipëria u dëshmua e fortë, konsekuente, parimore, dhe nuk e nënshkroi aktin e **KAPITULLIMIT** në Helsinki, i cili ishte ide e Brezhnjevit, dhe nuk pranoi status-kuonë e kufijve ekzistues në Evropë, sepse mbi 50% e tokave shqiptare janë të okupuara nga jugosllavët (Kosova me vise) dhe grekët – Çamëria (**Enver Hoxha** ishte një largpamës i jashtëzakonshëm dhe strateg i madh dhe kurrsesi nuk pranoi të shkonte në Helsinki për të bërë pazarllëqe në kurriz të popullit shqiptar të copëtuar në gjashtë pjesë. Ta marrim si shembull Berlinin, i cili në kohën e Rajhut të tretë ishte në zemër të Gjermanisë, e sot është i ndarë në dy pjesë dhe për 27 kilometra larg Gjermanisë Perëndimore? Pra superfuqive u konvenojnë ndarjet, përçarjet, konfliktet…

Ku janë rrënjët e POLITIKËS? Ato janë në stomak, në zorrë e plëndës, askush nuk hidhërohet me bukë… Edhe Shqipëria sot bën tregti me 119 vende të botës, por edhe me Jugosllavinë…

ꕥ

Po pse atëherë po bëhet gjithë kjo propagandë e ethshme kundër Shqipërisë socialiste?

ꕥ

Sepse reaksionin e tërbuar serb nuk po e lënë rehat **ëndrrat e shekullit XIV të Shën Savës e Car Dushanit,** sepse edhe budallai më i pacipë e din se çfarë kuptimi kanë fjalët propagandistike nëpër mitingje – ZHIVOT DAMO – KOSOVO NE DAMO (Jetën e japim – Kosovën nuk e japim!).

Dhe gjithë këtyre marrëzive po u ndihmon përçarja jonë, primitivizmi ynë, kur dihet se mbi 10.000 vetë në Kosovë i kemi **në hasmëri në mes vete**… dhe shqiptari primitiv ngatërrohet edhe për një pulë, edhe për një viç, edhe për një ngastër tokë, dhe vetëm për INAT nuk pajtohet me vëllanë e tij të gjakut… Ne duhet të punojmë shumë në këtë drejtim, sepse vetëm PUNA ËSHTË ÇELËSI I SUKSESIT!

Në tërë Indinë i kemi mbi 3000 ZOTRA, idhuj, dhe nuk e kanë vetëm një ZOT, siç e kanë p.sh. brahmanët, të cilët e konsiderojnë LOPËN – ZOT, dhe në flamurin e shtetit UTAR PRADESH është simboli i LOPËS!

Naim Frashri vdiq si shqiptar – shit, por ai para se të ishte shit, ishte shqiptar, dhe kurrë nuk e ka ngatërrua fenë me shqiptarizëm, sepse e dinte mirë se çështja e **SHQIPTARIZMIT** është çështje e **EKZISTENCËS FIZIKE**, sepse secili pushtues që na ka pushtuar e ka përdorur FENË SI INSTRUMENT, për t'na shfarosur. Ky realitet bëri që ne edhe në shekullin XX të jemi në këtë gjendje katastrofe, në **NARKOZË RELIGJIOZE, opium,** në gjumin kolektiv, pra pa shtetin-komb shqiptar.

ꕥ

A mund ta paramendoni se ku do ishim ne sot sikur t'mos ishte formuar më 28 Nëntor 1912 edhe kjo Shqipëri e cunguar tragjikisht?

Po, me siguri se do ishim ashtu siç është BASKIA sot, ose ALSTERI me Belfastin, ku çdo ditë derdhet gjaku. Pra ne duhet të mendojmë esëll, të zgjuar, e jo jerm, në ëndërr,

me din e me iman, dhe është njësoi si të **rruash vezë**, si të **flasësh për gjera të tilla**, për njerëzit e **infektuar me religjion.** Me këtë ne po i tregojmë botës se ende nuk po na punon logjika, sepse gjerat po i marrim kuturu, toptan, qorras, pa ia hapur grykën thesit, pa dyshuar fare në pazarin e politikës reaksionare ndaj nesh… Pra po veprojnë emocionet, ndjenjat, e jo arsyeja, logjika, dhe kjo që ne edhe sot e kësaj dite po merremi kaq shumë me problematikën religjioze është humbje e kohës, anormale… **Propaganda fetare** në ceremonitë mortore, në dasma, në syneti, dëshmojnë se hoxha ende po e luan rolin e POLICIT, polic pa uniformë – **polic i odës**… E duhet **të na vijë turp nga këto anakronizma**, sepse rilindësi më i shquar, Hoxhë Hasan Tahsini, para 100 vjetësh kishte pikëpamje shkencore materialiste ndaj dukurive të natyrës dhe shoqërisë, dhe kishte arritur të zgjidhej në pozitën e rektorit të Universitetit të parë në Perandorinë turke, në Stamboll, por meqë kishte pikëpamje ateiste pushteti feudal obskurantist e burgosi dhe e largoi nga detyra (Hasan Tahsini studentëve të tij u kishte dhënë përgjigje praktike kur ata e kishin pyetur se ku është dallimi në mes **SHPIRTIT dhe TRUPIT: kishte marrë një zog dhe e kishte futur në një kavanoz të mbyllur hermetikisht, dhe zogu rrojti vetëm për aq sa kishte ajër në kavanoz, dhe pastaj kur iu harxhua oksigjeni ngordhi. Dijetari Hasan Tahsini u kthye kah studentët e tij dhe u thotë: Doli gjë nga kavanozi? E kuptuat tani se cili është dallimi mes trupit dhe shpirtit?). Por këtë në mënyrë poetike e kishte shpjeguar edhe poeti i madh Ali Asllani me këto fjalë:**

Dynjallëk heu tungjatjeta,
Bëre botën qesharak,
Sado që të jetë i lartë truri,
I ka rrënjët në stomak...

ꕥ

V. I. Lenin thoshte: POLITIKA është shprehja më e koncentruar e EKONOMISË, dhe dihet se **e tillë çfarë është politika, të tilla janë edhe marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore**, dhe anasjelltas, sepse as politika, as e drejta, nuk mund të jenë më të larta se sa vetë rendi ekonomiko-shoqëror…

Nuk ka poezi shkencore, as pikturë shkencore, as art dramatik shkencor, sepse momenti **irracional futet në çdo art.** Por duhet ta dimë se edhe në art, edhe në religjion, por edhe në çdo gjë tjetër ka politikë. Dhe ata të cilët merren me të, me politikë, hanë bukë pa mundim, pa djersë, pa shat… Por ndodh shpesh të dëgjojmë këso broçkullash:

UNË NUK DUA TË MERREM ME POLITIKË! Jam APOLITIK! Por nuk e dinë të gjorët se apolitika e jopolitika shkojnë në të mirë të POLITIKËS, sepse e vërteta nuk mund të qëndrojë pa qëllimin e politikës, dhe jo rrallë këta të vetëquajtur APOLITIKË, ua kanë bërë gjëmën dhe i kanë vrarë mizorisht bijtë më të devotshëm të Atdheut si **Fazli Greiçevcin, Rexhep Balën, Nuhi Berishën, Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën** e shumë të tjerë… Pra politika e regjimit diktatorial kolonialist ka hesap që të gjithë ne të jemi të padijshëm, ose të disponojmë me dije të kufizuara, me dije minimale, e tillë siç po jepet sot në shkollat tona… Ndërkaq në vendin ku sundon pushteti popullor bëhet luftë këmbëngulëse dhe e pakompromis e të gjithëve që të zhduket analfabetizmi, terri i paditurisë, qoftë edhe te një anëtar i vetëm…

Punë bëjnë edhe kafshët, edhe bleta, buburreci, por organizimi i tyre është INSTINKTIV, i pavetëdijshëm. Pra është normale që edhe në politikë, por edhe në çdo punë tjetër, të jemi edhe SUBJEKT, edhe OBJEKT, edhe AUTOR edhe AKTOR, ndërsa te ne pjesa dërrmuese janë OBJEKTE, ashtu siç është kopeja e deleve për kasapin, ose si ata që thonë – unë nuk përzihem në politikën e shtetit… Por personi që e ka unin e vet, e ndien veten si SUBJEKT, ai e çmon dikë dhe meriton ta çmojnë në atë masë edhe të tjerët, pra nuk lejon ta marrin nëpër këmbë,

ta përbuzin dhe ta nënçmojnë, dhe të tillët janë të denjë për çdo respekt…

Duke e mashtruar një person, mashtruesi e konsideron atë person të pamend, dhe përmes padrejtësisë ai e realizon "drejtësinë" e vet prej grabitqari të tërbuar. Por nuk duhet harruar se kur grumbullohen shumë të zeza, shumë padrejtësi, një ditë ato kthehen në të kundërtën e tyre – në **drejtësi,** dhe kjo mund të zbërthehet edhe matematikisht: 100 të zeza herë 100 të ZEZA janë baras me 1000 të BARDHA (matematikë logjike). Arsyeja jonë nuk e kupton të paarsyeshmen. Edhe rrënjën katrore të minus katërshit (- 4), nuk e kuptojmë, sepse shenja minus (-) është simbol irracional. Kështu qëndron puna edhe me religjionin, sepse **shkenca merret vetëm me logjikën, me arsyen, me racionalen, me dialektikën,** ndërsa FEJA merret vetëm me numra IRRACIONALË (rrënja katrore e minus njëshit!), me gjëra jo-konkrete, jo reale, të paqena, dhe këtu e ka fjalën METAFIZIKA, dhe jo DIALEKTIKA… Nga kjo del se FEJA dhe SHKENCA janë dy realitete ANTAGONISTE, kundërthënëse, të papajtueshme… Dhe ja paradoksi:

Derisa në Shqipëri prej çlirimit e këtej nuk është ndërtuar asnjë kishë as xhami, nga ana tjetër këtu ndër ne në **Kosovën e robëruar** nga fashistët jugosllavë, si në fshatra, ashtu edhe në qytete po ngrihen dhjetëra e qindra kisha e xhamia, dhe atë që nuk do të arrinte ta bënte policia, po e bëjnë klerikët tanë…

ꕥ

Po pse po bëhet gjithë kjo fushatë e tërbuar ndaj mësuesve dhe profesorëve për t'i përjashtuar nga procesi mësimor?

Asnjë hoxhë, prift apo klerik tjetër nuk është larguar nga detyra dhe nuk është denoncuar si armik, sepse shteti ka nevojë më shumë se për **armë** t'i mbajë ata që

KULTIVOJNË GËNJESHTRA, dhe jo ata të cilët e edukojnë brezin dhe **KULTIVOJNË TË VËRTETAT**. Edhe njeriu më i pamend e më i verbër mund ta kuptojë se këta janë MAJA (THARMI – FARA) e politikës, me qëllimin më perfid që hendeku i dallimeve në relacionin SHQIPËRI – KOSOVË të rritet edhe më shumë, dhe kështu po arrihet që largësia gjeografike Prizren-Vermicë (kufiri me Shqipëri) është 17 km, por **largësia ideologjike (MURI I BERLINIT NË KOKAT TONA)** është 17.000 km. Pra kemi të bëjmë me distancën fizike dhe distancën politike.

Që nga viti 1972 po gatuhej kjo politikë, dhe sot kjo po del haptas përmes mediumeve informative (Radiotelevizioni, gazetat etj.)...

ꕥ

Po çfarë mendoni për çështjen maqedonase në Jugosllavi?

Maqedonasit kanë një status të veçantë. Cërvenkovski në Sofje (Bullgari) tha: nëse jemi bashkuar me Federatën Jugosllave, **nuk kemi bërë kurorë!** Serbët përmes maqedonasve po i vejnë në zbatim eksperimentet ndaj shqiptarëve atje, dhe pastaj Serbia po ka pretekst për të thënë se shqiptarët në Kosovë kanë më së shumti të drejta, dhe me këtë po i kërcënohen Federatës. Por Federata Jugosllave një herë për një herë mund të dalë nga kriza vetëm nëse ia **pranon Kosovës statusin e REPUBLIKËS,** për të vazhduar me strategjinë e tyre afatgjatë të shekullit XX, që **KOSOVA ta KAPËRDIJË SHQIPËRINË?!,** dhe të **formohet republika e shtatë**.

Me këto pikëpamje del edhe **Branko Horvati** (Shih librin: Branko Horvat – Problemi Kosova, Globus 1988, Beograd). Pra elita e tyre politike janë të vetëdijshëm se pa u hequr diskriminimi ndaj shqiptarëve nuk mund të realizohen këto plane, pra pa u bërë hapi i parë nuk mund të bëhet hapi i dytë, pra BASHKIMI I SHQIPËRISË ME FEDERATËN JUGOSLLAVE (ëndrra në diell)… Për t'u

bërë realitet këto ëndrra Federatës i duhet të **investojë miliarda e miliarda** në ekonominë e Kosovës (për ta tejkaluar atë të Shqipërisë), dhe kjo është një gjë absurde, e parealizueshme edhe për faktin se ne jemi të copëtuar në **katër pjesë** brenda Federatës Jugosllave:

1.**Shqiptarët në Krahinën Autonome të Kosovës**;
2.**Shqiptarët në Republikën e Serbisë**(Presheva, Bujanovci e Medvegja);
3.**Shqiptarët në Republikën e Malit të Zi** dhe
4.**Shqiptarët në Republikën e Maqedonisë**(Ilirida).

Autonomia në letër, autonomia formale, është **GËNJESHTËR**, sepse mungon parimi i vetëvendosjes në politikën kadrovike, në legjislacion, në arsim, mjekësi, urbanizëm, tregti, polici, pra aq të drejta sa kanë kantonet e Zvicrës. Kjo gjendje e nderë të ne është gjendje okupimi, gjendje shtetrrethimi, sepse shqiptari nuk guxon t'ia blejë kolonit serbo-malazez tokën, një diskriminim ky aq flagrant sa nuk është zbatuar as në kohën e Aleksandër Karagjorgjeviqit. **Ky është racizëm i llojit më mizor**, që ia kalon aparteidit në Afrikën Jugore.

Vetëm për mbajtjen e aparatit ushtarako-policor dhe rrjetit të spiunazhit Federatës i nevojiten miliarda dollarë. E ku do t'i merrte Jugosllavia këto miliarda e zhytur në borxhe deri në fyt? Por të gjitha këto po i mundëson faktori i brendshëm, sepse shqiptarët janë shumë të përçarë, sepse po kryhet procesi i diferencimit klasor. Populli është unik kur ndërton KISHËN dhe XHAMINË, dhe procesi po shkon në drejtim të krijimit të **JUGOSHQIPTARËVE...** Edhe gjermanët po i formojnë dy sisteme të kundërta ekonomike-politike, me MURIN E BERLINIT në mes, familjet e ndara me murin e gjatë 124 kilometra, të cilin e ndërtuan për 24 orë vetëm që të thellohet edhe më shumë hendeku i ndarjes në mes të te njëjtit popull – gjermanëve. Edhe ne jemi të ndarë që nga viti 1912, por nga **1945 e deri më 1966 ne ende ishim afër për kah standardi.** Ndërkaq procesi i ndarjes u thellua që **nga viti 1966-70, sepse vërshuan kreditë amerikane dhe**

evropiane, për ndërtesa, vetura, kamp-shtëpiza etj. , pra **nisi një ndarje shpirtërore**, ndarje si ajo e Vietnamit, e Koresë, Gjermanisë. Por shembulli i heroizmit të popullit vietnamez duhet të ndiqet dhe duhet t'i frymëzojë popujt e robëruar, sepse vietnamezët e Jugut dhe të Veriut si një trup unik iu kundërvunë superfuqisë botërore – SHBA-ve, dhe pas 31 vjet lufte të pandërprerë dolën ngadhënjyes dhe sot Jugu dhe Veriu vietnamez u bënë një dhe po e ndërtojnë të njëjtin sistem dhe me gjuhën e hunit dhe konopit po mbahen të bashkuar në sistemin e barazisë sociale…

Por shtrohet pyetja: **ne ku jemi?** Ne nuk jemi askund, ne jemi ende BRUMË, sepse ne ende po e vajtojmë **FATIN INDIVIDUAL, po qajmë për një viç, për një dele, për një copë tokë, dhe po i themi djalit e vajzës** të kenë kujdes e të mos përzihen në politikë, **të mos marrin pjesë në protesta e demonstrata**. Pra me këtë nivel të vetëdijes kombëtare nuk arrihet LIRIA, e cila i ka rrënjët në GJAK, ndërsa Serbia nuk po pajtohet t'i humb as ËNDRRAT e shekullit XIV të kohës së Perandorisë së Car Dushanit, dhe është e pamundur për t'i ndaluar të vajtojnë për të ZEZËN E VETVETES, për mesjetën, për Shën Savën… Ata po thonë se Serbia më 1912 nuk ia ka okupuar kujt asnjë pëllëmbë tokë, por i ka **"ÇLIRUE"** trojet e veta të kohës së Car Dushanit?! Me këto insistime ata po thirren në të drejtën HISTORIKE, dhe me qëllim e harrojnë faktin se sllavët e jugut u ngulitën në Ballkan aty kah shekulli VII, në trojet autoktone të ILIRIKUT (i cili shtrihej deri në lumin Ulmë dhe qytetin ULM të Gjermanisë, deri në Shvarcvald… Rusia cariste përherë fliste përmes gojës së Serbisë, dhe gjerat po vazhdojnë edhe sot me të njëjtin avaz…

Tani për tani, asnjë shqiptar që i ka dy fije mend në kokë nuk do të duhej të dëshironte **BASHKIMIN (fatal) me Shqipërinë**, sepse kjo do të ishte **vetëvrasje**, për shkak të Kosovës të varrosej edhe Shqipëria… **Vetëdijen kombëtare** e plagosën për vdekje për 700 vjet me radhë pushtuesit romakë, për 1000 vjet me radhë perandoria bizantine, dhe 500 vjet me radhë perandoria turke. Përkundër gjithë këtyre

vuajtjeve ende nuk jemi mbushur mend për t'u organizuar si një shtet unik, në nivel mbarëkombëtar…

LIGJËRIME, 17 nëntor 1987:

Sot kemi dy realitete: te ne në Kosovë favorizohet **PËRÇARJA** (divide et impera – PËRÇAJ DHE SUNDO), ndërsa në Shqipëri favorizohet **UNITETI**, qoftë ai edhe me zor, me hunin dhe konopin, për secilin që përhap ideologjinë fetare, për secilin që bën hakmarrje, vëllavrasje (dhe atje u zhduk vëllavrasja dhe hakmarrja brenda disa muajve…). Gjersa këtu te ne e bëjnë hallvën e NATËS SË MADHE, mevludin, të shtatat, në Shqipëri festohen vetëm festat shtetërore, të vetëdijshëm se vetëm komunizmi e çliron Shqipërinë. Komunisti i vërtetë kurrë nuk i harron të këqijat e armikut klasor, maskimet, servilitetin, demagogjinë, dinakërinë, dhe ai kurrë nuk frikohet nga lufta e drejtë, **por as nuk ngutet dhe nuk merr vendime pa fakte relevante**…

ꕥ

Çfarë mund t'na thoni për figurën e Josip V. Stalinit?

Meritë e Stalinit është që likuidoi 20.000.000 pansllavistë të tërbuar. Ai e vazhdoi luftën aty ku e kishte lënë V. I. Lenini, dhe e ngriti në një shkallë më të lartë çështjen e revolucionit socialist....

Intelektuali i cili nuk dëshiron të mësojë, të dijë, është shumë **i rrezikshëm**, është anormal, është rast **për klinikë**, është intelektual i rrejshëm… Nuk duhet harruar se **SHQIPËRIA ËSHTË FATI YNË**, dhe atë duhet ta ruajmë përherë si **SYTË E BALLIT**. Nëse largohemi shumë prej saj, atëherë mbaroi puna jonë. Por edhe po t'i ofrohemi shumë, me synimin për realizimin e KONFEDERATËS, është edhe më keq, sepse atëherë mbarojmë edhe ne edhe Shqipëria (Këtë e mendonte edhe Branko Horvati, në

librin e tij për Kosovën). Shqipëria askujt nuk ia ka frikën më shumë se neve, **si nëna që ia ka frikën fëmijës, se mos po ia nxjerr sytë pa dashje**, dhe në këtë mënyrë ne jemi ende VARRTARË POTENCIALË, të dyfishtë, edhe për vete, edhe për Shqipërinë. Të gjithë thonë se të gjitha fajet i ka Shqipëria, vetëm pse është e tillë, e fortë, konsekuente, parimore, dhe mu për këtë ne duhet ta ruajmë Shqipërinë si gjënë më të **SHENJTË**.

ꕥ

Te ne shumë vend, shumë kohë u kushtojmë gjërave të parëndësishme, gjërave të kota, religjionit, zotit, dhe pyesim si me e la të vdekurin, dhe nuk e dimë se si lahet beduni në shkretëtirë me rërë, ose eskimezi në Grënlandë, në kasollet e ndërtuara me akull… **Neve duhet t'na vijë turp nga Bajram Curri e Hasan Prishtina që ata ishin më të fortë ideologjikisht se sa ne sot** (Bajram Curri e quajti Leninin, **Hazreti Lenin**, sepse e dënoi traktatin e fshehtë të Rusisë cariste të nënshkruar në Londër më 15 prill 1915)…

ꕥ

LIGJËRATË, 18 nëntor 1987:

Në një dasmë në Gjakovë në të cilën ishin të pranishëm edhe disa intelektualë, një hoxhë mori fjalën dhe tha:

UNË NUK PO JU FLAS PËR POLITIKË, POR PËR SHPIRT!?

Kjo tregon se dasma dështoi, shkoi kot, u bë dasma xhenaze, sepse populli primitiv po i miratonte fjalët e hoxhës, në vend që t'i dëgjonte dhe miratonte fjalët e tre-katër mjekëve dhe profesorëve të pranishëm… **FËMIJA** ia ka borxh prindit që **t'ia ndryshojë bindjet e vjetruara**, pra nuk duhet t'ua lëmë fajin prindërve analfabetë, por fjalën duhet ta marrë ai i cili i din dhe i njeh gjërat shkencërisht, dhe kështu të dëshmohet se ka bërë shkollë, e jo

MEJTEP… Asgjë deri më sot nuk është keqpërdorë më shumë, dhe ende po keqpërdoret, se sa RELIGJIONI. Asnjë shtet nuk ka mundur të ekzistojë pa ritualet fetare, ndërsa në shtetin e mirëfilltë SOCIALIST, rituali FETAR u zëvendësua me RITUALIN KOMUNIST. Ndërkaq te ne ende po lulëzojnë ato FERRAT FETARE, siç i quante Noli, përmes të cilave populli po ia bën VARRIN VETVETES! Nuk është MËKAT i madh nëse nëna dhe babai AGJËROJNË, por është faj dhe turp nëse një nxënës ose student shkon në shkollë apo fakultet dhe agjëron?! Sepse para dite atij nxënësi apo studenti i flitet për natyrën, fenomenet natyrore mbi baza shkencore, ndërsa pas dite i flitet krejt ndryshe, mbi **bazat idealiste, metafizike, joshkencore, i flitet për ZOTIN**, për hajmalitë, për magjitë, orën e ligë etj. Në këtë mënyrë ne e kemi vënë fëmijën para mëdyshjes: t'i besojë prindit primitiv në shtëpi, apo mësuesit në shkollë? Por, ç'të themi **për ata qindra mësues e arsimtarë në shkollat tona të cilët agjërojnë, lexojnë biblën dhe kuranin, dhe kështu përhapin bindjet e tyre fetare** në mjedisin ku ata jetojnë, dhe si të tillë kryejnë misionin e **VARRTARIT TË VËRTETË**.

ꕥ

Tërë Komiteti Qendror i Serbisë, me Stamboliqin në krye, kanë marrë pjesë në kremtimin e 700-vjetorit të kishës së Studenicës, dhe kjo neve do të na kushtojë shumë shtrenjtë, sepse FEJA është ARTILERI E RËNDË NË DUART E RAKSIONIT, dhe shteti investon miliona për bllokada të tilla **mendore.** Kjo është fatale, vetë pengimi i ardhmërisë, rrezik i cili na shpie kah shpartallimi. Ne ende nuk jemi në nivelin që e kërkon e mira e kombit. Me fundamentalizmin islamik ka marrë hov ringjallja e fesë islame, (Sunitë dhe Shiitë). Shoqata e Vëllezërve Myslimanë u formua në vitin 1924 në Egjipt e Iran, qëllimi i të cilës ishte lufta kundër IMPERIALIZMIT, ndërsa sot, si në Kosovë ashtu edhe në

Bosnjë, nuk punohet në atë drejtim, por përkundrazi, për të qenë sa më besnikë ndaj pushtetit ekzistues tiranik jugosllav. Pikërisht në këto shtatë vitet e fundit këtu te ne ka marrë hov psikologjia religjioze. Me qindra bursa po u ndahen sot atyre nxënësve të cilët pas kryerjes së Medresesë Alaudin në Prishtinë i vazhdojnë studimet e larta fetare në Irak, Arabi Saudite, Libi, Egjipt, Siri, Sarajevë të Bosnjës etj. Bile edhe kisha ortodokse sot po e konsideron edhe Akademikun e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Dr. Aleks Budën, shkencëtar sllav ortodoks?! Ne në vend që të marrim masa për ta çrrënjosur këtë sëmundje të rrezikshme, edhe më me këmbëngulje po marrim vaksina të reja për ta kultivuar atë me sa më shumë sukses?! Në të mirën tonë është që sa më parë ta dimë se ku jemi, të mos kemi iluzione, dhe t'mos vazhdojmë të mendojmë siç mendonin të parët tanë. Por disa njerëz janë religjiozë nga natyra. Ata të Studenicës mund të kenë leverdi nga RELIGJIONI, sepse janë të njëzëshme kisha dhe Komiteti i Partisë, ndërsa te ne është **FATALE që religjioni të bëhet shkaktar që ne të mos e kemi SHTETIN deri në shekullin XX**. Duhet të na vijë turp pse më të vetëdijshëm ishin Vaso Pashë Shkodrani e Konstantin Kristoforidhi për kauzën kombëtare se sa ne sot. K. Kristoforidhin kisha greke nuk e lejoi të varroset në varrezat e Elbasanit, në vendlindje, sepse e kishte përkthyer Biblën në gjuhën shqipe, dhe me këtë kishte hedhur poshtë predikimet shoviniste grekomëdha se gjoja perëndia nuk ditka të flasë shqip, por vetëm greqisht. **Papa Kristo Negovanin** e vranë me thika andartët e tërbuar grekë në shenjë hakmarrjeje, sepse Negovani, pas orës së mësimit në gjuhën greke, i ndalte nxënësit shqiptarë pasdite dhe i mësonte në shtëpinë e tij, të cilën e kishte shndërruar në shkollë – mësonjëtore, dhe ua mësonte alfabetin e gjuhës shqipe. Ne sot nuk duhet që edhe pas 100 vjetëve të kacafytemi me **MORTAJËN RELIGJIOZE**. Dhe ja paradoksi: **derisa shkollat tona janë**

të shkatërruara dhe në një gjendje katastrofale, në anën tjetër po lulëzojnë xhamitë moderne dhe kishat.

Mirë profesor, po si mund ta shpjegoni faktin se edhe zviceranët, si shtetasit e një vendi më demokratik dhe më të përparuar, janë religjiozë?

Zviceranët janë religjiozë, **por për vetveten**. Atje edhe të shkolluarit shkojnë në kishë, për traditë. Por atyre nuk ju pengon kjo gjë, sepse FEJA te ata është ÇËSHTJE PRIVATE. Ata nuk e marrin veten në qafë si ne. Ata nuk e urrejnë fenë e tjetrit, nuk janë injorantë. Vetëm FANATIZMI FETAR e keqpërdor fenë. Zvicerani kurrë nuk e shet vendin e vet, edhe pse te ata qe pesë shekuj kultivohet feja.

ꕥ

Si mund ta shpjegojmë fenomenin absurd te ne kur një pjesë e mirë e mësuesve tanë janë inkuadruar në shërbimin sekret jugosllav (UDB) dhe kanë marrë pozita të larta politike?

Askush nuk mund ta zëvendësojë mungesën e prirjes natyrore që të ndjekë mësimet në akademinë e artit muzikor, në medicinë, në arsim etj. Një person mund ta kryejë një shkollë, por shkollës së tij populli do t'ia shohë sherrin. Duhet të bëhet zgjedhja e përcaktimit në një degë apo profesion në bazë të prirjeve natyrore të fëmijës, e jo të vrapojmë pas uniformave të bardha – mjekësisë, që pastaj ai person, ndonëse e ka marrë diplomën, të mos e dojë as profesionin, as vetveten dhe as shoqërinë. Pra duhet ta dimë se nxënësit janë si BRUMI, dhe nëse nuk ka kush t'i **GATUAJË (MËSOJË) dhe t'i PJEKË (ndërgjegjësojë),** atëherë është më keq sesa kur ishin brumë (të pamësuar) fillestarë. Pra talenti i fëmijës, plus dëshira e tij, plus gatimi i mirë nga ana e trupit arsimor është e barabartë me kuadrot e forta e të shëndosha.

BAZA MATERIALE e përcakton superstrukturën shoqërore, politike, filozofike….Por, baza ekonomike e kapitalizmit ka karakter ANTAGONIST, sepse përfshin marrëdhënie ekonomike të shfrytëzimit të njeriut nga njeriu, kështu që brenda kësaj baze ekonomike, borgjezia dhe proletariati kanë interesa themelore materiale të kundërta...

Maksimiliani, një piktor shumë i fortë, e shiti pikturëne vet për një porcion makarona, sepse ishte i uritur...

Sot po prodhohen **analfabetë me diplomë**, po na dalin nga shkolla tulla me diploma, dhe është tragjike kur dikush e merr diplomën ose dëftesën, **pa shkuar asnjë ditë në shkollë ose në fakultet**, dhe tallet me ata të cilët me vite të tëra kanë çarë kokën për të mësuar e studiuar me përkushtim, dhe në fund janë flakur në rrugë, edhe pse e kanë fituar me mund e me djersë diplomën e fakultetit. Dhe këtu kemi të bëjmë me **seleksionimin negativ të kuadrove**, d.m.th. pushteti okupator i ka instaluar filtrat dhe përzgjedh ata që më së miri i shërbejnë atij aparati shtetëror. Më të çoroditurit i kemi drejtorët e shkollave, shumica e të cilëve qysh në mëngjes vrapojnë në **komitetin e partisë**, ose UDB dhe marrin bekimin e tyre **për detyrat e shtëpisë**, pra janë kthyer në zagarë, roje të atij pushteti. ARSIMTARËT E TILLË SHQIPTARË JANË **VARRTARËT** më të rrezikshëm të vendit të vet, nëse janë inkuadruar në shërbimin sekret jugosllav… Tradita e arsimit te ne nuk ka jetë më të gjatë se 40 vite, ndërsa tradita fetare, allahu, shahadeti, duaja, kryqëzimi, mesha, kanë tradita mijëravjeçare. Feja nuk është pallavër, derisa themi tre katolikë e dy myslimanë, deri sa jemi në **kthetrat e saj mizore**. Serbia i identifikon, i barazon ortodoksët me serbë, dhe thotë për Akademik Aleks Budën:

”Ugledni pravoslavni albanski nauçnik Aleks Buda iz Elbasana (Shkencëtari i famshëm

ortodoks nga Elbasani, Aleks Buda…). **Ne nuk kemi kishë as xhami shqiptare...**

ꕥ

LIGJËRIME, 1 dhjetor 1987:

Te ne në Kosovë dhe viset tjera nën Jugosllavi ende po vazhdohet me mentalitetin fisnor. **Toskët** qysh në **shekullin e kaluar i kanë pastruar punët me fiset**. Që nga Elbasani e lumi Shkumbin dhe deri në Çamëri nuk i njohin fiset.

Por, fiset nuk i njohin as treva e Opojes?

Po, ashtu është, por këta janë më beter se këta që i ndjekin fiset, sepse këta vërtetë nuk i njohin fiset, por i kanë do punë më të zeza se fiset… Edhe në rrethin e Strugës i kemi 7 fshatra të cilat nuk i njohin fiset, janë toskë, dhe njerëzit e këtyre anëve i kanë mendimet e kthjellëta, të pastra, dhe nuk është e rastësishme se shumë nga këta njerëz të këtyre anëve ishin në ballë të revolucionit… Prandaj parakusht është çlirimi i njerëzve nga botëkuptimet patriarkale e fisnore…

Arkitekti i Beogradit, Bogdan Bogdanoviqi, iu drejtua me një letër klikës fashiste të Millosheviqit të cilët me insinuata dhe shpifje e përjashtuan Pavlloviqin (Sekretarin e Komitetit të PKJ) nga pozita e kryetarit të Komitetit, sepse ishin deklaruar për politikën e Shën Savës, Bogosllovisë që të gjuajnë në ujë të turbullt… Ndërkaq Dobrica Qosiqi thotë: Fati ynë – është humbja, sepse po e festojmë betejën e humbur. Ndërsa Desanka Maksimoviqi, shkrimtare serbe, shkon edhe më larg kur thotë: **"Ah sikur të mund t'u hiqja pak këtyre 65 viteve që kam dhe ta rrokja armën e t'u shkoja në ndihmë vëllezërve serbo-malazezë në Kosovë?!** E gjora shkrimtare, e paska harruar "Përrallën e përgjakshme"("Krvava bajka)...Pra nuk duhet harruar se këta mjekërrosha i kanë punët ngushtë, sepse problemin e kanë shtruar gabimisht kur thonë:

NE NUK MUND TË JETOJMË PA KOSOVËN, ose:

KOKËN E JAPIM – KOSOVËN NUK E JAPIM. Dhe sërish Qosiqi vazhdon:

Ne jemi mësuar të HUMBIM! Pjesa dërrmuese e popullit serb janë të manipuluar dhe po përpëliten në kthetrat e ideologjisë së Shën Savës (deri më 1945 dita e shën Savës kremtohej në mbarë vendin dhe këndohej: "Sveti Sava – shkolska slava". Bogdanoviqi po ju thotë këtyre mjekëroshave çetnikë: **"Edhe juve duhet t'ju vijë turp për këto marrëzira... "**

Por për ne, sikur ta hiqnin flamurin tërësisht do ishte më mirë, por nuk po kanë hesap, sepse siç dihet përdorimin e flamurit e lejuan edhe fashistët italianë… E dihet se **Fadil Hoxha as në WC** nuk ka mundur të shkojë pa urdhrin e Titos… Pra Tito ka qenë personi më i informuar për Kosovën, dhe ishte për politikën e kulaçit dhe kërbaçit (kujtojeni aksionin e armëve më 1955-1956). Por edhe Vatikani ishte për politikën e kulaçit, me ungjill, me urata, duke predikuar se MOSEKZISTENCA E SHQIPTARËVE SHKON NË DOBI TË SHQIPTARËVE!? Ndërsa për të mirën e të dy palëve, të shqiptarëve në Shqipëri dhe Kosovë, do të ishte BASHKIMI I TYRE, ashtu siç janë **binjakët sijamezë, me kurriz të bashkangjitur**. P.sh., Koçi Xoxe e kishte avionin special për t'i raportuar Beogradit në çdo kohë se çfarë po ndodh në Shqipëri. I pari ambasador i Shqipërisë në Beograd ka qenë Tuk Jakova, të cilin dalëngadalë e bindën krerët e Beogradit që ta **"çlirojnë" Shqipërinë nga barra e rëndë e PAVARËSISË?!** Mirëpo edhe lidhur me planet për KONFEDERATËN jugosllave nuk u pajtuan bullgarët, të cilët këmbëngulnin që Bullgaria të ishte një njësi e veçantë e konfederatës, e jo si republikë e shtatë apo e tetë…

A është e vërtetë se Stalini u tha jugosllavëve që mund ta merrnin Shqipërinë?

Po ta jap Shqipërinë, me kusht që ti të ma japësh vetveten, po ta jap veshin, që ti të ma japësh trupin – kështu i tha Stalini Jugosllavisë, por mospranimi i saj **e shpëtoi Shqipërinë**. Mikail Gorbaçov tha: **sikur Revolucioni i Tetorit t'mos kishte prodhuar një Stalin, nuk do kishte pasur as BRSS**. Pra këta donin **ta kapnin macen duke ia hedhur një mi.** Edhe Jugosllavinë po e mbajnë sllovenët dhe kroatët. Dimitrij Rupeli po thotë: Atë që po e zbatoni sot ndaj shqiptarëve, nesër do e zbatoni edhe ndaj nesh, mirëpo më shumë se ëndrrat e Serbisë ne e duam vetveten… Primitivizmi i serbëve ka kaluar në formën më drastike edhe te maqedonët në lidhjen **Kremlin-Beograd-Shkup.**

Mbi shqiptarët po ushtrohen metodat më të egra të dhunës dhe terrorit fizik dhe psikologjik, metoda e spiunazhit, shantazhimit, kompromettimit, korrupsionit. Pjesa më e madhe e popullit nuk i quan VUAJTJET gjërat më të mira, dhe dihet se gjerat e shenjta, si LIRIA, paguhen me çmimin më të lartë, me vuajtje, me burgje, me vdekje. Kemi njerëz të shkolluar, por aq të poshtër sa nuk ta merr mendja, dhe të tillët mund **t'i quajmë viça me shkollë, gomarë me shkollë,** sepse shkolla ta jep vetëm FORMËN, por jo edhe BRENDINË, esencën. Zhaveri i Ygoit (shih librin – TË MJERËT) – polici, është armë e çdo pushteti, zanati i tij – në shërbim të ligjit e urdhërdhënësve të pushtetit. Dhe në çastin kur ndryshon ligji – ndryshon edhe polici; zanati i policit si zanati i **xhelatit**. Ne pasi nuk e dimë se shteti është – APARAT DHUNE, themi: njeri me shkollë e bën këso të zezash. Por e harrojmë faktin se ai njeri me shkollë është vënë në shërbim të mekanizmit shtetëror, në shërbim të pushtetit.

ꕥ

A duhet t'i jepet vend psikozës disfatiste të disave që vajtojnë duke thënë se mbaruam?

Jo, kurrën e kurrës, sepse këtyre ultraçetnikëve e racistëve të sotëm u kanë dështuar planet e shfarosjes qysh moti, qysh **në vitet 1938-1939** kur i dëbuan me dhunë mbi 100.000 shqiptarë, ose në vitin 1953-1966, kur u dëbuan me dhunë mbi 400.000 shqiptarë në Turqi, dhe sërish jemi gjallë. Ndërsa sot as ndërmend nuk duhet të na shkojë se kemi kapitulluar… Shkrimtari slloven, Kermanuer, i shkruan Dobrica Qosiqit një letër – **Letër një mikut** – Pisma jednom prijatelju, dhe shton: ”Tani ju po befasoheni se si po ju del nga dora Bujanovci, Presheva etj., sepse fshatari shqiptar e donë tokën të cilën e punon më shumë se ju që po e shitni, pra shqiptarëve nuk po u dhimbset jeta për ta blerë, dhe kjo tokë po shitet me çmimin më të lartë në botë, më shtrenjtë se në Japoni dhe Bangladesh… Serbët nuk po ikin nga Kosova nga terrori, nga skamja, por nga prapambetja, dhe këta varfanjakë shqiptarë do e hanë “**stomakun e butë**” të Serbisë…

ꕥ

Vepra e F. Nolit – HISTORIA E SKËNDERBEUT është romantike, sepse aty del se gjoja Skënderbeu disa herë po ua **falë TRADHTINË** Mojsi Golemit e Hamza Kastriotit…

ꕥ

Në BRSS kemi 16 REPUBLIKA dhe rreth 60 republika autonome…

Kah fundi i muajit shkurt 1981, në gazetën javore NIN të Beogradit, Milija Kovaçeviq pat thënë se investimet në Kosovë janë – PLUHUR SYVE (Pepeo u oçi), dhe me këtë thënie ky funksionar i lartë i Federatës tha më shumë se ç’kanë thënë rinia revolucionare e Kosovës në demonstratat e marsit 1981, sepse ai foli në bazë të analizave ekonomike, ndërsa po i njëjti autor, dhe në të njëjtën gazetë – NIN, pas 8 muajsh i mohoi të dhënat

informative të para 8 muajve ku kishte dëshmuar me fakte lidhur me investimet minimale të Federatës në Kosovë, me çka vërtetohej katërçipërisht **DISKRIMINIMI EKONOMIK** në Kosovë, dhe njëherësh edhe diskriminimi politik… Por ky realitet po u hakmerret me ikjen e serbo-malazezëve nga Kosova dhe vendosjen e tyre në zonën e Kollubarës, Vojvodinës e gjetiu, sepse në Kosovë **brenda 22 viteve, deri në vitin 1958,** nuk është ndërtuar asnjë objekt i rëndësishëm ekonomik…

Me fushatën e egër kundër natalitetit të lartë të shqiptarëve në Kosovë po dështmohet programi racist i Serbisë. Dr. Milica Gërkoviq publikisht doli me propozimin diskriminues ndaj shqiptarëve duke ua ndaluar shtesat për fëmijën e katërt, ndërsa për serbët vlejnë kriteret stimuluese e privilegjuese duke i shpërblyer nënat serbe me nga 50 dinarë për secilin fëmijë që lindin, plus pushim lehonie dy vite, kohë e cila u pranohet edhe në stazhin e punës… Gazeta e Kishës Orthodokse Serbe "Pravoslavlje" shkruan: **Nënat shqiptare u treguan më trimëresha sesa nënat serbe, sepse ato po lindin më shumë fëmijë...** Kjo dështmon se kleri ortodoks serb nuk po vepron si hoxhallarët tanë… Në Vojvodinë është nataliteti i ulët siç është në Hungari, Austri… Hitleri për 13 vjet të diktaturës nazifashiste nuk ka arritur për të bërë këso marrëzirash, sepse edhe në Kosovë, sikur të ishin bërë investime të larta për 40 vite, do të kishim pasur natalitet (lindshmëri) të ulët, ashtu si në Slloveni. Problemi fillon kur secili fëmijë fillon të hajë në pjatën e vet, e jo kur në një tryezë e në një pjatë hanë 12 vetë… Në popull thuhet: MALLË E FËMIJË KURRË NUK JANË SHUMË…

Këtu e 2500 vjet ne në vazhdimësi etnikisht jemi duke u rrudhur, zvogëluar, dhe sërish po na akuzojnë se PSE NUK PO ASIMILOHEMI. Prandaj tani po programohet asimilimi me dhunë, me shkollë, me privilegjin inkuadrim etj., dhe në shkollë po planifikohet: 25 shqiptarë me 25 serbë, në gjuhën serbokroate…

ꕥ

Ilirët me shekuj ishin fqinj me fiset kelte, gotët… Në fillim të shekullit XX u ndal procesi i asimilimit të popullit shqiptar, pra nuk ka popull të vogël e popull të madh… Emri UKË – gjermanisht – WOLF – rusisht – VOLK, serbisht – VUK, pra më së shumti është shkruar trajta shqipe, dhe janë zhdukur V, L dhe O.

ꕥ

Profesor, mund t'na thoni diçka rreth barazisë së gruas, dhe në cilin vend është arritur suksesi më i lartë?

Tani për tani në Shqipëri kemi një arritje kolosale të barazisë gjinore. Atje gruaja është pjesëmarrëse aktive në të gjitha fushat e jetës: është pedagoge në Universitet, por edhe saldatore, tornitore, traktoriste, mësuese, mjeke, pilote etj. , dhe nëse i masim të drejtat e gruas në Shqipëri me ato në shtetet Skandinave del se shqiptaret **kanë më shumë të drejta se askund tjetër në botë**. Dhe ato të drejta janë reale, janë në praktikë, dhe jo të drejta false, në teori, jo formale…. Këtu te ne diskriminimi 42 vjeçar e ka bërë punën e vet, dhe për pasojë kemi këto primitivizma dhe këtë prapambetje të madhe.

Nga kjo del se nuk vlen as pesë pare nëse fitohet REVOLUCIONI NË LUFTË, **por nuk vazhdohet në praktikë**… Rusia deri në vitin 1866 e zbatonte ligjin e SKLLAVËRISË, sepse atje toka është shitur bashkë me njerëzit. Revolucioni i vitit 1905 është bërë pa asnjë parakusht, sepse substanca ishte shumë primitive, por edhe si e tillë popullin e kanë lënë pa bukë. Gjersa shteti i Carit rus ka shitur grurë në Evropë, Rusia e sotme, 60 vite pas revolucionit socialist, po blen bukë.

Para vitit 1918 Çekosllovakia ka qenë më e zhvilluar industrialisht se sa Franca, me fabrikat e avionëve, traktorëve etj., ndërsa sot ky shtet nuk mund të prodhojë asgjë pa e pyetur BRSS-në.

Gjatë luftës në Poloni asnjë peshkop as kryepeshkop polak nuk ka ngelë gjallë. **Kisha polake konsiderohet si kisha më kombëtare në botë**, dhe mu për këtë shkak atje nuk kanë hesap ta heqin kishën, sepse kjo kishë i ruajti polakët të mos mbarojnë, të ruajnë vetëdijen kombëtare polake. Dhe nga ky këndvështrim është e çuditshme se si arritën shqiptarët të bashkohen më 10 qershor 1878 në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit!

ꕥ

LIGJËRIME, 5 dhjetor 1987:

Në vitin 1940 Franca ishte vendi i parë në botë për rezervat e arit, por për 21 ditë, në muajin qershor, kapitulloi, sepse të mirat në standard kanë ndikuar si faktor negativ – kapitullues. Moda franceze ka ndikuar si faktor degjenerues, sepse francezët kishin nge për të ndjekur modën, dëfrimet, ahengjet, shthurjet, e jo për zhvillim, për punë, dhe kjo ishte tregues i DEKADENCËS, prapavajtjes, prandaj edhe të MIRAT FORMALE i kanë pasojat NEGATIVE. Për shembull, francezët turpëroheshin nëse dikush i kishte tre fëmijë, ndërkaq Hitleri më 1935 e ka institucionalizuar, e ka futur në aktet normative të Kushtetutës, që secila gjermane që e lind FËMIJËN E GJASHTË, të DEKOROHET ME **GRADËN E KOLONELIT**, ndërkaq ajo gjermane e cila kishte lindur fëmijën e nëntë, është barazuar me gradën e **GJENERALIT SS**.

Nëse një nënë ia ndërpret gjirin fëmijës për hir të vijës, modës, ajo e ka vrarë fëmijën e saj me dashje, por pa dije?!

ꕥ

Shoku profesor, a jemi duke i dalë borxhit mësuesve tanë të devotshëm?

Ju po veproni, po e bëni regjinë, ashtu siç veproi më 1799 gjenerali **LAZËR KARNUK**, konsulli i dytë, pas Napoleon Bonapartit (më 1804), kur i komandoi ushtarët dhe bashkë me ta edhe tërë popullin e pranishëm në atë manifestim që ta PËRSHËNDESNIN MËSUESIN PLAK, mësuesin e tij të dikurshëm, duke i thënë këto fjalë mirënjohjeje:

„ÇDO GJË QË UNË KAM ARRITUR NË KARRIERËN TIME ËSHTË MERITË E KËTIJ MËSUESI SHEMBULLOR!"

Prandaj as nënës që na ka lindur, as mësuesve që na mësuan me përkushtimin prindëror, kurrë nuk mund t'ua shpaguajmë detyrimet që kemi ndaj tyre. Por sa të tillë kemi sot me bindjet dhe konsideratat ndaj mësuesve si gjenerali Lazër Karnaku?…

ꕥ

Ç'mund t'na thoni për sistemin zgjedhor të sotëm?

Duhet ta pranojmë faktin se që nga viti 1945 e këtej askush nuk është zgjedhur me vullnetin dhe pëlqimin e popullit, sepse POPULLIN NUK E PYET ASKUSH, dhe vetëm formalisht populli del në votime. Votimet nuk janë të drejtpërdrejta si në botën borgjeze, por edhe **më keq se atje**. Dhe zgjedhjet bëhen sipas vullnetit të një grupi në pushtet, partisë, sepse ata i emërtojnë kandidatët dhe thonë: KUSH PAJTOHET ME QËNDRIMIN E PARTISË, E KUSH JO? Dhe nëse dikush merr guxim dhe deklarohet kundër këtyre qëndrimeve, e shpallin të rrezikshëm, armik, të papërshtatshëm moralo-politikisht. **Fushata paraelektorale është vetëm AGJITACION.**

ꕥ

Thuhet se çdo popull e ka pushtetin që e meriton, dhe ne a e kemi pushtetin që e meritojmë?

Po, është e vërtetë **se ATË PUSHTET TË CILIN E KE, ATË E MERITON**, pra gjithë ajo që ushtrohet mbi ty **dhe ti hesht, duron, nuk reagon, atë dhunë e meriton...** Shtrohet pyetja: pse rezistuan aq pak francezët kundër nazifashizmit? Sepse ua panë sherrin të mirave tokësore, sepse atje nuk pinin ujë, por verë. DRAJFUSIN e dënuan pa faj, ashtu si racistët, për të pabërat dhe të paqenat, me shpifje e kurdisje flagrante… **GOLI OTOKU** i tyre ishte Ishulli i ORËS SË LIGË (Antilet e Vogla)…

ꕥ

Çdo gjë e pamundshme që kërkohet është KUNDËRREVOLUCIONARE, ndërsa çdo gjë e mundshme, e arsyeshme, është REVOLUCIONARE. **Prandaj këta pushtues jugosllavë nuk e pranojnë revolucionin, sepse nuk kanë hesap, sepse duan të hanë bukë pa e përdorur shatin, as draprin, pa punë, pa djersë, si parazitë**, d.m.th. përmes eksploatimit të egër të popujve nga pozitat e kolonizatorëve. Prandaj këto të mira atyre patjetër do t'iu hakmerren dalëngadalë, sepse çdo gjë që e disponojmë dhe nuk e meritojmë – është imorale, e pandershme… Ne i kemi disa zona në rrethe kufitare, ZONA TAMPON, zona neutrale, zona joaktive, por në fakt shumë aktive, me gjithë ato përçarje fisesh, religjionesh, sektesh, si për shembull – ZONA NEUTRALE E JUNIKUT, askund nuk ka qenë më aktive më 1921-1923.

ꕥ

Rekë e Keqe – fjalë josllave: RRJEDHË, RRËKE, rrjedhë e shpejtë, serbisht – TOK; kroatisht – TIJEK, (proteçi), sepse gjuhët ilire-thrake ekzistonin më shumë se 1000 vjet para greqishtes antike. Ndërsa mbi 1000 vjet para gjuhëve **ilire -thrake** ka ekzistuar gjuha **PELLAZGJIKE, parailire.**

Ideja për favorizimin e teorisë së etnogjenezës ILIRE rrjedh nga synimet e Napoleon Bonapartit, pastaj gjermanëve e austriakëve. Oto Bizmarku jo që nuk e dinte se ku gjinden trevat autoktone shqiptare (në Kongresin e Berlinit më 1878), por nuk donte t'i dëmtonte interesat me Turqinë…

ꕥ

Pse Titoja e mbajti Vasa Çubrilloviçin shtatë vite në postin e ministrit për çështjet agrare – ministër të bujqësisë? E mbajti për hir të serbëve, edhe pse ai në vitin 1937 kishte hartuar ELABORATIN më racist në Ballkan për shfarosjen e shqiptarëve, ndërsa më 1944 ai ia dërgoi Titos planin e ri për – ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES SË PAKICAVE NACIONALE NË JUGOSLLAVI, me të njëjtat synime raciste. Por këta kralët e rinj, duke menduar pak më me dinakëri, dhe me një rrugë tjetër, duke ua dhënë shqiptarëve të DREJTAT FORMALE, me qëllim që më vonë ta OKUPOJNË TËRË SHQIPËRINË, Titua i thotë Çubrilloviqit dhe Andriçit se me internime masive nuk po kemi hesap, sepse po shkatërrohet Jugosllavia, por Kosovës do t'i jepet një Autonomi maksimale, për hir të synimeve për okupimin e Shqipërisë. Çubrilloviçi shkonte edhe më tej kur thoshte se: edhe BOSNJA është SERBI, pastaj gjithë Kroacia, përveç ZAGORJES, përveç Sllovenisë… (Istorijske srpske zemlje).

ꕥ

Po si u bë ndarja e Kosovës ?

Serbia e dha pëlqimin që tërë Kosova t'i mbetet asaj, por Tito si kompensim propozoi që Serbisë t'i jepej edhe SANXHAKU Verior, Novi Pazari, ndërsa malazezët pretendonin në pjesët që i kishin pasur para Luftës Parë Ballkanike, deri në Prizren, bashkë me Pejën, Gjakovën dhe Prizrenin me 3000 km katrorë. Por në vend të këtyre

trojeve Malit të Zi iu dha si kompensim Kotorri (pika më strategjike), si dhe 50% e SANXHAKUT Jugor, dhe plus udhëheqësit kryesorë në Kosovë – Gjoka Pajkoviqi, Milladin Popoviqi e Dushan Mugosha. Kështu Mali i Zi u zgjerua për dy herë më shumë territor (Më parë në zonën e Bokës së Kotorrit jetonin kroatët dhe serbët). Deri më 1918, deri në Dubrovnik, sundonin austro-hungarezët. KOTORRI konsiderohet – GJIBRALTARI i Mesdheut.

Për 27 vite me radhë tërë udhëheqësia në Kosovë ishte malazeze, bile edhe një shërbëtor malazez ka pasur më shumë vlerë se sa Fadil Hoxha, sepse funksioni i sekretarit të partisë ishte çdo gjë, ndërsa i kryetarit, vetëm nënshkrimi, pra ishte një post formal, i cili edhe sot e gjithë ditën po vazhdon me të njëjtin avaz…

ꕥ

Po si qëndron çështja me FLAMURIN KOMBËTAR?

Po, nëse lejon të ta ndryshojnë, e ndryshojnë, nëse lejon të ta heqin, ta heqin, sepse sikur të kishim qenë të organizuar dhe të fortë, as që kishin guxuar ta prekin. Sot akademik Ali Hadri po qan, dhe po u thotë: **mos na prekni FLAMURIN!** Dihet se Flamuri deri më 1966, respektivisht deri më 1968, pra për 24 vjet, ishte i ndaluar. Për gjëra të tilla fondamentale nuk duhet lutur, me derdhur lot. Sepse ato kur t'i falë dikush nuk kanë vlerë dhe nuk duhet pranuar. Gjërat e shenjta nuk FALEN, por FITOHEN. **Për këtë FLAMUR është derdhur gjaku i 113 mijë shqiptarëve**, pra është paguar çmimi më i lartë… Ndërsa ne sot jemi **më të ndarë se në kohën e Hyrjetit!** Kurrë nuk duhet shtruar pyetje jologjike si – cila anë do të fitojë? Sepse FITORJA arrihet vetëm kur njerëzit vetëdijesohen. E dihet se për Flamur njerëzit janë dënuar me 6-12 vjet burg të rëndë, edhe pse askush nuk ka dalë në mënyrë të organizuar për ta mbrojtur (armiku vepron si VIRUSI, të

vjen si MIK, hyn brenda organizmit i mirëseardhur, dhe vetë qeliza e trupit tonë e ushqen, dhe kur arrin numrin e duhur – 299, atëherë i shpall luftë qelizës mëmë dhe ajo VDES **–(Shih librin e Aleko Xoxës: NË ZEMËR TË JETËS)**. Prandaj me shkallën e vetëdijes jemi shumë ulët, s'jemi askund. Ata po na urrejnë, dhe ne po i urrejmë, dhe po del se si ata si neve nuk po i dallojmë gjerat. Po e IDENTIFIKOJMË TËRË POPULLIN me pushtetin tiranik kolonialist, dhe kështu do ta kemi gjithnjë derisa po i rrëzojmë xhamitë e vjetra e po i ndërtojmë më MODERNE, dhe kjo është pasojë e **JOARSIMIMIT KOMBËTAR** në vazhdimësi. Udhëheqësit e këtij pushteti janë ashtu si të gjitha gjerat që SHITEN dhe blihen, sepse PLATFORMA E PARTISË është manipulative dhe reaksionare. Në Kosovë bërtasin me gjithë zërin: ENI VËLLEZËR T'U NDIHMOJMË VËLLEZËRVE NË SHQIPËRI, E T'I ÇLIROJMË NGA VARFËRIA – **MORTAJA SOCIALISTE?!** Se gjoja atje nuk paskan as çorapë, as këpucë, as kisha e xhamia?!

Njeriu që të dallohet nga kafsha duhet të dëshirojë diçka më shumë sesa kërkesat dhe nevojat INSTINKTIVE ORGANIKE, dhe logjika – arsyeja e tij, ta kontrollojë INSTINKTIN. Nuk duhet ta marrim pjesën për tërësi (PARS PRO TOTO), sepse individi nuk mund të identifikohet me tërë një popull, sepse tërë një popull nuk mund të jetë fajtor, meqë edhe ai vuan nën zgjedhën e diktaturës së atij pushteti. Klasa sunduese është më e fortë, më e vetëdijshme, por më e vogël në numër, ndërsa gabimet e saj i paguan tërë populli. **REVOLUCIONI** ka për qëllim që t'i thyejë përgjithmonë këto kontradikta dhe të arrijë shkallën më të lartë të HUMANIZMIT. Prandaj gabimet duhet t'i paguajë klasa që ka faj, klasa në pushtet, dhe sot kemi ardhur deri aty që realiteti teorik t'i kundërvihet realitetit PRAKTIK. Ne sot vazhdojmë të jetojmë me padrejtësi duke e NGUSHËLLUAR vetveten, dhe po na duket çudi se si i gëzuam ato pak të drejta nga

viti 1968-1981, dhe nuk e dimë se të gjitha këto i paguan kurrizi i klasës punëtore…

ꕥ

Pas një stagnimi të gjatë, me padrejtësi e terror, deri më 1966-1969, diga e ngritur vit pas viti nuk mundi më ta mbajë peshën e rëndë të diskriminimit dhe padrejtësive, tensionin e madh mbarëpopullor, dhe u thye, sepse sot i kemi 40.000 studentë në Universitetin e Kosovës (në Prishtinë), prandaj nuk duhet të thuhet – NA DHANË UNIVERSITETIN, por vetë populli, pjesa më **revolucionare e popullit, shpërthyen në demonstratat e vitit 1968, dhe pushtetmbajtësit me çykë të zorit u detyruan ta hapin Universitetin**, të cilin më vonë, më 1981, shovinistët e tërbuar do ta quanin – **Çerdhe e irredentizmit**, dhe të tërbuar nga shovinizmi e mbyllën

ꕥ

LIGJËRATË, 7 dhjetor 1987:

Kush mund të quhet frikacak?

Frikacak dhe i lig është ai që u **frikohet të mirave**, siç janë: dashuria ndaj prindërve, ndaj Atdheut, ndaj njerëzimit dhe Lirisë.

ꕥ

Kë mund ta quajmë artist të popullit?

Artist të popullit mund ta quajmë atë komik ose mahitar, i cili i nxit të tjerët të qeshin, dhe masa kurrë nuk mërzitet me të. Një komik i tillë kurrë nuk flet pa lidhje e pa vend, nuk flet fjalë banale, nuk gajaset që të tjerët vetëm të qeshin pa lidhje, por flet siç do fliste populli, dhe kritikon përmes gazit, talljes, duke mos iu drejtuar asnjërit veç e veç me atë kritikë, por të gjithëve, dhe kështu secilit

i vjen keq për diçka që është e mbrapshtë në jetë, që ajo vepër e shëmtuar të mos përsëritet, por të bëhet e mirë. Ndërkaq, artisti i cili shtiret, ai nuk është artist, por **spekulant**…

ꕥ

Ç'mund të na thoni për natalitetin – lindshmërinë?

Kur ishim ne fëmijë, në atë kohë nënat na i ndërronin pelenat një herë në 24 orë, ndërsa sot ua ndërrojnë tri herë në ditë, dhe fëmija i ka të gjitha gjërat e veçanta: gotën, rrobat, pjatën, krevatin, tavolinën etj. Evropianët tmerrohen nga fëmijët e shumtë. Atje mijëra gra abortojnë brenda vitit. Dhe sa më shumë përparon teknika, aq më shumë jeta bëhet teknike, aq më e vështirësuar bëhet rritja e fëmijës në ato suaza të marrëdhënieve në prodhim. Sa më i vogël që të jetë standardi, aq më i lartë është nataliteti – lindshmëria. Nuk ka asnjë lidhje kur shovinistët thonë: **"Shqiptarët po lindin, e ne po ua përkundim djepat... ",** ose siç thoshte Vaska Duganova (kryetare e Lidhjes Socialiste të Jugosllavisë) – "Deri kur do vazhdojmë ne të financojmë natalitetin aziatik dhe standardin evropian për shqiptarët në Kosovë? Sot kemi shumë pak nëna të vërteta, por gjysmë-nëna ose hiç-nëna, të cilat janë vetëm nëna biologjike, të cilat fëmijës ia ndërpresin gjirin qysh javët e para pas lindjes, dhe fillojnë t'i rritin artificialisht, me plazma, frutolina e çokolina… **Beogradi sot po çuditet pse një nënë në Kosovë i lind mesatarisht pesë fëmijë**, dhe se kjo gjoja po bëhet për qëllime ekspansioniste dhe për okupimin e trojeve të tyre… Ndërkaq akademiku shovinist Mihajloviq shkonte edhe më tej me gjuhën prej racisti, kur thoshte: "Svako novorogjençe na pelenama na Kosovu jeste jedna zhiva bomba za nas… **(Çdo fëmijë i porsalindur në pelena në Kosovë është një bombë e gjallë për ne...)** dhe këtë natalitet të lartë të shqiptarëve e quajti – DEMOGRAFSKI TERRORIZAM (Terrorizëm demografik)… Nëna shqiptare nuk tmerrohet kur fëmija i

përbaltet, fëlliqet, përgjaket duke lozur, dhe një nënë e tillë nuk vete të lindë në spital, por në shtëpi, në mënyrë natyrore… Nënat moderne nuk lindin shumë fëmijë, sepse janë **EGOISTE**, për t'i ruajtur vijat e trupit, estetikën e trupit të cilën nuk e sakrifikojnë për fëmijën e tyre. Nuk duan ta prishin rehatinë jetësore, gjumin, pushimin, rekreacionin, shëtitjet… Në Vojvodinë nëna mezi pranon të lindë vetëm një fëmijë, dhe këtu shihet kulmi i egoizmit, ndërsa nëna shqiptare e vërtetë është ALTRUISTE dhe fëmijën e do përmes vetvetes, dhe vetveten përmes fëmijës, bile më tepër se vetveten, duke ia dhënë fëmijës edhe kafshatën e fundit që ka. Fëmija konsiderohet – BOTIMI I DYTË I YNI, ndërsa këta shovinistë jugosllavë po na akuzojnë për natalitet të lartë, dhe po na konsiderojnë "kundërrevolucionarë", vetëm pse nënat tona po e sakrifikojnë edhe jetën e tyre për hir të fëmijës…

ꕥ

Nga e njëjta lule gjarpri e prodhon HELMIN, ndërsa BLETA e prodhon MJALTIN. Vetë CILËSIA është SASI (kuantitet), dhe një vepër e mirë vlen sa qindra e mijëra vepra të dobëta…

ꕥ

Çfarë veçorish duhet të ketë revolucionari?

REVOLUCIONAR është ai njeri i cili e hedh shikimin **mbi MURIN e PENGESAVE** dhe vështirësive të çastit, dhe sheh më larg se të tjerët rreth e rrotull tij. Revolucionari nuk pushon kurrë së mësuari dhe së vepruari. **Libri** është armë e tij, busull orientimi dhe zgjerimi të njohurive të shëndosha e të vërteta. Njëra nga levat më të devotshme është kritika objektive e rendit shfrytëzues. Ai i ka qëruar hesapet me veten, me bindjet dhe me ndërgjegjen e vet. Ai është përherë në pararojë, i pari në sakrificë, dhe i fundit në pretendime. Ai është në dispozicion dhe në shërbim të

interesave të popullit, i gatshëm që në çdo çast të sakrifikohet për të mirën e popullit të tij dhe popujve tjerë. Ai është internacionalist, dhe kurrë shovinist…

Fjala PRIJËS (popullorçe), d.m.th. PRINC (zyrtare). Për shembull, Millan Obrenoviqi ishte analfabet, por shumë i aftë…

ꕥ

Kur u rrit më së shumti hendeku i zhvillimit në mes të dy gjysmave shqiptare, Shqipërisë administrative dhe pjesëve të Shqipërisë së okupuar – Kosovës me vise?

Më 1974 është legalizuar rritja e antagonizmave në mes të **DY GJYSMAVE SHQIPTARE** edhe me kushtet tjera ekonomiko-politike, thellimi i hendekut të vetëdijes për domosdonë e bashkimit mbarëkombëtar. Po ta paramendonim një REFERENDUM – PLEBISHIT, deklarim popullor për vetëvendosje dhe bashkim me shtetin amë Shqipërinë, unë mendoj se as **një për qind (1%)** nuk do të deklaroheshin pro kësaj ideje, **sepse ne ende nuk po mund të shkëputemi nga mentaliteti PRIMITIV**, sepse po na pëlqen të jetojmë në **ILUZIONE**! Sepse mentaliteti i pronës private e bën atë të kufizuar, të mos shohë më larg se gardhin e asaj prone të vogël, viçit, lopës, deles, ndërsa **bashkimin me Shqipërinë e identifikon me zhdukjen e lirisë së pronës private**, dhe nuk e kupton gjendjen e tij prej skllavi nën sundimin e kolonizatorëve jugosllavë. Prandaj nuk duhet të çuditemi kur ti e derdh gjakun, ndërsa të tjerët i korrin frytet e FITORES?! Filozofi i njohur francez, Rene Dekarti, pati thënë se:

NËSE FJALËVE UA PËRCAKTONI DOMËTHËNIEN E SAKTË, BOTËN DO TA ÇLIRONI NGA GJYSMA E ILUZIONEVE…

ꕥ

LIGJËRIME, 15 dhjetor 1987:

Shqipëria e 1912-ës u formua në tavolinë, dhe mu për këtë Italia fashiste hyri aq lehtë në të më 7 prill 1939, ndërsa Shqipëria e sotme është **mbi BAZAMENTIN E GJAKUT DHE ESHTRAVE të 28.000 dëshmorëve**, dhe nuk mund të kapitullojë pa gjak, sepse nuk është krijuar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, as në Jaltë më 1945, as në Helsinki më 1975. Çekosllovakia e formuar në tavolinën e Versajës, më 1919, kapitulloi për 6 orë, ndërsa Jugosllavia për 6 ditë (më 6 prill 1941). Duhet ta dimë se viti 1966 nuk mund të përsëritet, por tani kjo kastë e tërbuar raciste po tenton të gjuajë në errësirë, pa e rrezikuar Jugosllavinë. Shtrohet pyetja: pse po veprohet kështu? Po veprohet sepse janë të vetëdijshëm se kuislingët, marionetat e Kosovës, kolaboracionistët, nuk e kanë popullin me vete, dhe është kjo një taktikë e maskuar që të trembet populli shqiptar i Kosovës.

Më 1972 Savka Dapçeviq-Kuçar dhe Mika Tripallo kanë vepruar në stilin e Millosheviqit, e këta sot po e kopjojnë taktikën e tyre. Por Tripallo e Dapçeviq ia arritën që popullin ta masivizojnë (MASOVNI POKRET), por jo të gjithë. Lufta e tyre filloi për çështjen e devizave, për çështjet e eksploatimit ekonomik nga Beogradi, sepse 80% e financave shkonin në Beograd, dhe vetëm 20% i mbeteshin Kroacisë (fitimet nga turizmi në bregdetin kroat). Por më 1972 u arrit marrëveshja që 60% të financave të ngelin në Kroaci, dhe 20% t'i shkojnë Federatës. Në Kroaci fitorja u arrit për dy javë, ndërsa këta në Serbi po i quajnë tradhtarë Pavloviqin (Kryetar i Komitetit të partisë në Beograd) dhe Stamboliqin, ndërsa këta po e quajnë Millosheviqin dhe grupin e tij çetnik e kriminel… Vojvodina është e vetëdijshme për interesat e veta, por Kosova shumë pak. Kështu këta pushtetarë tiranikë po luftojnë me këmbëngulje për FITOREN E TË ZEZAVE të veta, dhe nuk po luhaten, e ne jemi me dy

mendje për ta bërë luftën për të mirat e PËRJETSHME – për PAVARËSI dhe SOVRANITET…

ꕥ

Po pse nuk e dënuan me vdekje kriminelin nazifashist kroat Artukoviç?

Po si do të dukej ty sikur dikush t'i ka dhënë hua 100.000 dinarë para 10 vjetësh, e ti sot do t'ia kthesh borxhin e devalvuar, me të cilin sot mund ta blesh një pako cigare. Kush e pranon atë borxh konsiderohet budalla, ndërsa Artukoviqi është vetëm njëri nga kriminelët, i cili akuzohet për vrasjen e 1.000.000 njerëzve të gjinive dhe moshave të ndryshme.

Nuk është njësoj kur e hamë bukën në dritë, dhe kur e hamë në terr, sepse në terr nuk i sheh as mizat as krimbat, kur dihet se para 27 vjetësh e përdornim për ndriçim pishën, bishtukun, llambën, e sot e kemi dritën elektrike… Sot po thuhet "srpski i cërnogorski junaci" (trimat serbo-malazezë) në vend se të thuhet – ÇETNIKËT serbomalazezë të Millosheviqit.

ꕥ

Nusja e sotme përton ta qesë një kulaç, e lëre më t'i pjekë nga 12 bukë me saç e çerep, për 40 anëtarë të një familjeje patriarkale, sepse është bërë decentralizimi i familjes, është bërë rikonstruktimi i familjes dhe i shoqërisë.

ꕥ

Çfarë atributesh e karakterizojnë një familje?

Shtëpinë nuk e simbolizon KULMI I SHTËPISË, as themeli i shtëpisë, por **MAGJJA**, baza materiale, sepse kjo nuk është punë sezonale, por e përditshme. Sot vetëm në

Has dhe në Rekë të Keqe kemi ndonjë familje patriarkale shumanëtarëshe. Edhe oborri më i ndotur e pa kanalizim në fshat, është më i mirë se sa 4-5 dhoma në një ndërtesë të qytetit. Për të mos të prekur pushteti standardin, kushti i parë ishte **mosregjistrimi shqiptar**, dhe kështu personin e vinin para dilemës: **ja shpirtin, ja rrogën?** Dhe pastaj vjen përcaktimi prej zorit: në këtë botë – RROGËN, ndërsa në botën tjetër – SHPIRTIN?! Sepse duhet gëzuar të gjitha këto të "MIRA" të kësaj bote, veturën, videokasetat, firmën, biznesin etj. Sot po lëvdohet Esat Toptani – Tradhtari, i cili ia dorëzoi çelësat e qytetit të Shkodrës më 1912 të birit të knjaz Nikollës, Danillos, pa u vrarë asnjë ushtar malazez **(Lexojeni romanin e Skënder Drinit – VRAJE TRADHTINË).** Sekretaresha e Peko Dapçeviqit kur erdhi në gjimnazin e Prizrenit si profesoreshë e gjuhës serbokroate më 1954-1959 më tha:

„Kur po i dëgjoj njerëzit **kur po flasin shqip** po më kapë psikoza, po ligështohna, dhe po më duhet të pi hapa për qetësim nervash…"

Ja çfarë shovinistësh vinin me detyrë në Kosovë, dhe pikërisht në sferën e arsimit… Sot tërë një shtet është angazhuar për të kultivuar tipa si Sinan Hasani, Fadil Hoxha, Veli Deva, Azem Vllasi, Halit Tërnavci, Sefedin Sylejmani etj., dhe pushteti okupator ato **marioneta** herë i FRYN e herë i ÇFRYN si rrogëtarët e vet të devotshëm, ashtu siç ua do interesi i politikës ditore. Franc Shetinci po thotë: ne e hodhëm atë beter, atë Fadil Hoxhë, se ai është më qen se qentë, qen e bir qeni, i cili tërë POPULLIN E KOSOVËS, SIDOMOS RININË, më 1981, e quajti – **PLEHU I KOSOVËS!** Pjesa dërrmuese e popullit është në baltë, dhe është e aftë vetëm t'ia hapë varrin vetes, sepse kohën ende po e mat me natën e madhe, me Shëngjergjin, ramazanin, kërshëndellat, Shën Mitrin, Shën Nikollin etj. Pra **po mendojnë serbisht e po flasin shqip**, dhe po i përkthejnë edhe këngët, dhe prej 300 këngëve, janë lejuar vetëm 26 këngë dashurie, sepse cenzura është e tmerrshme, sa që edhe **Dimitrije Tucoviqin** këta shovinistë

të tërbuar sot po e quajnë TRADHTAR (sepse më 1913 ai thoshte se nuk mund të pretendojmë në ato tri kisha murana të vdekura në Kosovë të rrethuara me detin e gjallë të shqiptarëve (Shih D. Tucoviq – Serbia dhe Shqipëria; D.Tucoviç-SABRANA DELA. Libri 7 dhe 8, Beograd 1980).

Ne po i lavdërojmë mbrapshtinat tona, jemi trima të vritemi mes veti. Se sa jemi varrtarë potencialë të vetvetes më së miri tregon fakti se më 1924 shqiptarët e Kosovës u bënë mercenarë të reparteve të ushtrisë serbe e bjellogardiste nën udhëheqjen e gjeneral Vrangelit, dhe e "ÇLIRUAN" Shqipërinë nga pushteti demokratik i FAN NOLIT e Bajram Currit. Dhe kështu është puna kur lëvdohemi me të zezat tona. Kjo është njësoj komike sikur të thuash: ka tre vite që më ka ra zhuga e kalit, dhe ende nuk po më hiqet (kur dihet se zhuga vjen si pasojë e **papastërtisë sonë trupore**). Edhe huni i ka dy anë, njëra në dorën e atij që rrah, dhe tjetra në anën e atij që rrahet… Ne po i festojmë HUMBJET, **po i festojmë të SHTATAT**, të 40-at, por në secilin vend islamik ka adete tjera, si në Indi, Bangladesh, Filipine, Kashmir, Pakistan, Liban, Algjeri, Arabi Saudite, Emiratet Arabe, Kinë, Indonezi etj. , ndaj ta lashë të vdekurin nuk është çështje fetare, por fanatizëm. Pra duhet që sa më shpejt t'i mundim të metat tona, dhe gjërat t'i shohim ashtu siç janë, t'i shohim më qartë, dhe pastaj kur fenë e zhveshim nga fanatizmi, misticizmi, iluzioni, atëherë ajo ngel pa asgjë IDEALISTE, ngel një gjë thjeshtë INTIME – personale, siç është në Zvicër… Pra duhet ta dallojmë shkurtpamësinë, verbërinë me syçeltësinë. FEJA, kur përdoret si instrument, ia sheh sherrin më së shumti ai i cili më së paku e di se dikush është duke manipuluar me paditurinë e tij… Edhe sot kemi familje ku gjysma janë myslimanë e gjysma katolikë, dhe para se të jenë myslimanë ose katolikë, ata janë vëllezër.

ꕥ

KRITER themelor i një kulture duhet të jetë – SINQERITETI, ndërsa masë e JOSINQERITETIT – është FITIMI – PROFITI, pra ky është realiteti i sotëm. Kur një **gjë e SHËMTUAR reklamohet me dekada**, atëherë me kalimin e kohës ajo gjë për veshin dhe syrin e masës së rëndomtë bëhet **REALITET...** Një reklamim i tillë u bë për vite të tëra përmes radiotelevizionit për këta pisa dhe këto pisllëqe, për çka u ka dalë fama gjakovarëve, sepse vetëm 5-6 veta po i humbin kolltukët, por jo edhe rrogat e majme, dhe po vazhdohet të investohet me të njëjtin plan dhe program, por me njerëz tjerë, me aktorë tjerë, më të shkolluar, si p.sh. **Shkëlzen Maliqi,** Rrahman Morina, Azem Vllasi e tj. , të cilët janë nën mbrojtjen e Federatës jugosllave, dhe për ta garanton Federata (si kuadro të verifikuara dhe të sprovuara, si kuadro besnike të politikës jugosllave). Më 1971 kritikohej gazeta VUS (Vjesnik u Srijedu) e Zagrebit, dhe autori Nebil Duraku, vetëm pse kishin shkruar mbi një të vërtetë, lidhur me shpërnguljen me dhunë të 283.000 shqiptarëve nga viset e ndryshme të Kosovës për në shkrepat e Anadollisë (Turqi), në kohën e satrapëve Tito-Rankoviq (vetëm për pesë vite: 1955-1960).

ꕥ

Hasi, Opoja, Reka e Keqe, Rugova, janë vise të brezit kufitar, janë **ZONA TAMPON** … Shtrohet pyetja: edhe sa do të jenë të ndara dy Gjermanitë, Perëndimorja dhe Lindorja? Vetëm edhe për aq kohë sa ato lejojnë që të jenë të ndara! Prandaj, përcaktues janë vetë gjermanët… Por, në këtë kontekst, përcaktues jemi edhe ne shqiptarët…

Siç po rrjedhin ngjarjet, sot ka ardhur koha, që nëse nuk të ndjek pushteti, nëse **NUK TË PËRJASHTON NGA PUNA**, përmes diferencimit policor, atëherë duhet të **DYSHOJMË NË VETVETEN** se a thua jemi apo nuk jemi **shqiptarë?!**

Elena Gjikën duhet ta ngjitim në rangun e SKËNDERBEUT, sepse është identifikuar si shqiptare, dhe tërë jetën e saj ia ka kushtuar emancipimit dhe afirmimit të shqiptarëve. Për ta parë se sa poshtë kemi rënë ne sot në çështjen kombëtare duhet t'i lexojmë letërkëmbimet e Elena Gjikës me De Radën e madh, në gjuhën italiane. Elena Gjika ishte Zhorzh Sandi shqiptare, ndërsa ne nuk po bëjmë asgjë… Jugosllavia është një rrip transmisioni në mekanizmin e REAKSIONIT botëror, dhe KUNDËRREVOLUCIONIT botëror, e të gjithë e dinë se i mbyturi pak pa dhënë shpirt e koncentron tërë forcën, dhe të merr me vete, se këta janë plehu i plehut, dhe të ndotin… Beogradi sot donë t'i hedhë në lumin Sava edhe eshtrat e Titos. Pas kësaj politike janë Drazha Markoviqi, Akademia Serbe e Shkencave dhe Kremlini…

ꕥ

LIGJËRIME, 26 dhjetor 1987:

MEDICINA – ekzekutivi i Biologjisë...

ꕥ

Profesor, a mund t'na thoni diçka për mësuesit?

Fjala **MËSUES** është fjalë e shenjtë, dhe gjithë dijetarët e botës kishin edhe mësuesit e tyre të lavdishëm. Të kujtojmë mësuesit tanë rilindës që e paguan me gjak e sakrifica hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë e deri te mësuesi hero – Fazli Grejçevci. Këta mund t'i quajmë me plot të drejtë **KOMISARËT E DRITËS**.I pari mësues i së parës shkollë shqipe, PANDELI SOTIRI, e pati paguar patriotizmin e tij me jetën e tij...Po kështu mbaroi edhe Nikolla Naço, martir i abetares shqipe. Arsimtarët e kanë për detyrë të rrinë me sa më shumë njerëz, dhe të tillët mund t'i quajmë arsimtarë operativë, sepse punojnë në gjirin e masës, në gjirin e popullit, në mesin e 15-20 dhe

40 vetave. Dhe në mesin e tyre ai e ndjen veten të lumtur, por nganjëherë ai mësues ka nevojë edhe për vetmi, ashtu siç kemi nevojë për GJUMIN. Në shumë raste nxënësit (por edhe disa arsimtarë) janë të padisiplinuar, dhe kjo neve na duket jonormale, ndërsa atyre u duket normale, sepse MËSIMI për ta ende nuk ka arritur të bëhet domosdoshmëri, pjesë e tyre jetësore, për të cilën ata do të duhej **që mezi të prisnin për të filluar ora e mësimit**. Si kur je i uritur dhe mezi pret të hysh në kuzhinë për të ngrënë, ose për t'u zbavitur në fushën e futbollit, dhe kjo është pasojë e **arsimtarëve përtacë** dhe të paaftë, të cilët nuk dinë ta bëjnë orën e mësimit sa më interesante. Dhe pastaj çuditen se pse nxënësve po u duket si me hy në klasë si me dalë para konopit …

ꕥ

Brenda njeriut bashkëjetojnë e mira dhe e keqja, dhe as "ZOTI" nuk mund të jetojë pa atë pjesën tjetër, gjysmën tjetër, ORËN E LIGË. Pra është e pamundur t'mos ekzistojë abnormaliteti. Prej gjithë atyre filozofëve të antikës, vetëm **SOKRATI** ka qenë PROLETAR, dhe nxënësit e tij, fëmijët e aristokracisë, e bënin me radhë se cili do ta ketë radhën për ta pasur Sokratin në shtëpinë e tij (për 5 javë afatet ishin të plotësuara paraprakisht!). Ndërsa te ne **më së shumti është i zënë hoxha**, gjatë muajit të ramazanit, për mevlud, për iftar, për të shtatat, për të 40-at, për syneti, për martesa, për ditën e varrimeve, ndërkaq profesorin se përfill askush.

Nëse dikë e kam komshi dhe me vite nuk hy as nuk dal me të, atëherë atë nuk e kam kurrfarë komshie, dhe kjo nuk është normale…

ꕥ

Mosha e pubertetit është revolucion fiziologjik për fëmijën, dhe nuk të shkon fytyra nëse dikujt i tregon se të

ka ra gripi, nëse vajza është rritur etj. Dhe kur dikush dëshiron të jetojë nga fëmijët është EGOIZËM, ndërsa kur fëmijës ia jep njërën veshkë, atëherë ky është kulmi i shpirtmadhësisë. Ndonjëherë mjekun e akuzojnë vetëm pse e ka thënë të vërtetën, sepse ai është mjek e jo VETERINAR. Sepse po t'i thuhet e vërteta pacientit, ai vdes nga frika, dhe kështu një mjek i tillë i keq bën atentat mbi pacientin e tij. Ne sot kemi mijëra sharlatanë të tillë me diploma, siç i quante të tillët Zhan Zhak Rusoi.

ꕥ

Çfarë mund t'na thoni për Materializmin dialektik e historik?

Së pari duhet ditur se **BOTËKUPTIMI** është tërësia e pikëpamjeve që kanë njerëzit mbi botën-pikëpamjet e tyre filozofike, politike, estetike, fetare etj., prej të cilave kanë rrjedhur edhe veprimet e qëndrimet e njerëzve ndaj REALITETIT të kohës së tyre, ndaj njerëzve të tjerë, ndaj sjelljeve të veta...Botëkuptim është edhe FEJA, e cila me dogmat, besimet e ritet e saj përfaqëson një kuptim të caktuar mbi botën, veçse një kuptim krejtësisht të shtrembër, fantastik e antishkencor...Filozofia materialiste kërkon që bota të shpjegohet me ligjet e saj të brendshme, pa iu drejtua ndonjë fuqie të MBINATYRSHME. DIALEKTIKA(Nga greqishtja e nome-dialego, që do të thotë-të diskutosh, të polemizosh për të gjetur të VËRTETËN...) dhe METAFIZIKA(Meta ta fizika, që do të thotë-ajo që vjen pas fizikës, është metodë e gabuar dhe antishkencore, armë e filozofisë borgjeze) janë dy metoda të kundërta filozofike....Forma më e lartë e **materializmit filozofik është materializmi dialektik e historik** që lindi në mesin e shekullit XIX që lidhet me emrat e udhëheqësve të mëdhenj të proletariatit botëror-Karl Marksit dhe Fridrik Engelsit.

DIALEKTIKA është SHKENCË, jo pallavër, është shkenca që studion ligjet më të përgjithshme të lëvizjes e të zhvillimit të natyrës, të shoqërisë dhe të mendimit; metodë shkencore e njohjes që i sheh sendet dhe dukuritë në lidhje e varësi reciproke, në lëvizje, në ndryshim e në zhvillim të pandërprerë, që pranon kontradiktat, unitetin e luftën e të kundërtave në natyrë, në shoqëri e në mendimin njerëzor. Kemi dialektikën e natyrës, dialektikën e njohjes, kategoritë e dialektikës, mendimi dialektik, i kundërt me mendimin metafizik etj. Për shembull: kur themi – **armiku i armikut tim është MIKU IM**, ose – miku i armikut tim është – ARMIKU IM. Pra sipas parimit negativ del se + 1000 x – 1= -1000, sepse një minus është e barabartë me një minus, dhe nëse 100 vjet ke jetuar me dikë dhe ia ke bërë një milion të mira, por në çastin e fundit ia ke bërë një **TRADHTI**, atëherë **një milionë të mira** të deriatëhershme kanë bien në ujë. Pra te dialektika varet nëse është shumëzim, zbritje, pjesëtim apo mbledhje, ndërsa me logjikën e jetës, kur thua – e kam mik filanin, kjo nënkupton kushtet e njëjta, pra vetëm nëse nuk ndryshojnë kushtet e rrethanat. Ashtu si edhe **BESA** e cila mbahet vetëm përderisa rrethanat janë të barabarta, dmth **kur të dy palët janë besnikë** dhe i plotësojnë kushtet e besnikërisë, dhe asnjëra palë nuk ia bën tjetrës me hile. Ndërsa në çastin kur ky raport prishet, dhe njëra palë punon me hile, atëherë kjo nuk është besnikëri njerëzore, por e **QENIT**. Si puna e truprojave kryesore të mbretërve, siç ishin në shumë raste shqiptarët, sepse ishin besnikë si qeni, dhe kjo mund të quhet **BESNIKËRI E VERBËR,** që do të thotë – po e ruan xhelatin, tiranin, të zezën tënde, armikun tënd. Një besnikëri të tillë e ka edhe qeni, i cili edhe kur e godet zotëria, kur ia jep një shqelm, nuk hidhërohet, e duron dajakun. Ndërsa puna është të jesh besnik si njeri, e jo si qen. Kur thuhet psh. ia kam dhënë besën xhelatit, Mehmet Ali pashë Maxharit, Abdullah Pashë Drenit, se gjoja ai na paska rënë në besë, dhe se nuk guxojmë ta presim mikun në besë?! Kjo është njësoj sikur

të te kërkojë besë vrasësi që ta ka vrarë djalin, dhe ti atë e mbron nga të tjerët duke u thënë – mos e prekni se më ka ra ndore, dhe nuk mundem me e pre në besë?! Kjo quhet primitivizëm, e zeza e vetes, dhe për të tilla mikpritje te fiset indiane, te ACTEKËT e Meksikës, shkruante shkrimtari Gjon Rid (Indianët e Amerikës kaluan në ato vise para 20.000 vitesh, kur klima ishte më e butë se sot, të ngjashëm me racën mongoloide).

ꕥ

Ne sot e kemi nxjerrë në plan të parë FENË, e jo KOMBIN, dhe thonë – lumë ne qe jemi katolikë, lumë ne që jemi myslimanë ose ortodoksë, e nuk jemi shqiptarë?! Nga kjo del se **FEJA ËSHTË SOT TAKSIRATI MË I MADH I YNI!** Po kush i ka fajet? Dihet se gjithmonë fajin e ka ai i cili **e lejon tjetrin me ta mashtrojë, ta gënjejë**. Pra është vetë padituria jonë ajo që po ua bën të mundur atyre që ende t'na mashtrojnë. Ne bile, mund të themi, se më mirë i kemi pasur punët në këtë aspekt në kohën e Vaso pashë Shkodranit, i cili në poemën manifest – O MOJ SHQIPNI, shkruante:

Mos shikoni kisha dhe xhamia, se feja e shqiptarit është – SHQIPTARIA!

E sot, ku jemi ne shqiptarët e Kosovës? Askund!

ꕥ

A mund të na thoni diçka për pellazgët?

Populli PELLAZG ende nuk është definuar tërësisht në pikëpamje shkencore. Prej tyre janë diferencuar ILIRËT dhe THRAKASIT, dhe ata e kanë pasur një sistem kulturor që është quajtur – KULTURA MIKENE (Merreni dhe lexojeni librin e Zahari Majanit – MISTERI ETRUSK). Dhe këtu qëndron shkaku pse Serbia sheh rrezikun e saj nëse pranon etnogjenezën ILIRE të

shqiptarëve. Dhe haptas po thonë se neve dëmtohemi nëse e pranojmë një teori të tillë (Dr. M. Jankoviq etj.). Thrakasit shtriheshin deri në Odesën e sotme, deri në DARDANELE (nga fjala shqipe – DARDHA). Kryeqyteti i DARDANISË ka qenë SHKUPI, i cili është një emërtim i lashtë – 2000/3000-vjeçar, sepse germën – SH nuk e kanë as grekët as latinët. Sepse nuk thuhet – SKIPE – skipetar, por – SHQIPE – SHQIPTAR, dhe thuhet – SHTRENJTË, e jo STRENJTË (STRIKTUS – latinisht), SHKRIM, e jo – SKRIBO (latinisht). Nga kjo del fakti se **shqiptarët u kanë shërbyer popujve të tjerë si BRUMË**, si SUBSTRAT, sepse nuk e patën shkrimin e tyre! Merreni me mend naivitetin kur thonë disa – shyqyr që nuk kemi qëlluar edhe me Fe shqiptarë, por vetëm me gjak?!. Pra po mendojnë se ne vetëm me trup jemi shqiptarë, ndërsa me shpirt – TURK, MYSLIMAN, ORTHODOKS, KATOLIK etj. , dhe kjo është një vetëdije e çoroditur, sepse edhe të krishterët po thonë – lumë ne që jemi katolikë e jo shqiptarë?!

KATHOLIKOS d.m.th. – besim i vërtetë;

ORTHODOKSIS dmth. – besim i vërtetë;

ISLAMIKË d.m.th. – besim i vërtetë;

PRAVOSLLAV – besim i vërtetë,

dhe kështu vijmë deri te RELIGJONI, që vjen nga RELIGIO – lidhje me perëndinë (RE – i ri; LIGO – ligament – lidhje, pra – rilidhje).

Dhe duhet ta dimë se te ne shqiptarët, më shumë se te askush tjetër, është bërë copëtimi, dezintegrimi, shpërndarja katastrofike e IDENTITETIT KOMBËTAR.

Por përballë kësaj fatkeqësie, nga e cila gjithnjë jemi TKURRUR, është sërish **një FAT i MADH** që nuk jemi zhdukur tërësisht, siç janë zhdukur shumë popuj tjerë. Dhe mu për këtë shkak po punohet me të madhe që sa më shpejtë të hapen FAKULTETET TEOLOGJIKE në Shkup dhe Prishtinë. Mirëpo, edhe nëse bëhet transfuzioni i gjakut religjioz, megjithatë damarët e trupit kombëtar nuk mund të transplantohen, as eshtrat, muskujt, ligamentet, e

siç dihet këto qëndrojnë më gjatë. Dhe këtu duhet ta shohim arsyen se pse sot po luajnë me ne si me arushën.

ꕥ

Profesor, si i shpjegoni sot masat që po ndërmerren në Maqedoni për kufizimin e lindshmërisë së nënave shqiptar

Duhet ta dini se një veprim i tillë diskriminues me masa administrative do ta ketë efektin e kundërt. Ashtu si te **LAVJERRËSI**, sa më shumë e shtyni në njërin kah, aq më shumë ikën në kahun e kundërt. Pra efekti do të jetë kontraproduktiv për autoritetet sllavo-maqedone…

ꕥ

Sa i përket fesë, në Shqipëri ka qenë më zi se te ne sot. Më shumë se askush tjetër po pengojnë këta të ashtuquajturit religjiozë me shkollë… Nëse X-Y-ni (p.sh.Dr. Sh. B., ose A. B.) , **i jep 10 milionë dinarë për ndërtimin e xhamisë në Therandë**, ose për ta pikturuar falas xhaminë e re, të gjitha këto veprime te masa e pavetëdijshme e bëjnë efektin e vet, bile më tepër se sa divizionet e armikut, sepse populli ynë nuk i takon vetëm një organizate kishtare, por katër organizatave, dhe kjo gjë neve na ka kushtuar me shekuj, dhe na ka sjellë në këtë gjendje në të cilën jemi sot. Për shembull, rumunët janë ortodoksë, hungarezët – katolikë, italianët – katolikë etj. Në epokat e mëhershme fëmijët janë pagëzuar, emërtuar, në kishë ose xhami, te hoxha, te prifti ose te popi (për ortodoksët), dhe kështu njëri e ka marrë emrin – Hasan, tjetri, Mark, dhe i treti Jovan, sepse te ne nuk kishte **organizatë KISHTARE SHQIPTARE**, siç i kishin popujt tjerë. Por është mrekulli se si ne para këtyre katastrofave **nuk jemi zhdukur fare** nga faqja e dheut, por ende jemi gjallë. Prandaj neve më shumë se asnjë popull tjetër duhet

të jemi vigjilentë, t'i hapim sytë dhe t'mos e thyejmë qafën në tepih. Dhe përkundër gjithë këtyre fakteve, për çudi, ne ende po i konsiderojmë si katër STOLI këto katër FERRA RELIGJIOZE, katër sektet fetare (Katolikë, ortodoksë, sunitë dhe shiitë). Dhe mu për këtë shkak e urrenin **Fan Nolin** dhe e quanin prifti i kuq. Pra puna qëndron se duhet ta njohim realitetin sa më mirë, ta shohim esëll, jo në ëndërr, jo në gjumë, jerm, jo me romantizëm. Dhe ende po na konsiderojnë shumë të rrezikshëm, të tmerrshëm, e dihet se njeriu më së shumti i frikohet **qenit të vet**, sidomos kur ai çartet, dhe atëherë atij duhet t'i jepet një plumb, përndryshe kë e kafshon, e helmon, e infekton dhe pastaj tërbimin e ke në derë. Por neve, edhe kur dikush bëhet SPIUN, jemi tolerantë ndaj tij. E do të duhej të silleshim sikur ndaj QENIT TË ÇARTUR, dhe jo ta mirëpresim dhe ta vendosim në ballë të oxhakut?!

Ne pothuaj në çdo shtëpi kemi elementë të **VARIOLËS RELIGJIOZE**. Ata që janë bërë vegla të pushtetit tiranik, ata janë paçavure, dhe armiku i njeh më mirë se ne vlerat e tyre prej paçavureje, por i përdorin për ta pastruar një fëlliqësi dhe në fund bashkë me atë fëlliqësi i gjuajnë edhe ato paçavure të pista… Armiku **i zhvillon me metoda dresimi tiparet e veçanta të shërbëtorëve të vet, zagarët e specializuar**, me teknikën e fjalëve para ekranit televiziv, dhe të krijohet përshtypja si të ishin patriotë origjinalë, jo të maskuar. Po pse ndodh kështu? Sepse ata janë të sigurt, e kanë shpinën e mbrojtur, dhe vetëm ata që nuk i njohin, mund të mashtrohen nga **fjalori i tyre patriotik** dhe u besojnë fjalëve të tyre plot dinakëri.

ꕥ

Kush mund të bëhet sot faktor politik?

Kushti i parë **për t'u bërë sot faktor politik** është që së pari **të mos jetë SHQIPTAR** prej nënës ose babait, së dyti,

të mos jetë aspak i edukuar në frymën e atdhedashurisë dhe shqiptarizmit, por që nga lindja të jetë edukuar në ambientin serbofil (Si Kolë Shiroka, Ali Shukriu, Remzi Kolgeci, Azem Vllasi, Sinan Hasani etj), dhe së treti, që t'mos i ketë "**helmuar**" nëna me ninullat si: Ti m'u bëfsh si Bajram Curri ose – Ti m'u bëfsh si Hasan Prishtina etj. Azem Vllasi nënë e babë i ka pasur shqiptarë, por është korrigjuar me martesën sllave…

ꕥ

Alternativa e Ivan Stamboliqit ishte që me të urtë e me të butë, **pa u prekë fare ana formale e AUTONOMISË së Kosovës, t'ia nxjerrin zorrët edhe asaj autonomie formale,** ndërsa Sllobodan Millosheviqi po i shpall luftë Federatës Jugosllave, në frymën e Bogosllovisë dhe Shën Savës, në frymën e ikonografisë mesjetare. Dhe po thonë se tapitë shpirtërore më të vlefshme janë kishat, të cilat më shumë se kurrë po u hyjnë në punë aq shumë për qëllimet e tyre raciste e pansllaviste. I LIGU MBJELL PANIKË, e mbulon psikoza e ligështisë, frustrohet…

ꕥ

A do të arrijnë këta shovinistë të tërbuar të na shkelin një ditë me tërë atë tërbim racist?

Jo, kurrsesi jo, sepse edhe pse jemi të përçarë dhe të paorganizuar, megjithatë **nuk jemi dele, nuk jemi idiotë**, bile edhe sikur ta merrnin pëlqimin nga Federata, dhe nga vëllai rusomadh, asgjë nuk mund të na bëjnë, përkundrazi, do të na **VETËDIJËSOJNË EDHE MË SHUMË**, do të na **ZGJOJNË NGA KY GJUMË I RËNDË,** dhe shembulli më shkollor për ne janë populli heroik VIETNAMEZ i cili i bëri ballë dhe e gjunjëzoi me turp edhe një superfuqi botërore siç është Amerika, e cila me gjithë atë armatim modern, me gjithë ato bomba napalm me të cilat bëri

shkrumb e hi Vietnamin (mbi 3 milionë të masakruar) u detyrua të ikën si zagarët, duke lënë 200.000 ushtarë në tokën e Vietnamit, dhe 60.000 të humbur (Por që të gjithë i ka shpallur dëshmorë?!)

Federata jugosllave po rezonon ndryshe: për shembull Franc Shetinci në një intervistë thotë:

„Nëse nuk ia zgjasim dorën Kosovës dhe shqiptarëve, atëherë ajo një ditë mund të bëhet **IRLANDË**, dhe do fillojë lufta fyte më fyt… ”

Mirëpo, Kosova nuk mund të bëhet as Irlandë, as Liban, sepse kjo nuk varet vetëm nga dëshira e Serbisë. Sepse këtu kryqëzohen sferat e interesit. Sepse këtu është pika më neuralgjike në Evropë, se ne jemi në **FYTIN e Evropës**, dhe me ne vetëm mund të provokohet lufta botërore. Ndërsa kjo nuk i konvenon asnjërës superfuqi, as amerikanëve, as rusëve, sepse në një zjarr të tillë do të digjeshin e do t'i linin eshtrat edhe vetë superfuqitë…

Millosheviqi po thotë – PO MA KËNDA KOSOVËN! (Kjo në serbisht thuhet – babi se snilo shto joj milo bilo (gjyshja ka pa ëndërr natën atë që e ka dëshiruar ditën).

Por, një gjë duhet të mos e harrojmë: nga kthetrat e armikut kurrë nuk mund të dalësh nëse je PRIMITIV.

ꕥ

Në qytet jeta është më e maskuar, më me doza, sepse atje nuk të thonë: për hatër tim rri sonte, ose merre edhe një kafshatë për hatër timin, por thuhet shkurt e shqip: Urdhëroni, kemi dëshirë t'na vini, na bëhet qejfi sikur t'na vini…

Fshatari është më natyror, sepse çdo okupator së pari i ka pushtuar qytetet e pastaj fshatrat, dhe në qytete i ka lënë të gjitha pisllëqet, të gjitha të zezat e veta, veset, çoroditjet, spiunazhin…

ꕥ

Kur është dënimi më i vogël?

Vetëm atëherë kur të dyja palët punojnë pa hile, janë të sinqerta, ndërsa rreziku më i madh është kur njëra palë punon pa hile, ndërsa pala tjetër me hile… Poashtu, rreziku është më i vogël edhe kur të dyja palët e dinë se po punojnë me hile, prandaj nuk mjafton vetëm zemërmirësia.

ꕥ

Hiri është detergjent natyror, me të cilin hiqet ndyrësia, papastërtia, dhe sërish kthehet në vegjetacion, dhe asnjë element nuk është më i pastër se hiri, më i pastër se sapuni, sepse paraprakisht ka kaluar nëpër zjarr. Dhe nënat, duke mos ditur se sa i pastër është hiri, u thonë fëmijëve të tyre – ik se i ke bërë duart me hi, je bërë pis, e nuk e dinë se duart lahen më së miri me hi.

ꕥ

Kur dikush na pyet: a jeni në punë, ne i themi – po, vetëm kur punojmë me pagesë, me mëditje, ndërsa nënës e cila punon tërë ditën, i thonë: ti nuk je në punë, e ajo u thotë – jo, nuk po punoj se jam amvise. E nuk e dinë **se një amvise vetëm me punët e shtëpisë i mban tri vende të punës, sepse punon 24 orë**. Pra është gabim kur dikë e pyesim – a po të punon gruaja…

ꕥ

Emërtimet Hasan, Hysen, Xhemail, Abdurrahman etj., nuk i mbajnë vetëm arabët myslimanë, por edhe arabët e krishterë. Edhe te ne emërtimet Teutë, Shkumbin, Bardhok, Dritan, Dritë, Agron etj. i përdorin si myslimanët, ashtu edhe të krishterët.

ꕥ

Këtu në trojet tona për 2000 vjet me radhë është zbatuar administrimi i okupatorëve të ndryshëm, dhe janë imponuar gjuhët e huaja, si latinishtja, greqishtja, turqishtja, serbishtja, pra gjuhët e okupatorit. Dhe kështu në zonat e qyteteve Shkodër, Prizren etj., 90% e popullatës e kanë folur gjuhën e okupatorit. Por edhe ata që kanë zbritur nga malet, qysh në brezin e parë e kanë mësuar gjuhën e okupatorit, gjuhën turke, sepse në gjuhën shqipe nuk mbahej kurrfarë administrate zyrtare. Por, a janë ata tërësisht fajtorë për këtë gjendje? Jo, sepse rrethanat historike ua kanë imponuar një gjë të tillë. Ose p.sh. **kur flet shqip, por mendon turqisht, ose flet shqip, e mendon serbisht**, si pushka pa mekanizmin për shpërthim, pa gjilpërë. Pra ne edhe sot e kësaj dite jemi e zeza e vetvetes, jemi **VARRTARË POTENCIALË të vetvetes.** Dhe kur ndodh që dikush ta bën një të mirë, psh. të merr në makinë, dhe ti pastaj i thua: sa me fat që jam, ma solli makinën para këmbëve baba sheh, ma solli zoti, duke ia humbur nderin atij që ndaloi veturën, ose kur thua psh., se më kanë shëruar baballarët, e në të vërtetë të ka shëruar mjeku, e me iluzione të tilla mashtrohet një botë e tërë të mjerësh, atëherë mund ta merrni me mend se ku jemi.

ꕥ

Para 3200 vjetëve është shkruar për shqiptarët, ndërsa para 543 vjetëve është shkruar relacioni i Atë Gulielm Adae-s, Brokardit të Monakos, se shqiptarët janë një popull që e flasin gjuhën shqipe, por që në të gjitha shkrimet e tyre përdorin shkronjat LATINE… Meshari u shkrua nga Gjon Buzuku më 1555, por nëpër arkiva kemi shkrime edhe më të hershme.

ꕥ

TEQE, është fjalë persiane, TAKIE, sepse gjuha e parë botërore ka qenë persishtja, pastaj gjuha greke, dhe në fund latinishtja dhe arabishtja…

Biblioteka më e njohur në botë është ajo e Vatikanit, në të cilën rastësisht Nikolla Jorga e zbuloi **FORMULËN E PAGËZIMIT**, dokumentin e parë në gjuhën shqipe (1462). Ndërkaq deri më 1908, deri në Kongresin e Manastirit, ne nuk kemi pasur as alfabet tonin, por kemi shkruar me alfabetin arab, turk, latin, grek, sllav – çirilicë etj. Nëse **ndonjëri e quan veten shqiptar e i vjen turp të flasë shqip, është njësoj sikur të na vijë turp pse i kemi DY SY E DY VESH**. Pra vetëm **i ligu turpërohet prej gjerave të mira**, prej nënës që e ka lindur e ka rritur. Ndërsa ty të vjen turp ta shohësh me rrobat e moçme kombëtare, prej gjuhës së saj të bukur, në vend se për të gjitha këto të mburresh dhe të krenohesh… Duhet të turpërohesh nga moda, stili, veset, gjuha, shprehitë, të zezat që t'i ka lënë armiku në derë, e jo nga thesari popullor, nga të mirat e trashëgimisë kombëtare të gjyshërve e stërgjyshërve tanë…

ꕥ

Edhe trimi më i madh nuk mund ta zërë një plesht në terr...

ꕥ

Pse t'i paguhet hoxhës tatimi nga droja se kur të vdesësh nuk ka kush të te lajë, gjersa dihet se bashkë me trupin ka marrë fund edhe shpirti, dhe i vdekuri nuk mund të dijë asgjë pas vdekjes së tij, ndërsa pasardhësit e të vdekurit do të çnderohen nëse nuk do ta varrosin të ndjerin. Këta hoxhallarët tanë janë POLICË me rroba fetare, dhe e gëzojnë përkrahjen e popullit NAIV, dhe së dyti, e gëzojnë përkrahjen e pushtetit …

Më 1912 shteti shqiptar ishte sa për sy e faqe, pra ishte **shtet formal,** sepse nuk kishte as shkolla. Sot po

investohet me të madhe në përçarjen e popullit mbi baza të sekteve fetare, sepse edhe sot kemi mjekë, mësues e profesorë të cilët shkojnë në xhami e kishë, dhe falen dhe agjërojnë… Shqiptarët bëjnë sot katër lloj lutjesh, katër lloj festash fetare…

Edhe Naim Frashëri ishte besimtar, ishte fetar, por ishte një patriot shumë i madh, i pashoq, dhe kurrë nuk i identifikonte FENË me ATDHEUN. Dhe të tillë si Naimi në atë kohë ishin shumë të rrallë – një në 1000 vetë, që do të thotë një promil…

ꕥ

I FORTË ËSHTË AI I CILI NUK THOTË NË FILLIM FJALËN QË DUHET TA THOTË NË FUND...

ꕥ

A ia vlen barra qiranë të bashkohen dy Gjermanitë, dhe të krisë lufta botërore? Po ku do të mbeten Austria dhe Zvicra të cilat janë "NEUTRALE", të TREDHURA? Por kjo mund të arrihet në një të ardhme, me kompromise të dyanshme, por kurrë me luftë, se nuk kanë hesap!

ꕥ

FEJA ka ndikuar pozitivisht në emancipimin e disa popujve, siç janë grekët, serbët, polakët etj., sepse te ata janë **IDENTIFIKUAR KISHA DHE KOMBI**. Kisha ortodokse serbe nën mbrojtjen e shtetit, dhe Millosheviqi dhe patriarku German janë të njëzëshëm… Sot edhe qenit serb t'i thuash – qyp, do ta marrish dënimin së paku dy muaj burg me akuzën – irredentist. Një gjë e tillë kurrë nuk ka qenë më parë… Kosova nuk është Irlandë, dmth. një vend prapa gardhit, sepse ne jemi pikë strategjike tejet neuralgjike në epiqendër të Evropës…

ꕥ

Edhe pas 3000 vjetëve ne ende nuk kemi arritur të bashkohemi deri në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 1878. Pra nuk mjafton vetëm të thuash se jam shqiptar. Për ta bërë përsheshin nuk mjafton vetëm buka, por duhet edhe kosi, tambli ose ciku, prandaj përçarja është armë në duart e armikut, **FEJA është armë në duart e REAKSIONIT.** Diagnoza nuk vlen as pesë para nëse nuk e gjejmë edhe barnatoren me ilaçe, e pastaj ta detyrosh të te sëmurin që të shërohet, e jo të thuash – dhashtë zoti e shërohemi… Vetëm Shqipëria ka arritur ta bëjë revolucionin, **dhe me kushtetutë e ndaloi propagandën fetare** (për përhapjen e propagandës fetare dënohesh me 5 vjet burg të rëndë). Edhe kinezët tentuan përmes revolucionit kulturor ta ndalojnë fenë, por pas 8 vitesh u dorëzuan …

Çetnikët e Millosheviqit duhet t'i konsiderojmë si ujqër të TËRBUAR të cilët **më shumë se sa neve po e kafshojnë vetveten**. Të gjitha këto diskriminime janë pasojë e paditurisë sonë qysh gjatë Luftës së Dytë Botërore, sepse në emër të KOMUNIZMIT neve na kanë mashtruar shumë keq duke na thënë: **NJË HERË PO BASHKOHEMI TË GJITHË – UJQËR E DELE, DERI SA TA FITOJMË LUFTËN KUNDËR ARIUT FASHIST, I CILI PO DON TË NA HAJË TË GJITHVE, E PASI TË PËRFUNDOJË LUFTA, SECILI DO TA ZGJEDHË RRUGËN E VET**…

Por edhe sot duhet ta dimë se planet e ballistëve të dikurshëm, agallarëve, bejlerëve, pasanikëve, që janë vetëm ujqër – parazitë, sepse kurrë nuk kanë qenë për një Shqipëri PROLETARE, por për çifligje e poste të majme, u ka kaluar koha përgjithmonë. PROBLEMI I ZGJIDHJES SË ÇËSHTJES SHQIPTARE është shtruar GABIM, në mënyrë IRRACIONALE, sepse **kurrë nuk mund të bashkohen ujqër e dele kundër arushës**, dhe duhet të jesh popull shumë primitiv për t'u besuar premtimeve me hile me të cilat na ka mashtruar armiku i moçëm…

ꕥ

REVOLUCIONIN NË SHQIPËRI e kanë bërë fshatarësia me inteligjencën në krye me Enver Hoxhën.

ꕥ

Po ju profesor që ishit pjesëmarrës në luftën antifashiste a e keni admiruar këtë qëndrim revolucionar?

Po, si jo, sepse kur më arrestuan kuestura italiane dhe më futën në burgun e Tiranës, unë u mahnita me qëndresën dhe heroizmin e atyre burrave dhe grave ilegale nga Toskëria, të cilët na flisnin me besim të patundur për fitoren e sigurt që do të na sillte e nesërmja…

Në këto kushte, siç jemi ne sot, lufta mund të jetë katastrofale, jo vetëm për neve, por për tërë Ballkanin dhe Evropën. . Prandaj askujt nuk i konvenon të digjet në zjarrin e një lufte botërore…

Nga kjo del se, ashtu si në çdo luftë tjetër, edhe në luftën tonë të fundit (1941-1945) mungesa e vetëdijes dhe pjekurisë klasore ka bërë që **FRYTET E GJAKUT TË DERDHUR PËR LIRI DHE BASHKIM** **të 113.000 dëshmorëve e martirëve** nuk i gëzuan punëtorët e fshatarët e varfër, por reaksioni i maskuar, i bërë tebdil. E dihet se LIRIA nuk pajtohet me reaksionin, me tiraninë.

ꕥ

Po si mund ta fitojmë këtë luftë nga pozicioni i realitetit të sotëm?

Asgjë nuk mund të fitohet veç e veç, me një gisht, por duhet bërë grusht, duhet bërë një. Dhe ky **GRUSHT I BASHKUAR** të shtrëngohet aq shumë sa t'ia thyejë

dhëmbët armikut që ai të marrë mësim një herë e përgjithmonë se nuk ka hesap të na mbajë nën sundim. Shqipëria **nuk do mund të luftonte 14 muaj vetëm me idealin e atyre pak çelulave të partisë komuniste, vetëm me idealin e partisë,** po të mos kishte shpërthyer revolucioni edhe në Greqinë Veriore dhe në Jugosllavi. Deri më 1949 popullsia sllavofone në Greqi ishte në anën e Partisë Komuniste Greke, ndërsa grekët në Greqinë Jugore ishin kundër kësaj partie, sepse aty ndërhynë anglezët dhe aty dështoi revolucioni grek. Prandaj edhe te ne në këto rrethana, lufta mund të fitohet vetëm me një kusht: nëse kundër reaksionit, borgjezisë, politbyrokracisë jugosllave do të ngriten proletariati i bashkuar kroato-slloven, serbo-malazez, maqedono-boshnjak, kosovaro-vojvodinas, dhe kurrsesi të vetmuar, sepse nuk ka klasë punëtore nacionale, kur dihet se **brenda të njëjtit komb i kemi dy kombe: KOMBIN shtypës dhe KOMBIN e shtypur**. Prandaj duhet ta dimë se interesat e proletariatit nga Nikaragua e deri në Filipine, nga Zimbabveja e deri në Kosovë janë një, janë të barabarta, sepse pa realizimin e luftës së proletariatit si klasë hegjemone e cila do e marrë pushtetin, si **DIKTATURË E PROLETARIATIT**, në këto treva, veç e veç nuk mund t'ia shohim hairin revolucionit. Në secilën etapë historike ne po jetojmë më ndryshe. Të shkojmë sipas kronologjisë:

1912-1941;
1941-1945;
1945-1948;
1948-1966;
1966-1981;

1981 e këtej, pra që nga viti 1974 ne jetojmë **100%** më ndryshe nga vëllezërit tanë në Shqipëri… Dhe mos të harrojmë se rrënja e të gjitha të zezave, të gjitha të këqijave, është **PRONA PRIVATE**, Këtu te ne edhe edukatorja në klasë mendon se sa vezë do t'ia bëjë pula, dhe **nuk i vjen turp e në klasë thur edhe çorape**, ose qëndis me gjilpërë, ndërsa fëmijën e kërcënon me gjilpërë

nëse nuk është i disiplinuar, dhe nuk e prish rehatinë duke pirë kafe?! Ndërsa në Shqipëri, po të ndodhte kjo gjë, dmth. të kapet mësuesja duke mbaruar çorapë në orën e mësimit, do ta dënonin me 6 vite dënim të rëndë.

ꕥ

Për sa mund të jemi ne përcaktues të fatit tonë?

Deri në 10% mund të varet nga vetja jonë, por më se 90% varet nga faktorët jashtë vetes sonë, sepse njeriu është produkt i natyrës, produkt i rrethanave tipike, dhe mund ta humanizojë natyrën më së shumti 10%. Pra këtu kemi të bëjmë me ndërvarësinë reciproke. Ne e krijojmë fëmijën, por edhe fëmija na krijon neve, sepse ende pa lindur fëmija e modifikon nënën, ndërsa kur të lind, gjiri i nënës, gjithë ato net pa gjumë, vaji i fëmijës, të gjitha këto janë proces edukimi i vetë nënës.

Për shembull kolaboracionisti Halit Tërnavci është një promil, pra shumë pak, por po bën punë, dhe kështu vetë rrethanat shoqërore në të cilat rritet personi i caktuar e përcaktojnë orientimin ideologjik të atij personi. Tërnavci është instrument në duar të një grupi ekstrem reaksionar të shtetit serb, e jo të kombit serb. Dikush mbaron qylahë, por vetë nuk i mban, dikush tjetër mbaron opinga, që janë të përshtatshme për mal, por vetë mbathë këpucë që janë të përshtatshme për qytet…

Pra edhe sëmundja nuk mund të largohet me IRRACIONALITET, me fantazi, por me **ilaçet** përkatëse… Edhe gjerat religjioze njerëzit naivë i marrin si absolute derisa t'mos e kuptojnë një ditë se të gjitha ato janë gënjeshtra.

Më 4 tetor 1987 e përditshmja e Beogradit "POLITIKA" shkruante se duhet të varen në litarë gjithë ata të cilët e kanë përgatitur kundër-revolucionin në tri faza: 1941-1945, 1945-1974, 1974-1981, dhe ky është programi i hartuar nga AKADEMIA SERBE E

SHKENCAVE, duke përfunduar se Fadil Hoxha, Ilija Vakiqi, Veli Deva, Ymer Pula, Xhevdet Hamza etj. duhet sa më parë të dërgohen në burgun e Goli Otokut. Pra ky ishte mendimi i SHTABIT ÇETNIK, në rrugën FRANCUSKA 7 të Beogradit. Zbatues i programit të këtij shtabi janë Bullatoviqi me shokët e tij, por është FAT i madh që ata nuk mundën t'i gjejnë edhe nja 100 Halit Tërnavca me fakultet… Pra puna është ende mirë për neve, sepse do të ishte absurde që Kosovës t'i rikthehet statusi i vitit 1945, me një strukturë të sajuar të rrejshme: me 65 % serbo-malazezë dhe 35% shqiptarë, pra të kthehet në statusin e autonomisë kulturore. Duhet të presim dhe të shohim se çfarë do të ndodhë edhe 14 muaj, deri në qershorin dhe shtatorin e vitit 1988, dhe të shohim se çka po synohet më tej? Ndërsa dihet se ata po planifikojnë që përmes Fadil Hoxhës e të tjerëve, të goditet vija Federative, vija Tito-Kardel, dhe të mohohet legaliteti i AVNOJ-it, dhe kjo për faktin sepse Titua nuk e dënoi, por e la gjallë Aleksandër Rankoviqin. Sot Serbia është për 20% më e madhe me territor se sa që ishte para 100 vitesh. Dhe hapi i parë është heqja e Fadil Hoxhës, e pastaj vijnë hapat tjerë…

ꕥ

Këto revista fetare te ne (katër revista) ta kujtojnë kohën e sundimit të satrapit Ahmet Zogu. Fadil Hoxha çirret me sa zë që ka duke thënë:

„**Atje në Shqipëri nuk kanë as DIN as IMAN,** ndërsa ne i kemi të gjitha, edhe kishat, edhe xhamitë, edhe hoxhallarët, edhe priftërinjtë?! Tani Federatës jugosllave po ia rrahin KËLYSHIN, sepse ajo ishte kapur për të si e keqja më e vogël. Fadili nuk ishte kurrfarë fenomeni, por është shumë e çuditshme se si popullit iu deshën 40 vjet që ta kuptojë se çfarë BETERI e ka përfaqësuar dhe ka folur në emër të tij në Federatën jugosllave (Fermë e bollave dhe gjarpërinjve për shqiptarë). Për shembull fëmijët e

Mehmet Hoxhës të gjithë janë martuar me serbë, dhe mu për këtë shkak varrimi iu bë në Beograd, ndërsa Elhami Nimani (vëllai i Xhavit Nimanit), është martuar me vajzën e vëllait të priftit serb të Bogosllovisë në Prizren. Pastaj, kush ua dha lejen grave serbo-malazeze të dalin në demonstrata në Kosovë? Ua dhanë Mamulla, Mojsovi, Millosheviqi, dhe kështu po del se qëllimi i arsyeton mjetet për luftën psikologjike, me një efekt makiavelist. Sundimtari më i mbrapsht është ai i cili as nuk vret, as nuk pret, se i kujtohen fëmijët e tij, e dihet se sa i ka kushtuar Gjermanisë Hitleriane një sistem i tillë makiavelist nga viti 1933-1945.

ꕥ

Profesor, çfarë mund t'na thuash për POLITIKËN si shkencë?

Politika është vazhdim i luftës, pjesë e luftës, por me mjete tjera, siç do të thoshte Klauzevici. Mirëpo edhe nëpër flakët e luftës ushtarët pas dy orë lufte frontale, një orë i lidhin plagët, dhe pastaj dy orë bëjnë mësim POLITIK. Pra asnjë luftë nuk është bërë pa u përzier në të politika. Dhe më saktë, sipas Leninit, **POLITIKA është shprehja më e koncentruar e ekonomisë**. Luftërat e drejta, çlirimtare janë luftërat e popujve për ta hequr zgjedhën e robërisë kolonialiste, ndërsa luftërat e padrejta janë ato luftëra që bëhen për të pushtuar dhe shtypur popujt.

Amerikanët e kanë standardin e lartë, dhe nuk mendojnë ta bëjnë dekën në luftime, por mendojnë vetëm për t'i gëzuar të gjitha këto të mira të kësaj bote. Ata mendojnë për vete, jo për tjetrin, ndërsa kur të zhvillohet lufta, siç ishte ajo në **Vietnam**, atëherë i rekrutojnë mercenarët, të varfrit, dhe jo fëmijët e tyre. Ata bëjnë çmos vetëm të grabisin nga situatat konfliktuoze në botë, ta kapitalizojnë edhe luftën për të mbizotëruar tregjet, sepse lufta vetëm me bombardime nga aviacioni është masakër, gjenocid, nuk është luftë, nuk është luftë frontale…

Për të gjitha këto gjëra për të cilat ne nuk po dimë gjë, sepse edhe dje nuk i kemi ditur, ne sot **po e paguajmë kamatën**, dhe nuk duhet kërkuar ato gjëra që nuk mund të realizohen. I mençuri shumë më vështirë e vret dikë, e shan apo ofendon, ndërsa i forti thotë: e bëra veprën, e bëra fajin, qe ku jam, jepmani dënimin e merituar, **ndërsa i ligu ik, nuk e pranon fajin, por shkon e bashkëpunon me armikun...**

ꕥ

LIGJËRIME, 6 shkurt 1988:

Ushtarët izraelitë e kapën një vogëlush palestinez 5-vjeçar i cili po i gjuante me gurë, dhe e pyetën: trego kush po të mëson të na gjuash me gurë? Vogëlushi u përgjigj shkurt: AHMATI. Ndërsa ky ishte një fëmijë 3 vjeç. Kjo do të thotë se në Palestinë edhe **fëmija 3 vjeç po e di se cili është armiku i palestinezëve...**

Sot në SHBA 180.000 firma prodhojnë armatim, ndërsa në BRSS i kemi 130.000 ndërmarrje të cilat prodhojnë armatim, sepse tregtia me armë e këtyre dy superfuqive ka përparësi të madhe, sepse nga shitja e armëve ato fitojnë miliarda dollarë… Por vendet që i blejnë këto armë nuk e dinë se ato armë janë LAK NË FYTIN e vendeve që i marrin ato armë, sepse përmes tyre garantohet ekzistimi i pushteteve reaksionare, regjimeve diktatoriale borgjeze e fashiste… Pas Luftës së Dytë Botërore u zhvilluan **150 luftëra** e konflikte dhe si pasojë kishte mbi 35 milionë të vrarë… Dhe këto luftëra nuk pushojnë sa në një vend në një vend tjetër…

ꕥ

LIGJËRIME, 20 shkurt 1988:

Para lufte 20 kokrra vezë të fshatit kushtonin 20 cigare, ose një kilogram mish mështjerre, pra veja shërbente në vend të monedhës, dhe aso kohe edhe pse shkollimi nuk

ka qenë masovik, nuk janë aplikuar mashtrimet naive, ndërsa këto mashtrimet e sotme janë mashtrime me shkollë, dhe dëmi i tyre është shumë më i madh se sa në atë kohë…

I mençur dhe i dijshëm janë sinonime, i MENÇUR – inteligjent, por pa shkollë, ndërsa i DIJSHMI është i shkolluar; savant (frëngjisht) – **i dijshëm – dijetar**, i cili e ka aplikuar inteligjencën, dhe secili pushtet më së pari i blen e pastaj i eliminon njerëzit e dijshëm, dhe kështu paguhet çmimi më i lartë…

Luigji Pirandelo, shkrimtar dhe historian i shekullit XX, tregon: Hyn arsimtari në universitet dhe thotë: mirëdita kolegë të rinj, pastaj vazhdon ligjëratën dhe i mban dy orë (80 minuta), por kur mbaron ora, në mësonjtore nuk ka asnjë student, sepse **ligjëruesi më shumë i ka folur vetes** se sa studentëve. Kësi lloj mësuesish sot kemi sa të duash …

… Kur ia ngulit dhjetë ditë sytë vetvetes, atëherë edhe po të duash nuk mund të lëvizësh nga vendi, dhe kjo është **AUTOHIPNOZË**. Pra nevojiten shumë komponentë për ta fituar atributin i MENÇUR, sepse mençuria nuk ka fund… **INTELIGJENCË intuitive**, praktike, të tillët kanë sukses, si doktor, në të sunduar…

Paraguai qe 40 vjet nuk pranohet as në OKB, as nëpër komisione, pastaj Nepali, Butani… Pra duhet t'i marrim globalisht e jo të izoluar. Në vendet e Amerikës Latine SHBA-ja ka llogari t'i vërë në pushtet ata njerëz të cilët i kanë ruajtur buallicat… Ndërsa kur vjen puna për luftë, atëherë i marrin të fortit.

I URTI kur u jep këshilla të tjerëve mjafton që po i porosit se çka duhet bërë.

ZARATUSTRA vetëm ka folur teorikisht, dhe përgjigjet: s'është e mundur me të thënë e me të bërë, nuk mund të sitet mielli, dhe sasia e miellit sërish të mbetet e njëjtë…

Mari dhe Pjerë Kyri nuk e kanë marrë me mend se nuk do të lejonin të shpallen zbulimet e tyre, pra **shkolla pa praktikë humbet, firon, bëhet përrallë...**

Mjaftuan ata 0, 5 litra DEUTERIUM, për ata 500 gram të bombës së parë atomike (hidrogjenike), dhe bashkë me Nils Borin në laboratorin e Maria Kyrisë po përgatitej mjeti për ta zhdukur njerëzimin…

Me ne do shkojë shumë FIRO, sepse kemi ndjenja të mbrapshta, ngase fatkeqësinë e tjetrit e shohim si NGUSHËLLIM?!

Ezopi është bërë i gjymtë si skllav, me gungë dhe me dorë të përdredhur, dhe namin e tij ai e ka paguar shumë shtrenjtë. **Në histori nuk mund të hyjë gjithkush e të mos dalë**, sepse duhet të jesh i fortë dhe ta paguash çmimin…

Rene Dekarti është filozofi më i fortë që ka dhënë Franca, i cili ishte një aristokrat i padegjeneruar.

DYSHIMI është parakusht për shkencën, sistemi kartezian, aplikimi i algjebrës në gjeometri, dhe i gjeometrisë në algjebër, dhe sot, në bazë të këtyre të arriturave, njeriu mund të shkojë edhe në hënë, ndërsa astronomia nuk është e mundur pa atë pjesë…

Dekarti ishte përfaqësues i RACIONALIZMIT, dhe predikonte vazhdimisht që arsyeja të aplikohet në shkencë, dhe nuk ndalej në cikërrime.

Pikësëpari duhet të hiqen morrat e pleshtat e viruset e pastaj të mendohet nëse morri e virusi kanë shpirt…

Ndërsa Spinoza e ka aplikuar gjeometrinë në Etikë, dhe që të dytë e kanë paguar rëndë. DEKARTI ka ikur, ishte 20 vjeç kur inkuizicioni e dogji në turrën e druve filozofin **Xhordano Brunon** (më 1600), sepse e internuan për gjashtë muaj në burgjet e Suedisë, dhe shpëtoi në arrati... Pra nuk u dogj si Bruno në turrën e druve nga inkuizicioni sepse në librin-DE LA CAUSA PRINCIPIO ED UNO V,1584, kishte thënë, veç tjerash, se:

BOTA ËSHTË PASOJË E PAFUND E NJË SHKAKU TË PAFUND, DHE SE HYJNIA ËSHTË E AFËRT DUKE QENË

SE ËSHTË BRENDA NESH EDHE MË SHUMË SESA NE QË JEMI BRENDA VETVETES...!

Mendja është fuqi kuptimore, ndërsa arsyeja aplikohet, i kupton gjerat, se vetë nuk është aplikative. Arsyeja i merr dhe materializohet mendja. Kanti: nuk ka njëri pa telashe, njeri me shëndet të lig, me kurriz të hendikepuar, ndërsa DEKARTI ishte shumë praktik, jo si Kanti, dhe është frymëzuar nga Zhan Zhak Rusoi…

ꕥ

Profesor, a i keni lexuar letërkëmbimet e K. Marksit ?

Letërkëmbimet e Marksit në katër vëllime arrita t'i lexoj para 30 vitesh, dhe kuptova se ai në fillim ishte kundër Komunës së Parisit, sepse e shihte të pamundur **FITOREN**… Mirëpo pas fitores së komunarëve për 72 ditë, Marksi këtë e quajti FITORE DERI NË QIELL! Në Komunën e Parisit kishte **20-30 marksistë**, dhe 70 e ca Blankistë e Prudonistë… JAKOBINËT – ishin shumica revolucionarë borgjezë (bolshevikët e asaj kohe). Në letrën dërguar A.Ruges më 19 nëntor 18 44 Marksi ia jep këtë përgjigje:

"...Ju më pyesni: sa para bën? Revolucioni nuk bëhet nga turpi.-E unë them: **TURPI është tashmë një lloj REVOLUCIONI**;turpi është me të vërtetë **FITORJA** e revolucionit francez mbi patriotizmin gjerman që e pat mundur atë më 1813. Turpi është njëfarë zemërimi, vetëm se i drejtuar nga përbrenda. **Dhe në qoftë se një komb i tërë do ta kishte me të vërtetë ndjenjën e TURPIT**, ai do të ishte si një **LUAN**, që mblidhet i tëri para se të kësejë...

F. Engelsi pohon: "Ne kemi qenë nën ndikimin e shkencës borgjeze, e nuk i kemi kuptuar jakobinët, dhe ata **janë konsideruar si kriminelë, siç po na konsiderojnë neve sot**. Marksi dhe Engelsi qenë **mashtruar...**

ꝏ

Në Elaboratin e Çubriloviqit, projekt zyrtar shtetëror, me Ivo Andriqin në krye, ku tregohet se si duhet të shfarosen praktikisht shqiptarët, se si duhet spërkatur shtëpitë e shqiptarëve me benzinë, pasi t'i merrte gjumi i parë, dhe kështu duhet të digjen e të bëhen shkrumb e hi qytetet dhe fshatrat. Dhe të gjitha këto kanë qenë fshehtësi shtetërore deri më 1966, dhe që nga ajo kohë dokumentet u mikrofilmuan dhe u përhapën edhe në Kosovë. Më 1988 po vazhdon në 10 numrat e gazetës së përditshme – BORBA të botohet ELABORATI i racistit Çubrilloviq (Akademiku racist Vasa Çubrilloviq u dekorua në vitin 1976 për planin e tij të detajuar për dëbimin dhe zhdukjen masive të shqiptarëve të viseve nën sundimin jugosllav. Plani hyri në veprim menjëherë me rikolonizimin e Kosovës që nga viti 1945 e këtej… ËSHTË SINJIFIKATIVE LETRA E JOSIF V. STALINIT DREJTUAR PK TË JUGOSLLAVISË QË NË VITIN 1925 (SEKRETARIT TË SAJ – **SIMIQ) NË TË CILËN KËRKOHEJ QË KOSOVA TË KETË TË DREJTËN E VETËVENDOSJES DERI NË SHKËPUTJE**, në të cilën veç tjerash thuhej:

„… Në programin e partisë si bazë për zgjidhjen e çështjes nacionale duhet marrë PARIMI LENINIST i së drejtës së **VETËVENDOSJES, DERI NË SHKËPUTJE,** dhe jo kufijtë imperialistë të shtetit borgjez jugosllav të krijuar si rezultat i luftërave dhe dhunës… " (Shih – J. V. STALIN: "VEPRA", vëllimi VII, faqe 22, B.K.).

Dhe kështu AVNOJI nuk e linte për t'u zgjidhur çështjen e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare që kishin vuajtur nën zgjedhën e robërisë së Jugosllavisë së Karagjorgjeviqëve në bazë të parimit leninist të VETËVENDOSJES DERI NË SHKËPUTJE, por e proklamon se zgjidhja e saj gjoja do bëhet pasi të përfundojë lufta nacionalçlirimtare…

Krizën e socializmit nuk duhet absolutizuar, sepse edhe maja, tharmi i bukës, **gjithnjë duhet të përtërihet**, se po nuk u përtëri, atëherë do të krimbet, kalbëzohet…

Në kuptimin hegelian, çdo gjë është e qenë, çdo gjë është QENJE absolute e gjithëkuptimshme, e cila përfshin edhe padijen, injorancën, dhe kështu e mohon edhe vetveten, në bazë të logjikës dialektike… Dhe në këtë diferencim hegelian kjo mund të merret sikur në vend të albuminave, sheqernave, të marrim **DROGËN**, sepse po kemi dëshirë të na **zërë gjumi...**

ꕥ

Millan Kangerga po thotë se – Shqiptarët janë bashkim fisesh, por nuk duhet të absolutizohen gjerat, përkundër faktit se ka shumë elemente të strukturave të shoqërisë fisnore…

ꕥ

Kur nëpër xhamitë e Prizrenit po puthet **"qimja e mjekrës së Pejgamerit"**, dhe jo krejt mjekra (?!), me këtë gjest naiv gratë e Prizrenit **po e pështyjnë vetveten...**

Dhe nëse prej 1000 luleve, **vetëm një lule prodhon HELM**, si ushqim për gjarprin, kjo është e mjaftueshme… Mbi 400 vetë u korrën nga breshëria e mitralozave në Çabe, dhe gjithë viktimat e gjora u shpallën shehitë (dëshmorë)… Pra shteti BETER prodhon kësi betera, **shteti kriminel prodhon kriminelë**, shteti hajn prodhon hajna, banditë… Edhe Hitleri i ka pasur disa astrologë e magjistarë… Pas luftës **ai që është marrë me HIPNOZË** është përjashtua nga Akademia si sharlatan, ndërsa sot kjo nuk ndodh…, dhe për fenomenet parapsikologjike është komisioni eminent. Mediumi… po e lexon tekstin edhe përtej murit, në dhomën tjetër, dhe po e përshkruan fizionominë e njerëzve, ndërsa shteti po ndan buxhet për këto hulumtime parapsikologjike… **Pra këto gjera banale, si hipnoza, në shek. XX-të kanë qenë**

kompromettuese... Edhe gjarpri arrin ta hipnotizojë luanin e tigrin, e lëre më pulën e bretkosën, nëse ato **futën në fushën e rrezatimit** të tij hipnotizues, dhe këto tema ende janë TABU. .

Ndodh që njeriu edhe midis dhomës ta humbë orientimin dhe nuk e gjen as derën e dhomës. Kështu është kur i përgjithësojmë gjerat, sepse nuk vlen as pesë para ARSYEJA nëse na mungon **OKSIGJENI...**

Hebrenjtë e kanë bërë si simbol shteti **yllin gjashtëcepësh**, ashtu si faraonët para 3000 vjetëve… Magjistarët e kanë përdorur yllin gjashtëcepësh, astrologët, babilonasit, priftërinjtë e Babilonisë, NINIVA, e prej tyre e morën hebrenjtë, MAGËT. Prandaj duhet diferencuar dijet POZITIVE nga RELIGJIONI, pra: këndej tambli, e pastaj maza, dhe hirra, secila në vendin e vet… Dhe kështu ZBRAZËSIRËN duhet ta mbushësh me diçka. Mirëpo në vend të sanës, e mbush qerren me THERRA… Tertuliani thotë: BESOJ SEPSE NUK KUPTOJ… Por shkenca vepron në të kundërtën…

Sipas shënimeve të UNESKO-s, në botë kemi 889 milionë analfabetë, ndërsa në TPE (Tregun e Përbashkët Evropian) kemi 11 milionë; në SHBA – 24 milionë analfabetë, ndërsa në Afrikë 666 milionë analfabetë; pastaj në Azi dhe Amerikën Latine… Asaj shoqërie e cila investon në arsim, investimet i kthehen dhjetëra herë, ndërsa me arsimimin e masave, siç ndodh **në Shqipëri**, me një arsimim të shëndoshë socialist, masat bëhen të vetëdijshme për pozitën dhe detyrat e tyre në shoqëri. Më 1981-1988 në Shqipëri u investuan 37% më shumë e buxhetit, ndërsa vetëm në sferën e arsimit u investuan 25% më shumë…

ꕥ

Profesor, ju shkollimin fillor e keni kryer në gjuhën serbokroate në kohën e diktaturës së mbretërisë jugosllave. Na intereson të dimë se çfarë mësonit nga fusha e historisë, dhe çfarë thuhej për shqiptarët në ato tekste?

Po, na mësonin në ato shkolla edhe historinë, dhe për shqiptarët thuhej: **"ALBANCI SU POARBANASHENI SERBI – SHQIPTARËT JANË SERBË TË SHQIPTARZUAR?!"...**

Të mos harrojmë faktin se ne ende jemi analfabetë politikë, sepse nuk mund ta kuptojmë se çfarë është duke përgatitur Jugosllavia për neve – që ne të bëhemi **JUGOSHQIPTARË**/jugosllavë, si fazë e parë, e pastaj përmes jugo-shqiptarëve të "çlirohet" edhe pjesa tjetër e shqiptarëve në Shqipërinë administrative, e cila gjoja po vuan të zitë e ullirit nën diktaturën komuniste?! Ne jemi si PALESTINEZËT, bile edhe më shumë se ata, sepse jemi në Evropë, d.m.th. , jemi problem i Evropës, dhe jo vetëm i Jugosllavisë… Tani po ribotohet libri i dr. Vladan Gjorgjeviqit **"ARNAUTI I VELIKE SILE**-Shqiptarët dhe Fuqitë e Mëdha" (Beograd 1913), i cili në këtë libër pamflet i cilësonte shqiptarët si: **MAJMUNI LJUDSKOGA RODA** – MAJMUNË TË GJINISË NJERËZORE. Edhe pse racisti Gjorgjeviq ishte mjek me profesion dhe e njihte mirë anatominë e njeriut dhe e dinte se majmunë të tillë nuk ekzistojnë në sipërfaqen e tokës, meqë e kishte verbuar racizmi, ai i shiste këso pallavrash Evropës plakë. Kështu sa vjen e hendeku i kundërthënieve po thellohet çdo ditë e më shumë…

ꕥ

Profesor, kemi dëgjuar se edhe ju i provuat prangat dhe burgun fashist italian. Kur ndodhi kjo dhe sa ju mbajtën në burg?

Në Tiranë, në maj të vitit 1943, më arrestoi karabinieria fashiste italiane, dhe në atë burg fashist të Tiranës vuajta bashkë me shokët e ilegales antifashiste 3 muaj…

Kur u varros mësuesi veteran **Ibrahim Fehmiu** më 1951 pushteti jugosllav i burgosi 18 vetë të cilët kishin marrë pjesë në ceremoninë e varrimit, dhe mund ta merrni me mend se çfarë diskriminimi bëhej në atë kohë ndaj shqiptarëve, kur

dihet se Ibrahim Fehmiu ishte ministër i arsimit në Qeverinë e Fan Nolit…

Ne për hir të pronës private po e ujisim divergjencën, përçarjen, për një viç, për një livadh… dhe sa më parë të shkrihemi (asimilohemi) në jugosllavë, dhe pastaj në shekullin e ardhshëm (XXI) të realizohen synimet ekspansioniste jugosllave për "ÇLIRIMIN E SHQIPËRISË"nga "mortaja komuniste"?! Sepse Shqipëria në vend të kishës religjioze e bëri – **KISHËN MARKSISTE – UNIKAT BOTËROR...** Ne nuk jemi në gjendje për ta kuptuar atë realitet, sepse na mungon INTERESIMI, sepse fantazma komuniste atje neve na tmerron se e dimë se na shkon viçi, na shkon delja e lopa, dhe merr fund PRONA PRIVATE. Pra kështu siç jemi në këtë gjendje të mjerë ne e duam Shqipërinë si **MASHË,** si instrument manipulimi për qëllimet tona të mbrapshta, **dhe më shumë se Shqipërinë e duam pronën private, viçin, lopën, delen etj.** Dhe nëse do bashkoheshim në këto rrethana, atëherë të dy palët do të kapitullonim, do të mbaronim, dhe mu për këtë ata duhet të ruhen prej neve si prej ZJARRIT, ashtu siç **ruhet nëna nga fëmija i saj, nga droja se do t'ia nxjerr sytë**… siç ndodhi gjatë luftës Nacional Çlirimtare me ballistët dhe kolaboracionistët e nazi-fashizmit në krye me **Xhafer Devën. Por edhe sikur t'mos kishim armiq, ne duhet t'i krijojmë, ashtu si bacilet që i rrisim në epruveta, dhe pastaj i përdorim për vaksinim dhe imunitet kundër epidemive të ndryshme** shfarosëse, ashtu siç veprojmë me tharmin e bukës, dhe kosit, të cilët i përtërijmë përherë për t'mos u krimbur, kalbur, shkatërruar… Puna jonë është shumë e koklavitur. Kur sot ka nxjerr kokën miu – **carizmi ballkanik**, Akademia e Shkencave Serbe, Millosheviqi me tërë shtabin e tij, kurrsesi nuk duhet të qëndrojmë indiferentë, **spektatorë pasivë para këtyre absurditeteve të tërbuara.** Përndryshe do konsiderohemi se jemi vetëvrasës barbarë të vetes sonë…

Fishta ishte tradhtari më i zi, anëtar i akademisë së shkencave fashiste, ndërsa **Shtjefën Gjeçovi** patrioti më i madh i cili u dënua me vdekje me plumb në kokë, më 1929, si Xhordano Bruno, të cilin e likuidoi inkuizicioni më 1600, duke e djegur në turrën e druve për së gjalli…

ꕥ

Xheni fon Westfalen bashkëshortja e Marksit, u dashurua në mendjen dhe gjenialitetin e K. Marksit, dhe hyri në histori përmes Marksit…

ꕥ

MANIFESTI I PARTISË KOMUNISTE në Shqipëri është – BIBËL, KURAN, TALMUD, KATEKIZËM, pra është çelësi, ndërsa ne këtu, në këto rrethana robërie, po ia hamë kokën njëri-tjetrit për një viç, për një pulë, për një copë tokë… Dhe mu për këtë neve na konsiderojnë si tradhtarë, si Halit Tërnavcin me shokë…

Edhe MEMORANDUMI i çetnikëve po na pranon autonominë si fasadë, si gëlqerosje, si kozmetikë…

Edhe në këtë gjendje të mjerë siç jemi, ne jemi një zero pozitive, dhe të tillë po na bëjnë këto tubime dhe konflikte të përditshme…

Vetë LUFTA E KLASAVE krijon rrethana dhe kushte që njerëzve të ligj e qesharakë t'u japë rolin e heroit, dhe kështu manifestohet **dobësia kolektive, e jo forca kolektive...** Kështu p.sh., nuk është i lig **baba sheh**, por ata të cilët me **vetë-dëshirë shkojnë e i bien nën këmbë, i nënshtrohen si kope...**

ꕥ

LIGJËRIME, 6 mars 1988:

Disa herë na keni folur për çështjet e etikës, a mund t'na thoni diçka më shumë nga kjo fushë?

Kuptimi konkret, praktika normative, morali – pjesë e etikës, etika – **teoria e moralit**, tradita, doket, i takon më tepër sociologjisë. Dhe gjithë puna qëndron në atë që të jesh i FORTË në pikëpamje ETIKE, ndërsa se sa je i fortë, këtë e vërteton **PRAKTIKA jetësore** e secilit person dhe kolektivit si tërësi, dhe nuk mund të themi se jemi të fortë pa u provuar nëpër sfida, përballje, në luftë të përditshme me situatat, problemet, cilado qofshin ato… Për shembull Vokrri nuk u dorëzua, nuk u thye, dhe nuk tha: unë nuk do e emërtoj fëmijën me emrin – ARBANA, por shovinistëve u tha troç – MË PËLQEN SHUMË KY EMËR dhe nuk ka bir nëne që mund ta ndërrojë. Dhe ta paramendojmë sikur ky të kishte qenë një qyqar, nga frika para xhelatëve do ta lëshonte shpirti. Por ai e dha provën dhe nuk pyeti fare se cilat do të ishin pasojat që do t'i pësonte pas këtij veprimi të guximshëm…

MENÇURIA ngjyroset me shumë gjera, dhe nuk është larg DHELPËRISË, ndërsa **GUXIMI, TRIMËRIA**, si të izoluara, të ndara, nuk kanë kurrfarë vlere, sepse duhet ditur se për çka je TRIM, për çka je i FORTË, dhe duhet t'ia vlejë barra qiranë, sepse **nuk është trimëri nëse nuk je në gjendje ta paguash ÇMIMIN që nëse është nevoja të te shkojë dhe KOKA**. Pra ky është investimi kapital i cili e arsyeton trimërinë, GUXIMIN, për të cilin GËTE do thoshte:

Paratë ke humbur, diç ke humbur,
Duhet të mendosh, të tjera të fitosh;
NDERIN ke humbur, shumë ke humbur,
Të duhet famë të fitosh, mendimin e të tjerëve të ndërrosh.
GUXIMIN ke humbur, shumë ke humbur,
Të jesh i bindur, do ish më mirë, të mos ishe LINDUR!

Ne dëshpërohemi kur nuk i kuptojmë, ose nuk duam t'i kuptojmë gjerat që nuk na pëlqejnë, dhe gjerat i marrim në formë STATIKE, të dhëna njëherë e përgjithmonë, dhe jo si PROCES. Pra na pëlqen të fitojmë pa djersë, pa mund,

pa punë, dhe gjerat i duam të gatshme, pa u lodhur fare, bile edhe diplomën nëse ta japin falë, por kjo është gjë shumë e rrezikshme, sepse gjerat me vlerë të lartë e kanë çmimin shumë të lartë, dhe ai çmim duhet paguar… Tani po shkruhet për shtatë vite (1981-1988) më shumë se për 700 vitet e mëparshme…

GJYSMË E VËRTETA është shumë më e rrezikshme se **RRENA**, ndërsa këta sot me gjithë këtë vistër shkrimesh nuk po e thonë edhe atë gjysmën tjetër të së VËRTETËS. Ndërsa Pavlloviqi, Ivan Stamboliqi etj. , po u thonë çetnikëve të Millosheviqit: **Ju doni ta ktheni kohën e nazi-fashizmi të Xhafer Devës**, i cili për një natë i ka likuiduar 104 shqiptarë, midis Tiranës, dhe pastaj edhe të tjerët…

ꕥ

Profesor, ju i keni njohur shumë figura të ndritshme të Kosovës, si Emin Durakun (te i cili e kishit sjellë shaptilografin nga Peja në Gjakovë), Ramiz Sadikun etj. Sidomos me Ramizin keni pasur më shumë kontakte në veprimtarinë ilegale antifashiste. Çfarë mund t'na thoni më shumë për këta dy heronj antifashistë?

Guximin dhe aftësinë e tij intelektuale **Ramizi** e pagoi me çmimin më të lartë – me kokë, sepse ishte i pajisur me botëkuptime të shëndosha komuniste. Me Ramizin kemi vepruar së bashku që nga viti 1937-1941, dhe duhet të them se ai ishte intelektuali më i shkolluar i cili i ka pasur gjërat shumë të qarta. Boro Vukmiroviqin e kam parë kur mbajti fjalimin më 27 mars 1941, dhe ai nuk do lejonte të vinte deri tek konferenca e Bujanit… Ramizi ishte aktivisti më i devotshëm antifashist, të cilin e arrestoi policia fashiste shqiptare dhe e pushkatuan duke i thënë: qysh s'e paske marrë vesh shtypjen e regjimit të Karagjorgjeviqëve për 23 vjet, meqë je i papërmirësueshëm, ty vetëm konopi e bajoneta kanë me të bindur… Përqafimi i Ramizit me Boron në Landovicë para se të pushkatoheshin ishte

taktikë… Pavle Joviqeviqi dhe Mita Milkoviqi, në librin e tyre, i kanë dhënë disa të vërteta, të nxjerra nga arkivat ushtarake, por më vonë u penduan dhe thanë: ah, çka i kemi bërë vetes që i kemi publikuar ato të vërteta.

Emin Duraku më ka lënë përshtypje të thellë, kur e takova në Gjakovë, ku ua kisha sjellë një shaptilograf nga Peja, për nevojat e organizatës ilegale antifashiste..

ꕥ

Profesor, sot jemi bashkëkohës të ekzistencës së dy sistemeve, sistemit borgjez-kapitalist dhe socialist. Çfarë mund t'na thoni për veçoritë e këtyre sistemeve antagoniste?

Në kushtet ekonomiko-shoqërore në të cilat po jetojmë sot, në kushtet e dy sistemeve, mund të themi se secili vend i ka specifikat e veta, si në vendet kapitaliste, ashtu edhe në ato socialiste. Të marrim si shembull Arabinë Saudite dhe Suedinë, të cilat janë shtete juridikisht me sisteme kapitaliste ku bazë është prona private, por të cilat 100% dallojnë nga njëra tjetra?! Ose të marrim Paraguajin, Bolivinë ose Kilin e kohës së fashistit Pinoçet, i cili thoshte se Kili është i vetmi vend demokratik në botë?! Këtu shohim dallime të mëdha, si nata me ditën… Por edhe në shtetet socialiste kemi shumë laramani, kemi shumë dallime, dhe dallime si nata me ditën. Për shembull socializmi në Shqipëri dhe socializmi në Poloni… Pra nuk duhet të **marrim në thua midis qilimit,** tepihut, dhe t'i marrim gjerat kuturu… Karl Marksi e ka përjetuar vetëm një SOCIALIZËM, si në laboratorium, për 11 javë ose 72 ditë në KOMUNËN E PARISIT. Sikur të kishte jetuar sa Fridrih Engelsi me siguri do ta ndërronte mendimin, sepse edhe Engelsi më vonë e pranoi dhe tha se – NE NUK KEMI MUNDUR T'I MARRIM VESH SHUMË GJERA, pra është korrigjuar (1883-1885) Edhe V. I. LENINI, sikur të kishte jetuar më gjatë, do ta kishin shpallur **TRADHTAR**,

dhe vdekja e shpëtoi pa u dënuar si të tjerët… Sot e kanë rehabilituar Buharinin, pas 40 vjetëve, dhe revizionistët po thonë se Buharini ka pasur të drejtë?! Dhe nëse i trajtojmë çështjet në frymën historike e jo politike, pra në kontekstin e rrethanave, atëherë del se me mendimet e **Buharinit BRSS-ja** do të mbaronte, do të kapitullonte, sepse po të mos ishin hequr Buharinët, **Adolf Hitleri kishte për të arritur deri në URAL**, dhe nuk do kapitullonte në Moskë…

Po kështu është edhe me Shqipërinë, e cila e ka **adutin** më të madh dhe të pamohueshëm: se aty kurrë që 44 vjet nuk ka hyrë ushtri e huaj, dhe **nuk ka shkelë këmbë e ushtarit të huaj si çlirimtar**, dhe kjo i bën ata specifikë dhe ua **jep të drejtën për ta ngritur zërin dhe për t'ua mbyllur gojën synimeve të te dy superfuqive**… Dhe në veçanti, synimeve hegjemoniste të Jugosllavisë, e cila po pretendon **bashkimin e shqiptarëve**, por **me prapavijë gllabërimi**, dhe po thonë se nëse një herë kemi dështuar, herën tjetër nuk do dështojmë… Por këto synime ekspansioniste nuk mund të realizohen, sepse këta po ëndërrojnë ta rikthejnë Perandorinë e Car Dushanit… Këto gjera po i shohin edhe qorrat…

ꕥ

LIGJËRIME, 7 mars 1988:

Sot Akademia e Shkencave Serbe në Beograd po punon në bazë të librit të Vlladan Gjorgjeviqit – ARNAUTI I VELIKE SILE, 1913, duke thënë: "Spasavajmo evropsku kulturu od neljudi… " **(TA SHPËTOJMË KULTURËN EVROPIANE NGA EGËRSIRAT… ")**, dhe reklamohen me të madhe librat e Vlladan Gjorgjeviqit e Millosh Cërnjanskit… Racisti Vlladan Gjorgjeviqi, 24 vjet para Adolf Hitlerit, thoshte për shqiptarët – JEDINI NELJUDI U EVROPI – **TË VETMIT JONJERËZ NË EVROPË**… ?! Një pafytyrësi dhe paturpësi e madhe, ndërsa 28 vjet më vonë, më 1937, Vasa Çubrilloviqi e dha projektin – ELABORATIN famëkeq, ndërsa sot po botohen memoaret

e V. Gjorgjeviqit, si bazë e strategjisë shtetërore, si pjesë e luftës psikologjike për ta helmuar popullin serb edhe më shumë dhe për ta yshtur drejtë një kasaphane në të ardhmen…

ꕥ

DËSHIRA PËR MËSIM është e barabartë **me 50% të mësimit**, por nëse nuk plotësohet edhe gjysma tjetër, ajo mbetet një hiç, një asgjë, mbetet vetëm dëshirë e kotë… Me mihë (me prashitë) në Bistricë ose në Drinin e Bardhë, është më zor se me mihë në tokë…

ꕥ

REVOLUCIONI ALGJERIAN është **revolucion komplet**, sepse atje u bashkuan të gjitha strukturat shoqërore dhe e detyruan Francën, njërën nga pesë superfuqitë botërore, të ikë nga Algjeria me turp e me humbje pas 130 vjet robërie kolonialiste (Shih librin e Franc Fanonit – **TË MALLKUARIT E BOTËS**). Dhe për herë të parë pas 2200 vjetëve, pas sundimit romak që nga shekulli i II-të para epokës së re, pastaj pas sundimit Bizantin, arab dhe francez, u pavarësua populli i vuajtur algjerian, pas një lufte heroike për shtatë vite me radhë kundër kolonizatorëve francezë. Edhe populli heroik i Vietnamit e fitoi pavarësinë pas një lufte heroike, pas 31 vjetëve… Ndërsa populli palestinez po lufton që 40 vjet, dhe ende nuk arriti të pavarësohet. Por duhet ta dimë mirë se nuk mund të ketë çlirim kombëtar **pa ÇLIRIMIN KLASOR** (sepse në të njëjtin komb kemi dy kombe-kombin **shtypës-shfrytëzues** dhe pjesën e **shtypur-të shfrytëzuar** të te njëjtit komb)

Populli ka të drejtë të dyshojë në secilin udhëheqës, ka të drejtë ta kontrollojë përherë, dhe ta ndërrojë po qe nevoja në gjysmë të natës secilin udhëheqës, sepse lehtë është të fitohet lufta, por **shumë e vështirë është të ruhet FITORJA**. Sidomos nëse populli nuk është në nivel

permanent të kryerjes së detyrave revolucionare. Edhe rasoli më i mirë prishet brenda javës, nëse nuk e ka temperaturën optimale, të përshtatshme, dhe kështu **BAKTERIET,** të cilat deri dje na kanë bërë mirë, sot mund të kthehen në të kundërtën, në armiq, dhe do t'ua shohim sherrin…

Kapitalizmi çdo ditë dhe çdo orë i **prodhon varrtarët** e vet – **PROLETARIATIN**, por edhe socializmi i ka **varrtarët** e vet, i ka **viruset e fshehur përbrenda**, dhe vetëm presin çastin e volitshëm, për t'u restauruar dhe rikthyer në pushtet përmes kundërrevolucionit – revizionizmit, sepse edhe socializmi, nëse nuk i qëndron besnik parimeve socialiste **të pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit**, do të degjenerojë në format e burokratizimit të grupeve shoqërore, dhe do të bëhet edhe **më i zi se kapitalizmi**, si psh. në Jugosllavi ku është legalizuar hajnia dhe ku po ia bëjnë varrin vetvetes, sepse atë akumulim modest të kapitalit e kemi përdoruar për gjera luksoze, ndërsa për fabrika jemi futur borxh deri në fyt, mbi 20 miliard dollarë, dhe vetëm më 1981 u publikuan këto shifra, dhe të gjitha këto ishin pasojë e planifikimit të dobët ekonomik, sepse së pari duhet siguruar buka, e jo të shpenzohet pa lidhje për bankete, dasma, frigoriferë, vetura etj. Fabrikat **në Kosovë janë fabrika politike**, për tekstil, për lecka, ndërsa ato kryesoret, si "Ferronikeli" etj. , janë mbyllur. Dhe kështu dasma po bëhet e nusja askund?! Më së paku një e treta e fabrikave politike janë mbyllur. Inflacioni – kjo "shtrigë" financiare, po i gëlltit të gjithë. Inflacioni deri në 10% është normal, sepse pas 30 vitesh kredia me kamatën 2% mbetet falas, sepse parasë i bie vlera dhe kështu po pasurohet ajo klasë e oligarkisë burokratike e cila për pallatet që po i ndërton po i vjen pagesa mujore e kamatës së kredisë sa për ta blerë një dry garazhi për ruajtjen e veturës, sepse këto janë paratë e huaja, paratë e djersës së atyre që nuk kanë bukë të hanë, paratë e klasës punëtore. Por të gjitha këtyre gjërave dikur do t'ua shohim sherrin. Ai që nuk punon me mend – FIKET, mbaron,

kapitullon. Edhe bakllavasë ia shohim sherrin nëse nuk dimë ta hamë.

Por këto çoroditje nuk guxojnë të ndodhin **në Shqipëri**, sepse atje edhe kur merret kredia merret me kundërshpërblim të mallit që eksporton. Por edhe pse ka marrë më shumë se Jugosllavia, ajo **nuk i ka asnjë BORXH askujt**, sepse askush nuk të jep mall për sy të zi, dhe atje po punohet me shumë mend, psh. VLORËN e SAZANIN ia kanë dhënë me QIRA (BRSS-së në fillim, deri në vitin 1960) me kushte të caktuara, me ndihmë në ekonomi dhe fushat tjera, deri më 1960, kur iu dha ultimatumi BRSS-së që nga Karaboruni e SAZANI të largohen forcat ruse brenda 24 orëve!!! Ndërsa edhe me Kinën u vazhdua ndihma, dhe Kina ia dha Shqipërisë mbi **10 miliardë dollarë**, sepse Kinën e Mao Ce Dunit(në rolin e avokatit) e përfaqësonte Shqipëria në OKB (1962-1974), sepse edhe pse Kina ishte shteti më i madh në botë, me rreth një miliardë banorë, ajo nuk ishte anëtare e OKB-së, deri **më 1974**, kur REZOLUTA E SHQIPËRISË fitoi mbi dy të tretat e votave në Asamblenë e OKB-së, dhe Kina u pranua në OKB.

Çdo reformë, çdo revizionim, çdo zhvillim tjetër, do ta kishte mbytur Shqipërinë, sepse vetëm me një programim të rreptë dhe rigoroz të zhvillimit ekonomik, me një sistem të rreptë kooperativist, në të cilin klasa hegjemone është klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste, ishte e vetmja mënyrë e ekzistencës pa u gjunjëzuar para asnjë fuqie, para askujt, pa borxhe, pa taksa, me arsimimin dhe mjekimin falas, ku **vajza shqiptare** ishte edhe traktoriste, edhe pilote, edhe pedagoge në Universitetin e Tiranës.

ꕥ

I forti duhet t'i kritikojë dobësitë e veta, të popullit të vet, dhe jo tjetrin, sepse **çetnikët tanë janë shumë më të zi se ata të Serbisë**, sepse bashkëpunojnë dhe e ndihmojnë armikun kolonizator në të gjitha mënyrat (dhe çfarë të themi kur lexojmë në shtyp edhe këso broçkullash:

Najnacionalnija birokracija u Jugoslaviji jeste albanska birokracija – Burokracia më nacionaliste në Jugosllavi është burokracia shqiptare…). Dhe kështu po na qesin pluhur syve kur thonë: po kjo është shkruar në KUSHTETUTË, por duhet ta dinë të gjithë se REALITETI është më i fortë se Kushtetuta, e cila është një pjesë e realitetit, është një fazë, një etapë, ndërsa njerëzit çdo ditë e më shumë po korruptohen.

DUKE IA LËNË FAJIN VETVETES ne kurrë nuk mund të dalim në dritë, por edhe mos me ia lënë fajin vetvetes ne nuk mund të dalim në DRITË.

ꕥ

Kur intimiteti (miqësia) teprohet, kalon në të kundërtën e vet, kalon në ARMIQËSI.

ꕥ

Thundra gjakatare e Karagjorgjeviqëve për 23 vjet me radhë (1918-1941) ia ka ngrënë kokën vetvetes, dhe deri sa të **pastrohet gjaku racist** serb nuk mjaftojnë dy breza. Dihet se i ligu i fiton 8 dhe i humb 16. Politika e ditës më tepër bazohet në taktikë. Ajo është si buka, si hudhrat, qepët etj. , ndërsa **INTELIGJENCA JONË** po e **tregon veten shumë të dobët**, sepse busull orientimi e ka kolltukun, pozitën, të ardhurat e mira, veturën, dhe nuk i intereson fare plani gjenocidist e racist i Serbisë që nga Naçërtania e Ilia Garashaninit (1844) e deri te "Elaborati" (1937) i Vasa Çubrilloviqit, dhe Memorandumi i ASHA të Serbisë. Fajet nuk i ka vetëm regjimi i diktaturës fashiste, por edhe ne që jemi ende të dobët… Fronti është i hapur që 7-8 vite… **Neve po na pranohet çdo LIRI, si kafshëve, por që të mos sillemi dhe t'mos jetojmë si NJERËZ, por si kafshë**, dmth. nëse pranojmë të bëhemi **mikrofona**. Këta servilët tanë pranojnë të jetojnë si qenë, e jo si njerëz, dhe këta krimba dalëngadalë do ta hanë tërë trupin e shtetit fashist të

thundrës së hekurt. Nuk është gjë normale kur mendojmë se nuk ka **TRADHTARË**, dhe veprojmë e sillemi sikur nuk ka të tillë në mesin tonë, duke shtuar: është faqezi, por meqë është me din e iman, sërish është i mirë?! E si mund të jetë edhe **faqezi**, edhe **tradhtar**, edhe me din e iman, **edhe i mirë?!** Pra kjo është pasojë e injorancës, është sëmundje, mungesë e arsyes, edukatës patriotike, përndryshe as ëndërr nuk do mund të shihte dikush që vëllait të vet t'ia nxjerr sytë e ballit, dhe të dalë para publikut. E shihni se si po politizohet mazohizmi i **Gjorgje Martinoviqit** (nga Gjilani) i cili u vetë-dëmtua dhe për këtë e dhanë mendimin edhe mjekësia ushtarake, ndërsa çetnikët po e shpallin Martinoviqin të shenjtë duke shkruar një libër prej 700 faqesh për të?! Pra edhe një rast banal psikopatologjik si ky i Martinoviqit po shfrytëzohet për qëllime mesjetare të shekullit XIV, ndërsa populli i gjorë të gjitha këto gjëra i merr kuturu, i merr troç, dhe nuk ia hap grykën thesit, t'i shohë gjërat ashtu siç janë në realitetin e kundërthënieve shoqërore.

Klasa punëtore sllovene është më kompakte, sepse atje po mbahen takime për ndryshimet kushtetutare bashkë me punëtorët dhe intelektualët, ndërsa te ne në Kosovë dalin vetëm me një pyetje ultimatum: KUSH ËSHTË KUNDËR KUSHTETUTËS? Pra me këso pyetjesh sugjestive shantazhimi dhe kërcënuese askush nuk bën zë, se e di se çfarë janë pasojat. Por nuk duhet harruar se në Slloveni edhe gjatë sundimit austro-hungarez administrata lokale është mbajtur në gjuhën sllovene, ndërsa te ne as në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878) nuk e kemi asnjë shënim në gjuhën shqipe?! E dihet se edhe një hajmali – talisman, po të shkruhet shqip, askush nuk i beson, nëse nuk është shkruar në gjuhën arabe?! E atëherë çfarë vlere mund të kesh kur nuk e do vetveten? Pra VETVETJA është qëllim dhe mjet për t'i dashur të tjerët, dhe të tjerët si mjet për ta dashur vetveten, ose: i dua të tjerët përmes vetvetes, dhe vetveten përmes të tjerëve, që do të thotë –

ndërlidhje dialektike – edhe objekt, por edhe subjekt, dhe në raport të barabartë – sa subjekt aq edhe objekt.

LIRIA është gjëja më e shenjtë e cila nënkupton MOHIMIN e vetvetes për hir të LIRISË kolektive, sepse nuk mund të ketë LIRI INDIVIDUALE pa LIRI KOLEKTIVE.

ꕥ

LIGJËRIME,19 mars 1988:

FJALËT nëse i qërojmë shumë (purizëm) nuk mbetet asgjë nga kuptimi i tyre i mirëfilltë, pra nëse i heqim fjalët e huaja nga fjalori i gjuhës shqipe, atëherë bëjmë shumë dëm, fitojmë 8 e i humbim 16. Për shembull gjermanët më së paku përdorin fjalë të huaja.

ꕥ

Para 50 viteve në Palestinë kishte vetëm 50.000 hebrenj/izraelitë, nga 20.000.000 sa kishte në tërë botën. Organizata sioniste bëri që të formohet shteti izraelit në trevat ku jetonin palestinezët arabë, dhe kështu u formua me terror shteti izraelit (20.000 km plus 6000 km. katrorë), duke i dëbuar 95% të palestinezëve dhe duke i lënë vetëm 5%, por edhe ndaj hebrenjve para 2000 vjetëve kishte ndodhur dëbimi me dhunë, dhe aty në ato treva të JUDESË kishin ngelur vetëm 5% e hebrenjve dhe pjesa tjetër kishin ikur në të katër anët e botës (95%), ndërsa pas vitit 1948 u formua shteti izraelit dhe u bë një imigrim total, zhvendosje totale, me ndihmën e organizatës sioniste, dhe këtu ndikoi faktori i jashtëm, superfuqia amerikane, dhe LOBI i miliarderëve sionistë amerikanë, por edhe interesi i shtetit amerikan, si dhe koalicioni i shteteve reaksionare arabe, përveç Algjerisë, ku për shtatë vite e gjysmë u derdh gjaku, ndërsa Arabia Saudite është armiku më i madh i palestinezëve. Jaser Arafati është lider, ndërsa Faruk Kadumi, komisar politik i palestinezëve (me bindje komuniste). **Në Palestinë** për 40

vjet po zhvillohen luftime, që do të thotë 10 vjet më shumë se në Vietnam, sepse **çlirimi i plotë palestinez është i pamundur pa luftë klasore**. LUFTA KLASORE E KOMBËTARE NUK NDAHEN, dhe nëse zhvillohen paralelisht, njëkohësisht, atëherë edhe FITORJA ËSHTË KOMPLETE, sepse në secilin komb kemi edhe një kategori të cilët kombin e kanë si maskë, për reklamë. Populli mbjell e kombi korrë, pra objektivisht janë të ndryshme, aty çdo ditë priten e vriten, dhe atentati në Liban, në ambasadën amerikane me autobombë, me 200 kg. tritol, dhe i vrau 2-300 amerikanë. Pra nëse digjet fqinji, duhet të mendojë se do digjet edhe vetë.

Mihail Gorbaçovi po i përsërit veprimet e Hrushqovit më 1955.

ꕥ

Më 1946 po punohej që të bëhej marrëveshja dhe Eduard Kardeli të bëhej ministër i punëve të jashtme të Shqipërisë. **Enver Hoxha** bëri vizitën në atë vit në Beograd, Zagreb, Lubjanë, Bled (Shih librin e Enver Hoxhës – **TITISTËT**), por atje nuk e takoi asnjë shqiptar të Jugosllavisë, dhe në shenjë nderimi për miqësinë, Enver Hoxhën e dekoruan me dekoratën më të lartë të Heroit të Popullit (Dekorata me platin, dhe në të gurë të çmueshëm – diamante), por Enver Hoxhës ia preu mendja se i del shumë keq dhe ia sheh sherrin (për të mos e shpallur populli "Ahmet Zogu i Jugosllavisë") dhe nuk e mori dekoratën, ua **ktheu prapa**, sepse ai kurrë nuk shkeli në dërrasë të kalbur. Kjo dëshmonte se strategjia 70-vjeçare nuk po ndryshon, sepse veku ishte i njëjtë, dhe vetëm ndërroheshin drugëzat (sovajkat).

ꕥ

PERESTROJKA e Gorbaçovit është botim i dytë i NEP-it (Novaja Ekonomiçeskaja Politika, në vitet 1922-1928 në BRSS), kur ishte kriza e madhe teknologjike, ndihma e

kapitalit për të dalë nga kriza, për të shpëtuar nga URIA, dhe atëherë dështoi vija e Trockit dhe Buharinit, ndërsa sot po rehabilitohen, dhe vija bolshevike po degradonte ngadalë, po revizononte, sepse nuk ishin përmbushur të gjitha kushtet e domosdoshme, meqë në Rusinë cariste kishte mbretëruar sistemi i SKLLAVËRISË deri më 1867, kur bashkë me tokën JANË SHITUR EDHE NJERËZIT, dmth. vetëm 50 vjet para Revolucionit të Tetorit (më 1918). Revolucionin bolshevik e bënë fshatarësia me një pjesëmarrje prej 85%, të cilët e derdhën gjakun për ta gëzuar atë tokë të zotërinjve, klasa punëtore kishte një pjesëmarrje minimale prej 1%, ndërsa 14% ishin klasa e burokracisë. Dhe pikërisht në këto rrethana të mjerueshme **KLASA PUNËTORE** e mori pushtetin, por që nga 1920-1928 tri herë më shumë vdiqën nga uria, se sa gjatë Revolucionit, dhe kjo vazhdoi deri më 1939, kur huni dhe konopi nuk kurseheshin për ata që i dilnin përpara zhvillimit të revolucionit bolshevik, dhe dërgoheshin në **kampet e internimit në Siberi...** NGA KJO DEL SE REVOLUCIONI BOLSHEVIK NUK I KISHTE PREDISPOZITAT E NEVOJSHME SOCIALE. Ndërsa sot Mikail Gorbaçovi po thotë: hapni shitoret private lirisht, dhe me këtë u dëshmua përfundimisht se **revolucioni bolshevik degjeneroi**… Pjetri i Madh (Cari rus, 2, 20 cm. i gjatë) edhe vetë punonte në farkëtari dhe më së shumti ka luftuar me Suedinë. Të vetmen përmendore të cilën nuk e rrëzoi Ushtria e Kuqe e Revolucionit të Tetorit, ishte përmendorja e Pjetrit të Madh, si ajo e Skënderbeut te ne, sepse Pjetri ishte reformator i madh, dhe e dënoi me **vdekje të vetmin djalë që kishte, vetë ia vuri konopin**, dhe nuk ia la xhelatit. Kështu veproi Pjetri, për të dëshmuar se **duhet të respektohet ligji**, sado i ashpër që të jetë, edhe pse atje mbretëronte skllavëria dhe ku bashkë me tokën shiteshin edhe skllevërit (Pronari p.sh. i blinte 100 hektarë tokë bashkë me 50 skllevër). Për shembull poeti i madh rus –

Pushkini, ishte nipi i skllavit Hanibal nga Etiopia (Gjyshin e Pushkinit e kishin blerë si skllav në Holandë).

Duhet ditur për çdo lëvizje nëse është KOMBËTARE apo është popullore, në pikëpamje klasore, ndërsa kombëtare në pikëpamje politike, se kurrë nuk thuhet – muzika kombëtare, pra e njëjta fjalë i ka dy kuptime – pjesa më e madhe **pa hile – POPULLI**, ndërsa **kombëtare – me hile**, sepse pjesa dërmuese e popullit është pjesa **prodhuese – klasore**, ndërsa në **pjesën kombëtare futet edhe pjesa joprodhuese**, sepse KOMBI ËSHTË KATEGORI HISTORIKE, QË HISTORIKISHT KA LINDUR, DHE HISTORIKISHT DO TË SHUHET, ndërsa POPULLI është i PËRHERSHËM, **ËSHTË KATEGORI PRODHUESE E PËRJETSHME.**

Nga pozicioni – këndvështrimi i territ shihet më mirë drita. Pra ty s'të sheh ai që nuk ka dëshirë të te shohë, dhe e sheh atë që ke dëshirë për ta parë.

SEFARDËT, janë pasardhësit e hebrenjve të cilët kanë ardhur, imigruar, nga vendet e ndryshme të Evropës, ndërsa ASHKENAZËT, janë autoktonë. Ata nuk udhëheqin, nuk janë fanatikë, dhe që prej 3000 vjet besimi hebraik dhe kombi hebraik nuk ndahen nga njëri-tjetri, ideologji FETARE, dhe përmes topave e raketave u rivendosën në vendin e tyre të kryehershëm ku kishin jetuar para 2000 vjetëve. HEBRENJTË ishin një fis me PALESTINEZËT. Ata u dalluan nga fiset tjera me pikëpamjet e tyre MONOTEISTE. IZRAELITËT së pari i përzuri me dhunë BABILONIA, dhe më vonë edhe PERSIA, dhe për herë të tretë i internoi me dhunë Perandoria romake, dhe i degdisi e i bëri pikë e pesë nëpër Evropë dhe vende tjera të botës, që këtu e 2000 vjet më parë, deri para 40 vitesh, kur u formua IZRAELI pa popullin IZRAELIT?!

Këta hebrenj e kishin shpallur **TREGTINË** si profesionin më të shenjtë, dhe më afër PERËNDISË. Një dogmë e vërtetë – ta blesh për 8 dhe ta shesësh 16, duke u betuar se e ke blerë 60. Tempulli kryesor në Jerusalem – qendra e

tregtisë, vendi më i shenjtë – FALTORJA – ALTARI, aty janë shkëmbyer të hollat me dukat – flori, aty ku është shitur e është blerë monedha, e në vendin kryesor rrinte pasaniku më i madh, ndërsa BURSA – vendtakimi – faltorja më e madhe, vendi ku bëjnë kryq – ku bëjnë TREGTI, pra QËLLIMI I ARSYETON TË GJITHA MJETET, **lejohet çdo gjë vetëm për të arritur deri te FITIMI?!** Shkëmbimi i mallit, shkëmbimi i mendimeve, **AVOKATI SHET RRENA**, kriminelin e shpëton prej konopit – litarit, dhe nëse domosdo duhet dikush të sakrifikohet me vdekje, atëherë **në konop e qesin të pafajshmin...**

Hebreu Mosha Pijade ka qenë adhurues i ideologjisë çetnike, është bërë revolucionar pa kompromis, teorik dhe praktik.

ꕥ

Në Maqedoni ndalohet me ligj shitblerja e tokës në mes shqiptarëve dhe sllavo-maqedonasve, që do të thotë se shqiptari nuk guxon t'ia blejë tokën sllavo-maqedonasit?! Racizëm dhe diskriminim i vërtetë, që nuk ndodh askund në botë. Edhe në shkolla po mësohet në gjuhën maqedone, dhe paralelet shqipe në Kumanovë e gjetiu po mbyllen. Po pse po bëhet ky diskriminim? Sepse para së gjithash ndjenjat kombëtare të shqiptarëve janë ende shumë të dobëta, ndërsa ndjenjat religjioze janë shumë të theksuara. Deri më 1941, gjatë tërë kohës së sundimit të mbretërisë serbo-kroate-sllovene, shtypja ishte e njëllojtë edhe për sllavo-maqedonët, edhe për shqiptarët, të cilëve nuk u njihej e drejta elementare e administratës dhe shkollimit në gjuhën amtare. Ndërsa pas vitit 1945 sllavo-maqedonëve iu pranua statusi i REPUBLIKËS dhe ata sot janë më të **PRIVILEGJUARIT NË JUGOSLLAVI?!**

ꕥ

Si është e mundur që kemi spiunë në çdo hap?

Sepse në rrethana të këtilla të mjerimit dhe skamjes, në rrethana të pabarazisë dhe diskriminimit, kur po shkatërrohen edhe ato pak fabrika që kishim, atëherë **kushtëzohet edhe kriza njerëzore, morali i njerëzve, të cilët shiten si çdo mall tjetër për PARA**, për pozitë, për karrierë. Dhe vetëm REVOLUCIONI mund t'i çrrënjosë këto gjëra absurde, jonjerëzore, dhe atëherë VDEKJA PËR LIRI SECILIT DO T'I DUKET PËRJETIMI MË I ËMBËL E MË I BUKUR NË JETË!

Dhe kurrë nuk duhet ta harroni thënien emblematike të filozofit Xhuzepe Macini, i cili veç tjerash thotë:

„LIRIA E FALUR ËSHTË MË E RREZIKSME SE ROBËRIA... "

ꕥ

LIGJËRIME, 5 prill 1988:

Të gjitha pushtetet reaksionare për demagogji i **referohen POPULLIT** të cilin askush nuk e pyet për asgjë, dhe mbi 50% populli nuk ka asgjë në dorë… Për shembull kur ti sot lexon ne faqet e të përditshmes RILINDJA (në tri faqe) **fjalimin e Sllobodan Millosheviqit,** atëherë është njësoj sikur ta shikosh murin, dhe pastaj të VERBOHESH… **Dr. Branko Horvat**, më i njohuri ekonomist, i cili me siguri e ka ekipin e tij, dhe thotë se është kategorik në mendimet e tija, kur thotë – **Populli shqiptar nuk është kombësi, por KOMB**, **ndërsa po t'i thoshte dikush tjetër këto gjera do t'i shkonte koka... Rexhai Surroin** e internuan në LA PAZ të Bolivisë, shteti më i mbyllur në botë, shteti kamp-llogor, ku njerëzit shiten e stërshitën me tapi, aty ku kanë gjetur strehim gjithë llumi i kriminelëve të para- dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Dhe ishte ky një dënim perfid ndaj Surroit kur e bënë ambasador, sepse nuk kishin hesap ta dënojnë me vdekje, ndërsa ky ishte dënimi më i rëndë – ta përzënë nga atdheu,

nga vendlindja, nga familja, ishte kjo një – vdekje për së gjalli, pra ishte një dënim shumë i rëndë, vetëm që shteti të mos ia shohë sherrin.

Branko Horvati nuk po largohet nga strategjia e boshtit të kurrizit, KONFEDERATËS BALLKANIKE, e jo FEDERATËS. Edhe SHBA-ja ka qenë nja 12-13 vjet KONFEDERATË, mirëpo atje dështoi ky model. Pra modeli që askush të mos humbë, dhe secili t'ia sheh hairin konfederatës… Por edhe me rastin e përpjekjeve për KONFEDERATËN BALLKANIKE Jugosllavia këmbënguli që do të pranonte me kusht që edhe Shqipëria, edhe Bullgaria të bëheshin PJESË e Jugosllavisë. Edhe kjo Jugosllavi është konfederatë shumëkombëshe, por jo si Danimarka, Norvegjia, Islanda, ku nuk pat sukses, sepse ato shtete u pavarësuan…

REPUBLIKA është pjesë autonome e një shteti, por çfarë autonomie?

Sepse kemi autonomi në tri rangje:

1. **Autonomia e rangut të parë** – Autonomi Republikane;
2. **Autonomia e rangut të dytë** – Autonomi Provinciale – si Vojvodina;
3. **Autonomi e rangut të tretë** – Autonomi Krahinore, regjionale, si autonomi e mëhallës, e lagjes…

Pra kjo u bë për të na mashtruar: që Kosova të përfaqësohej me 10 deputetë, prej të cilëve 5 malazezë dhe 3 shqiptarë si **Halit Tërnavci**?!

Edhe sot e kësaj dite Dr. Vasa Çubrilloviqi nuk po pendohet në kohën që teoria e tij është NJË **FASHIZËM I KULLUAR**, ndërsa këta që po e dekorojnë janë fashistë edhe më të TMERRSHËM… Edhe këta **ultra-fashistë** nuk mund të bënin më shumë, sepse nuk kishin teknikë, dhe nuk kishin mundësi ta realizojnë programin e tyre racist. Pra nuk mjafton vetëm dëshira fashiste, por duhet edhe teknika e nevojshme.

Maqedonët po e rrezikojnë Jugosllavinë me qëndrimin **e tyre fashist ndaj shqiptarëve**. Po kështu po veprojnë edhe serbo-malazezët ndaj shqiptarëve.

Në Maqedoni po eksperimentohet me shqiptarët, dhe këtu feja po luan një rol të veçantë… Fshatra të tëra janë asimiluar dhe është shpikur termi –MAKEDONSKI MUSLIMANI – MYSLIMANËT MAQEDONË, me Njazi Limanovskin dhe limanovskët tjerë… Edhe Branko Horvati po thotë se këto gjera duhet të zgjidhën, sepse në Evropë të tilla gjera është vështirë të ndodhin, dhe gjendja është e mbarsur dhe është para shpërthimit, si lehona para lindjes, dhe kjo nuk mund të zgjatë pa fund…

Në Danimarkë rrallë ndodh që ndonjë familje të mos e ketë një agronom në shtëpi, ose teknik të agronomisë, dhe atje të gjithë janë të shkolluar, dhe bujqësia është intensive, jo ekstensive, si te ne që inxhinierit të bujqësisë nuk ia "banë fytyra" ta kapë shatin, aty ku nuk hyn traktori ose kombajna, ose draprin, dhe kjo është prapambeturi.

Edhe **LIBRIN** – nëse gjithnjë e mbajmë në dorë vetëm librin, do humb kuptimi i librit (Profesor Qazimi na këshillonte **që 50% të kohës të lexojmë dhe 50% të jemi në mesin e popullit, sepse realiteti objektiv me gjithë ato kundërthënie nuk mund të kuptohet vetëm nga librat** dhe mediumet informative të kontrolluara dhe të dirigjuara nga pushteti – BK).

ꕥ

Gjithë këta të burgosur politikë, mbi 7000-8000 vetë, kjo është e rrezikshme, sepse këta fashistë pasojat i shpallin si taktikë, e duhet dalluar taktika nga strategjia. Mirëpo këtyre grupeve u konvenon ta shpallin **SHKAKUN** si **PASOJË**, dhe **pasojën** si **shkak**, sikur të merret gishti i vogël si kryesori, pjesa si tërësi. Por fajtori më i madh është ai i cili PRITON TË MENDOJË. Sepse po të kishim qenë aq trima e **mic sokola**, kurrë nuk do të ndodhte Londra e 1912-ës, dhe mu për këtë shqiptarët u copëtuan

lik përgjysmë, e ne edhe sot po merremi me priftërinj e me popa, me sheh e me hoxhë, me din e iman…

ꕥ

Profesor, çfarë mund t'na thoni për faktorin kohë?

Koha është shpatë me dy presa, dhe po nuk e preve – të pret, thotë një fjalë e urtë, dhe kjo do të thotë se koha ka një vlerë shumë të çmueshme, sepse një herë vjen (siç na vjen vera kah dera, por vetëm për bujkun e mirë vjen vera e mirë), dhe pastaj ikën, pra **KOHA ËSHTË PJESË E JETËS**, është xhevahir, dhe vlerën e saj e njohin vetëm ata që dinë ta shfrytëzojnë me mend, me përkushtim, dhe devotshmëri, me sakrifica, me djersë e me gjak, ndërsa për përtacët, dembelët, koha nuk ka vlerë, dhe çmimi i kohës për ta është shumë i lirë. Për **budallenjtë** koha e ka **çmimin shumë të lirë,** ndërsa për të **diturin** ajo e ka **çmimin e floririt**. Prandaj lumë ata që betohen në shenjtërinë dhe vlerën kolosale të KOHËS. Vetëm njerëzit e ditur që kanë lënë vepra të mëdha e kanë shfrytëzuar kohën racionalisht. **Mund ta blesh një orë, por kohën kurrë...**

ꕥ

LIGJËRIME, 9 prill 1988:

Branko Horvati, e kompani, janë pionë të strategjisë Jugosllave, dhe këta nuk janë brenda grupit që taktizojnë, brenda reaksionit, për t'ia arritur qëllimit. Këta e mbjellin farën hibride me metoda bashkëkohore agroteknike, dhe shpresojnë për të korra të sigurta, se si dhe kur me dalë në Sarandë, Vlorë, Selanik, Egje, dhe për këtë duhet përdorur mjete moderne dhe jo me primitivizëm, me mjekërrosha e me dëshira joreale, psh. t'i arrinin në vitin 1918 ato gjera të cilat mund të arriheshin vetëm në vitin 2019, dhe për gjashtë ditë (më 1941) u shkatërrua Jugosllavia e Karagjorgjeviçëve e cila u ngut të dalë në detin Jon. U

ngut, dhe u **NGELI NË FYT SHQIPËRIA**. Horvati si ekonomist e Shkëlzeni si publicist, po vazhdojnë me avazin e ëndrrave. Edhe **Ilia Garashanini sikur të çohej nga varri** do t'u thoshte këtyre mjekërroshave të sotëm çetnikë: heu, ju e paçi faqen e zezë, ndërsa Horvati haptas po thotë: nëse nuk i ngushtojmë këta shqiptarë, dhe i trajtojmë me të drejta të barabarta, por këta **nuk duhet ta gëzojnë REPUBLIKËN**, vetëm me një kusht – që edhe të tjerëve t'u hiqet republika, sepse këta i plotësojnë kushtet **për KOMB**, por ky është një synim i largët. Ai do ta therë, ta presë viktimën me sa më pak mundime, me **brisk të mprehtë**, me **bisturi kirurgjike**, e jo si mjekrroshat çetnikë – **me sharrë të kohës së Car Dushanit.** Dhe kështu, në mënyrën më perfide do të na humbë fijen. Pra të ngritën shqiptarët e Kosovës dhe ta "ÇLIROJNË" SHQIPËRINË nga mortaja komuniste, si gurë katapultash, si mish për top. Dhe **përmes kësaj gjysmë Shqipërie të merret edhe gjysma tjetër e Shqipërisë**.

Edhe qenin e ushqejnë tri herë në ditë, me supë e me gjithë të mirat, por megjithatë mbetet qen. **PAVARËSIA** është punë e madhe, por nuk mund të arrihet pa mund, pa vuajtje, pa sakrifica të mëdha, bile edhe pa gjak. Dhe të gjorët pranojnë ekzekutimin me varje, por në litar të mëndafshit, jo në litarin e rëndomtë?!

Vetë kjo dinamikë e kësaj kohe bën që njerëzit të marrin aspirina, ilaçe, për gjumë, për nervozë etj. Përpara është përdorë hajmalia, e sot po përdoren hapat, ilaçet, sepse tani tërë botën e ke në grusht, dhe gjithë këto mijëra informacione (2000-3000 bombardime informative) brenda ditës të mbysin fare, por për fat jo të gjithë.

Popullata autoktone indiane e Amerikës u helmua duke ngrënë vetëm bukë misri e lëng djathi, e duke pirë duhan, dhe mjaftuan 180 vetë të ekspeditës spanjolle, edhe pse indianët ishin luftëtarë trima, tërë një perandori ra, kapitulloi, për shkak të ushqimit të dobët, sepse grurin nuk e kultivonin, dhe armatimin e kishin me shigjeta, ndërsa

evropianët kolonizatorë me armë zjarri. Kështu ranë perandoritë e **Inkëve, Actekëve, Majave**.

Por nuk duhet absolutizuar faktori teknik, sepse në **Mi Llaj të Vietnamit**, u vranë 384 ushtarë amerikanë për një ditë, ndërsa superfuqia botërore këtu kapitulloi pa kushte, dhe me turp. Në Vietnam i lanë eshtrat 260.000 ushtarë amerikanë, të armatosur gjer në dhëmbë, me plot xhepat dollarë. Dhe **Amerika kapitulloi më me faqe të zezë se Adolf Hitleri**.

ꕥ

Së pari kishim KOMUNIZMIN PRIMITIV, te Majat, Actekët, Inkët, ILIRËT etj. , por ishte e nevojshme të mohohej DREJTËSIA PRIMITIVE, pa përparim, për t'i gjetur vaksinat, për të shpëtuar nga epidemia, progresi për padrejtësi, për të lindur KOMUNIZMI MODERN, bashkëkohor, pra për të dalë nga rendi i padrejtësisë skllavopronare, sepse në shkollë kanë shkuar vetëm fëmijët e skllavopronarëve. Edhe sot kemi skllavopronarë, por i kemi **MODERNË**. Ndërsa në atë kohë, sa më skllav që ishte dikush, më i mirë konsiderohej nga skllavopronari. Ndërsa pasuria matej me numrin e skllevërve, robërve, të cilët shiteshin në treg si bagëtia, si gomari, vegshi e çerepi. Edhe **DIOGJENI** i madh(404-323 para ep. re) ishte njëri ndër ata skllevër të shitur në treg...por u bë legjendë me urtësinë e tij të rrallë, dhe ditën ecte me qiririn e ndezur dhe thoshte**;"PO KËRKOJ NJERËZ!"**, ndërsa kur iu kishte afruar afër fuçisë Aleksandri i Madh, dhe i thotë- "kërko çfarë të duash", Diogjeni ia kthen**- "Të lutem, ma lësho diellin!"**

ꕥ

Dr. Branko Horvati po u thotë shokëve maqedonas: se nuk bën kështu siç po veproni ju me shqiptarët, dhe nuk do t'ju shkojë gjatë me këto qëndrime. Por ata racistë nuk po binden, nuk po pranojnë të ndryshojnë, dhe kështu po

veprojnë si në aparteidin e Afrikës së Jugut, duke u arsyetuar se gjoja kështu duan të shpëtojnë nga rreziku i shqiptarëve. Edhe fashistët në kohën e tyre ua jepnin fëmijëve nga një çokollatë për të treguar se ku janë strehuar prindërit e tyre, dhe kështu si kolonizatorë që janë po veprojnë si në xhungël – për ta zënë **TIGRIN** e sakrifikojnë VIQIN, pra si katalizator, d.m.th, Kosova **40% të sakrifikohet** sot (me ca privilegje të rrejshme si karamelet e fashistëve), që të **fitojnë nesër 60%,** pra të fitojnë dyfish, të fitojnë edhe Kosovën edhe Shqipërinë, ndërkaq Serbia po kundërshton duke thënë: *Bolje vrabac u ruci nego celi slon u dzungli* – Më mirë një zog në grusht se sa tërë elefantin në xhungël.

Maqedonia është fazë eksperimentale, që pastaj të njëjtat eksperimente të bëhen edhe me Kosovën, por për të gjitha këto gjera absurde duhet së pari ta fajësojmë vetveten, sepse ende po frymëzohemi me MESJETËN?! Ndërkaq Dr. Horvati ka për qëllim t'i ndihmojë shtetit jugosllav, duke supozuar se – KUR U JAPIM MË SHUMË TË DREJTA SHQIPTARËVE TË KOSOVËS, atëherë më shpejt do të arrijmë deri te realizimi i idesë për **ÇLIRIMIN E SHQIPËRISË** përmes **VËLLAIT KOSOVAR**, pra për t'i çliruar shqiptarët prej shqiptarëve… dhe po sillet sikur me fëmijët e mitur duke thënë: tregonani babën e nënën se po ua japim nga një **çokollatë**?! Po i "japim " 40% e po i marrim edhe 60% kur ata të bashkohen me Jugosllavinë brenda 10 vjetëve, dhe kështu shqiptarët do shpëtojnë nga PAVARËSIA… Sado që të jenë tigër e luanë, por derisa janë këlyshë, edhe fëmija luan me ta…

Nikolla Pashiqi e mbajti social-demokracinë për dekor, për reklamë, sa për t'u lavdëruar para Evropës se Jugosllavia është shtet demokratik… **Dhe nuk ka turp më të madh se sa të mashtrohesh nga thëniet e Horvatit**, i cili po bën çmos që të shfrytëzohet rasti, meqë gjysmën e më shumë të Shqipërisë (Kosovën me vise) e ka në grusht, ndërsa po derdh **lot krokodili** për gjysmën tjetër, Shqipërinë administrative. Por edhe Rusia cariste, pastaj

Hrushçovi, Gorbaçovi, te të gjithë është e njëjta strategji. Ndërsa Reis Malile (ambasador i Shqipërisë në SHBA) i çuditi ata 100 gazetarë në Beograd duke i bindur se **Shqipëria kurrë nuk do ta pranojë "xhelatin shpëtimtar",** sepse Shqipëria më 1946 kishte pranuar një herë të ishte pjesë e KONFEDERATËS BALLKANIKE: Jugosllavi-Shqipëri-Bullgari, por ky projekt dështoi, ndërsa Horvati po propozon diçka që nuk është e mundur, kur konfederata nuk mund të ekzistojë as në Danimarkë, Norvegji, Amerikë, ku ka një traditë shekullore, por ai po u flet deleve, lopëve, sepse Federata është kompromettuar, ndërsa rrethanat dhe atmosfera politike e vitit 1947 për bashkim me Federatën jugosllave nuk përsëriten, sepse gjerat nuk përsëriten dy herë në të njëjtën mënyrë. Pra duhet të jesh mjaft i aftë me dije që ta kuptosh me kohë dinakërinë e armikut. Është njësoj si kur një nënë e ka një djalë në burg e tjetrin në liri, dhe armiku po i thotë asaj nëne: a keni dëshirë **t'i bashkoni dy djemtë tuaj në burg?** Por nëna e mirë kurrë nuk do ta pranonte një gjë të tillë. Kështu po veprohet edhe me neve, vëllai i madh – Shqipëria, dhe vëllai i vogël – Kosova, dhe kështu po bëhen hesapet me dy hanxhinj.

Shkëlzen Maliqi po thotë: 99% e shqiptarëve janë **kundërrevolucionarë**, ndërsa prej intelektualëve (si Sh. Maliqi, Dobruna, Tërnavci etj) janë 1%. Sh. Maliqi është më i rafinuar, nuk është shulan si Tërnavci. Por nuk duhet harruar se SA KA FAJ AI QË TË MUNDON, **AQ KE FAJ EDHE TI QË PO LEJON TË TE MUNDOJNË**. Prandaj pikë së pari varet nga ne se a do të lejojmë të biem **në dorë të dreqit fashist**, dhe është absurde kur thua: po ne kemi qenë më të moçmit në Ballkan, ndërsa edhe sot e kësaj dite pretojmë të kthjellemi, të mendojmë me kokën tonë, të luftojmë pa kompromis, dhe **është çasti historik për t'i hapur sytë** një herë e përgjithmonë. Edhe nëse do të na falte dikush LIRINË, ne nuk duhet ta pranojmë, sepse LIRIA NUK ËSHTË GJË QË FALET, DHUROHET, por FITOHET ME MUND E SAKRIFICA TË MËDHA. Nëse

falet, atëherë ajo është tragjike, është hedhje e grepit. Sepse nuk thoshte kot Josip Gjergja më 17 mars 1987: **se sot apo nesër Vlora do të jetë e jona** (Kad tad, Valona biçe nasha)?!

Më 1968 ende nuk i kemi pasur gjërat e qarta, por edhe më 1981 po kështu, sepse me primitivizëm po kërkohen gjërat e pamundshme, dhe po shihet se askush nuk po i vuan më shumë se ne pasojat e shpartallimit shumëshekullor. **Shqipëria po ruhet prej nesh se e di mirë se çfarë jemi.** Dhe sikur t'mos i dinin këto gjera, atje kurrë nuk do të ekzistonte shteti… Dhe ne jemi **KARREM** për ta **JOSHUR Shqipërinë në grep**, për ta qitur në KURTHË, sepse në këto rrethana bashkimi me Shqipërinë është VDEKJE për të gjithë. ATJE PËRDORET DIKTATURA MË E ASHPËR E PROLETARIATIT VETËM PËR TA SHPËTUAR SHQIPËRINË.

Por të mos i harrojmë veprimet e palestinezëve ndaj tradhtarit: ata e **vrasin tradhtarin menjëherë**, posa i bien në gjurmë… E në Shqipërinë e para Luftës së Parë Botërore kishte qindra grupe **spiunësh**, tregu i tradhtisë, dhe kush ngrihej më herët mund të urinonte në atë farë Shqipërie, e cila ishte bërë kënetë, si **nevojtore publike (Shih romanin e Skënder Drinit: VRAJE TRADHTINË).**

ꕥ

LIGJËRIME, 13 prill 1988:

Branko Horvati, Shkëlzen Maliqi, eventualisht edhe Veton Surroi, janë programim i Federatës për ta bërë një baraspeshë me Bogosllovinë, Lidhjen e Shkrimtarëve të Serbisë, Akademinë e Shkencave të Serbisë dhe dy kryesitë, bashkë me marionetat e Kosovës si Tërnavci, Dobruna etj… Çfarë na thotë intervista e V. Drashkoviqit me peshkopin e Bogosllovisë? Për këtë duhet shfletuar "GLAS CRKVE", revistë që botohet në SHBA, në të cilën

thuhet se: ”Derisa nuk i likuidojmë 1.000.000 kroatë, ne nuk mund të bashkohemi… ”

Ka shumë njerëz që thonë: ka mbaruar Jugosllavia, dhe ata mendojnë vetëm me zemër, jo edhe me arsye, sepse nuk e dinë se nëse shkon Jugosllavia, atëherë mund të shkojë edhe Shqipëria.

Millovan Gjillasi haptas po flet, si homo duplekx, si dyfytyrësh, sepse më 1953-1954 ai tregoi se kush ishte, por jo tërësisht, dhe më vonë e qiti edhe pjesën tjetër të librit, dhe iu kundërvu vetvetes, dhe mori dënimin 6 plus 8 vite burg, dhe nuk pushoi në organizimin me grupet ilegale, edhe pse në burg e kishte edhe zyrën, dhe makinën e shkrimit, por kur nuk u përmirësua dhe nuk u pendua e dënuan edhe me 8 vite tjera burg. Dhe atëherë Gjillasi pati thënë se SHQIPËRIA NUK MUND TË BËHET PJESË E JUGOLLAVISË, sepse nuk i takojnë racës sllave… ”, por ai tha edhe disa parashikime tjera: se Jugosllavia do të shkatërrohet kah **viti 2000, dhe se KOSOVA DO TË BASHKOHET ME SHQIPËRINË**, se kjo është gjë kundërrevolucionare, por edhe sikur të jetë e mundur atëherë kjo do ishte **humbje e Shqipërisë**, një bashkim **VDEKJEPRURËS,** kur dihet se ne hë për hë jemi VARRTARË POTENCIALË, varrtarë të dyfishtë, të vetvetes dhe të shtetit amë, sepse nuk jemi në nivel të VETËDIJES **për ta parë grepin, kurthin, karremin e maskuar**, derisa nuk biem në të, por atëherë do jetë shumë vonë, dhe këta janë betera, por ne jemi edhe më betera. Kjo është dergjë, sëmundje e rëndë, e sëmundja nuk duhet fshehur. Pra **nuk duhet t'i fshehim të zezat tona,** dhe nuk duhet të pritojmë për të menduar, dhe të mos mbështetemi në dëshira joreale. Masa e tillë siç është po e do me hile Shqipërinë, pra po do ta ruajë edhe dinin, edhe imanin, edhe Jezu Krishtin, edhe Muhamedin, dhe me të gjitha këto të zeza gjoja po duam të bashkohemi, dhe ta **"shpëtojmë"** Shqipërinë, si kusht i domosdoshëm (konditio sine qua non), dhe ky sistem, helli, për t'i kapur ata për fyti, dhe pastaj për t'ua rikthyer ZOTIN përmes

Krishtit e Muhamedit. Dhe nga ky egoizëm i tërbuar nuk po duan asgjë të sakrifikojnë. Kjo Shqipëri është një realitet i pamohueshëm, por për ne është si dergja, si mortaja, dhe mu këtu synojnë Horvati e kompani, që ta **shlyejnë nga faqja e dheut dhe harta e Evropës edhe këtë copë Shqipërie që ka mbetur**… Por dihet se as Bizmarku e as Hitleri nuk arritën t'i bashkojnë austriakët katolikë me Bavarinë protestane. Ne nuk duhet të kemi nge të merremi me FE, sepse kjo po na sjellë shumë dëm.

ꕥ

Gjiganti ekonomik TREPÇA po del në humbje?! Po si mund të ndodhë kjo, kur ky gjigant e zë vendin e parë në Evropë, dhe të tretin në botë për resurset që disponon…

Ne jemi tani **në mes të kudhrës dhe çekanit**, diellit dhe erës, duhet të jetojmë bashkë, por të ruhemi…

Pas Luftës së Dytë Botërore doli në shesh edhe një fakt i cili s'mund të merrej me mend nga asnjë teoricien i mirëfilltë i marksizmit: QË TË KËRCASIN PUSHKËT E TOPAT NË MES TË VENDEVE SOCIALISTE?! Më 1956 në Budapest të Hungarisë; më 1956 në Gdanjsk të Polonisë, me rafalë e me topa. Më 1968 në Pragë të Çekosllovakisë (në sheshin e qytetit u dogj me benzinë në shenjë proteste studenti Jan Palahu); në Kinë e Manxhuri; luftime të ashpra në mes të Kinës dhe Vietnamit më 1978-1979 dhe luftimet zgjatën dy javë, gjera këto që askush më parë nuk i ka marrë me mend, sepse format e reja të burokracisë, restaurimi i mikrobeve të burokracisë – **zhugës socialiste** – MORTAJËS SOCIALISTE, sepse u shkelën PARIMET E MIRËFILLTA SOCIALISTE, sepse punëtori, proletari në çastin kur pranon funksionin e burokratit, funksionarit, menjëherë tjetërsohet, për shkak të ndryshimit të kushteve të reja, privilegjeve, dhe i harron vuajtjet e deridjeshme, dhe kjo tingëllon si "Sjashi Kurto, da uzjashi Murto" (Zbrit Kurto që të kalërojë Murto). Dhe kjo po vazhdon në formën më flagrante këtu ndër ne kur me një kredi që e ka marrë dje prej një milioni, sot i vjen një

pagesë aq e vogël sa për ta blerë një shkrepëse, sepse devalvimi është shumë i madh. Vetë klasa e polit-burokracisë i ka uzurpuar mjetet e shtetit, popullit, sepse me ndërtimet kolosale që i kanë bërë me nga 12 dhoma komfore, tre kate i jep me qira… Por populli ende po hesht, sepse ende ka për të ngrënë bukë. Por hendeku i kundërthënieve sa vjen e thellohet çdo ditë e më shumë, por se kur do të shpërthejë, këtë nuk mund ta dijë askush… Dhe kjo po i ngjan asaj sikur po e thërrasim ujkun për t'na i ruajtur delet?! Por edhe për SOCIALIZMIN vlen thënia e popullit: LEHTË ËSHTË PËR TA FITUAR, PO ËSHTË SHUMË VËSHTIRË PËR TA MBAJTUR, ashtu siç është **më lehtë ta lindësh një fëmijë, se sa ta rritësh atë...**

Gjerat dy herë përsëriten, herën e parë si realitet tragjik, dhe herën e dytë si realitet komik, farsë, mashtrim, spekulim. Dhe nëna histori, nëna dialektikë, herën e parë **qan për ne**, ndërsa herën e dytë, kur lejojmë **të na mashtrojnë, ajo qeshet,** tallet me ne si me të papjekur, fëmijërorë.

Kjo Shqipëri siç është sot, ËSHTË SERIOZE, sepse aty zbatohet teknika tjetër, njerëzit tjerë, kultura tjetër… Pra nuk duhet besua pa rezervë askujt, bile as vetvetes… Dhe këtu kemi dy gjera: ose **të jesh i fortë, ose të paguash që nuk je i fortë...**

Kriza ekonomike po i kushtëzon edhe krizat tjera me këtë DEVALVIM rapid brenda 24 orëve, dhe kriza është si DEKA, e cila për dikë është lule e dritë, se të paktën një jorgan i mbetet si trashëgim, ndërsa kriza e përgjithshme është gënjeshtër, është rrenë, sepse ajo godet vetëm shtresën e proletarëve… Si të shpjegohet fakti flagrant i ndërtimit të rafinerisë së naftës në Shkup, e nafta s'është askund? Ose ngrihet hekurana e Shkupit, e hekuri s'është askund? Energjia, askund! Por këta sllavo-maqedonas po e shantazhojnë Federatën duke thënë: nëse edhe për ne nuk do të ketë rafineri, hekuranë etj. , atëherë ne do ndahemi, sepse **jemi pa kurorë**, sepse e kemi kushtetutën tonë të Maqedonisë, e jo të Jugosllavisë… Federata përmes gojës së Azem Vllasit, mikrofonit të federatës, foli në tribunën e

Splitit, por të tjerët iu kthyen me kritika dhe thanë: pastë faqen e zezë secili që është në federatë dhe nuk e nxjerrin jashtë me shkelma nga partia, si Fadil Hoxha, se kush na kritikon neve është kundërrevolucionar, dhe Serbia dhe Maedonia janë kategorike në këtë drejtim…

Maqedonasit shkuan edhe më larg me diskriminimin dhe aparteidin e tyre specifik, duke shpikur edhe termin – **MAKEDONSKI MUSLIMANI** (Myslimanët maqedonas), deri në vitin 1971, dhe ai që fliste maqedonisht, detyrohej të regjistrohej si maqedonas, edhe pse një diskriminim i tillë ishte kundër Kushtetutës Jugosllave, dhe e njëjta gjë u praktikua edhe me shqiptarët, të cilët e flisnin një gjuhë të veçantë shqipe me fjalë turke, dhe detyroheshin të shkruheshin – TURQ, dhe të gjithë këta banorë kishin ardhur në Prizren nga treva e Opojës, Luma, Hasi etj. , dhe ishte absurde të regjistroheshin turq… Një racizëm i tillë nuk ndodhi as në Amerikë, sepse atje nuk thotë zezaku që ka ardhur nga Afrika se jam – **ANGLEZ**, por as skocezëve e as anglezëve nuk u thonë se jeni zezakë, sepse ata nuk janë nga Ballkani me këso cilësish primitive. Dhe në gjithë këtë diskriminim **mjekrroshat po na i lejojnë kishat dhe xhamitë**, ndërsa **shkollat po na i mbyllin,** por nëpër shtëpia po na lënë të flasim në gjuhën shqipe, pra leje private, e jo zyrtare… Ndërkaq nëpër shkolla mësuesi duhet ta plotësojë ditarin me njësinë metodike edhe në **gjuhën maqedonase**. Marionetat shqiptare dhe kolaboracionistët po ua mundësojnë maqedonasve një diskriminim të tillë flagrant. P.sh. Sefedin Sylejmani është Tërnavci i Shkupit, bashkë me shumë të tjerë. Ata po na rrahin e persekutojnë në mënyrat më mizore, e ne po heshtim…

ꕥ

LIGJËRIME, 24 prill 1988:

Shkrimi i një gjuhe është pasqyrë e një kombi, pasqyrë e nivelit shoqëror dhe sistemit shoqëror, sepse kur

bashkërendohet dhe integrohet ortografia dhe standardizohet gjuha, atëherë nuk mund ta gënjeni askënd se **nuk jemi popull unik** me të gjitha cilësitë etnokulturore… P.sh. alfabetin kinez e kanë deshifrua vetëm klasa sunduese, dhe dihet se sa simbole duhet ditur (rreth 3000) për të qenë në majën e piramidës kulturore…

Nëse një hajmali e përktheni shqip, atëherë ajo nuk është hajmali, dhe me këtë dëshmojmë se sa e ulët është vetëdija e masës, sepse njeriu thjesht përton të vetëdijesohet, përton të jetë i fortë, dhe për të tillët nuk ia vlen barra qiranë të mësohet, ndërsa kur i ndodhin të papriturat thotë: e po kështu paska qenë e SHKRUAR?! Kjo është tejet konservative dhe primitive, prandaj nuk duhet të përtojmë t'i pastrojmë pelenat – rrobat e vetvetes…

Nga thellësia e Adriatikut u nxorën 12 amfora (vegsha) me lëng rrushi (verë) një lloj pupërr–vere, me një lashtësi prej mbi 2100 vjetësh, e kohës së Ilirëve…

Duke iu referuar çdo ditë perëndisë, **ia nxjerrin shpirtin perëndisë**, dhe kështu çdo gjë kur teprohet zhvlerësohet. Naim Frashëri ishte panteist, sepse zotin e shihte në çdo bimë, lule, gjallesë. Dhe njeriu i tillë nuk po bën ballë për ta pranuar REALITETIN OBJEKTIV ashtu siç është.

Inkarnimi i nënës së përbotshme, është nëna e fëmijës – **SHIVA**, te indianët… Një popull që nuk e njeh të vërtetën është larg lirisë, dhe njerëzit më parë dëshirojnë t'u tregohen **gënjeshtra me fjalë të ëmbla**, vetëm për t'ua plotësuar dëshirën, ashtu siç e gënjejnë gjyshet fëmijën me përralla për ta zënë gjumi më shpejt. **Por një popull që bën një gjumë të tillë kolektiv, hipnotik, VDES**.

Është shumë vështirë ta rrisësh një fëmijë, sepse një nënë e vërtetë e lë tërë jetën e saj peng, dhe 24 orë është në dispozicion të fëmijës, dhe i thonë: asgjë s'ke bërë, se punët tua nuk po shihen. Prandaj **NËNËN** duhet adhuruar më shumë se gjithçka tjetër.

Kemi shumë universitete islamike, si në Kajro-Al Ahzar (Egjipt), Lahor (Pakistan), Bagdad (Irak), Bengazi (Libi) etj, dhe ata që e mbarojnë ato universitete janë

sofistë, janë si jezuitët. Dhe është **shumë vështirë t'ia dalësh në krye me ta.** Në Kajro – sunitët, ndërsa në Lahor – shiitët (protestanët e myslimanëve)…

Vetëm në vitin 1957 u hap një paralele e shkollës së mesme në Prizren në gjuhën shqipe, e deri atëherë mësimi zhvillohej në gjuhën serbokroate, pra ishte koha kur lulëzonte "Bashkim-Vëllazërimi"…

Në ato vite (koha e klikës së Rankoviqit deri më 1966 – BK) në Prizren ai person që nuk ka ditur të flasë **"turqisht"** (gjuhë shqipe me fjalë turke), ai nuk ka mundur të gjejë vend pune, dhe një diskriminim i tillë bëhej me qëllime raciste për t'i dëbuar shqiptarët në Turqi… Ndërkaq edhe më zi ishte gjendja në Maqedoni, **ku shqiptari me fqinjin e tij fliste shqip vesh më vesh, jo me zë**, sepse do të ndiqej si i dyshimtë. Dhe populli e duronte një diskriminim të tillë duke u arsyetuar, se nuk dua t'i marr në qafë fëmijët… Dhe kështu gjuha ishte kriter për t'u punësuar dhe ndahej buxhet i veçantë për t'ua siguruar vendin e punës të tillëve, sepse pushtetmbajtësit me këto privilegje i joshnin shqiptarët luajalë duke u thënë: ata të cilët na ndihmojnë neve, ata janë njerëzit më të mirë, ndërsa turqit janë populli më i kulturuar… Përdorimi i gjuhës shqipe konsiderohej vepër **KUNDËRREVOLUCIONARE**, e dihet se as Hitleri nuk i ka bërë këto veprime raciste…

ꕥ

Nëse e bëni **PYETJEN me vend**, atëherë e keni dhënë gjysmën e PËRGJIGJES, dhe me këtë dëshmoni se jeni i denjë për bashkëbisedim, se jeni i kthjelltë dhe largpamës…

ꕥ

Emri shqip ZOJË d.m.th – PERËNDESHË – HYJNESHË, por jo thineshë, pra emrin duhet merituar **(emri i shkëlqyeshëm, vepra edhe më e shkëlqyeshme),** duhet arsyetuar me vepër, e jo vetëm me fjalë… TEUTA është emër indoevropian, ndërsa ZEUS (greqisht), në

shqip d.m.th – ZOTI… Ilirët, Keltët, Sllavët, Gjermanët etj. ishin grupe fisesh indoevropiane që sot i thërrasim popuj… **Para 4000 vjetëve shqiptarët e pararendësit e grekëve të sotëm ishin një POPULL**… Keltët ishin pesë popuj. Grekët e lashtë kanë kaluar si valë nëpër ilirë dhe thrakas**. PELLAZGËT ishin shumë para këtyre fiseve….**

Shqipëria e ka pozitën më të mirë gjeostrategjike se asnjë vend tjetër i Ballkanit, sepse këtë ia mundëson kanali i Otrantos, porta e Adriatikut, sepse është det i hapur, e jo si deti Baltik, qorrsokak, pa dalje, dhe mu për këtë shkak të gjithë pushtuesit kanë lakmuar për ta pasur në mbizotërim këtë vend strategjik… Serbia përherë ka ëndërruar të dalë në Adriatik, dhe për këtë shkak serbët kanë bërë investime të mëdha…

ꕥ

Sado të te lavdërojë NJERKA nuk mund ta arrijë qortimin e NËNËS, pra miku të qorton e armiku të lëvdon… Më mirë është të te shajë 1000 herë NËNA, sesa të te lavdërojë një herë NJERKA…

ꕥ

Më 17 mars Josip Gjergja tha: **ne kurdoherë përmes jugo-shqiptarëve duhet t'i çlirojmë shqiptarët** (e Shqipërisë – BK) **nga burgu**…

ꕥ

Fjala **MËSUES** është fjala më e lartë, më e shenjtë, më me vlerë, dhe nëse është mësues i popullit edhe më me shumë vlerë… Doktor – mësues i studentëve, instruktor, këshillëdhënës, ndërsa magjistër – mësues për shkollat e larta pedagogjike… Profesor – mësimdhënës, ligjërues… Doktor – doktus (latinisht) – d.m.th – i DIJSHËM, dhe **SAPIENTISAT** – d.m.th – për të mençurin mjafton, le ta marrë vesh ai që është në gjendje ta marrë vesh.

Sot shumica e popullit nuk pranojnë të evitohet kriza (inflacioni – 50%), sepse për kredinë me të cilën e ka ndërtuar një shtëpi me 12 dhoma sot po e paguan një pagesë mujore, aq sa kushton **një shkrepëse**, ndërsa vetëm prej qirasë ai person **i merr 10 rroga**, dhe njerëzit e kësaj kategorie kurrë nuk pranojnë të shkatërrohet kjo status-kuo, sepse edhe nëse nuk rrjedhin, së paku do të pikojnë privilegjet (privilegjet janë shokët e TIRANISË, thoshte Sami Frashëri).

ꕥ

Nëse vetëm **një unazë** e boshtit kurrizor **shkatërrohet,** shkon tërë shpina, me 33 unaza, tërë shtylla vertebrore, nga qafa e deri te legeni…

ꕥ

Sa ishim robër e kishim njëfarë statusi, ndërsa kur u bëmë të lirë – kurrfarë statusi, sepse po përpëlitemi në kthetrat e traditës. Sipas kësaj logjike po del se është më mirë të jesh QEN me kafshatë të siguruar, sesa UJK e pa kafshatën e siguruar…

ꕥ

NËNA – 24 orë amvise plus 8 orë, që do të thotë 36 orë, dhe kjo do të thotë se ajo nënë jetës së saj po ia merr 8 orë…

ꕥ

Qelizat nervore i kemi edhe në shputën e këmbëve, dhe vraponi, ecni, edhe natën nëse nuk ju zë gjumi, dhe bëhuni miq të natyrës, ngjituni maleve, sepse atje është ajri plot me ozon (0-3)…

ꕥ

LIGJËRIME, 9 maj 1988

ÇMIMI i plotë i të vërtetës është **RRENA e 100%,** përndryshe e kemi humbur edhe atë që kemi… Për rrenën fajin e ka e vërteta… P.sh, kur themi – UNË DUA LIRI, por të gatshme, pa gjak, pa sakrifica, kjo është një RRENË shumë e madhe, sepse dihet mirëfilli se nuk ka dhe nuk ka për të pasur LIRI nëse atë ta **"falë"** dikush, nëse e merr të gatshme. Me këtë arrijmë kulmin e naivitetit, sepse po kërkojmë gjëra të pamundshme… LIRIA duhet të paguhet çdo orë, çdo ditë, me punë dhe përpjekje të vazhdueshme, me sakrifica të mëdha, me disiplinë të rreptë, me kulturë të lartë… Të moshuarve, të vjetërve, do t'ua shohim sherrin… Sepse këpucët të cilat i kemi mbathur në moshën trembëdhjetë-vjeçare, sot, kur i kemi bërë 20 vjet, do të na vrasin, sepse këmba është rritur tanimë për disa numra, ndërsa dje ua kemi parë hairin… Dhe kështu çdo gjë duhet të përtërihet, duhet menduar me KOKËN TONË. Dhe nuk mund të themi në mënyrë kategorike: ky është rrenacak…. Por edhe të **VËRTETËN**, nëse e thua aty ku nuk është vendi, do të te marrë në qafë…

ꕥ

Siç po shihet në bazë të këtyre rrjedhave shoqërore ne ende jemi në fazën e spontanitetit?

Për ta kapërcyer këtë fazë të spontanitetit dhe të primitivizmit duhet punë dhe përpjekje permanente dhe sakrificë kolosale… Ne presim që sa më shumë të marrim dhe asgjë të mos japim, të mos paguajmë, të mos sakrifikojmë as **gishtin e vogël**, me fjalë tjera, ne jemi shumë të vonuar dhe ende po vazhdojmë ta mashtrojmë vetveten… Po të mos kishim qëlluar në këtë gjendje dhe me këto marrëzira FETARE siç jemi, kurrë nuk do kishte guxuar komiteti i Maqedonisë të veprojë siç po vepron me shqiptarët e diskriminuar deri në skajshmëri… Ata pyesin: çka po doni ju shqiptarët? ZOTIN! Ja ku e keni, merreni ZOTIN! Dhe në këtë mjegull dhe hipnozë kolektive masat janë trullosur… Dhe çfarë diskriminimi dhe racizmi, sepse kur lind fëmija i tretë

atje, nuk ka të drejtë të mjekohet, të marrë librezën e shëndetësisë, dhe ndihmën sociale… Dhe e njëjta metodë raciste është përdorur ndaj hebrenjve në Gjermaninë naziste të Adolf Hitlerit më 1933-1945, ndërsa për të tilla absurditete e marrëzira EVROPA u bë shkrumb e hi për katër vjet të LDB dhe i dha rreth 60.000.000 viktima … Është turp të mos dish se ku po të dhemb, të mos dish të konstatosh, dhe të shkosh si delet në thertore… Rasti i Maqedonisë është përjashtim nga Kushtetuta e Jugosllavisë, dhe ky përjashtim do të paguhet me kamatë më vonë, sepse ata po thonë: mjafton që është e dobishme për ne, ani pse është kundër-kushtetuese. Dhe kështu po veprohet që 17 vjet, dhe tërë Federata s'po guxon të flasë kundër, sepse arushën e vogël mund ta kapësh për veshi, por të madhën kurrë… Maqedonasit po thonë: ne kemi hyrë në Federatën jugosllave me kusht, dhe neve askush nuk guxon të na imponojë asgjë që s'do të ishte në dobinë tonë… Më 1981 nuk u respektua ligji Federativ për regjistrimin e popullsisë që secili të regjistrohet në bazë të përkatësisë nacionale, dhe atje fëmija nuk regjistrohet nëse emërtohet me emrin: ARBEN, SHQIPE, LIRIDON, FLAMUR etj. Kështu maqedonasit bëjnë përjashtim nga të tjerët, kërcënohen dhe bëjnë shantazh duke thënë se ne jemi në kuadër të Federatës me kusht, nëse kemi hesap rrimë, përndryshe bashkohemi me BULLGARINË… Dhe me veprimet e tyre raciste ata në të vërtetë po e dënojnë **me VDEKJE fëmijën e tretë të nënës shqiptare**… Ata në të njëjtën mënyrë veprojnë edhe me arsimtarët shqiptarë të cilët nëse mbajnë ligjërata në gjuhën shqipe, shpallen IRREDENTISTË dhe ndaj tyre merren masa diskriminuese duke i flakur në rrugë… Dhe kështu po del se ne ende nuk jemi bërë të vetëdijshëm se sa është **ÇMIMI I LIRISË, dhe po duam edhe mallin, edhe paratë?!** Kleri te ne është shumë i dobët, por ata nuk kanë faj. Faj kanë ata që e **dëgjojnë hoxhën e dobët**, i cili nuk i ka dy lidhje, dhe kësaj do t'ia shohim sherrin, sepse masat e hipnotizuara keqpërdoren. Dhe këto turma po besojnë, por do t'ia shohin sherrin këtij besimi. Kjo u konvenon kolaboracionistëve si **Sefedin Sylejmani, Njazi Limanovski, Halit Tërnavci etj.**

Kësaj injorance e këtij primitivizmi do t'ia shohim sherrin në të ardhmen, siç po ia shohim edhe sot, sepse nuk mund të shiten përherë rrenat se Muhamedi shkoi në Hënë me pallua, kur dihet se Apollo 11, me astronautin Nil Armstrong, zbriti në Hënë më 1969, dhe të gjithë e pamë përmes ekranit se çfarë shkretëtire ishte Hëna… Dhe me këtë iu dha fund legjendave e përrallave të shekullit shtatë…

ꕥ

Shembulli më shkollor se çfarë duhet të bëjë një shqiptar për kombin e tij është **Hasan Prishtina** i cili kishte shkrirë tërë pasurinë dhe tërë dijen për Shqipërinë… Ai kishte një shkollim të lartë në Selanik, e pastaj e kreu Fakultetin e Drejtësisë në Stamboll. Kishte një kulturë të gjerë bashkëkohore dhe ide iluministe, ishte një temperament i gjallë, dhe për kauzën e shenjtë të Atdheut nuk mund t'i dilte kush para, ndërsa shtëpia e tij në Shkup ishte kthyer në një vatër patriotike. Luftoi deri në vdekje për shkollën shqipe dhe për çlirimin dhe bashkimin e shqiptarëve në një shtet… Ai e hapi një shkollë në Moravë, një tjetër në Pozharan të Vitisë, dhe ndante mendimin se DITURIA është arma më e sigurt për kombin, se **ARSIMI ËSHTË SHPIRTI I KOMBIT.** Ndërsa kur ishte fjala për çlirimin e Atdheut nga zgjedha e robërisë, thoshte – Nuk ka rrugë tjetër për të fituar LIRINË përveç kryengritjes së përgjithshme popullore… Hasan Prishtina e ndihmoi financiarisht hapjen e NORMALES së Elbasanit më 1908 dhe gjithë djalërinë nga Kosova, d.m.th. gjysmën e nxënësve të Normales së Ebasanit, i financonte vetë. Ata nxënës i thërrisnin – DJEMTË E HASAN PRISHTINËS! Hasan Prishtina ngriti zërin kryengritës edhe në parlamentin turk, kur tha:

"Shqiptarit nuk mund t'ia lidh gojën,
jo dyfeku, por as TOPI!

Ai deri në vdekje qëndroi në **RRUGËN E LIRISË,** dhe kurrë nuk shkeli në rrugën e TRADHTISË… Ai thoshte: NGA RRUGA E LIRISË NUK DO TË MË PËRKULË AS ARI I TËRË BOTËS, as propaganda, as shpifjet. Nga kjo rrugë do të

më **MPOSHTË VETËM VDEKJA!** Më 1921 në Shkodër u botuan dorëshkrimet e tij – **NJË SHKURTIM KUJTIMESH....** Në Vjenë më 1918, bashkë me Bajram Currin, Fan Nolin e Hoxhë Kadri Prishtinën, formoi KOMITETIN E MBROJTJES KOMBËTARE… Më 1920 përshëndeti vendimet e KONGRSIT TË LUSHNJËS…. Nëntë herë u dënua me vdekje – tri herë nga satrapët e Zogut, tri herë nga Turqia dhe tri herë nga Beogradi (Jugosllavia)… Më 16 korrik 1933 një dorë e zezë gjakatare e tradhtare e paguar nga Ahmet Zogu e vrau në Selanik…. PPSH-ja ia riatdhesoi eshtrat dhe e dekoroi me titullin e lartë – **HERO I KOMBIT!**

ꕥ

Rizan B. Gjogjaj (1.04.1920), i burgosur politik nga Vërmica e Prizrenit. Dënimin e vuajti 4 vite në Goli Otok, 1 vjet në Bileqe, 1,5 vjet në Mitrovicë të Sremit, Nish dhe Prishtinë

LIGJËRIME, 25 maj 1988:

(Bisedë në banesën time me profesor Qazimin dhe Rizan Gjogjajn nga Petrova e Prizrenit, ish-i burgosur që kishte vuajtur shumë vite në skëterrën e burgut të Goli Otokut)

Profesor Qazimi:

Të mirat ta hanë kokën më shpejtë se të ligat... Vetëdija kolektive kombëtare është shumë mbrapa… P.sh. të kujtojmë vetëm këto dy raste: Në Lidhjen shqiptare të Prizrenit më 1878 asnjë rresht nuk është shkruar në gjuhën shqipe (janë ndrojtur se po u shkon fytyra!)… Edhe më 1912 Qeveria e Ismail Qemalit në Vlorë asnjë dokument nuk e ka shkruar në gjuhën shqipe… Këto janë dëshmi të pamohueshme dhe tregojnë se sa shumë jemi vonuar në vetëdijen kolektive

kombëtare… Dhe sot, në bazë të këtyre fakteve, kësaj vonese kolektive, nuk lënë gjë pa na thënë përmes gazetave e botimeve të ndryshme, edhe pse dihet se sa pashallarë e sa papë, sa kryeministra e sa mbretër ia kemi dhënë botës (vetëm perandorisë turke i kemi dhënë **40 sadriazema** (kryeministra), pastaj enciklopedinë e parë turke në gjashtë vëllime të Sami Frashërit, Rektorin e parë të Universitetit të Stambollit, Hoxhë Hasan Tahsinin etj.)… Prej francezëve ka dalë vetëm një papë, ndërsa prej anglezëve asnjë. Sllavët para 9 vjetëve e fituan papë Vojtilën, ndërsa ne kemi pasur perandorë si Konstandinin nga Nishi dhe Dioklecianin nga Spliti, Justinianin (Perandor Bizantin) nga Shkupi (Justiniana Prima), ndërsa papën Klementi (i cili dinte të fliste shqip) **që në shekullin XVIII, i cili na uroi me: "ZOTI IU DHASHTË BEREQET",** por magjja na ngeli thatë… Romakët **na kanë shtypur kokën tri herë më shumë se turqit**, të cilët na mbajtën nën zgjedhën e robërisë 500 vjet… Dyndja e shqiptarëve në Kalabri kishte bërë jehonë, dhe atyre ua dhanë tokat më të liga, por, shqiptarët e ikur nga Shqipëria pas vdekjes së Skënderbeut, i pritën mirë si punëtorë e ushtarë. Ata i vunë themelet e shkrimeve në gjuhën shqipe, dhe atje u ruajt kujtesa dhe heroizmi i epopesë së lavdishme të Skënderbeut… Të mirave duhet t'u ruhemi më shumë, sepse mund të ndryshojë raporti dhe çdo gjë merr tatëpjetën… Duhet të punojmë pa ndërprerë për t'i krijuar të mirat materiale dhe shpirtërore, por duhet të kemi dro se mos po na **kafshon VETËKËNAQËSIA...** Në qeverinë e Ismail Qemalit një perfekt fliste turqisht me perfektin tjetër shqiptar?! Poashtu edhe në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit Avdyl Frashëri e **mbajti fjalimin në gjuhën turke**, ndërsa gjuha shqipe është folur dhe është kënduar nga malësorët që banonin në zonat malore… Qe 3000 vjet trevat arbërore po tkurren, dhe jemi rrudhur e copëtuar deri në 28.000 km. Edhe kjo po u duket shumë racistëve, dhe ata po tmerrohen vetëm kur po e dëgjojnë emrin SHQIPËRI?! Dhe pse i kemi pësuar gjithë këto mynxyra?

Sepse na ka ardhur turp prej vetvetes. E dihet se ai që turpërohet nga identiteti kombëtar vetjak, është QYQAR, është i mjerë. Por edhe sot e kësaj dite kur flasim për gjëra të rëndësishme, për gjera kruciale e fondamentale, flitet me gjysmë zëri, me pëshpëritje, në vend se të flitet me zjarr e me alarm., me dhembje…

ꕥ

Ne kemi një gjuhë dhe disa dialekte, ndërsa në Kaukaz ekzistojnë 30 gjuhë… Në Greqi çdo i lindur regjistrohej në kishë te prifti, e jo te shteti, ndërsa shteti i mbante të gjitha shënimet administrative përmes kishës dhe famullitarët paguheshin nga shteti… Ne nuk duhet të mburremi se jemi më të mirë se të tjerët, kur dihet se të tjerët na çmojnë për hesapet e veta, por edhe na ndihmojnë për hesapet e veta, siç është rasti me Austrinë dhe Italinë… Kogito ergo sum (Mendoj, prandaj jam), thoshte Rene Dekarti, dhe ne duhet t'iu qasemi gjerave me dyshimin njohës, dyshimin e shëndoshë, dhe siç thotë populli: me e ngrënë kosin duke i fry!

ꕥ

Në bisedë inkuadrohet Rizan Gjogja dhe shton:

„Pushtuesi kolonizator jugosllav nuk ka lënë emër pa na ngjitë, nuk ka lënë të zezë pa na bërë. Më kujtohet kur më 1937 babai na i kishte blerë 16 plisa të bardhë për ditën e Bajramit, por ishte detyruar nga xhandarët serbë t'i blinte **16 shapka serbe**, sepse kur kolonët serbë ta shihnin plisin e bardhë, do ta mbysnin me dajak. Më 1933 na morën edhe tokën më të mirë, dhe më vonë u detyruam ta blinim tokën tonë me çmim shumë të lartë. Më 1938 kisha 18 vjet dhe shkova me plis të bardhë e kaporane për të gjetur punë në Beograd, në rrugën e cila sot quhet – Francuska, dhe nuk dija asnjë fjalë serbisht, ndërsa xhandari m'i dha dy shpulla të nxehta, dhe më tha:"Govori

srpski kako je govorio bog", dhe këto fjalë m'i përktheu shoku që kisha pranë vetes, se xhandari më kishte thënë: **"Fol serbisht, ashtu siç flet edhe zoti?!"** Dhe në vitet e pesëdhjeta më burgosi UDB-ja jugosllave duke më akuzuar si armik të Jugosllavisë. Kishte ardhur një emigrant (i ikur nga Shqipëria më 1949), dhe i kishte thënë babë Bajramit: "Djalin ta kanë marrë në burg se po e do Shqipërinë", ndërsa babai ia kishte kthyer: **"O zot, sa çudi kjo punë, ne po duam bashkim me Shqipërinë, e ju po ikni nga Shqipëria!"** Në Goli Otok, burgun famëkeq, hoqa të zitë e ullirit, por mjafton se aty i pashë gjithë lulen e idealistëve shqiptarë, gjithë ata heronj që u bënë fli për Atdhe, siç ishin Omer Çerkezi, Dr. Nexhat Agolli, Dr. Xhafer Kodra, Salih Lisi, Shefki Lleshi, Mark Prekaj, Sami Peja, Ali Presheva(Ali Aliu, vër. ime,BK) e shumë të tjerë. Ndërkaq ne sot kemi bërë pak shkollë, dhe nuk po e zgjatim gishtin, por po nënshkruajmë në gjuhën shqipe…

ꕥ

Pastaj xhaxhi Rizan e pyeti profesorin:

Lumë profesor Qazimi, a do t'bahet ma mirë se ç'asht sot gjendja?

Profesori iu përgjigj:

Patjetër se do të bëhet, sepse ky popull i lidhur për tokën dhe për familjen, si një rrap mijëvjeçar, me rrënjë të thella në truallin e vet, i përballoi sfidat e kolonizatorëve që u ndërruan njëri pas tjetrit dhe secili më i zi se pararendësi. Edhe vetë racisti serb me damkë Vasa Çubrilloviq e pranoi më 1937 në ELABORATIN e tij famëkeq se – LUFTËN E FITUAN SHQIPTARËT PËRMES PJELLORISË SË NËNAVE…

ꕥ

Duhet të kemi mend e të mos ia përmendim askujt se e kemi shpëtuar mbretin (e dihet se Amet Zogu e vrau dhëndrin e tij, Cana Begun, në Pragë ...

ꕥ

Xha Rizani shton:
Qeveria turke i ktheu shqiptarët në fenë islame…

Profesor Qazimi:
Latinët thoshin: CUIUS REGIO, EIUS RELIGIO – **Kujt i përket vendi, i përket dhe feja**! Por bashkë me FENË edhe të gjitha të ZEZAT tjera! E dihet se më lehtë të thyhet qafa duke të lavdëruar sesa duke të sharë, dhe më mirë është të te thonë – Po vjen ai derri, se sa – po vjen qyqari! Është trefish më keq kur këta me shkollë ia nxjerrin sytë njëri-tjetrit, dhe nga kjo del se nuk mjafton vetëm shkolla, sepse te ne **mungon shkolla kombëtare**, edukimi mbi bazën e atdhedashurisë dhe solidaritetit ndërvëllazëror. Ndërkaq, pa këto atribute dhe pa guximin qytetar, kombëtar e njerëzor, **i shkolluari i tillë është si pushka pa fishekë**, e topi pa predhë. Por nuk mjafton edhe sikur t'i kenë predhat, nëse nuk dinë se në cilin drejtim dhe kur duhet gjuajtur. Edhe Hitleri kishte bërë shkollë, dhe ishte më beter se analfabeti, sepse i porositi dhe i detyroi të shkolluarit për t'i konstruktuar bombat FAU 1, 2 dhe 3, e i ndërtoi edhe furrat në të cilat dogji për së gjalli miliona njerëz, fëmijë, gra, pleq, të gjithë të pafajshëm… **Hitleri erdhi në pushtet me votën e popullit**, dhe për të tretën herë me radhë shumica e gjermanëve ia dhanë pushtetin, **bile edhe 50% e punëtorëve votuan për Hitlerin?!** Mjafton ta lexoni librin e tij MAJN KAMPF dhe do të shihni se çfarë planifikonte ai tiran…

ꕥ

Pra nëse diploma nuk arsyetohet në vepër, ajo është e rrezikshme për popullin… Fjala **MËSUES** është fjala më e

madhe dhe **më e shenjtë...** Edhe fjala HOXHË d.m.th – mësues që jep mësim për SHPIRT! Populli i quan dyfytyrësha ata që flasin mirë dhe veprojnë keq, me hipokrizi. Ndërsa MËSUESI I VËRTETË atë që e thotë e bën vetë, dhe kjo do të thotë edhe i shkolluar edhe i mbarë, përherë në dispozicion të nxënësve dhe popullit. Dhe s'duhet harruar fjalët e V. Ygoit se: **ZOT I NJERIUT TË LIRË ËSHTË E VËRTETA!** Ne që nga 1966 mund të themi se kemi filluar shkollimin, dhe kjo për disa ishte NATA E MADHE e për disa NATA E ZEZË?! Satrapin Rankoviç e shanin dhe e quanin derr, por pas tij erdhën rankoviçat tjerë edhe më të zi se çetnikët e mbretit Krargjorgjeviç.

ꕥ

Xha Rizani i bashkohet bisedës dhe shton:

„Më 1947 më caktuan në fshatin Zhur të Prizrenit në detyrën e referentit të bujqësisë, dhe pastaj na dërguan në një kurs në Prishtinë, dhe më vonë donin të na sistemonin në Komitetin e Prizrenit… Më 1948 ishte ndërmarrë aksioni për formimin e kooperativave me dhunë, kolektivizimi pa pëlqimin e popullit, dhe nuk vonoi dhe plasi REZOLUCIONI I INFORMBIROSË. Nuk kishim kah t'ia mbanim… Duhej të deklaroheshim se me cilin jemi, dhe më 1949-1950 na futën në burgun e Goli Otokut… Atje takova shumë shqiptarë të profileve të ndryshme, ndërsa Rankoviqi vinte atje çdo dy muaj, edhe Çeça Stefanoviç, të gjithë ministra e gjeneralë. Aty në atë burg të tmerrshëm na jepnin vetëm 200 gram bukë në ditë. Mizoritë që i përjetonim brenda atij burgu nuk mund të përshkruhen me fjalë, sepse Rankoviçi i kishte edhe brenda burgut njerëzit e tij… Nga 70 kg që kisha, rashë në 54 kg, por në repartin tim me jepnin kurajë 8 luftëtarët e Spanjës, dhe unë aty mësova shumë gjera që kurrë nuk do t'i dija… Aty një hungarez (Dr. Tajtacek , këtë ma vërtetoi Ali Aliu– BK) më tha –

"Kjo është luftë për ta zhdukur socializmin, dhe se pas 20 vjetëve në pushtet do të vijnë FASHISTAT!"

Parashikimet e tij dolën të sakta… Pasi vuajta 7 vjet dënimin mizor në atë burg më liruan ashtu të sfilitur e të bërë kockë e lëkurë… Na ngarkonin tërë ditën të banim gurë në shpinë deri te kodra që i thonin – MONT EVEREST, sepse për ne ajo kodër ishte e tillë. Sa e sa njerëz alivanoseshin dhe ngelnin pa frymë se nuk arrinin të ngjiteshin dot deri në majën e saj… Dhe ky ishte UNIVERSITETI i Goli Otokut, në atë Mont Everest, që ishte bërë si kala me gjithë ata gurë që i çonim deri atje. Do të ishte njësoj sikur t'i çonim ata gurë në shpinë nga fshati **Velezhë deri në majën e Kalasë së Prizrenit**, dhe prapa… Atje në atë skëterrë unë u mahnita me heroizmin e Sami Pejës, pastaj Shefki Lleshit, Sami Junikut, luftëtarit të madh etj…

ꕥ

Profesor Qazimi ndërlidhet në bisedë dhe shton:

Aty në at ferr, në atë Goli Otok, ju keni qenë në varr për së gjalli, dhe është çudi si keni arritur të dilni i gjallë, dhe lirisht mund t'ju quajmë – **ÇELIK I GJALLË!**

Xha Rizani:

Në Goli Otok e mbytën në torturë mizore heroin **Omer Çerkezi** nga Mitrovica, një intelektual aq i dijshëm dhe i guximshëm sa nuk kishte shoq… Një Ibrahim Xhikolli ishte krejt tjetër, sepse ishte në shërbim të pushtetit, dhe pasi u lirova prej burgut, më erdhi në derë dhe më tha: Kam ardhur të më ndihmosh! Po çka të te ndihmoj, – i them? – Të ma shkruash një biografi për mua, më tha, dhe të ma nënshkruash ti me dorën tënde, ashtu më kanë thanë ata të komitetit (ako ti on potpishe i potvrdi – nëse ai ta nënshkruan dhe ta vërteton…). Dhe çfarë dallimi në mes këtij servili dhe **Sami Pejës**, i cili ishte 100% shqiptar i

vërtetë… Qamil Brovinën, me gradë kolonel, e mbajtën 8 vjet në burg pa ia falë asnjë ditë, edhe pse ia kishin bërë të mundur lirimin, por me kusht që të pendohet (REVIDOHET)! Ndoshta po gaboj, por të gjithë këta që po i mbarojnë shkollat, është mirë të dërgohen edhe nga 3-4 vjet në burg të rëndë, që të mund të çelikosen më shumë… Para luftës së Dytë Botërore as në Pozharevc, as në Pozhegë, as në Mitrovicë të Sremit, as në Lepogllavë nuk është vepruar si në Goli Otok… Në Goli Otok as zog nuk kemi parë, por vetëm shkëmbinj… Aty ose je forcuar, e ke dalë i gjallë, ose ke mbaruar, sepse tërë ditën, në pikën e vapës së verës, na jepnin vetëm një gotë ujë… Të lodhur e të rraskapitur hanim edhe ndonjë rrënjë bime, nëse e gjenim… Avni Zajmi e Faik Pruthi i thanin do lule dhe i pinin në vend të duhanit… Dy vëllezërit Agolli, **Nexhati dhe Qemali**, dy heronj të gjallë (ata ishin nga Dibra) na mahnitnin me qëndresën e tyre, të dy kishin qenë ministra në pushtetin e Maqedonisë… Nexhatin, si duket, e mbytën në burgun e Beogradit, sepse ishte doktor i Universitetit të Romës, dhe i njihte shtatë gjuhë botërore… Dy vëllezërit Agolli, Qemali dhe Nexhati, bashkë me Rifat Berishën, ishin marrë vesh për t'u arratisur pas Rezolucionit të Informbirosë, por në ndërkohë Rifatin e kishin rrethuar dhe e vranë…. Qemali shpëtoi, dhe pas burgut shkoi në Shqipëri… Në burgun e Bileqës e hipën në tribunë një gomar dhe thoshin se ky asht vëllai i Vlada Dapçeviqit, i cili ishte arratisur më vonë në Shqipëri, si informbyroist. Sami Peja i ka provuar të gjitha llojet e prangave, dhe zor se ka mundur kush të qëndrojë si ai… Dhe ai kurrë nuk u REVIDUA, kurrë nuk u pendua. Kur e pyesnin se për kë je ti, ai përgjigjej: PËR TËRË NJERËZIMIN, për çlirimin e gjithë botës nga prangat e robërisë…

Profesor Qazimi:

Trimi duhet të jetë guximtar, trimi është më i madh se guximtari, e burri më i madh se trimi, ashtu siç është dëftesa, diploma, sepse shkolla është punë e madhe, por

nëse nuk janë edhe atributet tjera, ajo nuk është kurrfarë shkolle… Kështu është edhe me trimat kur janë diferencuar, se Nikita Hrushovi u përkul para Titos për hesap të vet, e këtë e vërtetoi me okupimin e Hungarisë më 1956, dhe të Çekosllovakisë më 1968… Jugosllavia në vend të Siberisë e kishte Goli Otokun (Siberi përvëluese, jo dëborë e akull). Pra nuk mjafton vetëm trimëria, sepse vetëm një element po t'i mungojë nuk quhet trimëri… Aq më keq nëse dikush ty me bukë, e ti ia kthen me gurë… Ne ende nuk po i njohim mirë gjerat… Ne edhe këtu në Prizren kemi pasur të tillë që ishin dënuar, dhe i kishin dërguar në burgun e Goli Otokut, por atje u thyen, u penduan, dhe kolaboruan, ndërsa më vonë morën edhe titullin e doktorit të "SHKENCËS" e ligjëruan në Universitetin e Prishtinës. Dhe sa kemi të tillë që janë rekrutuar në shërbim të UDB-së nëpër burgjet tjera të Jugosllavisë?

Xha Rizani:

Edhe shefin e UDB-së së Beogradit e kishin burgosur atje, dhe e kishin bërë si kardinal, ia vinin telin në qafë dhe e hiqnin zvarrë nëpër Goli Otok… Eh, lumë profesori, sikur ta kisha pasur dijen tënde, **nuk kisha dashur asgjë më shumë në këtë botë!**

Jo, jo o Rizan vëllai, – ia pret profesor Qazimi, – se edhe unë po ta kisha pas fatin tënd të vuajtjeve të Goli Otokut, nuk do ta ndërroja me asgjë, edhe pse unë e pata vuajtur dënimin e Gestaposë gjermane, në burgun e Tiranës…

Pastaj profesor Qazimi vazhdon:

E keqja vlen si ilustrim i të mirës; TRURI I VOGËL është rrënja e SHPIRTIT për të gjitha funksionet: për frymëmarrje, orientim, ushqim etj.

Racistat e vranë në zverk Abraham Linkolnin, kryetarin e Amerikës, ndërsa racistët serbë këtu në Jugosllavi janë në gjendje të vrasin edhe më shumë, sepse ata thonë: aq sa ka SERBIZËM në Jugosllavi, për aq do të rrojë Jugosllavia. Ndërkaq, **Kosta Novakoviqin** e gjakosën në Parlamentin serb, sepse ai kishte shkruar të vërtetën në librin: **SERBIZACIJA KOSOVA** (Serbizimi i Kosovës). Duke filluar nga liturgjia në kishë e deri në komitetet e partisë "komuniste" është i njëjti program i serbizmit (13 orë program plus tri orë liturgji)…

ꕥ

Mesha është kompozuar para 1500 vjetësh, që nga perandori Shën Konstantini, me financimin e shtetit romak, dhe kështu u zyrtarizua krishterimi…

ꕥ

Millosheviqi po e instrumentalizon kishën, ashtu si edhe pararendësit e tij, po e bën vegël, në krye me peshkopin German, funksionarin e parë të kishës ortodokse serbe, i cili ndahet nga familja, dhe jeton pa familje, bëhet murg, sepse sipas predikimeve të **Platonit** (para 2400 vjetëve) njeriu nuk mund të jetë i drejtë nëse ka familje, sepse anon dhe e privilegjon familjen e tij… Pra sot është duke u bërë marketing me formën, mbulesën, e jo me brendinë, esencën. Dhe kështu rrenat më të mëdha po mbështillen, kamuflohen, ambalazhohen, me gjysmë të vërteta, ndonëse brenda e ka dinamitin, ndërsa gëzhoja, mbulesa, amortizatori, e ruan nga shpërthimi. Dhe gjithë kjo po bëhet për shkak të shqiptarëve. Mirëpo gjerat kanë dalë në sipërfaqe dhe hendeku i kontradiktave nuk po mban më… Në Prishtinë **më 27 mars 1989** vriten 4 demonstrues, ndërsa në Pekin në qershor 1989 vriten 100, dhe çdo gjë atje mbyllet pa zë sepse demonstrata në Tien an Men, në Pekin, shuhet me gjak, ashtu siç u shua edhe

demonstrata në Prishtinë nga forcat ushtarako-policore jugosllave.

Rrahman Morina, poshtoni albanac ("shqiptar i ndershëm") e ka në shpirt mjekrën, dhe nuk ka nevojë të lëshojë mjekër… Kështu këta racista çdo ditë e më shumë po e fundosin vetveten duke thënë – Evropa nas ne shvaça, Evropa je glupa… (Evropa nuk po na kupton, Evropa është e marrë…), ndërsa Mikail Gorbaçovi nuk po ka hesap të hyjë llucave, dhe ta përkrahë haptas Jugosllavinë e Millosheviqit, sepse përbrenda i ka llucat e veta, dhe kështu krejt Evropa do ta dënonte, kur dihet se në KOTORR është pika më strategjike në Jugosllavi, e dihet se **RUSIA ka hesap vetëm Kotorrin ta mbajë si një garazhë detare**, ndërsa me muaj nuk po arrijnë t'i mundin muxhahidinët dhe ta pushtojnë Kabulin në Avganistan, ku rusët po luftojnë për t'i instaluar bazat e veta si dikur në Sazan, Vlorë e Karaburun… Naseri ua dha rusëve një bazë, në Aleksandri, dhe si kundërshpërblim rusët ia ndërtuan Digën e Asuanit në lumin Nil, deri sa erdhi Sadati, i cili i dëboi, dhe tani rusët janë vendosur në SIRI, në Latakia… Dhe kështu me vdekjen e Naserit, vdiq edhe baza në Aleksandri… Për ta marrë këtë bazë Sadati pushkatoi 12 arabë prorusë, ndërsa Shqipëria më 1949 e pushkatoi Koçi Xoxën, i cili donte t'ia bashkonte Shqipërinë Jugosllavisë, si REPUBLIKË E SHTATË… Duhet ta kemi **syrin e unët**, jo për pare, por për gjera tjera jetike, të domosdoshme, **për nderin dhe Atdheun**, sepse nderi nuk mund të shpëtohet me pare… Në hotel nuk zihet miku… **100.000 vetë do ta kishin pushtuar gjysmën e Evropës, siç ishte rasti me demonstratat dhe protestat e NËNTORIT 1988,** por ato ishin spontane, pa organizim, episode, pa bazë programore, si shkumë sapuni, një flakë e vogël. Dhe pastaj erdhi ofensiva ndëshkimore, masat ndëshkimore, dhe Kuvendi i shpalli kriminelë 1000 minatorët e ngujuar në zgafellet e nëntokës, në Trepçë, **1000 varre nën dhe**. Dhe në këtë fushatë raciste Serbia i shpalli kriminelë edhe Vllasin, Abrashin, Kavajën etj., por

Amerika intervenoi, dhe nuk po lejon të likuidohen, ndërsa këto marioneta po thonë – ne jemi në shtëpinë tonë?! Por kush mund të garantojë se fqinjit tënd nga kjo kasaphanë nuk do t'i kalojë as tymi pranë shtëpisë? Tani është e treta herë që ministri i punëve të jashtme të Jugosllavisë, Llonçar, që po jep llogari, sepse e din se i ka borxh botës së kapitalit miliarda dollarë, tha se – pardje (d.m.th. më 20 shkurt 1989) i kemi lëshuar nga izolimi. Atyre po u nevojiten faktet formale, që dikë ta likuidojnë, sepse ata e dinë se 20-30 vetë i kanë izoluar, por duan të dinë se çfarë është duke u bërë me të izoluarit (të burgosurit) shqiptarë. Dhe dihet se në atë farë javna pishanica (**NEVOJTORE PUBLIKE**) të quajtur – **Akademi e Shkencave Serbe,** bën pjesë edhe krye-racisti Vasa Çubrilloviq, i cili më 1937, në Elaboratin për shfarosjen e shqiptarëve porosiste: "… Që në gjumin e parë më të thellë, kur asgjë nuk pipëtin, t'ua futni flakën shtëpive të shqiptarëve…, ". Dhe pikërisht ai racist sot është legjitimuar si patrioti më i madh serb?!

Edhe gjarpri është inteligjent, por gjarpër është, e jo njeri. Xhafer Deva ishte bërë vegël e nazifashistëve të Hitlerit… Serbët po thonë: ne jemi popull i veçantë në Evropë, popull qiellor, të dashurit e zotit, ndërsa shqiptarët i identifikojnë me EGËRSIRAT, (divljastvo), barbarët, ndërsa ne, kur ata na identifikojnë si të tillë, duhet ta dëshmojmë se jemi – **EGËRSIRA,** se jemi të fortë, e jo QYQARË.

Sepse unë kam mendua se ju jeni kuçedër, e cila djeg e përvëlon (zhari i pali), kur i pata lexua punimet e J. Buxhovit, dhe kjo dëshmon se çdo episod shteret, dhe sado me pas magjja miell, merr e mos qit, ajo shteret një ditë,

…sepse vetëm fëmijës i duhet treguar përralla, për ta zënë gjumi, ndërsa popullit i duhet treguar të vërtetën… E dihet se ne nuk jemi fëmijë, sepse që nga nëntori 1988 e deri në mars 1989, asnjë shqiptar nuk ia ka marrë gjakun dikujt *SEPSE TËRË ENERGJIA E POPULLIT KISHTE SHPËRTHYER NGA QARKU I MBYLLUR DHE

ISHTE DREJTUAR KUNDËR ARMIKUT, E JO KUNDËR VETVETES). Ndërsa më parë çdo ditë janë vrarë me shoqi-shoqin… se gjakmarrja është PANDEMI, dhe domosdo duhet të shërohemi nga kjo sëmundje shekullore, duhet të ndërpritet kjo dukuri vetëvrasëse, siç e kanë zhdukur në Shqipëri, dhe të armatosemi në pikëpamje strategjike kundër armikut kolonizator. Sepse humbja e energjisë kombëtare në luftë me vetveten, do të na kushtojë shumë, sepse jemi vonuar me shekuj, kur dihet se deri më 1912 nuk kemi mundur të formojmë shtet, sepse çdo bajraktar të mëhallës e kemi shpallur mbret, dhe nuk kemi pasur ideologji shtetërore, **bile edhe Teuten e kemi shpallur mbretëreshë, e ajo i ka vra dy delegatët e Romës, dhe plasi lufta ilire-romake (casus belli – shkak lufte)...**

Më 3 shtator 1987 në kazermën e Paraqinit armata jugosllave e vrau mizorisht studentin **Aziz Kelmendi,** dhe vrasësi, i cili i "humbi" gjurmët, i ka vrarë edhe 10 ushtarët të tjerë, ashtu siç e vrau Li Osvaldi Xhon Kenedin (presidentin amerikan më 1963), sikur të qe Azizi një fantazmë. Dhe është e çuditshme dhe e pakonceptueshme se si qe e mundur të bashkoheshin në një dhomë serbi, boshnjaku, maqedonasi, kroati dhe slloveni?! Secila nënë që e ka dërguar të birin në armatën jugosllave pret në ankth se mos edhe biri i saj një ditë do të **kthehet i masakruar si Azizi, në arkivol**… Kjo tragjedi e Paraqinit, ky skenar perfid, është **kulmi i racizmit jugosllav.** Armata jugosllave është burgu më mizor për rekrutët shqiptarë, sepse aty si në laborator rekrutohen ata që do të bashkëpunojnë me shërbimin sekret në armatën jugosllave, me shërbimin e KOS-it. Ndërkaq, ata djem trima që e refuzojnë këtë bashkëpunim i pret plumbi i armikut (këtë e vërtetoi edhe oficeri i KOS-it, slloveni Roman Leljak, në librin e tij **"I vetëm kundër tyre").** Këta edhe të vrasin, por edhe të AKUZOJNË për vrasës, siç vepruan me Azizin duke e shpallur KRIMINELIN MË TË MADH NË JUGOSLLAVI (shih librin pamflet të botuar

në Beograd më 1990 – DESET NAJVEÇIH ZLOÇINACA U JUGOSLAVIJI – DHJETË KRIMINELËT MË TË MËDHENJ NË JUGOSLLAVI?!). Ndërsa në Kragujevc serbët e vranë nënën shqiptare me të birin, dhe vrasësin e shpallën psikopat, dhe pastaj e liruan?! Në anën tjetër, këta racistë propagandojnë se ligji serb është ligj njerëzor… Ne duhet të jemi të zotët për ta shfrytëzuar këtë shans, t'i hapim sytë sa më shpejt, sepse çdo gjë që merret e gatshme është HARAM, e pamerituar, dhe një ditë të mbetet në fyt. Sot po mbështillen rrenat në celofan, në ambalazh luksoz.

Nuk ka më FAJTOR se ai i cili e duron terroristin, kolonizatorin, dhe sa më NJERI që je, aq më pak DURON, dhe kurrë nuk thua: ia paça lënë zotit, se ai ia thyen qafën, dmth zotin e ke si rezervë për t' ia lënë FAJIN, në vend se ti vetë të bëhesh zot i vetvetes, i zoti i punës. Është shumë domethënëse semantika e fjalës ZOT, aftësia e lidhur me zotin, dhe dihet se bashkimi bën FUQINË, dhe fuqia sjell FITOREN… Duhet të gëzohemi kur shoku apo vëllai arrin një sukses dhe jo ta akuzojmë dhe të jemi xhelozë negativë…

ꕥ

Profesor i nderuar, një herë na keni folur për zgjedhjet e para pas luftës, dhe juve iu kishin caktuar sekretar në vendvotimin Han të Elezit, dhe kur i diktuat falsifikimet u zhgënjyet shumë dhe filluat të pini. Vallë mos donit ta ngushëlloni vetveten ma këtë pije?

Më 1945 u zhvilluan zgjedhjet e para pas luftës. Mua më kishin caktuar sekretar vendvotimi në Han të Elezit, dhe kur e pashë se ne nuk jemi askund, që nga ajo kohë fillove të pi, edhe pse e dija se sa dëm do t'i shkaktoja organizmit tim, edhe ashtu të dobësuar… Ato votime quheshin demokratike, ndërsa kryetari më kishte propozuar një FALSIFIKIM, sepse 7-8% të votave ishin

për **Drazha Mihajloviqin**, ndërsa për pushtetin demokratik – 92%, dhe kështu me këtë falsifikim donte t'i komprometonte edhe ato 92% të votave… Dhe që nga ajo kohë **unë u distancova** nga këta kolaboracionistë… Ne edhe sot e shohim një Rrahman Morinë, e Rrahmani nuk është vetëm, (Mos harroni se më **23 mars 1989** në KUVENDIN E KOSOVËS nga 120 delegatë, **vetëm 10 prej tyre** abstenuan ose votuan kundër suprimimit të asaj pak AUTONOMIE të vitit 1974), por janë me mijëra Rrahmana, me mijëra Hasana e Sinana, por ata **nuk deklarohen**. Dhe të gjithë janë varrtarë për ta varrosur nënën SHQIPËRI, dhe ditë e natë po punojnë për ta ndryshuar sistemin socialist në Shqipëri…

ꕥ

Lumi Shkumbin është kufiri në mes të Toskërisë dhe Gegërisë, ndarja dialektore, sepse në veri nuk ka ortodoks, dhe kreu kishtar grek nuk i pranon shqiptarët ortodoksë përveç si grekë, të krishterë grekë. Konstantin Kristoforidhi, shqiptari më atdhetar dhe më i shkolluar, kur vdiq, nuk e varrosën në varrezat ortodokse, sepse kisha greke e kishte mallkuar dhe e kishte identifikuar si SHQIPTAR!

Gjysma e farmakologjisë funksionon në bazë të helmeve (etil-alkooli)… Vinston Çërçilli ishte alkoolik ordiner, por shumë energjik dhe veprues… V. Stalini ka pirë alkool të fortë, dhe me spec djegës, me spec të shtypur, vodkë, dhe **ka punuar 20 orë pa pushim,** dhe puna e tij kryesore ka qenë ta ndalojë RUSINË për të mos i shkatërruar të tjerët, në një kohë kur nuk kishte as bukë. Vetëm një STALIN e ka ndaluar Rusinë të mos i shkatërrojë të tjerët, dhe mund të quhet **shpëtimtari i popujve të vegjël...** Por ai nuk mund të kishte MERITA pa pasur edhe faje, dhe sa më shumë merita, aq më shumë faje… por nuk kishte rrugë tjetër për ta SHPËTUAR SHTETIN SOCIALIST SOVJETIK. Ndërkaq, kur Shqipëria

ishte pothuaj para rrezikut më të madh për t'u gllabëruar nga Jugosllavia, **Stalini e përkrahu Enver Hoxhën**, dhe **Shqipëria shpëtoi pa hyrë në një kasaphanë të re...**

ꕥ

Në Zvicër fliten katër gjuhë, por të gjithë janë zviceranë, ndërsa te ne i kemi katër lloj sektesh fetare. Në Zvicër komuna (deri në 10.000 banorë) është shtet, disponon me atributet e shtetit.

ꕥ

Kur ndonjë libër ndalohet, si **GJARPINJTË E GJAKUT** të autorit Adem Demaçi, atëherë ai kërkohet dhe lexohet akoma më shumë… Kur nuk ka Rrahman Morina, atëherë duhet të prodhohen, sepse edhe **helmin** duhet prodhuar, acidet, bazat… QËNDRIMI shprehet më së paku me FJALË, dhe kriteri i së vërtetës është – PRAKTIKA, VEPRA… Të marrim mësim nga pësimi, dhe nuk duhet të mashtrohemi, sepse të gjithë janë me një strategji: si Kuçani, Markoviqi, Dernovsheku etj.

ꕥ

Vietnamezët kanë bregdet sa kinezët, vend tipik bregdetar, me gjirin e Tonkinit (në Veri), Ananit (në mes), Kotinkinit (në jug), dhe aty do të jetë ardhmëria e shekullit XXI, me resurse shumë të mëdha, ndërsa me një popullsi prej 60 milionë. Ndërsa Kina ka një miliardë, por Kina është e bllokuar nga pjesa jugore. Mirëpo edhe pse Kina dhe BRSS i kanë ndihmuar Vietnamit, tani nuk po shihet kapitali nga kamata, ashtu siç janë edhe borxhet e Jugosllavisë…

Për ato që ndodhën para pak kohe në Titograd, Stipe Shuvari po thotë se kanë qenë eskalacion çetnik…. Federata duhet të bëjë çmos që Serbia t'mos e teprojë (më

shumë duhet të frikohemi kur i kemi të gjitha të mirat, për t'mos ua parë sherrin)… Federata po e lidh ndjenjën e terrorit me barazinë, por edhe kryeçetniku Millosheviq po flet siç po flet Federata, se gjoja TERRORI është pasojë e BARAZISË?! E kjo do të thotë se barazia për serbët është PABARAZI, është TERRORIZËM?! Dhe kurrsesi nuk po mund ta marrin me mend se si është e mundur me qenë të barabartë serbët me shqiptarët, ndërsa Federata po u thotë që të bëjnë çmos dhe të merren vesh mes veti serbët dhe shqiptarët. Me këtë po dëshmohet se çështja e Jugosllavisë është e ndërlikuar, sepse të vërtetat po pranohen në mënyrë të njëanshme… Me gjysmë të vërteta Serbia po vazhdon ta mashtrojë Federatën, dhe nëse kjo arrihet, atëherë do të paguhet KAMATA, d.m.th. do të SHKATËRROHET Federata Jugosllave… REVOLUCIONI bën vetëvrasje nëse niset nga platforma raciste se – TËRË NJË POPULL ËSHTË ARMIK – KUNDËREVOLUCIONAR! Por neve duhet të jemi në nivel, të mos gabojmë! Kosova është në fokus të ngjarjeve botërore, sepse këtu është ndryshe nga Novi-Sadi, se për Federatën është – të jesh apo t'mos jesh (biti ili ne biti), sepse Kosova e dha provimin, sepse për 12 orë u ngritën nga 7 vjeç deri në 70 vjeç në këmbë, dhe mu këtë faktor shpërthyes e ka parasysh Federata jugosllave… Në Maqedoni deri tash kanë gri, e tani po vazhdohet me masa tjera, pa i gri, sepse Evropa nuk po lejon që këtu të bëhet si në LIBAN…

ꕥ

Me shpenzimet që u bënë për palestrën"BORO DHE RAMIZI" në Prishtinë mund të ndërtoheshin 20 shkolla me tërë pajisjet… vetëm që Prishtina të duket si Los Angjelosi, ndërsa Lubjana akoma duket si para 100 vjetësh… Hotel si GRANDI nuk ka as në Paris, dhe i tillë është edhe Hotel PASHTRIKU në Gjakovë. Por nuk duhet harruar se këtu i kemi mbi 500.000 njerëz të papunë të cilët bredhin rrugëve…

Ne po luftojmë për barazi qytetare, për të drejtat njerëzore, por jo edhe për barazi KOMBËTARE, pa të cilat nuk mund të ketë as të drejta njerëzore. Dhe po thonë se po luftojnë për të mirën tonë qytetare. Të gjitha këto janë sofizma të kulluara… Por edhe ata që kanë marrë pjesë në protestat e 1988 nuk besojnë në suksesin e tyre… Dhe këta 3000 heronjtë e nëntokës së Trepçës ia kanë futur dridhmën Serbisë dhe kanë bërë efekt 100 herë më shumë. Me këtë iu ndal turri çetnikëve të mos hapen topat e automatikët… **Pra efekti i 3.000 trimave të nëntokës, me gjithë përgatitjen si minatorë**, si astronautë, kishte aktivizuar mekanizmin e VETËMBROJTJES, dhe nuk ishte sa për dekor, sa për reklamë, sepse **ato 8 ditë kishin bërë efektin e bashkimit sa për 80 vjet**, dhe të gjithë ishin bërë një me preokupimin dhe me kërkesat e MINATORËVE. Por ata më në fund u tradhtuan, dhe u TRADHTUN shumë keq…

ꕥ

Origjina nuk është çdo gjë, është një moment, siç është rasti i Mamushës, se gjoja kanë ardhur nga Kaukazi (?!), por kjo është vetëm një kozmetikë perfide, sepse dihet se gjithë mamushasit u takojnë **fiseve shqiptare: Mazrek, Krasniq, Thaç, Gash, Bytyç, etj.**

Në Skandinavi janë ruajtur fiset gjermanike, për 2500 vjet, ata janë më të pastër, më arianë, të përzier me racën mongole… Finlanda, Norvegjia, Suedia, çfarë kulture e raca të ndryshme, dhe tri kombe: indigjenët, raca e verdhë, raca e bardhë, (Karelët, Laplandi, Finlandezët), ndërsa dega jugore e tyre – Hungarezët, plus bullgarët, të cilët e kanë mbajtur emrin, me sytë e me gjakun sllav, plus gjuhën, ndërsa hungarezët edhe sytë edhe gjakun, ndërsa emrin dhe gjuhën i kanë origjinale – hungareze, por edhe arkitekturën e Azisë Qendrore (me stilin e kulmeve të shtëpive, më të ruajtura se te finlandezët dhe karelët). Ndërsa ne po të guxojmë e të flasim diçka për Mamushën,

se këta po bëjnë falsifikim politik, sepse po kanë hesap, sepse tani po zhvillohet lufta se kush kënd po e bën gomar! Aty i kemi fiset Gashi, Thaçi, Mazreku, Krasniqi, dhe këto mamushaliu i merr për të mos rënë në thumb të pushkës, për t'u përshtatur, mimikri, si kameleoni, për t'u vetëmbrojtur…

Ajnshtajni gjerat i merrte si RELATIVE e jo absolute, ndërsa shoku (X-Y.) i merr si ABSOLUTE, si ëndërr, e jo si zhgjëndërr, si dikujt që nuk i mjafton e vërteta, dhe e përdor rrenën…

Prizrenasit po tregohen më guximtarë se ata që flasin shqip, dhe me qëndrimin e tyre po tregohen më patriotë, se e kanë zanafillën nga bjeshkët… Prizreni ishte një nga katër qendrat kryesore: SHKODËR-PRIZREN-SHKUP-SELANIK., dhe së paku për 3000 vjet është bërë efekti që këtu të flitet gjuha e sundimtarit: në fillim latinisht, pastaj greqisht, dhe turqisht (500 vjet), dhe tani me qëndrimin e tyre po e kompensojnë atë vonesë, dhe po i dërgojnë fëmijët e tyre të mësojnë në shkollat në gjuhën shqipe. Ndërkaq në vitet e 50-ta njëri vëlla mësonte në shkollën shqipe, ndërsa tjetri në shkollën turqishte, për t'u bërë aq luajal sa të zgjidhet edhe sekretar komiteti?!

ꕥ

3000 minatorët e Trepçës, nuk kanë bërë asnjë ekses, dhe mos na bëni qorra dhe t'na gënjeni… Por sot **rrena** po **shitet si hallva, si helmi, dhe po thonë** – fol çfarë të duash vetëm mos e thuaj **TË VËRTETËN**… Por ne ende nuk jemi në nivelin që duhet, sepse ende jetojmë në iluzione, dhe po sillemi në rreth, në rrethin e mbyllur, në vend se me sa më pak sakrifica t'i realizojmë të DREJTAT TONA LEGJITIME… A mundet njeriu të jetë patriot duke përfituar me spekulime. Një ditë gjeneratat që do të vijnë pas nesh do ta paguajnë kamatën, edhe pse ato nuk kanë asnjë FAJ. … Policia e verboi të burgosurin patriot me

reflektor special në burgun e Nishit (SH. M), pa e prekur fare, dhe këto metoda raciste i përdorte UDB-ja ndaj atdhetarëve të pathyeshëm…

Si këtu, si në Shqipëri, ne jemi një KOMB i cili ende mburret me të zezat e veta… Ne duhet ta dallojmë shqiptarin në bazë të përkatësisë klasore, e jo në bazë të gjyshit e katragjyshit… Dhe jo diferencimit në bazë të emrit të cilin ia ka ngjitë baba sheh, imami i xhamisë, apo prifti. Më hesap ke ta thërrasësh fëmijën BALOSH se sa Abdullah etj. Ne duhet ta paguajmë ÇMIMIN E LIRISË ME KOKË, ndërsa dihet se ai që nuk e sakrifikon një viç, një pulë… për mëmëdheun, ai nuk mund ta sakrifikojë as kokën e tij…

ꕥ

LIGJËRIME, 8 korrik 1998:

Hysen Tërpeza po thotë se: "Të kuqët e shkatërruan Shqipërinë… "?!, Ta thuash këtë është më shumë se padituri, do të thotë të rreshtohesh në krahun e humbësit, në krahun e kapitulluesve, dhe jo në krahun antifashist, në krahun e FITIMTARËVE…

ꕥ

Para 130 vjetëve **Xhuzepe Garibaldi** e pushtoi Vatikanin, kur kryeqytet ishte Firenca, dhe pastaj Roma u bë kryeqytet. . Papa Gjon Pali II e bëri me çmimin Nobël Nënë Terezën, Gonxhe Bojaxhiun, shqiptaren nga Shkupi, dhe kjo nuk ishte rastësi, sepse për këtë vendosi Amerika (SHBA) dhe Vatikani. Varrimi i saj u bë me shumë pompozitet në Kalkuta të Indisë.

ꕥ

Për 1000 vjet Franca ishte shteti më i fortë në botë…

ꕥ

LIGJËRIME, 9 korrik 1998:

Korrupsioni i shkallës së parë është më i rëndi, sepse të kesh familje e të mos jesh i korruptuar është shumë e zorshme…. Komunizmin nuk e zbuloi Marksi, por që nga Platoni, këtu e 2000 vjet më parë, dhe u vërtetua se nuk mund të ecet përpara nëse udhëheqësit në krye të shtetit janë të korruptuar… Prandaj në krye të shtetit është defekti, është bllokimi, dhe pa u eliminua shkaktari, nuk mund të eliminohen pasojat…

Klaus Kinkel (Ministër i punëve të jashtme të Gjermanisë) po thotë: "Pavarësia është ëndërr ataviste… dhe se në rast të shpërthimit të luftës separatiste në Kosovë, atëherë Gjermania nuk do t'ju përkrah, dhe çfarë doni ju më shumë se autonomi, kur politikanët në Kosovë nuk po kërkojnë më shumë?!". Por duhet ta dimë se çka i tha Kinkelit militanti i orëve të para të Lëvizjes për çlirim, Fehmi Lladrovci, derisa po mbante grevë urie në Bon të Gjermanisë:

"Ju zotëri, ÇDO GJË MUND T"NA NDALONI, POR QË TË VDESIM PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS, KËTË NUK MUND TË NA NDALONI KURRË, EDHE SIKUR GJITHË EVROPA T'I BASHKOHEJ SERBISË!...

VDEKJA PËR LIRINË E KOSOVËS DO TË ISHTE FATI IM MË I MADH JETËSOR!... " (Shih: KOHA DITORE, 9. 05. 1998).

Dhe këta djem janë dalzotësit idealistë, që po ma kujtojnë Qemal Stafen, Emin Durakun, Ramiz Sadikun, Manush Alimanin, Asim Vokshin, Omer Çerkezin, Abdullah Preshevën, Shaip Mustafën, Fazli Greiçevcin, Jusuf Gërvallen, Kadri Zekën, Xhemaili Berishën, Aziz Kelmendin etj.

Ajo që ndodhi me minatorët e Trepçës në ato tetë (20-28 shkurt 1989) ditë të ngujimit në shtatë palë tokë, në 11 horizontet e nëntokës, nuk kishte ndodhur as në Kili, as në Afrikën e Jugut, as në Bosnjë, dhe më 28 mars 1989 Federata Jugosllave ia suprimoi Kosovës edhe atë Autonomi formale të vitit 1974, dhe kështu qorrat po ia mbrojnë Federatës portën, dhe po ia bëjnë Serbisë për hair Kosovën duke pirë verë e "shlivovicë", ndërsa rrugët e Kosovës u lanë me gjakun e rinisë heroike.

ꕥ

Epika mitologjike… Në viset e atëhershme të Serbisë (Pashallëkun e Beogradit) nuk kishte kryengritje për tre shekuj me radhë, që nga 1389, që nga Lufta e Kosovës, por bënin luftë me pendë, projektuan programin megaloman pansllavist, dhe ideja e mitologjisë politike u lind në Vojvodinë, e cila atëherë ishte nën sundimin e Austro-Hungarisë… Perandoria otomane nuk kishte bujkrobëri, ku shiteshin njerëzit bashkë me tokën, ndërsa në Rusi kjo ndodhi deri në shekullin XIX, kur u bë atentati në carin rus Aleksandri II… Dhe prapambetja e Perandorisë turke filloi nga viti 1668 dhe vazhdoi deri më 1908 me ardhjen e Kemal Ataturkut në pushtet (shqiptar nga Selaniku, me nënë e babë shqiptar: shih – Skënder Luarasi: BEN OLLAÇAJN – UNË DO TË BËHEM, biografi).

Velikorusët me 160.000.000 banorë janë në vendin e parë, e pas tyre vijnë Malorusët në Ukrainë, me 50.000.000 banorë, ortodoksë unionistë, dhe në vendin e tretë vijnë Bjellorusët… Pas Revolucionit bolshevik të Tetorit më 1918 u formuan zyrtarisht këto kombësi:

1. Ukrainasit (malorusë, ortodoksë, por e njohin Papën…)
2. Bjellorusët (Bjellorusia) dhe
3. Velikorusët (Rusia)

ꕥ

Më 1 Maj 1886 u korr me mitraloza klasa punëtore e Çikagos (SHBA), dhe nga ajo ditë NJË MAJI është FESTA E GJITHË PROLETARIATIT BOTËROR, në shenjë nderimi për të rënët e Çikagos…

ꕥ

Edhe te ne në Kosovë po bëheshin eksperimente, sepse deri më 1974 kishim AUTONOMI sa për sy e faqe, autonomi formale, ndërsa nga viti 1974 kishim AUTONOMI ME PRAPAVIJË ekspansioniste, që në të ardhmen Jugosllavia të synonte për t'u shtrirë deri në SARANDË e Vlorë… dhe proklamoheshin tri emancipime:

Emancipim njerëzor;

Emancipim proletar (punëtor) dhe

Emancipim social…

Që nga viti 1943-1948 ishte programi i luftës, për realizimin e REPUBLIKËS së SHTATË në kuadër të FEDERATËS JUGOSLLAVE, pra edhe Shqipëria edhe Kosova me vise brenda një Republike federative, dhe kjo zgjati deri në pranverë të vitit 1948, kur Enver Hoxha ia përplasi Titos dekoratat që ia kishte dhënë më 1946, ndërsa **më 1949 u dënua me pushkatim tradhtari Koçi Xoxe,** dhe kjo vendosmëri i tmerroi sovjetikët dhe jugosllavët, sepse ua dogji në dorë kartat e synimeve kolonialiste …

Lufta nuk pushoi edhe pas bombës atomike në Hiroshima dhe Nagasaki më 6 dhe 8 gusht 1945:

Tri vjet vazhdoi Lufta e Koresë,

15 vjet Lufta e Vietnamit;

10 vjet lufta me Iranin,

Lufta me Kubën pandërprerë (Fidel Kastro shkonte në SHBA, në selinë e OKB-së, dhe e mbronte CIA, sepse nuk

kishin hesap për ta vrarë (sepse ai ishte bërë legjendë si Bajram Curri, Adem Demaçi etj).

Ndërsa në luftën me Irakun forcat amerikane mbytën mijëra e miliona irakianë…

Xhafer Deva, një kriminel ordiner, që bëri masakra edhe midis Tiranës, më 1944, një kuisling dhe marionetë nazifashiste e përbetuar, u strehua në SHBA, dhe kjo ishte një turp i madh për ta… Dhe Shqipëria po mbështetet në forcat e veta, siç thotë një fjalë sllave "UZDAJ SE U SE, I U SVOJE KLUSE, AKO GA IMASH (Beso në forcat tuaja, dhe në kalin tënd, nëse e ke…)

ꕥ

I nderuari profesor, siç e dimë ju për disa kohë e keni kryer detyrën e mësuesit të parë në fshatin Gadime, për tre muaj, më 1945. Çfarë mund t'na thoni për ato kohëra dhe për ato përpjekje tuaja për ta arsimuar brezin e ri?

Më 1945 për tre muaj e kreva detyrën e mësuesit në Gadime të Lypjanit… Më 29 nëntor 1945 më kishin zgjedhur në Komisionin për votime në Han të Elezit, dhe nga ajo kohë çdo gjë ishte bërë e qartë për ne se Jugosllavia po vazhdonte me avazin e vjetër të Jugosllavisë së mbretit A.Karagjorgjeviq. Ato ditë arrestohet bashkëshortja e Adem Gllavicës, e cila në burgun e Prishtinës, në rrethana mizore, lind një fëmijë, ndërsa nënës së Adem Gllavicës, e cila i kishte sjellë pelenat për fëmijën e porsalindur, nuk po ia lejonin. Ndërsa nusen e Ademit po e torturonin për shkak se nuk po u tregonte xhelatëve se ku ishte strehuar Adem Gllavica… Në atë kohë favorizoheshin vetëm – POSHTENI ALBANCI (shqiptarët luajalë, marioneta e kolaboracionistë të UDB-së), të cilët ishin bërë vegla, pyka në trupin e kombit, MYKU, VIRUSI i kombit…

ꕥ

Leka Zogu dy herë shkoi në Qabe, e dihet se ai ishte oficer i aviacionit në Afrikën e Jugut, si tregtar armësh, kontrabandisti më i madh…

ꕥ

Mosnjohja e ligjeve nuk është arsyetim për FAJIN që ke bërë si kriminel. Më së paku 50% konsiderohesh fajtor…

ꕥ

Po mirë, i nderuari profesor, çfarë mund t'na thoni diçka më shumë për fatin e popullit martir kurd, dhe sa e kemi fatin e njëjtë me ta ne shqiptarët?

Kurdët janë popull me përkatësi indoevropiane dhe fati i tyre është edhe më tragjik se i joni, sepse 25 milionë kurdë janë të okupuar dhe copëtuar nën thundrën e robërisë së këtyre shteteve:

1. Nën Turqinë (mbi 10 milionë),
2. Në Irak,
3. Në Iran,
4. Në Siri dhe
5. Në Azerbajxhan

Ky popull ka vuajtur dhe ende po vuan një fat më të zi se ne, sepse kurrë nuk kanë pasur shtet të vetin, dhe mu për këtë duhet t'na shërbejnë si shembull frymëzimi dhe NGUSHËLLIMI për rezistencën e tyre shekullore heroike…

ꕥ

Sot i kemi dy personalitete legjendare:

1. **Nelson Mendelën**, në hemisferën jugore (në Afrikën Jugore) dhe

2. **Adem Demaçin** (në hemisferën Veriore), me stazhin më të gjatë të vuajtjes së dënimit, me 28 vjet burg racist, dhe po bëjnë gajret, por jo si politikanë…

Edhe Idriz Ajeti (kryetari i Akademisë së Shkencave në Kosovë, po bën gajret, por është amortizuar, dhe nuk është politikan, ndërkaq Ibrahim Rugova, që 7 vite po i PËRTYP të njëjtat fjalë – **PAVARËSI! PAVARËSI!** si refren, por këto nuk mjaftojnë për t'u çliruar një vend i robëruar nga zgjedha e kolonizatorëve …. Duhet ta marrim si shembull luftën e popullit palestinez, KRYENGRITJEN PALESTINEZE e cila po realizohet çdo ditë, që nga viti 1947 (që 51 vjet), me liderin Jaser Arafat, ndërsa ne e kemi shallin, **simbol i mafisë**. Po t'ia heqësh shallin Rugovës, ia heq identitetin. Natyrisht që Rugova nuk është si **gjenerali DUDAJEV i ÇEÇENISË**, i cili me heroizëm luftoi për çlirimin e këtij vendi nga kolonializmi rus.

ꕥ

Me Bosnjën bota dhe superfuqitë po bëjnë eksperimente, dhe shkuan aq larg sa jo vetëm e copëtuan aq tragjikisht, sikundër neve shqiptarëve në vitin 1913, por edhe më zi, duke i privilegjuar serbët, të cilët i aneksuan mbi 50% të territorit, dhe krijuan Republikën serbe të Bosnjës, ndërsa në qytetin e Mostarit në Hercegovinë, e vendosën kufirin ndarës përgjatë lumit Neretva, i cili i ndan boshnjakët nga kroatët, njësoj siç ishte dikur MURI I BERLINIT në mes dy Gjermanive, dhe kjo po dëshmon se po krijohen muret e reja ndarëse në zonat tjera, të cilat po i sponsorizojnë NATO-ja, SHBA-ja, Evropa etj. (Profesori me këto krahasime vetëm se nuk **parashikonte** se e nesërmja do ta sjell edhe një mur të ri të Berlinit, jo më në Mostar, por për mjedis **Mitrovicës**, ku lumi Ibër do të konsiderohet vija ndarëse në mes shqiptarëve dhe serbëve…– BK)

ꕥ

Në Amerikë BESA, LETËRNJOFTIMI, NDERI, IDENTITETI është XHIROLLOGARIA AKTIVE, është **ZOTI DOLLAR**, vlera materiale. Nëse e ke atë xhirollogari aktive, do të zgjedhësh senator dhe kryetar shteti…

ꕥ

Ne jemi rast unik në Evropë me katër komunitete fetare, katër organizata fetare, dy të krishtera dhe dy myslimane (katolikë, ortodoksë, shiitë dhe sunitë), dhe vërtet FEJA na ka kushtuar shumë në prapambetjen tonë shekullore… **Dr. Aleks Buda** ishte një akademik me famë botërore, që i njihte **21 gjuhë botërore**, ndërsa ndër ne ka ende imbecilë të tillë që thonë: a bën të jesh edhe SHQIPTAR edhe ORTHODOKS?!

ꕥ

LIGJËRIME, 17 gusht 1988:

Benito Huaresi ishte i pari meksikan me prejardhje të pastër indiane...gjendjen si kafshë e statusin si njerëz...

Ndaj natyrës po veprohet barbarisht, dhe kjo do të na hakmerret keq, sepse hajnat, në bashkëpunim me rojtarët e pyjeve po i shkatërrojnë pyjet që janë mushkëritë tona, të natyrës, dhe është njësoj si me e pre viçin e mos me e lënë me u rrit, si me e pre ahun e lisin, e lisi të ushqen me mijëra vjet me oksigjen, pa të cilin nuk mund të jetojmë as dy minuta. Me e pre pishën, ahun, lisin, është si me e pre një pemë frutore,si me e pre vetveten, fëmijën tënd, si me ia nxjerr vetvetes sytë...Dhe kjo bëhet nga mungesa e vetëdijes, sepse gjyshja në Zvicër i tregon nipit e mbesës përralla se si duhet ruajtur lisin, e të ne e mëson me e pre lisin, Edhe në Shqipëri po ruhet me fanatizëm pasuria

mbitokësore e nëntokësore, me masa rigoroze e të rrepta...e po thuhet se atje nuk ka demokraci?!

Qe 30 vjet Shqipëria konsiderohet me të drejtë SUPËRFUQI, sepse as rusët as amerikanët hë për hë nuk po kanë hesap me e prek, se po iu dalin telashe...Mbretnia e Ahmet Zogut i vrau patriotët më të mëdhenj, **Bajram Currin, Luigj Gurakuqin, Avni Rrustemin, Hasan Prishtinën**, etj., pra kjo mbretëri ishte shtet formal, shtet-monedhë për kusuritje, e sot është rrezik që me e ngucë Shqipërinë bëhet puna buçuk...Që nga viti 1970 Amerika nuk po i lejon aleatët e saj të bëjnë telashe me Shqipërinë, sepse ata nuk po i lejojnë me u kthye në VLORË superfuqia tjetër-BRSS-ja, sepse po që se bëhet agresioni atëherë Shqipëria nuk zgjedh se cilin do e ketë aleat...Shqipëria po e përfaqësonte Kinën e madhe pothuaj me një miliardë banorë në OKB, dhe ajo u pranua më 1974...Edhe rusët investuan shumë stabilimente në Vlorë, pra paguan qira për ato 15-16 vjet sa qëndruan në ato baza të fortifikuara në Pashaliman e Karaborun...Shqiptarët me Selam Lapin nga Sallaria e qitën në det ushtrinë italiane më 1920, dhe 40 vjet më vonë Enver Hoxha i përzuri rusët nga bazat e Adriatikut, sepse ata kishin vendosur me vdek por mos me u gjunjëzua para superfuqisë ruse...

Harresa është nevojë fizologjike, si me urinua, sepse nuk ka harresë totale sepse TRURI është deponi...dhe varet se çka harron...sepse ai njeri që nuk harron , nuk konsiderohet si njeri human nëse nuk i harron disa sjellje, gjera të papëlqyeshme të marrëdhënieve ndërnjerëzore... pra duhet të kultivohet harresa e si sharjet, ofendimet etj., dhe nëse ato bëhen kompleks dhe bëhen e zeza e vetvetes...Pra nga pikëpamja etike duhet të kultivohet harresa, por në disa raste tjera duhet të ngimë këmbë që gjerat e **MIRA, HEROIKE**, t'mos i harrojmë kurrë...Por edhe nëse i harrojmë veprat kriminale, raciste të armikut mund t'na kthehen bumerang, mund të na përsëriten edhe më keq...E kush mund t'i harrojë djegiet në krematoriume të atyre katër milionë njerëzve nga nacistët e Hitlerit? Ose:

kush mund t'i harroj ata 3410 martirët që u masakruan në Tivar më 2 prill 1945 nga partizano-çetnikët e Tito-Rankoviçit? Po ata 30. 000 martirët që ranë në Drenicën heroike në krye me Shaban Polluzhën më 1945? Por, PERENDIA nuk mund të ekzistojë pa të kundërtën e vet, pa ORËN E LIGË, si terri pa dritën, pra mos të pritojmë ta pranojmë këtë të vërtetë kur e pranon edhe perëndia?! Kur dëshiron me e gëzua LIRINË për së gjalli, kur donë me e pas edhe mallin, edhe familjen, edhe shëndetin, në atë çast e ke rrezikua **LIRINË.**

ÇMIMI I JETËS është VDEKJA!

Por cila vdekje? Vdekja me faqe të bardhë dhe vdekja me faqe të zezë? Pra është e pamundur njeriu me jetua pa kategorinë e atdhedashurisë, pa fisin, pa familjen, pa vëllanë e motrën...dhe këtu i kemi të gjitha të mirat dhe të gjitha të zezat së bashku, dhe nuk është morale të marrësh e t'mos paguash, ta gëzosh jetën në mënyrë pozitive, dmth. jo në kurrizin e tjetrit, por me djersë, me mund, me sakrifica e privacione, dhe me e pagua çmimin më të shtrenjtë, me ra fli për LIRI! Për me e zbulua se ku është fshehur babai armiku po ia jep fëmijë një çololatë, sepse i mituri nuk po e din se babin do t'ia varin në litar...EKSPLOATIMI nuk mund të çrrënjoset pa u bërë njeriu i plotë, i vetëdishëm, sepse ai edhe kur bën keq, mendon se është duke bërë mirë...Një pjesë e vogël e jetës është jetë RACIONALE-e arsyeshme...

Përpara nuk ka pasur KOMBE, sepse më 14 korrik 1789 është datëlindja BORGJEZE, me ramjen e Bastljes, dhe nga ajo kohë përdoret kategoria historike e kombit, sepse më parë, para 200 vjetësh, ishte-POPULLI-shtresa-paria-populli-vullgus-turma- që mbjell e korrë, mbaron shtëpia, por asgjë nuk gëzon,shpërblehet me përbuzje, fshatarë skllevër, të cilët dikur u shitshin bashkë me tokën, dhe kjo bëri që humbi Lufta e Kosovës, më 1389, sepse rendi shoqëror i osmanllinjve ka qenë më përparimtar,

sepse nuk është shitur populli bashkë me tokën. Kodi i Car Dushanit ishte sistem mbi bazën e skllavërisë, deri në fund të shekullit XIV.. Me kthimin e Skënderbeut në Krujë (28 Nëntor 1443) u kthye sistemi i POPULLIT TË LIRË, dhe për 25 vjet e sfidoi me heroizëm pushtuesin osmanllinj...Dhe kështu pa momentin klasor nuk mund t'i shpjegojmë rrjedhat e të kaluarës , luftën e klasave...

MEMORJA, e kundërta e harresës, nëse çdo të mirë e mbajmë mend, pra deponi e cila ua lëshon vendin gjerave të tjera, të mësuara rishtas, dhe kështu të kompletohet arkiva e memorjes pa mikrofilma...Pra harresa është e nevojshme për jetën...Pra varet se në duart e kujt është shkencëtari i cili bën eksperimente psikologjike për të studiua reagimin e nënës kur të birit ia nxjerrin sytë, dhe kjo është veçori e njeriut UJK,...Ne po përtojmë me i zbulua të vërtetat por po donë me i marrë të gatshme, pa pagesë, dhe kështu po i dëshirojmë gjerat e pamundshme, pra nuk po donë me e ngrënë pjesë ushqimin, kafshatë pas kafshate, por përnjëherë, e kjo është absurde...Psh. DIZELLIT nuk ia dha perëndia formulën e zbulimit të dizelmotorit, por zbulimi i tij është rezultat i një pune të gjatë mendore e fizike, pra jo me ra në gjumë e me pa sa më shumë ëndrra...Me miliona tonë kafe, grurë, qumësht, oriz gjuhen në det, vetëm që të ruhen çmimet kapitaliste, e nga ana tjetër me miliona njerëz në botë vdesin nga URIA...Por, i njëjti ilaç kur iu jepet dy të sëmurëve, ndodh që njërin e mbytë e tjetrin e shpëton?! Pra duhet të kalitemi e të luftojmë çdo ditë me të zezat e kësaj bote e jo të bëhemi si qengjat me na dërguar e me na therë në kasaphane, por me u bë sa më të fortë si luani, dhe me e evitua rrezikun...Dhe duhet guxim i madh me shpëtua pa të tredhur në shpirt e në trup, pra duhet me iu frikua të ZEZAVE...Ky proces i të zezave në të bardha është i gjatë, gradual, si **edukimi i fëmijës**, i cili është **RIBOTIM I VETVETES....** d.m.th. edhe me e dashtë edhe me e ruajt mos me ta pa sherrin, sepse nëse frikohet nga bishti i maces, nga miza nuk ka kush që i ndihmon atij...por nëse

ia blen biçikletën, veturën, motoçikletën, ai ua sheh sherrin nëse i ka marrë të gatshme, pa mund e pa djersë...Nëse ta jep dikush një gjë DUHET TA PADISËSH, sepse ia sheh sherrin,sepse edhe fëmija nuk po e sheh procesin e jetës, dhe në një situatë ai e humb vetveten, sepse në të gatshmen është rreziku më i madh...

Përveç VDEKJES asgjë nuk ka të gatshme...

Sot në botë kemi fabrika të tëra që prodhojnë armë për shkatërrim masiv, sikur kasapi që e ka zanat me pre lopë, edhe ai që vret me një të shtënë të thikës me i vra disa vetë...Edhe zviceranët që janë të pasherr dhe falen nëpër kisha, edhe ata prodhojnë dhe shesin mitrolozë, automatikë dhe bomba që korrin njerëz... Në Zvicër është deponua tërë dukati i botës, si bazë monetare, edhe pse është vendi i parë me prodhimin e orëve, dhe duke i ushtruar nervat në atë industri prcize i mbushin xhepat...Në Zvicër bëhet edhe **pazari i dallavereve,** agjentët, për një copë dukat-një copë zot, të gjitha të zezat grumbull... Në Zvicër e mbajtën 20 vjet Leninin në Cyrrih, edhe pse e kanë ditur se kush është Lenini, por kanë pas hesap me e mbajtur...Qe 3-400 vjet Zvicra e kanë ushtrinë territoriale me 4-5 milionë burra e gra të mobilizuar, dhe secili e din bazën e vetëmbrojtjes, dhe në çdo muaj bëjnë manovra një ditë...Këtë sistem të mbrojtjes e kemi edhe në Shqipëri, por me një organizim më specifik dhe më rigoroz...

ꕥ

LIGJËRIME, 28 gusht 1988:

Ka raste kur rrota e historisë është kthye prapa, psh. siç kemi rastin e REPUBLIKËS SPANJOLLE më 1936, kur fashizmi intensiv, lindi si rezultante e marrëdhënieve shoqërore në botë...Fjala më e butë për fashizmin, si eufemizëm është përdorur , fjalë tipike gjermane, fjala bombastike-**NACIONALSOCIALIZËM...**Secili mund ta përjetojë një sëmundje të rëndë, dhe bien nën jorgan, ose

nëse nuk e përballon vdes, por nëse e përballon fiton imunitet...Te ne po rehabilitohet viti 1966, koha e Tito-Rankoviqit, sepse këta të sotmit janë pionë të Millosheviqit, dhe 12 akademikëve të ASHS-së, ideologët e PLATFORMËS 1986 . Kosovës ia pranojnë vetëm autonominë komunale-10 delegatë-3 serbë, tre malazezë, tre shqiptarë, dhe dihet se njëri prej këtyre delegatëve, Kadri Reufi, nuk ka dalë shqiptar, po turk...Psh, në Jugosllavi malazezë kanë 19 herë më shumë të drejtë vote se sa 19 serb., edhe pas lufte në Mal të Zi kemi vetëm rreth 500.000 banorë. Dhe pastaj serbët po kanë ku të kapën dhe po thonë-kur kjo bëhet në përmasa jugosllave pse të mos bëhet edhe në Kosovë, sipas parametrave të kurdisur paraprakisht: 20% shqiptarë, 20% serbë, 20% malazezë dhe 20 % turq!? Dhe kështu Millosheviqi po e kryen rolin e MIKROFONIT të atyre 12 ideologëve të Akademisë së Shkencave serbe, të cilët qyrrat po i përdorin si lot, po qajnë për gjoja shpërnguljen e turqve të Mamushës së Prizrenit, dhe po kërkojnë që në bazë të këtij pariteti me ua dhënë 20% të votave, dmth., si ata që kanë numrin e popullsisë 0,5% si ata që kanë mbi 80%, dhe po bëjnë shantazh duke thënë- ne dy herë e kemi kallë Evropën dhe do ta kallim edhe së treti, me detonatorin e Sarajevës, por po harrojnë mjekrroshat se sot janë kushtet tjera, se atëherë ka pranua bota me u kallë lufta botërore, por tash nuk do të pranojë...Pra të gjitha këto kërkesa janë në frymën e MEMORANDUMIT. Në librin e Branko Horvatit, ashtu si në NAÇERTANIEN e Ilia Garashaninit(më 1844) po synohet që me anë të Kosovës me e "Çlirua" edhe Shqipërinë, d.m.th. Federata me anë të **Jugoshqiptarëve** po donë me i çlirua jo-jugo-shqiptarët duke i maskua synimet e pansllavistit Ilia Garashanin, për të dalë në Vlorë dhe Selanik. Pra nuk duhet të harrojmë se kemi shqiptarë dhe shqipfolës, si Josip Gjergja...Kështu, Branko Horvati po synon që përmes shqiptarëve me ZOT me **i "çlirua" shqiptarët pa ZOT**, edhe pse Akademia e Shkencave po thotë se shqiptarët

nuk janë njerëz, por Horvati po thotë t'i pranojmë 100% si shqiptarë, pra si karrem, d.m.th. t' ua qesim **një fuqi me planktona në det,** e pastaj balena mashtrohet, bien në kurth... Ndërsa ne jemi në gjumë derisa po ndërtojmë kisha e xhamia...

Më 1918 vetëm katër shtete kanë gëzua të drejtën ndërkombëtare...Mali i Zi shtet me dy topa, se e ka pasur Kotorrin, si bazën më ideale në Adriatik, si perspektive e synimeve hegjemoniste ruse..

ꕥ

Ne nuk kemi pasur kurrë kishë shqiptare autoqefale si ideologji e shtetit siç e patën serbët dhe grekët, dhe pikërisht për këtë F. Noli, i cili ka qenë ATEIST, e luajti at rol për të sigurua autoqefalinë e kishës orthodokse shqiptare për ta shpëtuar TOSKËRINË deri në lumin Shkumbin nga synimet ekspansioniste, (për këtë i kanë thënë Nolit-Prifti i kuq) greke. Ardhjen e Zogut shtet fqinje e shihnin si e keqe më e vogël, sesa ardhjen në pushtet të një qeverie demokratike...Dhe mos të harrojmë, se ky standard do na kushtojë shumë shtrenjtë...

Në kohën e sundimit të car Dushanit njerëzit janë shitë e janë ble bashkë me tokën-si inventar i gjallë i tokës-kafshë që FLASIN, siç ishte dikur në Greqinë antike, pra njeriu kishte shpirt skllavi, shpirt lope, shpirt mize sikur në Rusi para 120 vjetësh (Shi- V. GOGOL-MRTVE DUSHE-Shpirtëra të vdekur). Deri në kohën e car Dushanit mbretërit ishin vazal të Perandorit Bizantin, ndërsa me Dushanin shteti serb u pavarësua nga Bizanti përafërsisht 10 vjet u lidh me Vatikanin dhe Patriarkanën e Konstantinopojës (Stambollit)...

I vetmi popull i cili nuk ka fitore (Beogradi iu është falë serbëve në shekullin XVI), por e feston **HUMBJEN,** janë serbët të cilët po i shëtisin eshtrat (moshti) e atij Car Llazarit) që e humbi luftën para 600 vitesh!?

Dera e bejlerëve në Kosovë, sidomos në Gjakovë, janë shitë me kile, duke menduar se do të pasurohen me të holla.. Haxhi Zekën e vrau tradhtari Adem Zajmi...PO edhe sot a e dimë se sa buxheti ndahet në Federatën jugosllave për t' i rritur **GJARPËRINJT helmues,** në sektorin bakteriologjik të helmimit, me i helmua bimët ose njerëzit, industria e MIKROBEVE..

Shokun e zgjedh me vetdëshirë, ndërsa vëllanë ta lind nëna, pra e ke nga natyra...Njëfarë Sh. Thaçi e kishte pranua detyrën për të më përcjellë me vite, dhe këtu kemi të bëjmë me homodupleksa e kompleksa-dy të trefishtë - dy ashtu siç i paraqiteshin njëri-tjetrit, dy siç mendonin për njëri tjetrin dhe dy ashtu siç ishin në të vërtetë, pa hile, për njëri – tjetrin...

ꕥ

Universiteti i Prishtinës lindi me çykë të zorit,

Me 1000 mami-infermiere, por pa traditë, dhe për këtë hap të madh shovinisti Millosh Cërnjanski tha se Jugosllavia ka bërë VETËVRASJE me hapjen e Universitetit të Prishtinës...

ꕥ

Kryezinjtë e Gjakovës janë shpirt- zinj e jo Kryezinj, sepse askush nuk ia ka ngjitë emrin vetvetes...Por edhe gjithë kjo krizë që po e përjetojmë ka për të ndikua që ne t'i hapim sytë, të kthjellemi, dhe të zgjohemi nga gjumi...

ꕥ

LIGJËRIME 28 gusht 1988:

H. Tërnafci është 100% me prejardhje shqiptare, por është kreten, idiot, i kultivuar në shtabin ideologjik serb, serpski kuturni klub(Klubi kulturor serb). Atij ia dhanë dekoratë duke e pyetur se a jeni me ato mendime që siç u programua më 1937 në Elaboratin e Vasa Çubrilloviçit, që

shqiptarët me i djegë, me i shfarosë duke ua lagë shtëpitë me benzinë që në gjumin e parë...

Shqipja popullore flitet në fshatrat malore... SHKËNDIJA-Skanteja(rumanisht)-GACA-shqip...

ꕥ

Ata mësues të cilët gjatë shkollimit kanë qenë të dobët në studime, ata bëjnë kërdi te nxënësit përmes shantazhit me nota, dhe kështu bëjnë një KRIM të pafalshëm...Prandaj duhet të jemi shumë autokritikë kur i vlerësojmë të tjerët. P.sh. Xhuzepe Verdit mësuesi ia ka dhënë notën e dobët në muzikë, e kush është sot aq i madh sa Xhuzepe Verdi, ndërsa mësuesin i cili e cilësoi Verdin me notë negative askush as emrin nuk ia din...Pra duhet të ruhemi e mos të koritemi, sepse edhe nxënësi më i dobët për disa gjera tjera është talenti më i madh...Edhe druri më i dobët kur latohet ndriçon...Nota e dobët është një lloj terrori, dhe këtu ka elemente patologjike, komplekse.. Pra, mos të harrojmë, se Mësuesi bëhet mësues i vërtetë vetëm **kur nxënësi e tejkalon**-prindi bëhet prind kur fëmija e tejkalon, dhe mësuesi duhet ta pranojë faktin nëse nxënësi bëhet më i fortë se ai... Për kë bie kambana? Ai ka vdek, por mos harro se edhe ti ke vdek bashkë me të (nota e dobët...).

ꕥ

Në atë dhomë ku ka oxhak, ajri është më i pastër, si në oborr, por çdo ditë duhet me e ndezë zjarrin, e nga një milionë dinarë dru me i djegë në ditë...Te njeriu kryhet procesi i alienimit, tjetërsimit, artificilizimit, në përputhje me rrethanat jetësore, sepse nuk ke nge sot me këtë dinamikë jetësore që të mbahet oxhaku, dhe kështu po del se jeta artificilale është e imponuar...Trupi nuk merr frymë në mënyrë natyrore, lëkura me lëkurë, indi i gjallë me indin që dikur ka qenë i gjallë...

Rrena nuk i ka të gjitha të zezat, por GJYSËM E VËRTETA i ka të gjitha të zezat, fjalë e rëndë, sepse si ambalazh, si mbulesë, si taktikë përdoret për t'i shitur më lehtë RRENAT...Në këtë mënyrë maskohet edhe BOMBA E BEFASISË, përmes një stilolapsi, shkrepse apo gjësendi tjetër të maskuar...Edhe në vitin 1924 kemi pasur këso shkrimesh të verdha siç i kemi sot BORBËN dhe POLITIKËN e Beogradit. Psh. Jovan Cvijiçi aq sa ka qenë i fortë si shkencëtar aq ka qenë i dobët si njeri shovinist, edhe pse ka ligjërua lëndën e morfologjisë në Universitetin e Sorbonës...Sipas tij, Evropa nëse donë me e marrë veten në qafë, atëherë do ta pranojë Shqipërinë si shtet të pavarur...Ata e ndjenin frikën nga PERSPEKTIVA e shqiptarëve në të ardhmen, sepse lindshmëria e lartë ka bërë që shqiptarët të jenë popullata më e re në Evropë, e cila kurrë nuk do të lejojë që të ringjallet Perandoria e car Dushanit në Kosovë... **Shovinizmi është MIKROB** i cili potencialisht e shkatërron vetveten. Politika është vetë jeta, përdoret si vegël, si ZOON POLITIKON, siç thoshte Aristoteli, psh. kur thuhet se unë nuk merrem me politikë, e kjo është imorale, është haram, sepse e donë çdo gjë të gatshme...SHTETI KRIMINEL i prodhon kriminelët, hajnat...

ꕥ

Profesioni i SHKRIMTARIT është i vështirë, është i rëndë...Psh. Jakov Xoxa i ka shkrua 10 vepra për 20 vite, dhe me këtë profesion ai këtu në Kosovë do vdiste nga uria, sepse këtu ende nuk e konsiderojmë **LIBRIN si bukën**, si ushqim shpirtëror, si armë e mendjes , siç thoshte N. Krupskaja(Në Shqipëri për bukën dhe për librin presin në radhë...).

Më i varfëri dhe më i gjori njeri është ai që thotë-**nuk kam kohë,** pra arsyetohet se nuk kishte kohë për të mësuar, për punë për vetëpërsosje, pra është përtac-armik i vetvetes...

Gjuhën amtare iliro-shqiptare e kanë folur edhe perandorët romak, Diokleciani, Shën Konstantini(Flavius Valerian Contantinus Magnus(280-237) etj. Vetëm osmanllinjt e ndaluan me ligj, si rrezik për shtetin osman, por edhe shteti okupator jugosllav e ndalonte perdorimin e shqipes në administratë dhe shkolla...Por mos të harrojmë se ne ende jemi në gjumë, sepse na vjen keq nëse na mungon LUKSI, dhe kësaj i vjen era EGOIZËM, që do të thotë-kush nuk është për veten e vet nuk është për askënd...K. Marksi ka qenë kopilavt, i shkathët, por të tjerët e kanë absolutizua bazën materiale...Herakliti, Hegeli, Ajnshatjni e bënë botën shumë jo-absolute, e cila shtrihet e zgjerohet, tkurret, pra është relative, jo absolute...Ndërsa HEGELI e absolutizoi shtetin prusian si model, dhe më vonë në bazë të modelit të tij lindi NACIZMI dhe pastaj krematoriumet e Hitlerit... Marksi me veprën e tij dialektike e përmirësoi, e drejtoi për 180 shkallë teorinë idealiste të Hegelit, e drejtoi nga kokë poshtë siç ishte, e normalizoi... **AI I CILI VETËM PËR VETEN PUNON, AI PUNON KUNDËR VETVETES!**

Prindi fjalën e rëndë e ka zbutë kur e mallkon fëmijën e tij dhe i thotë-**T'U RRITË MENDJA!** Kujt po ia lajmëron vdekjen kambana e kambanarës? Ajo po lajmëron edhe vdekjen tënde...Në Amerikë edhe ëndrrat tregohen në mënyrë realiste, Xhems Xhuji e lanë Frojdin, frojdista po, por nuk po shkojnë rreth e rrotull, pa sentimentalizëm...

ꕥ

Kombi serb është formua paralelisht me organizatën KISHTARE SERBE-BOGOSLLOVIJA...Neve duhet me na ditë për nder që po e dënojnë B.Horvatin për vdekje, sepse po donë me e humb Shqipërinë në bazë të një futurizmi, ARDHMËRIE-që të gjithë të bëhemi **JUGOSHQIPTARË!** Jugosllavia është realizim i idesë ballkanike...Këta janë aq të ndryshëm, si anglezët dhe serbët...Sllavët janë heterogjenë, sepse kurrë nuk janë

zhvillua së bashku, përveç Sllavonisë e Sremit ku është formua një organizatë shtetërore, me përfaqësues të sllovenëve, serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve...Në shekullin XII kroati **Ludevit Gaji** (Lui - Luigj - Luz - Gjon - Jan... Me i ditë të gjitha gjerat mbaron jeta...

Me pështy në Tërnavcin është ofendim, sepse pështyma është lule e dritë në krahasim me fëlliqtinë...

MOTRA IME (Shahbazja-BK) **si pioniere më 1942-43 ka bartur bomba e revolverë si ilegale**, duke mos e ditur se çfarë po bartë, sepse unë në atë kohë isha HALLKA kryesore për indoktrinimin e motrës të cilën e dua më së shumti. Pasi u ktheva nga Kroacia nuk kam fol me të-sepse ende nuk i kuptonte gjerat e punës ilegale, sepse njerëzit mendonin se çfarë thotë komiteti është e shenjtë. Por tragjedia e vajzës e tronditi shpirtërisht motrën, e cila ende nuk mund të çlirohet nga indoktrinimi se në komitet ka kriminelë...Rankoviqi i shenjti i Shën Nikollit... **Mikel e Zef Marku** ishin vëllezër...Zefi ishte pranë Shtabit Madhor të Kroacisë, intendant i armatës së IV, i cili vdiq në vitin 1952. Ai ma ka dhënë strehimin e parë në Kroaci, në Zagreb, më 1945, dhe më ka çua te Mikel Markaj, i cili në atë kohë ishte kryetar i këshillit të rrethit. Në pranverë të vitit 1945 Mikel Marku u hoq si nacionalist dhe në vend të tij e sollën Ymer Pulën. Motivi: sepse ishte paraparë që të therën 12 lopë e me iu dhënë mish malazezëve, por Mikeli tha se duhet me ua ndarë mishin të gjithëve, dhe jo vetëm malazezve. Mikeli **ka përngjarë me juve**, sepse ishte njeri i pakompromis...25 vjet jetoi në Beograd (korrespondent i gazetës - RILINDJA). Vëllai i Mikelit u quajt Jozef Markoviq...Por nuk mund ta harroj se **e ëma e Zefit më shtyri me ardhur në Kosovë**. Ajo më thoshte-**kur po të shoh ty po më duket si me e pa Shqipërinë...**

Dobrica Qosiç është racist i keq, nuk i donë shqiptarët. Ai ishte Gjillasi i serbëve-ministër i propagandës.

Ne jemi shumë të shpartalluar, sepse nuk po e kuptojmë as dinakërinë e B.Horvatit, dhe kurrë mos u realizoftë parashikimi i Horvatit, sepse ai po punon për të mirën e

gjithë sllavëve dhe jo vetëm të serbëve. Ai po e bashkon klasoren dhe sllavizmin, sepse serbët janë shpirtngushtë...Shqiptarët me i mbajtur të lirë duke i shtypur, ndrydhur...D. Qosiçi është pishtari i Serbisë, ndërsa ne e kemi të tillë **Rexhep Qosen**, por ai mundet me ra, e ne kemi pak të tillë...dhe mundet me thanë-ju jeni gjithçka, e ne s'jemi asgjë, sepse baza materiale e tjetërson njeriun...Dushan Kanazir, akademiku, po thotë-Nasha buduçnost je smrt-**E ardhmja jonë është vdekja, nëse nuk ndërmarrim masa urgjente...** Sot po thonë-ti po donë me na shkatërrua, nuk po donë me hy në infrastrukturë-me u shitë me kile,sepse unë jam nxënësi i çetnikëve, e unë nuk mund ta tradhtoi vetveten, siç tha **Petar Matiç** - Çka po mendoni ju serbomëdhenjtë? E këta mjekrroshat po e akuzojnë me e dënua me vdekje... Pra puna ka me kenë mos vet deri në fund të vitit, por edhe më vonë...Matiçin po e shpallin tradhtar të kombit serb...

ROBESPJERIT ia këputën kokën me gijotinë, e ai ishte njëri nga pishtarët e revolucionit botëror...Me qenë njeri duhet të jesh i SINQERTË, e ai nuk mundet me jetua si absolutist, me u zhveshë përgjithmonë...sepse PASQYRË me e njohtë vetveten është tjetrin-ALTER EGO-UNI I DYTË (miku), **Pa SHQIPËRINË ne jemi si peshku pa ujë, në zall...**

ꕥ

DEKARTI-dyshoj edhe në trupin tim...MARKSI-DIJA I KA QINDRA SY E QINDRA DUAR...

Dhjetë anëtar të Akademisë së Shkencave po ngulin këmbë që të marrin hetime për veprimtarinë e Titos, si ka synua ta shkatërrojë Serbinë...Këtyre serbomëdhenjve të shoqatës së shkrimtarëve të Serbisë Matiçi u tha-gnijezdo ulanfera-çerdhe e vagabondave, në krye me Sllobodan Millosheviqin.

Autonominë po donë me e bërë formale, të zbrazët, formale, pa planc, pa zorrë...

Edhe në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore serbët kanë derdhë shumë gjak, por gjithnjë kanë parë ëndrra... Kosovën dhe Vojvodinën ia aneksuan Serbisë...Kragujevci ishte kryeqytet i Serbisë në kohën e sundimit të Obrenoviçëve (1850).

Aporiet e Zenonit-Breshka dhe shigjeta, aporie më e fortë, nuk është kategori logjike, DIALEKTIKE sepse nuk i analizon dy faktorët. Me qëllim për ta hutua popullin-sofistikë, sepse sipas tyre as shigjeta as lepuri nuk mund ta kalojnë breshkën...Serbët po e kërkojnë Bosnjën, gjysmën e Kroacisë, deri në Shibenik, Likën, Baninë, Kordunin, Dalmacinë, Sisakun, Osjekun dhe gjysmën e Sllavonisë...

Një amerikan mbush hesap sa 10.000 vietnamez(homo deluvialis-njeriu i shpellave).. Njeriu duhet të jetë i fortë si bungu e si qarri...I shenjti i Shën Nikollit, Millosheviqi, po thotë- do i barazojmë rrogat si në Serbi si në Kosovë. Janë disa gjera që nuk FALEN, por paguhen me kamatë, si me mbjell në Bistricë...

Sa më shumë fiton, aq më shumë ke mundësi me iu ndihmua të tjerëve, që do të thotë se qëllimi i pasurimit është me iu bërë mirë të tjerëve...Pra një të dyzetën pjesë me ua dhënë skamnorëve...**Në 400 lira, duhet me i dhënë zeqatë-10 lira...**

ꕥ

LIGJËRIME, 8 nëntor 1988:

Tani këta mjekrroshat po e luajnë letrën e fundit, që ta indentifikojnë tërë popullin me kundërrevolucionin, dhe e dinë se me këtë askush nuk fiton,

Këta kriminelët e politikës janë **supërgjaksorë**, sepse ata nuk mendojnë të vrasin një njeri, por tërë një popull. Dhe të tillë si Millosheviqi mendojnë që 10.000 vetëve t'ua nxjerrin sytë...Pra këta nuk po i lëshon-INERCIONI-plogështi. **E dihet se me u ÇMËSUA duhen së paku 1000 mundime...**Por kush luan me jatagan, prej jataganit i vjen fundi...Kush pajiset me ato sende , e nuk është për ato

sende, ua sheh pastaj sherrin...Shpesh ka ndodh që edhe fëmija të vrasë fëmijën, me revole të babait, dhe fajin e ka babai, sepse fëmija mungesën e trimërisë e kompenson me REVOLE, sepse në jetë është shulan, frikacakë. Filmi ROJET E MJEGULLES ishte në nivel, jo si Abdurrahman Shala, nën dirigjim, ku tregohet se vetëm një shqiptar ka marrë pjesë në luftë antifashiste, e gjithë të tjerët ishin në anën e okupatorit gjerman...Ai edhe djalin e vet e ka pagëzua me emrin Jugosllav Shala, pra i lidhur me mish e shpirt me regjimin, si edhe Faruk Begolli, si raketat bashkëkohore të dirigjuara, pra i aftë dhe i zoti, por shumë i prishtë...Më 1956 e kanë nxitur mos me e krye normalen në gjuhën shqipe, në Gjakovë, ndërsa një paralele në gjuhën serbe dhe një në gjuhën turke në Prizren. Në këtë vit, më 1956, u hap kjo paralele, dhe i sollën 15 nxënës prej Drenice e 15 prej Pejës, që të ruhet Prizreni, dhe aty të mos rirrënjoset gjuha shqipe, pas Procesit të Prizrenit, dhe sipas Beogradit del se nëse nuk është kundërrevolucion i kulluar, atëherë është mbështetje e kundërrevolucionit... Nudizmi në filmin Rojet e mjegullës po e plotëson atë poshtërsinë politike, Vox populli, vox dei (Zëri i popullit-zëri i zotit).. Filmit, artit teatral, ia shohin hajrin milona njerëz nëse është në dobi të shumicës, të jep mësim për tërë jetën, siç thoshte M.Gorki, dhe i shtinë me mendua për tërë jetën...Filmi pa zë, kur ngihet njeriu bukë? Kur e hanë bukën thatë, ia ndien shijen bukës, se pjesa më e madhe e kafshatës është mishi, djathi... Filmi me zë ia humb shijen...

Çmimi i kokës për së gjalli, diku ka vlerë të madhe, si çmimet e sotme në shitore...Sa më e madhe KRIZA aq më të mëdha janë malverzimet, sepse spekulimet dhe malverzimet e mbajnë personin në vend të punës, e ai që nuk i bën ato spekulime e shpallin budalla...Edhe nata më e zezë është e dobishme për BISHAT, sepse mos me u bë terr ato e marrin veten në qafë, ashtu siç ndodh edhe me pjesët e caktuara të shoqërisë, sepse edhe superfuqive iu vjen për shtati me shitë armë, dhe tregtia me armë sot po

lulëzon...Ideali i asnjë proletari nuk është me qenë proletar, por përmes proletarizimit me e arritur NEGACIONIN(Mohimin) e proletarizimit...MARXI e ka pasur vetëm një sak, frak(setër).

Dhembjen duhet ta shndërrojmë në gjendje force, në gjendje joproletare, dhe fazën negative me e shfrytëzua e me dalë në negative dhe me shpëtuar njëherë e përgjithmonë, e jo me e shtua kokëdhembjen përditë, e kjo nuk është ideal i proletarit...

ꕥ

Po pse atëherë nuk janë të organizuar kjo klasë e proletarëve

Sepse shkërmoqën, shkapërderdhën, korruptohen, apo ikin duke i marrë në qafë ata tjerët. Çdo shtresë i diferencon sindikatat borgjeze...**Ideali: sa më i fortë me trup e me mend**, por edhe sa më i LIRË, e jo sa më i ulët. Inteligjenca e thotë të vërtetën dhe ngelë gjallë, duke e shfrytëzuar klasën punëtore. SYNIMI-ÇLIRIMI I TËRË BOTËS, e ndërrimi i shfrytëzuesve, jo me u restaurua, dhe kjo nuk është e lehtë për t'u arritur...

Skllavopronaria vazhdoi të jetojë mbi 10.000 vjet;
Feudalizmi (gjysmë-skllavëria)-1000 vjet, ndërsa
epoka e barbarisë me miliona vjet;
500 vjet kapitalizmi;
150-200 kapitalizmi modern, ndërsa
EPOKA SOCIALISTE filloi nga viti 1917.
Komuna e Parisit jetoi 72 ditë, faza komuniste, si gacë, jo si prush...

E gatshmja të mbyt, ndërsa NEVOJA të mëson.

Më 1935, për herë të parë i mbatha këpucët e para, sepse deri atëherë,verë e dimër, një palë këpucë kisha, të cilave u hynte e u dilte uji.

RRENA për njeriun gënjeshtar është stil i tij, por edhe kur ta flet **të vërtetën** dhe të drejtën, i merret si RRENË(Ju kujtohet përralla-UJKU BËRTITI RRAHMAN!...).

Që nga 14 korriku 1792 filloi epoka e re e historisë njerëzore, dhe kjo ka vazhdua deri më 1815, në Vaterlo, kur fitoi borgjezia në Evropë, 90% fshatarët vullnetarë, ata leckamanë, deri sa ka ra Napoleoni, për me ardhur në pushtet populli, por borgjezia nuk iu ka thënë se cila pjesë e popullit, sepse ai 10% e udhëheq ajkën e vet, me mish e me shpirt...Materialitetin e jetës së 10%-it e merr 90%-shi e kundërta me popullin, e kundërta me korrjen e fryteve të REVOLUCIONIT. **Gëte** ka qenë figurë poliedrike(zbulues si Leonardo Da Vinçi, konstruktor gjenial i motorëve dhe fluturueseve, i bagerëve, pastaj arkitekt dhe piktor gjenial)...Pas Volterit Gëte e ka qitë në sipërfaqe vlerën e madhe të bjeshkës Shekspir...Shopenhaueri ishte armik i luftës klasore...

MENDJEMPREHTËSIA , inteligjenca, **trashëgohet prej nëne**, ndërsa **guximi prej babait**...dhe lloj-llojshmëria e aktivitetit të nënës e tërheq më shumë fëmijën, por PATRIARKATI që disa mijëra vjet e ka qitë në plan të dytë NËNËN, dhe nuk është naivitet kur thuhet se edhe babai më i budalla është më i mençur se nëna më e mençur...Barazia gjinore mund të realizohet vetëm në rendin e barazisë sociale, dhe të drejtat e grave duhet të realizohen jo mekanikisht, por në mënyrë dialektike duke e HUMANIZUA bashkëshortësinë, pa e rrezikua jetën e asnjërit bashkëshort, dhe me sinqeritet barazohen të drejtat e burrit dhe të gruas, dhe kështu hiqet hipoteka nga rreziku i sinqeritetit, sepse jeta objektive, reale e prodhon NDËRGJEGJËN...Nuk kishte thënë kotë Abdyl Frashëri se-**DORA QË PËKUND DJEPIN ËSHTË DORA QË PËKUND FATIN E KOMBIT...** Prandaj u kemi shumë borxh nënave...

Në REZOLUTËN e BUJANIT (31 dhjetor 1943-1 dhe 2 janar 1944) thuhet veç tjerash:

*Populli shqiptar si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron me u bashkua me Shqipënrinë...(*Rezoluta e Konferencës së Parë të Këshillit Popullor Krahinor 1943-1953, Prishtinë 1955, f. 10)... Këto vendime ishin një sinjal se po hidhet një hap i madh në drejtim t ë realizimit të te drejtës për vetëvendosje deri në SHKËPUTJE, të zgjidhjes së problemit të Kosovës në rrugë marksiste, por me kusht që paraprakisht populli shqiptar i Kosovës t'iu bashkëngjitej radhëve të forcave të koalicionit antifashist...Mirëpo pa kaluar as tre muaj nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave erdhi letra për Komitetin Krahinor të Kosovë-Metohisë, lidhur me Mbledhje historike të Bujanit dhe vendimet e saj, ku theksohej:

"Këshillit tuaj Nacional - Çlirimtar nuk mund t'i japim karakter pushteti... (Shih-ZBORNIK, libri-19, dok.104, f.461 - 466), dhe me këtë shqiptarëve po iu ndalohej e drejta për t'u bashkuar me Shqipërinë, me pretekstin se gjoja tani për tani nuk është momenti i duhur meqë dy shtetet janë të okupuara...Me këtë veprim u bë e qartë se ndaj shqiptarëve po veprohej në stilin siç kishin vepruar fuqitë imperialiste në traktatet e Versajës e të Londrës, disa dekada më parë...Asnjë përfaqësues i shqiptarëve nuk mori pjesë në Mbledhjen e II të AVNOJI-it në Jajcë. Titua më vonë në kujtimet e tij pohon se çdo gjë ishte bërë fshehurazi, pa i njoftuar as udhëheqësit Sovjetikë, sepse ata qysh në Mbledhjen e Parë të AVNOJ-it në Bihaç më 27.11.1942, i kishin kundërshtuar vendimet e tyre shoviniste. **Titua pohon se në një telegram që kishte marrë nga sovjetikët ata e kishin denoncuar për tradhti duke i thënë se ua kishte futur thikën në shpinë** (Shih-J.B.Tito, Artikuj dhe fjalime, vëll.8, Prishtinë 1964, f.414), ndërsa sipas Memoareve të V.Çërçillit thuhet se Tito i premtoi atij se " Nuk kishte asnjë dëshirë që të vendosej sistemi komunist në Jugosllavi(Shi-U.Çërçill-Kujtime mbi

Luftën e Dytë Botërore, bot.italisht,vëllimi VI, pjesa e parë,f.117)

ꕥ

29 tetor 1988:

Sot masat janë të bombarduara nga dhjetëra mediumet e ndryshme informative, dhe mu për këtë ato nuk mund ta identifikojnë të vërtetën në këtë anarki informative. Në çdo lagje duhet të kemi nga një **Diogjen** me fener në dorë, nga një udhërrëfyes…

ꕥ

Sekvoja, baobabi, lloje druri me moshë deri në 12.000 vjet, janë drurët më çmimin më të lartë. Në dhomën e ndërtuar nga baobabi edhe sikur të çirresh e lemerisesh tingëllon ndryshe, bile edhe zëri i qyqes tingëllon si zë bylbyli… Pallatet në Kinë, Kore, Japoni, Mongoli etj. mbarohen pa asnjë gozhdë, dhe era e drurit është e tillë çfarë është lloji i drurit: pishë, qershi, arrë, mollë, ndërsa në jemi mbyllur në këto **SHPELLA BETONI,** në këto kazamate. Nëse nuk e thyen qafën në asfalt, do e thyesh shpirtin, sepse çdo ditë e më shumë jeta është më pak origjinale, dhe më shumë artificiale…

ꕥ

Në kohën e sundimit të perandorit **Kaligula**, kali i Kaligulës u zgjodh **kryetar i senatit romak**, i **PARLAMENTIT romak**, dhe merreni me mend se çfarë senati ka qenë ai. Dhe si rezultat i kësaj dekadence perandoria romake mori tatëpjetën… Dhe merreni me mend: romakëve po u jepnim perandorë, ndërsa vetë nuk ishim askund… Në librin ETNOGRAFIA të autorit

Radovanoviq, botim i paraluftës, shkruan se: Shqiptarët janë i vetmi popull i egër në Evropë. Ata po thonë: Shqiptarëve (Arnautëve) do ua japim të gjitha të drejtat mundshme, por për vetëzvoglim dhe vetëshfarosje… Edhe i vetëquajturi ”Revolucion” i Millosheviqit u bë në frymën e Sveti Savës…

Ne kemi hyrë në Shkup më 1912 të paorganizuar, me tespihe, me pare, të shitur… Dinastia e Bushatllinjve të Shkodres sundoi 250 vjet, si dhe dinastia e Ali pashë Tepelenës, por nuk ishin për vetvete, **ishin mercenarë të padishahut**… Ali pashë Tepelena ishte vasal formal, me SHTET PRIVAT… por administratën e mbajti në gjuhën turke, dhe **32 vjet e mbajti shtetin në shtet**. Tërë administratën e mbajti në gjuhën e huaj, dhe jo në gjuhën shqipe… Por edhe Skënderbeu tërë administratën e mbante në gjuhën latine. Edhe në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit gjithë administrata u mbajt në gjuhën turke… Ndërsa sot edhe Gjermania ia ka lakmi sovranitetit dhe PAVARËSISË së vërtetë të Shqipërisë… Neve jemi të shpartalluar me katër organizata kishtare, dhe kemi katër lloj klerikësh, katër lloj divergjencash fetare, por edhe divergjenca në gjirin e popullit…

ꕥ

MIRDITA – edhe në kohën e Bizantit, por edhe në kohën e Skënderbeut, gëzonte një autonomi kulturore, dhe i pari i Mirditës mbante titullin – PRINC, i pari i Bibdodajve. Kullat kanë ngelë të kishës romake, sepse numerikisht nuk ishin të shumtë, por edhe kur ushtria pushtuese serbe e Pashiqit pushtoi Mirditën, ata donin të kishin një AUTONOMI VASALE, dhe përmes bazës së Mirditës ta pushtojnë edhe Lezhën e Durrësin…

QEVERIA E VLORËS më 1912 ishte një shtet FORMAL, sepse asnjë dokument nuk e kishte në gjuhën shqipe, administrata kishte në përdorim gjuhën turke…,

gjersa Flota Ndërkombëtare patrullonte në bregdet me forcat angleze, franceze, italiane etj. , rreth e rrotull livadhisnin bandat serbomalazeze (në Veri), dhe ato greke (në Jug), dhe nuk kishte si të funksiononte normalisht një shtet i tillë i nakatosur dhe i copëtuar nga fqinjët grabitqarë… Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK) administronte çdo gjë… Nga kjo del se duhet të jemi realistë, e jo të shohim ëndrra, dhe të marrim në thua midis qilimit… TRIM është ai i cili i ndihmon edhe vetvetes, dhe i vjen turp të mos u përgjigjet këtyre tri thirrjeve: të mirës, të vërtetës dhe të drejtës, dhe sidomos kur e thërret zëri i Atdheut për çlirim dhe bashkim kombëtar…

A. Z. Çajupi me poezinë – SHQIPTAR! MOS RRI PO DUKU SHQIPTAR, dhe – KU ËSHTË BALTA MË E ËMBËL SE MJALTA, na ka dhënë gajret, na ka mobilizuar për luftë dhe rezistencë aktive kur thotë:

XHVISH RROBAT E ROBËRISË MËMËDHE,
VISH ARMËT E TRIMËRISË SE KE NE!...

ꕥ

VOJVODINA – u dorëzua para pushtimit serbo-malazez, kolonizimi pas vitit 1945 dhe dëbimit të folks-dojçerëve gjermanë (mbi 500.000). Vojvodina iu aneksua Serbisë më 1918 për herë të parë, dhe serbët e atjeshëm për shumë gjera dallohen nga serbët tjerë, ndërsa për kah mënyra e jetesës, kultura, qëndrimi nuk janë dalluar nga gjermanët. Sipër lumit Sava edhe veshjet ishin ndryshe, me çizme, ndërsa në jug mbathnin opinga gogishte, lëkure. Ndërsa priftërinjtë serbë jetonin njësoj si në Budapest si në Vojvodinë. Pas dëbimit të folks-dojçerve gjermanë në Vojvodinë u vendosën si kolonë mbi 60.000 familje serbo-malazeze, dhe kështu u bë një ndryshim i madh në strukturën demografike dhe etnike….

Në Kalabri në shekullin 17 ka dalë gazeta në gjuhën shqipe. Kështu ne kemi ngelë prapa tyre për 200 vjet, por

edhe këta serbët e Vojvodinës ishin 200 vjet para atyre serbëve që jetonin në jug të lumit Sava …

Më 1981 Boshko Kruniqi i Vojvodinës tha se në Kosovë nuk ka KUNDËREVOLUCION, pra 6 vjet para Branko Horvatit, por duhet ta dimë se kjo është thikë me dy tehe… Të gjitha strukturat e shkencës dhe artit po flasin si sharlatanë me qëllim, se po kanë hesap, po thonë gjera banale, antinjerëzore, dhe kjo është një makiavelizëm i vërtetë, sepse QËLLIMI i tyre i zi i arsyeton mjetet e tyre të zeza, kur një Stipe Shuvar është bërë komandant suprem i Kryesisë Kolektive të Federatës Jugosllave, por edhe këtu në këtë federatë krisi incidenti me përfaqësuesin slloven, Hafnerin, dhe gishti i Hafnerit ishte ATENTAT moral ndaj Millosheviqit dhe klikës së tij, por Millosheviqi këtë sulm nuk e bëri të madhe, sepse e dinte se do të prishte më shumë punë…

Kulmi, kurora e religjionit, qëndron në faktin se njerëzit nuk kanë asnjë lidhje me SHKENCËN… Sa më injorant, i padijshëm, të jetë dikush, aq më tepër është i kënaqur me vetveten, dhe u beson SUPOZIMEVE. M. Gorki thoshte:

PREJ 10 SUPOZIMEVE, 9 JANË TË PAVËRTETA.

Cila kafshë miklohet më shumë se qeni? Por, cila kafshë është edhe më besnike se qeni?

Grekët e moçëm mendonin se gjumin e udhëheq Zoti – HIPNOS **(Zoti i gjumit)** shih – Boris Sergejev – Fshehtësitë e kujtesës (Tajne Pamçenja) – Nolit, Beograd, 1976, f. 202.

LIGJËRIME, 5 dhjetor 1988:

SIMULUM (latinisht) – po shtirem, po shtirem se gjoja jam duke fjetur, gjoja ata po na sulmojnë neve, e ne po detyrohemi të vetëmbrohemi (Janez Jansha e zbuloi planin e SIMULIMIT me emrin – SLOBODA-3), se gjoja tanket dhe ushtria shqiptare po e sulmojnë Jugosllavinë, po i masakrojnë serbomalazezët, e jugosllavët gjoja po

detyrohen të vetëmbrohen me kundërpërgjigje… Kështu edhe **Adolf Hitleri** bëri një simulim në kufirin me Poloninë, se gjoja polakët i kishin sulmuar gjermanët për të pasur pretekstin për ofensivën gjermane mbi Poloninë më 31 gusht 1939, dhe kështu **i nxorën nga burgu 22 kriminelë dhe i veshën me uniforma të ushtrisë polake** dhe i detyruan duke i kërcënuar se nëse nuk veprojnë sipas urdhrave gjermane do t'i likuidojnë…

ꕥ

Tymi e imunizon organizmin, ndërsa stufat elektrike janë të rrezikshme si sida, e çarmatosin organizmin dhe kemi leverdi të blejmë dru, të ngrohemi me dru, ia vlen barra qiranë, sepse imunizohet organizmi dhe forcohet shëndeti…

ꕥ

Me ne po luhen lojëra shumë të mëdha, si brenda ashtu edhe jashtë… Që nga viti 1945 kur pas 2-3 ditëve REZOLUTA E BUJANIT u kuptua si **TAKTIKË**, një muaj pas AVNOJ-it (më 29, XI. 1943) sepse ishte në kundërshtim me vendimet për INTEGRITETIN territorial të Jugosllavisë, me pacenueshmërinë e saj territoriale, dhe në bazë të AVNOJ-it ky ishte një vendim KONTRADIKTOR, në muajin prill 1945 erdhi letra e Komitetit Qendror të Jugosllavisë, ku thuhej se kjo Rezolutë duhet të kuptohet si TAKTIKË, e jo si STRATEGJI. Dmth. si lojë, **si karrem**, si ndjellje, për mobilizimin e masave shqiptare në luftën antifashiste…

Bujani ka pasur vlerë taktike si gjilpërat e najlonit, të cilat mund të përdoren vetëm një herë dhe pastaj gjuhen… EDHEPSE KONGRESI I II, PASTAJ KONFERENCA E V-TË E VENDIT NË ZAGREB, E CILA U MBAJT NË ZAGREB, IA PRANONTE KOSOVËS STATUSIN E REPUBLIKËS AUTONOME,

SEPSE DIREKTIVAT VININ NGA MOSKA, NGA BRSS-JA, NGA STALINI. Në Poloni Kominterni e shpartalloi Partinë Komuniste, ndërsa në Jugosllavi tradhtia ishte e **Gorkiqit bashkë me Titon**. Pra burimi i të gjitha të zezave është kur përton të kuptosh, të marrësh vesh. **Tradhtinë kryesore e kemi bërë ne që kemi mbetur në BALTË, ne që nuk i kuptuam gjerat me kohë**… Individi nuk mund të bëjë asgjë vetëm për vetëm. Edhe nga Stalini nuk është varur tërë puna, sepse edhe BRSS-ja nuk do të mund të ekzistonte si e tillë pa kontributin e Stalinit… Dhe ne edhe **më së paku 20-30 vjet** nuk mund të presim diçka më të madhe, sepse dy pjesët e ndara të kombit janë ende **shumë larg njëra-tjetrës**, dhe po ruhen nga njëra-tjetra, sepse ne mund ta marrim në qafë edhe atë SHQIPËRI TË PAVARUR, si varrtarë potencialë të saj, dhe në asnjë rast nuk kërkohet BASHKIMI, përveç statusit të Kosovës si Republikë, në kuadër të Federatës Jugosllave, sepse askush nuk lejon të provokohet lufta ndërkombëtare, sepse Kosova është pikë neuralgjike nga pozita e saj strategjike, ndërsa Millosheviqi po kërkon, dhe po bën shantazh, sa për taktikë, kur thotë se tri herë e kemi filluar luftën, por edhe së katërti do t'ia fillojmë luftës botërore. **Ne jemi në FYTIN e Evropës, dhe askush nuk mund të garantojë se mund ta lokalizojë zjarrin e luftës vetëm në një territor...**

ꕥ

Atë që mund ta bëjë fëmija nuk mund ta bëjë as Herkuli. Sepse janë disa detyra të cilat vetëm fëmijët mund t'i kryejnë, psh. në rolin e postierit etj. Postierët e parë ishin PËLLUMBAT. Dhe kështu secila gjeneratë e luan rolin që i takon… Çfarë roli po luajnë sot fëmijët në Izrael, ku secili e kryen një detyrë, si taktikë në kohë lufte, por edhe jashtë lufte, në politikë, lejohet, pa kurrfarë të keqe. Dhe tagrin e paguan ai që nuk din, ai që nuk është i informuar sa duhet, sepse njeriu më i dijshëm është

NJERIU MË I INFORMUAR, më i sigurt, më kompetent për të bërë llogaritë mirë…

ꕥ

Me Rezolutën e Bujanit janë përkundur në djep, duke iu referuar Bujanit, e në realitet po ndaheshin prej Shqipërisë. E nënshkruesit e Bujanit kanë pranuar të marrin **DHURATAT** E DHJETORIT (31 dhjetor 1943) si taktikë, e tani si kundër-taktikë, si sulm, si mbrojtje dhe e njëjta arnë po përdoret në të dyja anët, dhe deri më 1981 askush nuk e ka diskutuar e as **kontestuar çështjen e Bujanit,** sepse mbi 50.000 luftëtarë të LNÇ-së ishin mobilizuar në luftën antifashiste në bazë të Rezolutës së Bujanit, e cila potenconte se pas çlirimit KOSOVA do t'i bashkohet SHQIPËRISË… Por ne ishim të dobët dhe e pritëm shekullin XX pa u konsoliduar, sepse nuk ishim të aftë të luftojmë kundër armikut, sepse nuk kemi ditur ta dallojmë armikun, dhe për 5 para na ka shkuar trimëria, lufta, mbi 113.000 të rënët gjatë luftës antifashiste, dhe kështu shekulli XX na ka gjetur në gjumë, dhe nuk kemi punuar kundër armikut të përbashkët… SERBËT E SERBISË NUK ISHIN FORCË NUMERIKE MË SHUMË SE NE NË FUND TË SHEKULLIT XIX (1876) NË KOHËN E LIDHJES SË PRIZRENIT, KUR KISHTE 1.200.000 SERBË, DHE 2.000.000 SHQIPTARË. POR ORGANIZATA KISHTARE – BOGOSLLOVIA – I MBAJTI HOMOGJENË, I MBAJTI TË LIDHUR DHE TË BASHKUAR, NDËRSA NE NUK ISHIM ASKUND, DHE VETËM FALË ARBËRESHËVE TË ITALISË, ME NË KRYE DE RADËN E MADH, NA ISHTE RUAJTUR KUJTESA HISTORIKE, NË ART, LETËRSI, FOLKLOR, DHE ISHTE EVOKUAR EPOKA E LAVDISHME E GJERGJ KASTRIOTI – SKËNDERBEUT…

ARBËRIA – shteti i parë, por si principatë, si zonë luftarake, e cila është respektuar aq sa i ka ndihmuar Skënderbeut. PRINCEPS – do të thotë – prijës, dhe jo – MBRET – REX, pra principatë e pavarur në bazë të luftës

shekullore, e pavarur nga Bizanti, që do të thotë se edhe Skënderbeu nuk është njohur si MBRET – REX. Dhe këta luftëtarë shembullorë të Krujës **ditën punonin tokën, e natën u dilnin në pritë hordhive të ushtrisë turke**. Kështu ishte arritur mobilizimi ushtarak mbarëpopullor, prandaj Skënderbeu u cilësua si njëri nga strategët ushtarakë më të zot të Evropës. Korrespondencën ai e mbante latinisht , por asnjë dokument nuk e kemi në shqip… Kishte bërë shkollat turke, në gjuhë turke, arabe, persiane, por edhe pse luftoi 30 vjet për Turqinë, në fund lau veten, **bëri epokë.** Po sot ne ku jemi? Kjo shëmbëlltyrë duhet të na frymëzojë neve sot se si duhet të punojmë për kauzën e shenjtë të Atdheut, sepse te ne nuk ishte kënduar asnjë këngë për Skënderbeun. Dhe deri pas Luftës së Parë Botërore ne ishim si HIRI i fikur, dhe pas 300-400 vjetëve te ne erdhi vepra e Marin Barletit – **HISTORIA E SKËNDERBEUT**, dhe bashkë me veprën e Naim Frashërit po i jepte gajret shqiptarëve pak para VDEKJES. Pra nuk guxojmë ta marrim realitetin objektiv si realitet subjektiv… Dhe nën juridiksionin ushtarak të Skënderbeut ishte një e nënta e Shqipërisë, sa krahina e Matit, me 3000 km katrorë, dhe kjo ishte zonë lufte, si një bunker, për t'i bllokuar turqit në rrugën drejt Italisë… Dhe secila principatë kishte detyrimin të jepte një numër të caktuar ushtarësh…

Durrësin dhe bregdetin e mbante VENEDIKU, dhe ata nuk hynin në luftime, bile as DUKAGJINËT, por ka luajtur rol si zonë shumë e rëndësishme…

Gjatë sundimit të Pirros, Iliria e jugut ishte shteti më i fortë ilir, që iu kërcënua Romës me pushtim, dhe ka mbetur fjala – FITORE SI AJO E PIRROS (viti 275 para epokës së re), sepse aq shumë u dobësua ushtria e Pirros sa gati po mbaronte në saje të FITOREVE të veta… **Pas Pirros me famë të madhe ushtarake ishte Leka i Madh, 10-15 vjet, dhe pas Lekës të gjithë ishin vasalë të Romës dhe Bizantit...**

Çetnikët e sotëm e mohojnë pjesëmarrjen e shqiptarëve në koalicionin Ballkanik në luftë kundër forcave turke në Fushën e Kosovës më 1389, dhe është çudi se si para luftës, në kohën e Karagjorgjeviçëve, librat kanë qenë më objektivë se sa në ditët e sotme, sepse këta "shkencëtarë" po thonë se – nuk kemi hesap të merremi me të vërtetat historike, dhe nuk e dinë se rrenave të te çastit sot ose nesër do t'ua shohin sherrin… Dhe çka të themi kur edhe Adem Vllahi deri dje pohonte se më 1981 në Kosovë kishte KUNDËREVOLUCION, dhe bashkë me Husamedin Azemin asnjëri nuk e la pa e përmendur "kundërrevolucionin" e vitit 1981, si kusht për të shpëtuar pa u arrestuar, ndërsa për demonstratat e vitit 1988 thuhej se janë krejtësisht të ndryshme nga ato të vitit 1981, edhe për kah forma, parullat dhe përmbajtja…

ꕥ

Një herë na keni thënë se për pak i shpëtuat xhandarëve kuislingë të Xhefer Devës në Pejë?

Po, është e vërtetë se unë për pak i **shpëtova xhelatëve të Xhafer Devës**, i cili bëri gjithë ato krime, edhe pse kishte mbaruar shkollën e inxhinierisë në Gjermani. Por pikërisht ky shkollim ishte bërë pengesë që ai t'mos e shihte realitetin, t'mos i shihte edhe gjermanët e italianët si okupatorë, por si ÇLIRIMTARË?!

Rrënjët e syve janë në tru…. Hitleri u rrok për kontrarevolucionin në përmasa botërore, baza e të cilit ishte urrejtja kombëtare në bazë të racës, gjakut. Dhe ajo kushtetutë ishte KUSHTETUTË RACISTE, në bazë të teorisë së Darvinit po bënin seleksionimin e llojeve në shoqërinë njerëzore. Ndërsa shqiptarët, sidomos ne në Kosovë, ishin lidhur me këta nazi-fashistë…

ꕥ

Pas vitit 1945, 1968, 1981 dhe 1988, këto protestat e fundit janë **PAJTIM KOMËTAR,** sepse arritën një pjekuri dhe disiplinë fenomenale duke i organizuar mbi 500.000 vetë, të te gjitha strukturave popullore, pa asnjë ekses, pa e gjuajtur asnjë gur, me pleq e fëmijë të bashkuar, dhe kjo është ngjarje historike, **nëse vazhdojnë e nuk shuhen**, dhe duhet studiuar ky unitet… sepse ishte pjekuri organizative popullore, dhe të gjithë u habiten kur i panë edhe Mamushasit me tabela në duar, në gjuhën turke, me parullat – LIRI – DEMOKRACI! Dhe u arrit në progresion për 7 vjet sa për 70 vjet. Në historinë shqiptare nuk kemi ndonjë shembull të ngjashëm…

ꕥ

LIGJËRIME, 4 janar 1989:

Lukthin duhet ta kemi të fortë, sepse ai i cili i qet zorrët për një mizë nuk ka lukth të fortë, as organizëm të fortë…

Sot tërë kriminaliteti është koncentruar në politikë… Sot kemi lloj-lloj interpretimesh dhe secili e akuzon secilin si kriminel, si shtypës… Këta të Beogradit nuk mendojnë për ne siç mendojnë sllovenët, sepse ne me serbët jemi fqinjë të parë. Ne me ta nuk jemi kapë fyt më fyt për **1000 vjet me radhë**, por kemi bashkëjetuar, përndryshe do ishim zhdukur edhe ne edhe ata, ndonëse në disa faza historike jemi përleshur mes veti me sëpata e me huta… Ata neve na njohin ndryshe nga ajo që flasin sipas preferencave dhe klimës ditore të politikës…

Perandor – d.m.th, mbret i mbretërve, në kohën e Perandorisë romake kishte rreth 150 mbretër… Napoleoni ka qenë jakobinas, dhe tërë fama e tij i detyrohet bashkëshortes së një gjenerali, Jozefina Boarues, ndërsa

më vonë Napoleoni (21 vjeç) u bë perandor e ajo perandoreshë (ishte shumë më e moçme, por prostitutë…)

ꕥ

LIGJËRIME, 19 shkurt 1989:

Rasti i **Mehmet Shehut** është fenomen shumë interesant, që nga Lufta e Dytë Botërore e deri më sot, si person POLIAGJENT, rast i rrallë, i cili pas luftës së Spanjës më 1936 u kthye në Francë, ku qëndroi 18 muaj, dhe askush nuk e di se si është kthyer nga Franca (nga hoteli me mercedes), ndërsa Franca nuk ka pasur llogari ta dekonspirojë… Tri vjet është madhëruar Mehmet Shehu si kryekomandant i aradheve partizane, dhe në mënyrë perfide ai u promovua me merita të larta para popullit, por me ndihmën e armikut, që me çdo kusht të imponohet zgjedhja e Mehmet Shehut si komandant. Është shumë interesant se populli e ka njohur vetëm Mehmet Shehun si kryekomandant të gueriljes partizane, e jo Enver Hoxhën, deri më 29.11.1944, kur për herë të parë Enver Hoxha u prezantua si kryekomandant i Ushtrisë Nacionalçlirimtare…

Vetëm **kur e humbim NËNËN ia dimë vlerën**, dhe na vjen TURP pse nuk ia kemi ditur vlerën me kohë…

Sipas disa indikatorëve as BRSS-ja nuk e ka marrë vesh tërësisht punën e Mehmet Shehut si potencial aq i madh informativ, sepse anglezët dhe amerikanët **e kishin blerë me pare**, ndërsa rusët me pare e pa pare, për shpirt, për partinë… dhe u bë **besnik si qeni** për italianët, për amerikanët, për anglezët dhe rusët, duke luajtur disa role. Por duhet ta dimë se **edhe me MJALTË mund të helmohesh,** edhe pse mjalti është me vlera të larta imunizuese natyrore, dhe shqiptarët nuk kanë mundur ta dinë tërë të vërtetën, përndryshe Mehmet Shehu kurrë nuk do të arrinte të manovronte për 40 vjet me radhë, ashtu si disa elemente të cilat sa më shumë që vjetërsohen, aq më të vlefshme bëhen (si p.sh. vena)… Por të mos harrojmë se nga një qerre me sanë përmes lopës e nxjerrim një qyp me

tëlyen, e dihet se askush nuk e merr punëtorin që të mihë në Bistricë, në lumë, ndërsa Shqipëria tani për tani nuk ka hesap ta tregojë tërë të vërtetën. Njësoj si me fenomenin e poliagjentit të përmasave ndërkombëtare – KIM FILBI, përmes të cilit për çdo gjë që ka ndodhur në Amerikë është njoftuar Moska brenda 24 orëve. Filbi, student i medicinës, jetoi në SHBA nga viti 1942-1962. Ai kishte arritur të bëhej kryeshef i Inteligjent Servisit anglez e pastaj të lidhet me Amerikën, duke u transmetuar rusëve çdo ditë të dhënat më të hollësishme shtetërore. Në Belgjikë CIA amerikane po e përgatiste një aradhe prej 300 rekrutësh shqiptarë, parashutistë, dhe kishin arritur të bënin stërvitje për dy vjet me radhë, ndërsa ditën kur eskadrila e parashutistëve zbarkoi nga avionët pa zë, të gjithë të armatosur dhe të pajisur deri në dhëmbë, në çastin e zbarkimit, në pjesën jugore të Shqipërisë, në vendin e caktuar, po i prisnin repartet e njësiteve të ushtrisë shqiptare, dhe me breshëri mitralozash nuk arriti të shpëtojë asnjë i gjallë, sepse **KIM FILBI** kishte informuar BRSS-në, dhe BRSS-ja kishte informuar Shqipërinë, duke i dhënë madje shënimet dhe biografitë e secilit shqiptar emigrant nga Dibra, Kosova, dhe viset tjera shqiptare të arratisur në Evropë. Këtë vepër heroike Kim Filbi e bëri për hir të **idealit që kishte**, e jo për para, se ishte bir pasaniku…

Profesor, çfarë mund të na thoni për luftëtarin e Spanjës, Shaban Bashën?

Shaban Basha, luftëtar i Spanjës, 20 vjet burg i ka mbajtur në Shqipëri, sepse ai u shpenzua më 1940, dhe më 1944 u arrestua dhe u dënua me vdekje, por iku te **Mehmet Shehu**, dhe ky e dënoi me 20 vjet burg, por më vonë e liruan dhe erdhi në Jugosllavi. 14 muaj para Luftës së Drenicës kapitulloi Italia fashiste… Në Drenicë Shaban Polluzha bëri rezistencë, dhe lufta filloi dy javë para vitit të ri 1945, dhe për dy muaj e gjysmë Divizioni i 26 i Armatës Jugosllave e kishin vënë në darën e rrethimit tërë

Drenicën, siç kishin vepruar divizionet e Karagjorgjeviçëve me rastin e rrethimit të Azem Galicës më 1924. Rrethimi ishte i ashpër, dhe armiku po priste dorëzimin e luftëtarëve trima të Shaban Polluzhës, duke menduar se do të ngelin pa bukë, por **populli u bë strehë e sigurt e vullnetarëve të lirisë** dhe i mbajti për dy muaj e gjysmë, dhe asnjë ushtar nuk u dorëzua, por Divizioni i Armatës Jugosllave u likuidua tërësisht.

ꕥ

Që nga viti 918-1918, për 1000 vjet me radhë viset e Sllovenisë, Kroacisë dhe Hungarisë jetuan nën sundimin e Markës gjermane (Ost Mark), dhe 300 vjet nën principatën austriake. Sllavët gjatë kësaj kohe u asimiluan dhe mbetën vetëm 1/3, ndërsa 2/3 u shkrinë. Pas 1947 u bë plebishiti, dhe 40.000 vetë e ndjenin veten sllovenë, por vetëm 20.000 vetë pranuan të bashkohen me Jugosllavinë, ndërsa çdo i dyti slloven u deklarua për Austrinë, ku Celoveci dikur ishte qendër ku kurorëzoheshin mbretërit sllovenë…

ꕥ

Nuk duhet të themi se kjo gozhdë është ndryshkur e nuk hyn në përdorim, as kjo tullë, as një tjegull, sepse vjen një çast e të gjitha të duhen, dhe kështu është edhe me ne shqiptarët, dhe **nuk duhet të themi ky shqiptar nuk na duhet,** se është "ndryshkur", **se nuk kemi shqiptarë të tepërt**, por duhet që sa më shumë të punojmë dhe t'i bindim njerëzit për vlerat e tyre, për fuqinë e tyre për të bërë vepra të mira, dhe ato vlera t'i bashkojmë në një drejtim, në një kah, kundër armikut të përbashkët, i cili po na konsideron të gjithëve, pa dallim feje e partie, armiq të egër, terroristë, ndërsa ne po copëtohemi duke u përçarë në tarafe, kur dihet se **PËRÇARJA jonë është VARRI** ynë, ndërsa BASHKIMI ynë është VARR për armiku, dhe kështu do jemi në gjendje ta paguajmë çmimin e lirisë…

Kur shkon para konopit duke vajtuar, **dy herë je i VRARË**, e kur këndon si **Patris Lumumba**, bëhesh i shenjtë dhe më i gjallë se të gjallët, sepse dikush të vjen te varri e BETOHET për ta marrë hakun.

Pas vitit 1981 u bë diferencimi policor ndaj gjithë mësuesve patriotë, dhe veteranët që kishin dhënë mësim për 20 vjet me radhë i dëbuan nga procesi mësimor me akuzën se ishin frymëzues të KONTRAREVOLUCIONIT.

Një diskriminim i tillë nuk ka ngjarë as në Spanjën e gjeneralit fashist Franko, as në Portugalinë e Salazarit, as në Kilin e Pinoçetit ...

Jusuf Kelmendin e sollën nga burgu dhe e emëruan në detyrën e sekretarit të Komitetit në Prishtinë?! Por më vonë Jusuf Kelmendin e caktuan ambasador në Senegal, dhe kështu e internuan, sepse i kishte dokumentet sekrete të PLENUMIT të Brioneve (30.6-1.7.1966), pastaj Elhami Nimanin e dërguan ambasador në Libi, ndërsa Rexhai Surroin në Bolivi, kurse Sinan Hasanin, QEN me përqindje, e dërguan në Danimarkë. Dhe nuk bën të thuash është ose nuk është qen, sepse nëse është me përqindje, s'kanë lënë gjë pa i thënë edhe çetnikët, sepse nuk po thotë se Kushtetuta e vitit 1974 është KUNDËRREVOLUCIONARE, se gjoja është kundër vendimeve të AVNOJ-it. Dhe kështu del se këtyre renegatëve, **për t'ua gjetur përqindjen duhet t'i dërgojmë në laborator...** P.sh. Shaban Bashës ia shndërruan dënimin me vdekje në dënim më 20 vjet burg, sepse asnjë shqiptar nuk ishte arrestuar me urdhër të tij, ndërsa ata të cilët i kanë përlye duart me gjakun e popullit, ata nuk janë POPULL, janë dizenteri e shkuar dizenterisë…

ꕥ

Svetozar Vukmanoviq-Tempo është i pari i cili e pranoi MEMORANDUMIN, pjesën e parë, sipas të cilit Kushtetuta e vitit 1974 është argumenti më eklatant i fitores së koalicionit anti-serb në krye me J.B. Titon, dhe Eduard Kardelin.

ꕥ

Më 1941 populli shqiptar brohoriste – BABA HITLER, DAJA MUSOLIN, dhe vetëm një njeri po të varej do të mbushte hesap, e jo që në çdo qytet vareshin partizanët, sepse ishte krijuar një psikozë e tmerrshme propagandistike se gjoja çdo shqiptar i cili i bashkohet radhëve të L.N.Ç-së është TRADHTAR. Të identifikosh shtresën e okupatorit me popullin është mungesë e vetëdijes, mungesë e kulturës, sepse për fajin e prindit nuk bën ta vrasësh fëmijën e tij, sipas konventave ndërkombëtare…

Sinan Vllasi / Azem Sinani, janë të shartuar. Gllaviqi e akuzoi Azem Vllasin se pse nuk i ka lajmëruar se është duke bashkëpunuar me Federatën, dhe sipas tij, edhe ai i cili është në krye të Federatës, si Stipe Shuvari, nëse nuk na pyet neve, edhe ai është kundërrevolucionar, dhe mbulesa gjithnjë e më shumë po shteret dhe nuk po arrin t'i mbulojë të zezat e këtyre çetnikëve, të cilët sot janë bërë aq të tejdukshme sa mund t'i dallojë edhe një fëmijë…

ꕥ

Po mirë profesor, si arritën anglezët ta mbajnë nën zgjedhën e robërisë një shtet siç ishte India me mbi 400 milionë banorë?

(Këtë pyetje ia bëri profesorit veprimtari Lebit Murtishi nga Ladorishta e Strugës, më 19.02.1989)

Vetëm anglezët kanë arritur që me 10.000 ushtarë ta mbajnë të okupuar për 250 vjet Indinë (me mbi 400. 000. 000 banorë, ndërsa Anglia kishte rreth 40 milionë banorë), por gjithnjë duke iu falënderuar SIKËVE vendës, **si mercenarë të devotshëm e besnikë,** në rolin e gardës së policisë, ngjashëm me ne shqiptarët…

Beogradi po bërtet përmes TV-programeve duke drejtuar gishtin kah Dibra:

"Ja ku e keni fidanishten e iredentës, farën e iredentës... "

Dhe Dibrën po e lënë për eksperimente, për reklamë, si sumbull, dekor për këmishë, për t'u tregua tjerëve se ja si qëndron puna, sepse Dibra është grykë strategjike, dhe këtu nuk ndërmerren masa verbale, raciste siç bëjnë me viset tjera… Serbia po na jep neve gishtin në gojë, në vend të kafshatës… Dhe dihet se kush i do të gjitha, ngel pa asgjë…

ꕥ

Edhe Hong-Kongu 5-6 milionësh është për Kinën një sportel, sepse aty malli kalon pa doganë, edhe pse Kina mundet ta marrë kur të dojë…

ꕥ

Por te ne nuk po reagohet me efekt të jashtëm për të marrë vesh tërë bota. Më 1945 tërë populli shqiptar është shpallur kundërrevolucionar, bile edhe më keq: jedini ljudozderi u Evropi (Kanibalët, njeri-ngrënësit e vetëm në Evropë), mbeturinat e fundit të kanibalizmit, si ato në Amazoni (Brazil)… Shqiptarët në Maqedoni hanë bukë e lëng e gjak njeriu, dhe me një propagandë të tillë raciste ata plasojnë gënjeshtra kudo në botë, por ne shumë pak reagojmë, dhe reagimi individual nuk mbush hesap, kundrejt reagimit kolektiv… Ne ende nuk e kemi arritur moralin e popullit vietnamez, **MORALIN KOLEKTIV KRYENGRITËS...** Ne mjaftohemi me pak, me premtime formale, me autonomi formale, me Kushtetutë formale, si ajo e 1974-ës, dhe pothuaj të gjithë thonë njëzëri se – **MA SHQIPNI ASHTË KOSOVA SE VETË SHQIPNIA?!** Dhe pas ndarjes më 1966, pas Plenumit të Brioneve, ne filluam të shohim ëndrra, të bëhemi më katolikë se papa, duke na ardhur keq pse SHQIPËRIA nuk po e gëzon LUMTURINË dhe **mirëqenien tonë formale, me vila, me mercedesa, me televizorë** etj., ndërsa atje po vuajnë të zitë e ullirit

duke punuar si skllevër nëpër kooperativa… Por kështu mendojnë vetëm ata me mentalitetin e robit, sepse as që e dinë se çfarë vlere ka LIRIA, sepse me liri ata nënkuptojnë vetëm rehatinë, mirëqenien personale, luksin, ngopjen e stomakut…

Hajni i vërtetë kurrë nuk e vjedh fqinjin e parë… Edhe macja bën çmos që të dalë e të fëlliqet jashtë, sepse e merr kërbaçin dhe e humb kafshatën… Kështu vepron edhe shteti, i **seleksionon vetëm tipat më të përshtatshëm**, dhe sapo të shpenzohet njëri, e sjell tjetrin, deri sa t'mos amortizohet tërësisht si shtet tiranik. Për këtë shkak shteti e len Dibrën pa masa ndëshkimore, për taktikë, për dëshmi, sepse kanë hesap të kenë dëshmitarë para Evropës… Edhe në Beograd i kemi mbi 20.000 shqiptarë, dhe askush nuk i ndjek (por asnjëri nuk është i regjistruar si shqiptar)… Pra LIRINË do ta kemi nëse e meritojmë, por nëse themi: po ia lë ZOTIT t'na i kryejë punët që t'na sjellë LIRINË, atëherë ti në të vërtetë po e shan PERËNDINË. Kjo do të ishte njësoj si t'i lutesh zotit që t'i hakmerret armikut për dëmin që të ka bërë, ndërsa ti të rrish nën hije! Dhe kjo është mëkat i madh, njësoj sikundër të lindësh në bregdet dhe të mos dish NOT, ose siç thoshteFan Noli:

Pranë detit i palarë,
Pranë dritës i paparë,
Pranë sofrës i pangrënë,
Pranë dijes i panxënë.

Trendi botëror – po shtyhet data e konfrontimit BËRTHAMOR, për të jetuar sa më shumë – TRENDI I PACIFIZMIT – bota bën çmos që ne t'mos bëhemi LIBAN, sepse këtu gërshetohen shumë interesa, dhe nuk guxon të derdhet gjaku, sepse pas erës së gjakut vjen **PESHKAQENI**, ndërsa ne jemi në grykën e FYTIT të Evropës: Kaçanik – Shkup – Selanik… dhe kur rrjedh gjaku atëherë nuk mund ta ndalin. Mirëpo sikur të ngrihet në këmbë e tërë bota, nuk do arrijnë ta shpëtojë QYQARIN… Remzi Kolgeci po thotë: na jepni ju mundësi të shpëtojmë, na zgjatni dorën, çfarë ironie… ndërsa kolonizatori e konsideron hap

revolucionar të mos e mbysë e ta shfrytëzojë shqiptarin, sepse ka nevojë për krahun e punës së skllevërve për t'ua pastruar rrugët, për t'ua shkurtuar dhe bartur drutë për ngrohje… Dhe ja paradoksi: ne që jemi populli më i vjetër, i cili e ka çliruar edhe Egjiptin, **po kërkojmë nga të tjerët të na sjellin Lirinë?!** Dhe të gjitha këto janë vetëm pasoja të obskurantizmit shekullor kur themi: ishalla e bën zoti mirë! Zoti n'havale!

ꕥ

Në Kinë është ndaluar feja për 8 vjet me radhë, revolucioni kulturor, dhe pastaj kapitulloi revolucioni… Në Shqipëri **ATEIZMI TRIUMFOI** qe 26 vjet (nga 6 shkurti 1967), dhe për këtë e quajtën Fan Nolin prifti i kuq, sepse ai donte që përmes kishës autoqefale shqiptare të triumfonte **SHQIPTARIZMI**, sepse ai në kishën ortodokse të Bostonit **çdo ditë mbante ligjërata për epopenë e lavdishme të Skënderbeut, dhe në cilën xhami u mbajtën ligjërata të tilla mobilizuese ?!...**

Edhe Millosheviqi po na i garanton të gjitha të drejtat njerëzore, individuale (të drejta private, brenda katër mureve të shtëpisë deri në oborr…), por nuk po garanton asnjë të drejtë kombëtare. Në Maqedoni që nga viti 1945 s'e ka hapur kush gojën, por është vepruar siç ka dashur Shatorovi, i cili më 1941 kishte thënë se ne jemi tërësisht BULLGARË, dhe komiteti jugosllav nuk arriti t'i gjejë as dy vetë për ta formuar KOMITETIN E PARTISË MAQEDONE, e këta kanë qenë Cërvenkovski e Lazar Kolishevski… por këta e pranuan këtë formim me kusht – që të mos preket integriteti i Maqedonisë pas çlirimit, të pranohen kufijtë shtetërorë. Ndërsa lidhur me shqiptarët askund nuk është përmendur AUTONOMIA, e lëre më VETEVENDOSJA, siç ishte përcaktuar në bazë të REZOLUTËS SË BUJANIT më 2 janar 1944?! E dihet se në Maqedoni veprohet si në Afrikën e Jugut me diskriminimin racor, ndërsa Dr. Vullnet Starova, kryetar i

Kuvendit të Maqedonisë, thotë: Ne kemi fakte të gjalla se në Maqedoni nuk ka kurrfarë nacionalizmi. Me këto gënjeshtra ai po e luan rolin e LEPURIT, si kavje për eksperimentime… Vetëm Maqedonia e gëzon sot statusin KONFEDERATIV në Jugosllavi, pra si ortak, si bashkëshorte, por pa KURORË (dhe t'mos harrojmë se pikërisht ky fakt ndoshta ka ndikuar që Maqedoninë t'mos e fusin në zjarrin e luftërave të përgjakshme në Jugosllavi më 1991-1993 – vërejtja ime – BK). Më 1971 tërë Jugosllavia kanë pasur një ligj për regjistrimin e popullsisë, ndërsa Maqedonia kishte një ligj të VEÇANTË, EKS-TERRITORIALITETIN maqedonas në Federatën jugosllave, dhe për aq sa i konvenonte Maqedonisë, sepse përndryshe, pas regjistrimit maqedonasit do të ngelnin PAKICË NACIONALE?! Dhe gjithë këto padrejtësi bëhen në kurriz të shqiptarëve të diskriminuar në të gjitha fushat e jetës ekonomike dhe shoqërore, edhe pse numri i tyre e tejkalon numrin e maqedonasve…

ꕥ

Dr. Sllavko Letica nxjerr përfundimin statistikor se raporti i prodhimit shoqëror bruto **KOSOVË-SLLOVENI është 1:30**. Një dallim i tillë alarmant nuk ekziston në asnjë vend të kolonizuar në botë (shih: DANAS, 14, II. 1989). Në Kosovë kishte pasur deri më 1989, 186.000 të burgosur, ndërsa mbi 580.000 shqiptarë kishin kaluar nëpër duart e xhelatëve të UDB-së jugosllave. Kjo është Kosova e ditëve të sotme – BURG KOLEKTIV i tërë një populli të robëruar. Si pasojë e këtyre masave fashiste barbare nga Kosova u arratisën mbi 300.000 shqiptarë, kryesisht djalëria shqiptare, pjesa më vitale e popullatës së aftë për luftë… Në Kragujevc fëmijës shqiptar, Burimit 10 vjeç, një çetnik ia nxori sytë me thikë, por këtë akt mizor askush nuk e publikoi dhe asnjë gazetë nuk i shkroi dy fjalë …

ꕥ

LIGJËRIME, 20 shkurt 1989:

Profesor, çfarë mund t'na thoni për rezistencën tonë sot, dhe rezistencën e Mahatma Gandit në Indi që nga 1886 e deri në çlirim?

Mahatma Gandi që nga viti 1886 bënte **rezistencë aktive kundër kolonizatorëve anglezë**, dhe rezistenca e tyre kishte një efekt spektakolar, sepse të gjitha dyqanet në çdo vend mbylleshin në shenjë proteste, dhe asnjë mall anglez nuk blihej nga asnjë indian. Por në ballë të protestuesve qëndronte vetë **MAHATMA GANDI** që kishte dy doktoratura, derisa vinin policia dhe e arrestonin, dhe e mbanin në burg nga dy javë, dhe pastaj detyroheshin ta lironin… Në kulmin e protestave, kur anglezët e humbën durimin dhe masakruan me **armë zjarri mbi 260 vetë**, masa u trondit, por Mahatma Gandi u thotë – **TANI VËLLEZËR E FITUM LUFTËN, SEPSE ARMIKU E HUMBI DURIMIN** dhe për 12 ditë me radhë askush nuk doli në rrugë, por të gjithë u ngujuan, dhe i bojkotuan kolektivisht prodhimet angleze që nga peri e deri te kripa e gjilpëra, deri sa kolonizatorët anglezë e pranuan **KAPITULLIMIN**, dhe India u çlirua. Mirëpo, nuk duhet harruar se as ne nuk jemi indusë (mbi 400 milionë në atë kohë) dhe as serbët nuk janë anglezë, sepse anglezët e pushtuan Indinë përmes tregtisë, ndërsa kolonizatorët serbë e pushtuan Kosovën me grykën e pushkëve dhe topave…

ꕥ

LIGJËRIME, 24 shkurt 1989:

Që nga **17 nëntori u bënë tre muaj**, dhe kjo te ne ende do të zgjasë, dhe do t'i ndihet krisma më vonë, sepse ajo që dëgjohet tani s'është punë e madhe, por kur dergja

është shumë e rëndë, si LIJA, atëherë ndihet më vonë. Kur theresh me gjilpërë e ndjen menjëherë. Te ne dergja (sëmundja – robëria) është mijëravjeçare. Nga Nëntori 1912 deri në Nëntor 1989 kemi 77 vjet, dhe kjo s'është punë e vogël se sa njerëz do të varen në litar, dhe pastaj efekti do të jetë shumë i madh në të gjitha mediumet informative botërore, sepse sot është dita e tretë e GREVËS SË MINATORËVE TË TREPÇËS, dhe në horizontin 8, 9, 11, nuk kanë ajër, **dhe aq më shumë nëse mbarojnë, vdesin, aq më punë e madhe do të bëhet,** dhe pastaj gjithë kjo sakrificë sublime do të paguhet më vonë, sepse as buka nuk hahet në çastin kur del nga çerepi, furra… Një gjë e ngjashme është bërë në KONGO me heroin Patris Llumumba, të cilin e masakruan mizorisht, duke e bërë copa-copa për t'mos iu ditur as varri, ndërsa sot siç po shihet, pas ngujimit të minatorëve, ma në hall janë ata mjekrroshat në Beograd, sesa minatorët e ngujuar në shtatë palë tokë… Kjo është më e gjata grevë e minatorëve në histori. Dhe fjala më e madhe del – PALLAVËR… Stipe Shuvari edhe sikur të vinte, e ka vetëm një kokë, dhe ia nxjerrin sytë e veshët mjekrroshat e Millosheviqit, i vdekur për së gjalli, por ai e dërgoi Zoran qenin … Ne me këtë akt heroizmi të minatorëve po dëshmohemi për herë të parë pra botës pas demonstratave të 1968 dhe 1981, se deri tani jemi treguar trima duke ia nxjerrë sytë shoqi-shoqit…

Zojë Kurti(23.09.1947-6.04.1999).
Nxënëse e devotshme e prof. Qazim Berishës, të cilës ia shuan jetën mizorisht në spitalin e Prishtinës më 5.01.1999 duke ia shkruar në librin e amzës diagnozën - TERRORISTE. (Në spitalin e Prishtinës punonin 141 "mjek" të ardhur nga Serbia).

ꕥ

NDËRHYN në bisedë bashkëshortja ime, **ZOJA** (e cila vdiq mizorisht nga pasojat e torturave, nga ata 141 mjekët çetnikë që kishin ardhur nga Serbia në spitalin e Prishtinës, më 5 janar 1999, me diagnozën-

TERRORIST), dhe i drejtohet profesorit Qazim me këto fjalë:

Çfarë mendoni lum profesori, deri kur mund të zgjasë GREVA, dhe çka duhet të bëjmë ne?

Sa më pak gjilpëra, aq më shumë therësh (vuan). Kjo që po ndodh sot me ne është një episod, por duhet të jetë **vazhdimësi**, e jo të presim të pamundurën, **që sot ta mbjellim qershinë, dhe që në mëngjesin e nesërm të hipim në pemë dhe të marrim qershi me grusht.** Pra nëse GREVA E MINATORËVE nuk duhet të mbetet një episod, por duhet të bëhet vazhdimësi dhe obligim për secilin shqiptar, atëherë fitorja nuk do të mungojë, FRYTI do të vijë domosdo, ne dalim në dritë, por ÇMIMI gjithsesi duhet të paguhet, sepse LIRIA nuk fitohet vetëm me GRAMATIKË, por me GJAK, me sakrifica të shumta dhe të përditshme…

Më 1955-1956 për çdo vjet nga 100 mësues e arsimtarë i kanë dërguar nëpër burgje me akuzën se janë armiq të shtetit, ndërsa sot çdo të dytin arsimtar po e dëbojnë me masa të dhunshme policore nga procesi edukativo-arsimor me akuzën se janë të infektuar me MORTAJËN ANTISERBE, një infektim 2000 vjeçar, i cili nuk ka ngjarë as në Afrikën e Jugut, ku racizmi është i miratuar me ligj. Dhe sa më vonë që paguhet një gjë, aq më shumë ngrihet kamata, ndërsa pagesa më e shtrenjtë është atëherë kur jeta e njeriut shkon si qeni në rrush… Amerikani fëmijës së vet ia lëshon banesën me qira, dhe nuk i vjen marre. Te ne ende kemi shumë Rrahman Morina, Halit Tërnavca, Sefedin Sylejmana etj. Letrat – **PETICIONET E INTELEKTUALËVE (Apeli i 215 intelektualëve të Kosovës në mars 1989)** të cilat po i lexojmë janë si **detyrë shtëpie e nxënësve të klasës së parë fillore, janë lutje që zotëria t'ua gjuajë skllevërve ndonjë thërrime**, si maces nën sofër?! Ne në krahasim me TOSKËT flasim si SORRAT, nuk jemi homogjenë, të njëzëshëm…

ꕥ

Deri më 1994 duhet të heqim keq, ta pakësojmë inflacionin, dhe pastaj plus 5 vjet, d.m.th. edhe 10 vjet do të jemi në këtë situatë... (deri më 1999 – BK, një parashikim profetik).

ꕥ

Nataliteti është pjellë e rrethanave ekonomike, e zhvillimit shoqëror dhe jo e qëllimeve ekspansioniste të shqiptarëve. Ndërsa këta mjekërrosha, si akademik Mihajlloviqi, thonë: demografski terrorizam na Kosovu (TERRORIZMI DEMOGRAFIK në Kosovë?!), ose: çdo fëmijë i porsalindur në Kosovë është një bombë e gjallë në pelena, një armik më shumë për ne… Gjëra absurde, të cilat ka mundur t'i pjellë vetëm mendja raciste e Vasa Çubrilloviqit. Në Kosovë të lindësh fëmijën e tretë dënohesh, d.m.th. nuk shpërblehet fëmija i tretë as me sigurim social, ndërsa në Serbi për çdo fëmijë të lindur kemi shpërblime dhe privilegje të mëdha… Dhe gjera të tilla raciste nuk kanë ndodhur në asnjë vend tjetër të botës…

Më 1968 loja zgjati 6 muaj, ndërsa më 1981, pas shpërthimit të demonstratave, loja zgjati 8 vjet, dhe ende po vazhdon, sepse tërë bota i ka drejtuar sytë kah ne vetëm që të mos libanizohet Kosova.

Shqiptarizimi i emrave ka domethënie të madhe, se p.sh. emrat Teutë, Ilir, Shkumbin, Flamur, Liridonë etj. kanë efektin si me qit pushkë ose top, dhe mu për këtë armiku këtë zgjim po e cilëson si – Sluzhbena kontrarevolucija (Kundërrevolucion zyrtar), dhe tani si duket kemi filluar të vijmë në vete… Ne nuk duhet ta marrim pjesën për tërësi (Pars pro toto), por gjerat t'i shohim nën dritën e realitetit objektiv, në tërësinë e tyre…

ꕥ

Gjakova nuk është qytet i vjetër, por si kasaba u themelua para 300 vjetësh, Shkodra para 3000 vjetëve, Peja para 2000 vjetëve, ndërsa edhe Juniku (JUNIS – I RI – JUVENIS – i gjallë) u themelua para 2000 vjetëve. Racistët po bëjnë alarm se gjoja po u kërcënohet rreziku nga shtimi natyror i shqiptarëve dhe po thonë se **brenda 30 vjetëve do të kemi rreth 4 milionë shqiptarë**, dhe pastaj na shkon edhe Beogradi?!

300 orë po rrinë nën dhé për së gjalli minatorët e Trepçës dhe të gjithë po pyesin: vallë a ka KOMUNIST në Jugosllavi që do na i kuptojë KËRKESAT tona të ligjshme… Historia nuk do na e falë nëse do ndodhë diçka tragjike në ato galeri… TV-Ljubjana e dha këtë vlerësim: ANTISHQIPTARIZMI ËSHTË BËRË POLITIKË ZYRTARE…

Punëtorët e tekstilit të fabrikës "Emin Duraku" në Gjakovë po i gjuajnë librezat e partisë duke thënë: "Çfarë na duhen librezat e LK-së kur atë e mban edhe Rrahman Morina… "

ꕥ

LIGJËRIME, 25 shkurt 1989:

Dita e gjashtë e grevës së 1300 minatorëve trima. Kryesia e RSFJ-së po i përforcon radhët e ushtrisë dhe policisë federative. Gjeneral Kadijeviqi dhe Çullafiqi arritën në Kosovë, ndërsa slloveni Jozhe Smole apeloi te autoritetet e federatës që të ndërmarrin masa parandaluese, sepse tani gjendja shëndetësore e minatorëve po keqësohet, dhe 90 minatorëve iu dha ndihma e parë, ndërsa 40 minatorë u dërguan në spitale. Minatorëve të Trepçës iu bashkuan edhe minatorët e Magurës (Goleshit), Kishnicës etj. , dhe kështu 6000 minatorëve që 6 ditë ua kthyen shpinën Stipe Shuvari me kompani dhe shkuan në

Beograd… Me minatorët grevistë u solidarizuan të gjitha shkollat dhe të gjitha kolektivet punuese në Kosovë. Shqiptarët po akuzohen si kundërrevolucionarë vetëm pse po e kërkojnë mbrojtjen e KUSHTETUTËS së vitit 1974, dhe po kërkojnë referendum, kundër tezës raciste – se të gjithë shqiptarët janë armiq… Me minatorët e Trepçës dhe Stan Tërgut po solidarizohen edhe minatorët sllovenë të Tërbovljes dhe Idrisë, ndërsa kryetari i Lidhjes së Rinisë së Sllovenisë, Dejan Vrçiç, proteston duke thënë se: MË TEPËR VLEN JETA E NJË MINATORI SE TËRË NJË QEVERI!… Lidhja e Luftëtarëve të Gjakovës proteston duke potencuar faktin se Kosova i ka dhënë 5000 dëshmorë në Luftën Antifashiste NÇL për t'mos guxuar askush të luajë me fatin e shqiptarëve… **Minatorët nxorën jashtë me fishkëllima Stipe Shuvarin dhe Radisha Gaçiçin...** Shuvari u thotë minatorëve: edhe unë jam lodhur për fatin e juaj, por një minator e ndërpreu me këto fjalë: po, e dimë se je lodhur, por duke pirë kafe dhe ujë të thartë…

Renegati Rrahman Morina nën presionin dhe kërkesën ultimative të Minatorëve, bashkë me Husamedin Azemin, dhanë dorëheqje ditën e tetë të grevës së minatorëve. Ky është turpi i turpeve… kur dihet se Trepça e zë vendin e katërt në botë për prodhimin e plumbit dhe zinkut, ndërsa vendin e tretë në botë për prodhimin e floririt (arit)…

ꕥ

PLEQËRIA është çmimi i RINISË, dhe nëse dikush ka ndërruar jetë në moshën 24 vjeç, nuk e ka paguar çmimin i rinisë, siç është rasti i Migjenit dhe shumë të tjerëve. Pra pleqëria është BILANSI i jetës, jeta e plotë… ose siç thuhet **– mendo me sintaksë e ec me gramatikë...**

ꕥ

Ali Shukriu po e fyen popullin shqiptar… Populli mund të manipulohet lehtë, p.sh. Mark Antoni, miku i Jul Qesarit, pas atentatit kundër këtij të fundit, për një orë fjalimi e ka kthyer popullin për qëllimet e veta…

Sot nuk është koha e Xhafer Devës, borgjezia kombëtare është pjesë e borgjezisë jugosllave, sepse shkollimi i këtyre burokratëve është bërë nëpër shkollat e pushtuesit, dhe janë indoktrinuar me të ashtuquajturin bashkim-vëllazërim… Ne nuk ua dimë vlerën as syve të ballit, sepse pa sy nuk mund të përjetosh as jetën, as artin, dhe ndodh shpesh që dikush të thotë nuk të pashë, sepse nuk ka hesap të te shohë…

ꕥ

Rrahman Morina është një episod, sepse këto procese nuk janë të sotme, por të shtresuara me shekuj… Sikur Federata jugosllave t'i kishte dhënë Kosovës aq sa i ka dhënë Malit të Zi, Kosova do të ishte bërë si Zvicra apo Belgjika, dhe atëherë do të duhej të vinin fuqia e punëtorëve nga vendet tjera e të punonin në RURIN e Kosovës, ndërsa nënat tona do të ishin shpërblyer për lindshmërinë e tyre të lartë dhe nuk do t'i ofendonin duke i quajtur – **LAVATRIÇE** që lindin, ose – gjarpëresha antiserbe të cilat çdo ditë lindin fëmijë – **BOMBA TË GJALLA…** Historiani nuk është dëshmitar i ngjarjeve. Për këtë duhet të sigurohet distanca kohore, minimum 30-40 vjet, dhe kështu vetëm ai që nuk është dëshmitar direkt bëhet historian pas 30-40 vjetësh. Sepse sot mungojnë dokumentet relevante autentike, siç janë p.sh. dosjet e UDB-së etj. Ali Hadri ishte historian zyrtar, deri në një kohë, dhe më vonë, pas kundërvënies së Svetozar Vukmanoviq-Tempos, u bë jozyrtar, jo historian i regjimit, sipas diktatit dhe në shërbim të aparatit shtetëror. Kjo bëhet me kontratë: **50% për veti e 50% për**

urdhërdhënësin, si p.sh. për Ali Kelmendin, të mendojë për të vërtetën historike maksimale…

ꕥ

Në fund të vitit 1944 Brigadat partizane shqiptare hynë në Kosovë nga dy drejtime: nga Dibra dhe Struga, dhe nga Kukësi e lugina e Drinit (Prizren-Gjakovë-Pejë-Ferizaj), dhe u evitua lufta frontale (por me marrëveshje me jugosllavët), si ndihmë, me qëllim të evitimit të gjakderdhjes, dhe dihet se ky ishte një qëllim i shumëfishtë, për ta shfrytëzuar rastin për të hyrë pa gjakderdhje në trojet shqiptare dhe njëkohësisht Shqipërisë t'i jepet rasti për të dhënë kontributin e barabartë. Por kjo ishte ndihmë me dy tehe, nga njëra anë si ÇLIRIMTARË (liberatorë), dhe nga ana tjetër për t'mos u shkaktuar gjakderdhje, një adut i fortë ky për të dëshmuar se ishin në krahun e forcave të aleancës antifashiste, dhe si rezultat i gjithë kësaj ende nuk po jetojmë së bashku… një rrugë e shumë punë… Por kurrsesi nuk qëndron fakti, siç thonë disa naivë, se BRIGADAT SHQIPTARE na morën në qafë, sepse, siç dihet, Jugosllavia e kishte planin strategjik për ta gllabëruar jo vetëm Kosovën, të cilën veç e kishte, por edhe Shqipërinë… Dhe siç rezultoi më vonë me shkuarjen në Frontin e Sremit kundër forcave nazifashiste gjermane , kur kanosej rreziku për të hyrë në gërshërë, dhe në Kosovë mësyni Divizioni 26 i armatës jugosllave, për konfrontim me forcat e rezistencës në krye me **Shaban Polluzhën**, një strateg me intuitë luftarake, por pa akademi ushtarake, strateg popullor, të cilit ia kishte prerë mendja, dhe në rrugë e sipër bashkë me eshalonin e tij , me të cilin ishte nisur në drejtim të Podujevës, për të vazhduar drejt Sremit, e kishin hetuar tradhtinë çetnikopartizane dhe ishin kthye mbrapa duke u besatua me shokë se do të qëndrojnë kundër armikut deri në pikën e fundit të gjakut. Kështu Shaban Polluzha u bë legjendë dhe nuk u thye

moralisht edhe pse e dinte se barbarët ia kishin marrë në burg bashkëshorten malësore bashkë me fëmijët.

Ne bashkëpunuam me luftëtarët toskë, të cilët kishin PARIME dhe kurrë nuk lejuan të dyshojë kush në ta… Te ne ende po jetojmë me iluzione, dhe **së paku edhe pesë vite duhet ta shtrëngojmë rripin**, derisa të bashkohet barku me shpinën, sepse pa dalë **në demonstrata edhe NËNAT ME FËMIJË përdore nuk mund të ketë FITORE.** Dhe jo vetëm nënat, por të gjitha strukturat shoqërore, ashtu siç veproi populli algjerian në revolucionin mbarëpopullor për 7, 5 vjet me radhë, dhe fitorja kundër kolonizatorëve francezë ishte e sigurt… Kur vetëm katër bukë kushtojnë një milionë dinarë, kjo është e tmerrshme, ndërsa për 6 vetë 20 milionë dinarë, që do të thotë proletarizim i bujkut, me një jetë të tillë tragjike… Për këtë Ante Markoviqi e dha mendimin shumë realist se edhe pesë vite duke ecur kësaj tatëpjete do ligështohemi derisa do të na vijnë mendtë, dhe pas 15 vjetëve do të bëhemi si para pesë viteve, ndërsa pas 20 vjetëve do bëhemi si para 10 vjetëve…

Radoje Domanoviq në novelat e tij satirike (si "Kraleviç Marko po drugi put megju srbima" – Kraleviq Marku për të dytën herë në mesin e serbëve) thoshte:

"Ai që do ta përtërijë mesjetën, ai edhe e meriton MESJETËN!"

Sot edhe Karl Marksi po të çohet nga varri, këta do ta burgosnin, sepse këta që po udhëheqin sot nuk janë qorra, por po ecin sipas një programi absurd, me iluzionin se kjo luftë nuk do t'iu shkojë huq, edhe nëse fitojnë vetëm 1%… Dhe nuk ishte pa qëllim letërkëmbimi i shkrimtarit slloven Grafenhauer drejtuar një miku serb, në të cilin ai ia tërheq vërejtjen duke i thënë – keni kujdes se me këtë avaz që keni nisur një ditë juve do t'ju shkojë edhe STOMAKU I SERBISË (Kragujevci, Krushevci, Leskovci etj.)

Hë për hë realizimi i statusit REPUBLIKË nuk vjen në konsiderim, sepse sipas konceptit racist serb kjo kërkesë e pamundëson edhe AUTONOMINË, që do të thotë se

kërkesa maksimale – Republikë e Kosovës e ka kuptimin e ruajtjes së autonomisë, d.m.th. të pengohet devalvimi i autonomisë, dhe kjo mund të arrihet vetëm nëse shqiptarët e Kosovës **i zë gjumi kolektiv...** Dhe kjo nënkupton: as republika të mos fitohet, por as autonomia të mos humbet, njësoj si në tabelën logaritmike. Por edhe sikur ne të themi se jemi – DELE dhe na e hiqni autonominë, armiku ka qëllimin për të te varë si **KRIMINEL** e jo si trim, **e të te këndohet kënga...**

ꕥ

Që nga 918-1918 sllovenët jetuan nën sundimin gjerman, ashtu si edhe kroatët… Nikolla Pashiqi e kundërshtoi bashkimin me sllovenët duke thënë se ata nuk mund t'i bëjmë serbë, ndërsa sipas konceptit ekspansionist racist të Sllobobodan Millosheviqit, tërë Jugosllavia është Serbi, përveç Sllovenisë dhe 50% e Kroacisë… ndërsa Drazha Markoviqi në memoaret e tij potencon se serbo-malazezët barazimin e të drejtave të shqiptarëve e përjetuan si terror, si tragjedi (1966-1968), sepse deri në mesin e shekullit XXI do të kemi 3,5 milionë serbë dhe 4,5 milionë shqiptarë, sepse çdo fëmijë i lindur i nënës shqiptare do të nënkuptohet si një bombë e gjallë për serbët. Dhe me këtë diskurs racist po synojnë ta tmerrojnë një popull me një popull tjetër, ndërkaq më përpara vetëm për mahi po t'i kishte thënë dikush këto gjëra do t'i shkonte koka…

Faktori i brendshëm është përcaktues, sepse popullit po i imponohet diferencimi (policor), sepse në TVP njëri po i mëshon thumbit e tjetri patkoit, dhe ky medium është në dorë të armikut, e jo siç ndodhi me Algjerinë kundër Francës, kur felahët, tërë populli punëtor e fshatar, u bashkuan kundër kolonizatorëve francezë, dhe Franca kapitulloi, edhe pse teknika dhe aviacioni ushtarak bënin masakra mbi popullsinë civile algjeriane… Por edhe amerikanët ikën me turp nga Vietnami, përkundër gjithë atij arsenali luftarak më modern, sepse faktori njeri është

FAKTOR VENDIMTAR për fatin e çdo lufte… Sot po shihen filmat dokumentarë se si kanë ikur amerikanët si lepuj nga Vietnami…

ꕥ

600 vjet para epokës sonë u bë internimi i parë i hebrenjve nga Babilonia, e 400 vjet më vonë edhe nga Persia, dhe në fund edhe nga romakët… Nazifashizmi hitlerian bëri gjenocid mbi 6 milionë hebrenj, ndërsa sot Izraeli e ka izoluar tërë botën nga vetvetja…

Serbomalazezëve sa më shumë që u japin beneficione për të vërshuar dhe kolonizuar Kosovën, aq më shumë u futet frika, dhe gjithë investimet u shkojnë kot, sepse secilit i dhimbset koka e vet, ngase askush nuk e ka edhe një kokë rezervë…

Diskriminimi dhe shtypja po bëhet edhe më shtypëse, dhe një ditë tërë populli do ta kuptojë gjendjen e tij prej skllavi, dhe nuk do ta durojë më zgjedhën e robërisë… **Kush janë ata që sot po thonë se Kosova është MATHAUZEN, se atje kemi gjenocid, terror, fashizëm?!...** Të gjitha ndërmarrjet në Kosovë, që nga "Ramiz Sadiku" e deri te "Trepça" po e kërkojnë dorëheqjen e Sllobodan Millosheviqit, Ali Shukriut, Rrahman Morinës, Husamedin Azemit….

ꕥ

Në Shqipëri u arritën rezultate kolosale, u sigurua buka në vend, që para dhjetë vitesh, stimulimi i bujqësisë 20% më i lartë, ndërsa çmimet 20% më të ulëta, pa taksa, pa tatime, sepse emulacioni është gjithëpërfshirës. Atje thuhet: nëse e largojmë një gur më shumë nga toka, do të kemi një lugë qumësht më shumë, por nëse e largojmë një shkurre, do të kemi një vedër qumësht më shumë… Dhe të gjithë e dinë se rreziku vjen nëse centralizmi demokratik zëvendësohet me centralizmin **BUROKRATIK,** por për t'u

parandaluar ky rrezik duhet të shkohet sa më shumë në bazë, në mesin e punëtorëve dhe fshatarësisë kooperativiste, dhe çështja e shpërblimit në praktikë të konsiderohet çështje jetike…. KOMUNIZMI nuk mbin, nuk lind në atë vend ku nuk janë pjekur kushtet ekonomiko-shoqërore…. Në Shqipëri u arrit elektrifikimi i tërë vendit, dhe u zhduk analfabetizmi, **duke zënë vendin e parë në BOTË me më së paku ANALFABETË** (001%, India me 58, 4% me më së shumti analfabetë, sipas shënimeve të UNESKO-s, shih- Rilindja, 13.02.1989, f. 13).

- Pas vitit 1945 deri më sot Kosova ka ngecur për 80% në krahasim me mesataren jugosllave në zhvillimin ekonomik;

– Pas vitit 1945 nga Kosova për në Turqi u dëbuan me dhunë mbi 500.000 shqiptarë;

– Nga viti 1981-1988 nga organet fashiste të UDB-së u keqtrajtuan **mbi 584.000 shqiptarë**;

– Në Kosovë mbi **10.000 familje janë në burg** shtëpiak për shkak të hasmërive dhe ngatërresave pronësore;

– Nga viti 1981-1989 numri i studentëve në Universitetin e Prishtinës u zvogëlua **për 45.86%;**

– Nga viti 1981-1989 1040 nxënësve nuk u është lejuar të vazhdojnë studimet për shkak të diskriminimit me akuzën "i papërshtatshëm";

– Në vitet 1987-1989 vetëm 36. 3% të femrave (ose 7266) e kanë vazhduar shkollimin e mesëm…

Thuhet se në Kosovë i kemi mbi 100.000 të papunë, por kjo shifër është e zvogëluar…

ꕥ

LIGJËRIME, 10 korrik 1989:

Dhe vjen një çast dhe gjenet zgjohen nga gjumi, dhe kemi njerëz që kanë vuajtur 30 vjet burg dhe nuk janë dorëzuar, dhe humbjen e shohin si fitore… MEMORANDUMI (1986) është UNGJILLI serb, ideologji serbomadhe, për të dalë në tre dete (Egje, Jon dhe Adriatik…)… Me kapitullimin e Austro-Hungarisë u formua Jugosllavia (më 1 dhjetor 1918) duke pushtuar Kosovën, Maqedoninë, Vojvodinën, dhe në krye të dhjetë ditëve u pushtua edhe Mali i Zi, si sot me Rr. Morinën e J. Karakushin, sepse malazezët ishin ndarë në dy grupe: Belashët ishin për t'u bashkuar me Serbinë, ndërsa Zelenashët ishin kundër këtij bashkimi, sepse Mali i Zi ishte shtet 100 vjet para Serbisë… Ndërsa sot Serbia, edhe pse e ka Vojvodinën dhe Kosovën, nuk e ka tashmë Maqedoninë, me të cilën i bashkon kisha ortodokse…

Dr. Ante Paveliqi e nënshkroi bashkimin më 1 dhjetor 1918, por me kusht që ligjet e Serbisë të mos kenë vlerë në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë, ndërsa më 1929 u shpall Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene….

Pra problemi qëndron në atë që Serbia t'mos e kalojë lumin Drin, sepse po thonë se janë 2000.000 serbë në Bosnjë, se gjysma e Dalmacisë, deri në Shibenik, Krahina e Kninit, me Likën, Kordunin, Baninë, Sisakun, Osjekun etj. janë toka serbe, dhe pastaj planifikohet mësymja e Maqedonisë dhe SHQIPËRISË… Ky program ekspansionist ka bërë që Greqia t'i hap sytë, sepse programi serb pretendon se – ATY KU ËSHTË NJË KISHË SERBE – ATY ËSHTË SHTETI SERB?! Dhe në këtë frymë të homogjenizimit pan-serb iu dha çmimi i 7 korrikut kryeçetnikut Matija Beçkoviq, duke pohuar se nuk ka serbë të këqij, dhe kështu u arrit pajtimi i çetnikëve me partizanët, sepse kisha u mbështet në çetnikë dhe çetnikët në kishë, e kjo do të thotë pajtim i atyre që u vranë mes veti më 1945, çetnikët me partizanët e LNÇ-së. Neve po na përdorin si arnë, dhe po thonë të ruhemi, se nëse nuk e arrijmë këtë, atëherë vijnë superfuqitë botërore dhe na ruajnë, sepse Evropa nuk lejon të kallet, dhe tërë

kjo luftë po bëhet për t'mos intervenuar forcat e OKB-së, dhe po nguten që sa më parë të formohen **SHOQATAT PLURALISTE** – DEMOKRATIKE për ta evituar terrorin. Por Millosheviqi nuk po e lejon liberalizimin e Jugosllavisë, dhe po pretendon t'i mbajë territoret deri në Trigllav, ndërsa shqiptarëve po u lejon BARAZI QYTETARE, por vetëm në letër, barazi formale, dhe kështu këta serbë të sotshëm po kërkojnë më zi se në kohën e mbretit Karagjorgjeviq, vetëm që t'na mbajnë nën zgjedhën e robërisë. Por ne duhet të luftojmë dhe t'mos i varim shpresat tek të tjerët, por pikë së pari tek VETVETJA!

ꕥ

Turqit nuk i kanë prekur tokat e kishës, sepse kisha serbe nuk e lejonte popullin për të bërë kryengritje, dhe për 500 vjet bëri aleancë vasaliteti, ndërsa ne shqiptarët nuk e kishim një kishë të tillë autoktone, për të dalë me kërkesa autonomie 200 vjet përpara, që të mos e prisnim tragjedinë e shekullit XX. Katër shtete bënë Aleancën Ballkanike më 1912 (Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia), dhe e sakatuan mizorisht Shqipërinë nga Veriu, Jugu dhe Perëndimi, duke ia okupuar asaj mbi 70% të territoreve më të mira, pjesën vitale të territoreve… Vetëm **Dimitrije Tucoviqi e Kosta Novakoviqi** ishin kundër këtyre kolonizimeve serbomëdha, por që të dy u likuiduan mizorisht…

Ne duhet të luftojmë në mënyrë permanente kundër kolonizatorëve serbo-maqedono-malazezë, dhe jo me episode, por në vazhdimësi, dhe kurrë mos themi se **po më kalbet djali në burg** për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata. Është budallallëk të pyesësh se kush i organizoi demonstratat, sepse e rëndësishme është se si janë organizuar demonstratat, dhe kjo është **HALLKA KYÇE PËR FITORE**, nëse nuk dështon… Dhe kriza të gjithë i ka kapur për FYTI! Sa më turbullt, aq më keq, nëse nuk jemi të fortë, nëse nuk jemi të organizuar…

Deri **më 1992 parashihet të bëhet Kushtetuta**, dhe në Kongres do merret vesh se si dhe sa do të ashpërsohet situata… Por Millosheviqi po e shpejton situatën, dhe deri në miratimin e Kushtetutës do të bëhet diferencimi më i madh, dhe mund të vijë deri te formimi i dy Kongreseve: njëri në Beograd, dhe tjetri në Zagreb, dhe këta në Beograd ta shpallin car Millosheviqin, ndërsa ata në Zagreb t'i përjashtojnë nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë…

ꕥ

Çdo njeri me ambicie negative është XHELOZ, dhe për një lugë kos më shumë që ty të ra hise i vjen inat...

ꕥ

Ç'mund të na thoni pak ,ë shumë për METAFIZIKËN?

Metafizika është disiplinë filozofike e cila merret me atë që i kalon kufijtë e realitetit (Dekarti, Spinoza, Lajbnici, Fihte etj.). Në bazë të **materializmit dialektik METAFIZIKA**, si spekulim i dëmshëm, ia lëshon vendin metodave shkencore të te mësuarit… **Materializmi** e shpjegon metafizikën si mendim i cili i konsideron të gjitha gjërat **të PANDRYSHUESHME**, të përhershme, jokundërthënëse. . E kundërta e kësaj disipline filozofike është **DIALEKTIKA MATERIALISTE.**

ꕥ

LIGJËRIME, 8 nëntor 1989

Sot medicina ka arritur shumë… dhe kirurgjia plastike po bën mrekullia… Për dikë rrudhat janë **kapital**, ndërsa për dikë tjetër janë VDEKJE, sepse ia han vetes kokën duke u mërzitur për gjëra të kota… Edhe gjumin duhet ta bëjmë me përmbajtje, jo **gjumë pasiv...** Realiteti i ËNDRRAVE është e kundërta e REALITETIT të zhgjëndrrave, d.m.th. është **pasqyrim SUBJEKTIV i botës OBJEKTIVE...** Kurrë nuk themi – shko e blej SHPIRT, i cili është një nga momentet e ekzistencës…

Sa më shumë gjuhë të dimë është një begati e madhe, si një kopsht plot me lule, por te ne p.sh. **TURQISHTEN** (gjuhë surrogat me gramatikë dhe sintaksë shqipe, dhe fjalë turke) po e keqshfrytëzojmë, dhe po ia shohim sherrin… Por duhet të mos harrojmë se ne më së pari jemi njerëz, e pastaj jemi shqiptarë, turq, serbë, malazezë etj. Deri më 1945 në Prizren **vetëm 2-3% kanë folur shqip,** ndërsa të tjerët flisnin **turqisht**, sepse ishte e favorizuar… Edhe më 1912 asnjë akt i pavarësisë së Shqipërisë nuk është shkruar në gjuhën shqipe, dhe kjo është një tregues domethënës për vonesën tonë shumë të madhe… Me **UNISIMIN E GJUHËS letrare shqipe** (1968-1972) u bë hapi

më i madh në drejtim **të BASHKIMIT KOMBËTAR,** dhe kjo i tmerroi shovinistët, të cilëve ky hap i madh historik u erdhi si **ATENTAT**… Dhe grumbullimi i shovinizmit dhe racizmit serbomadh shpërtheu me 1981, kur nën zinxhirët e tankeve u mbytën qindra demonstrues, dhe bota e kuptoi se **kolonializmit jugosllav po i vinte fundi**…

ꕥ

Sa nëna i kanë mbytur fëmijët e tyre pa dashje, duke menduar se po u japin gji, dhe **ua kanë zënë frymëmarrjen**. Edhe neve, duke menduar se po e shpëtojmë SHQIPËRINË, po ia zëmë FRYMËN, po ia hapim varrin… **DASHURI E VERBËR** – ta mbysësh Shqipërinë përmes vetvetes. Por sikur të mos e kishim atë Shqipëri, nuk do të guxonim të lazdroheshim aq shumë…

ꕥ

SHQIPËRIA është anëtare aktive e OKB-së, sepse atje nuk bëjnë gjumë, dhe ky shtet për 10-15 vite e ka përfaqësuar Republikën e Kinës në OKB. Ndërsa Kina për këto shërbime i ka paguar Shqipërisë mbi 2.000.000.000 dollarë, deri **më 1974**, kur Kina, falë Rezolutës së Shqipërisë, u pranua në OKB. Kështu Shqipëria kishte vepruar edhe me BRSS-në, me rusët, kur ua kishte dhënë me QIRA skelën e SAZANIT, Pashalimanin e Karaburunin, të veshur në hekur e çelik, si garazhë të nëndetëseve ruse, **deri më 1961**, kur për 24 orë iu dha **ULTIMATUM** rusëve, dhe rusët ikën me bisht nën shalë… Por investimet më të mëdha janë bërë në shkollimin e kuadrove për fusha të ndryshme, përveç në industri e bujqësi, ku rusët dhe kinezët kanë dhënë shuma të mëdha (p.sh. vetëm për shkollimin e një piloti janë shpenzuar mbi **1.000.000 dollarë**, ndërsa në Shqipëri për katër vite **janë shkolluar 1200 pilotë** dhe janë blerë qindra avionë MIG-

21). Por studenti shqiptar atje nuk ka guxuar të verbohet për një agjente ose për një kurvë ruse a kineze, sepse ndaj tij do të merreshin masat më rigoroze administrative… Për 41 vjet me radhë, **që nga viti 1948, kurrë nuk ka ndodhur që brenda kufirit shqiptar të shkelë këmba e ushtarit të huaj dhe ai të dalë i gjallë nga Shqipëria**… Ndërkaq sot Polonia, Hungaria, Gjermania Lindore, po lirohen me leje të BRSS-së, po dalin nga Traktati i Varshavës, por me program… dhe **po ruhet bërthama** që i lidh të gjithë në sistemin shumëpartiak… BRSS po mban lidhje intensive përmes sportelit, ambasadës rumune…

ꕥ

Konkurrenca në tregun botëror të mbyt, dhe kjo është më e madhe se pushka, dhe për ta përballuar këtë rrethim të EGËR IMPERIALIST Shqipëria duhet të jetë shumë e fortë **ekonomikisht.**

ꕥ

Vendet skandinave janë përjashtim: droga, vetëvrasjet, prostitucioni, të gjitha këto janë si pagesë e të MIRAVE, ose si **kamatë e të zezave** (P.sh. në pikë dite po vritet kryetari i Suedisë **Ullof Palme**, si rezultat i kësaj infrastrukture negative e këtyre të mirave, të cilat po e brejnë këtë shoqëri si krimbi…). Dhe si mund të shpjegohet fakti kur në sofër kemi minimumin e ekzistencës, bukë e lëng, ndërsa harmonia më e madhe, e sot standardi shumë më i lartë, por vëllezërit janë bërë pikë e pesë në mes veti?!

Ne në Kosovë jemi të BOMBARDUAR nga lloj-lloj interesash. Ne jemi në mes dy zjarreve, **në mes grykave të pushkëve**, sepse dëshirojmë t'i arrijmë të gjitha të mirat pa humbur asgjë… dhe një gjë e tillë edhe sikur të ishte e mundshme, do të ishte **e TURPSHME**… Ne jemi të

ekspozuar nga të gjitha anët nga influencat e shumëkujt, por **më së PAKU NGA INFLUENCA SHQIPTARE**!

ꕥ

MARCIUS – E MARTE (ditë lufte);

E MËRKURË – DITË E TREGTISË (në Prizren, 2500 vjet më parë);

E ENJTË – fjalë ilire – romake, ENTIS – ENTEM – (LATINISHT) – po e shoh mbi gjithë perënditë – planetin JUPITER, pra – FUQI SUPREME – ENJTI – JUPITERI;

E PREMTE – PERENDESHA E DASHURISË – AFËRDITA – Ylli i Dritës, dita e pestë e javës;

E SHTUNË – SATURNI (Perëndia i botës së përtejme – errësirës;

HADI – dita e vdekjes – dita e përmbysjes).

ꕥ

T'I URRESH TË ZEZAT ËSHTË BURRËRI E MADHE! TUCANI I DO TË ZEZAT...

ꕥ

Ne të gjithë deklarohemi se jemi për LIRI, por të kujt? Shqiptarët e kanë një shtet, e tani duan ta kenë edhe një shtet… **E shqiptarët këtu te ne i kanë shumë të "MIRA": viçin, lopën, traktorin, devizat, por edhe baba-shehun, dhe dorën në zemër,** ky shqiptar **kurrë nuk pranon të kolektivizohet si ata shqiptarët e Shqipërisë...** Marksi thoshte: NËSE NJË KUFI ËSHTË VENDOSUR ME DHUNË, VETËM ME DHUNË MUND TË HIQET, dhe ne këtë kufi duhet ta kemi si **kufi TAKTIK**, jo të hiqet, sepse atëherë do të mbaronte edhe Shqipëria, edhe neve. Ky është një PROCES I NDËRGJEGJËSIMIT KOMBËTAR, i formësimit, e tani për tani arritja më e

madhe është **UNISIMI I GJUHËS STANDARDE SHQIPE...** Millosheviqi, kur e vizitoi ELEKTROKOSOVËN, u foli punëtorëve në gjuhën shqipe: **MIRËMBRËMA!,** ndërsa ne nuk jemi ende të vetëdijshëm për këto të arritura, për këtë arritje POLITIKE. Strategjia e BASHKIMIT është strategji AFATGJATE, që do të thotë – **gjithnjë ta kërkosh e kurrë të mos ta japin, për të mirën e të dyja GJYSMAVE – SHQIPËRI – KOSOVË!** Dhe ne duhet t'i aktivizojmë të gjitha energjitë në drejtim të realizimit të te drejtave legjitime përmes VETVETES, e jo përmes SHQIPËRISË, sepse këtu jemi laramani e madhe, dhe e mashtrojmë vetveten… Shqipëria e ka shumë të qartë situatën tonë, bile **shumë më mirë se sa ne,** dhe mu për këtë ne kurrë nuk duhet ta harrojmë Shqipërinë, sepse është njësoj si ta harrojmë VETVETEN! Dhe për t'u ndryshuar ky realitet, këto gjëra të tmerrshme, por reale, si dergja, si mortaja (tri besime fetare), e për tu bërë këto transformime duhet të kalojnë disa gjenerata, sepse në Shqipëri ky emancipim kombëtar filloi që nga viti 1912, ndërsa te ne gjatë një episodi **më 1941-1944**, e pastaj **pas vitit 1968.** Dhe të gjitha këto prapambetje, këto vonesa, i kushtëzon **MUNGESA E SHKOLLËS KOMBËTARE**, e cila e ka kushtëzuar edhe vonesën e NDËRGJEGJËSIMIT KOMBËTAR! E kur deklarohemi për bashkim në rrethanat e sotme, kjo do të thotë **bashkim në VORR**, dhe asnjë nënë normale nuk e dëshiron një bashkim të tillë, që Shqipëria ta humbë PAVARËSINË. Ndërsa ne në KOSOVË nuk jemi në VORR, por jemi në **BURGUN KOLEKTIV** që quhet JUGOSLLAVI. Edhe më naivi, më budallai e di se më mirë është në **BURG** se sa në **VARR**! Por që jemi gjallë, dhe në burg kolektiv, këtë më së miri po e tregojnë **tanket dhe autoblindat e armatës jugosllave** që çdo ditë defilojnë dhe e kërcënojnë popullin e Kosovës me shfarosje, dhe për t'i frikësuar të rinjtë shqiptarë që ta marrin botën në sy, të ikin në Evropë deri në Amerikë, të **zbrazet Kosova**, këto janë qëllimet e armikut. Gjermanët janë më ngushtë se ne, sepse edhe

Austria, edhe Gjermania, edhe Zvicra ia kanë shumë lakmi **PAVARËSISË SË SHQIPËRISË**, edhe pse kjo pavarësi nuk zotëron as 50% të territorit të SHQIPËRISË NATYRALE… Sepse ata e dinë se më mirë është të jetë e lirë GJYSMA se të mos jetë hiç e lirë… Gjeli i cili këndon para kohe – shkon në kusi, bëhet çervish… Ta ruash **IDENTITETIN SHQIPTAR** në Evropë është shumë punë e madhe, dhe për këtë nuk duhet të kursehemi për asnjë sakrificë, edhe të derdhet gjaku, sepse **përmes nesh MBROHET SHQIPËRIA**! Por sikur të ishin investuar miliardat që nga viti 1947 edhe në KOSOVË, po të ishte bërë Kosova si **Luksemburgu**, atëherë ne do ta kishim harruar vetveten, do ishim bërë si Rrahman Morina me shokë, të cilëve po u "DIGJET ZEMRA" për ta **"ÇLIRUAR SHQIPËRINË** nga kolektivizimi socialist"?!

Përkundër gjithë këtyre diskriminimeve, dhe gjithë këtyre eksploatimeve barbare të pasurive të Kosovës, përkundër gjithë kësaj varfërie të skajshme, megjithatë shqiptarët nuk e harruan vetveten… Prandaj detyrë mbi detyra është që ne kurrë të mos bëhemi qenë roje, dhe ta "SHPËTOJMË SHQIPËRINË" nga diktatura e proletariatit…

ꕥ

LIGJËRIME, 30 nëntor 1989:

Ismet Shaqiri gjithnjë ka insistuar, që nga viti 1942, që shqiptarët e Kosovës të quhen – SHIPTARI, dhe kështu të diferencohen nga SHQIPTARËT e Shqipërisë, se gjoja janë krejtësisht të ndryshëm, ndërsa në Maqedoni nuk patën Ismet Shaqira, dhe sot atje thuhet – ALBANSKO izdanje, e jo SHIPTARSKO… Tradhtarët çelin si në inkubator… **TRADHTIA është një sëmundje specifike**… Cincarët martohen mes veti për të treguar se janë më serbë se serbët, ndërsa në kohën e okupacionit fashist italian, që i thoshin në kohën e Shqipnisë, ata thoshin se jemi AROMUNË…

Më 1939-1941 në librin – ETNOGRAFIA për klasën e VI-të, shkruante veç tjerash: FINI TURCI, A DIVLJI ARNAUTI… (Turqit e mirë, ndërsa shqiptarët të EGËR…). Dhe mund ta merrni me mend se me çfarë doze helmi shovinist e racist helmohej rinia serbo-malazeze!!! Edhe maqedonasit ishin të diskriminuar në atë kohë, por sot ata po sillen ndaj shqiptarëve njësoj sikundër serbët ndaj tyre para luftës, dhe atje po bëhen eksperimente me shqiptarët… Kjo do të thotë se shqiptarët në të gjitha kohërat ishin EX LEGE – JASHTË LIGJIT. Bariu iu përgjigj me urtësi kur e pyetën fashistët gjermanë se sa shkollë ke, dhe ai pa u hamendur ua thotë shkurt e shqip: **"NUK DI SHKRIM E LEXIM, POR TRADHTINË E LEXOJ NË SY... "**

ꕥ

Në Indi kur u ngordh lopa, të cilën atje e adhurojnë si perëndi, **mbajnë zi 10 ditë,** dhe lopa nderohet më shumë se NËNA?!

ꕥ

Është rrezik të jesh i mirë në këto rrethana raciste, por ia vlen barra qiranë.

Me këto veprime të Sllovenisë, e cila nuk i lejoi të mbaheshin mitingjet e çetnikëve serbë, u vërtetua se në Kosovë nuk ka pasur KUNDËREVOLUCION…

Papa Klementi i VI (1343) ishte arbresh, me gjuhën amtare arbëreshe (Shih: BOTA SHQIPTARE), e Musolini thoshte më 1939 – SHQIPËRIA ËSHTË NË ZEMRËN TIME (Musolini e shpërblente me 30 napolona ari për dasmën atë shqiptar që **martohej me italianen**), ashtu siç po thotë sot edhe Millosheviqi.

A.Vllasi është stërtradhtar, dhe me të duhet të ngrohemi e të mos digjemi, sepse ai nuk deshi të bëhej i Serbisë, si Rrahman Morina, **po i Jugosllavisë së Titos**… Vllasi është këlysh i Titos, dhe më i rrezikshëm për

shqiptarët se Rrahman Morina, sepse ai është si **mina e befasisë** (podmetnuta mina), por nuk e di se SHQIPËRIA do të na copëtonte me dhëmbë nëse dikush merr guxim e ia mësyn drejt saj… P.sh. **GJERMANIA mund të bashkohet tri herë**, ndërsa ne jo, sepse ne jemi **DIVERSANTA**, sepse për 40 vjet ne kemi jetuar në rrethana krejtësisht tjera në krahasim me Shqipërinë… Neve jemi si VARRTARË, varrtarë potencialë të dyfishtë, si **KALË TROJE,** shumë të rrezikshëm… Kurrë nuk duhet të fajësohet fëmija pse iu ka rritur këmba… Sinan Hasani gjithmonë ka qenë mall i skaduar që ka **kutërbuar**, dhe për të nuk vlen as plumbi të shpenzohet… Predrag Vranicki është kroat, por është një stërserb, më beter se serbët, dhe po e arsyeton D. Qosiqin… Sllovenët dolën në përkrahje të shqiptarëve për interesa të veta, dhe e penguan shkuarjen e serbo-malazezëve në Lubjanë për të mbajtur – mitingun e të vërtetës?! Këta mjekëroshë po thonë: NE PO **I MBROJMË SHQIPTARËT E NDERSHËM nga shqiptarët e TËRBUAR?!** (Mi branimo poshtene albance od pobjesnelih albanaca…). Rr. Morina është njëri prej atyre **qenve dykëmbësh** – policë të dresuar, dhe ai me detyrë është SHQIPTAR, por **me bindje është serb.** Dhe kjo situatë është e mbarsur me rreziqe, e cila e bën më të nevojshme se kurrë VIGJILENCËN E POPUJVE për ta ruajtur LIRINË e pavarësinë e tyre… Bisedimet në **MALTË** në mes të **Xhorxh Bushit dhe Mihail Gorbaçovit** (më 1989) ishin PAZARLLËQE në kurriz të popujve… Bisedime për Evropën, por në kurriz të saj… Nëse nuk merresh me çështje shoqërore, **atëherë je IDIOT**, fëmijë në pelena. Por më së shumti merresh me politikë, kur deklarohesh se je – APOLITIK?! E dihet se me FRIKËN e të nënshtruarve dhuna vetëm zmadhohet… B. Brehti thoshte:

KUSH NUK E NDAN SOT LUFTËN ME SHOKËT, NESËR DO TA NDAJË DISFATËN ME ARMIKUN …

Ata që rrinë asnjanës, ata e ndihmojnë armikun (Shih:B. BREHT – NËNA KURAJË), dhe Nëna Kurajë e

rrëmben pushkën kundër fashistëve vetëm në çastin kur i VRITET DJALI, dhe kështu BORGJEZI I VOGËL, një herë e simpatizon borgjezinë e madhe, ia kënda të mirat e saj, arritjet, shkëlqimin e rrejshëm, dhe nga ana tjetër e simpatizon edhe popullin, dhe kështu ai **një herë është BORGJEZ, e një herë është – POPULL**, dhe është krenar për PAANËSINË E TIJ, në vend që të **TURPËROHET** për indiferencën e tij … E dihet se bashkëpunimi i kriminelit me kriminelë mundësoi ardhjen në pushtet të NAZIFASHIZMIT…

ꕥ

KANUNI I MALEVE ishte mekanizëm vetëmbrojtës i shqiptarëve, traditë juridike gojore, e përcjellë brez pas brezi që nga mesjeta e vonshme. Studiuesi i njohur kroat, **Millan Shuflai**, e përcolli me vëmendje këtë jetë fisnore, ndërsa **Shtjefën Gjeçovi** mund ta ketë marrë idenë nga Shuflai, dhe e bëri redaktimin, renditjen e paragrafëve të KANUNIT sipas rrëfimeve të çdo plaku të urtë, por autorësia i mbetet Gjeçovit si redaktor, stilizues dhe mbarështues i secilit paragraf… Gjeçovi kishte studiuar të drejtën romake dhe frënge… E drejta zakonore te japonezët, me institucionin e gejsheve, për 7-8 shekuj me radhë, dhe këtë e kanë përfshirë edhe në kushtetutën e vitit 1946 (Gejshet nuk identifikohen me prostitutat, por as me gratë e zakonshme, te romakët dhe grekët, si HETERA, dhe ato ishin shumë të ngritura, dhe u mëshonin disa instrumenteve muzikorë, vallëzonin, dhe kishin aftësi si balerinat e sotshme, me një trup vital dhe të shkathët, atlete të vërteta.

ꕥ

Në rrethana tipike, në rrethana të caktuara, **nuk ka më tigër se NJERIU?!** Merre me mend, kur po vdes baba-shehu, Kosovatransi po organizon bartjen falas të

pjesëmarrësve në varrim, dhe kështu aty për aty i ndihmojmë Millosheviqit… Dhe çka i bën njeriu vetvetes nuk mund t'ia bëjë tërë bota. FISET e kanë shpëtuar këtë popull, se **gjakmarrja** nuk është gjithmonë vetëm **NEGATIVE.** Sepse përndryshe pushtuesit e ndryshëm do të na kishin shfarosur si pulat… Dhe vrasësi, krimineli, edhe pse i vuan 12 vjet burg, sërish përton të dalë nga burgu, ku ai e ka jetën e sigurt, ndërsa jashtë burgut sërish i kërcënohet rreziku i hakmarrjes për veprën e krimit që ka bërë… Dhe gjithë kjo ENERGJI kombëtare po harxhohet kundër vetvetes, po shterohet brenda QARKUT të mbyllur, dhe hë për hë nuk po kanë nge për t'u marrë me çështjen jetike të STATUSIT KOMBËTAR. Pra **KANUNIN** nuk duhet ta flakim, por duhet ta sitim, ta filtrojmë, ta qërojmë, dhe gjërat e mira t'ia marrim dhe t'mos i idealizojmë. E dihet se kanuni është pjellë e rendit fisnor mesjetar…

ꕥ

Para epokës së re, Apollonia afër Vlorës, Shkodra, Durrësi, ishin qendra të forta tregtare e kulturore, ndërsa Zagrebi nuk i kishte atëherë as 700 banorë… Ne e kemi përjetuar trefish prapambetjen meqë ishim në kufirin ndarës mes Perandorisë së Lindjes (Bizantit) dhe Perandorisë së Perëndimit (Romake)… Dhe Epoka e ndritshme e SKËNDERBEUT me merita të jashtëzakonshme na i dha **atributet e shtetit…** Strategu gjenial **Skënderbeu** luftonte në rrethana të jashtëzakonshme – herë në front e herë në prapavijë… **Bujku e linte parmendën në arë dhe e rrokte shpatën dhe u bashkohej radhëve të vullnetarëve të lirisë në krye me Skënderbeun**, dhe kështu ia futën tmerrin tërë një superfuqie kolosale siç ishte Turqia… Por Skënderbeut nuk po i ndihmonte as Jugu, as Veriu, por vetëm **Shqipëria e Mesme**, Dibra, Kruja, Mati etj. Lezha ishte **PROTEKTORAT** i Venedikut, po ashtu edhe Korfuzi… Dukagjinët ishin **vasalë** të Venedikut… Suksesin e

Skënderbeut duhet shpjeguar nga aspekti ekonomik, sepse deri në atë kohë bujqit ishin gjysmë-skllevër. Bujku mund të shitej bashkë me tokën, ndërsa në feudalizmin oriental bujku ishte i lirë, kishte të drejtë ta ndërrojë feudalin. Dhe vetëm falë këtij sistemi më të përparuar Perandoria osmane u bë e madhe, u bë superfuqi në tri kontinente: Azi, Afrikë dhe Evropë… Dhe ky fakt bëri që tërë fshatarësia iu bashkua Skënderbeut… Perandoria osmane ishte superfuqi si Amerika, ndërsa tërë pushteti i Skënderbeut ishte i tëri në luftë, si VIETNAMI, dhe ushtarët e Skënderbeut ishin vigjilentë, ditën dhe natën, dhe rrobat dhe armët i mbanin nën krye… Bujku ditën punonte në arë, e natën sulmonte njësitë e armikut. Skënderbeu ua hoqi **statusin e gjysmë-skllavërisë bujqve**, i liroi nga despotizmi i skllavërisë, i cili deri më 1868 sundonte edhe në Rusi, ku bujqit shiteshin bashkë me tokën **(Shih: V. GOGOL: SHPIRTRAT E VDEKUR).**

ꕥ

Akademia e Shkencave të Serbisë u bë shërbëtore e politikës serbe… Bile edhe akademik Pavle Saviqi pas dy muajsh u dorëzua dhe iu bashkua programit të **MEMORANDUMIT,** edhe pse ishte asistent i Institutit Atomistik "Maria Kyri" në Sorbonë, në Paris.

Azem Vllasi u demaskua pas vitit 1981, pësoi bumerang (vegël e aborigjenëve australianë e cila t'i thyen hundët po nuk dite ta përdorësh). Vllasit nuk i kthehet kurrë më reputacioni, që nga dita kur ia hëngri kokën Mahmut Bakallit, dhe kur humbi besimin. Populli nuk i beson më kurrë atij…

ꕥ

HERAKLITI thoshte: **Të pagjumët, të zgjuarit, janë bashkë në botë**, ndërsa të FJETURIT janë veç e veç…

ꕥ

Profesor, kemi lexuar librin e Zh. Zh. Rusoit: EMILI OSE MBI EDUKATËN, pastaj librin e Makarenkos: EDUKIMI MBI PRINDËRIT etj., dhe na intereson të dimë se ku qëndron sekreti i zotësisë së pedagogut në artin e EDUKIMIT, kur e dimë se edhe ju keni bërë shumë në edukimin dhe arsimimin e nxënësve serbë, malazezë, kroatë, boshnjakë, shqiptarë etj. që nga Gadimja e deri në Ogulin (Kroaci) e Prizren?

Shkathtësia e vërtetë e edukimit mund të shihet në bazë të asaj se sa jemi ne të zotë që fëmijës t'ia ofrojmë gjerat të cilat ai mund t'i kuptojë, dhe sa mund t'ia fshehim gjerat të cilat ai nuk mund t'i kuptojë… dhe pikërisht këtu shihet më së miri aftësia ose mos-aftësia e mësuesve dhe prindërve për t'i edukuar fëmijët drejt… Por, a jemi duke i edukuar fëmijët drejt? Pikësëpari **keq-shfrytëzimi i kohës** është dëmi më i madh që ia shkaktojmë fëmijës, bile dëm më i madh sesa mosshfrytëzimi i saj, sepse fëmija i MËSUAR KEQ është shumë më larg dijes dhe mençurisë, sesa fëmija i cili nuk ka mësuar asnjë MËSIM. Minimumi që mund të bëjë secili prind është nëse e ka mësuar fëmijën se si të GËZOHET, si të luajë me shokë, si të argëtohet dhe të jetë i lumtur, sepse FËMIJËRIA është kohë në të cilën mendja është në GJUMË. Kurrë nuk duhet harruar se **nuk ka edukim më të mbrapshtë se sa kur fjalët nuk përputhen me veprat,** prandaj një gjë që e kemi thënë para fëmijës, atë gjë duhet domosdo edhe ta bëjmë… LUFTA më e madhe e secilit prind është: t'ia mbjell fëmijës **VULLNETIN**, dëshirën për **MËSIM**, dhe në çastin kur fëmijës ia kemi zgjuar interesimin për mësim, dhe për dobinë që na sjell mësimi, ne mund të jemi të sigurt në suksesin e fëmijës… MËSUESI I KEQ (por edhe nëna e babai i keq), e të tillë kemi me bollëk, jo vetëm që nuk dinë ta nxisin fëmijën ta dojë mësimin, shkencën, dijen, por përkundrazi, ata me veprimet e tyre të pakontrolluara e **detyrojnë fëmijën të FRIGOHET nga**

MËSIMI, nga dija, nga LIBRI, bile edhe t'i urrejë ato, dhe për shkak të kësaj indiference në moshë të vogël fëmija mban qëndrim refuzues ndaj LIBRIT (kësaj arme të dijes) edhe kur të rritet… Nëna e mbrapshtë e bën budalla fëmijën me fjalët: mos e bëj këtë, mos e bëj atë, bëj kështu, dhe kështu e pengon fëmijën të veprojë me kokën e tij, sikur ai të ishte pa kokë, thjeshtë një robot, një kukull. Me një edukim të tillë arrijmë që fëmija të **bëhet i DËGJUESHËM, por jo edhe i arsyeshëm…** Prandaj tek fëmija edhe forcat trupore, edhe ato psikike duhet të zhvillohen paralelisht, përndryshe fëmija kurrë nuk do ta shohë vlerën e mendjes së vet, por do të jetë vetëm një **zbatues i URDHËRAVE të mendjeve të te tjerëve**, në vend që të veprojë sipas mendjes së vet… Ne nuk do të arrijmë të rritim njerëz të mençur e të shkathët nëse ata nuk i lejojmë të rriten të rrethuar nga egërsia natyrore (kujtojeni këtu edukimin e fëmijëve të nënave spartane, edukatën në SHTETIN E SPARTËS, kur secili pjesëtar i atij shteti ishte njëherësh edhe ushtar i atij shteti luftarak). **Kushti i parë për të qenë MËSUES është për të qenë NXËNËS**. Fëmija më shpejt e lexon shpirtin e mësuesit, nënës, babait, sesa mësuesi, nëna ose babai zemrën e fëmijës. Pa dijen e tij fëmija juaj tërësish është në dorën tuaj, dhe vepron ashtu siç ia do zemra atij, por ai duhet të GUXOJË të dojë vetëm atë që përputhet me vullnetin TUAJ, dhe ai nuk duhet të bëjë asnjë hap që ju t'mos e dini, dhe para se ai ta hapë gojën, ju duhet ta dini se çfarë është duke dashur të thotë. **Dhe këtu është sekreti i artit të edukimit: kur fëmija e thotë atë që duhet thënë, dhe e bën atë që duhet bërë!** Ai para jush do të tregohet i tëri, dhe as nuk do t'ju mashtrojë, as nuk do t'ju gënjejë… Fëmijët tekanjozë janë produkt i edukimit të mbrapshtë: **ose bëhen tiranë, ose bëhen skllevër**, në vend që të bëhen të **LIRË**… Pra nuk duhet të edukojmë vartës, skllevër, dëgjues robotë, të nënshtruar, por as me moral shtypës, despotik e tiran. Ndërtimi dhe përbërja cilësore trupore, trupi i shëndoshë, i bën operacionet e shpirtit më të lehta, dhe më të sigurta…. **MËSUESI I MIRË merret vetëm me mjetet me të cilat ARRIHET DIJA… Shqisat tona** ne

duhet t'i KULTIVOJMË çdo ditë, dhe t'mos i lëmë pas dore, sepse kur i edukojmë ato, ne do mësohemi **të ndjejmë drejt, të ngacmohemi drejt dhe të GJYKOJMË drejt.** Shkaku për frikën tonë i ka rrënjët në TERRIN E PADITURISË SONË, i cili nuk na ndihmon t'i njohim gjerat në dritën e realitetit objektiv, sepse edhe lëvizja më e vogël e zgjon kureshtjen tonë, se mos ndoshta është duke na u kërcënuar ndonjë RREZIK, dhe kështu del se ne po frikohemi nga një parashikim imagjinar, JOREAL, sepse e shohim atë që nuk e shohim, duke i dhënë liri imagjinatës, dhe nuk e zotërojmë vetveten… Vetëm kur e zbulojmë shkakun e sëmundjes, vetëm atëherë ne do të arrijmë deri te ilaçi… Personin i cili frikohet **nga TERRI** mund ta shërojmë nga kjo frikë, vetëm kur e dërgojmë vazhdimisht në TERR. Dhe zakonisht ata të cilët ecin natën kurrë nuk kanë frikë nga terri, as ata që punojnë në kulme nuk kanë frikë nga lartësitë… **EDUKIMI MË I KEQ** është atëherë kur fëmijën e lejojmë të luhatet ndërmjet vullnetit tuaj dhe vullnetit të tij, dhe aty fillon lufta në mes jush dhe fëmijës, se cili prej jush do bëhet – **SUNDIMTAR**! FËMIJËN e kemi liruar nga VESET nëse deri në moshën 12-vjeçare nuk ia kemi vënë **ZGJEDHËN E SKLLAVËRISË**, të cilën nuk ia ka vënë natyra… Gabimet e prindërve mund t'i përmbledhim në tri lloje:

1. **kur fëmijëve u ofrojmë dashuri të tepruar;**
2. **kur fëmijëve u ofrojmë dashuri të pamjaftueshme dhe**
3. **kur fëmijëve u ofrojmë dashuri të gabuar...**

Por në fund të fundit vetë shoqëria, vetë rendi shoqëror i bën njerëzit të mirë ose të dobët, të lirë ose skllevër, shtypës ose të shtypur, grabitës ose të grabitur… **Dhe njeriu është i LIRË vetëm kur i mëson mirë të vërtetat** – bëhet zot i vetvetes, dhe jeton i lirë në mes njerëzve të lirë…

Pedagogu i madh **Makarenko** në librin: EDUKIMI MBI PRINDËRIT, thotë: **SA MË SHUMË RESPEKT DHE SA MË SHUMË KËRKESA MDAJ FËMIJËVE...** Dhe këtu qëndron tërë shkathtësia e artit të edukimit, dhe çdo edukim veç e veç, edukim individual, do të ketë mangësitë e veta, por edukimi kolektiv, edukimi me punë, **është i pazëvendësueshëm**.

ꕥ

Të kujtojmë GUXIMIN e rektorit të Universitetit të Bilbaos (Spanjë) më 1936, **Miguel De Unamuno** (me prejardhje baske), gjatë kohës së fashizmit, i cili gjeneralit fashist M. Astray (i cili iu kishte kërcënuar atij me fjalët: **RROFTË VDEKJA**), iu drejtua me mospërfillje me këto fjalë:

„Ju ndoshta edhe do të ngadhënjeni, sepse në anën tuaj e keni dhunën dhe brutalitetin, por askënd nuk do ta bindni! Për këtë ju duhet ta keni atë që ju mungon – **ARSYEN DHE TË VËRTETËN!**"

Fashistët u gozhduan para këtij akti heroik të UNAMUNOS dhe nuk guxuan ta burgosin, sepse ishin të vetëdijshëm se burgosja e një njeriu aq të madh do t'u sillte më shumë dëm sesa dobi…

ꕥ

DIOGJENI (shekulli i IV para epokës së re) u vu në kërkim të njeriut të ndershëm, dhe në pikën e ditës udhëtonte me një llambë nga vendi në vend dhe kur e pyesnin se ç'po kërkonte, filozofi u përgjigjej kalimtarëve me këto fjalë: – **PO KËRKOJ NJERIUN E VËRTETË.**

SOKRATI e piu kupën e helmit, sepse nuk deshi të gënjente, meqë gjykatësit mendonin se e VËRTETA E TIJ DO T'I SHTHURTE TË RINJTË E ATHINËS PËR TË QENË TË PABINDUR NDAJ SKLLAVOPRONARËVE! Për këtë e dënuan me vdekje, sepse kërkonte ndryshimin e mënyrës së qeverisjes, duke i akuzuar pushtetarët për korrupsion, për vjedhje dhe krime tjera… Por askush nuk i mban mend emrat e gjykatësve që dënuan Sokratin me vdekje, ndërsa **emri i madh i Sokratit** mbeti i skalitur në kujtesën e brezave të tërë. Edhe në atë kohë fjala DEMOKRACI ishte FASADË, sepse prapa saj gjallonte korrupsioni, përfitimi material, krimi… Në luftën për të

mbajtur apo fituar pushtetin përdoren të gjitha mjetet e mundshme…

Robespjeri përdori edhe gijotinën kundër korrupsionit, por më në fund u mund nga vetë korrupsioni dhe njerëzit e korruptuar. Pas Robespjerit erdhën në pushtet aventurierët, vjedhësit, spekulantët, gjeneralët me para me thasë, pra erdhi ora e epokës së korrupsionit… **KOMUNA E PARISIT** më 1870, për 72 ditë provoi organizimin komunist të shoqërisë, por meqë **reaksioni ndërkombëtar ishte bërë një me reaksionin e borgjezisë franceze**, kërkesat e proletarëve të Parisit u shtypën me gjak, **kodra e Monmartrit dhe varrezat e dëshmorëve në Per Lashezë janë dëshmi e gjallë**… Në këtë luftë dhe mospajtim shekullor në mes të shtresës filistine dhe materialiste me shtresën e njerëzve revolucionarë **IDEALISTË**, këta të fundit përherë kanë qenë në pakicë, por ishin promotori, ishin katalizatori i kthesave të mëdha historike, ishin gjeneratori dritëdhënës i shkëndijave paralajmëruese të një **bote të re që po lind mbi gërmadhat e një bote të vjetër, botës që po jep shpirt...**

ꕥ

LIGJËRIME, 20 shkurt 1991:

Përmes "ZËRIT TË AMERIKËS" Akademik Rexhep Qosja po i lutej Ramiz Alisë që të përshpejtojë proceset DEMOKRATIKE pluraliste, dmth. të rrëzohet komunizmi si kusht për ta fituar Kosova statusin e Republikës në kuadër të Jugosllavisë. Në atë intervistë Akademik Qosja tha edhe këtë:

Enver Hoxha dy herë u varros, dy herë vdiq, dhe tani kur Shqipëria u shkërmoq, **socializmi mori fund**, por Kosovës askush nuk po ia jep statusin e Republikës. Dhe cilës Republikë, **në kuadër të Federatës jugosllave?! Por tani Qosja nuk po e hap gojën**!...

ꕥ

LIGJËRIME, 20 nëntor 1991:

Lufta e klasave është shumë domethënëse , sepse hendeku i kontradiktave në vendet borgjezo-kapitaliste sa vjen e thellohet çdo ditë e më shumë. Dhe si mund të durohet pabarazia sociale në atë ven ku dikush edhe **lulet i ujit me lëng mishi, e dikush tjetër nuk ka as një kothere buke në sofër.**

Ngjarjet në Maqedoni në vitin 1968 treguan se qëndrimi ndaj shqiptarëve është raporti konfederativ e jo federativ, ashtu siç ndodhi pas luftës me ne shqiptarët që u likuiduan të gjithë. Në Maqedoni jeton një popull që kontestohet nga shumë popuj: Serbia ua konteston kishën autoqefale, Greqia ua konteston emrin, Bullgaria ua konteston përkatësinë kombëtare, dhe i quan bullgarë, ndërsa ne shqiptarët ua kontestojmë territorin e okupuar...

ꕥ

Fjala **KOMB-NACION**, lat.nacion së pari u përdor në Francë për shtresën aristokrate-sunduese, e në kuptimin e sotëm të parët e përdoren Jakobinët më 1794. Pas rënies së komunitetit primitiv, me lindjen e pronës private,të klasave e të shtetit, si rezultat i zhvillimit ekonomik e politik, fiset e ndryshme bashkohen, asimilohen e shkrihen me njëri-tjetrin në bashkësi më të gjera me tipare të përbashkëta etnike, të quajtura POPULLSI. Popullsitë me kalimin e kohës formojnë **KOMBËSI**, që janë tipike për feudalizmin. Në periudhën e shembjes së feudalizmit dhe zhvillimit të kapitalizmit, kombësitë shndërrohen në KOMBE. **KOMBI** është një bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht, që ka **lindur në bazë të bashkësisë së gjuhës , të territorit, të jetës ekonomike dhe të formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës...**Baza ekonomike e kombit borgjez është prona private, ndërsa baza ekonomike e kombit socialist është

prona e përbashkët socialiste mbi mjetet e prodhimit, në krye të te cilit qëndron klasa punëtore që ka vendosur diktaturën e proletariatit, e udhëhequr nga pararoja revolucionare...

PIRENEJE-në gjuhën baske;
Bretanja-në gjuhën galeze-kelte;
Alzas-Loren-gjermanisht, në gjuhën alzasë
Rrethina e Parisit-gjuhë frenge-zyrtare;
Frankët-emër gjerman, gjaku galez dhe gjuha-romane-latine.

ꕥ

Kur njeriu e kafshon qenin, sepse është tërbuar, qohen në këmbë tërë qyteti...

Ramiz Alinë e priten në OKB jo si zhugan, por me duartrokitje, sepse ishte 40 vjet në instancat më të larta të shtetit shqiptar. Ai kurrë nuk do ishte trashëgimtar i Enver Hoxhës po të mos kishte qenë ideolog autentik, i cili nuk ka bërë asgjë krye në veti pa u konsultua me Enver Hoxhën, dhe po të mos kishte veprua kështu edhe ai do ta pësonte siç e pësoi **Beqir Balluku** me plumb në ballë më 1974. Ramiz Alia ishte i vetmi që pat sukses edhe me qenë konformist edhe mos me u komprometua te populli. Për analogji të kujtojmë rastin e Hrushqovit, i cili pas vdekjes së Stalinit u komprometua zyrtarisht, dhe në varrimin e tij nuk morën pjesë as 50 vetë?! Por të mos harrojmë se për çdo gjë që do t'i ndodh secilit njeri më së paku 50% faji i takon vetvetes. Që nga 1947 Ramiz Alia ishte udhëheqës i rinisë, e zëvendësoi Alikidiad Kondin. **Dhe të shohim se si do rrjedhin gjerat pas sotit, dhe sa do qëndrojnë komunistët shqiptarë deri në fund përballë sfidave të kohës...**

Profesor, çfarë mund t'na thuash për Enver Hoxhën?
A mund ta krahasojmë me Skënderbeun?

Jo, nuk mund ta krahasojmë, sepse Skënderbeu e mbajti pushtetin në gjendje rrethimi kundër perandorisë më të madhe të kohës, perandorisë turke, dhe për 24 vjet i arriti 24 fitore të mëdha. Ai ishte kolosi i shekullit XV. Ndërkaq, **Enver Hoxha për 42 vjet bëri EPOKË**, në epokën e atomit, në epokën e raketave interkontinëntale, në epokën radarëve dhe të avionëve të teledirigjuar, pa pilot!!! Dhe përballë gjithë këtij arsenali armatimi dhe gjithë atyre bllokadave e rrethimit të egër imperialisto-revizionist në përballje të përditshme me dy superfuqitë botërore dhe të dalësh fitimtar duke luftuar një kundër të gjithëve, kjo është më shumë se heroizëm...**Por për ta dhënë vlerësimin më të drejtë për këtë legjendë të njerëzimit nevojitet edhe distanca kohë**, sepse se çfarë humbje patën popujt e Ballkanit dhe në radhë të parë populli shqiptar i Shqipërisë dhe Kosovës, na tregoi tatëpjeta dhe katastrofa e luftimeve të përgjakshme në Kroaci, Slloveni e **po pritet të shpërthejë lufta edhe në Bosnjë dhe Kosovë,** dhe vetëm kur të bëjmë bilancin e përgjithshëm do të shohim se çfarë roli **heroik paska luajtur Shqipëria e Enver Hoxhës në vitet e luftës së ftohtë**. Pra loja ka fillua dhe duhet distanca kohë për të parë **finalen** dhe rezultatin përfundimtar, sepse ne as që e kemi marrë me mend se Shqipëria do të degjenerojë ndonjëherë nga parimet e saj të shenjta të barazisë sociale...

Nëse e prekim me hundë ne s'mund ta shohim as lisin, e lere më ta shohim pyllin. Pra madhështia qëndron në faktin se **përmes rusëve Enver Hoxha i përzuri jugosllavët nga Shqipëria**, dhe pastaj **përmes vetvetes i përzuri edhe rusët që kishin instalua bazat më të forta në Mesdhe**, duke iu dhënë ULTIMATUM që të ikin brenda 24 orëve, dhe duke rrezikuar luftën botërore. Por rusët nuk patën hesap me shpërthye lufta...**Në fund, Enver Hoxha i përzuri edhe kinezët në çastin kur ata po bënin plane në bashkëpunim me Jugosllavinë dhe Rumaninë** , dhe u tregoi se Shqipëria nuk lejon askënd t'i bëhet zot në shtetin e saj...Por edhe për Kosovën Enver Hoxha ishte

dalzotësi më i devotshëm... Ai e dinte mirë se pavarësia paguhet me gjak e sakrifica, e jo me DOLLARË, kur dihet se ishte paraparë që më së largu **deri në vitin 1952 Parlamenti i Shqipërisë të bashkohet në Federatën JUGOSERBE,** dhe nga ai Parlament me shpëtua vetëm marioneta-tradhtari Koçi Xoxe?! Por Koçi Xoxe dhe gjithë tradhtarët pas tij e morën dënimin e merituar me plumb në gojë...

ꕥ

Kuvajti Me 20.000 km. katrorë nuk e ka asnjë burim, por e ka basenin e naftës edhe nën det... Greqia është mvarur nga Amerika, dhe kontrollohet nga Amerika...Edhe IZRAELI e bën atë që i thotë Amerika...sepse LLOBI çifut i ka multimiliarderat më të mëdhenj në botë...

Edhe Qiproja u nda me lejen e Amerikës, sepse edhe amerikanët kanë hesap ndonjë herë me i shti këlyshët e vetë me u grindë mes veti...

Kryetari i Partisë Komuniste(duhet-**FASHISTE**) të Serbisë, Sllobodan Millosheviqi, ka dalë më Sveti Savë se Sveti Sava?!

Hitleri i bashko të gjithë gjermanët, sepse për 700 vjet ata ishin veç e veç...

Kur të gjitha ngjyrat bashkohen, fitohet ngjyra e BARDH-antingjyra...

Neve shqiptarëve, sa i takon mozaikut religjoz po na mungon vetëm edhe verzioni **protestan** i krishtenizmit...

ꕥ

LIGJËRIME, 8 mars 1992

Jugosllavia është ambalazha, ndërsa Serbia është brendia e kësaj ambalazhe. Tani të gjithë e kuptuan se Jugosllavia ishte SERBI(deri më 1968). Bile thuhej se pjesa më serbe janë malazezët(Najsrpski dio naroda).

Maqedonia është konsiderua si një KANTON i veçantë, pa kurorë, me të drejtë shkurorëzimi, ndërsa kur është fjala për Kosovën Vuk Drashkoviqi po thotë se – edhe 1% me qenë serbë në Kosovë, ose asnjë serbë, sërish Kosova është Serbi, sepse është JERUZALEMI i Serbisë, është Qabeja, është vendi i shenjtë për Serbinë...Ai po thotë edhe këtë: **tapitë e Kosovës i mban Shën Sava në qiell**?! Para 700 vjetësh kisha orthodokse serbe u bë autoqefale, ideologji e sundimit mesjetar serb, dhe sipas kësaj ideologjie kishtare është formua edhe shteti Serb. Stefan Nemanja ishte një Zhupan, ndërsa i biri Dushani u bë mbret vazal, **mbret i serbëve, grekëve, bullgarëve dhe shqiptarëve** (Car rashana, grka, bugara i arbanasa), dhe tani po shihet se çfarë roli ka pasur kisha orthodokse serbe në formimin e shtetit. Dhe këtu nuk ka mëdyshje se a me u identifikua me armatën apo me kishën? Jo, me të dyja-me një dorë me u mbajt për UNGJILLIN e me tjetrën për SHPATËN(Forcën). Drejtësia ka nevojë për FORCË, por forca nuk ka nevojë për drejtësi, sipas logjikës së forcës...

ꕥ

Të gjithë anëtarët e Këshillit të Sigurimit të OKB-së kanë të drejtën e VETOS, që do të thotë se për çdo vendim duhet konsensusi unanim i të gjithëve. Të kujtojmë rastin e Irakut se si u veprua me të, kur i nxorën irakianët jashtë KUVAJTIT, për shkak të burimeve të NAFTËS, por në rastin e KURDËVE po veprohet krejt ndryshe. Në rastin e Irakut u dha një afat prej 5 muajsh, që nga 15 janari 1990, dhe nëse e humbi do e humbi këtë që fillova ta marrë-Kuvajtin, e jo Irakun..

Rasti i Jugosllavisë nuk është identik për faktin se është në Evropë, dhe zgjidhjen hë për hë po e shohin në formulën 2+2 Sllovenia plus kroacia dhe Serbia plus Mali i Zi, ndërsa Maqedonia është më e sigurt, e për BOSNJËN të shohim a po shpërthen i thati, sepse **armata jugosllave po tërhiqet nga Maqedonia dhe po shkon në Bosnjë** se

atje është më urgjente, sepse në zonën e Kumanovës dhe Karadakut minoriteti serb është simbolik, ndërsa në Bosnjë e Hercegovinë kemi rreth 33%...

Shqipëria na ka dhënë përherë përkrahje MORALE, e tani edhe kjo mbështetje po na mungon, sepse po bëhet luftë speciale, psikologjike, dhe po arrihet efekti negativ qoftë me vetëdije ose pa vetëdije. Dhe po thuhet- Ne nuk kemi PAVARËSI, por kemi STANDART, dhe kështu **shqiptarët e robëruar të Kosovës në vend që të aktivizojnë tërë potencialin material dhe njerëzor për çlirim, po mjaftohen me ëndrra se e kanë-LIRINË E STANDARTIT,** lirinë me ble një thes sheqer, standardi i veturës, mercedesit, ndërkaq në Shqipëri me e blerë një thes sheqer ke mundur, por për ta ngrënë ke mundur vetëm **në burgun e BURRELIT**. Në Shqipëri ka qenë punë e madhe me e pasur një biçikletë...sepse atje ishte sistemi i BARAZISË SOCIALE.

Jugosllavët janë sjellë me ne si me varrtarë potencialë, si kalë Troje, që përmes nesh ta pushtojnë edhe Shqipërinë, dhe me dalë në detin Adriatik... **Fadil Hoxha** propagandonte se vetëm një qytet në Kosovë ka më shumë teknikë të bardhë(shporet elektrik) se tërë Shqipëria, por më 1981 ai shkoi edhe më larg, pas gjithë atyre masakrave mizore, dhe duke u vënë në shërbim të kolonizatorëve jugosllavë ai **lulen e rinisë heroike të Kosovës** , e cila duarthatë ia kishte kthye gjokset tankeve dhe bajonetave të armatës jugosllave , e quajti paturpësisht - **"PLEHU I KOSOVËS"**

E dihet se ne jemi në një luftë të pabarabartë, me një shtet si Jugosllavia të cilin e kanë ndihmuar me tërë potencialin dy superfuqitë botërore, SHBA dhe BRSS. Por tani pas luftës në Slloveni dhe Kroaci Jugosllavia i shkërmoq, por ende po përpëlitet para vdekjes. Në Knin që nga mesjeta ishte kryevendi i Kroacisë...Në Kroaci para Luftës së Dytë Botërore kishte 15 % serbë e sot janë 10%...

Sa gjak kanë derdhur shqiptarët për interesat e huaja, duke mbrojtur Turqinë, duke marrë pjesë në çlirimin e Greqisë, dhe kështu shqiptarët derdhën gjakun rrëke si orthodoks për Greqinë dhe si myslimanë për perandorinë turke?!

Partitë janë TAKTIKË, janë të regjistruara te Ministri i Drejtësisë në Beograd, dhe në programet e tyre e **pranojnë integritetin dhe sovranitetin e Jugosllavisë, dmth. e pranojnë OKUPIMIN jugosllavë?!** (Rexhep Qosja është ekstremist, ai nuk është për politikë?!)Tani kemi elemente të theksuara të një lufte të pashpallur, që është më e vështirë se sa kur shpërthen lufta, sepse tani po punohet me vlugun më të madh që RININË e Kosovës ta zbrazin sa më parë, duke e ndjekur **për t'u rekrutuar në Armatën Jugosllave**, dhe pastaj si mish për top të vriten në frontet e luftës në Kroaci e gjetiu...Kjo tragjedi jona po luhet në tri akte, siç thoshte Fan Noli:

1. Akti i parë-**Çpronësim;**
2. Akti i dytë-**Shpërngulje** dhe
3. Akti i tretë-**Shfarosje** e shqiptarëve, dhe mos të harrojmë se shteti okupues serb deri sot i ka hartua 24 programe për shfarosjen e shqiptarëve...

ꕥ

Vetëm TRIMI nuk i frikohet të MIRAVE, dhe është i gatshëm ta paguaj çmimin e këtyre të mirave, çmimin maksimal-me jetë, dhe çmimin minimal me të holla, me para , me mall, sepse Atdheu është në RREZIK. Por nuk duhet harrua se me para paguhet avokati, por kurrë LIRIA. Ne kishim shumë diplomatë shqiptarë në shërbim të perandorisë turke si Vaso Pasha, Ismail Qemali etj. , por të cilët vetëm pak pa vdekur u kthyen kah kombi i tyre, sepse e panë se kanë punua në shërbim të te tjerëve...Edhe Sveti Sava kah fundi i jetës u bë i shenjtë, sepse nuk e rrokte gjumi prej gjithë atyre të zezave që kishte bërë më parë, dhe u fut në shpellë dhe filloi të shkruaj dhe t'i formulojë

themelet teorike të shtetit serb, për të depërtua në Bosnjë, me i pushtua sepse ishin BOGUMIL...Por të mos harrojmë se edhe populli serb e ka pagua dhe ende po e paguan KAMATËN e mbrapshtirave të veta dhe të klikës udhëheqëse si asnjë popull tjetër gjatë Luftërave Ballkanike, LDB, dhe sot në Kroaci e Slloveni, e nesër në Bosnjë e Hercegovinë...

Por neve nëse presim që të MIRAT me na ardhur të gatshme, atëherë kalojmë **në IMORALITET**...Pra për çdo fatkeqësi që na ka ndodhur dhe ende do na ndodh **më së paku 50% ne e kemi FAJIN**, dhe duhet me e pagua çmimin e paditurisë, çmimin e vonesës për të kuptuar se cilin e kishim mik e cilin armik, ndërsa këto që po i paguajmë sot-**janë vetëm KAMATA**!!! Kush na ka faj pse edhe ne nuk e kemi formua një organizatë gjithshqiptare shumëshekullore për t'na BASHKUA?

Shqipëria e kishte shtetin përnjëmend, shtetin SUBJEKT, **me bukë e lëng, por me subjektivitet...Ne në Kosovë jemi deklarua për shtetin KARIKATURË,** shtetin për mahi, Shtetin e Kaçanikut... Ne kemi shumë kuadro, por i kemi në sasi, por jo në cilësi...dmth. kemi në disproporcion kualitetin dhe kuantitetin e kuadrove (Cilësinë dhe Sasinë). **Gurakuqi** e pagoi me plumb cilësinë dhe aftësinë e tij prej intelektuali liridashës, ndërsa **Fan Noli** mori dënimin me vdekje, por arriti për pak të arratiset në Evropë...

Të marrim shembull nga NËNA SPARTANE, e cila kur e niste të birin në luftë ia ngjishte armët, dhe MBUROJËN duke i uruar FITOREN me këto fjalë emblematike:

OSE ME TË, OSE MBI TË! E kjo do të thoshte-Nëse kthehesh i gjallë, duhet të kthehesh me FITORE dhe me mburojë në dorë, por nëse ke fatin me ra në fushën e nderit, atëherë edhe më mirë, shokët do të te kthejnë mbi mburojë, **me lavdi**!

Populli ende është në gjumë hipnotik, ende **nuk po bën ballë me e kap pushkën!** Ne vetëm po e mashtrojmë

vetveten duke ia lënë Fajet tjetrit! Ne kemi qenë të përçarë dje dhe ende jemi të përçarë edhe sot. Ne nuk kemi qenë në nivel të detyrave historike , sepse kemi lejua të formohet shteti shqiptar më së voni në Evropë, dhe çfarë shteti, me mbi 50% të trojeve të mbetura nën okupimin e serbëve, malazezëve, maqedonëve dhe grekëve...Ne nuk e kemi bërë aktin final për ta marrë atë që na takonte historikisht...

SENEKA thoshte-shyqyr që më ka ra sëmundja e ta provoj shëndetin...**Edhe këto vrasje që po na ndodhin çdo ditë janë si katalizator, përshpejtësues i procesit të vetëdijesimit të popullit, këto janë ÇMIMI, janë-PAGESA për me na zgjua sa më parë nga gjumi, sepse po na pret shfarosja kolektive...**

Për me GATUA nuk mjafton vetëm sasia e miellit, por duhen edhe shumë gjera tjera, sepse mielli miell mbetet nëse nuk e NGJESHIM deri sa nuk na dalin djersët, por merrni me mend sa duhet të ngjeshët **"BUKA E LIRISË!"**

ꕥ

Edhe në socializëm, edhe në komunizëm DREJTËSIA nuk realizohet pa mekanizmin e aparatit të DHUNËS, **dhunës revolucionare...**Duhet që çdo ditë e çdo orë të punojmë dhe të përgatitemi për ditën e madhe, ditën e shenjtë të shpërthimit të Kryngritjes popullore, dhe lëkurën ta shesim me çmim sa më të shtrenjtë!

Këshilli i sigurimit, pesësh-i bëjnë çka kanë hesap, ta ndihmojnë Millosheviqin me e vazhdua luftën, ashtu siç janë marrë vesh në Maltë BUSH-GORBAÇOV më 1989!?

Këtu te ne OKB-ja do vijë kur të fillojë të shkojë gjaku rrëke, si lumë... Në Bosnjë veç sa nuk ka krisë...Në Bosnjë janë tri forca ndërluftuese-boshnjakët, serbët dhe kroatët...Lufta po ndërlikohet çdo ditë Rrëzimi i helikopterit të NATO-s me ekuipazhin prej pesë vetash po e vërteton faktin se ka mundësi që flakët e luftës ta përfshijë edhe Evropën.

Këshilli i Sigurimit: **SHBA, RUSIA, ANGLIA, FRANCA dhe KINA** kanë të drejtën e vetos...Gjermania dhe Japonia që 50 vjet po forcohen. Gjermania sot është më e fortë se në kohën e Hitlerit, por sa vlen se është e OKUPUAR(aty ende i kemi bazat amerikane!?)Amerika e ka Gjermaninë rivalin më të fortë në Evropë, ndërsa në Azi e ka Japoninë...

Vuk Drashkoviçi këto ditë po thotë se 200.000 të rinj të Serbisë kanë ikur jashtë shtetit...

ꕥ

LIGJËRIME, 16 qershor 1992:

Tani është hapur fronti i përçarjes ideologjike… Duhet përpjekur që të jemi sa më realistë… Sot meritat e Dalaj Lamës, Havelit, Tjen An Menit, po i krahasojnë me **"mic-sokolat" e Salih Berishës e Ibrahim Rugovës**?!

Amerika e sotme nuk është Amerika e indianëve, sepse 2/3 janë me gjak autokton, 1/3 me gjak Evropian – spanjoll (Meksika – 85 milionë), Peruja – 2/3 autoktonë; Bolivia – 85% autoktonë (rreth 5 milionë banorë)… Në Peru kemi lëvizjen revolucionare që 18 vjet, por edhe në Bolivi e kemi një lëvizje të tillë…

Pozita jonë strategjike është me shumë rëndësi… Qëllimi: ta mbajnë Rusinë sa më larg nga Mesdheu, në vijën Selanik – Serbi – Rumani…

ꕥ

VATIKANI është superfuqi ideologjike, por me tjera modalitete, **përndryshe te ne do të ndodhte gjakderdhja para Bosnjës...**

Dobrica Qosiqi u bë kryetar i Serbisë, dhe kjo është KOMEDI, sepse serbët i kanë punët shumë ngushtë, por edhe ne i kemi shumë ngushtë…

Edhe roja, gardiani, që ruan te porta e qelisë së burgut, është i burgosur, sepse Marksi kishte të drejtë kur thoshte se:

NJË POPULL QË ROBËRON POPULLIN TJETËR EDHE VETË ËSHTË DYFISH I ROBËRUAR (Shih:K. MARKS – MBI ÇËSHTJEN IRLANDEZE). Në Irlandë që nga shekulli XIV-XX, për gjashtë shekuj në vazhdimësi zgjati lufta guerile (Konflikti më i gjatë në Evropë)… Ndërsa F. ENGELSI thoshte se – **AJO KLASË PUNËTORE e cila shkon pas qerres së aristokracisë, kurrë nuk do të çlirohet...** Më 1918 Irlanda e shpalli pavarësinë, përveç ALSTERIT, dhe atje për 6-7 shekuj vazhdoi indoktrinimi kishtar… Edhe Kisha Orthodokse serbe e instrumentalizoi Millosheviqin, si në teatrin e KUKULLAVE, sepse ai u bë marionetë e kishës, ushtrisë dhe Akademisë serbe të shkencave …

V. I. LENINI thoshte: **Ajo klasë punëtore e cila nuk armatoset dhe s'përgatitet për LUFTË, ajo nuk e meriton ÇLIRIMIN...** dhe një teori e tillë e mos-armatosjes, e mos-rezistencës dhe mos-përgatitjes për ÇLIRIM është **TRADHËTI**. E dihet se kur një vend është i kolonizuar, lufta për ÇLIRIM, kryengritja mbarëpopullore, është një gjë e **SHENJTË... Sot kemi skllavëri moderne**, dhe skllevërit e sotëm e pranojnë me dëshirë skllavërinë. Dhe aq më keq, sepse edhe e lavdërojnë, meqë në ndërgjegjen e tyre gjallon mentaliteti i ROBIT… Sot kundërthëniet janë të hapura, sepse në pushtet kanë ardhur ata të cilët e mbajnë FLAMURIN ANTIKOMBËTAR… Më 1968, me pushtimin e Çekosllovakisë, BRSS-ja shpalli sovranitetin e KUFIZUAR, d.m.th. KOLONIALIZËM i llojit specifik… Dhe lirisht mund të themi se i vetmi vend i cili e gëzonte sovranitetin e PAKUFIZUAR ishte SHQIPËRIA SOCIALISTE. Për 45 vjet Shqipëria u bëri ballë dy palë shtypjeve – nga brenda dhe nga jashtë, dhe ishte superfuqi. Por edhe në Shqipëri **kapitulloi roli hegjemon i klasës punëtore dhe fshatarësisë**, sepse në praktikë nuk u zbatua me konsekuencë parimi komunist i ndarjes – SECILIT SIPAS REZULTATEVE TË PUNËS, dhe pas vitit 1972 u burokratizuan shtresat e privilegjuara duke marrë pa meritë librezat e Partisë së Punës të Shqipërisë, dhe **klasa punëtore gradualisht e humbi besimin në avangardën komuniste,** e

cila filloi të korruptohet. Dhe kjo u pa më së miri pas vitit 1991, kur **PARTIA E PUNËS SË SHQIPËRISË u RESTAURUA në PARTI SOCIALISTE**, dhe u pa se cilët kishin qenë **OPORTUNISTËT** me librezat e kuqe të partisë, dhe cilët idealistët revolucionarë, heronjtë e punës socialiste. Por, detyrë mbi detyra në këto çaste kritike është – PAJTIMI KOMBËTAR! Dihet se kanceri zhvillohet kur në qelizat e gjakut futen viruset kancerogjenë dhe qeliza mëmë ato viruse i pranon si MIQ, deri në çastin kur ata arrijnë **numrin 299**, dhe pastaj i shpallin luftë organizmit me devizën – Ja vdekje, ja fitore, dhe kështu organizmi kapitullon për shkak të dobësive të vetvetes. Pra **revolucioni duhet të fitohet çdo ditë**, duhet të mbrohet dhe ripërtërihet përherë, sepse përndryshe rikthehet, restaurohet e vjetra, reaksionarja. Nuk thuhet kot se **njëmijë herë është më vështirë ta ruash fitoren e revolucionit sesa ta arrish...**

ꕥ

Hasan Prishtina ishte një demokrat borgjez, me merita të jashtëzakonshme patriotike… dhe kur erdhi katastrofa, Kominterna e quajti revolucionare Lëvizjen Kaçake të Azem e Shotë Galicës, më 1924, ndërsa Luftën heroike të Kryengritjes së Drenicës në krye me Shaban Palluzhën më 1945 e quajti – KUNDËRREVOLUCIONARE?!

ꕥ

Është paradoksale kur agjencitë kosovare – vasale të pushtuesit, çdo ditë bëjnë marrëveshje me armikun dhe bëjnë zbrazjen e Kosovës nga pjesa më vitale e saj, rinia, dhe kështu në kohën kur Kosovës i duhet më së shumti FORCA VITALE E RINISË për të hapur frontin e luftës çlirimtare, ata të rinj dezertojnë dhe strehohen nëpër vendet e ndryshme të botës duke kërkuar azil…

Bllokada të cilën ia bëri Evropa Serbisë **për ne është dyfish bllokadë**, është okupim, por ne nuk bën të kthehemi prapa, pa marrë parasysh vështirësitë… Është mirë që e kemi një armik të tillë barbar, ujk, i cili çdo ditë na mëson leksionin e vetëmbrojtjes se si duhet të jemi vigjilentë, t'mos na zërë gjumi, dhe t'mos degjenerohemi… Ndërkaq në Serbi brenda 10 vitesh (1979-1989), për shkak të lindshmërisë së vogël **u mbyllën 141 shkolla fillore** … Evropa lejoi që të masakrohen civilë në Kroaci dhe Bosnjë. Populli ka rënë në amulli… Me thellimin e krizës ka gjasa që në Serbi të **shpërthejë lufta serbo-serbe**… Evropa dhe bota na do si të varfër, skllevër, që të jemi përherë të nënshtruar…

ꕥ

Kapitali më i madh në Shqipërinë socialiste ishte – **SHKOLLA,** intelektualët, inteligjencia popullore, pa taksa, pa borxhe, pa kriminalitet, pa korrupsion, pa papunësi, pa analfabetizëm, pa prostitucion dhe pa dekadencën perëndimore…

ꕥ

Populli shqiptar **është si diamanti**, i cili krijohet nga qymyri në kushte specifike, gjatë shekujve, nën presionin e madh dhe në thellësi të mëdha nëntokësore…

ꕥ

LIGJËRIME, 11 korrik 1992:

MAGJJA E LIRISË është aty ku luftojnë të gjithë për një dhe një për të gjithë... DIAMANTI, xhevahiri, krijohet në thellësi të mëdha, nga thëngjilli… **I. Rugova është MARIONETË, është kukull**… Fehmi Agani është në sipërfaqe, ndërsa M. Bakalli etj. janë nën rrogoz… Në Kosovë **nuk po sakrifikohen TITISTAT**, por **po sakrifikohen ish-të burgosurit politikë**, dhe këta 47

deputetë e ndaluan mbajtjen e Kuvendit, e dihet se votat i morën njerëzit e besueshëm, dhe vetëm një po të jetë i fortë, e dridh tërë Parlamentin…

PËR AUTONOMINË E VITIT 1974 DUHET T'I FALËNDEROHEMI ENVER HOXHËS, SEPSE SUPERFUQITË DONIN TA NEUTRALIZONIN SHQIPËRINË PËRMES KOSOVËS, PËR TA BËRË KOSOVËN MË ATRAKTIVE, MË TË LAKMUESHME, DUKE I RRITUR DIFERENCAT, **PËR T'U KRIJUAR ILUZIONI SE NË KOSOVË PO JETOHET NË MIRËQENIE, NDËRSA SHQIPËRIA PO VUAN NËN DIKTATURËN E PROLETARIATIT...**

ꕥ

LIGJËRIME,1 nëntor 1992:

VATIKANI është fuqia e dytë në botë pas, SHBA-ve, me 1000 banorë, i cili në shekullin e kaluar i kishte vetëm 12 shtëpi...

BRSS-ja është neutralizua, por nuk duhet të themi se ka cofë, ka mbarua, sepse ende i ka të pademontuara gjitha ato koka atomike...

Klasa punëtore laburiste në Angli e shohin realizimin e socializmit përmes REFORMAVE, e jo përmes revolucionit me armë...Kjo parti 6 muaj e mbajti pushtetin dhe e pranoi BRSS, por konservatorët kur erdhën në pushtet nuk e ç'vlerësuan njohjen e BRSS-së...

Në Shqipëri po ndërrohen ligjet, dhe gjithë superstruktura shtetërore e mëparshme, sepse Salih Berisha nuk është politikanë, dhe as burrë shteti... Edhe Voisllav Shesheli është në pushtet ,stërçetnik, por është kreten... **Salih Berisha u bë "pashë", por nuk është bërë njeri...**

ꕥ

Po mirë profesor, deri kur do shkojnë punët tona kështu?

Do shkojnë deri sa të vijmë ne në veti, sepse nuk duhet të harrojmë faktin se edhe para 80 vitesh për ne, për fatin tonë është marrë vendimi në Londër, jo në Shqipëri, sepse të tjerët po vendosin për fatin tonë, bile edhe tani **më 1992 ,në Londër shkuan tetë subjekte shqiptare, pra tetë zëra**, në vend që të ishte një zë, dhe zë i fortë, mbarëshqiptar, dhe ata e panë se ende nuk jemi askund, dhe na thanë se – NE NUK MUND TË DERDHIM GJAK PËR JUVE..., dhe kështu po na imponohet bashkëpunimi me Paniqin, respektivisht me Millosheviqin...**Amerika po na thotë - Na jepni mundësi që t'iu ndihmojmë, duke u marrë vesh me Paniqin...**Po pse ndodh kjo? Sepse neve ende nuk jemi bërë të fortë për t'u marrë vesh në mes vete...Ju e dini se 10 muaj ditë zgjati Lëvizja për pajtimin e gjaqeve dhe ngatërresave, **por a mund t'i shlyenim 10 shekuj për 10 muaj, dhe tani sërish po frynë era dhe po e çon në ajër hirin me të cilin ju e mbuluat –GACËN E VËLLAVRASJES , ato 1200 gjaqe e ngatërresa,** sepse gjaqet ende po vazhdojnë...Ndërsa Enver Hoxha me pushtetin popullor vetëm për tre muaj e mbylli këtë plagë shekullore me sanksione të rrepta shtetërore, sepse PRONËN PRIVATE e kolektivizoi, dhe tërë potenciali popullor, burra e gra iu veshën frontit të punës, dhe askujt më nuk i binte ndërmend për ngatërresa...

FAJI MË I MADH YNI ËSHTË MUNGESA E BASHKIMIT...

Ne po vuajmë edhe nga harresa kronike, sepse po harrojmë se po të mos ishte lufta Nacional-Çlirimtare nuk do të kishte as Shqipëri...**Duke e mohuar gjakun e të rënëve në LNÇ ne po dëshmojmë se nuk jemi të aftë për t'u vetëqeverisur...**

Satrapi Millosheviq, i cili po mbulohet me Partinë Socialiste (SPS), kurrë nuk ka thënë se fitorja e komunistëve ka qenë FATALE, pra ai nuk shprehet keq edhe pse sillet si Hitleri...Kjo do të thotë se ne deri sa të

jemi kështu të dobët nuk kemi të drejtë të fitojmë...Ende duhet të forcohemi...

Bob Doli po thotë se ne **duhet ta bëjmë transfuzionin komplet të gjakut, me e shpërla ideologjinë komuniste...**

Në Shqipëri 50 vjet nuk ka guxua kush as me e shikua e lere më me e shkelë me këmbë tokën shqiptare, **e sot po vjen PELIKANI italian me i nda makarona popullit?!** E dihet se brigadat shqiptare e çliruan Kosovën dhe arritën deri në Vishegrad, Istër, Srem, Zagreb, dhe në ato luftime ranë mbi **600 dëshmorë**, dhe Shqipëria ishte i VETMI vend në Evropë i cili e çliroi vetveten vetëm me forcat veta, dhe asnjë ushtar i koalicionit antifashist nuk e ka shkelë tokën shqiptare si çlirimtar...Por kjo luftë heroike e shqiptarëve ishte e dyfishtë:

1.**Me i shporrë okupatorët nga Shqipëria** dhe

2. Mos me i lejua të tjerët me hy në Shqipëri psh. Rusët, angloamerikanët, jugosllavët, italianët, kinezët...

Vietnami luftoi 16 vjet me supërfuqinë botërore, me SHBA-të, dhe fitoi me heroizëm duke me 3 milionë dëshmorë, që do të thotë se Vietnami e pagoi me koston më të lartë ÇMIMIN e lirisë...Por edhe 260 mijë amerikanë i lanë eshtrat në tokën e djegur të Vietnamit, por si pushtues, si okupator, e jo si çlirimtar...

Çështja e Kosovës kurrë më parë nuk ka qenë më e internacionalizua! dhe kjo është arritje e madhe, por fitorja më e madhe është ruajtja e Shqipërisë...

Adem Demaçi me 27 vjet kapital politik nuk e ka lehtë ta ruaj këtë, dhe sa herë që e hap gojën e devalvon vetveten, dhe sa herë flet edhe më pus...Dhe nuk duhet të themi-**IA DHANË ÇMIMIN SAHAROV**, por e pranoi këtë çmim...Zhan Pol Sartri **e refuzoi ÇMIMIN NOBËL**, dhe tha- më vjen turp me e pranua...

Pas 2200-2300 vjetësh ne jemi nda me vëllezërit tanë shqiptarë, më 1912, dhe dy vëllezërit në të dy anët ishin në burg, sepse PAVARËSIA POLITIKE FORMALE, por edhe si e tillë ishte arritje e madhe, sepse neve mbi 50% që ishim nën okupimin jugosllav nuk na lejohej as përdorimi

i abetares në gjuhën shqipe... Ndamja e tillë e padrejtë na ka kushtua shumë, 80 vjet e kanë bërë efektin e vet, më shumë se 400-500 vjet më parë, dhe këto 80 vite ishin vite tragjike, sepse ne nuk u ndamë vetëm fizikisht me kufirin gjeografik, por me atë shpirtëror, pra ne jemi shitur pa dashje, sepse kemi jetua me standard më të lart se në Shqipëri, sepse tërë zona bregdetare ishte KËNETA, e standardi ynë ishte pa këneta, që do të thotë se kemi pasur pasuri, por nuk kemi pasur LIRI...dhe këtu konsiston tragjedia-në ndarjen shpirtërore...Zoti është përdor si artikull shpirtëror për TREGTI...

ꕥ

OKB-ja e din se Serbia i ka disa përparësi:

1.Disponon me potencialin e ushtrisë jugosllave,

2.Disponon me depozitën e arit, në BANKA...

3.Me organizimin e Kishës Orthodokse serbe,

4.Disponon me fuqinë e armatosur detare(edhe pse nuk disponon me det;

1. Disponon me flotën ajrore, aviacioni, dhe dihet se kush i ka ndihmua asaj me u bë fuqi ushtarake, kush tjetër përveç se BRSS dhe SHBA, sepse vetëm në bazën e aviacionit në Banjallukë Serbia disponon me 40 avionë...

Jul Cezari u bë perandor, por edhe kryeprift (Pontifiks maximus)...

Marksistat e kanë ceremonialin gati të ngjashëm me ceremonialin fetar,sepse kush e ka mohua është përjashtua, edhe nga jeta edhe nga puna, si në kohën e ikuizicionit...Edhe Ramiz Alia ishte si kryeideolog, si kryeprift, në sektorin e propagandës...Vetë fakti se është gjallë, është arritje e madhe, vetëm pse është përpjekë me e bë zbutjen e rënies së socializmit, ai do të merret si serioz e jo si KUKULL...Në periudhën e tranzicionit – krizës ai e evitoi gjakderdhjen, përndryshe atje do vraponin serbët, malazeztë, grekët secili për të **"çlirua"** copën e vet...Por loja nuk ka marrë ende fund, por deri tani

Ramiz Alia nuk do hyn në histori si Esat pash Toptani...e duhet ta kemi DISTANCËN KOHË dhe vetëm atëherë mund të themi se ku qëndron e vërteta për kapitullimin kaq flagrant të Shqipërisë...

MOS HARRONI SE NE KËTU KEMI SHUMË GOMARË ME DIPLOMA-LLUMPENINTELEKTUA!

ꕥ

OKB-ja në asnjë vend nuk ka intervenua pa shpërthye lufta... Edhe në Bosnjë ndodhi një gjë e tillë, dhe shtabi është në Sarajevë,Shtabi Suprem i OKB-së-UMPERFOR..

Në Kosovë ata do vijnë si të plasë lufta, d.m.th. në çastin kur ne nuk disponojmë me asgjë...

Mirë, profesor, po Rugova po thotë se shtetin do ta fitojmë me paqe, pa luftë?

Mirëpo ai nuk po thotë se kur do ta fitojmë shtetin e tillë imagjinar...Vetëm me eliminimin e luftës lokale si detonator i luftës botërore, sepse luftërat lokale e parandalojnë shpërthimin e luftës në përmasa globale, derisa të rritet hendeku i kontradiktave në mes superfuqive vendimmarrëse...

Luftërat Ballkanike ishin luftëra lokale. Më 1912..

Lufta civile në Spanjë ishte luftë lokale më

1936-1939, si dhe lufta në Poloni më 1939, dhe pas dy vitesh kjo luftë lokale u zgjerua në luftë botërore, ndërsa jashtë Evropës kemi luftën e Koresë-3 vjet, pastaj luftën e Vietnamit-31 vjet(15 vjet Franca dhe 16 vjet SHBA-të).

Edhe pse janë anëtare të NATO-s, Turqia dhe Greqia janë në konflikt në mes vet...Qipro u nda që nga viti 1973, dhe 20% e turqve qipriotë e mbajnë 50% të territorit të Qipros, dhe kjo bëhet me lejen e Amerikës...

Puna e Maqedonisë është si puna e serbëve të Malit të Zi. Deri në shekullin XIX maqedonët janë llogaritur si bullgarë, rreth 1000 vjet. Nga i njëjti popull u bë ndarja

kah fundi i shekullit XIX me rritje e rëndësisë strategjike të rrugës-Stamboll- Selanik (Egje).-Vardar-Nish, dhe kështu rruga Selanik – Shkup e merr prioritetin e rëndësisë strategjike(1873) dhe kështu kjo përparësi mundësoi lindjen e kombit të ri(artificial) maqedon, e dihet se deri atëherë ata ishin bullgarë...

Edhe puna jon është duke u zvarritur, që ne gradualisht të trajtohemi si "KOMB" në vete-KOMB KOSOVAR?!, ashtu si populli gjerman, si kombi austriak, edhe pse Hitleri arriti t'i bashkojë gjermanët për 7 vjet me radhë, por që kjo i kushtoi botës me rreth 60 milionë viktima...

BASHKIMI YNË ME SHQIPËRINË është çmimi më i vogël i mundshëm, ndërsa lufta botërore na rrezikon të gjithëve.

Mirosllav Llazanski, agjent i KOS-it (Shërbimit sekret të kundërzbulimit në armatën jugosllave), gazetar, po iu jep shpresë shqiptarëve me hy në luftë, dhe pas disa muajve, kur ta shohin të leverdishme, ata me veprua me masakra si në rastin e Vukovarit, dhe nga kjo po del se neve na kanë si **REZERVË**, si peng, në xhep, sepse këta me këto rezerva që kanë mund ta përballojnë embargon edhe rreth dy vjet...

Ne kemi qenë Krahinë Autonome, me prerogativat e shtetit të brendshëm, jo të jashtëm, që do të thotë se as si subjekt nuk kemi qenë me Kushtetutën e vitit 1974, por vetëm regjion...

ꕥ

Foshnjat shqiptare dhe lindshmëria e lartë e nënave shqiptare i ka tërbuar shovinistët serbomëdhenj deri në atë masë sa të shprehen me fjalë raciste përmes mediumeve masive. P. sh. në revistën INTERVJU të Beogradit thuhet – "ÇDO FOSHNJE SHQIPTARE E POSALINDUR ËSHTË NJË BOMBË E GJALLË NË PELENA... (Shih-TV-Prishtina,17.01.1988, ora 19 e 30). Këta shovinistë serbomëdhenj sa më afër fundit, aq më të egër dhe më të tërbuar bëhen...

ꕥ

Në librin e Iljaz Gogajt-NDËRHYRJA ARSIMORE ITALIANE NË SHQIPËRI dhe qëndresa kundër saj(1933-1938) veç tjerash shkruan: "Midis klerikëve katolikë shqiptarë ai që i bënte mbrojtjen më të madhe dhe "argumentimin" më të fortë të nevojës politike të futjes së italishtes në Shqipëri ishte agjenti i fashizmit, kleriku **Gjergj Fishta,** asokohe drejtor i gjimnazit françeskan në Shkodër. Në shtator të vitit 1938 duke i kërkuar drejtpërdrejt Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë mësues për gjimnazin e tij, i shkruan midis tjerash: **"Mësimi i gjuhës italiane që të jepet ne kompetencë dhe efikasitet premtues duhej të zhvillohej vetëm nga mësues italianë...**(f.96)"

ꕥ

Sipas kriterit marksist-leninist borgjezia kombëtare për sa kohë është e interesuar dhe merr pjesë në luftën Ncional Çlirimtare hyn në përbërjen e POPULLIT, por në çastin kur ajo lidhet me ARMIKUN dhe përpiqet ta sabotojë luftën NÇL kurrsesi nuk mund të hyjë kategorinë e **POPULLIT,** dhe kjo do të thotë se nuk guxojmë të fshijmë çdo dallim midis popujve dhe armiqve të tyre...

Borgjezia shqiptare e cila u lidh me armikun dhe tradhtoi luftën Nacional-Çlirimtare i vërtetoi fjalët e K.Marksit për borgjezinë kombëtare se **- "Ajo pëlqen më përpara të bashkohet me armikun më të rrezikshëm të popullit, se sa të bashkohet me popullin e armatosur".**

ꕥ

NJERËZIT JANË AUTORË DHE AKTORË TË DRAMËS SË TYRE, ATA JANË PRODUKTE TË RRETHANAVE SHOQËRORE...(K.Marks)

ꕥ

Po mirë profesor, cilin mund ta quajmë marksist të vërtetë?

Definicionin më të mirë për këtë e ka dhënë LENINI kur thotë se:

MARKSIST ËSHTË AI I CILI LUFTËN E KLASAVEE NGRIT DERI NË PRANIMIN E DIKTATURËS SË PROLETARIATZIT...

ꕥ

Po kush mund të meritojë të quhet poet?

Poet i madh mund të quhet ai i cili ka nostalgji të madhe për një dritë më të madhe, për një drejtësi më të madhe, për një Liri më të madhe...Ai është në anën e të voglit, të shtypurit, në anën e atij që kërkon liri dhe jo në anën e shtypësit, xhelatit, tiranit...Ai është përherë aleat i kryengritësve që bëjnë sfidën për të qenë të lirë...Poeti, e jo ëndërrimtari, mbështetet në realitetin dhe frymëzohet nga realiteti...Pena e poetit hedh dritë edhe mbi rrethanat më të errëta, duke i bërë ato të dukshme për të gjithë...Koka e poetit duhet gjithmonë të jetë e ngopur me **BOTËN REALE,** siç thoshte P.Elyar, përndryshe ai nuk mund të nxjerr në dritë veçse abstraksione, broçkulla, çoroditje, ëndrra e fantazira...Është URIA ajo që e bën njeriun të përpiqet që të mos ketë më uri; është LUFTA ajo që e bën njeriun ta dënojë VRASJEN, mizorinë; është PADREJTËSIA ajo që e shtyn njeriun ta ndez zjarrin e drejtësisë...Bashkë me turmën poeti duhet të dalë nga KËNETA e qelbur e marrëdhënieve jonjerëzore, e shtypjes së njeriut nga njeriu, e poetit nga filistini, e martirit nga xhelati...dhe në këtë luftë heroike të zhdukë çdo gjë që nuk është në funksion të te mirës, të drejtës dhe të vërtetës si dhe të ngazëllimit për të jetuar i lirë në mes të te lirëve...Poeti gjeni kurrë nuk GËNJEN, por e shpreh një

mendim dhe përmes atij mendimi- **NJË TË VËRTETË,** sepse siç thoshte V.Ygoi - **e vërteta është zot i njeriut të lirë...** Poeti revolucionar nuk jeton me privilegje pushteti dhe nuk i pranon ato, nuk jepet pas jetës së ëmbël e meskine, por peshon dhe gjykon **MJERIMIN** dhe shkaktarët e këtij mjerimi, siç bëri Migjeni i madh kur shkroi-POEMËN E MJERIMIT... Poeti duhet të himnizojë NJERIUN E PUNËS, jo parazitin dhe egoistin ; duhet t'i këndojë njeriut kryengritës që lufton për Liri e barazi shoqërore, e jo tiranëve dhe skllevërve që e durojnë tiraninë...Poeti ndez zjarrin si Prometheu dhe ndriçon rrugën popullit të robëruar drejt lirisë, me këngën e tij kushtrimdhënëse dhe shpresëdhënëse... Maksim Gorki në poezinë **KËNGA E SHQIPEVE** thotë këto vargje kushtrimdhënëse:

Lavdi heronjve që çajnë qiellin!
Në sulm të çmendur sekret i jetës!
O shpesë trime!
Në qiell armiqtë duke sulmuar,
Ti gjakun derdhe.
Pa çka se vdiqe!
Do vijë dita , kur si shkëndijë
Çdo pikë gjaku, që ti dhurove,
Do të shpërthejë në errësirë,
Do ndezë zemrat bujare, trime,
Do të buçasë: LIRI dhe DRITË!
Pa çka se vdiqe!
Në këngë o trim do rrosh për jetë,
Do bëhesh shembull,
Kushtrim i gjallë LIRIE-DRITE!

LIGJËRIME-17 dhjetor 1989:

Revizionimin e parë marksizmit, pra mendimeve të veta, ia bëri F.Engelsi, sepse rrjedhat e mëvonshme kanë shkua në drejtim të cilin ai dhe Marksi nuk e kanë paraparë...Komuna e Parisit nuk jetoi më shumë se 71 ditë, dhe kjo nuk ishte e mjaftushme si një provë... Nuk jetohet me fjalë, dhe fëmija nuk rritet vetëm me këngë e lojë, por duhet dhënë gji, duhet ushqim i përditshëm...Duhet krijua **KULTIN E PUNËS**, me shkua në punë si në dëfrim, argëtim, me u gëzua që po shkon në punë (A ju kujtohet kënga: **Me gëzim po shkoj në punë**?...), e jo ta konsiderojmë punën si dhunë, si mundim, si torturë... Pra duhet të jemi vigjilent dhe t'mos lejojmë të na topitet mendimi kritik për gjerat dhe dukuritë shoqërore, sepse çdo gjë e kundërnatyrshme nuk është revolucionare...Dhe Shqipëria duhet të ec me këto ritme revolucionare hap pas hapi, dhe sot na gëzon fakti se një mjek vjen në 500 banorë, pastaj vdekshmëria e fëmijëve të porsalindur ka zbritur në zero promil... Dhe kush e garanton këtë disiplinë në MJEKËSI? E garanton huni dhe konopi, shteti i diktaturës së proletariatit, sepse mjeku nuk guxon me e rrit mendjen, por me qenë përherë në gatishmëri si ushtari... Çështja e REVOLUCIONIT është çështje e përditshme, jo e një çasti, sepse duhet luftë e përditshme, dhe nëse nuk shkon përpara atëherë shkon në prapavajtje...Pra duhet çdo ditë e çdo orë me e mbrojt me çdo çmim revolucionin socialist, ashtu siç e mbron nëna e mirë fëmijën duke e lind çdo ditë, duke e rritur me përkushtimin amnor... Kjo do të thotë që kurrë mos me pritua me e derdhë pikën e djersës dhe të gjakut për t'i mbrojtur frytet e revolucionit...

Profesor, njëherë e kishit një biçikletë,
e tani po ecni këmbë?

Tani ajo është në"muze", sepse u lodh nga unë...28 vjet i kam grah asaj të shkrete biçikletë, e kam ruajtur me

fanatizëm, e kam mbajtur pranë vetes në dhomë duke e ruajtur nga ndryshku, bile e mbuloja me çarçafë, e kjo ishte e tepërt, por e ruaja se më shërbente çdo ditë...

ꕥ

Millosheviqi po thotë se pjesa e prapambetur e shqiptarëve ka shpëtua nga rrjeta e iredentës, dhe shton se kjo është ana më e ndritshme e "revolucionit tonë"!? Ndërkaq për gjakmarrjen te shqiptarët shton: **"kjo është ngushëllimi më i madh për ne..."** Kjo do të thotë se armiku i gëzohet dobësive dhe mbrapshtirave tona...Millosheviqi nuk ka faj, por kemi ne që sillemi kështu ndaj vetvetes...

Këtu te ne bëhet **seleksionimi NEGATIV**, d.m.th zgjedhja e më të këqijve në të gjitha sferat e jetës shoqërore, ndërsa në Shqipëri bëhet seleksionimi POZITIV, dmth. më të mirët avancohen...

Nuk është arsimtar i mirë ai i cili e shikon orën në klasë, ende pa tingëlluar zilja, dhe mezi pret me ikë nga klasa...

Jugosllavia ka punua tre vjet për ta bërë Shqipërinë pjesë të Federatës jugosllave(1945-1948), pra me e bë republikë autonome të Jugosllavisë, dhe në vend të Enver Hoxhës me u instalua në Federatën jugosllave tradhtari Koçi Xoxe, dhe gjithë kjo lojë e rrezikshme po bëhej atëherë, por edhe sot, duke na përdorur neve si KAL TROJE që përmes Kosovës me e fshi, me e gëlltit, edhe atë pjesë të Shqipërisë...

Për hatër të emrit të mirë BINAK duhet ta përqafojmë edhe nëse i ka të gjitha të zezat...

Tani për tani FEJA është duke na mbetur në fyt, po na ngulfat çdo ditë e më shumë... Dhe ne po ia zëmë frymën vetvetes me pallavra, rrena e gjysmë të vërteta, të cila janë më të rrezikshme se RRENA...

Komunizmi nuk është bërë as me Marksin as me Engelsin, por as me renegatët Trocki , Kaucki e Buharini...këta kriminelë..

Nëse një fëmijë padashur e ka thye një xham të dritares, atëherë nuk mund ta akuzojmë dhe identifikojmë si vandaliste familjen e fëmijës..

Për taktikë thuhet se MBAROI socializmi...sepse SOCIALIZMI është proces, sepse edhe në vendet kapitaliste kemi elemente socialiste, ligje sociale, jo si te ne ligje në letër, e jo në praktikë... Borgjezia e popullit qorr, popullit analfabet, punon për hesap të vet... Bogjezia revolucionare, Jakobinët, si Bolshevikët, iu prinë fshatarëve e punëtorëve... Lenini i përkiste klasës së mesme borgjeze, dhe u konsiderua tradhtar i klasës së vet, se e kanë kuptua me kohë se duhet të dalin në ballë të morranave, për t'i shpëtuar nga zgjedha e eksploatimit të egër... Edhe te ne që 40 vite është eliminua BORGJEZIA në letër, juridikisht, por në të vërtet ajo është në gjakun e mikroborgjezit të maskuar me maskën e komunistit dhe socialistit...Kur thua borgjezia e kuqe nuk je duke folur seriozisht, pra është kontraproduktive... Dy tre vëllezër që kanë punua intensivisht në Gjermani 15 vjet me bukë e krip, dhe i kanë ndërtua banesat moderne, ata nuk janë bogjezë...

Të MIRAT kur teprohen, të çojnë në varr para kohe...Ato dikujt ia çelin e dikujt tjetër ia qorrojnë sytë...

Sprinteri, vrapuesi ka pi hapa, drogë, doping, dhe e ka zënë vendin e parë, pra i pari i hapave, i drogës, dopingut...

Edhe të VËRTETAT kur i shpallim me qëllim NEGATIV, me qëllim të mbrapsht, janë johumaniste, jomorale, janë CINIKE...Edhe mjeku më i mirë dënohet nëse i thotë të sëmurit të vërtetën-se t'u kanë kalbur mushkëritë...

Më 17 nëntor 1988 ardhja e MINATORËVE në Prishtinë ishte spektakolare, ishte e programuar, nga ana e policisë, me qëllim të shpërthimit të Kryengritjes, e pastaj ajo të shuhej me gjak, dhe të komprometohet...Shtypi i verdhë i Beogradit nuk po fsheh asgjë, çdo gjë është bërë e

tejdukshme, kur po thonë se në shtetin serb të gjithë janë absolutisht të barabartë...Dhe pastaj po theksojnë se.

"Dy ditët e para të protestave të nëntori, nuk ka pasur kundërrevolucion, sepse ne nuk e kishim programua, nuk e kemi përgatitur, por në tre ditët tjera nuk ka shkua puna sipas programit tonë, dhe kjo është kundërrevolucion..."

Kjo po tregon se ne jemi të fortë me emër, por jo me cilësi...Populli ka nevojë për mish e pite dhe lojna-argëtim...Panem et circenses-thoshin latinët e moçëm...

Populli-kanë ardhur burrat, e jo shmoklanat, me të cilët nuk mund të bahet hajgare...Po vijnë gjindja-gentes(por jo edhe gratë)-populli-fëmijë-gra dhe burra, qyqanë dhe të fortë, të gjithë bashkë... PLEBES, plebisitun-plebejt për votime- me votua për mua, ata që shiten e blihen, që shiten si argat...**fjalë e rëndë kur thotë-tri ditë dola në tregun e punës dhe nuk munda me u shitë...**

ꕥ

Në Serbi e blejnë dhëndrin, dhe rrezikojnë që tërësisht të bankroton familja, dhe martesa bëhet me kusht me vajzën e cila i bind prindërit e saj për t'ia përkthye shtëpinë në emër të burrit, dhe veç tjerash dy pleqtë me dalë nga shtëpia dhe me jetua me qira, dhe pa plotësimin e kushteve të tilla nuk ka kurorëzim...

ꕥ

Sa më pak liri të ketë një vend , aq më të dobëta janë shfaqjet e luftës klasore, thoshte Lenini, dhe se- **NË ÇDO KOMB** kemi dy kombe, kombin punonjës të shtypur dhe pjesën parazite të kombit-shfrytëzuesit, shtypësit...

GRUAJA DHE KOMBI nuk guxojnë me qenë aq të papërgatitur sa edhe dhunuesi i parë të te DHUNOJË, thoshte K.Marksi në librin-**18 Brymeri i Luigj Bonapartit..**

.

Në periudhën 1983-1989, në Kosovë 48.029 nxënëse ose 50% e atyre nxënëseve që e kanë krye klasën e tetë nuk kanë arritur të regjistrohen në ndonjë shkollë të mesme (shih-Delegatske novine, 22.11.1989, Prishtinë), ndërsa në Shqipëri kjo dukuri nuk ekziston sepse atje shkollimi i mesëm është i obligueshëm...

Ne duhet të zgjedhim rrugën e luftës e jo rrugën e pajtimit me armiqtë, me oporunistët, me ata që janë zhytur në tradhti, por edhe me ata që kanë marrë **rrugën e tradhtisë...**

NJERËZIMI I SHTRON VETES VETËM DETYRA TË TILLA TË CILAT MUND T'I ZGJIDH (K.MARKSI), dhe detyra lind vetëm atëherë kur ekzistojnë kushtet materiale për zgjidhjen e saj, ose të paktën kur këto kushte janë në formim e sipër...

Te ne opozita legale mori pjesë në protestat e nëntorit 1988 dhe në grevat e shkurtit 1989, por nuk mori pjesë në DEMONSTRATAT e marsit 1989, dhe pjesëmarrja e tyre dështoi fare sepse kjo opozitë nuk i përfaqëson interesat e gjithë popullit, por vetëm ato të TEKNOBUROKRCISË së Kosovës (A.Vllasi, R. Kolgeci, K.Jashari, Jashanica, S. Vllasaliu , Abrashi, Kavaja etj.), ndërsa opozita ILEGALE ende është shumë pak e lidhur me klasën punëtore, është në stadin e spontanitetit, të cilin duhet tejkaluar sa më parë, sepse revolucioni kurrë nuk mund të fitohet me spontanitet...dhe se **çlirimi kombëtar dhe çlirimi social shkojnë paralelisht, jo veç e veç...**

Bogosllovia serbe tërësisht janë në unison me Komitetin, dhe atje ta shfletojnë biografinë që nga katragjyshi, e pastaj ta jep vizën për t'u ngjitur shkallëve të pushtetit...p.sh. siç ishte rasti me familjen Vllasi dhe familjet tjera...

Mos u bëftë ajo çfarë planifikonin Tito, Kardeli, Kërlezha, Vranicki etj., pra KONFEDERATA

BALLKANIKE...sepse ne nuk kemi hesap se mbarojmë të gjithë, sepse kjo punë është me hile..

LIRIA I KA RRËNJËT NË GJAK DHE MBOHET ME GJA E SAKRIFICA TË SHUMTA...

Shqipëria **e ka zgjedhur rrugën e zhvillimit që 45 vite, një vend pa borxhe të jashtme e pa taksa, pa analfabetë, me shkollim të detyrueshëm, me 3000 kopshte parashkollore, me 333 shkolla të mesme, me mbi 20.000 studentë të rregullt dhe po aq pa shkëputje nga puna, me 8 libra për kokë të një banori (në Kosovë-0,5 libra). Me 80% të popullsisë të vendosur nëpër apartamente banimi, vend me mjekimin falas për tërë popullsinë , pa vëllavrasje, dhe krime, me të ardhura dy herë më të mëdha se Kosova...**

ꕥ

LIGJËRIME, 28 nëntor 1990:

Më 1903 u formua DORA E ZEZË çetnike...Stërfashizëm,-tharmi i fashizmit, fashizmi-si FLAMA, GRIPI, ndërsa nacizmi si MORTAJA e zezë, Hitleri i kishte thënë Paveliqit më 1943, pas betejës së Stalingradit, se ne duhet të mësojmë nga ata pjesëtarët e DORËS SË ZEZË të cilëve nuk iu dridhet dora kur e therin njeriun në qafë... Egërsira nuk i frikohet gjakut... I lagëti për shi nuk ka dert...Tërë magjja me miell është përdorë për farë, për tharm... Ne duhet të kthjellohemi çdo ditë e jo me epizode, dhe nuk bën me i këndua fëmijës nina-nëna se si ke me ia nxjerr komshisë sytë për një flakaresh... Dhe secili lë të shohë në vetvete se a më shumë shkon kah të zezat apo kah të bardhat, dhe jo me i marrë për të vërteta fjalët e njeriut që ka temperaturë 40 shkallë dhe nëpër odë sheh lepra, haluçinacione... Janë këndua këngë me plot zemër për gjakmarrjen e vëllait me vëllanë, **dhe kjo ishte një vetëhelmim shekullor,** brez pas

brezi, dhe në këtë mënyrë është shpenzua energjia kombëtare kot së koti, për budalli, dhe jo për mbrojtjen e atdheut...

GUXIMTARI dhe TRIMI nuk janë sinonime...**Sokrati thotë se askush nuk i bën askujt më shumë keq sesa që i bën njeriu vetvetes**...Edhe popi Maltus thoshte se i MBRAPSHT është ai njeri që nuk din me bë llogari, që nuk ia pret mendja, që do të thotë se budallai është njeri i mbrapsht...Dhe sa më shumë që njeriut ia pret mendja, aq më i mirë është për të tjerët...

Të GJITHA TË ZEZAT NA VIJNË NGA MUNGESA E VETËDIJES...

Këta kolonizatorë nuk po turpërohen kur po thonë **se FALJAE GJAQEVE ËSHTË KUNDËRREVOLUCION...**

.Dobrica Qosiqi po thotë se për ne të vërtetat shkencore janë cikërrime, ndërsa me rëndësi të dorës së parë janë ndjenjat, dhe ne përherë po luftojmë për realizimin e këtyre ndjenjave 600 vjeçare-të vërtetave të Shën Savës... Pra kjo është një sëmundje kolektive shumë e madhe dhe e rrezikshme, për të cilën neve duhet të na vijë shumë keq...sepse ata po thonë se **VEND SERB** është çdo vend të cilin ata e kanë parë në ëndërr...që do të thotë se **një popull i tërë është nën ethet e këtyre ëndrrave...**Po ku është ilaçi? Në 1000 mundime plus gjaku i të tjerëve, dhe janë sakatua me përpjekje me i bë ëndrrat zhgjëndrra-realitet, por kur bëhet fjalë për shqiptarët të gjithë janë unik, të njëzëshëm, dhe ne nuk duhet të gëzohemi pse ata i ka zënë kjo epidemi, se dergja mund të përhapet...

DOBËSIA JONË MË E MADHE ËSHTË QË GJAQET I KEMI LËNË TË NA PËRCJELLIN DERI NË SHEKULLIN XXI...dhe kjo dobësi është FAJ që nuk e kemi dashur njëri-tjetrin dhe që nuk jemi të BASHKUAR.

Brindizi-Otranto-Porta e Adriatikut, në rast lufte mbyllet si dera e oborrit, e këta mendojnë ta kenë Adriatikun deri në Shibenik, por nëse nuk e ke VLORËN nuk ke asgjë, sepse aty është pika më gjeostrategjike, se aty të pret armiku që nga koha romake e këtej...Gjatë

kohës së paqes pika kryesore është Kotorri, ndërsa gjatë kohës së luftës-Sazani-Vlora-Saranda-Pashalimani, dhe për atë BAZË strategjike ruset kanë investua për 20 vjet me radhë mbi 3 miliardë dollarë si shpërblim...Vetëm Shqipëria ia ka lejua këto baza BRSS me marrëveshje, që për sa kohë do rrinë të paguajnë, dhe në çastin kur BRSS fillon me u sjellë si zot shtëpie me i thënë-ik shporru, dhe në nëntor 1961 për 2 ditë e dy net ishte gati për të shpërthye LUFTA në Evropë dhe botë, sepse Perëndimi kishte hesap me hy në luftë për atë pikë strategjike të Otrantos...por duke parë vendosmërinë e forcave shqiptare rusët vendosën të tërhiqen me turp... Puna e Shqipërisë mbushë shumë hesap... Kur u futën forcat malazeze në Shkodër, Ismail Qemali e thërriti Evropën, dhe pastaj forcat Evropiane arritën dhe ushtria malazeze u kthye mbrapa...

Brenda 48 orëve u vendos përmes Gjermanisë MURI I BERLINIT më 1952, dhe qyteti u nda në dysh, dhe ishte ndarje e përgjakshme, sepse po ndaheshin familjet nga njëra tjetra...Dhe nëse do rrëzohej ky mur në ato vite të luftës së ftoftë do provokohej lufta botërore bërthamore, dhe në nëntor 1989 u dha ultimatum-ose me u hekë ushtria ruse ose me shpërthye lufta , me mbarua bota, dhe për 12 muaj u arrit ajo që as Amerika nuk e ka paraparë, se natyra është më e fortë se njeriu...

KONFERENCA E HELSINKIT më 1975 ishte vetëm një kontratë, një fjalë e mirë, një ngushëllim, dhe samiti i Parisit është një fazë e Helsinkit, por Shqipëria më 1975 nuk ka shkua dhe nuk e ka nënshkrua asnjë dokument për paprekshmërinë e kufijve në Evropë, dhe me këtë hap të guximshëm ua ka bërë me dije superfuqive se nuk është pajtua kurrë me status-quonë e ndarjeve të padrejta në Evropë pas Luftës Dytë Botërore... Në krahasim me carizmin bolshevizmi ishte lule e dritë, sepse në kohën e carizmit (1868) shiteshin njerëzit bashkë me tokën, ndërsa sikur mos të kishte pasur të mira bolshevizmi nuk kishte qëndruar 70 vjet, derisa nuk i mbet vetëm skeleti, dhe u

shkatërrua...Përpara me të quajtur bolshevik ishte sikundër me të quajtur pasha, e tani është sharja më e ndotur kur të thonë-ik more bolshevik, more komunist...Në SHBA, Suedi, Zvicër, Holandë etj. respektohet ligji, dhe këto shtete quhen shtete juridike. Bolshevikët, marksistët ishin më të mirët, sepse mendonin mirë për njeriun...Qeliza e parë e shoqërisë njerëzore është FAMILJA, e cila nuk mund të ekzistojë pa rendin komunist ku zbatohet parimi- **secili punon sipas aftësive dhe shpenzon sipas nevojës...**

Edhe fëmijës ia ndërrojmë këpucët kur t'i rritet këmba, dhe ai shpenzon edhe pse nuk punon, dhe prindi po gëzohet pse po i rritet këmba, e nuk po i thotë-hiqu qafe bre parazit se ti nuk po punon asgjë...**Komunizmi është BAZA kryesore e QELIZËS njerëzore**...Duke u nisur nga ky parim fondamental i barazisë komunistët e vërtetë kanë dëshiruara ta aplikojnë këtë rend shoqëror për gjithë shoqërinë njerëzore. IDEALI i tyre ishte- NJERIU të bëhet zot i vetvetes, PERËNDI, po divinizohet, hyjnizohet,...Tani kemi arritur deri te një tjetërsim absurd, mos me e njohtë nënën dhe babin, kur ngjitesh lart me standard, me fotelje, me mercedes...A mundet perëndia me e krijua një shkëmb, gur, që as vet mos me mund me e mbajtur,ose me e bërë një GABIM të cilin as vet mos me mundur me e ndreq...Edhe njeriu më i afërm kur na vdes duhet ta varrosim, se i vjen era, pra kundërmon. Dhe nuk mundesh me thënë se nëse dua e varrosi... Edhe loja më e mirë në një çast plaket, ndërrohen kushtet dhe ndërrohen edhe sjelljet e njerëzve... Kroatët na ndihmojnë nëse kanë hesap, por edhe neve duhet t'i shohim hesapet tona... **FALJEN E GJAQEVE** mos me e bërë epizod, por trend, dhe gjithnjë me u forcua dhe me u arrit uniteti mbarëkombëtar dhe tërë energjia e kombit me u drejtua kundër armikut...Asnjë aleat kurrë nuk ta sjell si dhuratë LIRINË. Tokën nuk mund ta punojmë këtë vit për tërë jetën, kështu është edhe me LIRINË të cilën duhet ta lindim çdo ditë... Njeriut të pasur me ia ndalua të mirat mbaron...

KËTA XHAFERDEVAT TANË janë lidhur me lloj-lloj agjenturash, por më së paku atyre iu intereson fati i kombit...

ENVER HOXHËS ME TË DREJTË IA KANË DHËNË ATRIBUTIN –ARQITEKT I SHQPËRISË SOCIALISTE, sepse bëri shumë përparime dhe të mira kolosale dhe veç tjerash **e ÇRRËNJOSI GJAKMARRJEN...** Edhe në botimin e Enciklopedisë franceze- **LA RUSË** flitet me fjalët më lapidare për Enver Hoxhën...Edhe Skënderbeu vdiq, por populli shqiptar nuk mbaroi, nuk u ç'faros...dhe nuk duhet ta bëjmë mizën buall, pse iku-dezertoi Kadareja, të themi – mbaroi Shqipëria, por në asnjë rast të mos e marrim si tradhtar, sepse ai në fushën e letërsisë ka dhënë shumë, dhe ne ende nuk e dimë se a ishte marrëveshje e fshehtë dezertimi i Kadaresë...

Është rrezik për Shqipërinë nëse nuk adaptohet, nëse prej 40 km në orë makina kalon në shpejtësinë 120 km në orë sa edhe mund të digjet tërë makina... Koçi Xoxa nuk ka mund ta rrezikojë Shqipërinë në atë kohë, edhe pse atëherë ka qenë shumë më rrezik, por Shqipëria e ka tregua veten shumë të fortë, prandaj duhet të jemi vigjilent dhe të shohim se a ja vlen barra qiranë dhe të mos na kthehet bumerang ky proces, dhe pastaj ta paguajmë kamatën e dobësive tona, siç ndodhi me Gjermaninë... Neve na mungon **DISIPLINA,** dhe ajo që është edhe më e keqe se ne MBURREMI me qenë të padisiplinuar, ndërsa te gjermanët disiplina është në gjak me gjenerata të tëra...se atje është skamje e madhe e natyrës, se nuk e kanë Mesdheun, por detin Baltik...

Më 7 shtator 1990, delegatët në ata 20 minuta ishin unik në Kaçanik, por uniteti dhe këmbëngulësia do duhej të bëheshin përditshmëri, e jo epizod...Te ne sado me u veshë, prapë shihen cuklat...Të shohim se çka do bëjnë më tutje këta delegatët tanë...LIRIA kur nuk ke bukë nuk vlen asgjë, sepse pa bukë nuk mund të ketë liri... Ahmet Zogu ishte i aftë dhe dinak, por jo burrë, sepse ka dashtë që Bajram Currin me e bë arushë, por tribuni i vegjëlisë nuk e

pranoi një rol të tillë...Pasqyra më ilustrative e sundimit të Zogut është - **Poema e Mjerimit** e Migjenit, sepse Shqipëria në kohën e Zogut e kishte lirinë formale, por jo edhe BUKËN, lirinë e vërtetë...Ai satrap i ka vjedh nga arka e shtetit 50 milionë Franga ari nga rezervat e shtetit dhe bashkë me to iku në Evropë, sepse ishte pion i saj...Realiteti ynë gjatë historisë ka qenë i hidhur. Fizikisht nuk është e mundur me na ç'farosë, përveç nëse lejojmë me e ç'farosë ne vetveten..., me ia nxjerr sytë shoqi-shoqit, në vend që t'ia zgjatim dorën shoqi-shoqit... Dhe kur pritojmë me sakrifikua për gjera të mira, atëherë mburremi për mbarpshtirat tona, kur dikush thotë-për inat e kam, pra i ka hy në gjak inati, **është bërë skllav i dobësive të veta,** kështu ne po bëhemi **varrtar potencial të vetvetes...**Na po e vajtojmë Shqipërinë,. Në vend që ta vajtojmë vetveten, se atje gjoja nuk paskan as saç, as tepsi, as dru...ndërsa ne i kemi të gjitha dhe meqë i kemi vëllezër po iu çojmë edhe dhurata, duke menduar që Shqipërinë ta bëjnë si Kosovën...**E nuk e dinë faktin se në Shqipëri mbi 60% e nënave dhe vajzave janë në procesin arsimit...Mbi 75% e djemve dhe vajzave në Shqipëri i ndjekin shkollat e mesme, sepse që nga viti 1988 u bë i detyrueshëm shkollimi i mesëm...**

LIGJËRIME, 21 gusht 1991:

Ai që ka më shumë pasuri, ai frikohet më shumë se ka çfarë të humb, ndërsa ai që nuk ka asgjë, asnjë pasuri, ai nuk ka çfarë të bumbë përveç **PRANGAVE**, vuajtjeve dhe robërisë... Edhe me dhënë shpirt duhet të jesh i zoti...

BRSS nuk mundet me i mbyll sytë për çështjet e Ballkanit, sepse kanë investua shumë, që këtu e 100 vjet më parë, që nga viti 1878, kur iu dorëzuan Malit të Zi Ulqini e Tivari...

Kolaboracionistët janë ajo shtresë e cila është e pacifikueme, sepse për hir të interesave personale është e

dëgjueshme dhe e kontrollon vetveten, bën autocezurë, vetkontrollim, dhe kështu pushtuesi fiton dyfish-edhe financohet nga taksat e rregullta të tregtarëve , por edhe me koka, sepse bëhet frenimi dhe amortizimi i kryengritjes popullore... Këta kolaboracionistët tanë janë si **struci**, i cili kur e sheh rrezikun që po i kanoset, e fut kokën në zall që të mos e sheh rrezikun...

Komuna e Parisit ishte i katërti revolucion në Francë, dhe e tronditi tërë planetin si vullkani Krakatao...Sipas zotit çifut më i afërmi i perëndisë është ai që FITON (Zotin kapital)...Pas Komunës së Parisit më 1871 punëtorëve iu dha e drejta **për GREVË**, pastaj e drejta për sigurim social, e drejta për pensionim, e drejta për punën 8 orësh. etj...

Intelektualët e Shqipërisë ishin Fanolista, sepse deri më 7 prill 1939 ishin të frymëzuar nga Fan Noli..

Më 1886 nëpër rrugët e Çikagos me mijëra veta po bënin grevë për punën tetorëshe, dhe kjo protestë masive u shua me gjak nga ana e kapitalistëve të pashpirt...Që nga ajo kohë në shenjë solidariteti me klasën punëtore festohet **1 MAJI- Dita e punëtore...**

Nëse NJRIU është më tepër se sa duhet për veten e vet, atëherë ai nuk mund të jetë i mirë për të tjerët...

Qëndrimi neutral me dashje ose pa dashje i ndihmon njërës anë, asaj ane e cila ka interes për neutralitetin e saj, por atyre **të paktën lë t'u vijë turp për qëndrimin e tyre neutral,** për tradhtinë e tyre...

Ne duhet të jemi të fortë dhe t'i përpijmë dallimet (përkohësisht), dhe të mos sillemi sikur të ishin kohë normale, e dihet se sa dhe si po na kanoset rreziku i përbashkët...

Atje ku mbizotërojnë ligjet e amullisë dhe anarkisë, atje nuk ka as demokraci as LIRI...Në Shqipëri u dogjën mbi 700 shkolla, të cilat nuk janë djegur as në kohën e fashizm it, u prenë mijëra pemë frutore, bile edhe trupat e ullinjve shekullor, u shkatërruan binarët e hekurudhave dhe u dërguan në hekuranën e Nikshiqit, dhe vajtimin e

kësaj Shqipërie a mund ta bënte edhe një herë Pashko Vasa?

ꕥ

LIBRAT janë skllevërit e mijë, kishte thënë Marksi dikur, dhe unë pasurinë më të madhe që arrita ta bëjë gjatë tërë jetës sime janë këto libra dhe kjo bibliotekë modeste të cilën arrita ta ndërtoj në tavanin e kësaj ndërtese, sepse nuk kisha vend tjetër ...

ꕥ

Në republikat joruse të BRSS ose kryetari ose sekretari patjetër janë rus... Ngjarjet tragjike këtë e treguan më së miri...Gjeorgjia, Azerbajxhani, Gruzia, Armenia...Lëvizjet nacionaliste të këtyre vendeve drejtohen edhe kundër hegjemonizmit rus në ushtri, sepse në armatën ruse bëhet poshtërimi moral e fizik i ushtarëve jorusë...komanda bëhet në gjuhën ruse...125.000 ushtarë nuk e zotërojnë gjuhën ruse...

Letonia dhe Estonia në maj të vitit 1989 vendosën që gjuhët e tyre të jenë gjuhë zyrtare...Edhe Bjellorusia kërkoi që gjuha e saj të bëhet gjuhë zyrtare...Më 1987 në muajn gusht ukrainishtja u bë gjuhë fakultative...Të gjitha këto republika po luftojnë kundër rusifikimit kulturor...

Më 1959-1979 në Etoni, Letoni dhe Estoni rusët u shtuan, ndërsa në Kazakistan u shtuan më shumë (më 1949 atje kishim 49% rusë), në Armeni-12,5% rusë; Kazakistan-25,5% rusë, dhe atje rusët janë në vendet udhëheqëse- hegjemonizmi rusomadh...

ꕥ

Njeriu i dyfishtë-homo dupleks-jo me ndejtë drejtë e me fol drejtë..., por edhe me fol drejtë dhe me ndejtë shtrembët...Që dikush të ketë shumë të mira, tjetri e

paguan me kokë...Gjeli kur këndon para kohe e han kokën e vet...

Xhafer Deva ishte një gjakpirës supërfashist, dhe mua për pak më shkoi koka nga ai kur më arrestuan ushtarët e tij...

Në "ZËRI" janë infiltrua shumë agjentë dhe është çudi që nuk e marrin seriozisht këtë realitet këta njerëz që janë infiltrua me qëllim, janë komprometua keq dhe nuk turpërohen fare, sepse po mendojnë se janë duke veprua mirë, në shërbim të popullit...

SHQIPËRIA është shtet që 40 vjet, është subjekt ndërkombëtar, e ne nuk jemi, dhe për këtë duhet t'ia kemi lakmi për këtë subjektivitet...Në Shqipëri nuk ka shtëpia trekatëshe private dhe me frigoriferë e dy viça në frigorifer pastërma për dimër...Atje kjo pabarazi nuk lejohet...Prej KNINIT e deri më sot u bënë dy vjet...Kryengritja në Kore zgjati 3 vjet, në Spanjë 2 vjet...

Sot luftërat janë nën mbikëqyrjen satelitore...OKB-ja është instrumentalizua, është nën diktatin e Këshillit të Sigurimit ku vendosin 5 shtete, dhe secili shtet ka të drejtën e **VETOS**...Këtu kemi interesa antagoniste dhe lufta mund të zgjatë me vite, sepse BLLOKADA kundër Millosheviqit është me hile, me lluft, si planci i shpuar, sepse cisternat me naftë po kalojnë kah Greqia, Rumania, e tani së fundi edhe kah Shqipëria, nëpër Liqenin e Shkodrës!? Interesat e SHBA-së, Gjermanisë dhe Italisë nuk janë identike...Shtrausi ka qenë oficer i Hitlerit, por jo nacist, dhe ishte më i forti si antirus, por edhe antiamerikan, por Shqipërisë ia kishte lakmi për pavarësinë e saj, dhe e vizitoi 2-3 herë...Amerikën ai e konsideronte armik me perspektivë, ndërsa rusët pa perspektivë, sepse iu kishte hyrë kanceri, dhe këtë e dëshmoi rrëzimi i MURIT TË BERLINIT...Amerika nuk lejoi me ardhur Shtrausi...

Profesor, në këtë konstelacion forcash ndërkombëtare ku jemi ne ?

Lidhur me këtë duhet të bëjmë saktë analizën e thellimit të kontradiktave antagoniste...Në Irak dhe Kuvajt u bë ULTIMATUM me kusht, por edhe këtu është me kusht, por pa ultimatum, por me SANKSIONE kundër Millosheviqit, por bllokada po merr frymë, sepse nuk po e bojkotojnë Serbinë të gjithë, sepse interesat nuk janë identike...Kinezët kanë potencialin numerik ushtarak më të madh në botë, por jo në ekonomi, Rusia e ka fuqinë bërthamore atomike, por nuk e ka ekonominë, dhe vetëm Amerika është superfuqi në çdo pikëpamje...Evropa Perëndimore është shumëfish më e fortë se Amerika ekonomikisht...Gjerat duhet të dyshojnë, loja ende po vazhdon, sepse pas Luftës Dytë Botërore për herë të parë po bëhet luftë edhe në Evropë, pa llogaritur Hungarinë më 1956, Poloninë dhe Çekosllovakinë më 1968, sepse kurrë nuk u bë e qartë se sa ishte numri i viktimave në ato vende gjatë invazionit rus me tanke...Rreziku për të shpërthye një konflikt i përmasave globale po na kanoset...E dihet se **KURBAN, viktimë, për çështjet e Evropës bëhet më i dobëti...**Njëherë për njëherë janë në radhë **MYSLIMANËT** e Bosnjës, ata janë në radhë para nesh, dhe **pastaj kur të kryejnë punë atje jemi ne në radhë...** Atyre mundet me iu ndihmua vetëm Amerika, përmes Arabisë Saudite...Tërë arsenali propagandistik serbomadh është drejtua për t'i kompromettua luftimet në Bosnjë dhe Hercegovinë si LUFTË E FUNDAMENTALIZMIT ISLAMIK, si luftë e xhihadit (luftë e shenjtë fetare...)...Unë me Alia Izetbegoviqin kemi qenë bashkë në aksionin e ndërtimit të hekurudhës Shamac-Sarajeve, më 1948...

Serbët e kanë bukën, aviacionin, flotën detare, armatimin më modern, Kishën orthodokse, opozitën botërore, gjithë këto shtete që po e thyejnë bllokadën-embargon ekonomike...Kushtetuta e Serbisë nuk njeh kurrfarë autonomie politike, por vetëm autonomi administrative, me qëllim që ta bëjë asimilimin përmes plan-programeve shkollore të barabarta, dhe çfarë

hipokrizie dhe cinizmi kur thonë të barabarta për të gjithë...**Dhe për të qenë ironia edhe më e madhe ti po pret me shkua e me bisedua me ta, dhe për çfarë të bisedosh??** Të flasësh gjuhën private, jo zyrtare, që është një diskriminim flagrant...Serbia po thotë se as në Amerikë populli nuk kanë të drejta më të mëdha se sa në Serbi...E dihet se shqiptarët në Serbi mund të flasin, por edhe të lehin, vetëm privatisht, e jo zyrtarisht...Dhe tipat si hungarezi Kertes, si Sejdo Bajramoviqi nuk i pengon fare pse nuk flasin në gjuhën e mëmës...

Neve na ka qëllua fati të kemi një pozitë të tillë gjeostrategjike shumë neuralgjike ku gërshetohen interesat e superfuqive botërore...Para 2500 vjetëve këtyre anëve kalonte rruga e moçme-VIA EGNATIA- deri në Selanik e Gjirin Persik...

ꕥ

LIGJËRIME, 20 prill 1994:

Materia është e pamundur pa antimaterien, ndërsa lëvizja është e pamundur pa antilëvizjen, por edhe kusht i ekzistencës së të VËRTETËS është GËNJESHTRA, ndërsa kusht i ekzistencës së DRITËS është TERRI, dhe kusht i ekzistencës së JETËS është VDEKJA, dhe kështu manifestohet ligji DIALEKTIK i të kundërtave… Me shndërrimin e praktikës në teori mohohet teoria, dhe se – KRITER I SË VËRTETËS ËSHTË PRAKTIKA… RRENA është parakusht për ta kuptuar të vërtetën… Antinomia – antiemër (E. Kanti)… **GËNJESHTRA E BËRË ME QËLLIM është KRIM...**

ꕥ

J. V. Stalini kurrë nuk ka marrë ilaçe, përveç kur e kishte pasur një të thatë në dorën e majtë…

ꕥ

Moguli – perandor i gjithë mbretërve (Maharaxha në Indi). Kur erdhën në Indi kolonizatorët anglezë i zhdukën mogulët, por i lanë maharaxhët…

ꕥ

Kisha greke e mallkoi K. Kristoforidhin, kështu që e varrosën jashtë varrezave, por po të ishte shekulli XIV atë do ta digjnin në turrën e druve si Xhordano Brunon…

ꕥ

Ata që dje kanë shkuar në Komitet, kanë qenë dyfytyrësha. Ata kanë bërë vepra tradhtie, dhe askush nuk mund t'ua mbulojë poshtërsitë. Por sipas Makiavelit – QËLLIMI I ARSYETON MJETET. Shteti nuk mund të ekzistojë pa hipokritët, pa kolaboracionistët… Njeriu në një pikëpamje ngel fëmijë. Me qëllimin më të mirë edhe gjyshi bëhet HIPOKRIT, sepse nuk i tregon fëmijës se të ka vdekur nëna, ose me rastin e shkurorëzimit… Mjeku i mirë kurrë nuk i thotë pacientit – e paske KANCERIN… Mjekët dhe varrtarët janë në një SINDIKATË… Në kohën e mesjetës të vetmet shkolla ku fëmijët kanë mësuar shkrim-leximin kanë qenë KISHAT. Ne edhe me lisa, me baktere dhe me kafshë jemi KUSHËRINJ… Në Danimarkë dhe Holandë medicina preventive është më e zhvilluar. Në etikën e mjekut është që të ketë sa më pak pacientë… Mjeku i mirë është më filantrop (njeridashës) se gjithë të tjerët, dhe shpërblimin më të madh e përjeton në çastin kur ia zvogëlon dhembjet pacientit …

ꕥ

Kur i ke bërë 1000 të zeza, dhe kthehesh e lutesh: O ZOT FALMI MËKATET, kjo është HIPOKRIZI… Gjykatësit janë në shërbim të shtetit, **janë pjesë e POLICISË**, dhe ata betohen në DREJTËSI, por jo për filantropi….

ꕥ

Dobësia merret si FAJ, edhe ne marrim pjesë, por ne nuk kemi dëshirë të jemi të dobët. Duhet të bëjmë luftë për të qenë sa më të pavarur, ndërkaq vartësia duhet të jetë reciproke, dhe më e mira e të mirës është të jesh sa më pak i VARUR…

ꕥ

Zonja **Edit Dyrham** është shkencëtarja dhe humanistja angleze e cila bëri më së shumti për kauzën e shqiptarëve. Asaj i kemi shumë detyrime, shumë borxh…

Më 1912 neve nuk na ka pyetur askush, sepse as kryengritjet shqiptare, dhe gjithë ai gjak i derdhur për çlirim, nuk mbushën hesap, sepse në Londër u vendos në bazë të josuksesit, edhe pse në korrik dhe gusht 1912 kryengritësit shqiptarë në krye me Bajram Currin e Isa Boletinin, Zefin e Vogël etj. e kishin çliruar Shkupin… Kështu Konferenca e Londrës më 1913 u bë në bazë të interesave të Italisë dhe Austrisë.

Ismail Qemali ishte në relacionin Vjenë-Romë, sepse trupat e armatës pushtuese serbe kishin hyrë në Shqipëri… **Qeveria e Ismail Qemalit nuk arriti të jetojë më shumë se 13 muaj**, sepse rrotull bregdetit të Vlorës kishin ankoruar 6 luftanije të Francës, Anglisë, Austrohungarisë dhe Rusisë… Durrësin, Krujën, Tiranën, Peshkopinë, pa Elbasanin, e mbante **Esat Pashë Toptani** (20% të territorit)… Dhe kush është fajtor për të gjitha këto dështime? Ne, dhe askush tjetër, sepse ia kemi nxjerr sytë njeri-tjetrit. **Pra përçarja i bëri gjerat e mundshme të pamundshme,** dhe energjia mbarëkombëtare nuk kishte një goditje të përqendruar, por ishte bërë copë e thërrime…

ꝏ

Sot Shqipëria po përjeton restaurimin e rendit borgjez, dhe çdo gjë po përmbyset, **por me këtë fushatë, duke e stigmatizuar dhe ndaluar Enver Hoxhën, atë e bëjnë edhe më të madh, edhe më të pavdekshëm...** (Dy varreza-përmendore u zhvarrosën, ajo e Stalinit dhe e Enver Hoxhës)… Sot Shqipëria është kthyer në **protektorat** të te huajve, pa pavarësi dhe liri, pa dinjitetin dhe krenarinë e deridjeshme, pa industrinë që kishte deri dje, e cila u shkatërrua deri në **kuotën zero**, se gjoja fabrikat uzinat, kooperativat, brezaret, plantacionet e ullishtave i paska ndërtuar komunizmi dhe duhen zhdukur me rrënjë, sepse kështu ua donte qejfi armiqve të Shqipërisë. Por lavdia e humbur e Shqipërisë mund të rifitohet vetëm duke iu referuar atyre që e bënë Shqipërinë të lavdishme për 50 vite me radhë, duke iu referuar epokës së ndritshme e cila e shpëtoi popullin shqiptar nga të gjitha llojet e prangave e plagëve… **Tradhtarët shqiptarë**, të cilët dje ia çonin kurorën e Skënderbeut Viktor Imanuelit në Romë, sot po ia çojnë kurorën e Shqipërisë dikujt tjetër… Sot janë bërë copë e thërrime masat e dikurshme punonjëse nëpër ato **dhjetëra parti borgjeze**, të cilat mund të jenë çdo gjë por kurrë bashkim popullor… **Koha e tradhtuar e epokës së socializmit i ktheu 60 qytete të Shqipërisë**, të ndërtuara pas luftës, me pamjen e varrezave të mëdha, pa ujë e pa dritë, plot plehra e krime, **plot lot e gjëmë**, plot fukarenj e lypsa… Sot truri i kombit, komisarët e dritës, pedagogët, armata e intelektualëve popullorë, u arratis nga Shqipëria për të fshirë e larë nevojtoret e Evropës e të Botës për një pagë sa për ta mbajtur gjallë shpirtin. Dhe kush mund ta merrte me mend se sa shumë armiq paska pasur Shqipëria, e cila kishte arritur të mposhtë bllokadat e jugosllavëve më 1948, të sovjetikëve më 1960 dhe të kinezëve më 1978, dhe nuk kapitulloi, sepse në Shqipëri çdo qytetar ishte USHTAR dhe çdo ushtar QYTETAR. Sot në Shqipëri po shemben monumentet e heronjve dhe po ngrihen monumente kriminelësh… Nëpër

burgjet e Shqipërisë sot po kalben dhe po vdesin heronjtë veteranë të luftës antifashiste duke na lënë porosinë: JINI VIGJILENTË, FASHIZMI ËSHTË GJALLË!

ꕥ

Viktor Ygoi i madh thoshte:

VDEKJA MË E TMERRSHME ËSHTË VDEKJA PA LUFTË NË SHESHIN E LUFTËS!

ꕥ

Serbia sot është kompromettuar shumëfish, me tërë botën… Të kujtojmë Vietnamin e viteve 1974 kur e kishte tërë botën në përkrahje, dhe Amerikën kundër, dhe në fund Vietnami arriti të triumfojë mbi superfuqinë botërore – Amerikën…

ꕥ

Sot një rrogë mesatare ka rënë në 45 dinarë (1 din – 1 markë), ndërsa dihet se Serbia ka pasur rezerva vetëm për 2-3 muaj (rezervat – paret e DEKËS), sepse ishte pa eksport, pa import, pa prodhim, sepse vlera e të hollave është për aq sa vlen qarkullimi i mallit, bilanci tregtar negativ, dhe këtë bilanc po e mbajnë edhe ndonjë ditë rezervat, sepse një punëtor e ka mëditjen 1 markë, ndërsa 50% e punëtorëve janë në asistencë… **Por Serbia po e plaçkit Kosovën në mënyrën më barbare me një vlerë prej miliarda marka gjermane, tërë kapitalin e deponuar në bankat jugosllave dhe tërë punën e kaluar të punëtorëve e pensionistëve të te gjitha kategorive.**

Ekonomia e Kosovës po i afrohet gjendjes së viteve 1950, e pas pak do të arrijë deri në gjendjen e viteve 1945, ose të vitit 1941, kur në tërë Kosovën kanë punuar vetëm dy SHARRA… Punëtorët serbë janë pa vetëdije klasore, me një vetëdije të çoroditur me infektimin e fesë, bogosllovisë, me

kafshatën shpirtërore – SVETI SAVËN… Dhe kështu populli serb u bë skllav i traditave 600-vjeçare pansllave, me shpirtin e Sveti Savës, dhe ky destruktivitet mund të kthjellohet vetëm me një goditje të FORTË, sepse kthetrat e helmatisura të traditës 600-vjeçare janë ngulitur thellë në ndërgjegjen e serbëve…

Ushtrinë jugosllave e mbajti Amerika nga viti 1948-1953, ndërsa nga viti 1953-1991 e mbajtën dy superfuqitë botërore – Amerika dhe Rusia (BRSS), por edhe Evropa, dhe e modernizuan tërë armatimin e ushtrisë jugosllave për të bërë luftë për 2-3 vjet pa u ndalë… Dhe Beogradi është bërë një shtab i projektimeve më monstruoze… SHBA-ja e shpërbleu Jugosllavinë si agjenturën më të devotshme antikomuniste me **260 miliardë dollarë (?!),** dhe Beogradi për 40 vjet me radhë ishte qendra e CIA-s amerikane për tërë Ballkanin…

ꕥ

Në Egjipt 15% flitet gjuha KOPTE – gjuha e kishës, e liturgjisë, gjuhë **hamite...**

KOMBI si kategori historike merret në kuptimin e sotëm pas vitit 1789 (14 korrik 1789)…

Rrënjët e KUNDËRREVOLUCIONIT në Jugosllavi nuk duhen kërkuar vetëm në vitin 1948, me Rezolucionin e Informbirosë, por qysh para luftës, në pikëpamjet **oportuniste e deviante të komunistëve jugosllavë,** në lidhjen e tyre të ngushtë me imperialistët anglo-amerikanë, pastaj në Mbledhjen e Dytë të KAÇKJ-së, të mbajtur në Jajcë më 29. 11. 1943, me ç'rast as që u bë fjalë për çështjen e Kosovës… Dhe për t'iu hequr peta lakrorit, për të dalë për fushë, aradhet serbomalazeze e maqedone RIPUSHTUAN Kosovën dhe viset tjera shqiptare mbi të cilat u vendos pushteti ushtarak pushtues, pastaj u mobilizuan me dhunë mijëra djem të nënave shqiptare dhe u dërguan në Tivar, ku u masakruan në mënyrën më mizore **mbi 4310 rekrutë më 2 prill 1945...** Dhe kështu

edhe Jugosllavia titiste u shndërrua në NEOKOLONI të imperializmit amerikan e evropianoperëndimor dhe të socialimperializmit sovjetik… Por edhe kjo krijesë artificiale e quajtur Jugosllavi u shkërmoq si një kullë prej kartoni pas shpërthimit të luftës në Slloveni, Kroaci, Bosnjë, e së shpejti do të shpërthejë edhe në Kosovë dhe viset tjera… Ky është vetëm fillimi… Por triumfi i REVOLUCIONIT kurrë dhe në asnjë vend nuk ka pasur sukses aty ku nuk janë themeluar celulat e PARAROJES REVOLUCIONARE, të domosdoshme për ta shporrur zgjedhën e kolonializmit jugosllav dhe për ta vendosur rendin e ri të barazisë sociale, duke i goditur për vdekje tradhtarët dhe kolaboracionistët e të gjitha ngjyrave…

ꕥ

LIGJËRIME, 9 shtator 1995:

Më të moçmit në Evropë janë Baskët, Ilirët, pastaj në Azi Dravidët etj. Ilirët shtriheshin deri në malet e Shvarzwaldit në Gjermani, por u asimiluan shekull pas shekulli dhe arritën të shpëtojnë rreth 10% e tyre… Por ne edhe sot e kësaj dite jemi rreziku më i madh i vetvetes… Ende nuk po na pranon asnjë shtet, sepse nuk po kanë hesap, ndërkaq ne duhet të jemi shumë aktivë çdo ditë e çdo orë… Bile as **Shqipëria nuk po ka hesap të na pranojë kështu siç jemi**, ndaj duhen sakrifica të mëdha. Ndërsa ne jemi tepër pasivë, ende po bëjmë gara se kush do të kërcejë më lart për të rënë në lak, për t'u varë në litar, duke i bërë të shtatat, të dyzetat, pastaj me syneti e dasma, me biznes, me transport mafioz përmes agjencive kolaboracioniste e kuislinge përmes të cilave po zbrazet Kosova nga popullsia më vitale…


Shënime nga ligjëratat
e profesor Qazim Berishës
Berliner
Sparkasse



Fragment nga shënimet e autorit të datës 5.12.1987



Fragment nga shënimet e autorit të datës 26.12.1987

FRAGMENTE KUJTIMESH TË AUTORIT NGA LIGJËRIMET E PROF. QAZIM BERISHA

Në plejadën e ndritur të pishtarëve të arsimit dhe shkollës shqipe një vend me rëndësi të posaçme zë edhe profesor Qazim Berisha, jeta dhe vepra heroike e të cilit ishte e tëra në shërbim të Atdheut. Kujtimet e mia për profesorin liridashës janë të shumta e të paharrueshme sepse që nga vitet e shtatëdhjeta (kur profesori Qazim ligjëronte në Gjimnazin e Prizrenit, e unë në Shkollën Teknike dhe Normale) e deri në ditën kur ai u nda prej nesh, për të mos vdekur kurrë, na lidhi ideali revolucionar. Shokët më kishin folur shumë për të, dhe mezi prisja ta takoja profesorin dritëdhënës. Dhe që në takimin e parë më bëri përshtypje pamja e tij e jashtme, trupi i tij mesatar dhe fytyra e qeshur, me sy shqiponje e shikim depërtues, me fytyrë pak të zeshkët, i veshur pa bujë, i pastër dhe elegant. Dëgjonte i përqendruar. Kur e merrte fjalën, më bënte përshtypje të thellë për njohuritë enciklopedike që kishte për probleme e fusha të ndryshme të dijes. Me sjelljet dhe qëndrimin e tij të lirshëm, me fjalën e ëmbël dhe plot dashamirësi, më la përshtypjen e një intelektuali largpamës që unë nuk kisha pasur rastin të njihja edhe ndonjë të tillë si Ai deri atëherë. I kam të pashlyera në zemër e në mendje ato takime, ato biseda të ngrohta e dashamirëse, ato çaste e ditë aq të bukura në jetën time. Isha plotësisht dakord me të për të gjitha çështjet. Me kalimin e viteve shtohej edhe nderimi dhe dashuria për mësuesin tim të shtrenjtë, dhe më dukej vetja tepër i vogël para këtij eruditi kolosal, dhe me shumë ndrojtje merrja guximin t'i shtroja edhe ndonjë pyetje, sepse Ai na i thoshte të tërat, edhe pa e pyetur, dhe më bëhej sikur m'i lexonte mendimet se çfarë do ta pyesja, dhe ligjëronte pa u lodhur me orë të tëra. Por ku mund t'i mbaja në kokë gjithë ato dije që na i jepte, dhe pas një kohe fillova të mbaja edhe shënime, por me lejen e tij, për gjithë ato ligjërime që na i mbante, sepse e dija se një ditë kujtimet

do më ikin nga mendja, si zogu që të ikën nga dora, e nuk mund t'i kapësh më. I merrja këto ligjërime të tij nga dita në ditë, ashtu siç e thith bleta nektarin nga lulet, dhe kështu sa herë etesha për dije, shpalosja këto dorëshkrime, dhe pothuaj përherë isha i pandarë nga kjo enciklopedi e gjallë. Kështu mësuesi Qazim u fut në qenien time dhe shëtiste nëpër damarët e gjakut tim, nëpër mendjen time plot të panjohura. Të tillë si unë profesori kishte shumë nxënës, në ato dyzet gjenerata nxënësish e studentësh.

Me fundin e tij tragjik, nën oshtimën e breshërive të granatimeve, me ç'rast xhamat e dritareve ishin bërë copë e thërrime, **më 6 prill 1999**, zemra e madhe e profesorit pushoi së rrahuri – ai e fitoi përjetësinë. Në mesin tonë nuk e kishim më mësuesin e palodhshëm, i cili na kishe mëkuar siç e mëkon mëma fëmijën e saj të mitur për vite të tëra. Por mungesën e Tij fizike unë e plotësoja duke shfletuar dhe sistemuar dorëshkrimet që kisha marrë për vite të tëra. Dhe këtë punë arrita ta bëja deri më datën 5 qershor 1999, kur hordhitë gjakpirëse të soldateskës serbe u futën në banesën time përdhese, dhe të prangosur, nën tytat e automatikëve, më nisën për në burgun e Prizrenit. Bashkë me mua xhelatët konfiskuan mijëra dorëshkrime, libra, dokumente, fotografi, videokaseta, vëllimet e dorëshkrimeve që i kisha marrë nga profesori Qazim, dhe ato që kisha shkruar për katër vëllimet e librave **– GJAKU I LIRISË**, dhe çdo gjë tjetër që ishte pjesë e jetës sime, në burgun kolektiv me emrin Kosovë. Por, një shpresë të madhe e kisha në faktin se të paktën do shpëtonin nga dora gjakatare ato pak shënime që kisha vendosur në bodrumin e banesës, ku soldateska barbare nuk kishte shkuar, pasi kishte mbushur dy kamionë me libra e dokumentacion të llojllojshëm, dhe na kishte nisur drejt burgut skëterrë. Pasi kisha mbijetuar skëterrën fashiste në burgun-varr, pa ujë e pa bukë, deri më 9 qershor 1999, pasi kisha triumfuar mbi vdekjen, dhe kur thundrat e gjakpirëseve kishin ikur nga Kosova, në çastin kur më 16 qershor u ktheva i gjallë në banesë, dhe pasi përqafova nënën time 90 vjeçe dhe vajzën

time, për të cilat ende nuk dija se a kanë shpëtuar gjallë, u nisa drejt bodrumit, dhe për befasinë time i gjeta ato pak dorëshkrime nga ligjëratat e profesorit Qazim Berisha, **e që nuk përbënin as 10%** të te gjitha atyre vëllimeve që kishin konfiskuar xhelatët. Kështu shpëtuan si **hiri i zogut feniks** ato pak shkrime, si simbol feniksian i ringjalljes nga katrahura, për t'u shpënë brezave ato pak thërrime dijesh, ato rreze drite, ato shkreptima diturie, pjesë e pavdekësisë së profesorit – simbol qëndrese e flakadan lirie.

Edhe sot, në dhjetëvjetorin e përjetësisë së profesorit Qazim Berisha, më pushton ndjenja e përgjegjësisë dhe detyrimit për t'ia kthyer një pjesë të vogël të borxhit, duke ia lënë në dispozicion lexuesit të nderuar këto pak dorëshkrime të ligjërimeve të cilat i shpëtuan zjarrit të barbarisë serbe, por gjithnjë me bindjen se nuk e kam arritur të realizoi **as të njëmijtën pjesë të asaj që e meriton ky kolos dritëdhënës**. Me siguri këto fragmente dorëshkrimi do të rizgjojnë kujtimin e ëmbël për figurën e ndritshme të profesorit Qazim Berisha, dhe sidomos për ata të cilët nuk kanë pasur fatin ta njohin më për së afërmi këtë profesor gjenial të përmasave kombëtare. Prandaj, është më se e arsyeshme dëshira dhe kërkesa e gjeneratave të reja për të ditur dhe për të mësuar sa më shumë për jetën dhe veprën e simboleve të qëndresës kombëtare, dëshmorëve dhe heronjve të kombit. Aq më tepër kjo dëshirë merr vlera dhe bëhet imperativ i kohës, sidomos sot, kur vlerat tona kombëtare, fitorja e lavdishme e UÇK-së, si dhe gjaku i dëshmorëve, janë vënë në rrezik nga klasa kolaboracioniste, nga ata që dje jo vetëm ishin kundër luftës çlirimtare, por edhe e penguan dhe sabotuan zhvillimin e saj në të gjitha format dhe me të gjitha forcat. Derisa heronjtë e vërtetë injorohen, në anën tjetër edhe tradhtarët shpallen heronj (ata që i bënë homazhe dhe nderime kriminelëve serbë), dhe në anën tjetër injorohet Adem Jashari dhe heronjtë tjerë të kombit, dhe po përgatiten dosjet për denoncimin e luftëtarëve të UÇK-së dhe dërgohen në Gjykatën e Hagës. E dihet se heronjtë

dhe dëshmorët, me shembullin e tyre, duhet të bëhen simbol frymëzimi, shembuj të lartë vetëmohimi dhe edukimi të brezit të ri. Prandaj, edhe ky libër që e keni në dorë, del në dritë me këtë qëllim fisnik, sepse porosia e madhe e dëshmorëve dhe gjakut të derdhur me shekuj ende nuk është çuar në vend. Trojet e robëruara shqiptare ende nuk janë çliruar tërësisht dhe po përpëliten në udhëkryq. Fati i tyre vazhdon të jetë i lidhur në rezoluta (si 1244) të padefinuara, të cilat pengojnë pavarësinë e plotë dhe bashkimin kombëtar.

ꕥ

Në vijim të këtij shkrimi do përpiqemi t'i përmbledhim shkurtimisht disa çështje për të cilat na kishte dhënë informacione të pakursyera dhe të argumentuara në dritën e materializmit dialektik profesori dritëdhënës, Qazim Berisha. Jemi plotësisht të vetëdijshëm se nga gjithë ato leksione të pakursyera që na i ka dhënë për vite të tëra, këto që do i japim janë vetëm ca thërrime e copëza nga tryeza universale e profesorit legjendar. Nga burimet e freskëta të këtij **Olimpi dituror** ne dhe gjeneratat vetëm mund t'i lagim buzët, nga ato pakëz pika që shpëtuan pa u tretur nga kujtesa jonë. Me një stil lapidar, me një oratori të përsosur, profesori u jepte dritë dhe ajër leksioneve të tij aq njerëzore dhe me një thjeshtësi mahnitëse.

Gjatë ligjërimeve të tij profesori Qazim na shpjegonte se njeriu për të jetuar e ka të domosdoshme të orientohet në morinë e sendeve dhe dukurive që e rrethojnë, dhe se për t'u orientuar drejt dhe për të formuar një **BOTËKUPTIM TË DREJTË** për botën në tërësinë e saj, për forcat që veprojnë në të, duhen dije shkencore, armatosja me dije dhe botëkuptim shkencor revolucionar. Kështu njeriu e shpjegon botën nga vetë ligjet e saj, duke treguar edhe rrugët për transformimin e saj revolucionar. Në shoqëritë shfrytëzuese të së kaluarës dhe të sotmes, ka sunduar e sundon botëkuptimi IDEALIST dhe ai fetar, të

cilët e shpjegojnë botën me ndihmën e ideve të ndryshme idealiste dhe fetare, të cilat u shërbejnë klasave sunduese për të mbajtur nën sundim masat punonjëse. Ndërkaq botëkuptimi revolucionar materialist mbi botën ndihmon për të kuptuar drejt të sotmen, për të parashikuar shkencërisht të ardhmen dhe për të përcaktuar rrugët më të përshtatshme për arritjen e objektivave. Pa këtë armë ideore të pazëvendësueshme proletariati botëror nuk mund ta përmbysë rendin shfrytëzues ekzistues dhe nuk mund ta marrë pushtetin në duart e veta. Por që kjo FILOZOFI (Filozofi – në përkthimin e fjalëpërfjalshëm – dashuri për dituri) materialiste shkencore të shërbejë si armë ideore për transformimin revolucionar të shoqërisë, është e domosdoshme të njihet nga masat dhe të bëhet pronë e tyre (K. Marks: **TEORIA BËHET FORCË MATERIALE, vetëm kur ajo përvetësohet nga masat).** Ndërkaq V. Lenini thoshte se rruga dialektike e të njohurit të botës shkon – prej të vërejturit e gjallë nga të menduarit abstrakt, dhe prej tij nga praktika. Nga kjo del se problemi themelor i filozofisë kërkon të zgjidhet raporti në mes MATERIES dhe NDËRGJEGJES, qenia me mendimin, trupi me shpirtin. Zgjidhja e vetme e drejtë e këtij problemi themelor të filozofisë është se: MATERIA PËRCAKTON NDËRGJEGJEN. Në pozitat e kundërta me filozofët materialistë dialektikë qëndrojnë fetë dhe idealistët e ndryshëm. Nga kjo del se nuk janë mendimet, idetë e njerëzve të shquar PËRCAKTUESE TË FATIT TË NJERËZIMIT, por veprimtaria materiale e revolucionare e masave punonjëse, që shpie përpara shoqërinë, revolucioni shoqëror. Sipas përfytyrimeve primitive, JETA dhe VDEKJA e trupit përcaktohen nga SHPIRTI (ndërgjegjja), i cili qenka i pavdekshëm. Këta njerëz besonin në një botë plot qenie të padukshme, që për ta ishin reale sa edhe sendet e dukshme që ata perceptonin. Duke mos ditur të shpjegonin se si lindin sendet dhe dukuritë e botës, arrinin në përfundim se ato i ka krijuar diçka që nuk mund të shihet nga njeriu, që qëndron mbi natyrën. Kjo ide është

quajtur nga fetë – **ZOT ose PERËNDI**, dhe kështu për çdo dukuri të natyrës njerëzit primitivë krijuan zotin përkatës, si: **zoti i dritës, zoti i errësirë, zoti i erës, i shiut, i detit etj**., që komandonin dukuritë përkatëse natyrore. Më vonë u kalua në besimin në një zot, por sidoqoftë kjo nuk ndryshon thelbin e çështjes, sepse feja ka qenë dhe ka mbetur një shpjegim i shtrembër, i gabuar i botës, një shpjegim fantastik i saj. Kështu si përfundim del se NDËRGJEGJJA ka lindur në një etapë të caktuar të zhvillimit të materies, dhe se ndërgjegje ka vetëm njeriu. Materialistët tjerë të cilët e fshinin dallimin midis materies dhe ndërgjegjes F. Engelsi i quante MATERIALISTË VULGARË, sepse materia dhe ndërgjegjja s'mund të identifikohen, sepse ndërgjegjja është FUNKSION i trurit; pa tru s'ka ndërgjegje që do të thotë se ndërgjegjja është pasqyrim i botës së jashtme në trurin e njeriut, duke pasur si burim materien. Ndërgjegjja lind si rezultat i zhvillimit të gjatë të materies. Kështu filozofia materialiste dialektike e gjen shpjegimin e botës në vetë botën, në vetë realitetin objektiv. Materialistët e lashtësisë, materialistët naivë, elementet si uji, zjarri ajri etj. i konsideronin fillestare. Kështu p.sh., **Herakliti** (544-483 p. e. re.) thoshte se bota në tërësi, bile edhe shpirti i njeriut, lind nga zjarri dhe shndërrohet në zjarr. Ndërkaq sipas materializmit atomistik të **Demokritit** (460-370 p. e. r.) baza e gjithçkaje janë atomet, thërrmija të vogla, të pandashme. Ideja e Demokritit për strukturën atomike të lëndës u mbajt në shkencë për 2400 vjet, deri në fund të shekullit të kaluar, kur u zbulua ELEKTRONI, dhe me këtë fizika provoi se ATOMI nuk është i pandashëm, por përbëhet nga thërrmija akoma më të vogla. Në këtë kontekst materializmi dialektik duke parë ekzistencën objektive si vetinë themelore të materies potencon se LËVIZJA, HAPËSIRA dhe KOHA janë veti të brendshme themelore të materies. Engelsi na mëson se: Lëvizja e materies është nxehtësi dhe dritë, tension elektrik dhe magnetik, sintezë dhe analizë kimike, jetë dhe më në fund, NDËRGJEGJE".

ꕥ

Profesori na përkujtonte fjalët e shkencëtarit **Jacques Monod** (Zhak Mono) biolog i fushës së gjenetikës, fitues i **çmimit Nobël**, nga libri i tij - LE MASARDET LA NECESSITE-RASTËSIA DHE DOMOSDOSHMËRIA (shih - Zhak Mono:Slluçajnost i nuzhnost, Beograd 1983) i cili veç tjerash kishte thënë:

Kur lexova fjalët e Demokritit(460-370 p. ep. re)- ÇDO GJË QË EKZISTON NË BOTË ËSHTË PRODHIM I RASTËSISË DHE DOMOSDOSHMËRISË", i mahnitur nuk munda t'i ndalë lotët dhe thashë - si është e mundur me u përputh thënia e Demokritit me rezultatet e mia shkencore....Profesori na fliste me admirim për Demokritin, këtë filozof materialist të Greqisë së Lashtë, "mendja e parë enciklopedike midis grekëve"(K.Marks), themelues i materializmit atomistik, sipas të cilit zanafilla e çdo sendi që ekziston janë ATOMET, grimca të materies, në lëvizje të vazhdueshme. Ky filozof e kishte hedhur poshtë idenë e krijimit të botës nga ZOTI, dhe thoshte se bota nuk ka fund, nuk ka fillim në kohë dhe nuk është e kufizuar në hapësirë. Lindja dhe shkatërrimi i "botëve", sipas Demokritit, bëhet nëpërmjet rrugës së natyrshme, për shkak të DOMOSDOSMËRISË. Demokriti e mohonte RASTËSINË, të cilën e quante pasojë të padijes, të mosnjohjes së SHKAKUT...

ꕥ

Në lëvizje është edhe shoqëria njerëzore e cila përmes revolucionit kalon nga një rend i mëparshëm në një rend të ri më të përparuar. Nevojat e njeriut zgjerohen së bashku me zhvillimin e shoqërisë. Janë rritur kërkesat e punonjësve për librin, për artin, për sportin, për shkencën etj. Në çdo hap, në çdo veprim që bën, njeriu udhëhiqet nga një QËLLIM i caktuar. Nxënësi vjen në shkollë me qëllim që të fitojë dije dhe kulturë, që këto pastaj t'i vërë

në shërbim të ndërtimit progresiv të shoqërisë. Por, për të arritur qëllimet e caktuara, duhet VULLNET, i cili është ajo anë e jetës shpirtërore, ai element i ndërgjegjes që e vë në lëvizje njeriun në veprimet e tij për të arritur qëllimin e paracaktuar. Njeriu me vullnet të FORTË i bën ballë dhembjeve fizike, kapërcen me sukses vështirësitë në punë dhe në mësime, qëndron në radhët e para në luftën për çlirimin e Atdheut dhe fitoren e revolucionit shoqëror. FORCA E VULLNETIT varet nga drejtësia dhe vlera e qëllimit. Sa më i drejtë është qëllimi, sa më i vlefshëm është ai për shoqërinë, aq më i fuqishëm është edhe vullneti që vihet në shërbim të plotësimit të tij. Rruga për forcimin e një vullneti të fuqishëm është EDUKIMI i njeriut me idealin e lart liridashës, atdhetar e njerëzor, shtonte profesori liridashës, dhe vazhdonte më tej:

Domosdoshmëria e bashkëveprimit të veprimtarisë shoqërore prodhuese lindi tek njerëzit nevojën për t'i thënë diçka njëri-tjetrit. Kjo nevojë lindi GJUHËN si mjetin me anën e të cilit njerëzit shprehin mendimet e tyre. Gjuha dhe mendimi janë të lidhur reciprokisht, kanë lindur njëkohësisht. Gjuha është po aq e vjetër sa edhe ndërgjegjja. MENDIMI nuk ekziston dhe s'mund të realizohet pa gjuhën, gjuhën e folur, kur bisedon me të tjerët, gjuhën e shkruar, kur shkruan një letër ose harton një artikull, dhe gjuhën e brendshme, kur njeriu mendon me vete (artikulim i tingujve që nuk dëgjohen). Po harrove fjalën, edhe mendimi zhduket. **Fjala** që nuk shpreh **mendim, dhe përmes atij mendimi nuk e thotë një të vërtetë të realitetit objektiv, është një tingull i zbrazët, është një zhurmë.**

Rendi i ri i marrëdhënieve në prodhim, duke zhdukur shfrytëzimin e njeriut nga njeriu, ndryshon edhe karakterin e PUNËS. Puna mendore dhe ajo fizike marrin një kuptim të ri, ato harmonizohen, dhe nuk është puna GJYMTIM mendor e fizik i punonjësve siç ishte në rendin borgjez. Tani puna bëhet bazë për lindjen e ndjenjave të fuqishme dhe tipareve të larta morale. **Kryerja e një pune në dobi të**

shoqërisë bëhet burim gëzimi. Në punë forcohet dhe lind dashuria për shokun, solidariteti, dashuria e zjarrtë për Atdheun. Aksionet revolucionare përmes punës luftojnë parazitizmin, mërzinë, pesimizmin, luftojnë shfaqjet negative në ndërgjegje si: idealizmin, besimet fetare, patriarkalizmin, zakonet prapanike, ndjenjat egoiste mikroborgjeze, interesin e ngushtë vetjak etj., dhe mprehin vigjilencën dhe shtojnë urrejtjen për armiqtë, sabotatatorët, vjedhësit. Edukimi i njeriut të ri është proces i gjatë dhe i vështirë, por plotësisht i realizueshëm në kushtet e reja të marrëdhënieve në prodhim, ku rol të rëndësishëm luajnë puna edukative e organizatave të masave, kultura, letërsia dhe arti, si dhe shtypi, radiotelevizioni. Rol të rëndësishëm në kalitjen e ndërgjegjes tek brezi i ri luan SHKOLLA, detyrë kryesore e së cilës është edukimi e kalitja revolucionare e rinisë. Bindja, kritika dhe autokritika janë forma të luftës kundër shfaqjeve të huaja që synojnë shërimin dhe forcimin e ndërgjegjes.

Profesori më tej na shpjegonte se i vetmi shikim i drejtë e shkencor i shoqërisë është ai materialist-dialektik. Në dallim nga mendimtarët e mëparshëm, që shqyrtonin idetë e shoqërisë dhe mjaftoheshin me grumbullimin e fakteve, **Marksi** studioi në mënyrë të thelluar se çfarë fshihet prapa ideve e dëshirave të njerëzve, cili është SHKAKU, burimi, ç'pasqyrojnë dhe nga se varen ato, dhe nga këto studime ai nxori konkluzionin shkencor se QËLLIMET, IDETË, PIKËPAMJET e njerëzve e kanë bazën në kushtet e jetesës së tyre, janë pasqyrim i kushteve ekonomiko-shoqërore në të cilat njerëzit jetojnë e veprojnë. Dhe si të jetë mënyra e jetesës së njerëzve, kushtet e jetesës së tyre, **QENIA E TYRE SHOQËRORE**, ashtu janë pak a shumë edhe idetë, pikëpamjet e qëllimet e tyre. Marksi ka thënë **se "Nuk është NDËRGJEGJJA e njerëzve që përcakton QENIEN e tyre, por përkundrazi, qenia e tyre shoqërore përcakton ndërgjegjen e tyre".** Më këtë konkluzion ai zgjidhi në mënyrë materialiste problemin themelor të filozofisë në jetën shoqërore. Ky konkluzion materialist

dialektik i vërtetuar nga PRAKTIKA na bind se zhvillimi historik i shoqërive me ndryshimin e QENIES SHOQËRORE, të jetës materiale ka ndryshuar edhe NDËRGJEGJA e njerëzve, idetë dhe pikëpamjet e tyre. Në shoqërinë me klasa përmbajtja e ideve dhe e pikëpamjeve politike, juridike, filozofike të njerëzve e klasave përcaktohet nga INTERESAT EKONOMIKE të klasave. Thelbin e qenies shoqërore e përbën sistemi i MARRËDHËNIEVE ekonomike të shoqërisë. Kjo do të thotë se nga **MARRËDHËNIET NË PRODHIM** përcaktohet pozita e klasave në shoqëri. Në rendin kapitalist borgjezia është pronare e mjeteve të prodhimit, prandaj dhe siguron pasuri kolosale, ka një pozitë sociale sunduese, ka në dorë tërë aparatin shtetëror. Proletariati, i zhveshur nga mjetet e prodhimit, karakterizohet nga mjerimi e varfëria, shtypet e shfrytëzohet nga borgjezia, është i zhveshur nga pushteti politik. Por me përmbysjen e marrëdhënieve ekonomike borgjeze e të pushtetit politik të borgjezisë, **dhe me vendosjen e diktaturës së proletariatit e marrëdhënieve socialiste në prodhim,** ndryshon edhe pozita ekonomiko-shoqërore e klasave dhe e njerëzve.

Profesori erudit na fliste me orë të tëra për **REVOLUCIONET** shoqërore, për revolucionin francez të vitit 1789 i cili kishte karakter borgjez antifeudal, sepse drejtohej kundër bazave ekonomike e politike të feudalizmit dhe i hapte rrugën zhvillimit kapitalist. Na shpjegonte lidhur me revolucionin e qershorit të vitit 1924 në Shqipëri, në krye me Fan Nolin, ndonëse ai dështoi. Ndërkaq, Revolucioni i madh i Tetorit, që u bë më 1917 në Rusi, kishte karakter socialist, sepse i udhëhequr nga **V. I. Lenini** arriti të përmbysë klasën feudoborgjeze dhe të vendos rendin e ri socialist. Pastaj ai na fliste për revolucionin proletar francez të vitit 1871, që krijoi **KOMUNËN E PARISIT**, e cila arriti të jetojë vetëm 71 ditë, sepse reaksioni ndërkombëtar u bë një dhe e sulmoi nga të gjitha anët proletariatin e Parisit. Marksi revolucionet i quante në mënyrë figurative – **"LOKOMOTIVA TË**

HISTORISË", të cilat e çojnë historinë e njerëzimit përpara, ndërsa V. I. Lenini revolucionet shoqërore i quante – **FESTA E TË SHTYPURVE DHE TË SHFRYTËZUARVE.** Faktori objektiv numër një i shpërthimit dhe Fitores së revolucionit është KRIZA e përgjithshme nacionale, e cila përfshin edhe të shfrytëzuarit dhe shfrytëzuesit. Shembulli i Shqipërisë tregon, para së gjithash, se edhe në një vend të vogël e të prapambetur, me një klasë punëtore të vogël e të paformuar mirë, mund të formohet **Partia marksiste-leniniste**, e cila është e vetmja forcë e aftë të realizojë rolin HEGJEMON të klasës punëtore në revolucion. Por ngjarjet e këtyre dekadave të fundit tregojnë, gjithashtu, se si kanë DËSHTUAR lëvizjet revolucionare të klasës punëtore në rastet kur ato nuk janë krye e zhvilluar nën hegjemoninë e proletariatit dhe nën udhëheqjen e Partisë së tij marksiste-leniniste. Në asnjë nga këto vende (përveç **Shqipërisë**, ku Partia e Punës është pararoja e klasës punëtore, është forca e vetme politike e shtetit dhe shoqërisë), në Evropë, në Afrikë, në Azi ose gjetkë, revolucioni demokratik antikapitalist nuk është çuar gjer në fund, dhe në këto vende nuk kemi të bëjmë aspak me rend socialist. Shembulli i Bashkimit Sovjetik dhe vendeve tjera socialiste, ku është rivendosur plotësisht kapitalizmi e ku klasa punëtore shtypet e shfrytëzohet egërsisht nga diktatura e borgjezisë, tregon më së miri se ç'pasoja katastrofike sjell për klasën punëtore e socializmin uzurpimi i udhëheqjes së partisë e diktaturës së proletariatit nga KLIKA TRADHTARE revizioniste, dhe konvertimi i partisë marksiste-leniniste në parti borgjezo-revizioniste. Në këtë mënyrë elementët antisocialistë, të cilët kryen KUNDËRREVOLUCION "paqësor" në Bashkimin Sovjetik dhe vendet tjera ish-socialiste, bënë kështu të mundur atë që nuk mundi ta realizonte LUFTA E ARMATOSUR e armiqve. **Lenini** ka theksuar se **"Kur bëhet revolucioni nuk ndodh ashtu siç ndodh kur vdes një njeri, i cili pasi vdes nxirret përjashta. Kur vdes shoqëria e vjetër, kufoma e saj nuk mund të**

futet në ARKIVOL dhe të çohet në VARR. Ajo dekompozohet midis nesh, kjo kufomë kalbet dhe na moleps edhe vetë ne". Ndërkaq, në rastin e Shqipërisë armiqtë e jashtëm po praktikojnë metoda diskriminuese në marrëdhëniet tregtare, nuk u përgjigjen kontratave në fushën e tregtisë, pengojnë eksportet dhe nuk pranojnë të shesin shumë nga ato mallra që ne kërkojmë të blejmë. Armiqtë e jashtëm me praktika të tilla synojnë të minojnë realizimin e planit, të krijojnë shpërpjesëtime në zhvillimin e degëve të ekonomisë dhe vështirësi tjera për shkatërrimin e socializmit në Shqipëri. Për të çarë këtë rrethim dhe bllokadë kapitalisto-revizioniste shtrohet me forcë nevoja për rritjen e vigjilencës dhe e marrjes së masave të gjithanshme duke zbatuar me vendosmëri parimin e mbështetjes në FORCAT E VETA. Qëllimi i armiqve është të shthurin frontin tonë të hekurt të luftës dhe të nxisin e inkurajojnë elementët kundërrevolucionarë. Për këtë qëllim armiqtë e jashtëm borgjezo-revizionistë bëjnë përpjekje të jashtëzakonshme për të vënë në shërbim të tyre mjetet e format e propagandës së shfrenuar si radion, televizionin, filmat, shtypin, përfaqësitë diplomatike e tregtare, turistët, marinarët, shoferët, grupet kulturore e sportive, komunikimet postare etj. I gjithë ky agresion i madh funksionon ditë e natë. E dihet se **ARMIKU MË I RREZIKSHËM ËSHTË AI QË HARROHET.** Patriotizmi i vërtetë (e jo pseudopatriotizmi) kërkon ta njohësh, ta urresh dhe, në radhë të parë, të **përleshesh dhëmb për dhëmb me armikun.** Kjo kërkon që të jesh gjithmonë vigjilent ndaj armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Që të jesh ushtar i mirë për atdheun e popullin duhet të kalitësh trupin fizikisht, **të mos sëmuresh kurrë**, të durosh çdo situatë të vështirë në çdo çast dhe ta kapërcesh atë, të jesh i zoti të rrosh, të rendësh, të flesh, të luftosh në borë, në shi, në furtunë, në diell, i veshur e i zhveshur, me këpucë e pa këpucë, i ushqyer ose i uritur. Këtë gjë e lyp mbrojtja e atdheut. Mbrojtja e Atdheut ka qenë dhe mbetet detyrë mbi detyra, na mësonte profesori i

pavdekshëm Qazim Berisha, të cilit i bëhej zemra mal kur dëgjonte këngën e Fatime Sokolit:

Pyet Evropa e pyet Ballkani,
kush po i prin këtij karvani?
Nji Parti, trimnesh'e rrallë,
Enver Hoxha gjithmon'n'ballë.
Me të shekujve zgjasim hapin,
me rrufet' forcat i matim.
Dhe njiher'qe besa jonë:
na ke mbrapa njishkolonë.
Vrulli yn'nuk mund të ndalet,
sup më sup jem'lidh si malet.
Për rrethimin n'katër anët,
kemi zemrat bash si armët.
Le ta dij pra mir'tradhtia,
pushkën top e ka Shqipnia.

Poashtu, iu kishte bërë zemra mal nga fjalët e zjarrta të plakut nga Valbona i cili kishte thënë se sot Shqipëria s'ka dy milionë, **por dyqind milionë**, këtu edhe **toka qet zjarr, edhe guri qet zjarr, edhe ahu qet zjarr, edhe pushka qet zjarr, edhe zemra qet zjarr, po të japë kushtrimin Enveri** (poezi e Ndoc Paplekës). Dhe kishte të drejtë t'i gëzohej këtij entuziazmi mbarëpopullor të shtetit amë, sepse brenda **gjashtë orëve** Shqipëria mund të mobilizonte **një milionë forca mbrojtëse tokësore, detare e ajrore** (vetëm brenda katër viteve kishin diplomuar 1300 pilotë aviacioni, prej të cilëve 35 kishin rënë dëshmorë gjatë stërvitjeve, kur dihet se shkollimi i vetëm një piloti shtetit i kushtonte 4 milionë dollarë, kurse vetëm motori i një avioni MIG-119 kushtonte një milionë dollarë, ndërkaq vetëm në bazën e aviacionit në Lushnje kishte 400 avionë Mig-21). Kjo forcë kolosale prej 720.000 ushtarësh ishte e aftë për të përballuar çdo agresion të armikut, kur dihej se Shqipëria, veç tjerash, dispononte me një potencial çudibërës **të armëve kimiko-biologjike, prej 16 tonelatash,** dhe kush mund të merrte mbi supe një rrezik e ta sulmonte Shqipërinë. Profesori erudit na fliste me orë të

tëra për heroizmin e kësaj armate titanësh e cila i dha ultimatum armatës ruse të instaluar në bazën e Vlorës më 1960, dhe brenda 24 orëve ushtria ruse iku me turp si lepujt nga toka shqiptare duke lënë edhe **nëndetëset** e tyre në bazën e Pashalimanit. Por skenari i shkatërrimit të Shqipërisë ishte tepër i koordinuar, ishte kjo një strategji makabër e reaksionit ndërkombëtar për të përmbysur gjithë atë kala të ndërtuar me mund e me djersë, me gjak e shumë sakrifica brenda pesëdhjetë viteve të sundimit të demokracisë popullore. **"Qindëshet e zeza"** dhe kolaboracionistët tradhtarë restauruan zgjyrën e zezë të reaksionit ku sot njeriu nuk e ka të garantuar as punën, as shëndetin, as strehimin, as dinjitetin, as jetën. **Më 2 korrik 1990** u hapën dyert e ambasadave për mijëra refugjatë që ikën nga Shqipëria për t'u katandisur në "parajsën" e botës kapitaliste, për të shitur krahun e tyre të punës. Hajdutët dhe reaksioni po bënin gara se kush prej tyre do të shkatërrojë më shumë fabrika e uzina, kush do të presë e shkatërrojë më shumë trupa pemësh frutore si ulliri, portokalli, limoni etj., kush do të shkatërrojë binarët e hekurudhës dhe do t'i dërgojë në Hekuranen e Nikshiqit, sepse për këto punë shkatërruese vetëm Jugosllavia kishte paguar **jo më pak se 17 milionë dollarë**?!

Profesori na fliste pa u lodhur për veprimtarinë heroike të shërbimit inteligjent shqiptar, Sigurimit të Shtetit, dhe sidomos në kohën kur aleatët perëndimorë fillojnë rekrutimin e diversantëve shqiptarë nëpër Kampet në **Greqi, Itali, Gjermani, Belgjikë** etj. , ndërkaq në ato kampe ishin infiltruar agjentët e Sigurimit (Shih: romanin e Nasho Jorgaqit – **MËRGATA E QYQEVE**, ku protagonist kryesor është koloneli i Sigurimit shqiptar **Jusuf Mullai,** me pseudonimin – **Manush Kelmendi**, i cili ua mori tërë dokumentacionin e gjithë kontingjentit të rekrutuarve nëpër ato kampe dhe ua solli Sigurimit të shtetit shqiptar). Ndërkaq, Kim Philbi (Mai Silent War), përgjegjësi britanik në veprimtarinë agjenturore në radhët e shërbimit sekret amerikan, kishte futur në dorë sekrete ushtarake të

karakterit strategjik. Ai udhëhiqte gjithë këtë operacion diversantësh, në bashkëpunim me CIA-n, dhe ia jep në detaje planin operativ të këtij operacioni Sigurimit shqiptar përmes KGB-së, dhe kështu operacioni diversant dështon me turp në vitin 1949. Si pasojë, qeveria shqiptare kundër këtyre kriminelëve ndërmori masa të rrepta ndëshkimore, sepse i kishin edhe listat e bazave diversante, na sqaronte profesori Qazim Berisha.

Pas rrëzimit të shtatores së Enver Hoxhës në Tiranë më 20 shkurt 1991 nga Ladorishta e Strugës na erdhi në vizitë Lebit Murtishi, ish-nxënës i shkollës së Muzikës në Prizren, një veprimtar militant i paepur, dhe bashkë me ish nxënësin tim shkuam ta vizitojmë profesorin Qazim. Bisedë pas bisede, dhe në një çast Lebiti ia bëri këtë pyetje profesorit:



Prof. Lebit Murtishi nga Ladorishta e Strugës, veprimtar i palodhshëm i çështjes kombëtare

Cili nga dy fatosat e kombit është më i merituar,
Skënderbeu apo Enver Hoxha?

Dhe pa u hamendur profesori Qazim filloi ligjërimin me këto fjalë: **Pirrua famëmadh sundoi 25 vjet, dhe bëri epokë si strategu më i madh ushtarak i asaj kohës antike, ndërkaq edhe Skënderbeu me epopenë e lavdishme të qëndresës për 25 vjet bëri epokë me heroizmin** e tij përballë superfuqisë otomane turke, e cila kishte shtrirë sundimin në tri kontinente – Evropë, Azi dhe Afrikë. Por **Enver Hoxha është dy herë më i madh**, sepse mbijetoi me heroizëm të paparë përballë dy superfuqive të kohës, SHBA-së dhe BRSS-së, e më vonë edhe përballë socialimperializmit kinez. Tani po dëgjojmë

dhe lexojmë shumë idiotizma në shtypin e kohës dhe akuzën se **Enver Hoxha "Shiti Kosovën".** Pyetja ime është: **pse, e kishte ai në xhep që ta shiste**? E kundërta është e vërtetë. Për 50 vjet me radhë Shqipëria u penalizua për shkak të qëndrimit konsekuent e parimor në mbrojtje të vëllezërve shqiptarë në Kosovë të cilët po vuanin nën zgjedhën e kolonizatorëve jugosllavë...

Më 19 shtator 1966 Enver Hoxha shkruante:

„... Kosova e viset e tjera shqiptare në Jugosllavi, pjesë të Shqipërisë, u shkëputën nga mëma e tyre prej fuqive imperialiste dhe iu dhanë mbretërisë serbe. KOSOVA ËSHTË SHQIPTARE, MBETET SHQIPTARE DHE I PËRKETË SHQIPËRISË... "

Përveç kësaj, po të kishte qenë kështu, si nuk doli një historian në Perëndim të shtjellonte një tezë të tillë? Dhe mos harroni se gjithë këto broçkulla dhe budallallëqe politike përdoren si monedhë politike nga këta të vetëquajtur politikanë e historianë të mjerë. Dhe shumë njerëz edhe mund t'u besojnë. Po për sa kohë? Kujtoni për një çast fjalët e presidentit amerikan Abraham Linkoln i cili kishte thënë:

„Mund të mashtrosh një pjesë të popullit përgjithmonë, mund të mashtrosh edhe gjithë popullin për njëfarë kohe, por nuk mund të mashtrosh tërë popullin për gjithë kohën".

Jo vetëm kaq, por këta maskarenj të shitur nuk mund të tregoheshin as në nivelin e një **Bogdan Diniçi**, i cili pati guximin të deklaronte në "Zëri i Amerikës" se: **Kosova është sot për serbët ashtu siç ishte lufta algjeriane për francezët. Përqindja e serbëve në Kosovë sot është pak më e vogël se sa ishte përqindja e francezëve në Algjeri. Kosova është de fakto koloni e njëjtë, e fituar më 1913,** ashtu siç u fitua Algjeria nga francezët më 1830… "Por mos të harrojmë se sot batalioni i tradhtarëve kombëtar është hedhur në veprim…

Kjo që sot thuhet për historinë e këtyre 50 vjetëve ka elementet e një farse absurde të inskenuar në mënyrë

fëmijërore. Tani në Shqipëri nuk ka demokraci të vërtetë, por vetëm një iluzion të saj. Atje sot mbizotërojnë ligjet e xhunglës, ANARKIA… Hegeli thoshte: **"Çdo popull ka pushtetin që meriton"**, por ka edhe **pasojat që meriton.** Këta maskarenj po shkojnë edhe më larg duke thënë se Enver Hoxha është më kryekriminel se **Hitleri**, sepse Hitleri vrau e dogji botën për Gjermaninë, ndërsa Enveri vrau shqiptarët për botën?! Populli gjerman i dha votën Hitlerit, u mashtrua keq, dhe e pësoi edhe më keq, sepse ai vrau me miliona hebrenj gjermanë, qytetarë të ndershëm gjermanë; ai vrau edhe komunistë gjermanë, edhe socialdemokratë gjermanë, edhe liberalë gjermanë, edhe katolikë e protestantë gjermanë, edhe romë gjermanë, për hir të **"pastërtisë së kombit"**, dhe bashkë me ta u vranë rreth 60 milionë vetë.

Më 1975 Enver Hoxha nuk shkoi në Helsinki të nënshkruajë paprekshmërinë e kufijve në Evropë, nuk aderoi në KSBE, nuk pranoi Kartën e Helsinkit, sepse e dinte se **mbi 60% e tokave shqiptare janë nën okupimin serbo-greko, maqedono-malazez.** Pas demonstratave të studentëve në Prishtinë më 1981 Tirana zyrtare e dha reagimin e ashpër zyrtar që u botua në "Zëri i popullit" me titull – **PSE U PËRDOR DHUNA POLICORE NË KOSOVË"** (Zëri i popullit" 8. 04. 1981). Ndërkaq, në njërën nga seancat e Parlamentit të Shqipërisë Enver Hoxha me zë alarmi paralajmëron me këto fjalë:

"… Ne u themi serbomëdhenjve, miqve të fshehtë e të sigurt të rusëve, se dy rrugë ka për revizionistët ruso-bullgarë që të sulmojnë Shqipërinë, për të dalë në pjesën e Adriatikut tonë: njëra është rruga e Vardarit dhe e Kosovës, dhe tjetra, Kanali i Otrantos. Në rastin e parë, pa më të voglin dyshim, një popull shqiptar që jeton në Kosovë dhe viset tjera të Jugosllavisë, që nga Shkupi e Kaçaniku, nga Tetova e Gostivari, nga Llapi e Plavë e Gucia do të ngrihen në këmbë e t'i presin agresorët me grusht. ZJARR DO TË NDIZET GJITHË JUGOSLLAVIA! (duartrokitje të gjata, gjithë parlamenti në këmbë!).

Kjo ua prishi gjumin e rehatinë qarqeve ndërkombëtare, vazhdonte profesori, të cilat donin ta ruanin status kuonë në rajon, për të mbajtur balancën e rendit të përcaktuar në JALTË. Çështja e Kosovës është çështje kardinale për të gjithë shqiptarët në të dyja anët e kufirit. Është pikërisht moszgjidhja e drejtë e kësaj çështjeje pas Luftës së Dytë Botërore që ka përcaktuar edhe politikën e shtetit shqiptar të pasluftës, edhe aleancat me jugosllavët, me rusët dhe me kinezët, dhe **prishja e këtyre aleancave për shkak të Kosovës. Dhe Shqipëria u penalizua për këtë përkrahje që i dha kërkesës së shqiptarëve në Kosovë për statusin e REPUBLIKËS.** Por nuk duhet harruar se i gjithë shtypi perëndimor i denoncoi demonstratat e studentëve në Prishtinë si revoltë nacionaliste e irredentiste dhe u vu në përkrahje të plotë të politikës jugosllave. Objektiviteti shkencor, këmbëngulja për të zbuluar të VËRTETËN NËPËRMJET FAKTEVE, është një qëllim fisnik që çdo njeri duhet të përpiqet ta arrijë duke mobilizuar tërë energjitë e tija mendore. Kolonializmi ka marrë fund në botë dhe duhet të marrë fund edhe në Kosovë. Por ne ende po presim që të tjerët t'na i heqin gështenjat nga zjarri, në vend se të mobilizohemi në të gjitha frontet. Përcaktues të fatit tonë jemi vetë ne, jo të tjerët. Thënia lapidare e Jusuf Gërvallës është aktuale për çdo kohë:

„Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij do t'na vijë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që t'na ndalë në rrugën tonë të ndritshme".

Në letrën dërguar **Enver Hoxhës më 19 gusht 1980** nga Untergruppenbach i RF të Gjermanisë, militanti i orëve të para të Lëvizjes për çlirim, Jusuf Gërvalla, ndër të tjera shkruan:

I dashur shoku Enver!

Ne shqiptarët e shkëputur nga Atdheu i lirë dhe të mbërthyer me dhunë brenda kufijve politikë të Jugosllavisë, ndjekim me krenari çdo hap të Shqipërisë mëmë në përforcimin dhe përparimin e Atdheut. I gëzohemi prej së largu çdo prove të suksesshme të unitetit të pathyeshëm parti-popull dhe kjo na bën më të fortë edhe ne. Mburrja dhe entuziazmi s'ka kufi kur kujtohemi që Shqipëria nga një vend i varfër dhe i prapambetur feudo-borgjez, u kthye në një vend të përparuar e të zhvilluar, pa analfabetizëm e papunësi, në një vend të mirëfilltë, që jo vetëm po ia del ta ruajë në gji të shoqërisë së vet të paprekur kështjellën, por edhe t'i ndez shkëndijat revolucionare të pjesës dërrmuese të popujve të planetit…. Epoka e lavdishme shqiptare e Gjergj Kastriotit… hyri me të drejtë në histori si epokë e Prometheut kundër të gjithë perëndive. Epoka e sotme shqiptare me Partinë e Punës dhe me ty në krye, shoku Enver, nxori në shesh edhe një dimension tjetër: etjen e madhe të shqiptarit për punë dhe për ndriçimin e plotë të mendjes… Skena e dramës së sotme shqiptare është po ajo e **Prometheut** të pesëqind vjetëve… Në saje të ekzistimit të kësaj Shqipërie të mbarë, të fortë e vigjilente… edhe te ne në Kosovë dhe viset tjera shqiptare është **ndezur SHKËNDIJA E LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE, konturat e së cilës po duken në horizont.** Të nxirret pjesa e robëruar e tokave dhe popullit shqiptar nga kthetrat e përgjakshme të socialshovinistëve titistë dhe të çohet në vend vullneti i popullit tonë, **BASHKIMI ME VENDIN AMË, SHQIPËRINË...** Duhet të presim vetëm çastin vendimtar të luftës sonë kur lufta të kalojë në konflikt të armatosur…"

Lidhur me këtë çështje profesori shpesh merrte si shembull fjalët lapidare të **Fan Nolit** përmes telegramit të urimit dërguar shtetit të ri shqiptar më 1945:

„Diell i flaktë është Guverna Demokratike e Enver Hoxhës, e cila, padyshim, është e fortë brenda dhe jashtë... Brenda, se përveç veprave të tjera konstruktive ka mundur të zbatojë reformën agrare me rrënjë dhe të transformojë

Shqipërinë nga një çiflig i bejlerëve në një tokë të fshatarëve dhe të punëtorëve. Jashtë, se për herë të parë në histori të saj Shqipëria e vogël qëndron ballëpërpjetë, edhe di t'ua japë xhevapin kapadainjve që i bien në qafë, qofshin të humbur si Greqia, qofshin të mëdhenj si Italia… **Guverna e Enver Hoxhës jo vetëm që e shpëtoi Shqipërinë nga VDEKJA**, por tani i vë themele të patundura shtetit me reforma dhe vepra konstruktive. Këto vepra mund t'i bëjë vetëm një guvernë homogjene, e qëndrueshme me një program të caktuar përparimtar… Sikur të ngjante e pangjara dhe ballistët tanë të kishin qëndruar në fuqi pas disfatës gjermane, përfundimi do të ishte një anarki e plotë, … **e cila do ta shpinte Shqipërinë ose në një diktaturë reaksionare, ose në copëtimin final…** (Fan Noli, VEPRA 3, f. 375-378). Veç tjerash, është meritë e jashtëzakonshme e Enver Hoxhës kur refuzoi të marrë pjesë Shqipëria në KONFERENCËN E SIGURIMIT EVROPIAN të cilën ai e quajti "KONFERECË E PASIGURISË", e cila u mbajt më 1975 në Helsinki të Finlandës, duke shpallur paprekshmërinë e kufijve në Evropë, kur dihej se 70% e territorit etnik shqiptar ishte i okupuar nga serbët, grekët, maqedonët dhe malazezët. Profesori na foli edhe për "KRYENGRITJEN E MIRDITËS" në qershor 1921, me ç'rast, në Prizrenin e okupuar nga serbët, **më 17 korrik 1921** u shpall "REPUBLIKA E MIRDITËS", një shtet i pavarur nga vendi amë, i krijuar nga shpirti i shitur te jugosllavët i tradhtarit Kapedan **Marka Gjoni**, i cili kërkoi nga Jugosllavia dhe Italia që ta njohin këtë "shtet" kukull, megjithëse kjo kërkesë absurde u kundërshtua me armë nga vetë popullata mirditore të cilët formuan organizatën "Bashkimi i shenjtë". Mësuesi i madh na foli edhe për **Emrush Miftarin** dhe **Veli Dedin**. Për heroin Emrush Miftari na tha se ai ishte ndër të parët që ia vuri pushkën garnizonit serb në Pejë më 1941, dhe pastaj kishte formuar rrjetin e bazave luftarake Nacionalçlirimtare, ndërsa kishte ngritur zërin e protestës qysh më parë kundër gjenocidit

dhe masakrimit mizor të 5000 burrave, grave dhe fëmijëve në krahinën e **BIHORIT** në janar të vitit 1943 (nga çetnikët e Drazha Mihailoviqit), dhe i kishte mbushur disa arka me gjymtyrë të copëtuara të martirëve dhe ia kishte dërguar qeverisë në Tiranë. Por në fillim të janarit 1945 **OZN-a famëkeqe jugosllave, në krye me gjakpirësin Spasoje Gjakoviqin, të lidhur me hekura e vrasin në Prishtinë mizorisht heroin sypatrembur Emrush Miftari duke mos i lënë as gjurmë varri.** Profesori vazhdoi pastaj me rrëfimet për HEROIN e trefishtë – VELI DEDI, nga Dediçi i Medvegjës, i cili kishte marrë pjesë në luftën e Spanjës bashkë **me Asim Vokshin, Xhemal Kadën** e shumë të tjerë dhe kishe arritur të dekorohej me urdhrin e Kavalerisë së Lirisë "**NO PASSARAN**" një gradë e heroit të luftës së Spanjës, ndërsa më vonë merr pjesë në luftimet e rezistencës antifashiste në Francë (15 shkurt 1939), dhe caktohet komandant i forcave çlirimtare për departamentin e Marsejës. Për heroizmin e tij dhe guximin e treguar, gjeneralmajori Veli Musa Dedi shpallet **"SHQIPTARI TRIM" (Villant Albanias).** Në këtë luftë heroike ai kishte arritur t'i çarmatoste 3.700 ushtarë fashistë të cilët e kishin vënë në darën e rrethimit qytetin Marsej. Për meritat e jashtëzakonshme në ndërtimin e shtetit shqiptar gjeneral-major Veli Dedi dekorohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me titullin më të lartë – **HERO I POPULLIT**. Për heroin Hasan Prishtina Gjeneral Veli Dedi do të shprehej: Në jetë tri herë kam qëndruar gatitu para shpirtit dhe mendjes së ndritshme të heroit Hasan Prishtina. Herën e parë, kur dëgjova për **vrasjen e tij në Selanik më 14 gusht 1933;** herën e dytë, kur kam lexuar kujtimet e tij për Kryengritjen Shqiptare në Kosovë më 1912 dhe herën e tretë, më 1977, kur eshtrat e Hasan Prishtinës u sollën në Shqipëri. Heroi Veli Dedi na ka lënë këto fjalë amanet:

„KAM FRIKË SE PO VDIQA PA E ÇLIRUAR KOSOVËN, s'do ç'më TRET DHEU!"

Profesori na ligjëronte me orë të tëra për **intelektualin** e vërtetë dhe **intelektualizmin**, pikëpamje dhe praktikë që

çon në mbivlerësimin e punës mendore ndaj punës fizike, të teorisë ndaj praktikës, të njerëzve të punës mendore ndaj atyre të punës fizike, të kuadrove dhe inteligjencës ndaj masave punonjëse, dhe na thoshte se **baza ideologjike e intelektualizmit është idealizmi**. Intelektualizmi bëhet bazë për përhapjen e individualizmit, egoizmit, mendjemadhësisë, qëndrimit oportunist në luftë me të vjetrën, konservativen dhe reaksionaren. **Intelektualizmi** ushqen dhe nxit burokratizmin dhe liberalizmin. **Inteligjenca popullore** është shtresë e veçantë e shoqërisë e cila i shërben popullit punonjës në luftë për ndërtimin e shoqërisë së përparuar, në organizimin dhe drejtimin e prodhimit, në zhvillimin e letërsisë dhe arteve, të kulturës dhe shkencës, në edukimin ideologjik dhe politik, në ngritjen arsimore e kulturore të masave punonjëse. Tiparet dalluese të kësaj inteligjencie janë besnikëria e thellë ndaj popullit, qëndrimi revolucionar dhe ndërgjegjja e lartë në tërë veprimtarinë e tyre, lidhja e ngushtë me popullin dhe në shërbim të interesave të tij, patriotizmi i flaktë, papajtueshmëria me gënjeshtrën dhe çdo shfaqje devijonte në shoqëri. Shembull të kësaj armate të inteligjencës popullore profesori e merrte inteligjencën, **rreth 60. 000 kuadro të lartë**, në RPS të Shqipërisë të cilët janë përgatitur në Universitetin e Tiranës dhe në shkollat tjera të larta të vendit. Ndërkaq në rendin borgjezo-kapitalist një numër i madh i atyre që paraqiten si **INTELEKTUALË** (shkencëtar, profesor, filozof, poet, politikan etj.) nuk janë asgjë më tepër se sa **shërbyes besnikë të rendit përkatës shoqëror**, shërbyes të profesionit të tyre, një formaliteti të plotë, edhe pse mund të jenë në nivel shumë të lartë profesional, shkencor, artistik. Të tillët mund t'i quajmë – **TEKNIKË TË DIJES**, të cilëve klasa sunduese ua mëson dy role kryesore:

I bën specialistë të hulumtimit në fushën përkatëse dhe njëkohësisht shërbëtorë të ideologjisë sunduese. Prandaj ata janë produkt i vetë shoqërisë përkatëse. Çfarë të themi për intelektualët e Kosovës së sotme të cilët **vrapojnë për**

t'u regjistruar në partitë politike në regjistrat e Ministrit të Drejtësisë në Beograd, Vllado Kambovski? Këto parti Millosheviqi i lejoi për t'ia vënë kazmën Kosovës, për ta ruajtur status-kuonë, ndërsa në krye të këtyre partive sot po harlisen edhe njerëz të tillë, **marioneta**, të cilët nuk janë në gjendje ta bëjnë politikën as në një fermë pulash?! Prandaj këta "INTELEKTUALË" të vetëquajtur vazhdojnë të jenë BISHT i politikës kolonialiste. Të gjitha këto parti janë sabotatoret më të paskrupullta të LËVIZJES ÇLIRIMTARE në Kosovë. LIRIA E BRENDSHME, thoshte profesori, – MUND TA LEHTËSOJË ROBËRINË E JASHTME, dhe se kjo LIRI E BRENDSHME është kusht i luftës së suksesshme kundër robërisë së jashtme. Në udhëtimin e gjatë historik, tepër tragjik, populli shqiptar është mbajtur edhe në saje të përgjegjësisë që kanë pasur shqiptarët për njeri-tjetrin. Profesori vazhdonte të na shpjegonte se si një drejtor i një sipërmarrjeje të **ujërave** në qytetin KOBE të Japonisë kishte **bërë vetëvrasje vetëm për shkakun se ndërmarrja e tij nuk kishte arritur të furnizojë me kohë popullsinë e qytetit të dëmtuar nga tërmeti, ndërkaq te ne mund të vdesin 50% e popullsisë së Prishtinës** dhe askush nuk do të bënte vetëvrasje?! Poashtu na fliste profesori për paradokset tona flagrante, dhe thoshte – si është e mundur te kemi sot DY PARLAMENTE – DY PALË DEPUTETË?! Ata të cilët e kanë miratuar KUSHTETUTËN E KAÇANIKUT dhe ata të cilët e kanë FUNDOSUR Kushtetutën e Kaçanikut?! Profesori na fliste për tri grupet e INTELEKTUALËVE:

1. **Intelektualët e mirëfilltë**, të cilët luftuan pa u kursyer për kauzën e shenjtë – çlirim dhe bashkim të trojeve kombëtare, të cilët u ndoqën, u burgosën dhe u vranë nga dora gjakatare e armikut;

2. **Intelektualët të cilët gjatë tërë kohës së pushtimit vetëm heshtën dhe nuk e ndihmuan çështjen kombëtare** (numri i tyre, mjerisht, është i madh) dhe

3. **Intelektualët të cilët me besnikëri i shërbyen pushtuesit** (për fat numri i tyre nuk është i madh)

Për grupin e dytë militanti hero, Jusuf Gërvalla, thotë:

„ ... Dihet se një pjesë e madhe e intelektualëve tanë përkunden në gjumin e ëmbël të OPORTUNIZMIT, KONFORMIZMIT dhe izmave tjerë që e ngadalësojnë me të madhe realizimin e çështjes sonë të madhe. Seriozitetin historik kombëtar këta intelektualë e marrin si çështje së cilës mund t'i kushtohemi nga çasti në çast dhe si çështje që gjithmonë tjetërkujt i përket më shumë se atyre... "

Ndërkaq, për grupin e tretë Jusuf Gërvalla shton:

„Në krah të kësaj ideologjie false – naive, ata bëhen zëdhënës të "Vëllazërim – Bashkimit", të xhelatëve me viktimat e tyre, armë e heshtur e tinëzare për zgjatjen e jetës së shfrytëzimit të klasave dhe popujve të shumëvuajtur. UDB-ja Jugosllave, që s'le gjë pa bërë për të shfarosur popullin shqiptar të Kosovës, te ky lloj intelektuali ka gjetur një nga përkrahësit e heshtur më besnik të shuarjes së çdo ndjenje revolucionare... Nuk po dinë, vallë, a nuk po duan ta dinë, se kur s'ke si t'i gëzosh të drejtat elementare kombëtare, është puna më e kotë në botë të kërkosh të realizosh të drejtat për krijimtari shkencore, artistike, kulturore, që janë PARAROJË E LIRISË SË VËRTETË kombëtare e shoqërore!"

E dihet se **intelektuali** i një populli të pushtuar mund të ketë liri individuale vetëm **nëse arrin t'i PËRSHTATET KORNIZAVE jetësore të tërhequra nga pushtuesi** duke e heshtur pushtimin e popullit pjesëtar i të cilit është ai. Ndërkaq te ne në Kosovë ngjan paradoksi: në vend që inteligjenca, si pjesa më e vetëdijshme e një kombi, ta ndërgjegjësojë dhe orientojë popullin se si duhet punuar dhe luftuar për çlirimin dhe bashkimin kombëtar, përkundrazi, **POPULLI e ndërgjegjësoi atë kombëtarisht**. Dhe këtu qëndron përgjigjja se pse pjesa dërmuese e intelektualëve në Kosovë në çastet më të vështira për kombin HESHTËN, dhe nuk e kapërcyen vijën e kuqe që e kishte tërhequr okupatori. Këtu e ka burimin koncepti i gabuar dhe i

çoroditur se gjoja – **INTELEKTUALËT** në Kosovë kanë qenë më të LIRË se sa intelektualët në shtetin amë – **Shqipëri**, kur dihet se DIFERENCIMI POLICOR, sidomos pas vitit 1981, përfshiu të gjitha institucionet arsimore, kulturore, administrative, juridike, dhe në këtë mënyrë u zhvillua një fushatë e tërbuar e intelektualëve luajalë e kolaboracionistë të okupatorit që diferenconin intelektualët liridashës e patriotë, numri i të cilëve kishte arritur në 12.720 të burgosur dhe të dëbuar nga vendet e tyre të punës në arsim, administratë etj.

Profesori Qazim na fliste me orë të tëra për **INTELEKTUALIN BORGJEZ** i cili e ka në shënjestër – *marksizmin*, dhe këtë kategori sociale Zh. P. Sartri i quante "Teknikë të dijes praktike, të rekrutuar nga lart në shërbim të profitit" (SITUATAT, Prishtinë 1986). Këta intelektualë klasa sunduese i rekruton dhe siguron arsimimin e tyre duke ua dhënë ideologjinë e përshtatshme dhe duke i pajisur me dy role:

1. **SPECIALISTË TË HULUMTIMIT** dhe
2. **SHËRBËTOR (QEN-ROJE) TË SUNDIMIT**.

Këta intelektualë e fshehin karakterin kontradiktor të borgjezisë – shfrytëzimin e egër të shumicës nga pakica, e fshehin luftën e klasave, dhe pranojnë kolonializmin, imperializmin, racizmin, autocenzurën, dhe bëhen APOLITIKË - AGNOSTIKË, dhe me këtë veprim ata vetëpërjashtohen nga kategoria e mirëfilltët e INTELEKTUALËVE. Me fjalë tjera, ata janë prodhim monstruoz i shoqërisë monstruoze, dhe nuk janë në anën e luftëtarëve të LIRISË. **Armiku** më i madh i **INTELEKTUALIT TË VËRTETË është INTELEKTUALI I RREMË** (Kuaziintelektuali) i cili ua ndalon të shtypurve kryengritjen me armë, dhe bën përpjekje që revoltat e masave t'i futë në grackën e REFORMIZMIT duke i larguar nga kryengritja dhe revolucioni, sepse edukimi mikroborgjez i ka infektuar ata deri në palcë. Këta **kuaziintelektualë** mbjellin iluzione reformiste dhe preferojnë **IDHUJ lideristë,** përkundër **TRIBUNËVE**

POPULLORË, të cilët luftojnë për një botë të re, pa shtypës dhe të shtypur. Intelektuali luftarak ka vetëdije të lartë klasore dhe i konteston të drejtat e demokracisë borgjeze duke i zëvendësuar ato me të drejtat e demokracisë socialiste. Në këtë kontekst profesori na fliste për servilizmin politik të kuazi intelektualëve, të cilët edhe përkundër inteligjencës së tyre bien në kthetrat e egoizmit dhe vetëlavdisë karrieriste. Na fliste me orë të tëra për **Faik Konicën** i cili pas shpalljes së pavarësisë më 1912 vihet në anën **Esat Toptanit** në Qeverinë e Durrësit ku për sekretar kishte serbin Gjurashkoviq, dhe kundër Ismail Qemalit, pro Ahmet Zogut dhe kundër Fan Nolit, dhe ambasador i Ahmet Zogut në Amerikë. Na fliste për Ministrin e Kulturës, **Ernest Koliqin,** i cili kishte firmosur pushtimin fashist të Shqipërisë, por edhe për **Gjergj Fishtën**, autorin e "Lahutës së Malcisë", i cili më 1939 përshëndeti ardhjen e pushtuesve fashistë italianë, dhe u prit ngrohtësisht nga Benito Musolini dhe u pranua në **Akademinë Fashiste të Shkencave në Itali**, në kohën kur shumë akademikë italianë të shkencave po e braktisnin një institucion në të cilin projektoheshin programet raciste për robërimin dhe zhdukjen e popujve. Qysh para pushtimit ai i kishte shkruar një letër një koloneli italian duke e pyetur:

„Kur do ta dërgojë Musolini ushtrinë e tij në Shqipëri për ta shpëtuar këtë vend nga MYSLIMANËT injorantë?!"

Por, veç tjerëve, profesori na fliste edhe për Asdrenin, i cili edhe pse ishte autor i HYMNIT TË FLAMURIT e kishte duartrokitur ardhjen e fashizmit në Shqipëri dhe Benito Musolinit "Duçës", ia kishte kushtuar një poezi?! Edhe Dhimitër Pasko (Mitrush Kuteli) kishte veshur uniformën e oficerit fashist në Rumani dhe kishte shkuar bashkë me nazistët gjermanë të pushtojë stepat e Ukrainës.

Ndërsa sot, shtonte profesori Qazim, na dalin ca kalemxhinj dhe marrin guximin të sulmojnë me akuza për gjoja **servilizmin e shkrimtarëve socialistë të Shqipërisë**, dhe këtë e bëjnë pikërisht ata pinjoj kolaboracionistë të nazifashizmit të cilët ikën nga Shqipëria bashkë me

okupatorin. I verbri të njeh në ZË, shurdhi në SY, i marrosuri nuk të njeh me asnjë gjë, kurse i SHITURI di vetëm të lehë!

Profesori citonte fjalët e Gëtes: **"ËSHTË I ROBËRUAR PËRGJITHMONË AI QË NË ROBËRI MENDON SE ËSHTË I LIRË", pastaj fjalët e Bertold Brehtit se" KUSH NUK LUFTON PËR ÇËSHTJEN E VET, LUFTON PËR ÇËSHTJEN E ARMIKUT"**; pastaj na thoshte se – Ai që fle me gjarprin nuk bën të ankohet se e ka **kafshuar gjarpri**, dhe na fliste me admirim për gjeneral Dudajevin e Çeçenisë dhe heroizmin e luftëtarëve çeçenë të cilët kishin zënë 60 tanke ruse dhe secilin ushtar çeçen e kishte shpërblyer me nga 3000 dollarë për çdo ushtar të vrarë të armatës ruse, sepse Dudajevi thoshte – "Rusët kanë epërsinë e armatimit, ndërsa ne e kemi epërsinë morale, epërsinë e zemrave luftarake, sepse luftojmë për tokën tonë të shenjtë; vetëm kur jemi të bindur se jemi të okupuar, atëherë 50% jemi çliruar;

– me referendumin e **24 majit 1992** duke e mashtruar popullin se gjoja po mbajmë zgjedhje të lira dhe demokratike (nën okupim?!) **faktikisht e kemi pranuar copëtimin e trojeve të okupuara shqiptare nën Jugosllavi, sepse me një pushtet "paralel" të tillë pluripartiak amortizohet dhe përjashtohet çlirimi i Kosovës me vise duke krijuar iluzionin se kemi 15 parti politike, se kemi dy parlamente, se kemi Këshillat tagrambledhëse të 3% në diasporë dhe 200 opcione për zgjidhjen e çështjes së Kosovës?!;**

– Eksodi i 300-500.000 shqiptarëve përmes agjencive kolaboracioniste është tragjedia më e madhe kombëtare;

– rreziku më i madh janë strukturat kuaziintelektuale titiste, anacionale, luajale të okupatorit, të cilat u seleksionuan për 50 vjet të pushtetit kolonizator jugosllav duke mbetur kështu pa **INFRASTRUKTURË INTELEKTUALE TË MIRFILLTË;**

– Anarkia e sotme e ekzistencës së 104 partive e shoqatave është rreziku më i madh për kauzën e shenjtë për çlirim dhe bashkim;

– Ne po ia sigurojmë dhe po ia zgjasim jetën robërisë në Kosovë me sjelljet tona pacifiste në raportin 50% me 50%, dmth **50% dhunë nga lartë dhe shtypje me 50% durim nga frika që e ka mbjellë armiku me aparatin e dhunës;**

– Sot të vetëquajturit liderë të Kosovës bisedojnë me **Millosheviqin, Paniqin, Bullatoviqin, Gligorovin** etj., por më mirë do ishte të pajtoheshin dhe të bënin besëlidhjen mbarëkombëtare për një luftë çlirimtare;

– Si ta shpjegojmë paradoksin: në Kosovë Serbia i **plaçkiti mbi 500.000.000 marka gjermane dhe po i mbulon humbjet dhe po financon luftën në Kroaci dhe Bosnje?!;**

- **Çfarë bën rinia e Kosovës sot?** Ajo po bredh nëpër rrugët e Evropës pa punë dhe pa ekzistencë, dhe sikur gjithë ky potencial i pjesës më vitale të kombit të orientohej në frontin për çlirim do të dridhej tërë Evropa;
- **Kërkesa e pacifistëve për dialog me armikun** është tallje me popullin, sepse dialogu sjell autonomi e jo PAVARËSI, ashtu siç është qyqare dhe naive kërkesa për **PROTEKTORAT NDËRKOMBËTAR**. Prandaj, edhe kërkesa – Lidhje konfederale me Shqipërinë është kërkesë joserioze, sepse të bësh lidhje konfederale me një shtet të pranuar ndërkombëtarisht duhet **paraprakisht të jesh edhe vetë subjekt i pranuar ndërkombëtarisht, pra shtet i lirë dhe sovran;**
- **Më 18 nëntor 1994** në Palestinë u vranë 15 demonstrues dhe u plagosën 200 të tjerë, dhe me këtë u dëshmua më së miri se çfarë mund t'i sjellë një populli të robëruar rruga e kompromiseve dhe pazarllëqeve me armikun, siç po vepronte J. Arafati me kërkesat gjysmake **për AUTONOMI formale**, e cila është rruga e tradhtisë dhe e përçarjeve vëllavrasëse;
- **KUSHTETUTA E 7 shtatorit 1990** potencon se nëse PARLAMENTI nuk mund të mbajë mbledhjen, atëherë obligohet presidenti që me gjashtë veta me dekret të shpallë

GJENDJEN E LUFTËS, dhe nëse nuk e zbaton këtë nen të Kushtetutës, atëherë vetë presidenti ka bërë shkelje të rëndë të aktit më të lartë dhe shpallet – **TRADHTAR!** Ndërsa dihet se popullin mund ta keni pas vetes vetëm atëherë kur të mësoni mirë për t'ia thënë të VËRTETËN, dhe kështu çështjen kombëtare e kemi reduktuar në çështjen e të **DREJTAVE INDIVIDUALE** të njeriut dhe çështja kombëtare nuk është shtruar si çështje **INTEGRALE tërësore e Kosovës, Kosovës Lindore (Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë), Iliridë – Shqipëria Lindore, Malësia dhe Sanxhaku – Shqipëria Veriperëndimore;**

- Më 26 gusht 1992 në Londër shkuan 5 delegacione shqiptare, në vend që të shkonte vetëm një delegacion mbarëshqiptar, dhe aty u pohua se Kosova është çështje e Serbisë dhe u konfirmua NDARJA E SHQIPTARËVE NË PESË SHTETE;
- Më 26 nëntor 1992 në Tetovë u bojkotua Uniteti dhe pajtimi mbarëkombëtar nga tri partitë madhore: **LDK, PDSH dhe PPD;**
- Reaksioni ndërkombëtar po luftonte ditë e natë për ta shkatërruar rendin e barazisë socialiste në Shqipëri përmes Kosovës, duke propaganduar se e vetmja pengesë për çlirimin e Kosovës është rendi shoqëror në Shqipëri, ndërsa sot, **kur nuk ekziston rendi socialist, askush nuk e potencon kërkesën e ligjshme për vetëvendosje dhe BASHKIM mbarëkombëtar të Kosovës me Shqipërinë;**

Më 18. 02. 1995 në revistën "ZËRI", kryetari i LPRK-së, **Fazli Veliu**, veç tjerash shton se: PRAPA ÇDO SUBJEKTI POLITIK LEGALIST SHQIPTAR QËNDRON SË PAKU NJË SERB APO MAQEDONAS, dhe **pas çdo biznesmeni të madh shqiptar qëndron një serbomalzez apo maqedonas,** ndërsa në Parlamentin e pakonstituar të Kosovës klani proserb e saboton dhe e bllokon ecjen përpara të çështjes së çlirimit të Kosovës, ndërsa deputetët në Maqedoni marrin paga për shërbimet e tyre kolaboracioniste;

- Instituti Amerikan i Studimeve Strategjike më 15.02.1995 thotë se **"Shqipëria nuk duhet furnizuar me armë, pasi ka të ngjarë që ato të dërgohen në Kosovë...** Serbisë nuk duhet t'i tërhiqet vërejtja në mënyrë të hapur për sa i përket Kosovës, sepse në këtë mënyrë mund të **trimërohet krahu RADIKAL** i shqiptarëve (RILINDJA, 14.01.1995, f. 8), dhe nga kjo rezultoi se u deshën 5 vite pritje që shqiptarët **të çlirohen nga ILUZIONI** se do të na ndihmojë Evro-Amerika, siç u pa në Marrëveshjen e **Dejtonit, dhjetor 1995**, ku as që u përmend çështja e Kosovës dhe kështu u bë e qartë se SHBA-të dhe fuqitë Evropiane për hir të ruajtjes së **status-kuosë** në Ballkan po i FLIJOJNË të drejtat e shqiptarëve të paçliruar dhe demokracinë e Shqipërisë; Poeti **Dritëro Agolli** në poezinë LUTJA E KËMBANËS thotë:

Jam nisur të mbetem vërtetë një kambanë;
Aspak s'tingëlloj po s'më ranë
Më bini ju lutem, përherë e ngaherë;
Në doni prej meje gjëmim e poterë (1994)

Presidenti amerikan B. Klinton në letrën që ua dërgoi kryetarëve të Komitetit për Çështjen Shqiptare thoshte shkoqur:

„Megjithëse nuk e përkrahin PAVARËSINË e Kosovës, SHBA-të janë të vendosura për rikthimin e të drejtave NJERËZORE dhe politike të popullit të Kosovës", dhe nga kjo del se edhe ushtarët amerikanë kanë ardhur në Maqedoni për ta forcuar **STATUS-KUONË** Ballkanike e cila është në dëmin e shqiptarëve, ndërsa Presidenti i Shqipërisë, shton: **"Ballkani nuk mund të qetësohet në qoftë se të gjitha palët kërkojnë MAKSIMUNIN në kurriz të njëri-tjetrit, gjë që linte të nënkuptohet se KËRKESA PËR REPUBLIKË është kërkesë MAKSIMALE në kurriz të Serbisë?!** (Shih: Zëri i Kosovës, 15. 03. 1995). Profesori vazhdonte duke na bindur se rruga drejt LIRISË nuk është e shtruar me lule, por kalon përmes shumë sfidash dhe vështirësish. Armiku kurrë nuk ka lejuar që shqiptarët t'i hapnin sytë, të merrnin një shkollim të mirëfilltë, por të

ishin në terrin e paditurisë. Por ne duhet ta çajmë këtë errësirë, **sepse këto 36 shkronja të ALFABETIT janë 36 rreze drite, që kur i bashkon ndezin një YLL, e ky yll të ndriçon sytë gjithë jetën, për të parë si asnjë herë tjetër të djeshmen, të sotmen dhe të nesërmen**. Profesori na kujtonte fjalët e LENINIT se: **NJERIU ANALFABET QËNDRON JASHTË POLITIKËS, DHE PARA ÇDO GJËJE ATIJ I DUHET MËSUAR ABECEJA!".** Në këtë kontekst na kujtonte fjalët e Fan Nolit se: VARFËRIA dhe PADIJA janë sëmundje të zakonshme të popujve malësorë anembanë botës. Varfëria i bënë MERCENARË dhe padija REAKSIONARË. Shtypësit e brendshëm e të jashtëm përpiqen si e si t'i këllasin më thellë në varfëri e në errësirë që kështu t'i përdorin si vegla e t'ua thithin gjakun me rehat… dhe shtonte se: KYEPLAGA ËSHTË FEUDALIZMI, dhe prej kësaj rrjedhin të gjitha sëmundjet, përçarjet dhe kalbësirat. , sepse FEUDALIZMI ka nevojë për **padijen**, për **varfërinë**, për skllavërinë, për fanatizmin, për pseudokulturën, për regjionalizmin, për mercenarizmin, për spiunllëkun, për tradhtinë, se vetëm mbi bazën e këtyre të zezave mund të mbretëroje në Shqipëri. **Shkule feudalizmin**, dhe si me magji të gjitha tjerat zhduken ose humbasin forcën helmonjëse… " dhe vazhdonte duke numëruar KONFUZIONIN e pesë ANARKIVE që po e ngulfatin Shqipërinë:

1. **ANARKIA FETARE:** katër fe të ndryshme që s'kanë zënë rrënjë në zemrën e një populli PAGAN;
2. **ANARKIA SOCIALE:** (…. .)
3. **ANARKIA MORALE**: këtu qeni s'njeh të zotin, këtu karakteret lypësohen (shtazërohen), qullosen dhe ndërrojnë forma dita më ditë si në kaleidoskop; këtu i padituri i di të gjitha dhe i pazoti është i zoti për të gjitha;
4. **ANARKIA PATRIOTIKE** (…);
5. **ANARKIA E IDEALEVE:** këtu idealet e errëta, të shtrembëta e të mumifikuara, përfyten e përleshen në një luftë për vdekje me IDEALET E GJALLA, elegante dhe të ndritshme… por na mungojnë idealet e antropofagëve , në

vendin e të cilëve kemi KULLTUKOFAGËT, krimba të verdhë me kokë të zezë, që rriten mbi plagët e infektuara të Shqipërisë në lëngim…

A ka IDEAL më të lartë se sa ta nxjerrësh vendin tënd nga **SHPELLA E ERRËSIRËS**, ta shërosh nga plagët shekullore, ta lirosh nga thonjtë e nga gërxhorët e hidrës (kuçedrës) së ANARKIVE? A ka ideal më bujar se sa të krijosh e të vesh një racë të re, të fortë e të disiplinuar, me **FENË E DETYRËS NË ZEMËR, ME DIELLIN E LIRISË NË BALLË e me FLAMURIN E SAKRIFICËS** **për të mirën e përgjithshme në dorë?**

Ndërkaq për kritikën konstruktive na thoshte se është një domosdoshmëri që kërkon një fuqi morale dhe intelektuale, guxim qytetar, profesionalizëm dhe intelektualitet të vërtetë, dhe si shembull shkollor e merrte veprën heroike të shkrimtarit francez **Emil Zola "AKUZOJ"** përmes së cilës ai i doli në përkrahje DRAJFUSIT të dënuar padrejtësisht dhe më këtë gjest ai ngjalli ndërgjegjen e vdekur të Francës. Profesorit i pëlqente poezia e A. Z. Çajupit: SHQIPËTAR:

Të ka bërë perëndia luftëtar,
Si s'të lodhi robëria, shqipëtar?
Erdhi dita të ngresh kokë, të kërkosh
Lirinë bashkë me shokë, të luftosh!
Mos bëni si keni bërë gjer me dje;
Po të luftoni të tërë për Atdhe!
*… … … …

dëshmohemi para vetvetes dhe para botës se e meritojmë LIRINË si gjithë popujt tjerë të botës!

Poashtu, profesori ynë i dashur e kishte për zemër edhe poezinë **QËNDRESA** të Luigj Gurakuqit, përmes së cilës dëshmohet për vendosmërinë e luftëtarëve të lirisë, të cilët i kanë vënë detyrë vetes të mos DORËZOHEN, por të luftojnë e të çajnë rrugën për plotësimin e idealeve të tyre të shenjta:

Veç nji qëllim i naltë t'ban me durue,
e zemrën ta forcon,
Ndër kundërshtime s'vyen kurr' me u ligshtue,
Mjer'ai që nuk qindron!

Profesori shpesh na rikujtonte poezinë revolucionare të **MIGJENIT** – TË BIRT E SHEKULLIT TË RI:

Ne të birtë shekullit të ri,
Me hovin tonë e të ndezur peshë,
Ndër lufta të reja kemi m'u ndesh
Dhe për FITORE kem me ra FLI!

Dhe kështu leksionet e profesorit Qazim nuk kishin të mbaruar, kurse në dhomë gjatë një pauze po buçiste zëri i këngës – ECIM PARA DHE MARSHOJMË, të cilën çdo ditë po e këndonin luftëtarët trima të UÇK-së në përleshje me forcat e armatës fashiste serbojugosllave:

Ecim para dhe marshojmë,
Çajmë mes natës dhe stuhisë,
Marshim para – s'ka kthim prapa,
Për dasmorët e Lirisë!

Është e drejtë lufta jonë,
S'mund ta ndal kush hovin tonë.

Profesori shpesh na fliste se si vetëm duke iu falënderuar pjellorisë dhe qëndresës burrërore të nënave shqiptare ne i mbijetuam shekujt e robërisë, dhe sa për ilustrim merrte shembullin e nënës së Çerçiz Topullit,

pastaj të nënës së Mihal Gramenos, e cila kur ishte përhapur lajmi në Korçë se ishte vrarë Mihali (edhe pse ai kishte shpëtuar), ajo nuk vajton, por me vrap vesh rrobat e reja, duke thënë: **"Kam dasmë, se Mihalin e martova me Shqipërinë!"**

Profesori merrte si shembull inkuizicionin dhe djegien në turrë të druve të intelektualit dhe filozofit të madh **Xhordano Bruno** më 1600, pastaj **Jan Husin** etj., por merrte shembull edhe **Albert Ajnshtajnin** i cili nuk ishte intelektual vetëm sepse e zbuloi teorinë e relativitetit, teorinë për nxjerrjen e energjisë atomike, si bazë për nxjerrjen e bombës atomike, por për faktin se kur kjo bombë u keqpërdor në **Hiroshima dhe Nagasaki** më 6 dhe 7 gusht 1945, me ç'rast humbën jetën mbi 200.000 njerëz, dhe mijëra të tjerë edhe sot lindin me pasoja organike, atëherë ai e ngriti zërin e protestës kundër përdorimit të kësaj teknike shkatërruese me përmasa globale. Që nga ai çast ai e **fitoi të drejtën të quhet INTELEKTUAL**. Profesori na fliste për shoqërinë në të cilën jetonim, të cilën e paraqiste si një MOÇAL SHPIRTËROR ku kalben rrënjët e vlerave, rrënohet etika qytetare, dhe mbizotërojnë armata e kolltukofagëve dhe maskarenjve, marionetave dhe kuislingëve të sistemit kolonizator jugosllav, të cilët luftojnë për një kolltuk më të madh e më të butë, por me kusht që të **heshtin**, që viset shqiptare nën okupim kurrë të mos bashkohen me Shqipërinë, se atëherë ka rrezik edhe për kokën e tyre. Ai na fliste me orë të tëra për Lëvizjet çlirimtare në botë, na fliste edhe për **Kryengritjen paqësore të Mahatma Gandit** në Indi me 400 milionë banorë, të cilën e sundonte Anglia me 200.000 kolonizatorë, por kur Gandi u identifikua me masat protestuese dhe kur të gjithë u betuan se **asnjë prodhim, asnjë gjilpërë, asnjë send nuk do ta blejnë nga anglezët, dhe kur Gandin nga dy javë e mbanin në burg, herë me një dhi e herë pa të**, edhe pse ai i kishte dy doktoratura, pas 12 ditë grevë të përgjithshme pushteti kolonizator anglez kapitulloi dhe iku me turp nga India, më 1948,

ndërkaq te ne në Kosovë nuk mund të identifikohemi me Indinë dhe të jetojmë me iluzionin se Serbia kolonizatore do ikë nga Kosova me lutje e greva mbarëpopullore, të cilat mund të jenë vetëm shkëndija paralajmëruese të një **revolucioni nacionalçlirimtar në të ardhmen,** por kurrën e kurrës duke u regjistruar partitë politike pluraliste në Kosovën e robëruar te Ministri i Drejtësisë së Jugosllavisë – Vllado Kambovksi në Beograd, në një kohë kur lufta çlirimtare kishte kohë që kishte shpërthyer në Slloveni, Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë, dhe dita-ditës po pritej shkatërrimi përfundimtar i Jugosllavisë.

Profesori i nderuar na fliste pa pushim për figurat e ndritshme të njerëzimit, duke filluar nga prototipi i Prometheut antik, kjo figurë mitologjike e lashtësisë, që për të mirën e njerëzimit sakrifikon veten. Ai na thoshte se nuk do të mund të paramendohej civilizimi ynë pa literaturën antike duke filluar nga Homeri, Eskili, Platoni, Euripidi, Sofokliu, Aristoteli, Epikuri, Demokriti, Hipokrati, Sokrati, Diogjeni etj. , dhe pastaj duke vazhduar me Virgjilin, Danten, Petrarkën etj. Na fliste me orë të tëra për Gëten, Servantesin, Shekspirin, Gorkin, Gogolin, Balzakun, Ygoin, Robespjerin, Dantonin, Marksin, Engelsin, Leninin, Stalinin etj. Na fliste përherë për figurat e ndritshme dhe heronjtë e kombit si Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Papa Kristo Negovani, Thimi Mitkon, Sotir Pecin, Petro Nini Luarasin, Motrat Qiriazi, Elena Gjikën, De Radën, Koto Hoxhin, Pandeli Sotirin, Naim, Abdyl dhe Sami Frashërin, Hoxha Tahsinin, Luigj Gurakuqin, Avni Rrustemin, Bajram Currin, Hasan Prishtinën, Mihal Gramenon, Themistokli Gërmenjin, Ndre Mjedën, Hoxhë Kadri-Prishtinën, Fan Nolin Asim Vokshin, Xhemal Kadën, Veli Dedin etj. Na fliste për themelimin e Mësonjëtores së parë Shqipe në Korçë **më 7 mars 1887**, në të cilën ishin regjistruar 35 nxënës, dhe vazhdonte duke numëruar peripecitë e rrugës së shkronjave shqipe të lara me gjak e sakrifica të mëdha, deri te Kongresi i Alfabetit **më 14 nëntor 1908**, dhe duke

numëruar dëshmorët e shumtë të shkollës shqipe, duke filluar me **Pandeli Sotirin e Petro Nini Luarasin e deri te Fazli Greiçevci, Rexhep Mala, Zijah Shemsiu e Xhemaili Berisha** (të vrarë mizorisht më 6 prill 1989 në burgun fashist hetues të Prizrenit), duke apostrofuar se nuk ka emër më të lartë se emri i **Nënës dhe Mësuesit**, se nuk ka gjë më fisnike se sa të kryesh misionin e shenjtë të **MËSUESIT**, i cili mbjell dritë, dije e kulturë, dashuri për gjuhën shqipe dhe për Mëmëdhenë tek brezi i ri. **Banesa** e profesorit ishte kthye në një **mësonjëtore** të vërtetë ku merrnim mësime pothuaj çdo ditë ne nxënësit e profesorit famëmadh e zemërbardhë.

Më kujtohet, kur **më 23 maj 1987**, u takuam në shtëpinë e profesorit **Islam Balaj**, ku ishin të pranishëm profesori **Xhemaili Berisha** (tani dëshmor i kombit), unë dhe disa shokë të tjerë. Atë ditë për 12 orë pa pushim, profesor Qazimi na mbante leksionet e tij nga fushat e ndryshme të shkencës: nga filozofia, logjika, psikologjia, historia, ekonomia, politika etj. Biseda merrte zjarr kur preknim temat e aktualitetit politik dhe të gjendjes së rëndë të kombit shqiptar nën zgjedhën e kolonizatorëve jugosllavë.

Bisedat vazhduan atë natë në një atmosferë të këndshme, Në qendër të bisedave doemos ishte Shqipëria. Profesor Qazimi fjalën e sillte te Lufta Nacionalçlirimtare, duke shtuar veç tjerash: **populli shqiptar i tregoi edhe një herë botës se Shqipëria vërtet është e vogël, por e pamposhtur, se ky popull e donë lirinë, prandaj edhe me gjakun e vet u çlirua nga zgjedha e huaj, pa hyrë atje asnjë këmbë e asnjë ushtari të ushtrive aleate. Këtë që bëri Shqipëria nuk e bënë dot as Franca, as Anglia, as Italia, as Greqia e lëre më Jugosllavia** (të gjitha këto shtete u çliruan me ndihmën e forcave ushtarake të aleatëve), dhe duke iu falënderuar këtij fakti ne po ua mbyllim gojën gjithë armiqve, sepse ky është ai aduti bazë për t'mos pretenduar askush në participimin e sovranitetit të te gjithë trojeve shqiptare që ishin çliruar **me gjakun e 113.000 të rënëve** (25. 000 ushtarët e dy brigadave të

UNÇSH-së dhe brigadave kosovare pasi kishin çliruar Kosovën me Sanxhakun, kishin arritur deri në Vishegrad, dhe në luftë me nazistët gjermanë kishin rënë në fushën e nderit **600 dëshmorë** të këtyre dy brigadave heroike). Në një çast, duke potencuar luftën e Shqipërisë për të përballuar bllokadën imperialisto-revizioniste, veç tjerash shtoi:

Është fat që në ballë të Shqipërisë ishte njeriu më i madh i të gjitha kohërave**, Enver Hoxha**, i cili –

– NË NJËRËN DORË PO E MBAN SHPATËN E DIKTATURËS SË PROLETARIATIT, DHE NË TJETRËN "LLAMBËN E ARSIMIMIT" TË POPULLIT!

Profesor Qazimi e shihte tek INJORANCA rrezikun e tragjedive të mëdha, ashtu siç kishte parashikuar Karl Marksi. Ai nuk mund ta merrte me mend se si tërë kështjella e reaksionit shqiptar janë bërë një për ta injektuar injorancën historike, kur një turmë politikanësh të çmendur u ranë sirenave të histerizmit për të zhbërë historinë 50-vjeçare tok me 28.000 dëshmorët e LNÇ-së, kundër epopesë së tyre të lavdishme, **për t'i vrarë tashmë edhe politikisht** të gjithë ata që u vranë fizikisht nga fashizmi. Jetojmë në **epokën e gomarëve që pëllasin kundër epokës së luanëve**. Bertolt Brehti i madh thoshte për vdekjen e Leninit:

"Kur u nda Lenini prej nesh /
Ishte sikur pema u nda nga gjethet"

Dhe kur iku Enver Hoxha mbetën gjethet, nën mëshirën se ku do t'i shpjerë era, sepse nga gjithë anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë vetëm Heroi **Haxhi Lleshi** rezistoi hapur dhe tha publikisht:

„Enver Hoxha nuk ishte diktator, por burrë i madh shteti, ndërsa ata që atakojnë Enver Hoxhën janë TRADHTARË. Asnjëri nga ne nuk ishte në gjendje të udhëhiqte luftën në tërësi përveç Enver Hoxhës. I vetmi burrë që mund të na udhëhiqte e të çonte në fitore ishte Enver Hoxha. Tjetër s'kishte. Pa zgjuarsinë e Enver Hoxhës e talentin e tij si udhëheqës legjendar i

pagabueshëm lufta e popullit tonë do të zihej rob. Enver Hoxha është udhëheqësi më i madh që ka lindur kombi... "

Këto fjalë të Haxhi Lleshit, thoshte profesori i madh, po na i kujtojnë fjalët e **Hasan Prishtinës** të thëna më 12 janar 1912 në Mbledhjen e Taksimit në Stamboll, ku ishin ndarë detyrat e qarta për secilin. Hasan Prishtina u caktua që i pari ta filloi Kryengritjen e Përgjithshme në Kosovë, ndërsa të tjerët në pjesët tjera të Shqipërisë. Në at Mbledhje historike Hasan Prishtina do të deklaronte para të BESATURVE:

"Jam i bindur se të gjithë jeni të ndershëm, por po ju deklaroj edhe një herë që, ku të dalë le të dalë, unë kam për të kenë në mal kur ka me tingllu çasti i KRYENGRITJES. Për këtë kam vu PENG përpara fjalën t'eme të nderës. Ju lutem pra, mos me më lanë vetëm, pse jeni BETUE edhe ju!".

Mirëpo, çka ndodhi më pastaj. ASNJËRI NUK MBETI BESNIK DERI NË FUND. Madje, disa u bënë më vonë kundërshtarë e armiq, sepse kishin harruar BETIMIN dhe fjalët emblematike të Hasan Prishtinës:

"DHE, PARA SË GJITHASH, RUHUNI NGA MALLKIMI I HISTORISË DHE MOS E HARRONI ATË KUR TË JEPNI VENDIMIN TUAJ!"

Profesor Berisha qe drita e udhërrëfyese, të tjerët qenë **forca** e tij që e pasuan në këtë rrugë dhe ditën ta përshkonin, ndërsa ai vetë, siç ndodh përherë me BURIMIN E DRITËS, mbeti në hije, në heshtje, i harruar, mirëpo kush tregon rrugën drejt majave të larta nuk është më pak i denjë për t'u nderuar si HERO sesa ai që e përshkon atë rrugë. Ai me "Syrin e trurit " të tij të mrekullueshëm i ndriçonte problemet në tërë kompleksitetin e tyre në gjerësi dhe thellësi, nën dritën e dialektikës, dhe pasardhësve ua lë detyrën për ta vazhduar këtë rrugë të shenjtë, për ta përpunuar dhe shfrytëzuar

thesarin dituror. Mendja e tij si një projektor drejtonte ndriçimin mbi të gjitha problemet e jetës dhe i sqaronte me një mendjemprehtësi të mahnitshme. Kudo që ne bashkëkohësit e tij kalonim si nëpër errësirën e natës , pa vënë re gjë, ai gjente me **INTUITË** fillin e gjërave, damarin burimor, i nuhatë, i tregon i pari, dhe duke mos u mjaftuar me gëzimin e zbuluesit ngulmon që edhe të tjerëve t'u bëhet i qartë rreziku që të **mos e shpenzojnë energjinë kot duke u marrë me pasojat**, por të kapen dhe luftojnë me shkaktarët e problemeve të shumta. Një herë e pyetëm profesorin për Erazmin e Roterdamskit, dhe veprën e tij **LAVDATË ÇMENDURISË**, dhe pastaj na foli për këtë vepër të shkëlqyer të dijetarit enciklopedik dhe satirikut të mprehtë të shekullit XVI dhe shto: Erazmi studioi në College Montaigu, në Lagjen Latine të Parisit, ku ndodhet sot Panteoni. Kohën e kaluar në këtë burg të mendjes, në këtë burg teologjik, studenti i ri, i etur për dije, do ta përshkruaj si një periudhë burgimi, ku nata i kalon në luftë të palavdishme me insektet. Me tallje do të shkruaj në veprën e vet këto fjalë ironike: "Nga Montaigu paske ardhur?". Patjetër do ta kesh kokën me dafina!"

-Jo me dafina, por me morra!" shton me përbuzje Roteradmi kundër dhunimit të mendjes së mbërthyer në shtratin e PROKUSTIT. Dhe vazhdonte profesori ynë duke na paralajmëruar se FANATKUN herët a vonë e pret vetasgjësimi, dhe kur të tjerët veprojnë si të TËRBUAR, arsyes i takon të jetë më vigjilente se kurrë, sepse një ditë vjen koha e saj, durimit i vjen fundi,mjegulla zhdavaritet, populli zgjohet nga gjumi, dhe **shpërthen vullkani kryengritës...**

Profesori erudit na fliste me orë të tëra lidhur me shërbimin e fshehtë të një shteti dhe në veçanti për Shërbimin e Sigurimit Shqiptar i cili kishte arritur të realizohej në mënyrën më të përsosur me anë të hallkave të specializuara të diplomacisë së fshehtë si dhe të organizimit efikas të rrjeteve agjenturore që mbulonin zona, hapësira dhe territore me interes për shtetin.

Profesori na thoshte se **INFORMATIKA** është hallka bazë për të ruajtur dhe konsoliduar një shtet. Poashtu, ai na fliste për historinë e shërbimit sekret qysh para 2000 vjetësh si në **Kinë, Vatikan, Greqi, Persi, Itali, Vatikan, Turqi** etj. Na fliste për librin e autorit kinez SUN TZU për ARTIN E LUFTËS, në të cilin (në kapitullin 13) flitej për **PËRDORIMIN E SPIUNËVE**, ku theksohej rëndësia e spiunëve për garantimin e fitores në luftë, dhe klasifikimi i tyre në pesë grupe kryesore: SPIUNË LOKALË; të infiltruar brenda kundërshtarit, spiunë të konvertuar, spiunë që sakrifikohen për organizimin e DEZINFORMIMIT, si dhe ata që mbijetojnë duke grumbulluar informacione. Dhe në këtë kontekst profesori theksonte se si ia kishte arritur qëllimit **Sigurimi Shqiptar** të siguronte këto pesë hallka agjentësh të fshehtë duke zbuluar planet, organizimin dhe strukturën ushtarake të armikut. Kështu ky shërbim superior kishte arritur që vetëm brenda harkut kohor **1949-1955** të zbulojë 358 grupime me 1636 pjesëtarë të armatosur në Maltë, Mynih, Kretë, Heidelberg, Pire etj. , dhe shumica e këtyre personave iu dha organeve hetimore e gjyqësore, nga ku dolën informacione befasuese, ku dilte në pah përpunimi i madh ideologjik, politik e psikologjik që u bëhej subjekteve të emigracionit shqiptar për t'u rekrutuar në radhët e këtyre agjenturave armike. Këtë e vërteton në librin e tij edhe **Lordi Bethel** në librin e tij – The Great Betrayal **(TRADHTIA E MADHE).** Sigurimi shqiptar kishte arritur që përmes agjentit të dyfishtë, KIM FILBI, të vazhdonte LOJËN me CIA-n për një periudhë prej 18 muajsh (nga muaji korrik 1949), ndërkaq shërbimet italiane, greke dhe jugosllave nuk dinin asgjë për këtë lojë. Vetëm Asfalia greke më 1949 kishte infiltruar në Shqipëri **56 banda të armatosura me 194 banditë**, ndërsa po në këtë vit Jugosllavia kishte organizuar 119 banda përmes emigracionit politik shqiptar të grumbulluar në Jugosllavi. Loja e Madhe kishte vazhduar për 18 muaj rresht. Meqë radisti **Prençi** ishte vrarë qysh në përpjekjet e para me

forcat e Sigurimit të Shtetit, ishte bërë zëvendësimi i tij me një **radist tjetër,** i cili ishte i plagosur në dorën e djathtë, dhe **radio-loja kishte vazhduar pasi radisti i sigurimit do transmetonte në radio me dorën e majtë**. Truku funksionoi edhe kur u kërkua se ku i kishte vendosur Zenel Shehu florinjtë që mori nga mbreti? Megjithatë loja vazhdoi dhe kërkesa për të parashutuar agjentin dhe diversantin tashmë legjendë funksionoi. Ndërkaq, **Hamit Matjani**, mbi bazën e koordinatave ekzakte u arrestua qysh në ajër nga grupi operativ, dhe konkretisht nga Heroi i popullit **Asim Aliko**. Poashtu është shumë e rëndësishme të dihet se si kishin filluar marrëveshjet e FSHEHTA të ministrave të jashtëm **jugosllavo-grekë – Mosha Pijade dhe Caldaris**, për copëzimin e Shqipërisë më 19 korrik deri më 15 tetor 1946, të cilët nuk kishin rënë dakord për shkakun e **"oreksit të madh"** që kishin, për të marrë secili **pjesën më të madhe të territoreve tona**, gjë që **Josip Broz Tito** do ta kundërshtonte më vonë edhe ambasadorin amerikan Kavendish Kenan **më 22 shtator 1949** duke i thënë: "Është punë e tyre se si i rregullojnë shqiptarët çështjet e tyre të brendshme… ", duke pasur besim të plotë tek agjentura e tij në radhët e subjekteve të shtetit shqiptar (siç ishte **Koçi Xoxja me shokë**), për ta **"GËLLTITUR"** Shqipërinë në rastin më të volitshëm. Por Titua dhe Caldarisi ndoshta i kishin harruar fjalët emblematike të Komandantit të Përgjithshëm, gjeneral **Enver Hoxha**, i cili në Konferencën e Paqes në Paris (më 29 deri më 15 tetor 1946) iu kishte drejtua Caldarisit me këto fjalë:

„E GJITHË BOTA TA DIJË SE POPULLI SHQIPTAR NUK E KA DËRGUAR DELEGACIONIN E TIJ NË PARIS PËR TË DHËNË LLOGARI, POR PËR T'U KËRKUAR LLOGARI ATYRE QË E KANË DËMTUAR DHE QË AI I KA LUFTUAR ME ASHPËRSI DHE DERI NË FUND... " (Shih:E. HOXHA – GJITHMONË VIGJILENTË, faqe 351)

Profesor Qazimi na fliste me zjarr për gjithë këtë veprimtari heroike të pushtetit popullor. Nga tetori i vitit

1946 e deri në janar të vitit 1947 në luftën e organizuar kundër bandave dhe grupeve të armatosura që vepronin në Shqipëri, **u vranë 393 anëtarë të tyre**, si dhe **u kapën** të gjallë 770 persona të armatosur. Njëri ndër ta ishte edhe kapiten **Zenel Shehu**, nga Bulqiza, roje mbretërore e Ahmet Zogut, i cili si përgjegjës grupi, ishte stërvitur në bazën e Pireut, dhe në hetuesi kishte deponuar këto të dhëna: " … **Pak kohë pas kthimit nga Amerika, më 27 tetor 1951, më thirri Zogu e më njoftoi se kishte vendosur të më dërgonte me mision në Shqipëri. Ai më tha, gjithashtu, se më kishte vënë në dispozicion të amerikanëve...** " Më 7 gusht 1949 në një përpjekje heroike vritet Bardhok Biba, e më vonë **Cuca e Maleve** dhe mësuesi **Ndrec Ndue Gjoka** me urdhër të Rankoviqit. Ndërkaq në Paris, më 26 gusht 1949, krerët e emigracionit politik në krye me Mit'hat Frashërin, Abaz Kupin, Seit Kryeziun, Nuçi Kotën dhe Zef Palin shpallin formimin e KOMITETIT KOMBËTAR SHQIPTAR. Gjatë këtij viti (1949) serbët kishin bërë 119 provokacione në kufi, në krye të te cilave ishin drejtuesit kryesorë të OZN-ës: Spasoje Gjakoviqi, Çedo Topalloviqi, Çedo Mijoviqi, Dushan Mugosha etj. , që ishin kuadrot kryesore të gjenocidit kundër Shqipërisë dhe Kosovës martire. Në këtë periudhë përgatiteshin **1105 pjesëtarë të emigracionit politik në qendra sekrete stërvitjesh në Jugosllavi – Guci-Podujevë, Ferizaj, Prizren – 377 pjesëtarë**. Profesor Qazimi na fliste edhe për shërbimin sekret amerikan, CIA (e formuar më 26 korrik 1947 me dekret të presidentit Harri Truman) me 20.000 agjentë në Amerikë dhe rreth 200.000 agjentë jashtë territorit të saj në krye te të cilëve ishte Allen Dalles. Ndërkaq në BRSS më 1953 u formua KGB-ja me një agjenturë masive me rreth 4 milionë informatorë brenda territorit të tij, dhe 250 mijë agjentë në gjithë botën, në krye të te cilës ishte Laurenti Beria. Profesori na fliste me kompetencë për rolin e agjentëve të dyfishtë të cilët kishin arritur të dekonspironin të gjitha bandat e dërguara në Shqipëri, pa përjashtuar edhe bandën

e fundit të **Xhevdet Mustafës** (1982) që erdhi për të bërë terror, dhe ia arriti pjesërisht qëllimit, por jo qëllimin e koduar të tyre për të **eliminuar udhëheqësin kryesor të Shqipërisë**. Poashtu një preokupim të veçantë e kishte profesori për shumë të panjohura dhe sidomos për vetëvrasjen e Mehmet Shehut, prej të cilit Enver Hoxha kërkonte të dijë:

1. Pse nuk është njoftuar për futjen ilegalisht të Panajot Plakut (më 15 maj 1957 në Shqipëri dhe takimet e tij me Feçor Shehun dhe Mihallaq Ziçishtin në Pentar të Shkodrës, pastaj takimet e tij me Tahir Demin në Elbasan, me Teme Sejkon në Orikum…. Grupi i Mehmet Shehut (Mihallaq Ziqishti dhe Kadri Hazbiu) e organizoi arratisjen e Panajot Plakut në Jugosllavi, ndërsa vetë Mehmeti kamufloi kombinimin me udhëtimin për pushime në Moskë, dhe atje kishte takuar gjeneral Panajot Plakun…) Gjeneral Arif Hasko në hetuesi pohon se në grupin e Mehmet Shehut ishin: Panajot Plaku, Beqir Balluku, M. Ziqishti, Z. Themeli, Feçor Shehu (i rekrutuar nga shërbimi jugosllav në vitet 1949-1951), Ll. Peçini dhe Ll. Ziçishti, dhe këtij grupi iu dha për detyrë të vazhdohej rruga e Koçi Xoxes, që Sigurimi të kontrollonte Partinë dhe drejtuesit kryesorë të saj. Mehmeti urdhrat dhe udhëzimet i merrte nga Panajot Plaku…
2. Enver Hoxha kërkonte alibinë se pse u fut në burg gjenerali i nderuar Arif Hasko me akuzë të rreme, në një kohë që me Panajotin ishte takuar Teme Sejko e jo Arif Hasko, dhe pse nuk ishte njoftuar për të gjitha këto?
3. Të deklarohej për takimin e tij në shtator 1960 në anijen "Kuin Elisabet" me Randolf Çërçillin, J. B. Titon, Koça Popoviçin, ministrin e jashtëm jugosllav, takim ky që kishte zgjatur rreth gjysmë ore, pastaj takimi me Randolfin, një nga kuadrot kryesore të shërbimit sekret anglez, MI-6…
4. Të dhënat nga kasaforta sekrete e Hysni Kapos…

5. Të dhëna nga kasaforta e vetë Mehmet Shehut, ku kishte një material të bollshëm kompromettues i cili iu kishte fshehur vendimmarrësit për 20 vjet;

6. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme;

7. Arkivi Shtetëror;

8. Informacioni i detajuar i organizatave bazë të Partisë.

Por janë shumë sinjifikative çështjet që dalin nga letra që Mehmet Shehu ia la Enver Hoxhës para se të kryente aktin makabër të vetëvrasjes (më parë Mehmeti ishte konsultuar edhe me bashkëshorten Fiqereten se Kadri Hazbiu ia kishte mbyllur edhe një derë, nga e cila mund të dilte, dhe pas këtij takimi ai kuptoi përfundimisht se duhet të sakrifikohej që të shpëtonte të paktën fëmijët e tij), kur thotë – **Ramizi është HRUSHQOV**, ndërsa për Kadriun thotë se është – JAGO, duke i lënë porosinë Enverit për të luftuar tri fuqitë imperialiste, si dhe HRUSHOVIN (Ramizin) dhe **JAGON** (Kadriun), i cili pas kapitullimit të bandës së Xhevdet Mustafës më 1982 u likuidua si poliagjent). Mehmet Shehu para se të bënte aktin e vetëvrasjes fizike, kishte bërë vetëvrasjen morale, për të mos mbetur në duart e hetuesve, që dikur ai i kishte vartës. Në këtë kontekst janë shumë domethënëse fjalët e profesor **Abaz Ermenjit** (i arratisur si agjent nga Shqipëria) i cili më në fund kishte pranuar këtë fakt tronditës për emigracionin shqiptar kur kishte thënë: **"TË HUAJT NA PËRDOREN NE SI MINJË LABORATORI...** (për këtë më së miri flitet me argumente në romanin në dy vëllime të autorit Nasho Jorgaqi: **MËRGATA E QYQEVE, ku protagonist kryesor është JUSUF MULLAI**, oficer i lart shqiptar, me pseudonimin MANUSH KELMENDI, i cili arriti të depërtonte deri në bazat sekrete të këtyre agjenturave të Inteligjens Servisit dhe CIA-s dhe gjithë materialin sekret e kishte sjellë pa u diktuar në Shqipëri)

Në këtë kontekst profesori na përkujtonte se sa e fuqishme ishte Shqipëria e viteve gjashtëdhjeta, kur para 81 partive komuniste në Moskë Enver Hoxha e kishte sfiduar Nikita Hrushçovin, dhe ua kishte dhënë forcave ruse ultimatumin në bazën e Pashalimanit, që brenda 24 orëve të ikin nga Shqipëria, dhe ky ultimatum po ndodhte në kohën kur BRSS kishte instaluar bazat e raketave bërthamore në Kubë, dhe N. Hrushçovi në një seancë të Asamblesë së OKB-së kishte zbathur këpucën dhe po i binte tryezës së foltores duke kërcënuar vendet e aleancës së NATO-s me raketat në Kubë, dhe duke i trajtuar ato vende në mënyrën më të mjerueshme.

Profesori i nderuar na shpjegonte edhe faktin se Shqipëria socialiste për 50 vite me radhë u bëri ballë bllokadave dhe bandave të armatosura përmes të cilave si Perëndimi ashtu edhe Lindja eksperimentonin ditë e natë se si ta rrëzonin një qeveri, një regjim, i cili kurrë nuk i kishte rënë askujt në qafë edhe pse ky regjim dha një SHEMBULL UNIKAT në botë, në vitet e 60-ta kur doli nga TRAKTATI famëkeq i VARSHAVËS, dhe shporri bazat sovjetike nga Vlora e Pashalimani, në një kohë kur bazat e NATO-s në territorin e Italisë si në Aviano, Augusto, Brindizi, San Vito, Xhoja del Koles, Riçione etj. rrinin në gatishmëri të plotë ditë e natë, duke harxhuar **rreth 5 miliardë dollarë në vit**. Falë gjestit heroik të Shqipërisë ky buxhet u lehtësua në minimum dhe u amortizua FRIKA dhe STRESI i përhershëm i ushtarëve të NATO-s nga prania dhe agresiviteti i NËNDETËSEVE sovjetike, sidomos ato në bazën e qytetit të VLORËS. Por ushtarakët e NATO-s harruan propozimet e marshallëve sovjetikë Malinovski dhe Greçko për pajisjen e raketave shqiptare me mbushje BËRTHAMORE, të cilat do të instaloheshin në zonën Butrint-Karaborun, të drejtuara në objektet strategjike të Italisë fqinje. Dhe dihet se këto projekte kobzeza nuk u realizuan vetëm falë gjenialitetit të strategut Enver Hoxha. Profesori na fliste edhe për

heroizmin e ushtrisë shqiptare e cila kur kapitulloi Italia fashiste në shtator 1943 i strehoi, i ushqeu dhe më në fund i ktheu shëndoshë e mirë në vendin e tyre mbi 100 mijë italianë robër lufte. Por nuk duhet harruar edhe faktin se Gjermania Federale ua ka paguar një për një dëmet e luftës (reparacionet) të gjitha shteteve të dëmtuara përveç Shqipërisë, ndërsa Britania e Madhe edhe sot e kësaj dite nuk ia ktheu kurrë shtetit shqiptar 1574 kg. ari të deponuar në bankat angleze nga mbreti Zog. Profesori na thoshte shpesh se **MOSMIRËNJOHJA ËSHTË POSHTËRSIA MË E MADHE!**

ꕥ

Dhe si përfundim, shtonte profesori, për komunistët revolucionar SOCIALIZMI NUK KA DËSHTUAR, por u PËRMBYS me anë të veprimtarisë revizioniste dhe të ndërhyrjes imperialiste, me TRADHTI nga brenda e nga presioni nga jashtë, dhe duhet ta dimë mirë se do të duhet një periudhë e gjatë përpjekjesh mbinjerëzore e luftërash për të arritur objektivat e socializmit dhe komunizmit, sepse më 1852 , në letrën drejtuar Vedemejerit, Karl Marksi shkruan-

Sa për mua, nuk më takon as merita e zbulimit të ekzistencës së KLASËS në shoqërinë e sotme, as ajo e zbulimit të luftës midis tyre. Historianët borgjezë shumë kohë përpara meje kanë parashtruar zhvillimin historik të kësaj lufte, dhe ekonomistët borgjezë-ANATOMINË EKONOMIKE TË KLASAVE. Ajo që solla unë të re ishte, se provova sa vijon;

SE EKZISTENCA E KLASAVE ËSHTË E LIDHUR

VETËM ME FAZA HISTORIKE TË CAKTUARA TË ZHVILLIMIT TË PRODHIMIT;

SE LUFTA E KLASDAVE ÇON MEDOEMOS NË DIKTATURËN E PROLETARIATIT;

Se vetë kjo DIKTATURË s'është, veçse kalim drejt zhdukjes së çfarëdo klase dhe drejt SHOQËRISË PA KLASA...(MARKS-ENGELS, Vepra të zgjedhura,II,f.430).

Së këtejmi, lufta e klasave nuk është një ABSTRAKSION TEORIK -një shpikje e komunistëve shqiptarë, apo shpikje e Enver Hoxhës, siç thonë politikanët e sotëm borgjezë, ballisto-zogistë dhe pseudohistorianët, ose siç e mohon këtë luftë sot zëdhënësi i borgjezisë, Ramiz Alia, kur thotë në librin- SHPRESA DHE ZHGËNJIME, f. 14:

" E keqja e shoqëroi sistemin socialist, të zbatuar në BS dhe tek ne, duke ideologjizuar të gjitha fenomenet e jetës,duke e parë LUFTËN E KLASAVE si forcë kryesore lëvizëse dhe pas vendosjes së Pushtetit Popullor, vëmendja u spostua tek ARMIKU I KLASËS dhe zhvillimi më tej me atë, se si bëhej lufta kundër tij..."

Derisa ne në Kosovë kishim ndërmarrë një aksion për të luftuar plagët e GJAKMARRJES dhe NGATËRRESAVE (në vitet e 90-ta), që do të thotë se po merreshim me PASOJAT e jo me SHKAKTARËT e krimit, ndërsa nga një statistikë e arkivave të shtetit shqiptar dilte se brenda vitit më 1930-1938 kishte 772 vrasje (Shkodër – 244, Dibër – 140, Kosovë – 136, Vlorë – 10), dhe pastaj:

Vitet 1945-1950…. . 153 vrasje;
Vitet 1951-1960…. . 39 vrasje;
Vitet 1961-1965…. . 3 vrasje dhe
Vitet 1966-1982.... . 0 vrasje, dhe komenti është i tepërt për të shpjeguar se si u arrit të zbresë në kuotën zero kriminaliteti i rrezikshëm i gjakmarrjes në Shqipëri, sepse u zhdukën shkaktarët që e kushtëzonin këtë krim njerëzor (shtrohet pyetja: pse nuk u krye asnjë krim i gjakmarrjes në vitet **1998-1999** kur në Kosovë kishte shpërthyer lufta çlirimtare e UÇK? Sepse tërë energjia negative e tërë kombit të robëruar ishte drejtuaer në drejtim të luftimit me çdo kusht të armikut kolonizator serbo-jugosllav). Por pas restaurimit të sistemit kapitalist në Shqipëri, **krimi i rrezikshëm i gjakmarrjes sërish u ringjall i stimuluar nga problemet pronësore, mungesa e shtetit ligjor, kështu që**

vrasjet nga gjakmarrja u shtuan duke zënë 11% të vrasjeve të kryera brenda territorit të Shqipërisë?!

Profesori na fliste me admirim të lart për luftërat çlirimtare të popujve të kolonizuar: Kriza kubane, lufta e cila e çoi botën buzë greminës së kasaphanës së përgjithshme, lufta e Vietnamit, Algjerisë, Palestinës, ”Revolucionet” në Amerikën Latine, fenomeni Çe Guevara, lufta në Afganistan (në vitet 1980-1989 kundër pushtuesve sovjetikë), lufta në Angola, luftimet në Kil, Liban, Kamboxhia, pastaj për luftën heroike të popullit Çeçen kundër kolonizatorëve sovjetikë, luftimet në Kuvajt dhe pushtimi i Irakut nga SHBA-të, Lëvizjet çlirimtare të popullit Bask, Organizata çlirimtare e irlandezëve në Irlandën Veriore (Alster) – IRA etj. Profesori theksonte se si ia kishte arritur Shqipëria të shpëtonte nga kthetrat e superfuqive vetëm falë vigjilencës dhe guximit heroik, të cilit ia kishte lakmi edhe ish-presidenti i Francës, **De Gol**, i cili kishte thënë: “… Jam vetëm profrancez, dhe ajo që i dëshiroj Francës është e drejta e saj për të kontestuar. Po qe se nuk KONTESTOJ, UNË NUK JAM ALEAT, **POR PROTEKTORAT”**. Shembulli më shkollor është rasti i Çekosllovakisë kur atje u futën tanket e pushtuesve sovjetikë më 1968, edhe pse Çekosllovakia kishte të drejtë të dilte nga Traktati i Varshavës, siç kishte dalë Shqipëria më 1960, por meqë **Çekosllovakisë** i mungonte një Enver Hoxhë, ajo kapitulloi para diktatorit fashist Brezhnjev, i cili veproi me logjikën e forcë së tankeve sovjetike. Poashtu, Egjipti më 1956 kishte të drejtë të vendoste mbi sovranitetin mbi Kanalin e Suezit, por duke mos pasur forcë të përballonte ushtrinë anglo-franceze u detyrua të pranonte forcën e tyre dhe konceptin e tyre mbi të drejtën. Më 1973, populli kilian kishte të drejtë të zgjidhte formën e tij të qeverisjes dhe politikën e jashtme që do të ndiqte duke pasur në krye demokratin **Salvador Alienden**. Por meqë nuk kishte forcë për ta mbrojtur këtë të drejtë, u detyrua të pranojë atë të drejtë që i dhanë amerikanët, **DIKTATURËN gjakatare të Pinoçetit**. Më 1981, populli

shqiptar në Kosovë kishte të drejtë të kërkonte statusin e REPUBLIKËS, por duke mos pasur FORCË, u detyrua të pranonte atë të drejtë **sa i dhanë tanket dhe ushtria gjakpirëse jugosllave** e cila masakroi mbi 400 demonstrues nëpër rrugët e Prishtinës. Mbi këtë bazë kemi të drejtë të themi se përcaktimet mbi të DREJTËN në programet e organizmave ndërkombëtarë nuk kanë qenë gjë tjetër veçse një **MASHTRIM I MADH** mbi popujt dhe shtetet e ndryshëm. Por edhe periudha e re e marrëdhënieve ndërkombëtare, ajo pas viteve 1990, kur BLLOQET nuk ekzistojnë më, dhe kur sistemi komunist nuk ekziston më, në fakt ka mbetur ajo e para. Gjatë periudhës 1990-1999 marrëdhëniet ndërkombëtare janë ndeshur me disa konflikte të përgjakshme, siç është rasti me luftërat e kroatëve me serbët, luftërat e boshnjakëve dhe serbëve në Bosnjë e Hercegovinë, dhe me luftën e shqiptarëve të Kosovës me Jugosllavinë (1997-1999), pastaj me konfliktin ruso-çeçen dhe turko-kurd. Në të gjitha këto konflikte kemi një tabllo të tillë ku nuk vendos drejtësia, por forca. Kështu në **Dejton të Ohajos** (SHBA) më 1995 Bosnja u nda padrejtësisht 50% me 50% në dobi të Serbisë, dhe Kroacisë (me ndarjen e Mostarit përmes lumit **Neretva**, ashtu siç do të ndahej më vonë edhe Mitrovica përmes lumit IBËR). Ndërsa çeçenët edhe pse shpallën Republikën e pavarur të Çeçenisë nën udhëheqjen e gjeneral Dudajevit, kapitulluan, sepse aviacioni dhe tanket ruse marshuan dhe e bënë shkrumb e hi Groznin dhe tërë Çeçeninë, dhe në qeverinë kukull erdhi **Kadirovi** tradhtar, ndërsa SHBA-të nuk ndërhynin në zonën e interesit rus. Edhe kurdët janë një popull me mbi 25 milionë banorë, dhe kërkojnë të drejtat e tyre legjitime, por meqë u mungon forca, këto të drejta nuk po realizohen edhe sot e kësaj dite (dhe sa herë na fliste për popullin kurd, profesori na thoshte se sa për t'u ngushëlluar se ka edhe më keq se sa gjendja e shqiptarëve të copëtuar në pesë shtete, i kemi kurdët edhe më keq se ne). Por, në këtë kontekst, edhe për popullin e copëtuar shqiptar po

veprohet sipas kritereve të vjetra, me vetë faktin se në RAMBUJE, mars 1999, po bëhej presion mbi përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) që ata të çarmatoseshin dhe të pranonin KOMPROMISIN dhe kushtet e KAPITULLIMIT, që në Kosovë të ndërhynin forcat e NATO-s, ashtu siç ndërhynë forcat e Evropës në Shqipëri më 1913, pas shpalljes së pavarësisë më 28 Nëntor 1912. Thelbi i këtij konflikti midis popujve të Ballkanit janë kontradiktat e të mëdhenjve: Francës, Anglisë, Gjermanisë, Rusisë etj. Kush janë ata që u masakruan nga lufta? Popujt e Ballkanit. Kush janë ata që pësuan nga sanksionet? Popujt e Ballkanit. Kush janë ata që nxitën dhe ndezën luftërat? Fuqitë e Mëdha. Kush janë ata që shuan zjarrin e luftërave? Sërish Fuqitë e Mëdha, njësoj si dje. Kush janë ata që përfituan nga shitja ilegale e armëve? Fuqitë e Mëdha. Pra, zjarri i ndezur është larg Evropës Qendrore e Perëndimore, në periferi të kontinentit, në gadishullin Ballkanik, na thoshte profesori. Ai i elaboronte pa u lodhur këto probleme në mënyrë dialektike dhe shtonte se në rrënjën e DRAMËS SHQIPTARE qëndron **PADREJTËSIA** e shteteve evropiane të cilat e projektuan dhe e miratuan copëtimin e trojeve shqiptare dhe aneksimin e tyre nga Serbia, Mali i Zi, Greqia, dhe sot Maqedonia, kështu që si pasojë edhe sot e kësaj dite mbi 70% të trojeve shqiptare janë nën okupimin e shteteve fqinje, dhe ky problem përbën sot KONTRADIKTËN KRYESORE midis shqiptarëve dhe bashkësisë evropiane. Shqiptarët sot janë para dilemës: TË PRANOJNË FILOZOFINË POLITIKE QË UA OFRON EVROPA, DUKE HEQUR DORË NGA BASHKIMI DHE ÇËSHTJA KOMBËTARE, apo të mos e pranojnë zgjidhjen e Evropës, duke e zëvendësuar **KOZMOPOLITIZMIN** me **NACIONALIZMIN shqiptar**? Thelbin e filozofisë politike moderne evropiane e ka dhënë shumë qartë **Dritëro Agolli** me këto fjalë:

" Puna është se Evropa nuk do që ne shqiptarët të bashkohemi dhe të bëhemi një shtet i madh! Përse na

duartroket dhe na lavdëron Evropa? Na duartroket dhe na lavdëron jo se paskemi ndërtuar demokracinë, por na duartroket dhe na lavdëron pasi nuk e duam SHQIPËRINË E BASHKUAR dhe nuk kërkojmë ndryshimin e kufijve. Evropa na thotë: A doni sallam e coca-cola, a doni whiski dhe xhin? Ju jap, vetëm mos kërkoni ndryshimin e kufijve. Evropa thotë "bravo Shqipëria". Dhe Shqipëria hyn në Evropë si INVALIDE me gjysmë trup, me paterica dhe me librezën e invaliditetit në xhep. Këtë invalid me librezë invaliditeti, Evropa e përshëndet me brohori. Dorën mund t'ia shtrish Evropës vetëm për djathë dhe sallam, se po e shtrive për kufijtë, ajo ta pret" (Dritero Agolli, intervistë dhënë revistës REPUBLIKA, dhjetor 1995).

Profesori e kishte kuptuar shumë mirë esencën e propagandës që u bë mbi shqiptarët në fillim të viteve '90-të. Atyre iu tha se, me PËRMBYSJEN E KOMUNIZMIT, Shqipëria do të LULËZOJË: politikisht, ekonomikisht; se njerëzit e saj do të punojnë në vendet e ndryshme të Evropës; se ata do të jenë të lirë të qarkullojnë ku të duan pa vështirësi, dhe kësaj propagande hileqare i besuan shqiptarët në Shqipëri dhe **përmbysën çdo gjë që kishte ndërtuar populli në kohën e komunizmit.** Dhe arritën deri atje sa edhe ato pak kursime që kishte bërë populli i shumëvuajtur t'ia grabitnin përmes **firmave piramidale mashtruese (miliarda dollarë)**. Gjithë kjo tragjedi skandaloze që kishte pllakosur popullin në një mjerim të paparë e kishin frymëzuar poetin Dritero Agolli të shkruante poezinë – POETI DHE VDEKJA:

Veç me vdekjen s'jam takuar kurrë,
ndaj e pres të nderuar në shtëpi.
Për respekt – një qengj manar në furrë,
për humor – një shishe me raki.

Do ta ftoj në sofër tok të pimë
vdekja mbretëreshë dhe unë mbret!
Dehur bashkë natën do gdhijmë,
dehur do dalim në qytet.

Xurxull vdekja do këndojë: U prisha!
Moralisht u prisha!... Ah, ç'mëkat!
Do çuditet President Berisha
„Paska dehur vdekjen ky lugat!"

Këmbanat mortore të "DEMOKRACISË" po bënin gjëmën me tërë egërsinë dhe brutalitetin mbi një popull të tërë **pas 22 marsit 1992**. Vazhdoiniun krismat nëpër natë, vriteshin njerëz, grabiteshin dyqane, digjeshin shkolla. Viktimat pa jetë e të gjymtuara e masakruara barbarisht i shihje në çdo lokalitet. Hijet e zeza **po spërkatnin me benzinë bankat, dërrasat e zeza, dritaret, dollapët, tavolinat, dokumentacioni pedagogjik i sa e sa brezave, dhe flakët e zjarrit kishin përpi çdo gjë, kishin ngelur vetëm rrënojat e shkollave...Kjo ishte padyshim gjëma më e llahtarshme e viteve të fundit, ku shkronjat për librat shqip të Dhaskal Todrit u lyen me gjak, Armiku këtu synonte, në pikën më nevralgjike, në kokën e një populli, në zemrën e një populli, në ardhmërinë e një populli martir, i cili prapambetjen kulturore të pesë shekujve e kishte kapërcye me heroizëm për 50 vjet**, dhe nga mësonjëtoret elementare dhe abetarja tek UNIVERSITETI dhe disertacionet, te arsimi i detyruar dhe falas 8-vjeçar dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm te AKADEMIA E SHKENCAVE dhe Teatri i Operas dhe Baletit. 182 intelektualët e Shqipërisë nënshkruan MANIFESTIN e tyre më 15 mars 1992 të cilëve iu bashkuan edhe mijëra e mijëra të tjerë se atyre u ishte sosur DURIMI! Dhe me këtë iu hap drita jeshile **"demokracisë"**, por ky manifest u harrua menjëherë dhe si rrjedhojë erdhi "Manifesti i dytë i intelektualëve", për Kushtetutën e Berishës më 1994 që të mos përfillej më nga populli, meqë intelektualët e Manifestitit të 1992-shit u hodhën në rrugë në shumicën e tyre. Tani restaurimi kapitalist kishte marrë frenat dhe çdo gjëje që ishte ndërtuar me gjak e djersë për 50 vite po përmbysej brenda

natës për të realizuar të ashtuquajturën-KUOTËN ZERO?! Që të paralizohej gjithë industria dhe tërë hekuri, bile edhe binarët e hekurudhës të shiteshin jashtë vendit. Po propagandohej ÇEKU I BARDHË? Çek i zi që niste me korrupsionin e një grupi hajdutësh ordinerë përmes përvetësimit të paligjshëm të pasurisë shoqërore. **Që vajzat tona të merrnin rrugën e prostitucionit** në Evropë. Shqipërinë e kishte kafshuar "mortaja", po shuhen pemët, po priteshin ullinjtë, po shkatërroheshin vreshtat, pyjet dhe çdo gjë që kishte mbëltuar dora e bujkut duarartë. Fidanishteve dhe plantacioneve i kishin futur buldozerët. Prapë po livadhisnin vandalët nën hundët e një qeverie demokratike? Partia në pushtet më 1993 **nxori në pension para kohe të gjithë profesorët dhe shkencëtarët e shkollave të larta dhe institucioneve shkencore që sipas mendjes së saj ishin të majtë.** Për qeverinë demokratike nuk kishte rëndësi se ç'vlera potenciale përfaqësonin ata për vendin, rëndësi kishte për ta që nuk ishin me Partinë Demokratike. Shkurt, Shqipëria u nxor në ANKAND Nuk kishin kaluar veç katër muaj dhe populli e kishte kuptuar mashtrimin sepse në krye të pushtetit kishin ardhur një turmë hajdutësh, dhe populli në zgjedhjet e pushtetit lokal në korrik të vitit 1992 i tha jo kësaj bande. Por parlamenti shqiptar me mazhorancën e Partisë Demokratike po merrej me heqjen e yllit nga flamuri, me ndërrimin e targave të makinave, me zhvarrosjen e militantëve e heronjve të LANÇ, me rikthimin e gradave në ushtri etj. Dhe kulmi i kësaj katrahure u arrit me skemat piramidale të fajdeve, të cilat qenë një strategji e menduar mirë dhe një MASHTRIM kolosal për t'i grabitur popullit edhe atë pak që i kishte mbetur. Skemat piramidale ishin GOMA E SHPËTIMIT për politikën ekonomike të qeverisjes së PD-së. Dhe kurrë nuk u bë e ditur se kush i ka grabitur paratë e popullit, ku janë çuar për t'u pastruar, dhe po heshtet për peshkaqenët mafiozë të cilët duhet t'i godas çekani i pamëshirshëm i drejtësisë. Të gjitha këto ngjarje po i përcillte me indinjatë profesori Qazim dhe shtonte se

QEVERITË KUKULLA mbahen në secilin vend të botës nga të huajt vetëm për interesa të tyre. Kështu kur u zemëruan padronët në fillim të muajt **janar 1997** pushtetin shqiptar në një gazetë të madhe perëndimore e cilësuan si QEVERI GANGSTERËSH. Populli i mashtruar është OPOZITA REALE në Shqipëri, dhe kjo opozitë është shumë e rrezikshme, ndërsa partitë politike janë vetëm opozitë juridike formale. **MJERIMI** dhe zhgënjimi nuk njeh ngjyra partie, ai është i njëjtë dhe ka vetëm një EMËR: MJERIM DHE VARFËRI. Nga ana tjetër opozita reale e jashtme janë SHBA-të, dhe kjo opozitë është shumë e rrezikshme për pushtetin shqiptar, dhe sidomos pas **26 majit 1996**, ndërsa organizmat ndërkombëtar si OSBE-ja, Këshilli i Evropës, Federata e Helsinkit, janë **opozitë juridike** e jashtme, dhe fuqia e tyre është deri në bërjen e rezolutave, dhe hiç më shumë. Por nuk duhet harruar se ishte ambasadori amerikan **Rajerson** në Korçë ideatori i fushatës së makartizmit në Shqipëri kur deklaroi se pas zgjedhjeve të **22 marsit 1992**, socialistëve u uronte të mbeteshin pa punë. Ndërsa rasti më eklatant është më 30 korrik 1993, kur vetëm tre orë e gjysmë para se të arrestohej Fatos Nano deklaron në konferencën e partisë socialiste për Tiranën se ambasadori amerikan RAJERSON ka ardhur në Shqipëri me **THIKË NË GOJË** për të vënë shqiptarët kundër shqiptarëve. Por në çastin kur pas 26 majit pushteti shqiptar dhe lidershipi i tij u " rebeluan" ndaj Amerikës dhe filluan të kërkojnë ALETATË tjerë në Evropë, dhe për të ndëshkuar "rebelët" Amerika doli me kritikat e ashpra ndaj pushtetit shqiptar duke iu dhënë një leksion partive politike në Shqipëri:UNË QË JU SJELL NË PUSHTET, UNË MUND T"JU HEQ PËRSËRI KUR TREGOHENI TË PABINDUR DHE REBELË. **Kryengritja popullore kishte filluar në janarin e 1997**, ndërsa qeveria shqiptare kishte shpallur gjendjen e jashtëzakonshme duke mobilizuar ushtrinë dhe forcat speciale për të shtypur manifestimet paqësore. Populli në Vlorë ju përgjigj me rrëmbimin e

armëve. Pas Vlorës brenda një jave populli u ngrit dhe u armatos pothuaj **në 14 qytete të Shqipërisë së jugut dhe Shqipërisë së mesme**. S rezultat i kësaj kryengritjeje popullore në Shqipëri kemi faktin se në pushtet nuk erdhën drejtuesit e kryengritjes, por ish-opozita shqiptare e cila u **mbështet nga diplomacia euroamerikane** si e keqja më e vogël, sepse faktori ndërkombëtar më parë pranonin **rrëzimin e Berishës** se sa **ardhjen në pushtet të forcave kryengritëse.** Epilogu i kësaj kryengritjeje popullore u përmbyll me MARRËVESHJEN E 9 MARSIT N1997 me formimin e qeverisë së koalicionit. Dihet se të gjitha partitë pluraliste në Shqipëri pas vitit 1991 kanë përjashtuar nga programet e tyre marrjen e pushtetit me rrugë të ARMATOSUR. Synimi i tyre imediat ishte për t'u pranuar në gjirin e partive homologe në Evropën perëndimore. Ndërkaq qëndrimi i **partisë socialiste ndaj çështjes kombëtare është i njëjtë me qëndrimin e partisë demokratike.** Në këtë çështje që të dyja janë parti KOZMOPOLITE. Dhe kështu konkludonte profesori largpamës se kancelaritë evroamerikane kishin mbrojtur dhe përkrahur një qeveri gangsterësh dhe hajdutësh dhe jo një qeveri demokratike, sepse ata e dinin se kryengritja popullore ishte një lëvizje për DINJITET KOMBËTAR, ishte patriotike kombëtare, e jo kozmopolite. **Asnjëherë** populli shqiptar gjatë gjithë historisë së tij nuk ka qenë **më i POSHTËRUAR nga propaganda shoviniste e RACISTE e të huajve se sa gjatë periudhës 1992-1997** përmes librave, filmave, reportazheve dhe komenteve FYESE e denigruese. Kësaj i thonë- DEMOKRACIA E POSHTRIMIT, demokracia e shkatërrimit të shtetit, demokracia e parave të pista, demokracia e hajdutëve dhe mashtruesve e cila nën maskën e LUFTËS KUNDËR KOMUNIZMIT në fakt bëri gjyqin dhe përdhunoi racën shqiptare duke e rikthye **Shqipërinë realisht në vitin 1913** kur në Shqipëri **u vendosën forcat shumëkombëshe (Komisioni i Kontrolli),** dhe kështu duke e mbytur në gjak këtë kryengritje

popullore erdhi në pushtet përmes intervenimit ndërkombëtar **DIKTATURA KOZMOPOLITE**. e cila lejon edhe akte të tilla vandale të pashembullta duke rrëzuar edhe bustet e heronjve si **Ndrec Ndue Gjoka, Bardhok Biba** etj. e duke e futur Shqipërinë në skenarin makabër të vëllavrasjes.

Profesori Qazim na fliste me argumente lidhur me paradokset tona duke theksuar se në gusht **të vitit 1992 në Londër në Konferencën për Jugosllavinë** populli shqiptar i Kosovës trajtohet si MINORITET. Tekstin e deklaratës e miraton dhe qeveria shqiptare me anë të ministrit të jashtëm të saj.

-Më 1994 presidenti gjerman **Hercog** premton në parlamentin shqiptar **autonominë e Kosovës** dhe duartrokitet nga deputetët e parlamentit të cilët që para tre vjetësh kishin aprovuar një REZOLUTË ku njihej **PAVARËSIA e Kosovës**?!

-Në nëntor 1994 klasa politike shqiptare në Prishtinë që kishte bërë referendumin për pavarësinë e Kosovës, bën thirrje për miratimin e kushtetutës së Shqipërisë ku Kosova trajtohet si **PAKICË KOMBËTARE**?! Por profesori përherë e theksonte thënien e mençur lakonike të **Flavius Renatus:**

ATA QË DUAN PAQE LE
TË PËGATITËN PËR LUFTË!"

Dhe vazhdonte duke dhënë shembullin ilustrues të SHQIPËRISË e cila ishte bërë një kala e pamposhtur , sepse ushtria dhe populli ushtarë tre milionësh ishin bërë një me ato 22 DIVIZIONE, tre regjimente AVIACIONI me MIG-19 dhe 21(me 1200 pilotë), pastaj me tre regjimente (baza) detare dhe një fortifikim kolosal të pakalueshëm,nga toka dhe nga ajri, në një kohë kur Rumania 24 milionëshe **kishte 22 regjimente**.

Ne nxënësit e profesorit çuditeshim me gjithë këto të dhëna dhe shpesh e pyesnim se ku qëndron sekreti i këtij

SUKSESI në memorien e tij fenomenale? Dhe sipas tij formula është e shkurtër: **pakëz talent dhe punë dhe vetëm punë!** Merrte shembullin e Viktor Ygoit i cili thoshte se nuk duhet ta ndërpresësh asnjë ditë punën për krijimtarinë, sepse nuk ka gjë më të rrezikshme, shënonte ai në romanin TË MJERËT, sesa **puna e NDËRPRERË**. Poashtu na përkujtonte fjalët e Shilerit i cili GJENINË dhe AFTËSINË punonjëse i quante MOTRA që ecin bashkë dora-dorës, dhe pastaj fjalët e Zhyl Vernit i cili kishte thënë se-**Kur nuk krijoj, nuk ndjej jetë në veten time**, për të nxjerr përfundimin se po **NUK PUNOVE MBI VETVETEN je ZERO** dhe krijues nuk mund të bëhesh kurrë, që do të thotë përherë të jesh **shërbëtor** i punës së vetvetes. Kjo mund të konkretizohet qartë, theksonte profesori, duke marrë shembullin e gjigantëve të intelektit siç janë Shekspiri, Gëte, Balzaku, Marksi, Engelsi, Lenini, Bethoveni, Noli, Naimi, Samiu, Enveri, që secili prej tyre qe aq origjinal dhe secili prej tyre ka gërmuar në arkivin e tij me filozofinë e vet të punës, por që secili prej tyre në moshën e fëmijërisë nuk janë dalluar aq shumë nga fëmijët e zakonshëm. Pra artisti duhet të punojë gjithnjë dhe të mendojë gjithnjë ashtu siç na mësonte Naim Frashëri: **PUNË NATË E DITË, QË TË SHOHIM PAKËZ DRITË!** Dhe në vazhdim të kësaj teme mësuesi ynë mori shembullin e gjeniut të muzikës A. Çajkovski, për të cilin profesori i tij **A. Rubinshtajn** kishte thënë: **"Çjakovski punonte gjithë natën pa pushim, po edhe të nesërmen nuk e humbiste ditën e punës.** Kështu pas katër vjetësh e gjysmë nga një fëmijë muzikor u transformua në një burrë të pjekur me energji përrallore. Njëherë i dhash një detyrë në klasë që të punonte dhjetë variacione për një temë, kurse ai më solli më shumë se 200. Mua më duhej më shumë kohë për t"i lexuar sesa kishte harxhuar ai për t"i kompozuar ato". Profesori na tregonte për shfaqjen e talentit të **Mocartit** në moshën 5 vjeç, ndërsa **Bethoveni** shtatë vjeç çuditën njerëzit. Pastaj na ilustroi një shembull të jashtëzakonshëm të skocezës EVELYN GLLENIE, soliste unike në botë në

instrumentet me prekjes. Skocezja 28 vjeçare kur ishte 8 vjeç, për shkaqe që nuk u sqaruan kurrë, nervat dëgjimore filluan të degjenerojnë . Në moshën 12 vjeç qe plotësisht e SHURDHËR, por nuk u përkul se dëshironte të studionte muzikë. Pasi mbaroi akademinë muzikore të Londrës vendosi të SFIDOJË të gjithë dhe gjithçka: **sëmundjen, skepticizmin, mosbesimin madje dhe vetë natyrën e u bë soliste.** Dhe si është e mundur që pa dëgjuat të krijosh notat që duhet dhe t"i harmonizosh tingujt me ato që krijon një orkestër?Skocezja e jashtëzakonshme jep 120 koncerte në vit. Më 1994 ajo ekzekutoi në Cincinati së bashku me orkestrën simfonike të qytetit me shkathtësinë e një atleteje dhe realizoi ritme e melodi nga cimbalet,timpanet,kongat kubane,një vibrafon,katër ksilofon etj. Nga kjo del se **ARTI kërkon PUNË KËMBËNGULËSE,** sakrifica, tension të vazhdueshëm,dashuri të madhe, sepse talenti nuk është gjithnjë dhuratë e natyrës. Prandaj duhet të investojmë shumë dhe kërkojmë shumë për TALENTIN. Duhet t"i edukojmë me durim talentet. Duhet të "prodhojmë" sa më shumë talente**. Një shkollë ose një sistem arsimor që nuk vënë në qendër këtë QËLLIM, nuk janë gjë tjetër veçse KAZERMA që bëjnë stërvitje stereotipe.** Profesori potenconte faktin se të gjithë GJENITË kanë një vëmendje INTENSIVE, që nuk dorëzohet në asnjë çast, kanë aftësinë për të dalluar sendet dhe fenomenet, kanë kujtesë të fortë, kanë perceptim depërtues përtej asaj që sheh syri indiferent i vrojtuesit të zakonshëm i cili vetëm bredhërin nëpër objektet e botës së jashtme, por në mungesë të rrethanave të favorshme , talentet mbeten të pazbuluara ose VYSHKEN shpejt, si lulet për ujë. Mbi bazën e vrojtimit të MPREHTË Tolstoi në veprat e veta letrare ka arritur të përshkruaj 85 nuanca të te shprehjes së SYVE dhe 97 nuanca të BUZËQESHJEVE, të cilat zbërthejnë gjendjet emocionale të personazheve të tij. Në këtë kontekst SHPREHITË DHE ZAKONET POZITIVE si puna sistematike, regjimi rigoroz, etj. kanë një rëndësi

kolosale në çdo krijimtari. Dhe në këtë kontekst profesori theksonte veprimtarinë letrare, gjuhësore, folklorike, patriotike, shkollore të De Radës, Homerit të Shqipërisë(siç e quante revista Die Press e Vjenës më 5 janar 1887) për të cilin Leonardo de Martino ka dhënë këtë vlerësim:

Atë që bëri Skënderbeu me shpatë,
Ti e bëre me pendë, o i madhi De Radë!

Profesori kishte parasysh këshillën e shkrimtarit Maksim Gorki kur thotë: **"Mos iu afro kurrë njeriut me mendimin se ai ka më shumë cilësi NEGATIVE sesa pozitive.** Gjithnjë shkoi pranë me mendimin se ai ka më shumë të MIRA se sa të këqija. Dhe kështu do të dalë. ÇDO NJERI JEP ATË QË KËRKOHET PREJ TIJ ... Talenti zhvillohet nga ndjenja e dashurisë për punë, ...bile respekti ndaj lexuesit kërkohet patjetër nga letrari, ashtu siç kërkohet kujdes nga furrtari që të mos lejojë të bien në brumë plehra e ndyrësira, sepse njeriu nuk është derr të hajë çdo gjë që t'i japësh. ", ose këshillën e GËTES kur thotë: "Në rast se ju i trajtoni njerëzi ashtu siç janë me të gjitha të METAT e tyre, nuk mund t"i bëni kurrë më të mirë. **Në rast se ju silleni me ta tamam si me njerëz IDEALË, do të mund t"i ngritni në atë LARTËSI, që dëshironi t'i shihni",**
Profesori i jepte shumë rëndësi përcaktimit të domethënies së FJALËVE dhe çmonte thënien e qëlluar të Rene Dekartit:

Nëse fjalëve ua përcaktoni domethënien
e çlironi botën nga gjysme e iluzioneve.

Mirëpo shteti borgjez nuk edukon mijëra mjeshtër të mrekullueshëm të kulturës, inxhenjer të shpirtrave, edukatorë të brezit të ri, por , vazhdonte profesori, në shkollat borgjeze janë edukuar dhe edukohen vetëm shërbëtor të bindur të kapitalizmit, që besojnë në

përjetësinë dhe ligjshmërinë e kapitalizmit ku njeriu për njeriun është ujk. Dhe kjo botë e kapitalit arriti të restaurojë edhe në Shqipëri rendin e mëparshëm borgjezo-kapitalist, duke krijuar heronjtë e nënshtrimit, DURIMIT, njerëzit e kotësirave, të cilët e kuptojnë se të rrëmbesh është më lehtë se sa të krijosh, se të te **GËNJESH dhe të VJEDHËSH është më lehtë se të PUNOSH**.

Dhe propaganda e qindësheve të zeza iu premtonte kontingjenteve të klasës punëtore parajsën e botës së kapitalit, mirëqenien dhe luksin marramendës, por me kushtin që të shkatërronin çdo gjë që kishte ndërtuar shteti i diktaturës së proletariatit brenda 50 viteve. Por alternativa e pushtuesve, "Liria" që ofronin ata, na i kujtonte fjalët emblematike të filozofit italian të shekullit të kaluar, **Xhuzepe Macinit**, i cili thotë:

> **"Më shumë se nga skllavëria, kam frikë nga LIRIA e dhuruar".**

Në muajin shkurt 1991 Shqipëria ishte në **prag** të luftës civile, sepse në Sheshin Skënderbej kishin hyrë mbi 10.000 protestues, shumë prej të cilëve edhe nga Kosova e Mali i Zi(Shoqata-POSTOJBINA) dhe po tentonin të rrëzonin monumentin e Enver Hoxhës. Ishte data **20 shkurt 1991** kur turma huligane po e rrëzonte monumentin e njeriut që bëri epokën më të ndritshme të Shqipërisë për 50 vite me radhë, por këtë turmë askush nuk e ndaloi, edhe pse monumenti ishte i mbrojtur nga ligji, dhe për pasojë më vonë lindi **"Lëvizja e vullnetarëve për mbrojtjen e Enver Hoxhës"** me pjesëmarrës nga Gjirokastra, Përmeti, Tepelena, Skrapari, Vlora e Mallakastra të cilët organizuan një mbledhje kombëtare të përfaqësuesve të vullnetarëve të lëvizjes në Gjirokastër. Një rast tjetër, poashtu shumë tronditës, **ishte 11 tetori 1995 kur antifashisti dhe heroi Shqfqet Peçi, rreth 100 vjeçar, ishte arrestuar barbarisht dhe ashtu të lidhur me pranga,**

në dy palë pranga, në ato të sëmundjes së rëndë dhe të shtetit fashist, e kishin dërguar me barela në spitalin e burgut të Tiranës. Kjo ngjarje tronditëse na kishte shokuar të gjithve, dhe sidomos fjalët lapidare të Shefqet Peçit në çastin e arrestimit: **"E KAM PËR NDER TË VDES NË BURGJET E FASHIZMIT!"** Kështu Shqfqet Peçi, antifashisti legjendar, me këmbë të thyera e komplikime të rënda në zemër, i lidhur në pranga, dhe i armatosur me të vetmen ARMË-**Grevën e urisë dhe grevën juridike.**Garda e zezë e Republikës së zezë me këtë akt ultrafashist po demaskohej paturpësisht para botës. Duket se Shqipëria ka mbetur pa heronj të gjallë. Disfata e vitit 1990 ka qenë disfata e saj e madhe. Një disfatë e ardhur me TRADHTI. Partia dhe shteti kapitulluan. Është ngritur në këmbë populli, por një popull sërish i tradhtuar. Murtaja e çmendurisë po bënte punën e saj. Fashizmi kishte marrë në dorë frenat e pushtetit. Prangat në duart e Shqfqet Peçit janë pasqyra e vërtetë e këtij shteti. Këto fakte ishin rrënqethëse për profesorin Qazim, luftëtarin antifashist të orëve të para, si dhe për ne të tjerët bashkëmendimtarë të tij, dhe arrestimin e gjeneralit famëmadh e përkujtuam me vargjet e poetit D.Agolli në baladën "KOMISARI":

" Si naganti nuk na ngeci
që në Kuq e në Korab
kur na thërriste Shefqet Peçi
Komandanti ynë lab"

Dhe pastaj profesori i nderuar na thoshte se akti i pashembullt i Heroit Shefqet Peçi duhet të na frymëzojë për rezistencë kundër okupatorit, sepse rezistenca kundër të keqes është shtylla vertebrale e një kombi. Duhet të guxojmë. Bota u takon GUXIMTARËVE! I gjallë apo i vdekur Shqfqet Peçi do të dalë nga burgu i katërt me radhë(dy herë nga mbreti Zog dhe një herë nga fashizmi italian), por **NDERI** i Shqipërisë kur do të dalë nga **BURGU**?

Dymbëdhjetë ditë e dymbëdhjetë net në grevë urie, 12 ditë e 12 net në luftë me vdekjen e pavdekshme, në një betejë të gjatë, që rrallë kush në botë mund ta fitonte. Gjergjelez Alia legjendar me nëntë plagë në trup u ngrit ngas shtrati dhe e mundi balozin e zi që kishte dalë nga deti për të masakruar e gjunjëzuar një popull të tërë. Shefqet Peçi, një figurë e gjallë historike, jo një trillim artistik, i mbërthyer në shtrat më rëndë se Gjergj Elez Alia, jo një armë (topuzin) si Gjergji, po dy, GREVËN E URISË në njërën dorë dhe GREVËN JURIDIKE në tjetrën dhe po godiste brinjë me brinjë një shtet fashist, balozin stërmadh, dhe nuk u përgjigjet pyetjeve të hetuesve, por u thotë: **LARGOHUNI FASHISTË. KAM VRARË KRIMINELË DHE PRAPË DO T'I VRASË PO T'MË VRISNIN SHOKËT".** Heroi që u përket shekujve nuk mposhtet. Ai nuk i ka vënë gjoksin topit si MIC SOKOLI në Slivovë të Kosovës, por i ka vënë gjoksin **TOPIT TË SHTETIT FASHIST!** Shefqet Peçi ishte ngritur si mal dhe si mal do rëndojë në ndërgjegjen e Kombit. Ai nuk vdiq, por fashistët e vranë mizorisht. Më **24 tetor 1995 Shefqet Peçi u përjetësua si një marathonomak legjendar nëpër mijëra vjeçar që vijnë. Si tribun i lirisë.**

Ndërkaq, shqiptarëve në Kosovë iu bë po e njëjta propagandë intensive, po me një pako tjetër premtimesh. Atyre iu rekomandua të bënin një **REZISTENCË PAQËSORE** ndaj pushtimit kolonialist serb, të mos rezistonin me mjete DHUNE, se pastaj komuniteti ndërkombëtar do t'i shpërblente me të drejtat individuale njerëzore. Shqiptarët e Kosovës me vise e pranuan një EKSPERIMENT të tillë, dhe duruan për dekada të tëra duke e lënë FATIN e tyre në "BESË" të fuqive të mëdha, por harruan se bashkësia ndërkombëtare nuk e njeh INSTITUCIONIN E BESËS SHQPTARE, por njeh vetëm llogaritë dhe interesat, aleancat e vjetra dhe të reja. Ky ishte MASHTRIMI MË KOLOSAL I SHEKULLIT, një shaka tragjike mbi kurrizin e shqiptarëve të kolonizuar. Por kjo ofshamë e sotme është PARALAJMËRIM i një

zgjimi luftarak të së nesërmes me vullnetarët e lirisë në ballë.

Me dhembje na fliste profesori për kundërrevolucionin në Shqipëri dhe shkatërrimin e çdo qelize ku kishte vënë dorë socializmi për 50 vite duke bërë të mundur gllabërimin e pasurive shtetërore kombëtare, të ndërtuara me djersë e gjak nga populli ynë punëtor, të cilin e lanë të zhgënjyer dhe me gishta në gojë. Terapia "SHOK" arriti suksesin duke arritur objektivat e "KUOTËS ZERO", që do të thotë – çdo gjë që ka ndërtuar komunizmi të shkatërrohet, dhe pastaj do vijnë "ÇEKAT E BARDHË" nga legjenda bashkë me sloganin e padëgjuar askund në botë – **"NE QEVERISIM – BOTA NA NDIHMON?!"** duke bërë që 70% e shqiptarëve të marrin më pak se një dollar në ditë?! Mijëra njerëz të sfilitur nga uria i mbanin sytë nga deti, se andej shpresonin se do t'u vinte mbarësia, por deti për ta u kthye në KOB TË ZI. Nga deti atyre u vinte MANDATA e djemve dhe vajzave që kërkonin SHPËTIMIN në Itali, natën, me varka plastike – e vetmja VIZË që u dhanë të huajt shqiptarëve. Dhe poeti e përjetësoi në këngë këtë tragjedi të Otrantos:

Kapitalizmi –
Kuçedra plakë
Na qenka ky varr,
na qenka kjo natë.
Gjëmo baladë
në shekuj pa fund
Kambanës tënde
Me gjak e me plumb
Në rrugën pa rrugë
më nisi URIA,
Rrugën na e preu
në det ITALIA....
As hi e as varr,
Atdhe, mos na prit
OTRANTOS – akuzë
Ne jemi të gjithë...

(Hysni. Milloshi: VALSI I VDEKJES, baladë)

Viti 1997, viti më i mbrapshtë në historinë e Shqipërisë, ishin shembur institucionet e shtetit nga vetë shteti. Evropa po shikonte një spektakël me dramën shqiptare. Shqipëria ishte kallur flakë. Po digjej kultura e kombit, universitetet, shkollat, po digjeshin gjykatat, prokuroritë, bashkitë. Po sulmoheshin dhe grabiteshin bankat. Më 12 mars 1997 burgjet u përfshinë në revolta. Turma njerëzish rrëmbenin ç'të gjenin, që nga depot e armëve, magazinat e ushqimeve e deri te sendet e thjeshta. Në burgjet e Tiranës po vuanin dënimin ish-**Presidenti Ramiz Alia**, pastaj Fatos Nano, Rita Marko, Hekuran Isai, Vilson Ahmeti etj. Të gjitha këto ngjarje tronditëse e shqetësonin profesorin Qazim, i cili na jepte kurajë duke na thënë se edhe këtë rrezik të madh do ta përballojë Shqipëria, dhe një ditë **të gjitha këto të zeza do bëhen të bardha**, dhe djemtë e Kosovës do rrokin armët dhe do fitojnë lirinë e shumëpritur.

Profesori kurrë nuk mbështetej në ligjin e METAFIZIKËS, por në ligjin objektiv të zhvillimit të shoqërisë së ndarë në klasa, dhe theksonte thëniet emblematike të Marksit dhe Engelsit se:

„Historia e të gjitha shoqërive që kanë ekzistuar deri më sot, është HISTORIA E LUFTËS SË KLASAVE. I liri dhe skllavi, patrici dhe plebeu, çifligari dhe bujkrobi, mjeshtri dhe shegerti, shkurt, shtypësi dhe i shtypuri kanë qenë në antagonizëm të përjetshëm me njëri-tjetrin, kanë bërë një luftë të pareshtur, herë të mbuluar, herë të hapët, që ka përfunduar kurdoherë me një transformim revolucionar të së gjithë godinës shoqërore ose me zhdukjen e përbashkët të klasave në luftë. "

Profesori na mësonte se nuk mund të zhdukësh luftërat pa zhdukur **SHKAQET** që i lindin ato, dhe hidhte poshtë predikimet boshe se gjoja edhe në kushtet e imperializmit mund të shmanget çdo lloj lufte e të krijohet bota pa armë, pa ushtri, pa luftë?! Ai na mësonte për LUFTËRAT E DREJTA, luftërat e klasave dhe forcave përparimtare

kundër forcave reaksionare, luftërat REVOLUCIONARE, çlirimtare e mbrojtëse të punonjësve e të popujve kundër shfrytëzimit e shtypjes klasore e kombëtare të cilat duhet të përkrahen me të gjitha forcat dhe mjetet nga revolucionarët sypatrembur. Ai na mobilizonte shpirtërisht për luftëra të tilla dhe potenconte fjalët e Engelsit se: **"Para se të filloni KRYNGRITJEN duhet të kishit bërë njëmijë parapërgatitje"**, dhe njëkohësisht deklarohej kundër PACIFIZMIT, rrymës liberalo-borgjeze që predikon paqen me çdo kusht, duke maskuar faktin që vetë ekzistenca e kapitalizmit është BURIM I LUFTËRAVE, dhe kështu mohojnë revolucionet dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve. Në këtë kontekst edhe çështja shqiptare është e pazgjidhur, sepse qëndrimi i fuqive të mëdha evropiane dhe botërore ndaj çështjes shqiptare, si në të kaluarën, ashtu edhe sot, në esencë është qëndrim TOTALITAR. Dhunimi i të drejtës së një populli për të qenë i lirë të VETËVENDOSË për fatin e tij çon në TOTALITARIZËM. LIRIA KOMBËTARE kërkon si parakusht grumbullimin në një shtet të te gjithë pjesëtarëve të një KOMBI apo të shumicës së tyre.

Profesori na fliste mbi bazën e argumenteve shkencore dhe parashikonte fundin e turpshëm të Jugosllavisë fashiste të zhytur deri në fyt në borxhe, me mbi 117 miliardë dollarë, dhe me një inflacion galopant, dhe si pasojë do mbyllen mijëra ndërmarrje dhe do mbesin jashtë fabrikave një milionë e pesëqind mijë punëtorë, sipas analizave të profesorit të Fakultetit Ekonomik të Beogradit, dr. **Jovan Rankoviq**, i cili alarmonte se në Serbi janë fshirë nga harta gjeografike **573 fshatra në të cilat nuk ka asnjë banor, ndërsa vetëm në Beograd i kemi me regjistrim dhe sigurim mbi 30.000 qenë dhe 25.000 mace** ("ZËRI", 16. 02. 1991, f. 11). Ndërkaq kur na fliste për SHTIMIN NATYROR NË SERBI, profesori Qazim u referohej të dhënave statistikore të ekspertit serb për sociologjinë e familjes, **dr. Marko Mlladenoviq** – **SERBËT NË KTHETRAT E DEMOGRAFISË**, – i cili theksonte se:

Shpopullimi i Serbisë ka filluar nga viti 1953, ndërsa sot gjendja është alarmante. Më 1992 në Serbi kishte 6000 persona të vdekur më shumë se foshnje të porsalindura. Në Vojvodinë kishte 22.000 certifikata të vdekjeve më shumë se sa të lindjeve. Ndërkaq në Kosovë kemi këtë raport: një i vdekur me shtatë të lindur (1:7). Serbinë po e rrezikon **VDEKJA BIOLOGJIKE** ose siç thuhet – MORTAJA E BARDHË, dhe vazhdon profesori Mlladenoviç duke pohuar se Lufta Demografike është e humbur në Serbi, dhe parashikon se pas 20 vitesh në Serbi do ketë **më shumë pensionistë sesa të rinj**. DJEPI SERB në Kosovë është i zbrazët, thekson Dr. Adasheviq, sepse mesatarisht çdo familje ka vetëm 0, 9 fëmijë, ndërsa në Kosovë – 5 fëmijë (Shih: "NASHA BORBA", dhe "BUJKU", 4. 02. 1995, f. 3). Më poshtë thuhet: SOT SERBËT JANË PAKICË NË SERBI, **me vetëm 46, 6%,** ku mbizotërojnë romët, vllahët, boshnjakët etj. Gjatë dhjetë viteve të kaluara – 1981-1991 në Serbi kanë vdekur 834.104 serbë dhe 115.872 shqiptarë, që do të thotë – **8 serbë dhe një shqiptar (8:1)**. Nga kjo del se është ABSURDE dhe e parealizueshme që të KOLONIZOHET një vend me natalitet më të lartë nga një vend me natalitet më të ulët, i cili lëngon nga sëmundja kanceroze biologjike **– mortaja e bardhë**, kur dihet se shqiptarët brenda një viti shtohen me 50.000 vetë (Shih: JEDINSTVO dhe BUJKU, 2. 02. 1995). Profesori i Fakultetit Teologjik në Beograd, dr. Radovan Bigoviq, shton: **"Shqiptarët janë arrë e fortë dhe Serbia aty vetëm mund t'i thyejë dhëmbët** (ZËRI, 2. 8. 1995). Ndërkaq në gazetën e arsimit, PROSVETNI PREGLED të Beogradit, të datës 3. 06. 1989, veç tjerash shkruan: **" Në dhjetë vitet e fundit, 1979-1989, në Serbi u mbyllën 141 shkolla tetë-vjeçare, për shkak të natalitetit të ulët... "**. Nga libri – SERBIA NË MES TË SHTIMIT NEGATIV TË POPULLSISË DHE SHPËRTHIMIT TË LINDJEVE (Beograd 1995) thuhet: **"Sot 119 komuna të Serbisë kanë shtim natyror negativ**, gjegjësisht – 1 i vdekur me 1, 2 të lindur, dhe çdo i treti banor në Serbi nuk

është serb. Një prift serb deklaroi për TV Beogradin 2, më 25. 03. 1995, në orën 19: "SOT ËSHTË DITA MË E ZEZË PËR MUA, SEPSE NË BEOGRAD VDIQËN 90 VETË, **ndërsa lindën vetëm 12 vetë?! Në çdo 20 minuta në Beograd hapet një varr, që do të thotë mesatarisht 72 varreza në ditë**…

Për të na bindur se sa i tmerrshëm kishte qenë gjenocidi dhe etnocidi serb mbi shqiptarët profesori këtë e argumentonte me këto të dhëna: se në krahinën e populluar me shqiptarë të trevës së Sanxhakut të Nishit me 11.000 km. katrorë dhe me mbi 800.000 banorë shqiptarë, me mbi 700 fshatra e 8 qytete u masakruan me zjarr dhe hekur nga ekspeditat serbe mbi 35.000 vetë të moshave dhe gjinive të ndryshme, u përzunë me dhunë mbi 400.000 banorë vetëm brenda katër ditëve (janar 1878), u **konvertuan në fenë ortodokse mbi 200.000 shqiptarë myslimanë, u rrënuan mbi 320 kisha e xhamia, 80 tyrbe** dhe iu konfiskua tërë pasuria e tundshme dhe e patundshme …

Profesori gjithnjë na fliste se kjo gjendje e robërisë është e padurueshme dhe se Kosovës i duhen më shumë se kurrë idealistë dhe revolucionarë të vërtetë dhe shtonte se **vetëm 5 luftëtarë militantë po të dilnin me 5 automatikë në malet e Sharrit**, Serbia do të tronditej e tëra, ndërsa edhe 500.000 "demokratë" po të dalin në tubimet protestuese, Millosheviqi dhe Gligorovi gjumin do ta bënin të qetë bashkë me Arkanin pa i shqetësuar kush në tokën e pushtuar.

Profesori i urtë ishte një aktor i përkryer i artit të te folurit, orator i pashoq, dhe me këmbëngulje vazhdonte me pikëpamjet e tija gjersa i lodhte kundërshtarët. Këto cilësi, kuptohet se e tërbonin kundërshtarin bashkëbisedues. Më kujtohet një rast, në maj 1985, ku ishim për ngushëllime, për babin e ndjerë të një kolegu (J. B), kur një "profesor" i ndërhyri në bisedë profesorit Qazim duke i thënë: **"Boll bre, se na lodhe me at Shqipëri, thuajse nuk ka shtet tjetër në botë?!"** Por profesori nuk u

mor me të, thjesht e injoroi agjentin cinik, dhe vazhdoi ligjëratën aty ku e kishte lënë me insistimin e pjesëmarrësve në ngushëllim. I tillë ishte profesori ynë i paharruar i cili na thoshte se lufta jonë është e gjatë, është si dallgët e detit që nxjerrin në breg gjithë mbeturinat dhe gjërat e panevojshme, dhe vetëm revolucioni do t'i flakë një nga një mbeturinat tona kombëtare të cilat për 2200 vjet i kanë lënë pushtuesit e ndryshëm. Profesori na mësonte përherë se duhet ta mësonim artin e luftës, artin politik të kuptimit të gjerave duke shtuar se njerëzit nuk janë aq të këqij, por **janë shumë të paditur**, janë të gënjyer nga interesat e vogla – meskine.

Profesori na fliste për LUFTËN E IDEALISTËVE dhe romantikëve të Francës, të cilët përpiqeshin për LIRINË, BARAZINË dhe VËLLAZËRINË njerëzore, dhe se kjo luftë deri në vitin 1789 thuajse gjithmonë kishte përfunduar me disfatën e idealistëve. REVOLUCIONI FRANCEZ më 1789 ishte prova e parë serioze për të realizuar në jetë tri premisat kryesore- "LIRI, BARAZI, VËLLAZËRIM!"Babai shpirtëror i kësaj parulle ishte- **Zhan Zhak Ruso** me veprën-KONTRATA SHOQËRORE, e cila konsiderohej si KODI ETIK i shoqërisë njerëzore, dhe më i përkushtuari në zbatimin e saj ishte avokati **Maksimilian Robespieri**, i cili mori flamurin e revolucionit(1791-1794) PARULLËN:

-Që njerëzit këtej e tutje do ishin të lirë;

-Që njerëzit këtej e tutje do ishin të barabartë;

-Që njerëzit këtej e tutje do ishin vëllezër;

Brenda tre vjet përpjekjesh për realizimin e kësaj parulle revolucionare në ballë me përfaqësuesit më të spikatur- Robespjerin, Sen-Zhystin, Kutonin etj. më në fund radikalizmi i këtij revolucioni në fushën e ekonomisë, duke shpronësuar deri në fund klasën feudale dhe kishën, duke ekzekutuar në gijotinë mijëra pronarë dhe kundërshtarë të revolucionit, por që në vitin 1794 Talieni, Barrasi, Fusheja, Vareni etj. bënë **kundërrevolucion** dhe çuan në gijotinë e **Robespjerin** dhe

shokët e tij idealistë të mëdhenj të cilët përmbysën me dhunë mbretin, sundimtarët feudalë, aristokratët, peshkopët. Por në shembullin e Shqipërisë socialiste të viteve 1945-1990 parullës-liri-barazi-vëllazëri po i shtohej edhe zbatimi në praktikë i parullës-**SECILIT SIPAS NEVOJAVE, NGA SECILI SIPAS AFTËSIVE!** Me këtë parullë u dëshmua se dëshmorët e lirisë, partizanët liridashës e antifashistë, tek shumica e shtresave të populli, u kultivua motivi i qëndresës dhe heroizmit në luftë me bindje se ata nuk po luftonin thjesht **vetëm për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit, por , më shumë se kaq, ATA LUFTONIN PËR NJË BOTË TË RE!** Dhe këngëtari popullor këtë koncept idealist e ka shprehur më së miri në këto vargje:

"Ju kish rritur nëna,
Për një botë të re,
Lule more trima,
Që ratë për atdhe!"

Ishte kjo një ëndërr për **një botë ku nuk do të kishte pabarazi, ku njerëzit do jetonin të lirë realisht, të barabartë realisht, dhe vëllezër realisht.** Në pamundësi për ta realizuar këtë ëndërr të rënët, barra u ngeli të gjallëve, shokëve të tyre, dhe një pjesë e këtyre dëshmorëve të gjallë punuan deri në vdekje për realizimin e kësaj ëndrre-AMANET I SHENJTË I SHOKËVE TË TYRE, dhe realizimi i kësaj ëndrre kërkonte prej tyre, shokëve të gjallë, **heqjen dorë nga JETA PERSONALE, nga përfitimet karrieriste, nga të mirat materiale etj., dhe kështu të realizohej revolucioni në kokat e njerëzve.** Dhe tani, pas një sfide titanike prej 45 vitesh socializmi në Shqipëri u përmbys, dhe shumë njerëz nga ata që u përmbysën më 1944, nxorën TAPITË e fshehura dhe të ruajtura me fanatizëm për 45 vjet, dhe njëkohësisht, bashkë me ata, i nxorën tapitë edhe mjaftë ish-komunistë, të cilët më 1945 'gjoja" ia kishin falur pasurinë pushtetit popullor. Këta ishin "**agallarët e socializmit**" të cilët u lidhën në aleancë të ngushtë me agallarët e djeshëm. Kjo

ndodhi më 31 mars 1991, kur shtresa e idealistëve ish-komunistë u eliminua dhe juridikisht nga skena politike shqiptare. Humbje tragjike pësoi shtresa që ëndërroi, punoi dhe lufto për idealin e **NJË BOTE TË RE!** Dhe ishte shumë e dhimbshme për këta idealistë revolucionarë të shihnin **VDEKJEN** e idealit të tyre duke qenë vetë gjallë. Por nuk duhet harruar se në fjalimin programatik në shkurt të vitit 1972 në qytetin e Matit, Enver Hoxha synonte ndreqjen e shtrembërimeve që ishin vënë re në realizimin në praktikë të parullës- PËR NJË BOTË TË RE! Shtresa filistine në gjirin e PPSH-së iu kundërvu atij me shumë mençuri, zgjuarsi dhe dinakëri, dhe në emër të gjoja- rrezikimit të fryteve të revolucionit nga ARMIKU I KLASËS. Fjalimi i Enver Hoxhës në Mat kishte për qëllim mbrojtjen e fitoreve të revolucionit dhe rrezikonte pozitat e shtresës së **'agallarëve dhe bejlerëve"** të socializmit, dhe disa muaj pas këtij fjalimi shtresa filistine dhe karrieriste brenda PPSH-së ia jep një goditje të re shtresës idealiste dhe revolucionarëve të vërtetë duke tundur flamurin e " botës së re" për të fshehur " botën" e saj filistine të përfitimeve. Ndërkaq periudha e fillimit të PLURALIZMIT në Shqipëri u përjetua si PËRVETËSIM DHE SHKATËRRIM i pasurisë kombëtare. Me këtë u dëshmua se kjo shtresë KANCEROZE , e maskuar brenda gjirit të PPSH-së, kishte vepruar si virus duke braktisur idealet e barazisë, lirisë dhe vëllazërisë, dhe duke synuar kah bota e tyre e pabarazisë dhe jetës personale. Tani në këtë situatë pluraliste shtresa idealiste u ndodh e vetmuar, numerikisht shumë e pakët. Të ndodhur përballë përdhosjes së idealit, shpifjesh të neveritshme, sulmesh të egra, kjo shtresë e kuptoi se ishte humbëse e madhe, sepse presioni ishte shumë agresiv: djali i drejtohej babait, gruaja burrit, motra vëllait: **po çfarë fitova nga gjithë ato privacione dhe nga ato ideale, e çfarë fituam ne pjesëtarët e familjes për 45 vjet?** Të varfër ishim dje, të varfër mbetëm dhe sot. Na morët në qafë! Agresiviteti po kulmonte me parullën-**"Veteranët në litar-komunistët në**

hanxhar", dhe këtu fjala ishte për ata komunistë dhe kuadro partie, për atë pjesë të shoqërisë, të cilën pluralizmi e gjeti të varfër materialisht, të humbur politikisht, por të pastër në KARAKTER, sepse ishte autorja e ndërtimit të shkollave, spitaleve, fabrikave, rrugëve, hidrocentraleve, ndërtimeve kolosale të nëndheshme për vetëmbrojtje , që u kishte rezistuar me heroizëm për 45 vjet me radhë furtunave të shekujve, bllokadave imperialisto-revizioniste, për realizimin e lirisë dhe barazisë socialiste. Pas vdekjes së Enver Hoxhës shtresa filistine që ishte gangrenizuar në gjirin e partisë deri në majën e piramidës shtetërore, që ishte shndërruar në " agallarë dhe bejlerë të socializmit", ndjeu një gëzim dhe lehtësim shumë të madh, prandaj shpërdorimet, abuzimet, privilegjet dhe shfrytëzimi i aparatit shtetëror për përfitime personale, në periudhën 1985-1990, morën një përhapje të gjerë duke e shndërruar pakënaqësinë në URREJTJE. Kodi moral i shoqërisë së sotme shqiptare është KOZMOPOLITIZMI si filozofi dhe psikologji. Kozmopolitizmi është armiku kryesor i idealizmit dhe romantizmit, sepse ai shndërrohet në mënyrë jetese për individin dhe shoqërinë, në traktat moral të saj, dhe për këtë iu shpall luftë të egër ideve progresive dhe shtresës IDEALISTE. Internacionalizmi predikonte "PROLETARË TË GJITHA VENDEVE TË BOTËS BASHKOHUNI!(për të përmbysur kapitalizmin), ndërkaq KOZMOPOLITIZMI predikon:

" INDIVIDË TË GJITHA VENDEVE TË BOTËS, HIQNI DORË NGA KOMBI, LIRIA DHE PAVARËSIA KOMBËTARE! KU ËSHTË MIRË, ËSHTË ATDHEU! KU ËSHTË PARAJA, ËSHTË ATDHEU!

Karakteristikë e kozmospolitizmit nuk është BOTA E IDEVE, por BOTA MATERIALE. Njeriu kozmopolit ia **ndez një qiri edhe DJALLIT** nëse mendon se do t'i sjell PARA. Termat si përkushtimi, solidariteti, sakrifica, vetëmohimi, privacionet personale etj. janë të panjohur për të dhe moralin e tij kozmopolit. Ata e dinë se me PATRIOTIZËM nuk fitohen para dhe nuk shtohet pasuria,

por me patriotizëm **çlirohet atdheu**. Sot propaganda e mbushur me terma patriotizmi VERBAL për të trullosur mendjet e njerëzve dhe për t'u hequr armët nga dora atyre që duan vërtetë ta realizojnë këtë propagandë në praktikë. Patriotizmi aktual i shqiptarëve nuk është gjë tjetër veçse **KARIKATURA e patriotizmit real.** Për këto vlera na fliste profesor Qazimi dhe nxirrte lakuriq hipokrizinë dhe mashtrimin e shoqërisë civile dhe të moralit të saj mbi çështjen kombëtare. Unë dhe profesori Qazim kishim marrë ilegalisht korrespondencën e **Viktor Çamit** (qershor 1994, **botuar në ZËRI I POPULLIT)**, i cili në mënyrë dinjitoze ngrihet kundër rrymës zyrtare shqiptare dhe me argumente të pamohueshme e mbron historinë 50 vjeçare të Shqipërisë(Kush është Viktor Çami? Babai i tij, Azis Çami, u vra më 1943 në kohën e luftës nacionalçlirimtare në Tiranë. Ai vetë së bashku me familjen emigron nga Shqipëria. Xhaxhai i tij, Njazi Çami gjatë kohës së pushtetit të Enver Hoxhës burgoset, ndërsa një pjesë e farefisit të tij persekutohen, për shkak të biografisë së tyre. Punoi në seksionin shqip të BBC, dhe pastaj në ambasadën amerikane në Londër dhe në Vjenë, dhe ishte simbol i propagandës antikomuniste që bëhej përmes Radio Londrës ndaj shtetit shqiptar). Dhe në korrespondencën e tij Viktor Çami i drejtohet Presidentit, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit Popullor dhe parlamentarëve me këto fjalë:

"...Çfarë nuk dëgjon këtu në mërgim për ato që ndodhin në Shqipëri! Korrupsion në të gjitha nivelet, prostitucion, pornografi, vjedhje të pasurive kombëtare në mes të ditës nga Muzeu Kombëtar, **drogë,** përdhunime. Dëgjojmë në radio dhe nga njerëzit tanë se shiten vajzat nëpër shtëpitë publike nga Stokholmi në Athinë, nga Roma në Sofje, ndërsa parazitët që merren me këtë tregtim dhe kontrabandistët ndërtojnë vila dhe ngrejë dolli për demokracinë me wisky-cola... Le të pyesim veten pse nuk ranë shtetet e Evropës Lindore në atë gjendje kaosi dhe anarkie ku u zhyt vendi ynë? Pse nuk u dogjën depot dhe

ndërtesat në Poloni? Pse nuk u shkatërruan shkollat në Hungari? Pse nuk u thyen xhamet e serrave dhe të trenave në Çekosllovaki? Pse nuk u plaçkitën kooperativat dhe fabrikat në Gjermaninë Lindore, por në Shqipërinë tonë të dashur dhe aq të vuajtur nga ambiciet dhe intrigat e huaja?...**Si analist nuk mund t'i shoh si rastësi të shkëputura ngjarjet e dy korrikut(1990) në Tiranë dhe në Prishtinë...**Pa përdorur terma metaforikë për delikatesë: **KY ËSHTË FASHIZËM I SHKOQUR DHE KURGJË TJETËR!!** Shohim pra se e gjithë politika berishjane është ngritur mbi një piramidë gënjeshtrash të dimensioneve gëbelsiane, e cila po fillon të shpërbëhet ashtu si piramidat financiare! Zotërinjtë pushtetarë duhet ta dinë se ky nuk është fundi i këtij kapitulli. Një fjalë popullore thotë se "Popullin mund ta vrasësh dhe të falë, mund ta mundosh dhe të fal, **por nuk të fal po e MASHTROVE!** ...Historinë nuk e bëjnë delet e çala po LUANËT që hidhen në zjarr! ...Shqipëria po kthehet në një REPUBLIKË TË HAJNAVE, në vend që të shkojmë në drejtim të REPUBLIKËS SË NJERËZVE TË MIRË, siç thoshte mendimtari francez **Montesquieu**...HISTORIA nuk është studim i HIPOTEZAVE, por i SHKAQEVE dhe PASOJAVE. Qëllimi ynë është-të përpiqemi të kërkojmë dhe zbulojmë të VËRTETËN në tri kategoritë e saj kryesore: E VËRTETA historike, E VËRTETA shkencore dhe E VËRTETA personale....Ndërkaq, rreth të ashtuquajturit-KOMPLOTIT komunist serbo-shqiptar kundër Kosovës, Viktor Çami përgjigjet shkurt: SHQIPËRIA U PENALIZUA për përkrahjen që i dha kërkesës për STATUSIN E REPUBLIKËS në ato vite dinamike. Edhe shqiptarët e Kosovës nuk duhet ta harrojnë këtë, dhe shton mendimtari i shquar Viktor Çami:

Marksist-leninisti-stalinisti E. H. (Enver Hoxha-BK) ia theu kokën pseudomarksistit-leninistit-titist-revizionist F. H. (Fadil Hoxha-BK), shefave të tij pseudo-marksistë-leninistë-titistë-revizionistë jugosllavë dhe padronëve të

tyre imperialistë dhe social-imperialistë amerikanë dhe sovjetikë!! Pikë!! Shpresoj se u sqaruam!

Para shumë viteve lexova në Austri recensionin e një kritiku anglez për një libër mbi Skënderbeun, ku thuhej: **Skënderbeu ishte një udhëheqës ushtarak gjenial, por i krisur, i tribuve shqiptare, i cili u pleks para kohe me turqit dhe, rrjedhimisht, u bë shkaktar që u SHKATËRRUA vendi në një mënyrë të atillë që akoma nuk e ka marrë veten edhe tani"**

E pra, ja që e paskërkemi edhe një precedent historik kombëtar për ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë! Shqiptarët u pleksën me turqit 'para kohe" 500 vjet më parë dhe e përsëritën gabimin duke u pleksur **"PARA KOHE"** me federatën jugosllave 500 vjet më vonë!...Provë për vërtetësinë e teorisë së gjeneve! **O burra, ta rrëzojmë MONUMENTIN e pseudo-heroit kombëtar!** Sa mirë do të jetonim sot sikur të mos kishte qenë ai! Na mori në qafë, i mallkuari! Ashtu qoftë! Ta rrëzojmë monumentin që i ngritëm gabimisht në mes të Tiranës! Ta shkulim! Pyetja është: a duhet ta bëjnë këtë ALABAKËT, VANDALËT dhe PLEBEJTË e Tiranës? Apo të bëhet me vendim të Kuvendit Popullor PLURALIST apo me anë të një REFERENDUMI!

Nuk ishte ideologjia e Ho Chi Minh-it ajo që siguroi FITOREN në Vietnam: ishte veprimi i forcave patriotike vietnameze në terren....Veprat e strategut ushtarak gjenial, gjenerali **Gjap**, mund të blihen edhe në SHBA...Ndërkaq Vietnami u BASHKUA!...Një koleg slloven më tregon një artikull të gazetës :BORBA" të Beogradit, ku Enver Hoxha përshkruhej si "**Pol Poti i Shqipërisë**". Të gjithë e dimë se kush ishte Pol Poti. Më thotë kolegu slloven:

"Këta tanët janë budallenj, nuk dinë të bëjnë propagandë fare: po të ishte E. H. "Pol Poti i Shqipërisë" **amerikanët do ta ndihmonin ashtu si ndihmojnë Pol Potin sot(në Kamboxhi-BK) për arsye të interesave të tyre lidhur me politikën ndaj Vietnamit...** Imazhi i Shqipërisë sot në botë është pak a shumë i njëjtë me atë që

ishte në kohën e ish-mbretit Zog: atëherë këqyrej nga bota si MBRETËRI-OPERETË, kurse sot këqyret si REPUBLIKË OPERETË. Do të thosha se në çdo aspekt është vepruar gabim, është lidhur gomari nga bishti... Sot po e vetëshkatërrojmë shtetin, rrafshojmë një kompleks të tërë industrial, çrrënjosim një sistem ARSIMOR, i kthejmë spitalet në FERR për të gjallët, "spastrojmë" një trup diplomatik të tërë dhe **dërgojmë në botë si "AMBASADORË" ish mësues të edukatës fizike, mjekë, sekretarë provincialë për folklorin, apo rrugaçë që pleksen me prostituta të rrugës në vendet ku janë akredituar** (pa zënë në gojë spastrimet në ushtri, shërbimet informative, në arsim, e tjera); zhduket një flotë e tërë tregtare pa lënë gjurmë e nishan, u hapet rrugë MAFIOZËVE të çdo kategorie, etj.,etj., e lëmë veten të hapur si pasojë e veprimeve të një qeverie INJORANTËSH para akuzave për shkelje të kush e di sa konventave ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut(sa që edhe sponzorizuesit e kësaj "DEMOKRACIE" fallso detyrohen ta kritikojnë administratën shqiptare; ringjallim traditën e **GJAKMARRJES, furnizojmë bordelet e botës me gra dhe vajza, krijojmë një rrjetë të tërë vjedhësish të organizuar të automobilave në vendet e ndryshme DEKOROJMË KRIMINELË dhe injorantë si "PISHTARË TË DEMOKRACISË",** mohojmë një luftë të tërë kundër okupatorëve nazi-fashistë.... Politika e Berishës dhe e oborrtarëve të tij është thjeshtë politika e përçarjes kombëtare,politika e ndasive krahinore, politika e nxitjes së urrejtjes, politika e shantazhit dhe kërcënimit, politika e mohimit të çdo vlere të vërtetë, politika e ANTIKULTURËS, politika e NJERËZVE PA ATDHE, pa BESË, pa BURRËRI, pa NDER dhe pa ideal tjetër veçse PARANË...Një gjë më habit: DENONCOHET(jo pa të drejtë) qëndrimi i kaluar ose i tashëm i këtij apo atij shteti ndaj Shqipërisë ndërsa, nga ana tjetër, KRITIKOHET ENVER HOXHA se e "VET-IZOLOI" Shqipërinë, thjesht sepse diti ose pati rastin t'ua vërë

KUFIRIN TEK THANA të tjerëve! Kurse sot? Jo vetëm që u kemi hapur dyert, por u lejojmë edhe baza ushtarake?... E gëzofshin! Thotë Hegeli: **"ÇDO POPULL KA PUSHTETIN QË MERITON!" Por ka edhe PASOJAT QË MERITON!**...Administrata amerikane ishte jashtëzakonisht e interesuar në rezultatin e zgjedhjeve në Shqipëri, sepse PREFERONTE **injorantin Berisha** në vend të intelektualit Alia(senatori B. Dole në zgjedhjet e vitit 1992 deklaroi në një intervistë me një radiostacion që transmeton programe në gjuhën shqipe se**"PO TË FITOJNË SOCIALISTËT ZGJEDHJET NË SHQIPËRI, AMERIKA DO T'I MBYLL DYERT PËR SHQIPTARËT!",** pastaj prezenca e vazhdueshme e ambasadorit amerikan **Rajerson** pranë kandidatit Berisha, pastaj pritja që iu bë ministrit të jashtëm amerikan Xh. Bejker, që ishte një skandal kombëtar, **ku nuk kishte asnjë flamur shqiptar** dhe ku u krijua përshtypja e një popullsie orientale, anadollake dhe provinciale që priste SULLTANIN. **Turp i madh**!)...Në Perëndim është mendimi i përgjithshëm se Enver Hoxha e siguroi DE FACTO dhe DE JURE PAVARËSINË e Shqipërisë, ndërsa sot, **me praninë e bazave amerikane**, me praninë e **Fondit Monetar Ndërkombëtar**, dhe të **Bankës Botërore**, nuk jam aq i sigurt për këtë. Mund të më sqaroni nëse këto baza do t'i shërbejnë zbërthimit të çështjes nacionale, d.m.th. **PROBLEMIT TË KOSOVËS, apo të kundërtën...** Por pa zgjidhjen e drejtë të çështjes së VETËVENDOSJES së popujve, çdo mendjet e ndritura mund t'i shërbejnë çështjes së kombit dhe njerëzimit liridashës. Njerëz të tillë konsiderohen si FARKATARË të opinionit publik, aq të domosdoshëm për momentin REND I RI që mund të krijohet, nuk vlen asgjë. **Zgjidhja e drejtë e ÇËSHTJES SHQIPTARE lyp unitetin e mendimit dhe të VEPRIMIT të te GJITHË SHQIPTARËVE, në të dyja anët e KUFIRIT**. Në qoftë se shtrohemi si bagëtia, fajin e kemi vetë dhe kurrkush tjetër..." Të gjitha këto mendime të arta të **Viktor Çamit** profesori Qazim i miratonte

njëzëshëm duke shtuar se **Shqipëria më shumë se kurrë ka nevojë për njerëz të tillë largpamës**.

Profesori martir idealist përherë ishte i papajtueshëm ndaj servilizmit, hipokrizisë, mashtrimit, korrupsionit, egoizmit, individualizmit e shumë veseve tjera që kishin mbërthyer shoqërinë shqiptare në të gjitha sferat e shtetit dhe partive shqiptare. Ai ishte gjithnjë në kundërshtim me politikën, mentalitetin dhe mënyrën e jetesës nën okupimin e dyfishtë: **shpirtëror dhe fizik**. Profesori na fliste se si Anglia e asaj kohe nuk i kishte dashur idealistët si Lordin Bajron dhe Persi Shellin, dhe i përndoqi ata. Por Bajroni këtë dëbim e kishte shprehur shumë qartë: " NË QOFTË SE ATO QË THUHESHIN PËR MUA ISHIN TË DREJTA, unë nuk isha i DENJË për Anglinë. Në qoftë se ishin të gënjeshtërta, atëherë Anglia nuk ishte E DENJË PËR MUA!" dhe na i përkujtonte vargjet e Bajronit për luftën e suljotëve për liri:

Sepse unë do t'u mësoj edhe gurëve,
Që të ngrihen kundër tiranëve
E le ta dijë bota mbarë se ne
Kurrë s'do t'u përunjemi froneve.
Gjaku do të derdhet rrëke
E lotët si mjegull e më në fund
Popujt do të triumfojnë.
Bijt e Sulit - merrni hak!
Fjala juaj tym e flak!
Çani mespërmes me shqotë!
Dridhjani trima suljotë!
Lumë kush për të drejtën bie
Tundeni siç u ka hije!"

Sa e sa net pa gjumë kishte kaluar profesori për të mësuar mirë të vërtetën, dhe na përkujtonte fjalët e **KONFUCIT** i cili kishte thënë se: "Nuk dua ta mësoj njeriun i cili vetë nuk dëshiron të mësojë, dhe nuk dua ta sqaroi atë njeri i cili nuk mundohet që vetvetes t'ia sqaroi gjerat. Por nëse unë atij ia sqaroj një të katërtën e gjerave,

por ai sërish nuk e merr mundimin që të nxjerr përfundimin nga ato tri të katërtat e gjerave të pashpjeguara, atëherë unë nuk do mundohem që sërish t'i jap mësim atij njeriu...Dhe nëse do bëhesha sundimtar, atëherë e para gjë që do bëja do ishte **PËRDORIMI I SAKTË I GJUHËS** (terminologjisë), sepse nëse gjuha nuk është e SAKTË , çdo gjë që themi është pa kuptim, dhe nëse ajo që themi nuk ka kuptim, urdhëratë nuk mund të zbatohen, dhe nëse urdhrat nuk mund të zbatohen atëherë e drejta ligjore nuk mund të zbatohet, dhe atëherë njerëzit do jenë në dilemë se çfarë duhet bërë dhe çfarë nuk duhet bërë... Arti i shkathtësisë së gjuajtjes së shigjetës i përngjan parimit të njeriut të moralshëm. Kur shenjëtari nuk e qëllon cakun me shigjetën e tij, ai kthehet dhe në vetvete e kërkon shkakun e dështimit..."---

Po nuk e mësuam mirë të VËRTETËN kurrë nuk do të çlirohemi, na thoshte profesori, dhe shtonte se ai i cili donë të luftojë kundër GËNJESHTRËS dhe PADITURISË, duhet të përballojë së paku **pesë vështirësi**, sipas shkrimtarit gjerman Bertold Breht:

Së pari: Duhet ta ketë GUXIMIN që ta shkruajë dhe ta thotë të VËRTETËN, edhe pse ajo çdo kund heshtet;

Së dyti, duhet ta ketë MENÇURINË për ta dalluar të VËRTETËN, edhe pse ajo në çdo vend mbulohet;

Së treti, Duhet ta ketë shkathtësinë që të vërtetën ta bëjë armë të përshtatshme për LUFTË;

Së katërti, duhet të kemi aftësinë e të gjykuarit të saktë për të zgjedhur ata në duart e të cilëve e VËRTETA do të jetë frytdhënëse, dhe

Së pesti, duhet ta kemi zotësinë për ta shpërndarë të vërtetën në popull...

Profesori kishte një dashuri të madhe për librin, dhe kurrë nuk mund ta gjenim pa një libër apo revistë në dorë. I kishin pëlqyer fjalët e Stefan Cvajgut kur kishte thënë se:

„VLERA E LIBRIT ËSHTË E PËHERSHME DHE SE INVESTIMI MË I MIRË NË BOTË ËSHTË INVESTIMI NË LIBËR", sepse, vazhdonte profesori, kur e ke blerë një

libër të mirë, e ke siguruar një mik të mirë që nuk kërkon nga ti të hajë e të pijë dhe gjithmonë e ke pranë vetes. Ata që arritën ta siguronin këtë armë diturie kurrë nuk do të kapitullojnë para gjithë sfidave të botës.

E gjithë vepra e Qazim Berishës i ngjan një deti të pafund, ku sa më thellë zhytesh në të, aq më i pasur del prej tij si atdhetar, si intelektual dhe revolucionar i paepur. Për ta studiuar veprën e Qazim Berishës në tërë kompleksitetin e saj do të duheshin një duzinë studiuesish patriotë e të kualifikuar në të gjitha fushat e dijes.

Një herë i kërkova falje profesorit, dhe ndërhyra në bisedë, duke i shprehur admirimin tim për konsekuencën dhe rreptësinë në parimet e tij, i cili ndonëse në moshë të shkuar, vazhdonte të punonte me një energji dhe përkushtim që do t'ia kishin zili edhe të rinjtë. Vitet bëjnë punën e tyre, – shtoi profesori, – radhën tani e keni ju të rinjtë, sepse në duart tuaja do jetë e ardhmja. Por ne e dinim se ai ishte shembulli i gjallë se si duhet punuar, luftuar e krijuar, se si puna e pandërprerë intelektuale e mban njeriun të gjallë e të freskët, i ruan aftësitë krijuese. Dhe mbi të gjitha e dinim se përvoja e profesorit ishte një thesar i gatshëm, që për fat të keq, ishte nënvlerësuar dhe mospërfillur me cinizëm vetëm pse ishte largpamës dhe nuk pajtohej me mendimet e harbutërisë dhe kolaboracionistëve, se ishte idealist, njeri me virtyte, e nuk ishte mashtrues, hipokrit, servil e gënjeshtar, sepse idetë e tij aspironin për një "BOTË TË RE". Nuk thuhet kot se KUR VDES NJË PLAK, DIGJET NJË BIBLIOTEKË.

Dy muaj pasi e kishin vrarë xhelatët e UDB-së profesorin militant, **Xhemajli Berisha** (më 6 prill 1989), një profesor i Gjimnazit shkon ta vizitojë profesor Qazimin dhe e pyet: **"Si mund ta shpjegoni rastin e profesorit Bajram,** i cili mbajti fjalimin lamtumirës ditën e varrimit të profesor Xhemailiut, dhe gazetat jugosllave lëshuan alarmin me artikuj sfidues e denigrues (më 16. 04. 1989), siç ishte artikulli në JEDINSTVO: "Separatistiçka xhenaza" **(VARRIMI SEPARATIST),** dhe ende nuk po e

arrestojnë këtë veprimtar? Profesor Qazimi me keqardhje për këtë naivitet të profesorit X.Y. (i cili nga frika se do ta arrestojnë dhe përjashtojnë nga arsimi as që kishte guxuar të merrte pjesë në varrim), i drejtohet me këto fjalë:

„Ju duhet të keni dëgjuar për arrestimin e filozofit Zhan Pol Sartër nga xhandarmëria e Parisit, por kur dëgjon Ministri francez i Punëve të Brendshme, menjëherë jep urdhër të lirohet nga burgu filozofi Sartër, i cili e kishte akuzuar rëndë publikisht aparatin e shtetit francez, duke u thënë vartësve të tij: "Ju jeni budallenj, dhe nuk mund ta dini se me arrestimin e Sartrit ne kemi arrestuar tërë Parisin... ". Edhe UDB-ja e Prizrenit nuk mund ta arrestonte tërë lagjen Arbana, në të cilën brenda ditës vijnë për ngushëllime mijëra pjesëmarrës nga të gjitha anët e Kosovës. A ju kujtohet rasti i varjes në lis të Sefë Koshares më 1881, të cilin këngëtari popullor e përjetësoi në këngë me fjalët – Sefë Kosharja i pari i fisit / Hije t'paska maja e lisit / Hije m'ka o shokt'e mi / Kam dhanë jetën për Shqipni!, atëherë gjenerali turk kishte dhënë urdhër që Sefa të hiqet menjëherë nga litari duke thënë se më i rrezikshëm qenka për së vdekuri, sesa për së gjalli. Nga kjo del se armiku i bën llogaritë mirë se cili veprim do kishte pasoja më të vogla për të, dhe zgjedhin të keqën më të vogël.

Profesori Qazim e nderonte shumë Fan Nolin e madh, dhe na i parafrazonte fjalët e Nolit nga fjalimi për Ditën e Flamurit, më 27 nëntor 1949, në kishën e Shën Gjergjit në Boston, me ç'rast ai kishte ndarë historinë e Shqipërisë në tri periudha: **Periudha e parë**, nis me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 1878 dhe mbaron me ngritjen e Flamurit në Vlorë më 1912, dhe konsiderohet periudha e përgatitjes për të arritur qëllimin kryesor – çlirimin e Shqipërisë nga Turqia; **periudha e dytë** nis me 1912, dhe mund të thuhet se mori fund më 1939, dhe gjatë kësaj periudhe ndihmën më të madhe na dhanë grekët, serbët dhe italianët, të cilët na MUNDUAN aq shumë sa na bënë shqiptarë me pahir, sepse po të ishin sjellë mirë serbët, grekët dhe italianët, mund të na kishin vënë në GJUMË dhe t'i pranonim siç pranuam

Turqinë për 500 vjet. **Periudha e tretë**, dhe e vërtetë, nis me organizimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila fitoi luftën dhe pastaj qëroi Shqipërinë nga jatakët, ua mori Shqipërinë nga dora bejlerëve dhe ia dha popullit..."

Por profesori i palodhshëm nuk na dekurajonte, por përkundrazi na entuziazmonte që të ishim përherë në nivelin e detyrave kombëtare duke shtuar se ende jemi duke i vuajtur pasojat e padrejtësive shekullore, por edhe të dobësive tona në radhë të parë, që këtu e 2200 vjet më parë, **kur Iliria kishte mbi një milionë kilometra katrorë dhe 20 milionë banorë,** ndërsa vetëm të numërohen se sa perandorë të gjakut ilir u kishim dhënë perandorisë romake dhe bizantine, por edhe më shumë se 40 sadriazemë (kryeministra) e sulltanë perandorisë turke, duke shtuar se vetëm në Gjakovë ishin vrarë 16 pashallarë, ndër ta edhe gjenerali Mehmed Ali Pashë Maxhari dhe Abdullah Pashë Dreni (më 6 shtator 1878) nga dora e trimave si Col Delia, Mic Sokoli etj.

Fryma liridashëse kishte ndezur zemrat e trimave shqiptarë të cilët me urdhër të Isa Boletinit, më 29 mars 1903, kishin protestuar me mijëra shaljanë të rrethit të Mitrovicës dhe kishin vrarë konsullin rus **GRIGOR SHQERBININ.** Ushtari i garnizonit turk Ibrahim Popoci (nga Zhegra e Gjilanit) kishte bërë atentat mbi këtë kriminel, për shkak te të cilit kishin rënë 300 dëshmorë në fushën e nderit në përballje me forcat ushtarake turke.

Poashtu i elaboronte gjerësisht Traktatet që dolën nga Shën Stefani (më 3 mars 1878) dhe Kongresi i Berlinit (13 qershor 1878), ku del në shesh politika ekspansioniste e pansllavizmit rus në Ballkan duke ndihmuar në të gjitha format cungimin e tokave shqiptare që i jepen Serbisë, si Vranja, Leskovci, Kurshumlia, Nishi, Toplica (713 fshatra e 8 qytete) ndërsa Tivari, Ulqini, Hoti, Gruda, Plava, Gucia i epen Malit të Zi, dhe në fund Arta, Preveza, Janina dhe tërë Çamëria i jepen Greqisë, sepse shqiptarët nuk patën një përkrahës të jashtëm për t'ua njohur individualitetin kombëtar dhe të drejtën tokësore.

Profesori elaboronte faktin se si Cari rus, Pjetri i Parë, qysh në vitin 1711 i kishte nxitur sllavët e Ballkanit (Serbinë, Sllavoninë, Maqedoninë, Bosnjën, Hercegovinën dhe Malin e Zi) që të kërkojnë nga Rusia që t'i çlirojë ortodoksët e Ballkanit nga robëria e Perandorisë Osmane.

Shtrirja e influencës ruse te shtetet ortodokse sllave bëri që Evropa të jetë e margjinalizuar nga Ballkani. Pastaj na fliste për rektorin e parë të Universitetit të Stambollit (Turqi), **Hoxha Hasan Tahsini** (poet, shkrimtar, filozof, astronom, fizicien etj.) i cili kishte formuar në Stamboll edhe **Akademinë e Dijetarëve Shqiptarë**, dhe në "Revistën Shkencore" (Mecmua i Ulum) kishte shkruar veç tjerash se: "… Shqiptarët deri më sot kanë kaluar 3000 vjet që nuk janë duke e përdorur shkrim-leximin në gjuhën e vet amtare. Dhe kështu duke mësuar dhe shkruar në gjuhët e huaja, studimet e shqiptarëve shkuan kot, dhe kurrfarë dobie nuk patën prej tyre. Për këtë arsye, duke vërejtur këtë dukuri, e pamë të arsyeshme se është nevojë jetësore dhe ekzistenciale të lexojnë dhe të shkruajnë në gjuhën shqipe, dhe kështu formuam këtë Akademi si domosdoshmëri e kohës … ". Dhe kështu del se para se të formoheshin greqishtja, latinishtja, sllavishtja etj. si gjuhë të shkrim-leximit, shqipja e kryehershme ishte gjuhë universale jo vetëm e të folurit, por edhe e të shkruarit, si bijë e PELLAZGJISHTES hyjnore, ndërsa gjuhët tjera janë mbesat dhe stërmbesat e kësaj gjuhe të stërlashtë.

Profesori na fliste se si Studiuesi Zaharie Majani në librin- **FUNDI I MISTERIT ETRUSK**, 1973, f. 69, e quante SHQIPEN si: "... Ajo gjuha e mrekullueshme që i përngjan një vendburimi të pasur, mbi të cilin mjafton të përkulesh dhe të mbledhësh kokrriza ari filologjik" Ndërkaq **Herodoti** dëshmon se Athina është një popullsi PELLAZGE që fliste një gjuhë që nuk e kishte ndryshuar asnjëherë, pra që ishte gjuha e pellazgëve, dhe se HELENËT ishin vetë PELLAZGËT dhe se nuk e kanë ndryshuar asnjëherë gjuhën. Kështu të dhënat historike tregojnë se në Greqinë antike është folur një gjuhë

pellazge dhe ato që quhen dialekte greke si jonishtja, eolishtja dhe dorishtja nuk janë dialekte të greqishtes, përderisa greqishtja e vjetër nuk i përkthen ato, por janë PELLAZGJISHT. Dhe meqë ky popull ishte me origjinë pellazgo-ilire, ka folur një gjuhë pellazgo-ilire (Gjuha antike greke është një gjuhë artificiale, e stisur, e cila u bë gjuhë e administratës dhe e njerëzve të kulturuar që më pas u mësua nga populli që banonte në POLIS(Qytet), pasi populli i fshatit nuk mund ta ketë mësuar dot.

Lidhur me këto çështje kishte shkruar edhe Pashko Vasa më 1879 poemën – **O moj Shqipni**. Profesori me një konsideratë të veçantë na fliste për – UDHËN E SHKRONJAVE – të mësuesit të parë martir, Teodor Haxhi Filipi, **Dhaskal Todri** (1846), mësues i shkollës greqishte në Elbasan, i cili shpiku një alfabet me 52 shkronja, më i ploti nga të gjithë alfabetet e vjetër (sipas studimit të prof. Aleksandër Xhuvanit mbi Dhaskal Todrin), dhe në çastin kur ai po sillte në Elbasan shkronjat për të hapur një shtypshkronjë në gjuhën shqipe, forcat reaksionare e vranë tinëzisht.

ꕥ

Profesor Qazimi vlerësonte lart kontributin që kanë dhënë studiuesit e huaj në vlerësimin e ndihmës që kanë dhënë shqiptarët për qytetërimin botëror dhe apostrofonte amerikanin **Xhorxh Villiams**, i cili e dënon ashpër persekutimin e shqiptarëve në shekullin XX, kur thotë se:

"Është tragjedi tej çdo përfytyrimi që kjo racë e madhe dhe shumë e lashtë të katandisej në këtë gjendje, e cila meriton të quhet SKANDAL I QYTETËRIMIT EVROPIAN".

- Dhe shtonte profesori se ka ardhur koha që të njihet e vërteta historike dhe shqiptarëve t'u jepet vendi që meritojnë, sepse ata janë STËRGJYSHËRIT DHE GJYSHËRIT E KOMBEVE dhe gjuhëve të Evropës dhe krijuesit e qytetërimit të lashtë etnik evropian dhe nuk e

meritojnë të injorohen me kaq cinizëm, kur dihet se qytetërimi TROJAN-DARDAN, është një nga qytetërimet më të lashta dhe më të ndritura që ka njohur njerëzimi dhe së bashku me qytetërimin e Kretës dhe atë ETRUSK, përbëjnë bazën e qytetërimit evropian, apo Perëndimor, meqë si qytetërimi grek, dhe ai romak nuk janë gjë tjetër veçse derivate të këtij qytetërimi të lashtë pellazgo-ilir(Dardanët përmenden si aleatë të Hetëve në betejën e Kadeshit në vitin 1272 p.k., kundër mbretit të Egjiptit, Ramzesi i II). Ene Dardanidi është ai që e themeloi Romën, pas rënies së Trojës, dhe një qytet e ngritën në Itali me emrin Alban. TROJANËT (Lufta e parë e Trojës 1230 p.k.) kishin simbol të tyre SHQIPONJËN, dhe këtë simbol e mbajti Aleksandri i Madh Maqdonas, pastaj PIRROJA i Mollosëve, si dhe perandorët ilirë të Romës, Ptolemejve, dhe në vazhdimësi deri te Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, dhe sot populli shqiptar (Albanë) është i vetmi i cili SHQIPONJËN e mban në flamurin e kombit dhe veten e quan me emrin SHQIPTAR. Pellazgo-ilirët janë themeluesit e qytetërimit antik grek, pasi fiset e mëdha si JONËT, DORËT, EOLËT, ishin të një prejardhjeje pellazgo-ilire.Të gjithë dijetarët e antikitetit Grek si në filozofi, mjekësi, matematikë , art etj. ishin figura pallazgo-Ilire. Meritat e kulturës antike greke i takojnë Pellazgo-Ilirëve.. Në librin –Historia e mbretërve të Britanisë, botuar në shekullin XII, autori Geofrey Monmuth na ka dhënë shumë qartë gjithë historinë e Britanikëve nga shekulli XI p.k. deri në vitin 650 kur Britania pushtohet nga Anglo-Saksonët. Autori thotë se libri është shkruar në gjuhën e lashtë BRITANIKE dhe se ai po e përkthente në gjuhën latine në shekullin XII. Së këtejmi del qartë origjina **trojano-dardane** e britanikëve(BRITI ishte nipi i Ene Dardanidit dhe themelues i mbretërisë së ALBIONIT-BRITANISË). Bashkimi i dy popullsive të dyndura- DARDANËVE në shekullin XI p.k. dhe Anglo-Saksonëve në shekullit VI-VII krijoi kombin BRITANIK.

- Ndërkaq, në territoret e FRANCËS së sotme mbretëronte një dinasti GALO-KELTE (më 1216 p.k.) që e kishte origjinën nga Troja. Frankët janë fisi me origjinë gjermnaike që formoi së bashku me galët dhe romakët kombin francez. TEUTONËT, një nga fiset kryesore gjermanike, formuan kombin GJERMAN dhe atë SKANDINAV. Të gjithë këta popuj i takonin të njëjtës origjinë-pellazgo-trojano-iliro-thrak, ose ndryshe-gjermanët janë-iliro-thrakë.

Fjalët e gjuhës DAKE 60% me shqipen kemi një përputhje me mendimet e STRABONIT, i cili tregon se trakët, dakët e GOTËT GJERMANIKË flisnin një gjuhë, dhe kjo gjuhë ishte të paktën 60% shqip apo një dialekt i shqipes. Nga kjo del se shqiptarët janë i VETMI popull etnik evropian që ruante gjuhën e vjetër të Evropës, meqë kombet e tjera që rrodhën nga kjo racë e njëjtë krijuan gjuhë tjera, por që NËNË E KANË SHQIPEN!

- Profesori na shpjegonte se territoret e MAQEDONISË i kanë banuar me shekuj iliro-shqiptarët ashtu siç i banojnë edhe sot. Vetë ekzistenca e shqiptarëve në këto troje është dëshmia më e mirë se shqiptarët janë autoktonë në këto territore që prej mijëra vjetësh, para Filipit dhe Aleksandrit të Madh. Mbreti i parë i Maqedonisë ishte **PELLAGONI**, i cili kishte marrë pjesë në Luftën e TROJËS si aleat i trojanëve.Dinastia maqedonase fillon me KERAUNIN në shekullin IX para erës së re. Në shekullin shtatë ka të dhëna për një mbret të quajtur **TRIMI**, pas të cilit vijnë sundimtarët-Perdika, Argoja, Filipi, Aeropi, Alketa...Më vonë vjen në pushtet **Aleksandri i Madh i Maqedonisë**(356-323 p.k.), i biri i Filipit të II dhe Olimbisë, princeshës ilire-epirote, bija e Neoptolemit I, i cili u bë një nga burrat dhe strategët më të mëdhenj të njerëzimit. Në përkrenaret e tyre edhe Leka i Madh, Pirroja dhe Skënderbeu vunë kokën e dhisë. Një tjetër simbol ishte shqiponja. E ëma, Olimbia, i solli nga Epiri një njeri të vetin të quajtur Leonidha, që e edukoi për 10 vjet në artin luftarak, ndërsa në letërsi dhe filozofi e

mësoi dijetari i madh, **Aristoteli**. Me ekspeditat e tij luftarake pushtoi shumë territore, gjithë perandorinë e Persisë, Egjiptin dhe tërë Afrikën Veriore bregdetare, përveç Kartagjenës, të cilën mendonte ta pushtonte më vonë. Në Egjipt, në grykëderdhjen e Nilit themeloi Aleksandrinë. Pushtoi Afganistanin(Arianen) dhe arriti deri në kufi me Kinën. Pushtoi Pakistanin dhe arriti deri te lumi Ind, dhe aty u ndal, pa arritur të pushtojë Indinë. Vdiq ende pa mbushur 33 vjeç, më 13 qershor të vitit 323 p.k.Trupin e tij e dërguan në Egjipt ku e balsamosën. **Aleksandri** është **burri më i madh iliro-shqiptarë** dhe më i madhi strateg që ka njohur njerëzimi, i cili brenda 10 vjetësh pushtoi pjesën më të madhe të botës së qytetëruar të asaj kohe. Katër vjet pas vdekjes së Aleksandrit lindi **Pirro i Epirit** (319-272 p.k.) strategu ushtarak më i madhi i kohës antike pas Aleksandrit të madh. Filozofi i madh, **Aristoteli** (384-322 p.k.) ishte pellazgo-ilir dhe fliste gjuhën e nënës, ilirishten, ndërsa greqishten e mësoi në Akademinë e Platonit. Aristoteli ishte filozofi më i madh i antikitetit dhe ndër më të mëdhenj të njerëzimit, të cilin gabimisht shumë njerëz e njohin si grek. Evropa e lindi konceptin REK në shekullin XIX, sepse më parë nuk ka ekzistuar, na shpjegonte me argumente profesori **Qazim Berisha.**

- Me prejardhje pellazgo-ilire ishin edhe këta dijetar: **PITAGORA** (580-500 p.k.) i cili konsiderohet si babai i matematikës: **HIPOKRATI** (460-370 p.k.), i cili konsiderohet me të drejtë-babai i mjekësisë;
- **DEMOKRITI** (470-380), konsiderohet babai i materializmit të lashtë që futi në shkencë nocionin e atomeve;
- **PROTAGORA**, i cili thoshte se NJERIU është masa e të gjitha sendeve që ekzistojnë, dhe mohonte ekzistencën e perëndive; PINDARI(518-438) poet i njohur i antikitetit;
- **CICERONI** (106-43), ilir, oratori më i falshëm i antikitetit, avokat dhe politikan i njohur;

- **Taciti** (556-117), historian, avokat, politikan dhe orator i madh i Romës;

- **VIRGJILI** (70 p.k.) me prejardhje nga fisi ilir i RETVE që popullonin Italinë e veriut. Kryevepra e tij është ENEIDA ku tregohet për peripecitë e udhëtimit të heroit trojan Ene Dardanidit.

- MBRETËRIT ETRUSK TË ROMËS:

- **ROMULI** qeverisi në vitet 753-716 p.k. Romuli njihet si themelues i Romës, por edhe mbreti i parë i saj, dhe rridhte nga familja princërore e DARDANËVE TË TROJËS. Ai formoi senatin e falshëm romak.Ai krijoi kalendarin e parë romak, që kishte 10 muaj-304 ditë, dhe fillonte me muajn MARS, me FESTËN E DITËS SË VERËS më 14 mars, që ishte VITI I RI, sipas kalendarit të vjetër, me çka vërtetohet edhe një herë autoktonia e padiskutueshme e shqiptarëve, sepse kjo FESTË,DITA E VERËS, edhe sot e kësaj dite është festë kombëtare në Shqipëri.

- NUMA 716-672;
- TUL HOSTILI 672-640;
- ANKU MARKU 640-611;
- SERVE TULI 578-534;
- LUK TARKIN SUPERBU 534-510;

- PERANDORËT ILIR TË ROMËS:

- Gai Mariu,
- Luc Septim Severi,
- Karakalla,
- Deci,
- Mark Viktori,
- Tetriku,
- Klaudi II,
- Luc Aureliani,
- Mark Aurel Probi,
- Mark Kariusi,
- Mar Karini,
- Gai Valer Diokleciani,
- Mark Aurel Maksimiani,

- **KONSTANDINI I MADH** (306-337), lindi dhe u edukua në Nish të Dardanisë Ilire, nga nëna e tij Helena.Më 313, me Ediktin e Milanit, shpalli lirinë e besimit të krishterë në kuadër të Perandorisë Romake. Ai ka qenë një strateg i madh ushtarak. Pas tij kemi këta perandor ilir:

- Konstanti,
- Konstandini,
- Konstanci i II,
- Veterani,
- Juliani,
- Joviani,
- Valentiniani,
- Valenti,
- Gratiani,
- Valentiniani II,
- Valentiniani i II(425-455).
- Në vitin 476 Roma ra nën pushtimin gjerman.

- PERANDORËT ILIR TË BIZANTIT:

- Justini(518527)
- Justiniani i Madh;
- Justini II(563-578);
- Tiber Konstandini (578582);
- Mauricio(582-602);

- KRYEMINISTRAT SHQIPTARË TË PERANDORISË OSMANE:

- Gjedik Ahmet Pasha(1475-1479);
- Daut Pasha;
- Naim Ahmet Pasha;
- Ahmet Pash Dukagjini;
- Ibrahim Pasha;
- Ajaz Mehmet Pasha;
- Lufti Pasha;
- Rustem Pasha;
- Kara Ahmet pasha;
- Semiz Ahmet Pasha;

- **Koxha Sinan Pasha** (1506 1596), pesë herë ishte kryeministër i perandorisë;
- Ferad Pasha;
- Merre Husein Pasha;
- Jemishxhi Hasan Pasha;
- Kujxhu Murat Pasha;
- Nasuh Pasha;
- Ohril Hysein Pasha;
- Hasan Pasha;
- Taban Mehmet Pasha;
- Xhixhan Mehmet Pasha;
- Ra Mustafa Pasha;
- Tarahanxhu Mustafa Pasha;
- Qypyrli Mehmet Pasha;
- Fazlli Ahmet Pasha Qypyrliu;
- Fazlli Mustafa Pasha Qypyrliu;
- Ali Pashë Arabxhiu;
- Hysen Qypyrliu;
- Dalltaban Mustafa Pasha;
- Numan Pash Qypryliu;
- Haxhi Halil Pashë Shqiptari;Ivaz Zade Halil Pasha;
- Almedar Bajraktar Mustafa Pasha;
- Memish Pasha;
- Gjurtili Mustafa Nail Pasha;
- Mehmet Ferid Pashë Vlora;
- Mirsili Said Halim Pasha;
- Ahmet Izet Pasha;
- Demat Ferit Pasha(1919-1920) ishte kryeministri i fundit i perandorisë osmane. Shqiptarët qeverisën perandorinë osmane për 150 vjet, dhe me punën dhe mendjen e shqiptarëve u ngrit perandoria osmane.

Shqiptarët kanë qeverisur Egjiptin para vendosjes së Dinastisë së **Mehmet Aliut** nga vitet 1698-1798, pra për rreth 100 vjet, pastaj IRAKUN nga viti 1704 deri në vitin 1754, për rreth 50 vjet, dhe Arabinë Saudite nga viti 1817-1841.

Mehmet Aliu i Kavallës(1805-1841), që nga viti 1841 Egjipti u bë i pavarur dhe për një shekull atë e qeverisin pasardhësit e Mehmet Aliut, i cili vdiq në vitin 1849.

Ibrahim Pasha më 1817 e pushtoi Arabinë, dhe pastaj bashkë me të vëllanë, Ismailin, pushtuan SUDANIN më 1820, dhe themeluan kryeqytetin e sotëm Khartum.Nën sundimin e dinastisë shqiptare të Egjiptit ishin Ekuadori, Uganda, një pjesë e Somalisë, Etiopisë dhe Eritresë;

Abas Pasha, djali i tretë i Mehmet Aliut, qeverisi Egjiptin më 1849-1853;Mehmet said Pasha(1853-1863);

Ismail Pasha(1863-1875);

Mehmet Tefik Pasha(1875-1892);

Haxhi Halim Abas Pasha(1892-1914);

Hysen Qemal Pasha(1914-1917);

Ahmet Fuat pasha(1917-19345);

Mbreti Faruk, i biri i Fuatit(1936-1956);

Mbreti Fuati i II(1952-1953), oficerët në krye me Gamal Abdel Naserin rrëzuan monarkinë , dhe shpallën republikën.

FAMILJA FRASHËRI i ka dhënë shumë jo vetëm Shqipërisë, por edhe Turqisë. Sami Frashëri është një nga themeluesit e turqishtes moderne, dhe hartoi fjalorin e parë turqisht-turqisht, dhe ishte i pari që përdori emrin-turk, sepse për 700 vjet shteti ishte identifikua me emrin e dinastisë osmane. Ai vuri bazat e turkologjisë dhe gjuhës turke. Është autor i veprës së parë **ENCIKLOPEDIA** në gjashtë vëllime.

HOXHË HASAN TAHSINI (1811-1881), ka lindur në Filat të Çamërisë, dhe më vonë ndoqi studimet në Stamboll. Studimet e larta për 10 vjet i kreu në Paris. Është themelues i arsimit të lartë në Turqi, sepse hapi **Universitetin e parë turk më 1871**, në të cilin punoi si profesor dhe rektor i parë. Në Universitetin e Stambollit ka dhënë lëndët:Fizikë, Kimi, Astronomi, shkencat sociale etj. Ai është autor i 20 librave shkollorë. Por me gjithë kontributin që dha , **vdiq në varfëri dhe mjerim, aq sa nuk i dihet as varri?!**

PRINCËRIT SHQIPTARË TË RUMANISË:

- Familja shqiptare Gjikaj ka qeverisur për disa shekujsh Vllahinë dhe Moldavinë, të cilat më vonë do të përbënin Rumaninë.Famija Gjika ishte me origjinë nga Përmeti.

- **Gjergj Gjika**, emërohet princ në Moldavi në vitin 1658-1659 dhe në Vllahi më 1659-1660, dhe vendosi si kryeqytet të Rumanisë Bukureshtin(Shqip-Bukur-është)
- Grigor Gjika(1673-1678);
- Grigori i II Gjika(1726-1733) princ i Moldavisë, dhe pastaj princ i Vllahisë më 1733-1735 dhe 1748-1752;
- Mateu Grigor Gjika(1752-1158) princ i Moldavisë dhe i Vllahisë më 1758-1761;
- Aleksandër Gjika, princ i Vllahisë më 1766-1768;
- Grigor i III Aleksandër Gjika;
- Grigor Dhimitër Gjika;
- Grigor Aleksandër Gjika;

Aleksandri i II Dhimitër Gjika;
Grigori i IV Gjika(187—1871) ishte kryeministër i Rumanisë;

Jon Gjika ishte kryetar i Akademisë së Shkencave të Rumanisë dhe kryeministër i Rumanisë më 1867, pastaj profesor në universitet dhe ambasador.
Dhimitër Gjika ishte president i senatit të Rumanisë në vitin 1886.

ELENA GJIKA një erudite e shquar që në moshën 14 vjeçare fliste 9 gjuhë, dhe mbante lidhje me patriotët shqiptarë si De Rada etj. dhe kontribuoi shumë për çështjen e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ishe një nga gratë më të kulturuara të shekullit XIX.

KONTRIBUTI ARVANIT PËR GREQINË:

Arbëreshët luftuan për çlirimin e Greqisë me në krye figurat e shquara si Marko Boçari, Xhavella, Kolokotroni, Bubulina etj. **Nga 100 heronjtë e 1821, 90 ishin arbëreshë.** Arvanitët ishin profesorët e parë që themeluan Akademinë e Athinës. Ministri i arsimit, **Dhimitër Egjinit**, hapi më 18

mars 1825 Akademinë e Athinës.. Jon Kapodistria ishte presidenti i parë i Greqisë.

KRYEMINISTRAT ARVANITË TË GREQISË:

Kiço Xhavella(1801-1855);
Gjeorgjio Kundurioti(1772-1858);
Andoni Kryeziu(1796-1865);
Dhimitër Vullgari(1801-1877);
Atanasios Miauli(1815-1867);
Dhimitër Qirjako(1811-1869);
Emanuel Repili(1811-1869);
Aleksandër Koriziu(1885-1941);
Petro Bulgari(1884-1957);
Aleksandër Diomidi Qirjako(1874-1951);

Melina Merkuri, artiste me famë botërore , ministresh e kulturës;

Teodor Pangallosi, ministër i kulturës dhe ministër i jashtëm i Greqisë, dhe më 1926 president i Greqisë;

Pavllo Kundurioti në vitin 1923-1926 ishte president i parë i Greqisë, dhe sërish u rizgjodh më 1929.

Athanagora(1886-1972) patriark i kishës lindore, shqiptar me origjinë nga Shqipëria e jugut. Emri i tij i vërtetë është Aristokle Spirou.

Profesori elaboronte çdo dukuri mbi bazën e shkakut dhe pasojës, pra bazohej në kritere dialektike, dhe shtonte se tokat shqiptare që u përdorën për krijimin e shteteve tjera, **del që këto shtete u kanë pushtuar me dhunë të paktën 132.000 kilometra katrorë, dhe po të vendosësh edhe 28.000 km. katrorë nga Shqipëria dhe 12.000 km. katrorë nga Kosova, del që tokat e banuara nga shqiptarët kanë qenë rreth 180.000 km. katrorë para se të krijoheshin shtetet ballkanike**

Më 1912 kishte rreth 92.270-100.000 km. katrorë toka të banuara me shqiptarë, ndërsa më 1913 shtetet fqinje i zgjeruan territoret e tyre në llogari të tokave shqiptare si vijon:

SERBIA - zgjeroi territorin e vet 82% dhe popullsinë 55%;

MALI I ZI - zgjeroi territorin 62% dhe popullsinë 100%;

GREQIA zgjeroi territorin 68% dhe numrin e banorëve 67%, dhe kështu u pushtuan 67,79% e territorit dhe u bë zgjerimi i territoreve të shteteve ortodokse të Ballkanit dhe zvogëlimi drastik i territorit të shtetit shqiptar. Kështu nga rreth 180.000 km. Katrorë që kishin ruajtur shqiptarët, Evropa i la shtetit shqiptar vetëm 28.000 km. katrorë, pasi pjesën tjetër, me gjithë popullsinë shqiptare, ua dhuroi kolonizatorëve serbo - malazezo - grek. Pasi përfundoi fazën e kolonizimit Serbia, Mali i Zi dhe Greqia filluan procesin e asimilimit, dëbimit dhe vrasjeve. Vendet si Serbia kishin hartuar edhe elaborate dhe plane shtetërore për shfarosjen e shqiptarëve autoktonë, siç ishin planet e Vlladan Gjorgjeviqit dhe Vasa Çubrilloviçit, në të cilat flitej për ZHDUKJEN e popullsisë autoktone, sikur flitej për zhdukjen e kafshëve, plane këto të padëgjuara në historinë botërore. Në vend që vendet e qytetërura t'i dënonin këto plane ANTINJERËZORE, përkundrazi, e përkrahën dhe e shpërblyen Serbinë dhe Greqinë duke u dhënë atyre të gjitha mundësitë që t'i realizojnë këto plane raciste e ultrafashiste. Dhe me këtë veprime ogurzeza Fuqitë e Mëdha u bënë bashkëpjesëmarrëse në këtë krim monstruoz antinjerëzor kundër të cilit ngriti zërin Xorxh Fred Williams në librin e tij për shqiptarët ku qorton rreptë padrejtësitë e Fuqive të Mëdha duke shtuar:

" Ato, prenë copa me rëndësi nga toka shqiptare dhe ua dhanë fqinjëve në veri, në jug dhe në lindje, duke shkaktuar kështu ngatërresa dhe luftëra të përditshme në mes të këtyre shteteve; copën që mbeti nga GËRSHANA e tyre e quajtën SHTETI DIPENDENT SHQIPTAR...", dhe pastaj shtonte profesori ynë i nderuar-JA PRA SE CILI ËSHTË BURIMI I TË KEQËS QË VAZHDON EDHE SOT E KËSAJ DITENË TROJET TONA AUTOKTONE SHQIPTARE TË BALLKANIT, dhe ja cili është shkaktari kryesor për shkak të cilit ne po i vuajmë të gjitha pasojat e vuajtjeve dhe tragjedive.

Profesori na fliste me konsideratë të thellë për filozofin e vjetër romak EPIKTETIN të cilin e

skllavëronte forca e skllavopronarëve të pashpirt, por Epikteti shpirtin e kishte më të madh se Koloseumi i Romës; padronët e tij ishin SHPIRTSKLLËVËR ndërsa Epikteti-SHPIRTLIRË duke u bërë kështu simbol qëndrese për të gjithë skllevërit e asaj kohe. Epërsia e tij ndaj xhelatëve ishte epërsi MORALE e SHPIRTËRORE, sepse xhelatët mund t'ia copëtonin trupin, por shpirtin kurrë. Ndërkaq, për Toma Kampanellë profesori shtonte: a mund të harrohen fjalët e Kampanellës kur thotë:

MBAJ NË BALLIN TIM FOTOGRAFINË E RAVIJZUAR TË DASHURISË PËR TË VËRTETËN I SIGURT SE ME KOHË DO TË ARRIJ ATJE KU MË KUPTOJNË EDHE ATËHERË KUR NUK FLAS...", dhe pastaj vazhdonte mësuesi ynë me fjalët lapidare të **MONTENIT**: "Njeriu i arsyeshëm punën më të madhe e bën kur e ruan vetveten për ta kuptuar se gjëja më e shenjtë e njeriut është të qëndrojë në anën e arsyes dhe guximit për ta thënë të **VËRTETËN**, ndërsa sot anarkohistorianët, anarkodemokratët, agjentët e fashizmit, abazkupët, esattoptanët, vrasësit e Avni Rrustemit e Bajram Currit, Luigj Gurakuqit e Hasan Prishtinës, Haxhi Zekës e shumë të tjerëve sot po shpallën martirë të DEMOKRACISË!!??

Okupatorit i intereson që në Kosovën e okupuar të kultivojë sa më shumë kuadro të paafta, dhe sa më shumë propagandë për shtetin përmes kuadrove gjysmake, servile, kolaboracioniste. Ja një shembull shkollor, shtonte profesori: me dy muaj kurs pedagogjik bukëpjekësin "komunist" e bënin MËSUES të cilin më vonë e avanconin në postin e drejtorit të Entit të Botimeve!!?? Fati i njeriut të madh, na thoshte profesori, i përngjan fatit të PROMETHEUT i cili me GUXIMIN e tij arriti t"ia rrëmbente zjarrin perëndisë e ua dhuroi njerëzve , por nxori edhe mallkimin e madh për MOSMIRËNJOHËSIT:

Sllevër, bij skllevërish,
(Zjarrin) s'e meritoni,

Se LIRI s'doni!

Secila klasë në pushtet e krijon edhe tipin e intelektualit të vet, për të realizuar qëllimet e veta hegjemoniste, shtonte profesori Qazim. Pushteti **kolonizator investon shuma marramendëse për të kultivuar të gjitha profilet e pseudointelektualëve: mësues, shkencëtar, mjekë, shkrimtarë etj. që ti ketë si leva të propagandës në shërbim të tij.** Por një kritikë depërtuese që ia heq maskën konformizmit, gënjeshtrës dhe hipokrizisë në shoqërinë tonë nuk ekziston. Në këto rrethana specifike të anarkisë e robërisë, për të mos e njohur qeni të zotin, është krijuar tipi i intelektualit të pasigurt në vetvete **i cili para rrezikut të pushtetit bëhet si pulë, rob i përbuzur, ndërsa para të drejtës dhe të padrejtës qëndron indiferent.** Mungesa e besimit në vetvete e solli kompleksin e INFERIORITETIT për t'u dukur shumë i vogël para hijes së madhe të demagogut, karakteristikë kjo e mentalitetit primitiv dhe provincial të intelektualit tonë. Ky surrogat intelektuali është bërë aq i mjerë sa ia kalon edhe analfabetit. HARBUTËRIA e marrë edhe marritë edhe poshtërsitë e idhujve të saj i merr për urti e qëllime të larta. **Bethoveni** i madh, theksonte profesori, i indinjuar nga harbutëria kishte dhënë alarmin me këto fjalë:

"KOHA JONË ËSHTË E SËMURË NGA RRIQËRIT, AJO KËRKËN KARAKTERE TË FORTA QË T"I VEJË NË LËVIZJE ME KËBAÇ TURMAT TRADHTARE E TË MJERUARA TË HARBUTËRISË"

Pas viteve 1989, pas heqjes së **DELIKTIT VERBAL**, si kërpudhat pas shiut lindën njëra pas tjetrës dhjetëra parti politike në Kosovë, me lejen e ministrit të drejtësisë në Beograd, Vllado Kumbovski, dhe bashkë me partitë dolën në skenë edhe dhjetëra liderë me gojën plot atdhedashuri e patriotizëm deklarativ. Bijtë e shqipes mbetën gojëhapur para liderëve të tillë "idealistë". Rezistenca ndaj okupatorit po bëhej përmes retorikës, përmes dy gishtërinjve, përmes qirinjve, e duke u rënë tenxhereve e kusive me çelësa nga

dhjetë minuta çdo mbrëmje, dhe në fund arriti edhe spektakli komik- **VARRIMI I DHUNËS me dy çizme policësh të Millosheviqit në ARKIVOL të zbrazur, dhe në ballë të këtij "kortezhi funeral" simboli i qëndresës Adem Demaçi?!** Kjo strategji i shkonte për shtati edhe okupatorit që shqiptarët ta shpenzojnë energjinë kot, me qëndresë paqësore, me gandizëm shqiptar, që s"është asgjë tjetër veçse karikaturë e gandizmit të vërtetë të Mahatma Gandit të madh, babait të Indisë, i cili duke u bërë një me masat popullore duke ecur në ballë të kolonës milionëshe këmbë dhe i **zbathur i gatshëm për t"u shtruar para tankeve dhe kavalerisë angleze të dhunës atë që e thoshte e bënte dhe atë që e bënte e thoshte me fjalët emblematike:**

ATY KU DUHET TË ZGJEDHI NË MES TË QYQARISË E TË DHUNËS-UNË JAM PËR DHUNËN! Sepse ai e dinte shumë mirë se përulja, gjunjëzimi, qyqarallëku është PRAGU I VDEKJES SË NJË KOMBI. Ndërsa **DIOGJENI** i madh i antkës na mësonte se LIRINË MUND TA FITOJË VETËM AI I CILI E KA VRARË FRIKËN NGA VDEKJA!

Por profesori me këto krahasime sikur na paralajmëronte se të gjitha këto të zeza nën zgjedhën e robërisë së shpejti, kur të shpërthejë zjarri çlirimtar revolucionar, do bëhen të bardha, dhe na i përkujtonte fjalët e domethënëse të Edith Durhamit:

> ***POR SHQIPTARI EDHE KUR DUKET SE I NËNSHTROHET RRETHANAVE, E BËN KËTË PËR T"I DETYRUAR RRETHANAT T"I NËNSHTROHEN ATIJ"***

Por profesor Qazimi shpesh na përkujtonte se sa shumë kanë kontribua shqiptarët për të tjerët dhe sa pak për vetveten, dhe sot e kësaj dite jemi duke i vuajtur pasojat e këtyre mosmirënjohjeve pikërisht nga ata të cilëve ua kemi bërë mijëra të mira. Dhe pas këtyre ligjëratave të gjata sërish kthehej për të na inkurajuar me

fjalët shpresëdhënëse se vetëm falë heroizmit të micsokolave ne i kemi përballuar burrërisht dhe i kemi sfiduar fuqitë kolonialiste të kohës, dhe pastaj lexonim pjesë nga romani-MIC SOKOLI:

Tym të zi po qet Evropa
Mic Sokoli permi topa.
Shtat krajli i kish Evropa,
Shtat krajli na msyn me topa,
Po shtat zemra n'gjoks t'shqiptarit,
Shtat herë vritet, tetë herë ngjallet...

Profesori na përkujtonte se pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë me vise kanë ngjarë shumë turbullira, shtypje, kthesa, sa përcaktojnë mirë karakterin e cilitdo që mendonte për popullin e për çlirimin e Kosovës me vise. U duk haptas se cilët ishin patriotët, cilët revolucionarët, cilët tradhtar e cilët servil, cilët antishqiptarë, cilët me karakter e cilët palaço. Dhe këto 50 vite kishin ndarë shapin nga sheqeri. Dhe **magnetotruri i gjeniut Qazim Berisha** me një saktësi të përsosur kishte regjistruar në ekranin e pafund të jetës së tij morinë e shqetësimeve dhe të ëndrrave, të realitetit lakuriq dhe të gjurmëve të thella të emocioneve, imazheve, vizioneve, duarve, syve, zemrave, gjëmave, këngëve, valleve, pasioneve, shqetësimeve, dashurive, gjuhëve, tingujve, shfaqjeve të përditshme... Ai me gjithë këtë bagazh dijesh e mbresash **kurrë nuk kishte mbajtur shënime për gjithë atë që kishte parë e kishte dëgjuar,** për t'i çel rrugë detit të pafund të mbushur për shtatëdhjetë e pesë vjet me radhë, dhe vetëm Qazim Berisha do kishte aftësinë për ta Çelur RUBINETIN e detit të KUJTESËS së tij gjeniale, sepse vogëlsia jonë, e nxënësve të tij, nuk kishte përmasat e fuqisë për të këmbëngulur që profesori të na lë një AUTOBIOGRAFI siç na kishte lënë Fan Noli, sepse ishte e pamundur që tërë atë jetë të mundte dikush tjetër ta tregonte e ta ndërtonte, se ato ngjarje, data, njerëz, histori, përjetime, përveç atij vetë, askush tjetër nuk do të mund t'i

rendiste me saktësi.... I mbetur jetim në vogëli, i përplasur nga tallazet e një deti të stuhishëm, i rrethuar nga helmi i kohës nën thundrën e okupimit fashist jugosllav, në burgun e madh kolektiv, i lidhur me zinxhirë të padukshëm, hije të zeza, që kurrë nuk iu ndanë atij, njeriut që ishte nisur për t'i luftuar e zhdukur ultrafashistët për të ndërtuar një BOTË TË RE, pa gjerdhe, pa errësirë, pa shtypje e shfrytëzim, e një bote të denjë të jetuar nga njerëz të denjë . Ai shumë pak fliste në veten e parë, për vetveten, por edhe kur e pyesnim të na tregonte për rrugën e tij, të kësaj jete përherë të vështirë, nuk shpërndante hidhërimin te ne, duke na ruajtur në çdo çast, nga helmimi prej tij, dhe na tregonte shembujt pozitiv, anën e bukur të jetës, NJERËZIT E MIRË, besimin për të ardhmen, dhe besimin se e bardha është më e fuqishme se e zeza, drita më e fuqishme se errësira, dashuria se urrejtja, e ARDHMJA SE E TASHMJA! Ai na thoshte se MIQËSIA është gjëja më e shenjtë, se në një miqësi nuk mjafton të dish të zgjedhësh, por edhe të dish të zgjidhesh.

Profesori ynë i ndjerë, Qazim Berisha, qe 10 vjet jeton në pavdekësi, dhe pavdekësinë e jeton në zemrat e popullit të vet, në zemrat e atyre mijëra nxënësve e studentëve të cilët i mësoi me përkushtimin më të madh. **Data e fundit e jetës së Tij dhe fillimit të jetës së Tij në pavdekësi është 6 prilli 1999**, pikërisht në ditën e dhjetë vjetorit të rënies së dëshmorit **Xhemaili Berisha**. Jeta e profesorit liridashës ishte më shumë se jetë – ishte luftë e vërtetë, luftë me armën e diturisë, me armën të cilës nuk i shterojnë plumbat kurrë, me armën – QËNDRESË, me të cilën ai vrau shumë xhelatë duke mos u nënshtruar, **dhe armiqtë të revoltuar nga pathyeshmëria e këtij trimi, e përbuzën, e injoruan, e përgjuan tërë jetën, por nuk arritën ta mposhtin, edhe pse ia kishin përgatitur disa atentate.** Ai më parë pranoi të ishte një **Sokrat i vuajtur**, sesa një derr i pangopur, një kolltukofag, një marionetë e kolaboracionist. Të rinjtë e quanin **Sokrat të gjallë**, sepse përherë i armatosur me armën e tij dialektike ai shkulte me rrënjë ferrat konservative idealiste që iu kishin

qepur popullit me shekuj në ndërgjegjen e tij. Në kraharorin e tij ziente llava që djeg e shkrumbon çdo gjë antinjerëzore, sepse e dinte se midis xhelatëve dhe luftëtarëve të lirisë nuk mund të ketë kurrfarë kompromisi. Bile shpesh na i përkujtonte fjalët emblematike të Ismail Qemalit ditën e shpalljes së PAVARËSISË:

„S'më mbetet gjë tjetër veçse të lutem e të uroj që të jem i DENJË i kësaj dite dhe që këtej e tutje të jem unë DËSHMORI I PARË I ATDHEUT ashtu si pata nderin dhe fatin që të jem i pari ta puth e ta bëj të valëvitet i lirë FLAMURI ynë në atdheun tonë të lirë! RROFTË FLAMURI! RROFTË SHQIPËRIA!"

Profesorit i pëlqente shumë kjo vjershë nga romani OSO KUKA (nga autori Sulejman Krasniqi, i cili më vonë kishte pësuar ndryshime në qenien e tij pas ardhjes së pluralizmit në Shqipëri dhe kishte kërkuar ndihmën e mjekëve për të **riparuar unin e tij dhe ndërgjegjen e tij**):

Teshat i ka me crule dhe fle mbi bar
Gishtin n'kamzën e pushkës, prore gati për zjarr,
T'mos e gjej armiku gafil, zakon për çdo shqiptar.
Kalimtar, mos vuaj për të,n'vorfninë e tij ai është krenar.
Fyellin dhe këngën nuk e ndërron për asnjë skepter,
Asht ma dinjitozi nga ç'ka bota perandor e mbretën!
Bunet, malet dhe katundin e tij me asgja nuk i ndërron,
As me krajli, pashallarë, vezir, as me t'sulltanit fron,
Cuklat dhe barkun e untuem i quan shenja robnie,
Çfarë ka më të shtrenjtë e ban fli për çdo gurë Shqipnie.
Asht përmendore madhështore në vorfninë e vet,
Po e preke ku i dhemb, në KOMB e në NDER, të pret e të vret!

Dhe kjo na kujtonte thënien emblematike të K. Marksit:

SA MË ME PA VLERË TË JETË EKZISTENCA JOTE, SA MË PAK E SHFAQ JETËN TËNDE, AQ MË E MADHE ËSHTË PASURIA JOTE, AQ MË E HUAJ ËSHTË JETA **JOTE. ose:**

NË PËRPJESTIM TË DREJTË ME RRITJEN E VLERËS SË SENDEVE BIE VLERA E NJERIUT (ku mbizotëron parimi i tregut si rregullator i të gjitha marrëdhënieve ekonomike)

Ose thënia e PARACELSIUSIT:

KUSH NUK DI ASGJË, NUK DO ASGJË, KUSH NUK KUPTON ASGJË, NUK VLEN ASGJË, KURSE AI QË KUPTON, EDHE DASHURON, EDHE VROJTON, EDHE SHIKON, DHE SA MË SHUMË NJOHURI, AQ MË SHUMË DASHURI (dhe sidomos sot në shoqërinë e konsumit ku dashuria është bërë një dukuri mjaft e rrallë dhe vendin e saj e kanë zënë format e ndryshme të pseudodashurisë që në realitet janë forma të degjenerimit të saj, ashtu si dhe robotët që nuk mund ta duan njëri-tjetrin).

Prandaj është një barrë e rëndë dhe punë me përgjegjësi të madhe të **pikturosh me fjalë** veprën e këtij flakadani të arsimit kombëtar, cilësitë e tij karakteristike, jetën e tij të thjeshtë të një filozofi të vërtetë.

Duke shprehur vlerat e larta për profesor Qazimin ish-nxënësit e tij dhe kolegët e tij evokojnë kujtimet e tyre se ishte një kënaqësi e veçantë dhe një fat i madh të kishe rastin të dëgjoje ligjëratat e këtij mësuesi të madh, të thjeshtë e plot dashamirësi, me përvojë të madhe e dije enciklopedike pothuaj nga të gjitha fushat shkencore. Ai gëzonte dashurinë më të madhe dhe respektin e të gjithëve si rrallë kush. Me kalimin e viteve ne gjithnjë e më shumë po bindeshim për cilësitë e larta morale të Tij, se sa i përpiktë e i rregullt ishte, ç'ndërgjegje të lartë detyre kishte, sa i palodhur e i papërtuar ishte, edhe pse në moshë të kaluar. Punonte sistematikisht, pa hope, pa ndërprerje, dhe kurrë nuk ka ndodhur që ta gjenim pa një libër apo pa një revistë a gazetë në dorë. Përreth shtratit të tij kishte libra të renditur, dhe nga të gjitha fushat e dijeve dhe në gjuhë të huaja. Ne e çmonim lart modestinë dhe thjeshtësinë e këtij dijetari të shquar i cili me gjithë autoritetin e tij të pakontestueshëm, të cilin e kishte fituar gjatë karrierës së tij, kurrë nuk dëgjuam të fliste ndonjëherë për meritat e tij personale. Nuk ishte mburravec e rrahagjoks, siç veprojnë mediokrit dhe meskinët. Priste me dashamirësinë më të madhe mendimet e të tjerëve. Gëzohej pa masë kur kuptonte se ish-nxënësit

e tij kanë marrë edhe gradat e larta të akademikëve të Universitetit, e ca të tjerë, si Ukshin Hoti, kishin marrë gradën e lartë në Universitetin e Harvardit. Dhe kurrë nuk mburrej se kishte bërë shumë gjatë jetës së tij plot me peripeci e vuajtje, por na thoshte se nuk ka bërë tjetër veçse **detyrën që duhej të bënte çdo shqiptar** për popullin e për vendin e tij; një detyrë për mësimin dhe edukimin e brezit të ri me ndjenjën e lartë të atdhedashurisë. Na mobilizonte përherë dhe na inkurajonte për vepra të larta patriotike, por edhe na paralajmëronte se në këtë rrugë plot me të papritura të mos dekurajoheshim, por të qëndronim deri në fund përballë sfidave të kohës. Ai na kujtonte **PROMETHEUN E LIDHUR të ESKILIT**, dhe na mësonte ta forconim DURIMIN, GUXIMIN, VULLNETIN dhe DËSHIRËN për t'i bërë mirë njerëzimit e për të jetuar me nder edhe duke qenë buzë greminës, dhe na thoshte se shqiptarët janë një racë origjinale, dhe se FEJA për shqiptarin nuk është gjë tjetër veçse një GUNË, të cilën e heq dhe e vë si t'ia dojë puna. Edhe në çastet më të rënda e mbante veten të fortë si çeliku, dhe kurrë nuk ia kemi parë lotin në sy, kurrë nuk rënkonte dhe nuk binte në ngashërim emocional, bile as në ato çaste të rënda shpirtërore kur ia komunikonim ndonjë lajm tronditës, siç ishte rasti i vrasjes mizore të profesorit liridashës **Xhemaili Berisha** (më 6 prill 1989) në burgun hetues të Prizrenit. Përkundrazi, ai mbahej burrërisht dhe neve shokëve të idealit të Xhemailiut na ngushëllonte me fjalët e tij forcëdhënëse duke e kthyer dhembjen në forcë dhe krenari, por edhe në betim për të dhënë prova të reja përballë sfidave që na prisnin çdo ditë në frontin e luftës kundër armikut. Ai nuk e donte lotin, sepse e dinte se **LOTI ËSHTË ROBËRI,** ndërsa **GJAKU ËSHTË LIRI,** dhe na parapërgatiste moralisht që ta kuptonim se VDEKJA ËSHTË ÇMIMI I JETËS, dhe këtë çmim të shenjtë e kanë paguar vetëm DËSHMORËT të cilët bënë sakrificën sublime duke rënë në altarin e shenjtë të Atdheut. I tillë ishte profesori edhe kur shkuam për ngushëllime bashkë

me të në familjen Berisha, te babë Reshiti e nënë Mehrija, dhe prindërve të dëshmorit iu drejtua me fjalët forcëdhënëse e shpresëdhënëse, që ata të krenohen për birin e tyre hero, duke u thënë se biri i tyre nuk ka vdekur, por është i gjallë, sepse ka rënë për çlirimin e Atdheut, dhe nëse duhet të qajmë me lot, atëherë duhet t'i vajtojmë të gjallët e vdekur, ata që po heshtin dhe po ia bëjnë gjëmën Kosovës duke bashkëpunuar me armikun kolonizator. Dëshmia më e mirë se Xhemailiu është i gjallë, dhe në zemrën e popullit, ishte dita e varrimit të tij në Arbanë, ku morën pjesë mijëra vetë, edhe pse armiku kishte kërcënuar dhe alarmuar profesorët dhe mësimdhënësit e shkollave se ai që shkon në varrim do të përjashtohet nga procesi edukativo-arsimor. Kjo propagandë negative kishte ndikuar që nga rreth 100 mësimdhënës të marrin pjesë në varrim vetëm dy-tre kolegë të Xhemailiut, ndërsa populli, rinia, nxënësit e shkollave, studentët, punëtorët, pionierët, nënat dhe motrat, pothuaj të gjithë ia kishin mësy Arbanës më 7 prill 1989. Mu për këtë, të tmerruar nga ky varrim madhështor, në nderim të veprës së tij heroike, po shkruanin dhe po villnin tërë vrerin dhe helmin racist gazetat e Beogradit dhe Prishtinës, sepse dita e varrimit u kthye në revoltë mbarëpopullore, u kthye në zëkushtrimi dhe besëlidhje për të shpaguar gjakun e këtij revolucionari të paepur (Më 16 prill 1989 gazetat serbe – JEDINSTVO, BORBA etj., botuan artikullin denigrues me titull – SEPARATISTIÇKA XHENAZA – VARRIM SEPARATIST) dhe për këtë tërbim të kolonizatorit profesori Qazim e dinte shumë mirë se kjo fushatë raciste do të jetë edhe një nxitje e madhe për të na zgjuar nga gjumi dhe për të na bërë edhe më luftarak dhe më këmbëngulës në luftën për liri e bashkim kombëtar. Vrasja e Xhemailiut ishte edhe një shkëndijë paralajmëruese e shpërthimit mbarëpopullor që do të vijë së shpejti me organizimin e radhëve të vullnetarëve të UÇK-së

Nga takimet e mia të shumta me profesorin Qazim kam mësuar më shumë sesa nga universiteti. Jam

përpjekur të depërtoj sadopak në shpirtin e tij për të kuptuar ato motive të thella që e shtynë profesorin t'ia përkushtonte tërë jetën dhe tërë qenien dhe aftësitë e tij çështjes së Atdheut të cilin e njihte pëllëmbë më pëllëmbë, ashtu siç i njihte edhe vendet tjera të rruzullit tokësor. Por që t'ia arrija këtij qëllimi me vogëlsinë time, e dija se ishte punë e vështirë, por jo edhe e pamundur që të kuptoja se ai u rrit dhe jetoi si atdhetar i flaktë, luftëtar i paepur për pavarësinë, tërësinë tokësore dhe bashkimin me shtetin amë. Ai ishte armik i shtypjes dhe padrejtësive, atdhetar me ndërgjegje të lartë qytetare e politike, me bindjen e thellë se duhej të luftonte për një ideal të madh, si një Promethe që kishte vendosur të sakrifikohej për t'i dhënë dritë – liri, mirëqenie, kulturë e përparim popullit të vet. Profesori Qazim nuk ishte vetëm njeri i punës së palodhur, i shkathët e me temperament, por edhe shumë kërkues ndaj vetes e tolerant ndaj të tjerëve, pa paragjykime ndaj të tjerëve, i rreptë dhe metodik në punë e në jetë. Në përballje me sfidat e jetës ai ishte pjekur qysh në ditët e vegjëlisë dhe ishte optimist i madh kur na thoshte – TË GJITHA KËTO TË ZEZA TË ROBËRISË NJË DITË DO TË KTHEHEN NË DITË TË BARDHA TË LIRISË! Preferonte mësimet e lashta të **Epikurit** dhe mbi të gjitha i pëlqente ushqimi shpirtëror i cilësisë së parë, në një shoqëri të barazisë sociale. Të bisedoje me profesorin ishte një privilegj dhe një fat i madh. Ai kishte një humor të natyrshëm, të hollë dhe e qeshura i dilte nga thelbi i zemrës. Mbi çdo gjë e çmonte kohën, dhe kurrë nuk e bjerrte kohën pa bërë diçka të dobishme. E kishte bërë të veten porosinë e Horacit: **"Carpe Diem!"** (PËRFITO NGA DITA!). Nuk llogariste orët e gjumit, llogariste vetëm kohën aktive, dhe mendja e tij ishte përherë vitale me një memorie fenomenale.

ꕥ

Profesorit i bëhej zemra mal nga gëzimi kur shihte realizimin me sukses të veprave kolosale në shtetin amë.

Mbaj mend një çast të jashtëzakonshëm gëzimi , që lexohej në fytyren e profesorit, **më 19 tetor 1979**, me rastin e përfundimit me sukses të plotë i të gjitha ndërtimeve në rrethet e Shkodrës, të Lezhës, të Mirditës, të Dibrës, të Krujës, të Matit, të të Pukës e të Tropojës, që u dëmtuan rëndë nga termeti i fortë i 15 prillit 1979, sepse në një kohë rekord dhe vetëm me forcat e veta brenda një afati rekord u zhduken pasojat e një fatkeqësie të madhe natyrore. Atë ditë ne e kishim përjetua ngrohtësisht fjalimin e **Enver Hoxhës** në mitingun e madh në Bahçellëk të Shkodrës dhe fjalët emblematike:

TERMETI LËKUND MALET POR JO SHQIPTARI N!

Profesori na fliste me orë të tëra për artin, letërsinë, filozofinë, politikën etj. Njëherë na foli gjerë e gjatë për **L.Van Bethovenin**, i cili i kishte shkruar Princit Lihnovske këto fjalë: " Princ, ajo që jeni ju, jeni për shkak të rastësisë dhe familjes ku keni lindur, ndërsa ajo që jam unë, jam përmes vetes sime; **princa ka pasur dhe do të ketë me mijëra; BETHOVEN ka vetëm një!"**

Profesori na fliste me respekt të veçantë për VLERËN E KOHËS, dhe na i përkujtonte fjalkët e LENINIT se **VONIMI QOFTË EDHE NJË MINUTË** NGA ORA E CAKTUAR ËSHTË NJË **KRIM**, dhe na porosiste që ta kursejmë KOHËN tonë dhe të tjerëve, të tregoheshim të përpiktë dhe të organizuar, të kujdesshëm dhe të disiplinuar, sepse koha për ne është shumë e shtrenjtë, më e shtrenjtë se margaritarët,më e shtrenjtë se floriri,por jeta është e tillë që **FLORIRIN KOHË** ta harxhojnë edhe njerëz jashtë kohës. Ne jemi shumë të vonuar, pohonte profesori, dhe natën duhet ta bëjmë ditë për të shpëtuar nga prangat e robërisë shekullore, për të dalë nga shpella e errësirës, nga oqeani i paditurive tona të pafalshme, dhe na përkujtonte poezinë e Nolit të madh-RENT OR MARATHONOMAK! Dhe pastaj poezinë e Dritëro Agollit: TË PAGJUMËT(sepse Shqipërinë e përgjonte vdekja e ujqërve imperialisto-revizionistë):

Mos vallë se dikush në botë rri zgjuar

Dhe mua me gjuan, dhe mua me ndjek
Me gishtin në këbëz shtrënguar,
Me plumb në dyfek?
Po!
Ai gjuan me plumb e me sy!
Ne, të pagjumët e botës, e dimë mirë!
Ja, ai bën stërvitje anës Rinit e Missisipit: "Një,dy!"
Helmetën ul nën ballin e nxirë!
Po ne, të pagjumët jemi racë e zgjuar,
Ne, punëtorë, konstruktorë, astronomë, poetë,
Ne kemi uranium, yje e vargje në duar,
Le të bëjë "një, dy" ai me helmetë.

Dhe sa e çmueshme është koha, dhe sidomos në rrethana lufte, shtonte profesori, kur vullnetarët e lirisë lëshohen me vrull të papërmbajtur kundër armikut, ditën dhe natën, nëpër borë e nëpër shi, jo sikur shkonin në luftë, por sikur shkonin në dasmë! Dhe falë këtyre trimave, këtyre micsokolave të UÇK-së bota u detyrua të kuptojë se shqiptarët e meritojnë lirinë, dhe tani KOHA po detyrohej të punonte për shqiptarët, dhe armikut po i bëhej me dije se edhe shqiptarët dinë të FLASIN me gjuhën e FORCËS, **me gjuhën e grykëhollave**.

Karakteri i tij i fortë ishte prodhim i rrethanave tipike të mjedisit ku jetoi, krijoi e luftoi. Si njeri i madh dhe i jashtëzakonshëm, që të kuptohet, shpjegohet e njihet drejt duhet parë i vendosur në kontekstin e kohës, në rrethanat personale, kombëtare e ndërkombëtare ku ka jetuar e luftuar. Të gjithë ia atribuonin profesorit epitetin – SOKRAT I GJALLË I DITËVE TONA, sepse gjithë ajo dituri kolosale nuk ishte shkruar nga dora e tij në asnjë vend, përveç atyre mësimeve dhe thënieve proverbiale që kishin ngelur në kujtesën e nxënësve të tij, kolegëve të tij, ithtarëve të tij dhe dëgjuesve të tij të shumtë, të cilët edhe sot e kësaj dite thonë me admirim: KËSHTU NA THOSHTE PROFESOR QAZIMI.

Profesori i nderuar edhe vetë ishte i vetëdijshëm se sa e dëmshme është që gjithë ajo dije enciklopedike nuk po mbetet e shkruar, qoftë edhe në një autobiografi të shkurtër nga dora e tij, sepse vetëm ai mund ta njihte më së miri vetveten, dhe mu për këtë na thoshte shpesh: **VERBA VOLANT, SKRIPTA MANENT** (Fjalët harrohen, shkrimet mbesin).

Për ta vënë në spikamë gjenialitetin e profesor Qazimit po e japim vetëm një shembull sa për ilustrim: posa kishte përfunduar vitin e parë të ligjëratave në Gjimnazin e Prizrenit ishte domosdoshmëri të kryhej edhe provimi shtetëror si kusht për të vazhduar procesin edukativo-arsimor, dhe ky provim duhej të jepej para këshillit pedagogjik në Beograd. Atje kishte qindra mësues që po shkonin në provim për të dytën dhe të tretën herë, se ishte shumë i vështirë. Dhe i pari i merr pyetjet Qazim Berisha, dhe përgjigjet një për një. Por, në një çast profesori e kundërshton, dhe i thotë se përgjigja nuk është e saktë. Por Qazim Berisha merr lapsin, dhe shkruan se në cilin libër, te i cili autor, dhe në cilën faqe është shkruar ajo që tha ai. Këshilli pedagogjik kishte vendosur një orë pushim, dhe pasi kishte vërtetuar se përgjigja ishte e saktë, ngrihet profesori – kryetar i atij komisioni, dhe thërret **Qazimi Berishën** duke ia bërë me dorë në shenjë nderimi: **"Urdhëroni zoti Qazim, uluni këtu, se ky është vendi i juaj, jo imi!"** Dhe pastaj profesori në fjalë, merr indeksat e të gjithë mësuesve dhe arsimtarëve dhe u thotë: **"Pasi unë sot u rrëzova në provim, ju të gjithë keni kaluar!"** Pjesëmarrësit në provim, nga të gjitha republikat jugosllave, të gëzuar se e dhanë provimin shtetëror, e ngritin mbi supe Qazim Berishën, dhe e shëtisin rrugëve të Beogradit.

Sa e sa episode të tilla kishte përjetuar Qazim Berisha.

Përkundër përpjekjeve të pareshtura të shqiptarëve për të shkatërruar zgjedhën e robërisë, megjithatë vendet evropiane akoma po hezitonin të zgjidhnin çështjen shqiptare, dekolonizimin e KOSOVËS ME VISE, sepse

ende nuk po i shihnin interesat e veta dhe, sidomos, pa u nxitur nga vetë kryengritja e shqiptarëve të robëruar. Lidhur me këtë profesori na prezantonte shembullin e publicistes dhe patriotes shqiptare **Elena Gjika** (1828-1888), e cila e indinjuar nga cinizmi dhe mospërfillja e vendeve të mëdha ndaj çështjes shqiptare, i shkruante Xhuzepe Garibaldit. Përgjigja e Garibalidit ishte kuptimplote – **"VENDET E MËDHA NUK DUAN SHQETËSIME, DERISA VENDET E VOGLA NUK DO T"I SHQETËSOJNË ATO ME LUFTËN E TYRE**, mos u ankoni me mospërfilljen e vendeve të mëdha. Nëse doni diçka, shqetësoni ato… "Dhe me këta shembuj profesori na mësonte se vetë ne shqiptarët e robëruar duhet të jemi pjesë e zgjidhjes së problemit, d.m.th. , duhet t'i rrokim armët e lirisë.

Profesorin Qazim Berisha e gëzoi pa masë fakti i **daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 28 Nëntor 1997** ditën e varrimit të dëshmorit Halit Geci në Llaushë, por nga ana tjetër e kishte hidhëruar pa masë shthurja e shtetit shqiptar si një kështjellë rëre, dhe kjo po ndodhte në kohën kur çlirimtarët e Kosovës kishin më së shumti nevojë për ndihmën vëllazërore të shtetit amë. Po e brengoste pa masë edhe **sabotimi i UÇK-së nga ana e pacifistëve të LDK-së** të cilët për herë të parë po takoheshin me përfaqësuesit e vullnetarëve të lirisë në RAMBUJE (sepse në Kosovë nuk i njihte)? Kishte ende shumë paqartësi në zhvillimet e papritura. Pse delegacioni shqiptar **në Rambuje nuk guxon të kërkojë më shumë** se sa janë INTERESAT amerikane në Kosovë? A duhet që përfaqësuesit e UÇK-së në Rambuje të pranojnë **çarmatosjen e UÇK-së**, dhe të kërkojnë më shumë se pacifistët e Rugovës? Pse u nënshkrua marrëveshja e qeverisë së përkohshme në Paris dhe jo në Prishtinë? Pse **Adem Demaçi** nuk e njeh strukturën e re qeverisëse, dhe nuk pranoi kompromiset për çarmatosjen e UÇK-së? A është unike UÇK-ja në qëndrimet e veta politike? Pse nuk u bë presion në Rambuje që në delegacionin e Kosovës të

futej **edhe i burgosuri më me famë në Evropë, Ukshin Hoti?** A janë të vetëdijshëm se çfarë përgjegjësie po marrin mbi vete ata që po nënshkruajnë kompromise aq flagrante, kur dihet se Millosheviqi njeh vetëm gjuhën e forcës. Shqiptarët pranuan marrëveshjen, ndërsa delegacioni i Beogradit refuzoi, dhe sa kohë që vonohet ndërhyrja, kjo do të thotë se është **LEJE** për Millosheviqin **që dora gjakatare e dhunës serbe të masakrojë si në Prekaz, Likoshan, Qirez, Abri, Reçak** etj. Në kushtet kur po intensifikohet masakrimi masiv i shqiptarëve, bisedimet dhe marrëveshja do të ngjanin me një çudi. Dhe profesori nuk mund ta kuptonte paradoksin që po ndodhte me shqiptarët, kur në situata luftarake po përdornin mjete paqësore, dhe anasjelltas, në situata paqësore po përdornin instrumente luftarake. Dhe kur më 1995 "Paqja e Dejtonit" dështoi, kur as që u përmend çështja e Kosovës, dhe shqiptarët u ngritën në luftë, atëherë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm u aktivizuan për të bindur popullin e Kosovës që të ndërrojnë rrugë, duke përdorur instrumente të paqes në vend të atyre të LUFTËS, gjoja për shpëtimin kombëtar. Kur në ish-Jugosllavi bëhej luftë në disa fronte, me sllovenët, kroatët dhe boshnjakët, **shqiptarëve u thuhej – RRINI URTË**, sepese pacifizmi i tyre do të SHPËRBLEHEJ. Më pas, kur Kosova u ngrit në këmbë të kërkonte lirinë e shumëpritur me LUFTË, faktori ndërkombëtar **vraponte për t'i bindur përfaqësuesit shqiptarë se tani është koha për t'i përdorur mjetet paqësore**?! Ndërkaq, kur rreziku i luftës u ndie pranë Maqedonisë, pa u organizua asnjë konferencë bisedimesh, 13 mijë forca ushtarake u urdhëruan të nisen për të siguruar qetësinë e Maqedonisë së përkëdhelur. Nga kjo shihej qartë se ishte shumë evident **CINIZMI I FUQIVE TË MËDHA** ndaj shteteve më të vogla, të cilat do të duhej që vetë të përpunojnë STRATEGJINË VETËMBROJTËSE. Eshtë naive të mendohet se **Rambujeja** do t'i mbyllte problemet shekullore, sepse shqiptarët e Kosovës pranuan një **"PAQE ME KUSHT",** dhe nënshkrimi i obligon ata ndaj

Perëndimit. Ndaj Beogradit shqiptarët do të mund t'i obligonte vetëm një marrëveshje e DREJTË. **Rambujeja u organizua për t'i ÇARMATOSUR forcat çlirimtare të UÇK-së, shpërbërjen e UÇK-së, kur dihet fare mirë se agresorët serboçetnikë kanë instaluar në Kosovë mbi 100 mijë forca ushtarako-policore**, dhe pikërisht këta xhelatë gjakpirës duhej çarmatosur, e jo liridashësit e UÇK-së. Kjo hile e vjetër e diplomacisë ndërkombëtare po ushtrohet me të gjitha mjetet ndaj shqiptarëve, dhe fare nuk përmendet emri KOSOVË, si dhe përjashtohet premtimi që faza kalimtare të përmbyllet me REFERENDUM dhe VETËVENDOSJE! Prej shqiptarëve kërkohet një flijim, KAPITULLIM. Dhe situata mund të eskalonte në një luftë që do të përfshijë gjithë Evropën, dhe Moska vendosi ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me NATO-n. Ministria e mbrojtjes së Shqipërisë urdhëroi pastrimin e vendstrehimeve dhe fortifikimeve të trashëguara nga koha e socializmit dhe të braktisura prej një dekade. Bunkerët dhe transhetë po rehabilitoheshin dhe po përforcoheshin trupat ushtarake me teknikë lufte në zonën kufitare në rajonet veriore. **Ushtria serbe për tri ditë me radhë po godiste me artileri fshatrat kufitare në Tropojë, Has dhe Kukës** (25, 26 dhe 27 mars 1999). Salih Berisha e kishte cilësuar UÇK-në si **"FORMACION TERRORIST marksist-leninist,** "fanatik dhe bolshevik"?! Tërë bota kundër nesh, dhe ne kundër vetvetes?! Shqiptarëve u është marrë peng fjala, dhe Beogradi çdo ditë po i sulmon për t'i shfarosur. **Shqiptarët nënshkruan një marrëveshje paqeje dhe po shpërblehen me GJENOCID**. Kosova po vritet në dorëzani (GARANTIM) të NATO-s, Amerikës dhe Parisit. Marrëveshja e Rambujesë po vret çdo ditë qindra e mijëra shqiptarë. Shqipërisë iu ka **mbyllur goja**, iu kanë lidhur duart, që të lëshojë kushtrimin për mbrojtjen e vëllezërve në Kosovë. Sa shumë njerëz me koka në duar, pleq, burra, gra, fëmijë, djem të rinj, nëna kanë marrë ikën në drejtim të Shqipërisë të tmerruar nga goditjet e breshërisë së

granatimeve nga artileria serboçetnike. Fshatra të tëra u bënë shkrumb e hi. Kosova po zbrazet. Sot kush mbetet në Kosovë, me uniformë e pa uniformë, është UÇK! Në Shqipërinë shtetërore, me largimin e mbi gjysmë milioni të rinjsh drejt Perëndimit, është krijuar një boshllëk demografik. Në zonat verilindore kanë mbetur vetëm 20% e popullatës. **Nga ana tjetër 20 mijë ish-oficerë në lirim të Shqipërisë, janë bërë gati të shkojnë në frontin e luftimeve në Kosovë, dhe vetëm po pritnin lejen e presidentit Mejdani.** Shtabi i UÇK-së shpalli mobilizimin e detyruar të të gjithë shtetasve të aftë për luftë, prej moshës 18- deri 50-vjeç. Kosova u bë test për besnikërinë e unitetit të vendeve anëtare të NATO-s. Të gjitha këto probleme po e preokuponin profesorin shpirtndritur edhe në çastet e fundit të jetës së tij. Profesori kurrë nuk u pajtua me pikëpamjet absurde, naive dhe foshnjarake se çështja kombëtare shqiptare do të zgjidhej menjëherë nëse do të **"DEKOMUNISTIZOHET SHQIPËRIA" dhe "të DEMOKRATIZOHET SERBIA",** sepse problemi shqiptar nuk ishte kaq i thjeshtë për t'u vulgarizuar në këtë farë mënyre. Çështja shqiptare u trashëgua si padrejtësi e historisë politike të Evropës, dhe zgjidhja e saj do të thotë RISHIKIM i traktatit të Shën Stefanit (mars 1878), vendimeve të Kongresit të Berlinit (13 qershor 1878), Traktatit të Londrës (1913), Paqes së Versajes (1919), i Konferencës së Jaltës (1945) i bisedimeve të Maltës (1989), konferencës së Londrës (gusht 1992), paqes së Dejtonit (1995), dhe ndoshta i vendimeve të konferencës së **Rambujesë** (mars 1999), sepse shqiptarët nuk u ndanë vetë por i ndanë të tjerët. Protektorati politik dhe ushtarak funksionon prej vitesh në Bosnje dhe në Maqedoni, është vendosur pjesërisht në Shqipëri, dhe po bëhet gati për Kosovën. Profesori potenconte se Kosova e sotme gjendet pothuajse në po ato kushte në të cilat gjendej Shqipëria në vitin 1913 kur u bë PROTEKTORAT ndërkombëtar. **Esat-toptanët ende janë gjallë, tradhtia ende nuk është vrarë.** Në rastin e shqiptarëve kemi të bëjmë me një popull të

përgjysmuar, të copëtuar në pesë pjesë, bashkimi i të cilit imponohet si imperativ për zhvillimin e tij normal. Një shtet i tillë i bashkuar shqiptar do t'i thyente paragjykimet e shumta të krijuara artificialisht nga armiqtë tanë. UÇK-ja është pjesë e zgjidhjes së problemit shqiptar, dhe ZËRI I RADIO KOSOVËS SË LIRË (4 janar 1999) na i forcon zemrat, na i rrit shpresat, sepse **po krijoheshin bazat e INFORMATIKËS.** Tani UÇK-ja nuk ishte pa zë, nuk e kishte gojën e mbyllur e veshin e shurdhër, për ta thënë të vërtetën për luftën e vullnetarëve të lirisë në Kosovë, sepse dihet se pa mediumet e informatikës kurrë nuk mund të bëhesh shtet, pohonte profesori Qazim. **Tanimë kishin dështuar skenarët që të ndizej NJË LUFTË CIVILE në Shqipëri dhe "fiset" veriore do të nxisnin një Kryengritje në Kosovë më 1997 për të ndihmuar S. Berishën** (i cili po dërgonte trupa në krahinën e jugut, dhe një MIG në orvatje për të bombarduar qytetin e Delvinës) që të thyente revoltat e jugut, dhe tërë vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare ishte fokusuar nga Shqipëria, ndërsa Millosheviqi po shfrytëzonte shansin për ta thyer UÇK-në, por nuk ia arriti. Pas epopesë së lavdishme të Jasharajve, më **5 mars 1998** (me ç'rast ranë në fushën e nderit 59 dëshmorë të lirisë) nisi të shembej STATUS-KUOJA që ishte mbajtur nga viti 1990. Masakra e familjes Jashari ishte shkëndija e zjarrit të kryengritjes gjithë-popullore dhe ngjalli simpatinë e gjithë botës liridashëse për luftën e drejtë të UÇK-së (në një kohë kur kryetari i pacifistëve të LDK-së e konsideronte UÇK-në – **"TURPIN më të madh të Kosovës"** (siç shkruante në KOHA DITORE të 10. 10. 1998, në një intervistë me Jirzhi Dinsbirin), dhe tërë Kosova ishte në këmbë në përkrahje të njëzëshme të vullnetarëve të lirisë duke brohoritur rrugëve dhe shesheve të Kosovës: UÇK! UÇK! dhe "DRENICË JEMI ME JU! "JETËN E JAPIM, KOSOVËN NUK E JAPIM!". Këto shpërthime të vrullit çlirimtar po ia zgjatnin shpresat profesorit veteran të LNÇ-së. UÇK-ja e mundi vdekjen, thoshte profesori, dhe kishte besim të plotë se UÇK-ja,

ashtu siç doli në skenë, në mënyrë dinjitoze dhe efikase, do të dijë ta përmbush misionin e vet deri në çlirimin përfundimtar të çdo pëllëmbë toke shqiptare nën okupimin serbo-maqedono-malazezo-grek. Profesori na i përkujtonte fjalët e një gjenerali francez, të kohës së Napoleon Bonapartit, i cili iu kishte drejtuar ushtarëve të vet me këto fjalë: **PO TË VETE PËRPARA, PASOMËNI, po të gjunjëzohem, ndihmoëni, PO TË KTHEHEM PRAPA, VRITMËNI!** Dhe kështu do të duhej të vepronin komandantët e UÇK-së, na thoshte profesori militant. Poashtu, shtonte profesori, trimat e UÇK-së nuk duhet t'i harrojnë fjalët e Dantonit të madh – se në luftë dhe në jetë duhet: GUXIM, GUXIM dhe VETËM GUXIM, sepse qyqarët nuk e meritojnë as jetën as lirinë.

JETËN DHE LIRINË E MERITOJNË VETËM ATA TË CILËT NË ÇDO ÇAST JANË TË GATSHËM TË VDESIN NË EMËR TË JETËS DHE LIRISË!

(GËTE)

ꕥ

Profesori shpesh na i përkujtonte fjalët aq dinjitoze të DANTONIT të madh(1792):

UNË NUK I FRIKOHEM VDEKJES, SEPSE
JETA IME I TAKON ATDHEUT!

Profesori ishte një shembull tipik i njeriut praktik revolucionar, e jo utopik dhe metafizik, dhe shpesh na thoshte se për realizimin e veprimeve revolucionare duhet një investim i madh dhe i gjatë, një energji kolosale, një intelekt dhe entuziazëm i madh, sepse nuk mund të krijojmë nëndetëse vetëm duke lexuar Zhyl Vernin, ashtu siç nuk mund të krijojmë një shoqëri humanitare vetëm duke lexuar librat e dijetarëve si Marksi, Engelsi e Lenini, sepse çështja qëndron në faktin – **si ta ndryshojmë botën, e jo si ta shpjegojmë e interpretojmë atë.** Deviza e tij

ishte – NUK NDËRTOHET NJË BOTË E RE PA U PËRMBYSUR BOTA E VJETËR! Profesorin e preokuponte çështja e organizimit të mirëfilltë të UÇK-së dhe na paralajmëronte se është i nevojshëm organizimi i denjë i hierarkisë ushtarake përbrenda bërthamës së qendres së komandimit, koordinimi dhe furnizimi të SHTABIT TË PËRGJITHSHËM, sipas modelit të Shtabit të Përgjithshshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në përbërje prej 12 vetash në krye me Spiro Mojsiun (10 korrik 1942). Profesori na përkujtonte shembullin e suksesit të brigadave partizane kur më 9 tetor 1943 një divizion i tërë italian, divizioni "FIRENCE", i komanduar nga gjenerali **Aci me një efektiv prej 15. 000 ushtarësh** e oficerësh u DORËZUAN te Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare (UÇNSH), dhe prej tyre **1500 ushtarë e oficerë** pranuan të luftonin me armë në dorë kundër nazistëve gjermanë në radhët e reparteve partizane në kuadër të batalionit me emrin e themeluesit të Partisë Komuniste të Italisë, **Antonio Gramshi**, ndërsa ushtarët tjerë italianë, të cilët nuk dëshironin të luftonin, u strehuan në shtëpitë e fshatarëve në zonat e çliruara të vendit, me gjithë vështirësitë e jashtëzakonshme ekonomike. Poashtu, profesori theksonte shembullin e heroizmit të UNÇSH kur **më 18 tetor 1943 artileria e UNÇSH-së** qëlloi me top "Asamblenë" e KUISLINGËVE të mbledhur me nismën e komandës gjermane. Po atë ditë në Tiranë PKSH-ja kishte shpërndarë traktin: **"SI I PËRGJIGJET POPULLI SHQIPTAR ASAMBLESË SË GESTAPOSË ME TOP!"**

Profesori thoshte se UÇK-ja duhet patjetër ta bëjë diferencimin e thellë të forcave politike, dhe repartet e forcave çlirimtare t'i spastronin nga reaksionarët dhe tradhtarët në gjithë krahinat e çliruara, dhe të **formoheshin Këshillat popullorë nacionalçlirimtarë**, përndryshhe nuk mund të luftohej me sukses dhe të arrihej FITORJA kundër serboçetnikëve, pa luftuar njëkohësisht edhe **kundër shërbëtorëve të tyre**. Dhe në këtë kontekst historik UÇK-ja mund ta çlirojë Kosovën me vise.

Ndërkaq, në mungesë të këtyre faktorëve të domosdoshëm, të konspiracionit të thellë dhe organizimit konseguent të DREJTORISË POLITIKE të UÇK-së, në të cilën u infiltruan sabotatorë dhe karrieristë qëllimi i të cilëve nuk ishte – **ÇLIRIMI I KOSOVËS** dhe viseve tjera nën okupim, sipas BETIMIT TË UÇK-së, por interesat personale dhe ambiciet e sëmura meskine politike, për një thërrimë pushteti, qëllimi i shenjtë madhor u sakrifikua për interesa meskine. Kështu rezultoi se lufta e UÇK-së kaloi nëpër tri faza: **FAZA E PARË** filloi me luftën GUERILE për ÇLIRIM DHE BASHKIM KOMBËTAR (sipas parimit – **GODIT SI RRUFEJA DHE ZHDUKU SI ERA)** deri në vitin 1998, kur në udhëheqje të Luftës sonë Çlirimtare ishte LPK-ja (Lëvizja Popullore e Kosovës), dhe më **11 maj 1998** ishte nënshkruar një marrëveshje midis Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe LKÇK-së (Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës), për bashkimin e të gjitha forcave çlirimtare në luftën e armatosur dhe për krijimin e FRONTIT POLITIK të LUFTËS, për bërjen e politikës së luftës… Në këtë fazë të luftës i dërguari i SHBA-së, **R. Gelbard**, e cilësonte UÇK-në si GRUP **TERRORIST**?!; **FAZA E DYTË** rezultoi me një luftë të **kontrollueshme nga faktori i jashtëm ndërkombëtar (NATO – Evropë) me inkuadrimin e luftëtarëve në një luftë FRONTALE dhe mbrojtje pasive, në vend të sulmeve të pareshtura dhe njësiteve guerile,** kur armiku kishte epërsinë numerike dhe teknike të arsenalit luftarak, dhe reduktimin e kërkesave në PAVARËSINË E KOSOVËS, pra **nga çasti kur u mohua shpërthimi i luftës** edhe në MAQEDONI, që nga ai qast **LUFTA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS U VU NËN KONTROLLIN E PLOTË TË DIPLOMACISË NDËRKOMBËTARE** dhe u bë shmangia e LPK-së nga udhëheqja e luftës, kur ajo u zëvendësua nga një grup njerëzish që u quajtën – DREJTORI POLITIKE, dhe kjo u bë lehtësisht nga se " krerët" e Lëvizjes ishin në Evropë (**më vonë qendra e tyre nga Zvicra u vendos në Tiranë), e jo në frontin e luftimeve në Kosovë (1998-**

1999), dhe për më keq ndodhi kur në mënyrë të njëanshme **u anulua marrëveshja midis Shtabit të Përgjithshëm dhe LKÇK-së;** ndërsa pas marsit të vitit 1999, pas RAMBUJESË, fillon **FAZA E TRETË**, reduktimi shkon edhe më larg, dhe degradon me kërkesën për **AUTONOMINË E KOSOVËS** brenda Jugosllavisë. Pranimi i ftesës për të shkuar në KONFERENCËN E RAMBUJESË (po kush i zgjodhi këta udhëheqës që shkuan në Rambuje?), **ku përfaqësuesit e UÇK-së kapitulluan me pranimin e 10 pikave të panegociueshme, ndërkaq në pikën katër të kësaj marrëveshjeje thuhej se – PALET NË KONFLIKT (pra – jo në LUFTË, BK), zotohen për ruajtjen e INTEGRITETIT TERRITORIAL DHE SOVRANITETIN E JUGOSLLAVISË"??!!** Këtu ishte tragjedia më bizare, sepse sipas Marrëveshtjes së Rambujesë KOMBI SHQIPTAR reduktohet në bashkësi nacionale, dhe me këtë parim flagrant popullit shumicë, shqiptarëve të kolonizuar, u bëhet i pamundshëm realizimi i të drejtës së VETËVENDOSJES, një e drejtë e cila, sipas aktit final të HELSINKIT (1975) të drejtën e **vetëvendosjes** ua njeh vetëm POPUJVE dhe jo **BASHKËSIVE NACIONALE**?! Kjo do të thoshte heqje dorë nga REFERENDUMI, heqje dorë nga LIRIA, dmth. nga KRIJIMI I SHTETIT KOMBËTAR. Profesori e parandjente dështimin, sepse e dinte mirë se si janë zgjidhur DEKOLONIZIMET në botë, dhe parashikonte se alkimia politike perfide e çetnikëve të Beogradit – MË SHUMË SE AUTONOMI E MË PAK SE PAVARËSI ose – PAVARËSI PA SOVRANITET, ende është rrezik permanent sepse fuqitë evropiane dhe Amerika po vazhdojnë të bëjnë TREGTI me fatin e popullit shqiptar në viset e robëruara, ndërsa drejtuesit shqiptarë pranuan **REZOLUTËN 1244** të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (Pas marrëveshjes së KUMANOVËS më 10. 6. 1999, në të cilën nuk kishte asnjë përfaqsues shqiptar) e cila Kosovën e njeh vetëm si Krahinë Autonome të ish-Jugosllavisë (ose të Serbisë). Si pasojë e

gjithë këtyre dështimeve flagrante për shkak të mungesës së UDHËHEQJES POLIKE të luftës në Kosovë dhe mungesës së organizimit të unitetit të popullit nga ana politiko-ushtarake dhe ekonomike ku do të rekrutoheshin në luftë shumica e popullsisë së aftë për luftë, sot e kësaj dite **as Kuvendi, as "QVERIA"**, **as Presidenti nuk kanë kurrfarë pushteti real**, sepse nuk i kanë në dorë **as policinë, as ushtrinë, as punët e jashtme, as financat, as gjyqësinë** etj. , të drejta këto të rezervuara për kryeadminstratorin e OKB-së në Kosovë. Profesori na thoshte se për çlirimin e Francës më 1945 dhanë jetën **122.000 ushtarë amerikanë**, anglezë e kanadezë, gati sa numri i vogël prej 130.000 luftëtarësh të rezistencës në krye me gjeneral Dë Golin, ndërsa për **ÇLIRIMIN e Kosovës asnjë ushtar i NATO-s nuk e ka derdhur asnjë pikë gjaku** (UÇK-ja kishte arritur numrin prej 32.000 luftëtarëve – elita idealiste e kombit shqiptar të cilët po e bënin sakrificën sublime për çlirim dhe bashkim të Kosovës me shtetin amë – Shqipërinë). Në bazë të këtij krahasimi Franca është një komb gati 30 herë më i madh se popullsia shqiptare në Kosovë, dhe në bazë të këtij krahasimi do të duhej që për çlirimin e Kosovës NATO-s t'i vriteshin në luftë kudër Jugosllavisë 30.000 ushtarë aleatë. Pra NATO bëri vetëm LUFTË TEKNOLOGJIKE, pa derdhur asnjë pikë gjaku për të shpëtuar Aleancën e saj, të cilës më 12 prill 1999 i skadonte kontrata prej 50 vitesh (1949-1999).

ꕥ

"Përfaqësuesit" e UÇK-së në Rambuje ngiten flamurin e kapitullimit dhe i harruan fjalët e heroinës Shotë Galica, e cila në verën e vitit 1921 organizoi vrasjen e naçallnikut të Mitrovicës, dhe më vonë në negociatat e zhvilluara me perfektin e Mitrovicës, Mihajllo Ceroviq, si kryetare e grupit negociator (Azem Bejta, Fazli Berani, Bajram Tërnafci, Shaban Mangjolli), hodhi poshtë

propozimin e naçallnikut për ÇARMATOSJEN e çetave dhe 'PAQEN" me shtetin serb, duke përfunduar me fjalët:

"PO HOQËM PUSHKËT PREJ DORE, SERBI KA ME NA VU SHQELMIN NË BARK E KONOPIN NË FYT!"

Por këta të vetëquajtur përfaqësues të UÇK-së nuk e dëgjuan as kundërshtimin e Përfaqësuesit politik të UÇK-së, **Adem Demaçi** (13 gusht 1998 - 2 mars 1999), për të mos shkuar në RAMBUJE për të nënshkruar KAPITULLimin e plotë dhe pa asnjë kusht të KOSOVËS, sepse me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje po pranohej **sovraniteti dhe integriteti i Jugosllavisë mbi Kosovën** (Shih pikën katër të MARRËVESHJES SË Rambujesë) dhe më vonë REZOLUTËN 1244 e Këshillit të Sigurimit dhe KORNIZA KUSHTETUSE në të cilën shkruan se:**Punët e jashtme, Mbrojtjen, Jurispudencën dhe Ekonominë e financat i ka në duart e veta i dërguari special** i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe nga kjo kuptohet se shqiptarët e kanë vetëm FRYMËMARRJEN E LIRË! Dhe në çastin kur zjarri i luftëtarëve trima të UÇK-së kishte arritur deri në Bardh të Madh, dhjetë kilometra afër Prishtinës, po ngarendnin zjarrfikësit e flakëve të Kryengritjes me projektin për formimin e një qeverie të kryesuar nga Mehmet Hajrizi në të cilën do përfshiheshin një shumicë civilësh nga "krahu i PAQES" që do të qëndronin në Prishtinë, nën kontrollin e forcave serbe, dhe dy a tre përfaqësues nga " Krahu i luftës" nën kontrollin e UÇK-së, dhe kjo qeveri do të merrte përsipër ndalimin e menjëhershëm të veprimeve luftarake të UÇK-së, pastaj t'i lironte rrugët e bllokuara nga UÇK-ja(Gryka e Llapushnikut etj.), të hiqte rrethimin e KIJEVËS nga UÇK-ja dhe të tërhiqej UÇK-ja nga Bardhi i Madh me rrethinën e gjerë, dhe pastaj me ndërmjetësimin e Riçard Holbrukut të hyhej në bisedime me Millosheviqin, kasapin e Ballkanit, të cilin Holbruku e konsideronte "PAQEBËRËS".

Ndërhyrja e jashtme e NATO-s luftës sonë çlirimtare së pari ia hoqi KARAKTERIN KOMBËTAR , pastaj frymën e MAJTË, duke e degraduar atë në "MISH PËR

TOP" të intervenimit HUMANITAR ndërkombëtar, dhe kështu ua bëri të mundur faktorëve të jashtëm vendimmarrës që ta shndërrojnë Kosovën në PROJEKT EKSPERIMENTAL (**PROTEKTORAT** ndërkombëtar) ku nuk ka demokraci, të drejta elementare, mirëqenie, por vetëm **neokolonializëm, shtypje, varfëri, papunësi, mafiozitet, korrupsion, injorancë...**

Këto parashikime vizionare të profesorit gjenial u vërtetuan katërcipërisht, sepse **intervenimi i NATO-s në Kosovë, në çastet kur Serbia tanimë ishte para kapitullimit dhe shkatërrimit total, Serbisë ia bëri një shërbim kolosal, ia hoqi GANGRENËN KANCEROZE nga trupi- KOSOVËN E KOLONIZUAR e cila ishte bërë gur mulliri** në qafën e Serbisë, dhe intervenimi erdhi për ta **SHPËTUAR SERBINË**, edhe pse Kosova ishte bërë arenë e përgjakshme e bombardimeve të NATOS- edhe mbi kontigjentet e kolonave të të dëbuarve me dhunë që ia kishin mësy shtetit amë-Shqipërisë(të kujtojmë bombardimet më 14 prill 1999 te Ura e Terzive afër Bishtazhinit, pastaj në pozicionet e UÇK-ë në Koshare, pesë herë me radhë (në maj të vitit 1999), pastaj në **Nagafc të Rahavecit**, më 2 prill 1999, **në fshatin Korishë** të Prizrenit, më 13 maj 1999, **te Ura e Luzhanit** të Besianës, maj 1999, e shumë vende tjera me ç'rast humbën jetën me qindra gra, fëmijë, pleq e plaka. Dhe pak më vonë, Jugosllavisë-**Serbisë iu dhanë 10 miliard dollarë ndihma(shpëtimtare), dhe më 11 nëntor 2000 ajo u pranua në OKB**, edhe pse ajo kishte bërë krime të llahtarshme mbi popullsinë shqiptare të Kosovës, Bosnjë Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë, dhe në vend që të mbështetej për muri dhe të dënohej nga Gjyqi Ndërkombëtar i Hagës për krimet e bëra(ashtu siç u veprua ndaj Gjermanisë hitleriane në Gjyqin e **Nyrnbergut** më 1945) Serbia raciste e ultrafashiste u shpërblye nga ish sponzorët e krijimit të shtetit të saj kolonialist që nga Kongresi i Berlinit(1878), Konferenca e Londrës(1913), Konferenca e Parisit(1919), Patsdami dhe Jallta(1945),

Parisi(1945), Malta(1989), Londra II(1992), Dejtoni (1995), RAMBUJE(mars 1999). Nga gjithë ajo propagandë e Serbisë se gjoja ka pësuar aq shumë ekonomia e Serbisë nga bombardimet e NATO-s më së miri ilustrohet me këto fakte: **Serbia asnjë ditë nuk ngeli në terr nga "shkatërrimi" i hidrocentraleve, dhe pas "shkatërrimit" të industrisë luftarake të armatimit** (Kragujevc etj.), Serbia u bë **eksportuesi** më i madh i armatimit në rajon, ndërsa ekonomia e Kosovës jo vetëm që u shkatërrua tërësisht gjatë luftës, por edhe më keq e pësoi pas luftës, kur çdo gjë me vlerë u vu në ankand nga strukturat gllabëruese ndërkombëtare dhe kolaboracioniste vendore nën sundimin **kolonialist të UNMIK-ut**, ndërsa edhe pas 10 vitesh asnjë ditë nuk kalo e që Kosova të mos mbetet për orë të tëra në TERR. Ja edhe disa shembuj ilustrativë:

-Pas instalimit të administrimit ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe KFOR-t në në bazë të REZOLUTËS 1244 të OKB-së(sipas së cilës Jugosllavisë-SERBISË i njihet statusi i integritetit territorial mbi KOSOVË??!!) pesë zona administrative, kontingjenti i ushtarëve francez u pozicionua në vijën e demarkacionit te Lumi Ibër në Mitrovicë, dhe sipas shembullit të Mostarit, Mitrovica u rikolonizua dhe mbi 20.000 civilë shqiptarë u detyruan të ikin nga breshëria e kalashnikovëve dhe bombave të bandave kolonizatore serboçetnike dhe aleatëve të tyre-kontingjenti francezo-polak në Veri të Mitrovicës, dhe kështu ajo që nuk kishte arritur për t'u bërë gjatë ditëve të përgjakshme të luftës tani po bëhej nën patronazhin e aleatëve ndërkombëtar të Serbisë në periudhën e "PAQES" duke e mundësuar administrimin e strukturave paralele të kolonizatorëve serbë mbi 33% të territorit të Kosovës në 11 komuna të reja serbe dhe 47 zonave eksterritoriale përreth kishave orthodokse serbe(psh. vetëm territori i Kishës së Deçanit përfshinë 800 hektarë tokë);

- **Më 4 shtator 2003** u vranë mizorisht katër djem nënash shqiptare që po mbaheshin në burgun e Dubravës,

dhe u dogjën për së gjalli, nga bandat ultrafashiste të policisë së UNMIK-ut, dhe për këtë vepër mizore raciste askush nuk dha asnjë llogari;

- Kosova u la në gjak nga strukturat paralele serboçetnike dhe të policisë së UNMIK-ut **më 17 mars 2004**, me ç'rast u masakruan mizorisht dhjetra shqiptarë dhe u plagosën qindra të tjerë, dhe përveç kësaj u burgosën qindra demonstrues paqësorë duke u akuzuar si terrorist dhe vandalë. Parlamenti kukull i Kosovës i dënoi këto protesta paqësore, dhe nuk u kujtua kurrë të mbajë asnjë minutë heshtje në shenjë nderimi as për këta djem liridashës nënash shqiptare, por as për ata 2200 heronjtë dhe dëshmorët e UÇK-së heroike;

- **Më 10 shkurt 2007** sërish Kosova u la në gjak nga breshëria e plumbave të kontingjentit rumun dhe polak, dhe në fushën e nderit në sheshin qendror të Prishtinë u vranë dy demonstrues të LËVIZJES VETVENDOSJE (Arben Xheladini dhe Mon Balaj) dhe u plagosën rreth 1000 të tjerë, për të vetmën arsye se kërkonin të DREJTA DHE VETVENDOSJE!;

- **Më 17 shkurt 2008** Kosova e shpalli PAVARËSINË, duke gëlltitur KARREMIN e PAKOS SË AHTISARIT, në të cilën në asnjë vend nuk përmendet fjala SHQIPTAR, por **KOSOVAR**, dhe në baz të këtij projekti fantom favorizohen 3% minoritarë serbë, boshnjakë, romë, turq, ashkalinj etj., dhe diskriminohen pozitivisht 97% shqiptarë me arsyetimin e krijimit të një shoqërie MULTIETNIKE në Kosovë. Në bazë të kësaj PAKOJE shqiptarëve u mohohet HYMNI dhe FLAMURI KOMBËTAR, HISTORIA DHE KULTURA kombëtare, dhe në bazë të PLANIT të Ahtisarit u merret legjitimiteti njerëzve të zgjedhur nga vota e popullit, dhe definitivisht po realizohet NDARJA "de fakto" e Kosovës, me pamundësinë e vendosjes së shtetit ligjor në Veri të Kosëvës dhe në enlavat tjera të banuara me kolonistët serbë. Është paradoksale se si u mashtruan dhe votuan NJËZËSHËM tërë PARLAMENTI I KOSOVËS për

PAKON E Ahtisarit, e cila tani është origjina e gjithë problemeve, sepse drejtuesit kolaboracionistë të Kosovës e kanë bërë Planin e Ahtisarit pjesë të KUSHTETUTËS, me çka ata obligohen para bashkësisë ndërkombëtare për zbatimin e këtij PLANI.. Dhe këtu është kontradikta- as UNMIK-u, as EULEX-i nuk e njohin Kosovën si shtet të PAVARUR, dhe bëjnë pazare dhe pakte-PROTOKOLLE me Serbinë, dhe nga kjo rezulton se Kosova mund të bëhet plotësisht e PAVARUR vetëm nëse përmbushen të gjitha kushtet e PLANIT të Ahtisarit, **e dihet se këto kushte ashtu si STANDARDET e UNMIK-ut dikur, janë formuluar në atë mënyrë që të mos mund të përmbushën KURRË!** Dhe kjo do të thotë që gjithmonë duhet të ketë nevojë për PËRFAQËSUES CIVIL NDËRKOMBËTAR NË KOSOVË! Ndërsa pa bashkëpunimin e serbëve në Kosovë dhe pa bashkëpunimin e Serbisë për plotësimin e kushteve të përcaktuara nga PLANI i Ahtisarit, mes të cilave edhe DECENTRALIZIMI, përfaqësuesi civil-ushtarak ndërkomëtar në Kosovë do të jetë mbikëqyrës i PËRHERSHËM(Shih: Intërvistën e analistës dhe ekspertës për çështjet e Ballkanit, Ana Di Lellion, dhënë REL-it më 10.9.2009);

- Gjithë " klasa politike" në Kosovë, pozitë-opozitë - shoqëri civile, përveç VETËVENDOSJES, e përshëndetën dhe e duartrokitën njëzërit ardhjen e EULEX-it. Tani kjo "klasë kolaboracioniste" është nën presionin e KUDHRËS popull dhe ÇEKANIT EULEX. Hendeku i kontradiktave të papajtueshme gjithnjë e më shumë po thellohet, dhe kjo status-quo s'mund të zgjasë për shumë kohë,

dhe një ditë populli do zgjohet, do kthjellohet dhe do të dalë nga "HIPNOZA KOLEKTIVE POLITIKE" dhe nuk do të lejojë më që dikush të luaj pamëshirshëm me fatin e tyre, dhe kjo ditë do jetë dita e madhe e dekolonizimit ndërkombëtar, dita e përfundimit të PROTEKTORATIT të OKB-së mbi Kosovën, kur KS i OKB-së të ratifikojë PAVARËSINË e Kosovës ,

DEKOLONIZIMIN e saj përfundimtar nga Serbia (e cila edhe sot pas gjithë këtyre sakrificave sublime të 2200 dëshmorëve të UÇK-së dhe 21.000 martirëve ende i administron 33% të territorit të Kosovës?!) duke ia pranuar të drejtën e VETVENDOSJES dhe bashkimit me shtetin amë, ashtu siç u bashkuan Vietnami, Gjermania etj.

Profesori me indinjatë të thellë na fliste për gjenocidin serbosllav mbi shqiptarët që nga MOLLA E KUQE e deri në ÇAMËRI, na fliste për harresën kronike të pafalshme si komb për të rënët në MASAKRËN E TIVARIT-VARRI MË I MADH KOLEKTIV I SHQIPTARËVE në Ballkan gjatë Lufës së Dytë Botërore, më 31 mars 1945, kur u masakruan brenda disa orëve **4310 rekrutë shqiptarë nga dora gjakatare serbo-malazezo-maqedonase**, dhe kurrë nuk u bë anjë aktakuzë kundër shtetit kriminel, dhe nuk u kërkuan eshtrat e këtyre martirëve e heronjve të pavdekshëm, dhe as që u ngrit ndonjë memorial i HOLLOKAUSTIT në Prishtinë apo gjetkë. Na fliste profesori edhe për 1300 rekrutët shqiptarë të mbytur mizorisht më 18 prill 1945 në Babin Kuk të Dubrovnikut me monoksid karboni, si dhe për 180 rekrutët tjerë të fundosur në kanalin Qiovo afër Trogirit dhe 2100 rekrutë tjerë të likuiduar në mënyrën më barbare gjatë rrugës për në Frontin e Adriatikut, që nga Shkupi, Prizreni e deri në Istri të Kroacisë. Ku është gjaku i tyre, ku janë eshtrat e tyre, pse po e mbyllin gojën, sytë dhe veshët këta të vetëquajtur politikanë e kolaboracionistë, të cilët ishin bashkëpjesëmarrës që e ndihmuan këtë kasaphanë mizore në TIVAR - AUSHVICIN E SHQIPTARËVE, shfrynte i indinjuar për këtë HARRESË KRONIKE , për këtë krim të turpshëm mbarëkombëtar, sepse duke i harruar dhe injoruar ne po i vrasim dëshmorët për të dytën herë, shtonte i indinjuar profesori promethe me fjalët:

Ju kush u harron,
Për mot e për jetë,
E mallkoftë toka mëmë,
E shofshin rrufetë!....

Gjithë jeta e Qazim Berishës qe një luftë ndaj regjimit fashist jugosllav. Gjithë jeta e tij qe një sakrificë e një martiri në shërbim të shkencës dhe atdheut. Parimi i tij jetësor ishte: T'i kurseni të tjerët në çdo pikëpamje, dhe atë që s'mund ta besh vetë, mos e detyro tjetrin ta bëjë; vetëm distanca kohore mund të na japë përgjigjen e saktë për vërtetësinë e mendimeve tona për njerëzit, ngjarjet dhe dukuritë e kohës në të cilën jetojmë; urrejtja e madhe e pabarazisë, e filistinit, e pasurisë, e fitimit, e egërsisë njerëzore, e së djeshmes së afërt, e së djeshmes së largët; para se të jem shqiptar, jam njeri (sipas analogjisë së filozofit francez Monteskije); **më mirë Sokrat i vuajtur, se sa derr i kënaqur**; i pari në sakrificë, dhe i fundit në pretendime; mos u bëj urë dhe vig, të të shkel i fort' e i lig; kurrë të mos jemi të pamoralshëm (e preferonte moralin kryengritës), të papërgjegjshëm, të pakorrigjueshëm dhe të paaftë; kurrë mos përdorni vese të tilla si mashtrimin, hipokrizinë, servilizmin, gënjeshtrën për të arritur deri te pushteti; jeta e njerëzimit ka vetëm një KRITER – ajo njeh vetëm përkushtimin, vetëmohimin, dhe angazhimin e individit për plotësimin e kërkesave të jetës së vendit e të popullit; që njerëzit të jenë të lirë; që njerëzit të jenë të barabartë; që njerëzit të jenë vëllezër; te njeriu të behet vazhdimisht një luftë e brendshme për përsosjen shpirtërore; të jemi në radhë të parë autokritikë ndaj vetvetes; **duhet të arrihet pohimi i mohimit të mohimit** (kur është fjala për ta çuar në vend amanetin e të rënëve që u sakrifikuan për lirinë që gëzojmë ne, sepse dëshmorët e mohuan vetveten duke mohuar armikun, dhe nëse ne nuk e çojmë amanetin e tyre në vend, atëherë nuk është realizuar amaneti i tyre, aspirata e shenjtë e tyre);

Mjerimi është një njollë e pashlyeshme,
në ballë të njerëzimit që kalon nëpër shekuj,
mjerimi nuk donë mëshirë, por donë vetëm të drejtë

(Migjeni); secili duhet t'ia ngrisë vetes një përmendore me punën e tij në shërbim të atdheut dhe njerëzimit; (**kam**

qarë kur kam lexuar Migjenin. Nuk më vjen turp të them se qava, por më vjen turp të them që vetëm tani, në moshën dyzetvjeçare, munda ta njoh këtë poet të mrekullueshëm, – pati thënë poeti rumun – Nikolaj Morare, dhe ne pyesim: sa shqiptarë kanë qarë që kurrë nuk e kanë lexuar asnjë poezi të Migjenit të madh?); **armiqtë i kam merituar, po nuk di a i meritoj miqtë**? (U. Uitman) etj.

Ne që patëm fatin dhe privilegjin ta takonim dhe të ishim nxënësit e tij nuk mund ta harrojmë kurrë fytyrën e tij të qeshur, sytë e tij të zjarrtë, ngulmues e shprehës të një pasurie shumë të madhe ndjenjash e emocionesh, ballin e lartë e fisnik, ngrohtësinë e kujdesin e tij, taktin pedagogjik të bashkëbisedimit, këshillat dhe porositë e vlefshme, **por dhe paraqitjen e jashtme të tij kurdoherë dinjitoze, të rregullt e plot shije.** Mendja e tij në ato çaste bashkëbisedimi punonte me tërë intensitetin e mundshëm, që të përfitonte e të mësonte sa më shumë prej këtyre kontakteve dhe veçanërisht që të na jepte një ndihmë sa me më shumë vlerë. Ai, me cilësinë e një psikologu të mbaruar, dinte të depërtonte në shpirtrat e njerëzve, t'i çlironte ata nga çdo lloj druajtje, të krijonte ato kushte që janë të domosdoshme për të nxitur mendimin e bashkëbiseduesit. Një tjetër karakteristikë e tij ishte UNITETI I THELLËSISË SË MENDIMIT me thjeshtësinë e shprehjes. Ai kurrë nuk manifestonte kulturë dhe erudicion si qëllim në vetvete, përkundrazi, kulturën e tij të gjithanshme e vuri në shërbim të popullit, të zgjidhjes së problemeve dhe halleve të tij. Ai kurdoherë ishte në dijeni të arritjeve të kohës në shkencat e ndryshme. Ai i **gëzohej çdo libri të mirë të ri, dhe mund të themi se ishte MIK I DENJË I LIBRIT**. Me një pasion të fuqishëm lexonte literaturë të shumëllojshme, dhe në gjuhë të ndryshme.

Sa herë e kemi vizituar kurrë nuk ka ndodhur ta gjejmë pa një libër apo revistë në dorë. Këtë ARMË të re ai dinte ta zotëronte si askush tjetër, dhe padyshim se vetëm brenda llogoresë së LIBRAVE e ndiente veten të

fortë, të sigurt dhe të lumtur. Atdheu i tij ishte aty ku sundon LIBRI dhe fjala, gojtaria dhe DITURIA(eloquentia et eruditio).Për të një qytet pa biblioteka të pasura me libra është qytet i **VDEKUR**, ndërsa një shtëpi pa libra e konsideronte-**shtëpi pa dritare!** Biblioteka e profesorit kishte mijëra libra, por jo gjithëfarë librash, por ato që ishin arritjet më kulmore të nendjes së njerëzimit, që nga klasikët latinë e grekë e deri te klasikët e materializmit dialektik. **Me një fjalë ishte në bibliofil i pangopshëm**. Me atë rrogë të vogël është e çuditshme si ka arritur të blinte aq shumë libra, sepse ishte i vetëdishëm se LIRINË nuk mund ta arrijmë pa armën e diturisë. Por na **sugjeronte që 50% të kohës ta harxhojmë duke studiuar libra, e 50% duke u futur në mesin e popullit punëtorë për ta parë më mirë realitetin objektiv. Ai nuk mbyllej në kullën e fildisht dhe të verbohej nga librat**, por hidhte shikimin rreth e rrotull për të parë e për të kuptuar sa më qartë dhe sa më drejt jetën e njerëzve. Kishte neveri nga çdo gjë e errët,, e ngatërruar, mistike dhe metafizike. **Qartësia ishte pjesë organike e shikimit të tij të kthjellët dhe të mprehtë.** Na mësonte se njohja e njerëzve ka në themelin e saj **PRAKTIKËN**, e cila realizohet nëpërmjet dy shkallësh-shkallës SHQISORE, dhe shkallës **LOGJIKE**, nga të cilat burojnë dy lloj dijesh-**DIJET EMPIRIKE** dhe **DIJET RACIONALE**. Të dyja këto shkallë të dijes ekzistojnë dhe realizohen në një lidhje dhe bashkëveprim të ngushtë, dhe përbëjnë një proces të vetëm dialektik, të cilin **Lenini** e formuloi me këto fjalë:

"Nga soditja e gjallë në të menduarit abstrakt, dhe nga ky në PRAKTIKËN, kjo është rruga dialektike e njohjes të së VËRTETËS, e NJOHJE SË REALKITETIT OBJEKTIV" (V.I.LENIN, VEP, Vëll.38,f.176), dhe pastaj na merrte si shembull zgjerimin dhe përsosjen e njohjes shqisore dhe të aftësive përcepruese te teksitilistët që merren me ngjyrosjen e stofave të cilët janë në gjendje të dallojnë **gjer 40 nuanca të ngjyrës së zezë**, kurse një njeri i zakonshëm nuk dallon **veçse 3-4**. Dhe kjo vjen nga fakti

se NGJYRA nuk është krijim i SYRIT të bjeriut, por VETI objektive e trupit, aftësia e tij për të thithur një pjesë të spektrit dhe për të paqyruar pjesën tjetër. Trendafili nuk është i kuq sepse ne e krijojmë me organet e shqisave, por sepse ai me të vërtetë i kuq, d.m.th. ka aftësinë të thithë TË GJITHA BGJYRAT e spektrit dhe të pasqyrojë vetëm ngjyrën e KUQE. Ndërsa faktori që i lejon njeriut të ZBULOJË shkakun e thellë të sendeve, thelbin dhe ligjet e zhvillimit të tyre është MENDIMI ABSTRAKT, apo NJOHJA LOGJIKE. Ligji i GRAVITACIONIT, thoshte Isak Njutoni, nuk është shkruar në qiell në mënyrë që mjafton ta lecosh për ta zbuluar. **Në analizën e marrëdhënieve ekonomike**, thoshte Karl Marksi, **nuk mund të përdoren as mikroskopi, as reaksionet kimike, por vetëm forca e ABSTRAKSIONIT, forca e arsyes dhe mendimit tonë.** Dhe shoqëria, ashtu si natyra , ndjek "rrugën" e saj, të pavarur nga vullneti i njeriut. LIGJET e saj në shoqëritë e pronës private veprojnë në mënyrë të verbër e spontane. **Veprimi i VERBËR i LIGJEVE të shoqërisë kapitaliste u sjellë punonjësve SHTYPJE, VARFËRI, MJERIM. Veprimi i tyre çon në luftëra të përgjakshme.** Vetëm me triumfin e revolucionit socialist njerëzit nga SKLLËVËR të ligjeve të VERBËRA, spontane të shoqërisë, bëhen bëhen zotër të tyre dhe zëtër të vetvetes., d.m.th. bëhen të LIRË, që do të thotë, sipas F.Engelsit, nga mbretëria e domosdoshmërisë në **MBRETËRINË E LIRISË(**Anti-Dyring"f. 324). Mundësia , p.sh., që FARA të bëhet BIMË është në vetë farën., por për këtë duhen edhe disa kusht: që ajo të mbillet në kohën e duhur, në tokë të përshtatshme etj. Kështu është edhe me FITOREN e revolucionit-duhet të ekzistojë një situatë revolucionare, **dhe që në krye të këtij revolucioni të jetë një parti e vërtetë marksiste-leniniste**, por përkundër kësaj, por **edhe pas fitores së revolucionit, mbetet një RREZIK REAL restaurimi i kapitalizmit,** thoshte E.Hoxha, nëse nuk jemi gjithnjë vigjilentë dhe rigorozë në zbatimin e ligjeve, nëse nuk jemi kurdoherë në këmbë dhe

revolucionar, të bëjnë një luftë të vendosur e të papajtueshme klasore. Pas këtyre ligjërimeve të gjata profesori evokonte kujtimet e tij me shokët e veprimtarisë ilegale kur pas kryerjes së çdo detyre me sukse këndonin internacionalen:

Ngrehini ju o të munduar,
Ju të u'rët skllevër ane mbanë
Na buçet gjaku i turbulluar
S'duam patronë dhe tiranë...

Është lufta finale,
Vendimtare mbi dhe,
Internacionale
Do jetë bot'e re.

Dhe sërish kthehej, ku e kishim lënë ligjratën një ditë më parë, te lufta dhe paqa, duke na kujtuar fjalën e vjetër latine:

"SI VIS PACEM, PARA BELLUM"
"Në qoftë se do paqen, përgatitu për luftën!

Ose: **Si vis vitam, para mortem!**
Në qoftë se do të përballosh jetën,
Organizohu për VDEKJE!

Pastaj, vazhdonte profesori- Sa kohë ekziston imperializmi parulla e çarmatimit të plotë dhe të pëgjithshëm është një MASHTRIM I MADH, dhe përderisa në botë ka të shtypur e të shfrytëzuar ne duhet të kërkojmë jo ÇARMATIMIN, por ARMATIMIN e pëgjithshëm të popoullit.Prandaj luftëtarë të vërtetë për paqen nuk janë ata që ngrihen kundër luftërave të DREJTA revolucionare e çlirimtare, por ata që qëndrojnë në radhet e para të këtyre luftërave.

"Një klasë e shtypur, -thoshte Lenini, - e cila nuk përpiqet të mësojë përdorimin e armëve, të ketë armë, kjo klasë e shtypur nuk meriton gjë tjertër, veçse të trajtohet si skllave, sepse

LUFTA ËSHTË VAZHDIM I POLITIKËS me mjete DHUNEË...”

Pastaj profesori merrte shembullin konkret të mbrojtjes popullore në Shqipëri ku çdo qytetar është ushtar dhe çdo ushtar është qytetar me parullën domethënëse - **NË NJËREN DORË KAZMËN e në tjetrën PUSHKËN...**

Më kujtohet njëherë kur po flisnim për çështje filozofike, për Dialogje filozofike të Dëni Didroit, i cili kishte thënë :

”...T’ua thuash të vërtetën disa njerëzve, donë të thotë të futësh një rreze DRITE në një strofull HUTASH; ajo vetëm u LËNDON SYTË dhe nxitë KLITHMAT e tyre... Sikur njerëzit të ishin injorantë vetëm pse nuk kanë mësuar asgjë, ndoshta do të mund të arsimoheshin, por verbërimi i tyre është SISTEMATIK... Këtu nuk kemi të bëjmë me njerëz që nuk dinë asgjë, por me njerëz që **nuk dëshirojnë të dinë asgjë. Mund të arsimohet vetëm njeriu i cili është mashtruar në mënyrë të pavullnetshme. Dhe vazhdonte: INTERESI ka lindur priftërinjtë, priftërinjtë kanë prodhua PARAGJYKIMNE, paragjykimet kanë shkaktuar luftëra, dhe luftërat do të zgjasin derisa të ketë PARAGJYKIME,** paragjykimet do të zgjasin derisa të ketë **PRIFTËR**, dhe priftërit derisa të kenë interes të jenë priftër.(f.30).

ꕥ

Profesori poliglot gjatë ligjëratave në gjuhën e lashtë latine sqaronte shprehjet dhe fjalët e urta dhe argumentonte domethënien e tyre të gjerë, si për shembull:

- Amicus Plato sed magis amica est veritas-lat.,
- (**Platoni është mik, por e VËRTETA është mikeshë edhe më e madhe, d.m.th., e vërteta është më e shtrenjtë se çdo gjë.** Perifrazim i një shprehjeje që i vishet Aristotelit);
- Cogito ergo sum-lat., MENDOJ, PRANDAJ JAM. Parim themelor i filozofisë së Dekartit;

- Conditio sine qua non-lat., KUSHT I DOMOSDOSHËM, kusht pa të cilin diçka është e pamundur;
- Cum principia negante non est disputandum-lat.,Me atë që mohon parimet nuk duhet DISKUTUAR, d.m.th., pa qenë të një mendimi përsa u përketë premisave, nuk mund të ketë një DISKUTIM LOGJIK;
- EX NIHIL NIHIL FIT-lat, Nga asgjëja s'del asgjë(Melis, shek.5 p.e.s.), shprehje në kundërshtim me doktrinën idealiste, që thotë se bota është krijuar nga zoti;
- **NOSCE TE IPSUM-lat.,NJIH VETEN**;këto fjalë janë të gdhendura në hyrjen e e tempullit të Apollonit të Delfit. Kjo shprehje i atribuohet filozofit Tales;
- **OBSCURUM PEROBSCURIUS**-lat., të shpjegosh diçka të errët me diçka edhe më të errët:
- **SACRIFICUM INELLECTUM**-lat., flijim i arsyes, të hequrit dorë nga mendimi.; të bësh fli bindjet e tua në emër të autoritetit të kishës;
- **Tabula rasa**-lat., dërrasë e pastër, e pashkruar (kështu e quanin stoikët shpirtin e fëmijë së posalindur);
- **HISTORIA EST MAGISTRA VITE-lat., Historia është mësuesja e jetës;**
- Concordia patria firmat-lat., **BASHKIMI FORCON ATDHEUN;**
- Accipe librum et devora illum-lat., **Merr librin dhe përpije**!(Lexoje shpejt dhe me vëmendje!);
- Acti laboresiucundi(sunt).-lat., **Punët e kryera janë të këndshme;**
- Ad paenitendum properat cito ludicat-lat., **Kush gjykon shpejt, pendohet shpejt;**
- Aere perennius(monumentum)lat., **Përmendorja është e përjetshme!**
- **SI VIS PACEM, PARA BELLUM!-lat., Në qoftë se do paqen, përgatitu për luftën;**

- Si vis vitam, para mortem- Në qoftë se e doni jetën, përgatitu për vdekjen;(**Seneka: U mësua të jetojë ai që u mësua të vdes!);**
- Alteri vivas oportet,si vis tibi vivere- **duhet të jetosh për tjetrin nëse do të jetosh për vete;**
- Ames parentem, si aequus est, alite feras- lat., **Prindin duaje nëse është i drejtë, përndryshe duroje;**
- Amici vitia si feras facias tua-laat.,**nëse i duroni gabimet e mikut tuaj, jeni duke gabuar edhe vetë;**
- Amicos res secundae parant, adversae probant-lat.,**Mikun ta krijon fati dhe ta sprovon fatkeqësia**; Amicum an nomenhabeas, aperit calamitas –lat., **Fatkeqësia e zbulon se a keni miq vetëm me emër:**
- Ante victoriamne canas triumphum-lat., **Para fitores mos këndo për fitoren;**
- ARS LONGA VITA BREVIS-**Arti(dituria) është jetëgjatë, kurse jeta e shkurtër;**
- Artem non odit nisi ignarus-lat., **Vetëm i padituri e urren artin**(Mbishkrim në Muzeun e Berlinit);
- Aut hunc aut super hoc-lat., Ose me të(Mburojë) ose mbi të(Kështu i kanë uruar nënat spartane fëmijët e tyre para se të niseshin në frontin e luftë,
- Bene vixit is, cum voluit, mori-Ka jtua mirë ai i cili ka mundur të vdesë kur ka dasht;
- Beneficium dignis ubi des, omnes obliges.-Nëse je bëmirës ndaj atyre që janë të denjë, atherë i ke obliguar të gjithë;
- BIS DAT QUI CITO DAT: nil dat qui munere tardat-lat., Dy herë ka dhënë ai që jep shpejt(me kohë); asgjë nuk ka dhënë ai q[renkon për dhuratën;
- Bis peccat qiu crimen negat-lat., DY HERË GABON AI I CILI E MOHON FAJIN;
- Bis vincit qiu se vincit in victoria-Dy herë fiton ai i cili e fiton vetveten në fitore(me sjellje burrërore e jo barbare);

- Bonis nocet qui malis parcet-Kush i falë keqbërësit i ka dëmtuar të mirët;
- Bonis probatur quisqiuis displiquit malis-Kush nuk iu pëlqen të këqinjve iu pëlqen të mirëve;
- Bonis pastoris est tondere pecus, non deglubere-Delet e bariut të mirë janë të qethura, e jo të rjepura;
- Brevissima ad divitias per contemptum divitiarum via est- Rruga më e shkurtër deri te pasuria kalon përmes urrejtjes së pasurisë;
- Caecorum in patria luscus est rex-Në vendin ku jetojnë qorrat, mbret është ai që ka një sy;
- Carere patria intolerabile est-Është e padurueshme të jetosh pa atdhe;
- Fas est et ab hoste doceri-Duhet të mësojmë edhe nga armiku;
- FELIX, qui potuid rerum cognoscere causas-**I lumtur është ai i cili arriti t'i kuptojë shkaqet e gjerave; ...**

ꕥ

- Erase humanum est et confiteri errarem prudentis-TË GABOSH ËSHTË NJERËZORE, DHE TË PRANOSH GABIMIN ËSHTË MENÇURI;
- CAVE AB HOMINE UNIUS LIBRI-Ruaju nga njeriu i cili ka lexuar VETËM NJË LIBËR(aludohet në BIBLËN);
- Save amicum quem quam credas nisi probaveris-Ruajuni dhe mos i besoni asnjë miku pa e provua;
- Homo, qui tacere nescit, nescit dicere-Njeriu i cili nuk din të hesht nuk din as të flasë;
- Historia est testis temporum, lux veritatis, vita memoriae, magistra vitae, muntia vetustatis-**Historia është dëshmitare e kohës, dritë e të vërtetës, jetë e kujtimeve, mësuese e jetës, lajmëtare e të kaluarës;**
- **FESTINA LENTE-NGUTU, POR NGADALË!**
- **Fide, sed cui, vide!-Beso, por të keni kujdes se kujt!**

- Fortiaque adversis oponite pectora rebus-Me zemra trimëresha sfidojeni fatkeqësinë;
- Fertior est qui cupiditatem vincit quam qui hostem domat-Më i fortë është ai i cili e mund pasionin(afshin) e vetvetes se ai i cili e mund armikun;
- Fur furem cognoscit-Hajni e njeh hajnin;
- GLORIA fugientes magis sequitur, insequentem fugit-**LAVDIA MË SHUMË SHKON PAS ATYRE TË CILËT IKIN PREJ SAJ, NDËRSA IKËN NGA ATA TË CILËT VRAPOJNË PAS SAJ!**
- Gratus animus est una virtus non solum maxima, sed etiam mater virtutum omnium reliquarum-**MIRËNJOHJA është një virtyt, jo vetëm më i madhi, por edhe mëma e të gjitha VIRTYTEVE;**
- Gravissima est probi hominis iracundia-Mllefi i njeriut të ndershëm është shumë i rrezikshëm;
- Homo quantum scit, tantum potest-Njeriu aq sa din aq edhe mundet;
- HONESTA mors turpi vita potior-**MË MIRË TË VDESËSH ME NDER SESA TË JETOSH ME TURP;**
- Piger ipsi sibi obstat-**Njeriun përtac e pengon edhe vetvetja;**
- Panem et circensses-**(Turma kërkon vetëm)-BUKË DHE CIRKUS(lojna, argëtim);**
- Quisnam igitur liber?**Sapien, sibi imperiosus-Kush është i lirë? I mençuri i cili e zotëron vetveten:**
- **QUOD HOMINES TOT SENTENTIA-SA NJERËZ AQ MENDIME:;**
- **Vulgus veritatis pessimus interpres-TURMA është përkthyesja me e keqe e të vërtetës;**
- PATRIA comunis parens est omnium nostrum-**ATDHEU ËSHTË MËMA E TË GJITHVE:**
- Omnis fortuna faber est- **Çdo njeri është farkëtar i fatit të vet;**
- DIXI ET SALVAVI animam meam-**E thash dhe shpëtova shpirtin tim.**

Profesori Qazim kishte informacione të sakta mbi misonet e specializuara të spijunazhit dhe shërbimeve agjenturore të Intelixhens servisit britanik CIA-s amerikane , KGB-së ruse dhe UDB-së jugosllave. Pastaj ai na fliste me argumente bindëse mbi shërbimin e kundërzbulimit shqiptar duke veçuar kuadro të specializuara të këtij shërbimi siç ishin **Asim Aliko "Tomori**" (nga Kurveleshi), kryetar i grupit special të Ministrisë së Brendshme që kishte si qëllim depërtimin në radhët e bandave dhe agjenturave të huaja, **i cili për pesë vjet kishte kapur 120 banditë të rekrutuar nga shërbimet e huaja**, shumë prej të cilëve i kishte kapur të gjallë. Për këto merita të larta pushteti popullor e kishte vlerësuar me titullin-**Hero i Popullit**" (jetoi deri më 1987). Një ndër agjentët më të mirë të Sigurimit shqiptar ishte edhe Pal **Mëlyshi**, i cili u vra më 1950 në përballje me bandat diversante.

Një agjent i regjur i cili punonte në shërbim të CIA-s, **Hamit Matjani "Tigri",** kishte arritur të realizonte shumë aksione për të rrëzuar pushtetin popullor në Shqipëri, por **pas 26 aksioneve desante nga ajri ai ra në kurthin e Sigurimit shqiptar dhe u dënua me vdekje më 14 prill 1954.** Një kurth tjetër i Sigurimit shqiptar ishte kapja e agjentit të rryer shqiptar, **Hysen Lepenica**, i cili punonte për shërbimin e CIA-s. Shkjak për dështimin e bandës së tyre në tetor 1948 ndihmuan edhe informacionet e agjentit sekret **Kim Flbi** (Sigurimi shqiptarë likuidoi qindra agjentë të shërbimeve të huaja), i cili informacionin për bandën ua kishte dhënë shërbimit sovjetik, dhe këta menjëherë ua kishin dhënë informacionin Sigurimit të Shtetit shqiptar. Një tjetër agjent i rrezikshëm ishte **Tejme Sejkon** ga Filati i Çamërisë i cil u kap më bandën e tij më 1960 dhe menjëherë u ekzekutua.

Më 1950 CIA dhe britanikët kishin sajuar një plan tjetër për të rrëzuar Enver Hoxhën në Shqipëri.Për këtë

kishte njoftuar këshilltari i mbasadës amerikane në Beograd eprorin e tij **Sulbergerin**, lidhur me operacionin-Valuable-Fiend. Nën drejtimin e OPC-së u hodhën me parashutë më 19 nëntor 1950 nëntë shqiptarë në krye me agjentin e rryer **Adem Gjura**. Selim Daci, një pjesëtar i grupit u kap i gjallë, ndërsa Gjura pati fat, dhe bashkë me ca shokë kaloi në Jugosllavi, në mbarim të dhjetorit. Mirëpo meqë ishte strehuar në familjen e tij e cila nuk kishte informuar Sigurimin, **policia sekrete arrestoi dhe më vonë likuidoi 40 pjesëtar të kësaj familjeje.** Në janar 1951 në Veri të Shqipërisë kishin hyrë me anije dhe parashuta 43 guerilje dhe ishin thye keq nga policia shqiptare në një luftim të ashpër që kishte zgjatur disa ditë. 29 diversantë ishin vrarë ndërsa 14 ishin kapur të gjallë.

Më 1951 në Prishtinë ishte formuar **Komiteti i Apostol Tanefit** , një komitet mërgimtarësh shqiptarë me qëllim për të rrëzuar pushtetit në Tiranë. Por edhe ky komitet dështoi, për çka Millovan Gjillas (funksionar i lart jugosllavë) e njoftoi ambasadorin e SHBA –së , Sulcbergerin, në Beograd.

Më 10 tetor 1951 në një kinema të Tiranës u mbajt seanca gjyqësore ndaj Kasem Shehut dhe Muhamet Hoxhës dhe bashkë me të tjerë agjentë të kapur gjatë operacioneve të mëparshme të sponsorizuara nga britanikët, gekët, italianët dhe jugosllavët. Me këtë gjykim spektakolarë u bë e qartë disfata e anglo-amerikanëve dhe trumfi i forcave të Sigurimit shqiptarë. Vigjilenca dhe patriotizmi i lart i forcave të Sigurimit shqiptarë kishin bërë një lojë të shkëlqyer radiofonike për të futur në rrjetin e tyre bandat e kriminelëve që kishin ardhur si cjapi te kasapi.

Zenel Shehu, bodigard i Ahmet Zogut dhe mik e Hamit Matjanit, i cili zbarkoi në Shqipëri më 1952 në cilësin e prijësit të grupeve diversante. Nëpërmjet Zenel Shehut, Sigurimi shqiptar arriti të kap edhe ttë 13 grupe tjera përmes **radiolojës,** dhe në veçanti agjentin e rrezikshëm Hamit Matjani.Një tjetër agjent i rryer ishte **Xhevdet**

Mustafa, i cili ishte stërvitur disa vite nga shërbimi sekret amerikan për të vrarë Enver Hoxhën. Në shtator të vitit 1982 niset nga Brindizi i Italisë dhe zbarkon në plazhin e Divjakës, por nuk arrin të kryej detyrën dhe **më 27. 9. 1982, pas dy orë luftimi, Xhevdet Mustafa me grupin e tij vritet në vend.**

Isuf Mullai, pikërisht personazhi i **Manush Kelmendit** te romani i njohur **MËGATA E QYQEVE**, i shkrimtarit **Nasho Jorgaqi**, ishte një nga agjentët më të fuqishëm që ka pasur Sigurimi i shtetit shqiptar. Për dhjetë vjet me radhë ai arriti të shtijë në dorë gjithë dokumentacionin sekret të Partisë së Legalitetit në mërgim., dhe për 10 vjet **(1955-8.12. 1964).** Oficeri i Sigurimi punoi me sukses në shërbim të Qeverisë shqiptare në Bruksel dhe arriti të bëhej një nga njerëzit më të besuar të Ahmet Zogut dhe familjes së tij. Me aftësitë e tij prej zbuluesi, arriti jo vetëm të futet fuqishëm në radhët e Partisë së **LEGALITETIT**, por të marrë edhe poste të rndësishme në të. Ky mision i tillë kaq i vështirë dëshmon se sa i fortë ishte shërbimi sekret shqiptar në atë kohë (P.sh.**Isuf Mullai në Greqi kishte provuar edhe torturat më mizore, gjarpërinjtë e lëshuar në qeli, i mbërthyer nga ata për dy ditë, një torturë e tmerrshme, pas së cilës oficeri i lartë i armatës shqiptare kishte bindur autoritetet greke për t'mos dyshuar më në të, dhe ia kishin dhënë lejen të kaloji në kampin e emigrantëve në Athinë, dhe prej andej në Bruksel.**

Akoma më ogurzezë ishte përkrahja e hapur e anglezve , ndaj një plani, të përpiluar nga SH.B.A-të, në muajn gusht 1944, për ta **NDARË SHQIPËRINË NË DYSH** dhe për të pushtuar një pjesë të saj. Ky plan perfid theksonte-**Sazani të merret menjëherë, dhe sa më shpejtë të dërgohen në Tiranë dhe Durrës 5000 forca amerikane...** (Shih-Jon Hallday, SHQIPTARI DINAK,f.114-115) . Por të gjitha këto ishin pazare pa hanxhiun, sepse PKSH-ja dhe Lëvizja Nacional Çlirimtare e kishin kuptuar situatën dhe u rreshtuan në koalicionin

antifashist dhe fituan...Lidhur me këtë historiani dhe analisti i njohur france **Henri Bogdan** shkruan: "ÇLIRIMI I SHQIPËRISË, kishte qenë vetëm vepër e partizanëve shqiptarë..."(Shih-"Hanry Bogdan-Histoire de Pays de l'est., f.403).

Dhe pas këtyre elaborimeve me orë të tëra, profesori na thoshte-Ja sa e vështirë ësht mbrojtja e shtetit dhe fryteve të revolucionit, ja kush janë **dalëzotësit e saj dhe HERONJT E HESHTUR të cilët bëjnë ROJE NË KUFI dhe sfidojnë armiqtë e tërë botës...**

ꕥ

Profesori lexonte gjithnjë me mendim kritik. Njohja e tij ishte e thellë, jo panoramike dhe e sipërfaqshme. Sot na fliste për gjeografinë e nesër për historinë, një ditë tjetër për etnografinë, për mjekësinë, astronominë, filologjinë, për historinë e biblës dhe islamizmit, për regjimet e monedhës dhe valutave, për inflacionin, për lindjen e gjuhëve dhe alfabeteve të ndryshme që nga PELLAZGËT e moçëm, dhe një ditë tjetër na fliste për Betovenin e Mocartin, sa ne ngelnim gojëhapur duke u mahnitur me gjithë atë kapacitet gjenial enciklopedik që shquante personin e tij.

Figura e Qazim Berishës i përket asaj plejade kolosësh që koha ua rrit vlerat. Njerëzit si ai, një studiues i pasionuar i shkencës me përmasa poliedrike, **janë dhurata më e shtrenjtë për një komb, dhe i takojnë, sa kohës kur jetojnë, aq edhe së ardhmes, sepse ai simbolizon atdhedashurinë e zjarrtë dhe militantizmin revolucionar, urtësinë popullore dhe mendjen e ndritur të një njeriu me aftësi të rralla, të kultivuara në shkollën e revolucionit për drejtësi e progres shoqëror.**

Unë, autor i këtyre radhëve, ndjehem shumë i privilegjuar dhe shumë me fat që njoha dhe bashkëjetova çaste të çmueshme me Heroin e gjallë, njërin prej pedagogëve më të mirë të kombit, **Qazim Berishën**, për të

cilin edhe sikur të shkruhen një mal me libra për jetën dhe veprën e tij të ndritshme, sërish do t'i ngelim shumë borxh. **Dhe kjo figurë e shquar, ky yll i pashuar, ngrihet akoma më madhështor në piedestalin e historisë, po të kemi parasysh armiqtë e shumtë që duheshin përballuar, vështirësitë e mëdha që duheshin kapërcyer, rreziqet e panumërta që i kanoseshin jetës së tij prej militanti të paepur të çështjes së atdheut**, i cili edhe atëherë kur përballej me vështirësi dhe rreziqe, ndriçonte edhe më shumë, siç do të thoshte Sami Frashëri: **"SI FLAKA E SHREPSËS ME KOKË POSHTË, QË ËSHTË MË E FORTË, ASHTU EDHE VIRTYTET E DIJETARIT TË RËNË NË FATKEQËSI DUKEN MË QARTË."** Emri dhe vepra e ndritshme Qazim Berishës na frymëzon përherë për punë dhe na jep vullnet për të vazhduar rrugën e tij të lavdishme deri në fitoren përfundimtare. Porosia e Tij e shenjtë ishte: **ta duam punën, mësimin, arsimimin, shkencën, ta duam kulturën tonë kombëtare dhe ndërkombëtare.**

Misioni i shenjtë, që i kishte ngarkuar vetes Qazim Berisha, nuk do të kursejë asgjë nga mendja dhe zemra e tij, nga frymëzimi dhe dijet e tij enciklopedike. Dashuria e tij për njerëzit dhe popullin e tij martir e bëri atë të tretej si qiriu dhe e shtyri deri në flijimin suprem. Sakrificës së tij sublime i shkojnë më së miri vargjet e fuqishme të poetit të madh Naim Frashëri – FJALËT E QIRIRIT:

Në mes tuaj kam qëndruar
e jam duk'u përvëluar,
që t'ju jap pakëz dritë,
natën t'jua bëj ditë.
Do të tretem, të kullohem,
të digjem, të përvëlohem,
që t'ju ndrij mir'e të shihni,
njëri-tjetrin të njihni.
Për ju do të rri të tretem
as një çikë të mos mbetem,
të digjem e të qaj me lot,
se dëshirën s'duroj dot.
Unë zjarrit nuk i druhem

dhe kurrë s'dua të shuhem,
po të digjem me dëshirë
sa të mund t'ju ndrij më mirë.
Kur më shihni se jam tretur,
mos pandehni se kam vdekur,
jam i gjall'e jam në jetë,
jam në dritë të vërtetë.
Unë jam në shpirtin tuaj,
mos me kini për të huaj...
Në shpirt kam dashurinë,
pa digjem për njerëzinë...
Me zjarr ta djeg mushkërinë
e të tretem për NJERINË...

Me këtë ndihmesë modeste, pa pretenduar të shteroj të dhënat autobiografike për të ndriçuar në mjaft aspekte jetën dhe krijimtarinë e profesor Qazim Berishës për të zbërthyer disa anë të personalitetit të shumanshëm të tij si gjuhëtar, si orator i shkëlqyeshëm, si përkthyes, si edukator, si ekonomist, si filozof, si politikan, si veteran i luftës antifashiste, si shok dhe si prind, u mundova të bëj **një hap të vogël**, i vetëdijshëm se studiuesit tjerë në të ardhmen, do të sjellin kontribute të veçanta në këtë drejtim. Qazim Berisha është një figurë e shquar poliedrike me përmasa kombëtare sa në çdo periudhë kohe t'u imponohet shkrimtarëve dhe studiuesve që të shkruajnë përsëri për të.

Të mos harrojmë, për shembull, dy veprat e përkthyera nga profesori Qazim Berisha, **UDHËTIMI NË KONGO të Andre Zhidit dhe GJOKU të Rene Gijo**, dy libra këto që tingëllojnë bukur në shqip aq sa **në gjuhën e origjinalit** , në gjuhën frenge, në të cilën janë shkruar , dhe kjo ishte një dëshmi se profesori i nderuar ishte mjeshtër i fjalës së shkruar që ka lënë gjurmë në fushën e përkthimit. Dhe këtu profesori u dëshmua se zotëronte shkëlqyeshëm gjuhën frenge dhe gjuhën amtare, gjuhën shqipe, duke krijuar kështu një harmoni të shqipërimit në një gjuhë korrekte, të zgjedhur, dhe të bukur. Profesori

ishte i vetëdishëm se letërsia është arti i fjalëve, dhe jo vetëm që kishte gjetur fjalët gjegjëse në mënyrë sa më të saktë dhe me një ndjesi vetëkorrigjimi duke kryer kështu një detyrë fisnike dhe me shumë përgjegjësi. Me këtë përpjekje **Qazim Berisha vuri një gur në monumentin më të madh të vendit, të gjuhës në pëgjithësi.** Është humbje e madhe pse profesori nuk arriti të vazhdojë këtë rrugë të trasuar nga shqipëruesi më i spikatur, Fan Noli i madh.

Ideja për të hedhur në letër ato mbresa e kujtime të pashlyeshme që ruaj vazhdimisht në mendje e në zemër për këtë burrë të shquar të kombit, për mësuesin tonë të dashur, gjithmonë më është dukur një punë fort e vështirë. Përballë një personaliteti të tillë të punës e të dijes nuk është e lehtë të gjesh në çdo rast fjalët e përshtatshme, të veçosh tiparet karakterizuese, midis larmisë së pafund të cilësive e vlerave të shquara të tij. Në këto shënime të miat vetëm sa preken, vetëm sa vihen në pah disa nga cilësitë dhe vlerat e shquara të këtij heroi-**monument i përjetshëm i skalitur në zemrën e popullit të tij martir**, të cilit do t'i kujtojmë vetëm një datë, **ATË TË LINDJES! Më 6 prill 1999** ne vetëm fizikisht u ndamë nga profesori Qazim, duke u përpjekur t'i mposhtnim emocionet dhe ngulçimat që më ngjiteshin në fyt, me betimin – **DO TA VAZHDOJMË RRUGËN TUAJ DERI NË VDEKJE!**

Dhe ç'të themi sot, në dhjetëvjetorin e rënies së mësuesit, filozofit dhe pedagogut hero Qazim Berisha, për të cilin fjala poet dhe njeri janë një, pedagog dhe njeri janë një, mësues dhe njeri janë një, por që as qyteti në të cilin jetoi dhe veproi mbi dyzet vjet, dhe u varros po në këtë qyetet, nuk u kujtua të organizonte ndonjë manifestim përkujtues për t'mos e lënë në harresë emrin dhe veprën e gjeniut dhe militantit që tërë jetën e tij deri në atomin e fundit e sakrifikoi në shërbim të shkencës, kulturës, arsimimit dhe jetësimit të kauzës së shenjtë të Atdheut duke përgatitur gjenerata të tëra për **LIRI**. Por kjo është dëshmi se harresa, ose edhe më keq, injorimi, janë bërë sëmundje kronike jona, ndërsa HESHTJA ishte një lloj

tjetër burgimi dhe izolimi. Por sa e sa fatosa të kombit u harruan me vite e decenie pa ua ditur kush as varrin, siç ndodhi me të ndritshmin **At Shtjefën Gjeçovin** eshtrat e të cilit preheshin në fshatin Zym të Hasit, por vetëm falë një plake të moshuar, më 1967, u gjet gërmadha e gurëve nën të cilët pushonte i madhi Gjeçov, por pa asnjë mbishkrim se i cilit ishte ai varr (Vetëm në 80 vjetorin e rënies së Gjeçovit, më 2009, iu ngrit monumenti i përjetësisë në Zym të Hasit). Po kështu ndodh edhe me pishtarin e arsimit, **NIMAN FERIZIN**, mësuesin e parë të shkollës shqipe në Gjakovë më 1917, partizani i paepur i revolucionit demokratik në Shqipëri në vitin 1924, bashkëluftëtar i **Bajram Currit** dhe ithtar i qeverisë së **Fan Nolit**, eshtrat e të cilit u varrosën në Zarë, por cili mund ta gjej sot varrin e tij të harruar? Po varrin e kolonel **Xhavit Leopardit** (me akademi ushtarake në Romë dhe Voroshillov) të cilin UDB-ja e likuidoi në mënyrën më mizore duke e keqtrajtuar me vite të tëra nëpër burgjet jugosllave vetëm pse nuk u pajtua me riokupimin e Kosovës? Po për kolonel **Xhafer Kodrën** nga Dibra të cilin UDB-ja fashiste e likuidoi mizorisht më 1949 ? Po për eshtrat e gjeniut dhe filozofit me **aftësi enciklopedike OMER ÇERKEZI** nga Mitrovica çfarë dimë, dhe çfarë kemi bërë për të, kur sot e kësaj dite të paktën një rrugë do të duhej ta mbante emrin e këtij kolosi të cilin UDB-ja fashiste e masakroi në burgun famëkeq të Goli Otokut(Kroaci) më 1949? Për turpin tonë edhe sot e kësaj dite kemi me dhjetra heronj të cilëve nuk u dihen as varret, në vend që t'iu ngrisim monumente pavdekësie. **Duhet të na brejë ndërgjen tonë harresa jonë kronike, turpi ynë i madh, një FAJ që nuk mund të arsyetohet me asgjë, përveçse me ndriçimin dhe përjetësimin e veprës së tyre heroike.** Nderimi për profesorin me njohuri universale të shumë fushave të kulturës njerëzore si QAZIM BERISHA është DINJITETI ynë. "Verba docent, exemle trahunt **"- Fjalët MËSOJNË, shembujt EDUKOJNË"** - na thoshte profesori dhe shtonte se në UDHËTIM nuk ka rëndësi sa

zgjatë rruga, sa e vështirë është, rëndësi ka mbërritja në cakun e dëshiruar, e ne do të mbërrijmë medoemos, por vetëm me një kusht: **kur ta kuptojmë se DITURIA ËSHTË NJË ARMË E DOMOSDOSHME NË LUFTËN TONË PËR ÇLIRIM KOMBËTAR E SOCIAL**, sepse **SKLLAVI** që e kupton gjendjen e vet prej skllavi dhe lufton kundër saj, është **REVOLUCIONAR, është 50% i çliruar**, ndërkaq skllavi që nuk e kupton skllavërië e vet dhe që hiqet zvarrë në heshtje, pa kundërshtuar, **është vetëm skllav**. Por SKLLAVI, të cilit i kullojnë jargët nga goja dhe i kënaqur nga vetja me jetën prej skllavi dhe flet me admirim për zotninë e tij të mirë, **është SHËRBËTOR, është HARBUT, është dy herë i skllavëruar.**

Shembulli i Qazim Berishës është i paharruar. Ai na mësonte **ABECENË E LIRISË** duke e ngarkuar veten me detyrën e luftëtarit **PARAROJË** që udhëhiqej nga një teori **PARAROJË.** Do të duhet shumë kohë të lindi një i ngjashëm i racës së tij prej dijetari.

Le të shpresojmë se në të ardhmën shkolla e mesme ku punoi dhe veproi profesori **Qazim Berisha**, apo ndonjë institucion tjetër kulturor-arsimor do të **pagëzohet me emrin e madh të profesorit të profesorëve, heroit Qazim Berisha**, dhe kështu, duke bërë një hap të tillë , do t'i lëmë në harresë të gjitha këto lëshime të pafalshme të derisotme, **do ta shlyejmë një borxh të madh ndaj një liridashësi të madh, rrugën e lavdishme të cilit duhet ta ndjekim si kusht të domosdoshëm për të pasur të drejtë ta quajmë veten NJERI dhe SHQIPTAR**, të denjë për të rrojtur në këtë tokë të shenjtë, e jo paçavure kolabocioniste, leckë e fëlliqur e denjë për shportën e mbeturinave, kur dihet se **të vdekurit e mëdhenj janë të PAVDEKSHËM**, janë gjithnjë në këmbë nëpër LAPIDARE, nëpër vitrina librash, sepse atyre u referohen vazhdimisht të gjallët. Një popull udhëhiqet nga të vdekurit e tij më shumë se sa nga të gjallët e tij, sepse ata shekull pas shekulli e brez pas brezi kanë **përpunuar NDËRGJEHJËN kombëtare duke u kthyer në TRIBUNË të kombit**, siç ishte profesori **Qazmim Berisha**,

dhe mu për këtë populli këta dëshmorë e heronj i varros në varreza të veçanta të DËSHMORËVE TË KOMBIT të rrethuara me pemë e lule, se janë monumente lavdie. **Në varrezat e dëshmorëve duhet të pushojnë në përjetësi edhe eshtrat e profesorit Qazim Berisha, pastaj eshtrat e profesorit Xhemaili Berisha, i cili u vra mizorisht në kazamatin e Prizrenit më 6 prill 1989, pastaj eshtrat e studentit dëshmor ,Aziz Kelmendi, i cili u vra mizorisht në kazermën e Praqinit më 3 shtator 1987**, si dhe gjithë dëshmorët tjerë që ranë në demonstrata ose u likuiduan mizorisht në armatën fashiste jugosllave. Një hap të tillë duhet bërë sa më shpejt për t'mos na zënë mallkimi i të rënëve, duke na thirrur:

Shqiptarë, mos e harroni luftën tuaj të shenjtë për liri!
Shqiptarë, mos shkelni mbi gjakun tuaj, se e bëni
Atdheun të skuqet nga TURPI!

Në fund, kërkoj ndjesë nga lexuesi se thashë vetëm **dy fjalë, nga dy mijë që duhej thënë** , në nderim të figurës heroike të profesorit legjendë, pa pasur pretendimin për t'i shterruar gjithë faktet biografike **për një monografi të denjë**, për të cilën do të duhej **një kohë e gjatë hulumtuese për të vjelë në tërësinë e saj gjithë veprimtarinë e tij prej pedagogu e filozofi të paepur.** Mësimet e profesorit na mungojnë sot e gjithë ditën ashtu siç i mungon fëmijës gjiri i nënës, por sa herë e ndjejmë mungesën e tij dhe përmallohemi për ta parë dhe për të mësuar nga leksionet e tij filozofike shtypim butonin e videokasetës të incizuar nga veprimtari **Sabir Krasniqi** në dhejtor 1997, dhe për një orë rresht marrim frymëzim dhe energji mobilizuese nga mësuesi ynë i pavdekshëm, simboli i qëndresës dhe heroizmit, i cili nuk dinte ç'ishte frika, që s'i trembej syri kurrë, që përbuzi çdo rrezik, që s'ju përkul asnjë vështirësie, dhe që pasurinë e vetme e kishte **MORALIN PATRIOTIK.**

Dhe, në qoftë se këto radhë nxitin mendime, përtërijnë mbresa e kujtime, si një ndihmesë në edukimin dhe

frymëzimin patriotik, sidomos në radhët e atyre që patën fatin dhe privilegjin ta thithnin nektarin dituror të këtij pedagogu e filozofi të madh, atëherë kjo gjë për mua do të jetë një kënaqësi e veçantë. Në fund, **kërkoj ndjesë nga profesori i ndjerë, por edhe nga lexuesi i nderuar**, për çdo interpretim jo të saktë dhe keqkuptim gjatë mbarështrimit të këtyre pak dorëshkrimeve të cilat shpëtuan pa u konfiskuar nga dora gjakatare e UDB-së gjatë kohës sa ishte autori i këtij shkrimi në burgun e Prizrenit.

KUJTIME TË TË TJERËVE PËR PROFESORIN QAZIM BERISHA



Ali Aliu - Kelmendi
12.09.1924
Veteran i luftës antifashiste, i burgosur politik, veprimtar i palodhshëm i çështjes kombëtare, armik i paditurisë dhe obskurantizmit, i cili vuajti shumë vite nëpër burgjet e Goli Otokut, Nishit, Prishtinës, etj

ALI ALIU-PRESHEVA:

PROFESOR QAZIM BERISHA, PERSONALITET FLAMUR,ENCIKLOPEDI E GJALLË, FILOZOF i VËRTETË, HERO I ARSIMIT DHE SHKOLLËS SHQIPE

Jam i privilegjuar që pata fatin ta njoh Qazim Berishën qysh në rininë e hershme, kur isha duke ndjekur mësimet në Gjimnazin **"Sami Frashëri"** në Prishtinë, më 1942-1943, por edhe më vonë si pjesëtar të Lëvizjes Antifashiste. Këtë militant të orëve të para të Lëvizjes për Çlirim dhe Bashkim të trojeve nën okupim, këtë figurë të ndritshme të çështjes kombëtare e kisha busull orientimi, sepse me punën e tij kolosale si profesor, filozof, shkencëtar, politikan, dhe

pedagog ai la vulë të pashlyeshme në ndërgjegjen tonë. Qazim Berisha ishte njeri i idealit, i sakrificës, njeri i cili kurrë nuk iu tremb punëve të rrezikshme duke u bërë shembull frymëzimi për ne që ishim në hapat e para të Lëvizjes për Çlirim. I pajisur me dijeni enciklopedike e profesionale, me një kulturë të gjerë, me një vizion të qartë ndaj ideve dhe lëvizjeve revolucionare, bashkëluftëtar i heronjve **Emin Duraku, Ramiz Sadiku** etj., i përballoi me heroizëm torturat e nazifashistëve gjerman në burgun e Tiranës, por edhe më vonë në burgun kolektiv – në Kosovën e ripushtuar nga neoçetnikët jugosllavë. Ai mbeti i skalitur në zemrën e shumë gjeneratave të nxënësve dhe studentëve, në zemrën e madhe të popullit martir, por që **nuk pati shokë të denjë rreth vetes, duke qenë i pakorruptueshëm në çdo pikëpamje, duke mos iu bashkuar klaneve kolaboracioniste, dhe duke qenë përherë armik i përbetuar i diktaturës fashiste kolonizatore jugosllave dhe bashkëpunëtorëve servilë të kësaj diktature mizore.**

Kontaktet e para me Qazim Berishën më frymëzuan dhe me inkurajuan për të qenë një militant i devotshëm i Lëvizjes antifashiste. Me inteligjencën e tij, me taktin e komunikimit, me fjalën e ëmbël dhe dashamirëse, me plot zjarr, **militanti Qazim Berisha u bë epiqendër e gjithë shokëve të Gjimnazit.** Ai ishte një gjeneratë para meje, dhe ishte i kyçur më herët në Lëvizjen Antifashiste, dhe bashkëvepronte me **Emin Durakun** dhe **Ramiz Sadikun**, por edhe me militantë të tjerë. Në Pejë vepronte njëra ndër celulat më të forta revolucionare, në ballë të cilës ishte Ramiz Sadiku, me të cilin Qazimi kishte lidhje të ngushta, por edhe me celulën e Gjakovës, të cilën e drejtonte Emin Duraku.

Me militantin e orëve të para, Qazim Berishën, u takuam edhe pas kryerjes së Gjimnazit, pas Mbledhjes së **AVNOJIT, më 29.11.1943**, në Jajcë, në të cilën nuk kishin ftuar asnjë përfaqësues shqiptar nga Kosova, dhe mbaj mend kur së pari Qazimi me paralajmëroi se mospjesëmarrja e delegacionit nga Kosova në KAÇKJ nuk është ogur i mirë, dhe na jep me kuptua se çështja jonë kombëtare po **TRADHTOHET**

paturpësisht. Fjalët e Qazimit me goditën si çekan në kokë, dhe aty për aty fillova t'i kundërvihem me fjalët se **PARIMI I VETVENDOSJES është i garantuar nga Fuqitë e Mëdha** (SHBA, Anglia dhe Bashkimi Sovjetik), dhe vazhdova ta bindi se kjo çështje do të zgjidhet pozitivisht në favorin tonë. Por Qazimi mendimet e mia nuk i aprovoi, dhe kur unë edhe më tej po këmbëngulja në mendimet e mia se duhet besuar në garantimet që janë dhënë, **ai me shikoi me dhembje dhe me atë shikim zhbirues ma preu bisedën, dhe i ra shkurt me këto fjalë:**

„Dëgjo, shoku Ali, vëlla i idealit, këtë që po m'i thua ti me insistim, në njërin vesh po më hynë dhe në tjetrin po më dalin... "

Pas këtyre fjalëve të prera unë fillova të dyshoj në mendimet e mia që kishin **dozë optimizmi të tepruar**, dhe u binda se kishte shumë të drejtë shoku Qazim, i cili me kohë i kishte nuhatur **lojnat dinake** që po luheshin rreth çështjes së Kosovës, dhe në dëm të zgjidhjes së drejtë të kësaj çështjeje. Por, pas **Mbledhjes së Bujanit, më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944**, mua sërish m'u kthye besimi, por Qazim Berisha, si një vizionar e largpamës që ishte, sërish ishte kategorik dhe as që donte fare të bisedonte rreth kësaj çështjeje madhore. Mjerisht, mendimet dhe parashikimet e Qazim Berishës më vonë u bënë realitet, **Kosova u ripushtua në mënyrën më flagrante, neve na burgosën një nga një, dhe Administrimi ushtarak i Kosovës i fundosi të gjitha ëndrrat tona për çlirim dhe bashkim me mëmën Shqipëri**. Në takimin e parë pas përfundimit të luftës, pasi i kisha kryer studimet në Fakultetin Ekonomik, më 1952, kur u takova me Qazimin në Prizren, u përshëndeta me të përzemërsish dhe i thashë:

„Qazim, të gjitha ato parashikime tuaja rreth çështjes së Kosovës u vërtetuan katërçipërisht... " Qazimi, i cili kurrë nuk ishte mburravec, me shikoi me dhembje, siç më kishte shikuar edhe më 1943, dhe nuk tha asnjë fjalë, por mua më dukej se po më thoshte: ah, **Ali Aliu, sikur të gjithë t'i kishim kuptuar gjerat me kohë, kurrë**

nuk do të ishim këtu ku jemi sot (Këto u vërtetuan edhe pas Mbledhjes së Kuvendit të Kosovës në Prizren, më 8-10 korrik 1945, kur edhe formalisht u zyrtarizua me forcën e automatikëve dhe mitralozave ripushtimi i Kosovës nga ana e Jugosllavisë).

Me profesorin liridashës, Qazim Berisha, u takova edhe pasi e kisha vuajtur dënimin me 8 vite burg të rëndë në Goli Otok, në vitin 1969, kur Qazimi po jepte mësim në Gjimnazin e Prizrenit. Herë pas herë e kemi vizituar bashkë me ekonomistin **Fevzi Nojani**, sepse kishim nevojë të madhe për të na i sqaruar gjerat për të cilat ne kishim mëdyshje dhe nuk i kuptonim në tërë kompleksitetin e tyre. Ne dinim se **atë që e thotë Qazim Berisha nuk mund ta rrëzojë as topi**. Ai ishte një njeri shpirtmadh e zemërbardhë që predikonte vetëm të vërtetën. Bisedat me të vazhdonin me orë të tëra dhe ishin të nivelit akademik, dhe tërësisht të sakta.

Vepra e profesorit Qazim Berisha mbijeton jetën fizike të shumë gjeneratave duke lënë gjurmë të pashlyeshme në ndërgjegjen e kombit dhe do të jenë objekt analizash dhe vlerësimesh të përhershme, sepse problemin e kauzës kombëtare ai e **vështronte nga këndvështrimi filozofik, historik dhe politik**. Ai jo vetëm që na fliste për faktet relevante historike të çështjes kombëtare, por na tregonte edhe se si mund të zgjidhet kjo çështje, dhe çfarë mund të bëhet që populli ynë i copëtuar në pesë pjesë të bëhej një popull i bashkuar, një komb jo i ndarë, një Shqipëri integrale. Kur ne flisnim se do hyjmë në Evropë, do evropizohet edhe Shqipëria, dhe profesori i binte shkurt duke thënë:

Këto janë FANTAZIRA, janë broçkulla, **sepse Shqipëria siç është kështu e sakatosur dhe e copëtuar në pesë pjesë si do futet në Evropë, pa Kosovën, pa Preshevë Bujanovcin e Medvegjën, pa Iliridën, pa Malësinë e Madhe, Ulqinin, Plavën Gucinë, Hotin, Grudën, pa Sanxhakun, pa Çamërinë? Te profesori Qazim Berisha bashkoheshin dituria, zgjuarsia filozofike**

me patriotin e vërtetë, jo një patriot librash, por një patriot i madh me guxim të pashoq, por të cilit i kemi shumë borxh, sepse edhe dhjet vjet pas rënies së tij pothuaj nuk është bërë asgjë në kujtim të veprës së tij , dhe kam frikë se pikërisht ky nivel i lartë i dijeve enciklopedike ka qenë edhe burim i injorimit të këtij heroi, nga ata të cilët iknin prej tij për të gjallë, e sot kanë zënë majat në hierarkinë pushtetit si kolltukofagë e kolaboracionistë. Indiferenca është KRIM, është pajtim me vrasësit. Profesor Qazim Berisha është simbol i vetëdijes historike, i ndërgjegjes dhe qëndresës së pamposhtur shqiptare. Profesor Qazimi nuk i përket harresës, sepse është në vetë esencën e kujtesës së kombit, ai nuk mund të vdesë, dhe nuk ka për të vdekur kurrë. Emri dhe vepra e tij heroike do të rrezatojë përjetësisht frymëzim për dituri, guxim dhe dinjitet brez pas brezi! Ai është përherë i gjallë në zemrat tona!

LAVDI E PËRJETSHME JETËS DHE VEPRËS
SË HEROIT QAZIM BERISHA!

P.S. (Këtë shkrim ia dha Ali Aliu autorit më 11. 03. 2009)

Bislim Elshani, profesor i Gjuhës dhe Letërsisë shqipe, veprimtar i palodhshëm i çështjes kombëtare, i cili vuajti dënimin politik me shumë vite nëpër burgjet e Jugosllavisë fashiste.

Bislim Elshani

QAZIM BERISHA OSE SOKRATI I PRIZRENIT

Gjatë viteve 80, së bashku me një mikun tim, Rushit Ramabajën, vizitoja shpesh motrën e Xheladin Hanës, një martir i shquar kosovar i likuiduar nga UDB-ja më 1949, fatkeqësisht dhe padrejtësisht të lënë në harresë gjatë gjithë këtyre viteve. Është fjala për Hyrije Hanën, ish- aktore e Teatrit popullor të Prishtinës. Kur shihja bibliotekën personale të vëllait të saj, të ruajtur me aq xhelozi nga e motra, pyesja veten: si u bë vallë që Kosovës t'i likuidoheshin figurat më të shquara e më të ndritura intelektuale, për të mbetur nën drejtimin e ca matrapazëve gjysmanalfabetë si puna e Fadil Hoxhës, Xhavit Nimanit, Sinan Hasanit, Ali Shukrisë etj. Kisha dëgjuar edhe për nivelin e lartë të një personaliteti si Rifat Berisha, të vrarë tradhtisht nga UDB-ja serbe e Kosovës. Kisha dëgjuar për nivelin e lartë intelektual edhe të Emin Durakut, Hajdar Dushit e të Ramiz Sadikut, të vrarë në rrethana të dyshimta gjatë luftës. Por kurrë s'më kishte rastisur të njihja nga afër ndonjë kundërshtar të gjallë të shovinizmit serb e të udhëheqjes titiste jugosllave, me një nivel të

jashtëzakonshëm intelektual siç ishte Qazim Berisha, që i përkiste njëkohësisht edhe periudhës së LNÇ, pjesëmarrës aktiv i së cilës kishte qenë, edhe asaj të pasluftës, për të arritur deri në vitet e kurorëzimit të ëndrrës kosovare për pavarësi. Pyesja veten, si kishte arritur ai vallë t'i shpëtonte syrit të pagabueshëm dhe instinktit prej hiene të drejtuesve serbë?

Si duket ai kësaj ia kishte arritur duke përdorur disa taktika: nuk kishte treguar asnjëherë synime të hapura politike për pushtet (ngjashëm si rasti i Kristo Frashërit në Tiranë), dhe e dyta, i ishte dorëzuar pa kushte gotës së rakisë, (ngjashëm si Mihal Grameno, në kohën e Zogut, dhe Lasgush Poradeci, në kohën e Enverit në Shqipëri). Duke shqyrtuar edhe ndonjë rast tjetër të ikjes nga realiteti dhe gjetjes së shpëtimit pranë gotës së rakisë, them se për alkoolin mund të flitet si për njëfarë vendstrehimi të fundit politik, sidomos kur të gjitha rrugët tjera, si psh. ai i realizimit të ikjes reale, qoftë për shkak rrethanash familjare, qoftë për shkaqe parimore, qoftë dhe për pamundësi objektive, janë të përjashtuara. Psh. një disidencë specifike brenda realitetit shqiptar mund të quhet edhe ajo e Dritëro Agollit. Ekzistojnë rrëfime e anekdota të panumërta, ndonjë edhe me natyrë thjesht disidente, që tregojnë lidhjen e tij me verën e me rakinë. Alkooli te kjo kategori intelektualësh nuk është vetëm një shkëputje virtuale nga realiteti, por edhe një mundësi për të shprehur hapur mospajtimin dhe për t'u arsyetuar tek përndjekësit me arsyen e thjeshtë: Ku di unë ç'kam thënë? Ndërkaq rrethanat lehtësuese të dehjes i sanksionojnë pothuajse të gjitha kushtetutat e vendeve ku pijet alkoolike nuk janë të ndaluara. Në anën tjetër, edhe për vetë njerëzit e establishmentit politik, dehja ka qenë shumë shpesh një brez shpëtimi për situata të pakëndshme, që në kushte normale mund të kishin përfundime dramatike. Lasgush Poradeci, falë dy miqve të tij më të ngushtë, një qenushi që e përcillte ngado dhe gotës së rakisë, arriti të jetonte një jetë të tërë në kushtet e një diktature me të cilën ai

nuk u pajtua kurrë. Po edhe për diktaturën ishte më e lehtë të bashkëjetonte me një opozitar të dehur.

Ajo që e kishte shpëtuar ndërkaq Qazim Berishën nga thonjtë e çakenjve të UDB-së ka qenë edhe biografia e tij e rregulluar fatbardhësisht përmes një periudhe të jetuar në Kroaci, ku mungonte urrejtja shoviniste antishqiptare. Atje ai e mori pasaportën e një intelektuali të madh dhe njëkohësisht, sigurimin e paprekshmërisë nga hienat serbe. Ai kishte shkëlqyer në Kroaci si një mësues dhe studiues i jashtëzakonshëm, dhe pas kësaj periudhe kroate, askush në Kosovë s'mund ta akuzonte dot më për anti-jugosllavizëm, nacionalizëm apo irredentizëm.

Nuk kam pasur fatin të jem nxënës apo student i prof. Qazim Berishës. Por ajo që mësova që nga takimi im i parë me të në banesën e prof. Bajram Kurtit në Prizren, ishte mahnitëse. Kishte ndodhur kjo një ditë vere të vitit 1986 kur unë, me të hyrë në dhomën e pritjes, vura re të ulur në divan një burrë trupvogël, të shtyrë në moshë por plot vitalitet. Unë nuk kisha njohur kurrë deri atëherë (1986) një intelektual aq të kompletuar, që të fliste me aq kompetencë për aq shumë fusha të dijes si prof Qazim Berisha. Pati rënë fjala psh. në një rast për jezuitët e për priftërinjtë françeskanë të Shkodrës. Ai ishte në gjendje të na ofronte njoftime të hollësishme jo vetëm për historinë dhe organizimin e tyre, por edhe për detajet më të imëta të veshjeve të tyre, për secilin rang veç e veç dhe në gjithë hierarkinë. Dhe përshkrimet e tij ishin aq të gjalla e aq plastike, sa dukej sikur të shfaqeshin para sysh në formë vegimi. Mënyra e tij e të folurit ishte pasionante. Ai s'fliste kurrë vetëm sa për të kaluar radhën. I vetëdijshëm për superioritetin e tij të dukshëm në raport me nivelin intelektual të tjerëve, ai fliste rrjedhshëm dhe kalonte nga tema në temë, duke sqaruar gjithçka hollësisht e me kompetencë, gjë që të kënaqte më shumë se sa kur e ndërpriste ndokush me ndonjë ndërhyrje idiote. Një fushë e veçantë ku Qazim Berisha shfaqte sigurinë dhe kompetencën më të madhe shkencore ishte linguistika. Nga shënimet që ka ruajtur prof Bajram Kurti, fitohet përshtypja se prof. Berisha

mund të dinte edhe ndonjë sekret të pazbuluar akoma nga prejardhja e gjuhës sonë, por që, në mungesë të shkrimeve të tij autentike, mund ta ketë marrë në varr me vete. Kompetenca e tij në fushë të etimologjisë të përkujtonte nivelin e një Çabeji. Ndërkaq mjeshtëria e tij në përdorimin e metaforave e të paradokseve mund ta kishte bërë atë një linguist shumë më atraktiv se sa ata që njohim, po t'i ishte dorëzuar tërësisht hulumtimeve shkencore, së paku brenda qarqeve shkencore të Prishtinës.

Nga ndonjë vërejtje e autorit të këtij libri, të cilin pata fatin ta lexoj në dorëshkrim, fitohet përshtypja se Qazim Berisha kishte edhe ndonjë fuqi profetike. Për të mos lënë shteg për ndonjë interpretim mistik të këtij fakti, duhet theksuar se "profetizmi" i tij s'ishte ndonjë "dhunti hyjnore" por thjesht një rezultat i përgatitjes së tij të lartë shkencore. Ai vilte informacione nga të gjitha burimet e mundshme, nga radioja e nga televizioni, nga librat e nga gazetat, në gjuhën shqipe, serbo-kroate e franceze. Niveli i lartë i njohurive e shpuri domosdoshmërisht në shkallën e përgjithësimeve filozofike mbi jetën dhe të përfundimeve të sakta politike që ia jepnin mundësinë edhe të ndonjë parashikimi.

Ajo që ka arritur të na ofrojë libri i shënimeve dhe kujtimeve të **prof. Bajram Kurtit përbën vetëm majën Ajsbergut** të asaj çfarë përfaqësonte realisht personaliteti erudit i prof. Qazim Berishës. Dhe kjo jo vetëm sepse, siç e pohon autori, një pjesë e madhe e shënimeve i është grabitur e mbase edhe asgjësuar nga policia serbe, por edhe nga fakti se ato janë shënime që pasqyrojnë jo vetëm një aspekt të figurës së Qazim Berishës, por edhe fushën e veçantë të interesimeve të vetë prof. Bajram Kurtit. Mbase ndonjë intelektual tjetër, me pikëpamje dhe me interesa të ndryshëm nga ato të prof. Kurtit, mund të kishte nxjerrë nga Qazim Berisha ndonjë segment tjetër të pasurisë së tij filozofike që mund ta pasuronte e ta plotësonte akoma më shumë këtë personalitet. Aq më parë kur në disa raste duket sikur ekziston edhe ndonjë kontradiktë, si, ta zëmë, në pikëpamjet e tij mbi fenë. Në një anë ai e quan fenë me të drejtë si një

handikap të kosovarëve dhe si një mjet me të cilën qarqet politike serbe arrinin të manipulonin kosovarët. Në anën tjetër, ai pohon se vetëm me shkencën, dmth. pa të kundërtën e saj, pa fenë, s'do të mund të bënim dot as një javë.

Një befasi për lexuesin e këtyre shënimeve mund të jetë dhe qëndrimi i veçantë i Qazim Berishës ndaj figurës së Stalinit. Ai nuk i fsheh krimet e Stalinit ndaj kundërshtarëve, të cilat, pos tjerash, ishin të kushtëzuara edhe me faktin se revolucioni i tetorit nuk i dispononte kushtet e nevojshme sociale (mungesa e proletariatit), por njëkohësisht, ai nënvizon edhe faktin se Stalini grushtin më të madh ia dha shovinizmit rusomadh dhe pansllavizmit, një fakt nga i cili përfituan shumë popuj të vegjël jorusë, madje edhe shqiptarët. Ai nënvizon p.sh. faktin e paditur ndër ne mbi mosrealizimin e shpërnguljes edhe të hungarezëve nga Vojvodina nën shembullin e folks-dojçerëve për shkak të ndërhyrjes së Stalinit. Për rastin e shumëpërfolur lidhur me fjalët e Stalinit drejtuar Gjillasit e Kardelit, se ju mund ta gllabëroni lirisht Shqipërinë, Qazim Berisha ka një shpjegim origjinal, bazuar në burimet e veta: "**Po ta jap Shqipërinë, me kusht që ti të ma japësh vetveten, po ta jap veshin, që ti të ma japësh trupin! Kështu i tha Stalini Jugosllavisë, por mospranimi i saj e shpëtoi Shqipërinë."**

Kur zbulon pikëpamje të tilla autentike të padëgjuara nga askush tjetër, të lind automatikisht keqardhja se përse gazetarët e shtypit tonë, që intervistuan lloj-lloj hohshtaplerësh politikë të Kosovës, nuk trokitën qoftë edhe një herë të vetme në portën e prof. Qazim Berishës në Prizren. **Është për të ardhur keq që për kapacitetet filozofike të Qazim Berishës të flasim sot me më pak shënime se sa kishin mbetur në kujtesën e Platonit para 2500 vitesh për mikun e tij Sokratin**. Ndërkaq prof. Berisha jetoi deri në prag të shekullit 21.

Në aspektin filozofik, Qazim Berisha është i pari dijetar shqiptar që frazën e njohur proverbiale shqiptare mbi "fryrjen e kosit" nuk e quan diçka që i referohet marrëzisë por të kundërtës së saj, urtisë së vërtetë. Qazim Berisha ngul

këmbë se i duhet fryrë edhe kosit, gjithë përderisa të mos kemi zbuluar natyrën e vërtetë të objektit. Pra nuk duhet të shkojmë si të marrë drejt gropës që na hapin të tjerët, por duhet të prekim me kujdes të madh truallin ku do të shkelim.

Në këtë mënyrë prof. Qazim Berisha, nga ngjashmëria me Sokratin, kalon te një ngjashmëri akoma më e afërt me Diogjenin. Prof Qazimi duke i fryrë gotës me kos na kujton kështu Diogjenin që mban fanarin në pikë të ditës për të kërkuar njeriun. Mirëpo me Diogjenin prof. Qazimin e lidhin edhe nja dy episode shumë pikante nga jeta e tij private. Në një rast atij i shkojnë në banesë disa intelektualë të shquar nga Prishtina për t'ia ofruar apelin e njohur për mosndryshimin e kushtetutës me 1989. Qazim Berisha, në vend të përgjigjes, fut kokën nën tryezë dhe nis të mjaullijë si mace. Mysafirët e kuptuan mesazhin, i cili do të thoshte se ajo çfarë po kërkonin ata ishin mbeturinat që do t'u hidhnin nën sofër zotërinjtë qeveritarë federativë. Në një rast tjetër atij i kishin vajtur për mysafirë ca njerëz të dyshimtë ose në ndonjëfarë mënyre të padenjë për t'u kushtuar kohën e tij të shtrenjtë. Duke mos pasur në atë çast një mjet tjetër refuzimi diplomatik të mikpritjes, ai kishte nisur të brohoriste: "Sllobo! Sllobo!". Mysafirët e befasuar kishin mbetur të shtangur dhe kishin ardhur në përfundim se profesori paskësh lojtur nga fiqiri, dhe e kishin lënë të qetë!

Punën e kosit ai na e përsërit disa herë kur bën fjalë për kosovarët si për varrmihësit potencialë të Shqipërisë dhe të vetvetes. Ndonjëherë të krijohet përshtypja se ai e tepron me frikën që Kosova mund të paraqiste për Shqipërinë dhe për rrezikimin e pavarësisë së saj. Mirëpo ai nuk flet në qiell. Ai u referohet planeve objektive jugosllave, ndonjëherë të shfaqura edhe hapur, psh. përmes ambasadorit jugosllav Josip Gjergja, për futjen e Shqipërisë në kuadër të Jugosllavisë. Ajo që mbase i mungonte atij ishte ndonjë informatë më burimore për sa i përket forcimit të pozitave ndërkombëtare të Shqipërisë pas viteve 80 (kujto shkëlqimin diplomatik të Ministrit të jashtëm shqiptar, Reis Maliles, në Beograd), gjë që ia mundësonte asaj një angazhim më të

vendosur për Kosovën. Në anën tjetër, statuti i mundshëm i republikës për Kosovën me 1981 mund të paraqiste ose mund të mos paraqiste ndonjë rrezikim për Shqipërinë, varësisht nga struktura, nga organizimi dhe nga gatishmëria e klasës politike kosovare për t'i shërbyer qëllimeve të huaja apo vetjake, dmth. zhvillimit të Kosovës dhe njëkohësisht ruajtjes së Shqipërisë. Ndërkaq, sipas analizave të Ukshin Hotit, të gjitha kushtet ishin pjekur për mundësinë e fundit. Megjithatë, përgjigjen më të saktë në këtë pyetje sot mund të na jepnin ish-politikanët kosovarë në shërbim të Jugosllavisë, përkatësisht, nëse ka ekzistuar ose jo ndonjë plan i fshehtë shkëmbimi ose pazarllëku për statusin e republikës së Kosovës në këmbim të heqjes së pavarësisë së Shqipërisë. Është koha e fundit që ky taraf politikanësh të rrëfehet publikisht para popullit, me qëllim që t'i kemi hesapet e qarta për të **ardhmen**. Në secilin rast, këshilla e urtë e Qazim Berishës, se megjithatë i duhet fryrë kosit, duket gjithmonë me vend, si dje, ashtu edhe për sot e për nesër.

Në këtë pyetje mund të përgjigjen edhe nja dy personazhe nga publicistika e sotme kosovare, të apostrofuar konkretisht në shënimet e prof. Qazim Berishës. Ndërkaq, apostrofimi konkret i tyre implikon dhe një pyetje të karakterit etik për botuesin e këtij libri: a do të lëshohej në apostrofime të tilla vetë prof. Berisha po të vendoste të publikonte pikëpamjet e tij? Sepse përgjegjësia e fjalës së shkruar ndryshon nga ajo e fjalës së shqiptuar dhe sepse reagimet e mundshme të apostrofuarve do të mbeteshin pa përgjigje, duke qenë se autori s'është në mesin e të gjallëve.

Bislim Elshani

Basel, Zvicër, 10 nëntor 2009

Profesor Shefki Muçaj (1942)

Qysh si maturant i Gjimnazit të Prizrenit u burgos nga UDB-ja fashiste me akuzë për veprimtari armiqësore kundër shtetit dhe vuajti dënimin dhe keqtrajtimin më mizorë në burgun famëkeq të Goli Otokut(Kroaci) më 1964-1968, por edhe më vonë në burgun e Prizrenit më 1994-1996, por përherë qëndroi burrërisht dhe i pathyeshëm në qëndrimet e tij atdhetare dhe liridashëse përballë xhelatëve fashistë të UDB-së jugosllave.

Shefki Muçaj

PROFESOR QAZIM BERISHA-URAGAN I SHPIRTIT TË POPULLIT- BUÇET E RIBUÇET STUHISHËM

Jeta e njeriut është shumë e shkurtër, po vepra vazhdon të jetojë shumë gjatë, sidomos kur lë pas vepra të vërteta. Një ndër ata është edhe profesori ynë i madh, të cilin pata fatin ta kem edhe profesor edhe kujdestar klase për katër vite me radhë në Gjimnazin e Prizrenit. Por edhe më vonë, për tërë jetën, ne mbetëm nxënës të tij të devotshëm, të përkushtuar në rrugën e ndritshme drejt Lirisë. Historia mbështet në fakte dhe faktet janë shumë kokëfortë. Faktet janë si muret e kështjellës, na thoshte profesori, e në këto mure gjakoset vetëm populli, pasi vetëm ai është i aftë t'i pushtoi **KËSHTJELLAT**. Në kështjella hyjnë të palagur dhe si "TRUMFATORË" heronjtë e rremë, siç ka ndodhur shpesh në histori, potenconte profesori ynë i dashur.

Për katër vite me radhë unë thitha nektarin e diturisë që na jepte i madhi profesor Berisha, për të cilin unë e ndjej veten shumë të vogël të jap vlerësim meritor, sepse në jetën

time kurrë nuk kam parë edhe një njeri më të gjithdishëm dhe më enciklopedik se profesorin e profesorëve, Qazim Berisha. Ai na ligjëronte gjuhën frenge dhe gjuhën latinishte, por sa herë ndodhte të mungonte ndonjëri nga profesorët e lëndëve **matematikë, filozofi, psikologji, histori, gjuhë shqipe, gjeografi, fizikë, kimi etj.**, atëherë profesori Qazim hynte në klasë dhe vetëm na pyeste se cilën njësi metodike e kishim mësuar orën e fundit, dhe pastaj vazhdonte të ligjëronte me zërin e tij melodioz që dilte nga thellësia e shpirtit të tij, ndërsa ne ngelnim gojëhapur dhe pyesnim veten: **vallë ku i ka mësuar profesori gjithë këto dije enciklopedike?** Ai kishte aftësinë që për një nocion, për një dukuri, mund të bënte një oqean me shpjegime në horizontale dhe vertikale, por edhe **nga ai oqean arrinte të bënte sintezën dhe e reduktonte oqeanin e dijeve në një pikë!** Qëllimi didaktik dhe pedagogjik i profesorit nuk ishte vetëm të na ngarkonte me bagazhin dituror, por të na mësonte dhe udhëzonte si mëma fëmijën, **se si duhet të arrihen dijet, si duhet të kalitet vullneti për të arritur dijet pa të cilat përherë do të ngelnim skllevër e shkuar skllevërish.** Por profesori ynë ishte i palodhur dhe e njihte mirë artin e **FJALËS**, dhe ajo kurrë nuk ishte e gjatë për dëgjuesit e tij. Ata që kishin fatin të dëgjonin ligjërimet e profesorit Qazim me orë të tëra ishin të kënaqur dhe e anulonin vlerën e kohës, sepse në fushën e elokuencës ishte padyshim një kompetent, dhe se diskutimi i tij më i gjatë ishte diskutimi më i mirë. Fjala ishte për profesorin instrumenti bazë i suksesit, është pikëmbështetësja e levës së Arkimedit, dhe pikërisht duke pasur para sysh këtë fakt profesori **mëtonte të na bënte folës të shkëlqyer, të zotë për të joshur një sallë të tërë të mbushur me dëgjues të moshave dhe gjinive të ndryshme**. Ai i njihte mirë se cilat janë sekretet e artit të oratorisë për të folur në publik, për të bindur dëgjuesit, për të ndikuar tek ndjenja e për ta dominuar publikun duke i krijuar entuziazmin. Kur fliste në publik profesori thoshte vetëm atë që kishte për të thënë, asnjë fjalë më shumë, dhe këtë e thoshte pa zbukurime retorike apo

akrobacira stilistike. **Para Qazim Berishës kapitullonte çdo autoritet kushtetor , sepse para vullkanit të fjalëve të tij askush nuk guxonte t'i dilte përpara**. Profesori ynë i dashur kurrë nuk i shkruante diskutimet e tija, asnjë shënim, sepse e dinte se publiku është një përbindësh me mijëra kokë dhe atë mund të arrini ta dominoni vetëm duke fiksuar vazhdimisht sytë tuaj mbi të tijtë. **Fjala e zjarrtë, gjestet e ekuilibruara, shikimi zhbirues, lëvizjet prej artisti të shkathët e dinjitoz, të gjitha këto të bënin të kujtoje se para jush është një Demosten, një Sokrat, një Ciceron apo një Aleksandër Mosiu**. Më kujtohet kur një herë derisa po flisnim se cili ishte artisti më i mirë në botë, profesori na tha shkurt: më i miri artist është **Çarli Çaplin...**

Në vitin 1987 më kujtohet kur kishim shkuar bashkë me profesorin Qazim te **Salih Basha** i Vraniqit, dhe në bisedë e sipër dikush e pyeti profesorin: Çfarë mendoni ju profesor, a mund ta krahasojmë **Enver Hoxhën me Skënderbeun**? Dhe, pa u hamendur, profesori na drejtohet me fjalët" **jo, iu gjet e mira, sepse Skënderbeu e kishte shumë më të lehtë se sa që e kishte Enver Hoxha, sepse arsenali i armatimit sot është mijëra herë më i tmerrshëm, më shkatërrues, me këto raketa atomike, me sistemin teledirigjues të komandimit dhe vëzhgimit, dhe përballë gjithë këtyre avantazheve të superfuqive botërore, SHBA dhe BRSS, vetëm një ante siç ishte Enver Hoxha mund të bënte sfidën me mospërfillje dhe guxim heroik. Enver Hoxha ishte Skënderbe e shkuar Skënderbeut, dhe i vetmi që iu kundërvu ngritjes së MURIT TË BERLINIT në vitet e gjashtëdhjeta, i vetmi që para 81 partive komuniste në Moskë në nëntor 1960 ua përplasi në fytyrë revizionistëve hrushqovianë gjithë të vërtetën dhe arriti të kthehej shëndosh e mirë në Shqipëri,** përfundoi bisedën profesori i lavdishëm. Profesori nuk jepte vetëm mësim, por edhe shpirt. Nxënësit inteligjent shikonin shpirtin e profesorit në sytë e tij! Profesori e dinte mirë faktin se njerëzit e kanë zakonin që ta konsiderojnë kulturën e madhe të një tjetri pothuaj si një **FYERJE për injorancën e tyre**, dhe më kollaj e falin një shuplakë se një përulje. Profesorit i interesonte

gjendja shpirtërore dhe konsideratat e dëgjuesve. Profesori me timbrin specifik dhe kumbues të zërit si bilbili bëhej edhe më tërheqës, dhe kishte zotëruar gjimnastikën e frymëmarrjes në përgjithësi, dhe kjo falë sportit të gjimnastikës, ecjes, notit, ushtrime këto që kanë epërsinë të zgjerojnë kraharorin e të rrisin fuqinë e mushkërive. Profesori ishte zotërues absolut i zërit të tij dhe kishte korda vokale shumë të fuqishme sa që kurrë nuk ka ndodhur që dikë ta zinte gjumi para oratorit Qazim Berisha, i cili duke bërë disa pushime të shkurtra, duke ngadalësuar ritmin e të folurit, arrinte ta përqendronte vëmendjen e dëgjuesit. Papritur, me magnetizmin e tij, me gjallërinë e tij, shkundej plogështia e përgjithshme e dëgjuesve...

Pakkush e di peshën e pazakontë të këtij pedagogu e filozofi, askush nuk shikon vullkanin që ziente çdo çast në shpirtin e tij të zjarrtë. Kurrë nuk na fliste për veprën e tij, për bëmat e tij, për të kaluarën e vet, kurrë nuk u mburr për punën e dobishme që kishte bërë për të mirën e atdheut dhe të popullit, me zor mund t'i shkëputësh ndonjë fjalë, sepse nuk e kërkonte LAVDINË. **Lavdia e kërkonte profesorin dritëdhënës!** E ne nxënësit e tij sa herë shkonim në shëtitje kur përfundonim klasën këndonim vargjet e zjarrta kushtrimdhënëse të poetëve mëmëdhetarë dhe kështu i përkujtonim profesorit shqipet e lirisë, partizanët trima, bashkëluftëtarët e tij që ranë në fushën e nderit për çlirimin dhe bashkimin e gjithë trojeve nën okupim, dhe të gjithë me një zë këndonim këngën luftarake:

O trima luftëtar e bijtë e Skënderbeut,
Kërkoni ju shqiptarë lirinë e mëmëdheut,
Se mjaft në robëri, o e mjera Shqipëri,
O djem rrëmbeni pushkët, ja vdekje ja Liri!

LAVDI E PËRJETSHME PROFESORIT TË PAVDEKSHËM QAZIM BERISHA!



Afrim Morina,
profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, veprimtar i paepur i çështjes kombëtare, i burgosur politik disa herë me radhë nga regjimi fashist jugosllav, duke vuajtur dënimin nëpër kazamatet e tmerrshme që nga Prizreni e deri në Pozharevc.

Afrim Morina

BASHKIMI FORCON ATDHEUN
(Concordia patria firmat)

Në vitin 1966 u hapën shkollat e mesme, normalja dhe gjimnazi në Therandë, si paralele të ndara të normales dhe gjimnazit në Prizren. Edhe profesorët udhëtonin nga këto dy qendra shkollore. Kjo mundësoi që të përfshihen pothuaj të gjithë nxënësit që kishin mbaruar shkollën fillore, madje të pranoheshin edhe nga shkollat tjera fillore jashtë komunës sonë. Fillimi i vitit shkollor kishte vështirësi, sepse udhëtimi i profesorëve ishte problematik për kohën.

Pata nderin ti takoj asaj gjenerate, që më vonë do të jetë edhe bartëse e disa proceseve në shkollë dhe më gjerë. Kuadri ishte në nivel, por kënaqësia më e madhe ishte të njihesha me profesorin e nderuar, ndoshta një nga mësuesit (filozofët) dhe poliglotët e rrallë të kohës, Qazim Berishën. Ne kishim dëgjuar për te nga nxënësit që vijonin mësimin në gjimnazin e Prizrenit, që na e paraqitnin si të

rreptë, sepse kërkonte disiplinë dhe ishte i shtrenjtë për nota. Erdhi edhe dita e parë që do të mbanim mësim me te dhe të gjithë nëpër banka rrinim të strukur, se na kishin thënë, se po qese të merr një herë në sy vaj halli. Koha e orës mësimore kishte filluar dhe Ai nuk dukej ende. Ne filluan të lëviznim nëpër klasë, kur për një moment u hap dera, u duk një kokë me flokë të çrregullta pak të rëna dhe vetëm pëshpëriti:

- **Fol për ujkun, ujku pas dere** (në gjuhën latine)- dhe e mbylli derën.

Këto fjalë për ne ishin të panjohura dhe u ngritëm të gjithë në këmbë për të shkuar nga dera duke buzëqeshur. Përsëri u hap dera, hyri një burrë i shtyrë në moshë, me një palë rroba mesatare, me një çantë bukur të madhe për trupin e tij dhe me një zë të qetë e të butë na u drejtua,

- Uluni të dashur, unë jam profesor Qazim Berisha dhe së bashku këtë vit do të mësojmë gjuhën latine.- Ishte një prezantim i shkurtër dhe i shpejtë.

E përcillnim lëndën e Tij me përkushtim, pak nga frika, por edhe na dukej lëndë tërheqëse, sepse ai arrinte ta bënte këtë me përkujdesën më të madhe, duke ilustruar për ato që shpjegonte, që sa më mirë ta përvetësonim.

Pasi kaluan disa njësi mësimore, sipas emrave në ditar, pata fatin të dal i pari për të shkruar në dërrasë të zezë. Kisha edhe frikë, sepse asnjëri nuk e dinte për kriterin e notave dhe metodën se si pyeste. Më tha ti shkruaja tri fjali në gjuhën latine:

- Historia është mësuesja e jetës
- **Bashkimi forcon atdheun**
- Hëna është satelit i tokës

Me përkujdesën më të madh i shkrova që të tria fjalitë. Në klasë kishte rënë një heshtje. Edhe miza po të fluturonte do të dëgjohej. U afrua afër meje, me shtat ia kisha kaluar dhe më bërryl u mbështet në mua

- **I dashur e di ti çfarë ke shkruar?**

Unë i habitur fillova edhe një herë të shikojë se mos kisha bërë ndonjë gabim. Me mimikë i dhashë për të

kuptuar se nuk shoh farë gabimi. Ai sikur u xhindos, filloi të më mëshonte me grushte lehtas në cep të krahut, me bërryl filloi të më trus afër qafës dhe dikur u largua nga unë dhe filloi të shkonte te secili nxënës duke iu bërtitur dhe rënë me grushte lehtas dhe duke i pyetur se çka kisha bërë. Unë vidhja shokët me bisht të syrit që të më korrigjonin se ku kisha gabuar. U binda se gabime nuk ka dhe profesori pasi e kreu me të gjithë nxënësit, mu afrua qetas, tash kishte ndryshuar edhe pamjen edhe qëndrimin dhe edhe një herë më tha:

- Nuk e din se çfarë ke bërë?... Jo ti nuk e di... E, i dashur, **e di ti se sa gjaku është derdhur në këtë Suharekë që gjuha latine të shkruhet zyrtarisht!?**

E ku ta dija unë atëherë peshën e këtyre fjalive, kur dihej se çfarë historie kishim mësuar në shkollë? Më vonë do të kuptojë se nëpër çfarë peripecish kishte kaluar shkolla shqipe dhe kombi shqiptar.

Më vonë, sa herë takoheshim, gjithnjë kur u ndanim, nuk lente pa ma përkujtuar, se **bashkimi forcon atdheun (konkordia patria firmat**), sepse kishte nuhatur se merresha me politikë.

Me te kaluam vetëm një vit shkollor, sepse vitin tjetër erdhi ta zëvendësonte tjetri. Herë pas here takoheshim në Prizren, në fillim i ndrojtur, por më vonë krijuam raporte shoqërore dhe shumë herë e kam pyetur për problemet shoqërore, historike etj. kërkoja literaturë, interesohesha për disa personalitete etj. Ai ishte i pa lodhshëm dhe nuk përtonte dhe nuk i dhimbsej koha nëse kishte arritur të sqarojë gjërat për të cilat ishe i interesuar.

Pas kryerjes së shkollës së mesme kisha kontakte më shpesh me të, isha më i pjekur dhe pyetjet më nuk ishin naive sikurse kur isha nxënës gjimnazi.

Kur kishte tema bukur me peshë, të natyrës së historisë jo të largët të cilat konsideronte se dikush tjetër ishte më me kompetencë, më orientonte dhe më sugjeronte të thirresha në emër të tij. Këtë pothuaj asnjëherë nuk e kam preferuar, por këmbëngulja që nga ai të marr

përgjigje. Një herë më pati sugjeruar të bisedoja me **Xhavit Lopardin** dhe më porosit që ta gjeja kur kishte lucia intervale (momente të ndriçuara, sepse organet e UDB e kishin torturuar në skajshmëri dhe vështirë e kishe që ta shtyje të përqendrohej në bisedë). Për te kisha dëgjuar dhe e njihja si endacak, shëtiste vetëm, i heshtur, me rroba të vjetra dhe më kishin fol edhe të tjerët, mirëpo nuk e kam ditur se edhe profesor Qazimi e vlerësonte. Qytetarët e Prizrenit e trajtonin si njeri të çmendur, si njeri të rrugëve etj., por nuk ishte ashtu. Ky referim më zgjoi kureshtjen dhe mu deshtë kohë për ta takuar Xhavitin. E takova dhe në Shatërvan u ulëm me një tavolinë dhe nga ai pata mësuar shumë gjëra që nuk më kishte rënë ti lexoja as në shtypin ilegal të kohës. I tregova profesor Qazimit, u gëzua si fëmijë dhe më porositi të mos i ndahesha, se në këtë fushë mund të mësoja shumë nga ai. Kur më arrestuan në vitin 1981, veç tjerash më patën pyetur edhe për kontaktet që i kisha pasur me Xhavitin.

Një herë më duhej përkthyer një dokument për vëllanë nga gjuha gjermane, për të marrë kuptimin, kur papritmas e takojë profesor Qazimin. Përshëndetemi dhe i tregoj qëllimin e shkuarjes në Prizren, mori dokumentin , e lexoi në gjuhën shqipe dhe ma dha, duke shtuar

- Para hotel Therandës është një lustraxhi këpucës, shko te ai se është përkthyes zyrtar, ose mund të shkon edhe te profesoresha e nderuar, Elvani

- Profesor, ajo që më interesonte e mora vesh, kjo më mjafton

- I dashur duhet zyrtarizuar përkthimin, unë vetëm ta lexova shqip- dhe më shtyu në drejtim të hotelit.

Unë e kisha kryer punën me te dhe nuk më interesonte më tepër.

Se sa ishte i përkushtuar të ishte parimor për të udhëzuar në zënien e diturisë, të mos humbte as një orë mësimi, është edhe një anekdotë për të

Këshilli i Gjimnazit "Jovanka Radivojeviq- Kica" diskutonte zgjedhjen e drejtorit. Për kandidat kishte

profesor Luigj Lumezin. Këtij nuk ia kishte qejfi të pranonte këtë detyrë, por të refuzonte do t'i dilte problem me Komitetin e Partisë, prandaj u mundua të gjej një arsye:

- Ju lutem mos ma vëni këtë barrë, ka tjerë profesor që mund të jenë më të suksesshëm se unë. Unë nuk mundëm, ta zëmë, t'i them profesor Qazim Berishës, pse je vonuar.

- Jo i dashur- foli qetas profesor Qazimi- Nëse unë vonohem pesë minuta në mësim, dërgo një nxënës te varret dhe shiko nëse është duke u hapur një varr i ri, e nëse jo, dërgo në spital për të verifikua a gjendem aty, dhe që të dyja për fat janë shumë afër.

Demonstratat e vitit 1981 kishin bërë jehonë dhe pushteti kishte vu në përdorim gjithë arsenalin propagandistik e policor, duke rekrutuar njerëz të rinj, të cilët qoftë nga frika, qoftë nga paraja apo edhe nga dhënia e mundësisë për të qenë dikush, për të parandaluar tensionimin e situatës politike. Kishin filluar edhe diferencimet në çdo mjedis, duke filluar nga kreu i Komitetit Krahinor e gjerë në celulat nëpër fshatra. Këto diferencime bëheshin edhe në shkolla të gjitha niveleve, të cilat kishin për qëllim të ngushtonin veprimtarinë e iredentës dhe të zbulonin nacionalist të rinj. Ne disa që nuk ishim burgosur ende, përcillnim situatën në teren dhe mundoheshim të ju ndihmonim. Edhe në gjimnazin e Prizrenit kishin shkuar aktivistët e Komitetit për të detyruar profesorët që të diferencoheshin nga demonstruesit. Asnjëri nga profesorët nuk lëshonte zë, sepse në mesin e tyre ishte profesor Qazim Berisha, të cilit i frikoheshin nëse jepnin mendim negativ për protestuesit, e në anën tjetër ishte komiteti i partisë, i cili menjëherë ua ndërpriste marrëdhënien e punës edhe mund ti burgoste nëse nuk e bënin një gjë të tillë.

Qazim Berisha pa hezituar e merr fjalën:

- Një jogurt dhe një gjysmë buke kushtojnë një dinar e gjysmë- mëngjesi. Një jogurt dhe një gjysmë buke kushtojnë një dinar e gjysmë- dreka. Një jogurt dhe një

gjysmë buke kushtojnë një dinar e gjysmë- darka. Gjithsejtë këto bëjnë katër dinar e gjysmë. Katër dinar e gjysmë është shpenzimi ditor vetëm bukë e jogurt, herë tridhjetë ditë bëjnë 135 dinar. Pa i llogaritur shpenzimet tjera për jetën e një studenti. Dhe nëse llogaritni kështu, do të vini në përfundim se a kanë pasur apo jo të drejtë të protestojnë ata.

U krijua një heshtje. Përfaqësuesit e Komitetit, duke e ditur mentalitetin e profesor Qazimit, **pa bërë zhurmë u ngritën dhe ikën.**

Pas daljes nga burgu u takuam edhe disa herë. Një herë i pata thënë që të merrej me shkrime, qoftë në shtypin ilegal me nofkë apo edhe atë të huaj, sepse gjuhët nuk paraqitnin problem për te. **Më pati thënë, se nuk është i pendës dhe ka kush merret me to**. U mundova mjaftë për ta bindur, por kot. Më vonë kam mësuar se edhe shokët tjerë kishin insistuar që ai te merrej me shkrime, por pa sukses.

Me daljen në skenë të **Lidhjes Demokratike e Kosovës,** ai ishte në spital, ku iu kishte nënshtruar një operacioni. Kisha kundërthënie me shokë rreth kësaj, të cilët insistonin që të kyçesha edhe unë në këtë subjekt politik. Mora vesh se kishte dal nga spitali profesori dhe ishte më mirë, i morra disa shokë dhe shkuam në shtëpinë e tij për ta vizituar. I blemë nga pak dardha, banane, portokaj dhe trokitëm në derën e tij. Pak vonoi derisa e qeli derën. Nëpër të gjithë dhomën ishin të hapura gazeta në gjuhë të ndryshme dhe mbi tavolinë kishte një shishe raki rrushi, së cilës gati i kishte rënë në fund. U përshëndetëm dhe ia ofruam dhuratën. Kur i pa, mu drejtua:

- I dashur, ti e di që unë gjatë tërë jetës time nuk kamë ngrënë kaq shumë kokrra pemësh.

E kuptoi se ne nuk kishim shkuar vetëm për ta parë që kishte dalë nga spitali, por kishim edhe një hall tjetër. Na shikoi drejtë në sy.

- Hë, i dashur, çfarë halli keni?

- Profesor, Ju e dini se ka dal një subjekt politik, pra Lidhja Demokratike e Kosovës, çfarë mendimi keni për te?

- **A po blen populli rrëgalla (orendi)**?

- Po.

- **Kur të ndalen së bleri rrëgalla(orendi të kushtueshme), ne do të çlirohemi!**

Me këtë na dha për të kuptuar, se biseda rreth kësaj teme kishte përfunduar. Njëri nga ne u mundua ta ngacmojë për të fol edhe diçka. Mirëpo, ai nuk binte lehtë në provokime dhe mu drejtua:

- **I dashur, isha i kartë rreth kësaj?**

- Po profesor, të faleminderit.

Pas një kohe u ngritëm dhe u thash se përgjigjën time e morët nga profesori. Duhet ndalë blerjen e orendive dhe këto para të shkojnë në armatim.

Ky ishte takimi i fundit me profesor Qazim Berishën, se më vonë u burgosa dhe pastaj kalova në Prishtinë, që në mungesë të profesor **Ukshin Hotit** të udhëhiqja Partin e Unitetit Kombëtar Shqiptar- UNIKOMB.

Një ditë duke kaluar nëpër Prizren, pashë një rrugë që mbante emrin e tij, edhe pse ky emër është nderë të ishte mbi ndonjë derë shkolle të Prizrenit, ku edukoi me dhjetëra gjenerata, pothuaj në të gjitha lëndët, kur e lypte nevoja në mungesë të kuadrove, por më rëndësi që dikujt iu kujtua që edhe ky emër të jetë i respektuar, e koha do të bëjë të vetën.

Prishtinë, 12.10.2009



Profesor Behxhet Berisha, veprimtar i palodhshëm, i cili arsimoi dhe edukoi shumë gjenerata nxënësish në gjimnazin e Therandës, dhe gjithnjë qëndroi i pathyeshëm në rrugën drejtë çlirimit dhe bashkimit kombëtar.

Behxhet Berisha

LIGJËRIMET E PROFESORIT QAZIM BERISHA ISHIN MË TË FORTA SE KRISMAT E GJITHË TOPAVE TË SERBISË

Të dish të flasësh do të thotë të dish të edukosh e të dish të edukosh do të thotë të bëhesh i pavdekshëm nëpërmjet koncepteve për pasardhësit e për ata që të ndjekin. Dhe profesor Qazim Berisha ishte njëri ndër të rrallët që e zotëronte shkëlqyeshëm artin e të folurit dhe edukimit, dhe mu për këtë u bë i pavdekshëm për pasardhësit dhe për ata që patën fatin të dëgjojnë ligjëratat e tij plot gjallëri e elokuencë. Dhe të dish të flasësh është çështje cilësie, jo sasie, dhe pikërisht për të arritur këtë cilësi janë të nevojshme: shpirti, maturia, thjeshtësia, inteligjenca, gadishmëria, zëri, mimika. Me të gjitha këto cilësi dispononte profesori ynë i dashur , ndaj të flasësh për profesorin Qazim Berisha, për personalitetin e tij, menjëherë të kap një emocion i veçantë, dhe ndjehesh para një detyre të vështirë nga droja se nuk do arrini të thoni atë që duhet thënë për këtë erudit të rrallë. Besoj se para këtyre vështirësive është gjendur edhe autori i këtij libri kur u zotua për të përshkruar pulsin shpirtëror dhe mendor të këtij edukatori dhe mësuesi të madh.

Kur bisedoja me ish-nxënësit e tij, dhe i pyesja se çfarë mendonin ata për mësuesin e tyre, ndaleshin për një çast, dhe

pastaj me admirim fillonin t'i shpalosnin mbresat që kishin ngelur të pashlyera në kujtesën e tyre. Pothuaj se të gjithë pajtoheshin me faktin se profesori Qazim ishte një e **enciklopedi e gjallë.** Njëri prej tyre mbante mend çastin kur profesori Qazim kishte hyrë në klasën e tyre për ta zëvendësuar profesorin e matematikës, bllok orë, dhe nxënësit me një zë i drejtohen me fjalët:

-**Profesor, tani kemi matematikë!**

-E po mirë, matematikë do bëjmë, ishte përgjigjur profesor Qazimi. Ia lëshon një shikim tabelës me plot numra të detyrës ende të pa përfunduar të profesorit të matematikës, i cili i kishte porositur nxënësit të mos e shlyenin tabelën. Profesori Qazim fiksoi se ku kishte mbetur pa u zgjidhur detyra, **pastroi tabelën, dhe për habinë e të gjithve e përfundoi detyrën** me sqarime përcjellëse duke i lënë nxënësit gojëhapur. I tillë ishte profesori me aftësi të gjithanshme, i cili përveç lëndës së gjuhës frenge, pastaj gjuhës latine, mund të ligjëronte pa asnjë ndrojtje edhe lëndët tjera si logjikë, filozofi, histori, gjeografi etj.

Me autorin e këtij libri shpesh e kemi vizituar profesorin në banesën e tij në Prizren, e sidomos gjatë viteve 1992-1993. Hynim në kuzhinë mirë të ndriçuar, me orendi të thjeshta, dhe rreth e rrotull krevatit dhe mbi tavolinë shihje plot libra dhe revista të ndryshme, dhe sa herë e kemi vizituar e kemi gjetur me një libër në dorë duke lexuar. Meqë ishte i moshuar përveç se ulur rrinte edhe gjysmë i shtrirë në një krevat klasik, me federë. Ai nuk i ushtonte rëndësi luksit, nuk identifikohej me gjësendet. Pasuria e tij më e madhe ishte biblioteka në tavanin e ndërtesës, e rregulluar dhe e rrethuar me llamarinë për t'mos i dëmtuar minjtë librat. Mbaj mend kur në gjimnazin "Jeta e re" në Therandë, në vitin shkollor 1980-1981, profesori kishte ardhur nga Prizreni në cilësinë e anëtarit të komisionit për temat e diplomës nga gjuha frenge. Pasi u përshëndetëm me të një arsimtar po na tregonte me mburrje se kishte ndërtuar një shtëpi moderne dykatëshe. Profesori po e shikonte në sy folësin dhe iu drejtua me fjalët:

-Me siguri me material të fortë, që qëndron qindra vjet... dhe me siguri edhe me basen sipër ndërtesës, që të lahen vetëm fëmijët tuaj! Këtë ironi të profesorit as që e kishte kuptuar arsimtari i gjorë. Profesori nuk e zgjaste shumë me njerëzit e tillë mburravecë të cilët mezi presin të tregojnë sa janë të pasur duke e kompensuar kështu mungesën e vlerës së botës së tyre shpirtërore.

Sa herë jemi takuar me profesorin ai kurrë nuk e fillonte bisedën me fjalët e zakonshme: Si jeni? Familjen si e keni? Por me një takt të rrallë e fillonte bisedën duke u kapur për diçka krejt të vogël, dhe pastaj nga kjo trampolinë dalë ngadalë kalonte në temë interesante. Ashtu si Migjeni që pikturoi me fjalë gjendjen sociale të shtresave më të varfëria, anatominë e mjerimit, edhe profesori Qazim kur e analizonte një çështje apo një dukuri e kapte atë në tërë kompleksitetin e saj. Pikëpamjet e tij ishin të sakta, të argumentuara deri në imtësi, duke mos lënë asnjë vend për mëdyshje. Kishte një aftësi të rrallë intuitive, dhe përmes gjysmë të vërtetave vinte deri te e vërteta, duke potencuar se gjysmë e vërteta është më e rrezikshme se RRENA. Gjatë fushatës së diferencimeve politike(policore) gjatë vitit 1981 që po bëhej nëpër shkollat e Kosovës secili arsimtar duhej të deklarohej publikisht se a ishin apo nuk ishin ARMIQËSORE demonstratat e studentëve në Prishtinë më 1981. Përballë subjekteve politike të Komitetit të Prizrenit profesori e merr fjalën i pari, **për t'mos i lënë të tjerët të deklaroheshin dhe nga droja se do t'i flaknin në rrugë sikur të thoshin se demonstratat ishin apo nuk ishin armiqësore, dhe me ironi dhe cinizëm** iu drejtohet autoriteteve komunale me fjalët:

-Po, armiqësore janë, por për kë, për Beogradin apo për Prishtinën?! Dhe me këtë përgjigje lapidare tubimi mori fund, autoritetet politike e lëshuan sallën, dhe gjithë trupit arsimor iu lehtësua frymëmarrja dhe shpëtuan nga ky presion psikologjik. Por nga ky çast edhe profesor **Qazim Berisha më kurrë nuk arriti të kap ditarin dhe të ligjërojë para nxënësve të tij të dashur...**

Temat e natyrës historike profesori i shtjellonte nga këndvështrimi dialektik i shkakut dhe pasojës, në funksion të kohës dhe hapësirës, në ndërvarshmërinë dhe ndërndikimin reciprok, dhe jo ndaras. Sa herë i dëgjonim ligjëratat e profesorit zbulonim secilën herë se sa të mangëta dhe të pa sistemuara janë dijet tona. Jo se nuk kishim lexuar e studiuar, por nuk e kishim studiuar me kompetencë dhe në mënyrë sistematike as lëmin e fushës së ngushtë shkencore, dhe për këtë e ndienim veten para tij si nxënës. Ai ishte unikat në relativizmin e gjerave, dhe dukurive nuk iu vinte pikë, por çështjet i analizonte nga shumë këndvështrime. Ishte një analitik i shkëlqyeshëm dhe me një intuitë të rrallë parashikonte gjerat. Një herë e pyetëm se çfarë do bëhet me Kosovën nesër kur për momentin po vuanim të zitë e ullirit nën thundrën ushtarako-policore të Beogradit. Po, na tha profesori duke na shikuar drejt në sy e duke qeshur, më bëni një kafe e ta kthejmë filxhanin, e pastaj të shohim se çfarë është halli e çfarë thotë falli për ne të gjorët që ende po presim që të tjerët të na sjellin lirinë? Edhe një herë tjetër këmbëngulëm dhe i bëmë pyetjen e njëjtë dhe profesori kësaj radhe na tha shkurt:

-Në vitin 2000 Kosova do bëhet Republikë, ndërsa në vitin 2020 do bashkohet me shtetin amë, Shqipërinë! Ishte viti 1993 kur e dha këtë parashikim profetik, i cili u bë realitet, ndërkaq për parashikimin e dytë duhet të presim se si do zhvillohen ngjarjet. **Para profesorit Qazim e ndienim veten si para një filozofi të antikës greke, si para një Sokrati të gjallë.** Dhe mu për këtë na ka mbetur peng në zemër se si nuk arritëm në rolin e Platonit për t'i vjelë dijet enciklopedike të profesorit në mënyrë të organizuar që brezat të disponojnë me këtë thesar të rrallë. Kjo është një humbje e madhe, një lëshim i pafalshëm, sepse të rrallë ishin martirët si Qazim Berisha që me zjarr dhe me alarm theksonin se kombet të cilat e pranojnë PAQEN NË ROBËRI janë dyfish të robëruara, ekonomikisht dhe moralisht.

LAVDI E PËRJETSHME JETËS DHE VEPRËS SË PROFESORIT QAZIM BERISHA!

Ali Kurti, veprimtar i palodhshëm i çështjes kombëtare, i cili edukoi dhe arsimoi shumë gjenerata nxënësish, jurist i diplomuar, i cili përherë qëndroi i pathyeshëm përballë stuhive të regjimit fashist jugosllav

ALI KURTI

PROFESOR QAZIM BERISHA- FLAKADAN I PASHUAR QË NA NDRIÇOI RRUGËN DREJT LIRISË DHE BASHIMIT KOMBËTAR

Gjithçka është e shtrenjtë në Atdhe- guri e druri, rrugët e rrugicat...Gjithçka, po mbi të gjitha, kujtimi i atyre që tërë jetën u sakrifikuan për të na ndriçuar rrugën drejt lirisë dhe bashkimit kombëtar, siç ishte profesori gjenial Qazim Berisha. Edhe unë, si shumë të tjerë, pata fatin dhe privilegjin ta njoh profesorin Berisha përmes vëllait tim, Bajramit, i cili shpesh me thoshte: *"Ali, a do shkojmë te profesori Qazim?"* Dhe unë me kënaqësinë më të madhe e shoqëroja vëllain tim, sepse profesori ai kishte një diapazon të madhë dijesh enciklopedike dhe na fliste me kompetencë për tema të ndryshme nga fusha të ndryshme të dijes, që nga historia kombëtare e deri te revolucionet dhe luftërat çlirimtare të popujve të robëruar të botës. Mendja e tij gjeniale nuk njihte tundime, lodhje, ngurrime,

pasiguri, dhe i mjaftonin tri ose katër orë gjumë që sërish të punonte me të njëjtën energji të kthjellët dhe rrezatuese. Ne nxënësit e tij ishim të bindur se po qëndronim përballë një enciklopedie të gjallë që percepton botën vetëm me syrin e trurit, dhe ishim të lumtur nëse arrinim të kishim aq kondicion dhe të thithnim tërë ato dije që na jepte, racionin e asaj dite, dhe ishim të vëmendshëm që mos t'ia bjerrim kohën të cilën ai e çmonte me fanatizëm. Forca e vërtetë e mendjes së tij qëndronte në aftësinë e tij që secilit problem t'i qasej në tërësinë e tij, duke bërë analizën dhe sintezën e shkaqeve dhe pasojave të kundërthënieve shoqërore. Ashtu si rrezet e dritës, mendja e tij depërton kthjellët përmes të gjitha të çarave të fshehta, duke mos lënë asgjë pa ndriçuar. Ne ishim të vetëdijshëm se dijet tona janë të përcipta, horizonti ynë pafundësisht më i ngushtë, dhe kishim etje të përhershme për dije që të gjenim fillin e gjerave dhe problemeve kaq të ngatërruara në një shoqëri që po përpëlitej nën zgjedhën e robërisë jugosllave. Ligjëratat e tij plot elokuencë, fjalët e tij të zjarrta hynin në ndërgjegjen tonë dhe të mbarë kombit si vetëtima ndriçuese, si rrufe shungulluese, aq sa dridhej e tërë ngrehina e kalbur e një superstrukture të pushtetit kolonialist. Tanimë profesori ishte bërë simbol qëndrese, tribun i të gjitha dëshirave dhe i të gjitha aspiratave kombëtare për çlirim dhe bashkim. Ai na inkurajonte me fjalët shpresëdhënëse se populli së shpejti do zgjohet, dhe ky zgjim do të jetë zgjim i furishëm, zgjim i luanëve, zgjim i vullnetarëve të lirisë kundër kolonizatorëve jugosllavë.

Profesori Qazim na mësonte se ne dhe vetëm ne jemi përcaktues të fatit ose fatkeqësisë sonë, dhe për këtë na përkujtonte thënien e urtë –NJIH VETEN TËNDE, të drejtat tua, detyrimet tua, vlerat tuaja, historinë e kombit tënd dhe të njerëzimit, historinë e luftërave çlirimtare të popujve të kolonizuar, sepse duhet të kemi një marrëdhënie të përzemërt me veten tonë para se të kërkojmë që ta kenë edhe të tjerët ndaj nesh. Dhe nëse në

këtë rrugë të jetës ne jemi të paplotë dhe të PAPËRSOSUR, atëherë ne do të jemi përherë të vonuar, përherë të robëruar dhe përherë pjesë e PROBLEMIT dhe jo pjesë e zgjidhjes së problemit që është cilësi vetëm e atyre që kanë moral kryengritës, të papajtueshëm me moralin e të nënshtruarve, të cilët janë pajtuar me gjendjen e tyre prej skllavi. Profesori kishte një DURIM fenomenal dhe i duronte me qetësi vështirësitë dhe sprovat dhe kishte një harmoni dhe ekuilibër të brendshëm të jashtëzakonshëm. Ai na përkujtonte SOKRATIN i cili u detyrua të gëlltiste kukutën me helm ngaqë u bë kryengritës ndaj imoralitetit të kohës së tij. Profesori poashtu na përkujtonte **Diogjenin,** humanistin e lashtësisë, i cili me fener në dorë endej rrugëve të Athinës , ditën me diell, dhe thoshte se po kërkonte-NJERIUN! Kështu, edhe profesori mendjendritur falë aftësisë gjeniale të tij të jashtëzakonshme me **"fenerin e Diogjenit"** e hetonte se cili prej vizitorëve i meriton mësimet dhe ligjëratat e tij filozofike, dhe cili injorimin dhe ndëshkimin e merituar. Ai gjatë ligjëratave të tij i përmbahej thënies së urtë të Naim Frashërit-*Vetëm dritë e diturisë përpara do të na shpjerë!* Një theks të veçantë profesori ia kushtonte këtyre çështjeve:

Së pari, çështjes së PADITURISË, dhe shtonte:
" ÇDO PADITURI DUHET TË PAGUHET së paku 50%...sepse sa më i informuar që të jetë njeriu aq më i sigurt është..." Në këtë kontekst profesori na fliste për planet ogurzeza të armiqve tanë, dhe shtonte:

"Armiqtë e shqiptarëve...dolën haptas me idenë që shqiptarëve të shkolluar t'ua hiqnin kokat, ndërsa të pashkolluarve të mos u jepnin shkollimin e duhur, sepse , mendonin ata, çdo shqiptar i shkolluar është një armik më shumë për Jugosllavinë...", dhe pastaj vazhdonte ligjëratën me këto fjalë: "Dukuritë negative na ndodhin sepse njerëzit janë të katandisur në terrin e paditurisë, dhe po PRITOJNË TË MENDOJNË ME KOKËN E TYRE... I padituri e ka FAJIN më të madh dhe të pafalshëm...dhe

goditjet e para i marrin ata që nuk kanë mësuar sa duhet e çka duhet..."

Së dyti, profesori kërkonte PËRGJEGJSHMËRI dhe disiplinë të hekurt në punë dhe merrte si shembull zellin, disiplinën dhe përgjegjshmërinë e japonezëve për punën. Prindërve u sugjeronte këtë këshillë pedagogjike: " Duhet të kemi kujdes që mos t'i edukojmë fëmijët me hipokrizi, sjellje dyfytyrëshe...Prindërit duhet t'i edukojnë fëmijët që të mësohen se si fitohet kafshata e gojës, dhe t'ua lëmë trashëgim të vetmen PASURI- VIRTYTIN E PUNËS..."

Së treti, rëndësi të veçantë i kushtonte emancipimit kombëtar, dhe kërkonte vetëdijesim, vetëdijesim dhe vetëm VETËDIJËSIM! Dhe pastaj thoshte: " Me vendimet e AVNOJ-it çështja jonë kombëtare ishte tradhtuar...sepse dihet se që nga viti 1912-1941 me ligjin kushtetues të Jugosllavisë ka qenë e paraparë që shqiptarët të zhdukeshin dhe mos të ekzistonin si komb, , por i njëjti avaz po vazhdon edhe sot nga pasardhësit e këtyre fashistëve me damkë..."

Profesori potenconte faktin e papjekurisë sonë politike dhe thoshte: " Në luftën partizane ne nuk kemi qenë të pjekur politikisht, sepse besonim në premtimet e rrejshme jugosllave duke bashkëpunuar me partizanët jugosllav, se gjoja pas përfundimit të luftës ata do të na pranojnë të drejtën e VETËVENDOSJES deri në shkëputje..." Dhe pastaj na fliste lidhur kolaboracionistët, bashkëpunëtorët e armikut, dhe thoshte -

"KUISLINGËT dhe marionetat tona nuk mund t'i krahasojmë as me PLEHUN, sepse pushtuesi i jep përparësi dhe i privilegjon vetëm ata të cilët nuk e konsiderojnë veten shqiptar.."

Pas luftës për ÇLIRIM, vazhdonte profesori, luftë edhe më e madhe se lufta frontale është lufta me këmbëngulë dhe me i kërkua armikut llogari për të gjitha dëmet e shkaktuara njerëzore dhe materiale..." Dhe pastaj vazhdonte ligjëratën duke na thënë:

“ Duhet të na vijë TURP që ne sot jemi me vetëdije më të ulët se rilindësit, se Pashko Vasa...

“...Më shumë se buka dhe uji neve na duhet abetarja, dituria, gjuha shqipe, sepse pa gjak e sakrifica nuk fitohet LIRIA...”

Nuk ka gjë më poshtëruese dhe më jonjerëzore se sa kur dikush e pështyn vetveten në fytyrë dhe lejon për ta mashtruar të tjerët...”Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, profesori e vlerësonte si aktin më të lartë pas Luftës së Dytë Botërore në drejtim të realizimit të objektivit strategjik: NJË GJUHË, NJË FLAMUR, NJË KOMB, NJË SHTET!”.

Në jetën time kurrë nuk kam pasur rastin të njoh dhe të takoja ndonjë njeri me aq erudicion dhe horizont dituror nga shumë fusha të dijës si Qazm Berisha.

Së katërti, çështja më e shenjtë për të cilën në çdo çast duhet të sakrifikohemi është LIRIA, thoshte profesori dhe shtonte se për të arritur këtë objektiv duhet të kemi GUXIM, GUXIM DHE VETËM GUXIM... dhe theksonte se – “Ne duhet të TURPËROHEMI për këtë VONESË kaq të madhe , për këtë gjendje prej skllavi nën zgjedhën e robërisë jugosllave...” Ndërsa për inteligjencien servile të Kosovës profesori jepte këtë vlerësim:

“...Më parë se sa për çlirimin e atdheut inteligjencia jonë po lufton për një standard të rrejshëm personal, për një kolltuk më të mirë, për një pozicionim në hierarkinë pushtetore si kuisling në shërbim të okupatorit...” dhe shfrynte mllefin e urrejtjes dhe thoshte:

“ Këta servilët tanë më parë pranojnë me jetua si QEN se sa si NJERËZ...Por vetëm REVOLUCIONI MUND T’I ÇRRËNJOSË KËTO GFJERA ABSURDE JONJERËZORE, dhe atëherë VDEKJA PËR LIRI do të na vijë si përjetimi më i ëmbël dhe më i bukur në jetë...”

LIRIA E FALUR ËSHTË MË E RREZIKSME SE ROBËRIA, shtonte profesori duke parafrazuar fjalët e filozofit Xhuzepe Macini. Nëse nuk e paguajmë ÇMIMIN E LIRISË, atëherë ne jemi duke kërkuar gjera të

pamundshme, përfundonte profesori , dhe na paralajmëronte se koha do të tregojë më së miri se sa jemi mashtruar me këto marrëveshje dinake në Rambuje dhe sa kanë ndikua rrjetat agjenturore në përpunimin e delegatëve që nuk ishin gjë tjetër veç se pengje në KËSHTJELLËN BURG DIPLOMATIK të Rambujesë mbi të cilët po bëhej presion psikologjik për të nënshkruar sa më parë kapitullimin duke pranuar sovranitetin dhe integritetin e Jugosllavisë mbi Kosovën!? Ndërkaq insistimi i diplomacisë botërore për një nënshkrim të njëanshëm, vetëm nga pala shqiptare, do të ishte thjesht një KAPITULLIM i njëanshëm dhe pa kushte, dhe çdo nënshkrim i delegatëve shqiptarë do të ishte një tradhti, sepse do të dilnin para botës si njerëz naivë , analfabetë politikë, që nuk dinë ose nuk kuptojnë se çfarë bëjnë. Kërcënimi nga ish-senatori amerikan **Bob Doll** se mosnënshkrimi i dokumentit nga delegacioni shqiptar mund t'u kushtojë shqiptarëve HUMBJEN edhe të asaj përkrahjeje që kanë pasur deri tani në SHBA, dhe ky është një shantazh i ri drejtuar komandantëve në frontin e luftimeve dhe **Adem Demaçit** i cili e kundërshtoi ashpër nënshkrimin e një dokumenti të tillë komprometues e kapitullues. Dhe si në dritën e diellit profesori sa e sa herë na kishte thënë se në çastin kur t'i e kupton mashtrimin dhe thua më kanë mashtrua, atëherë ti po pranon se je dallkauk ose tradhtar, sepse të mos vetëdijesohesh edhe pas gjithë kësaj lufte heroike dhe gjithë këtij gjaku të derdhur për pavarësi dhe çlirim nga kolonizatorët jugosllavë është gjëja më e tmerrshme në botë. Por të gjithë e kanë ditur konceptin paraprak se konferenca e Rambujesë është thirrur në bazë të konceptit- NUK KA PAVARËSI PËR KOSOVËN, dhe epilogun e gjithë këtyre prapaskenave profesori Qazim na kishte bërë të qartë me kohë *(të mos harrojmë se ditën e nënshkrimit të marrëveshjes së Rambujesë profesori Qazim nga tronditja e thellë për këtë tradhti brofi nga shtrati ku po lëngonte dhe më nuk e mori vetën kurrë deri më 6 prill kur i mbylli*

sytë përgjithmonë) , ndërsa ne e kuptuam më mirë vetëm ditën kur Mitrovica u nda përmes lumit Ibër, dhe 33% të territorit të Kosovës ngeli nën juridiksionin serb me 11 komuna dhe 47 kisha ortodokse serbe me mija kilometra territore të okupuara (vetëm kisha e Deçanit mban mbi 800 hektarë sipërfaqe...), ndërkaq vetëm në fshatin OSOJAN të komunës së Burimit bëjnë roje ditë e natë, të armatosur deri në dhëmbë një kontingjent i tërë forcash të KFOR-it me një efektiv prej 300 ushtarësh e oficerësh gjoja për t'i mbrojtur nga shqiptarët *147 kolonista serbë,* dhe të gjitha këto po bëheshin në përputhje me rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244. Mirëpo këto parashikime rrëqethëse të profesorit Qazim i vërtetoi edhe ish-kryetarja e të burgosurve politikë të botës, intelektualja amerikane, **ALICE MEAD,** e cila veç tjerash theksoi edhe këtë:

"KOLONIALIZMI është shuar gati në tërë botën, përveç në KOSOVË, ku ai mbetet konstant, dhe që nga viti 1912 Kosova ishte dhe ende është KOLONI E SERBISË. NATO-ja nuk e "NXORI" Kosovën(d.m.th. nuk e ÇLIROI) me të ashtuquajturën - "luftë humanitare" në vitin 1999, sepse Serbia tanimë e kishte humbur Kosovën qysh në vitin 1989, për shkak të gatishmërisë së Serbisë që Kosovën ta trajtojë si KOLONI, në kohën kur epoka e kolonializmit kishte kaluar që moti, aparteidi kishte marrë fund. Vendimi për NDARJEN E MITROVICËS dhe vendosjes së kontrollit serb mbi 30% të territorit të Kosovës ishte pjesë e paramenduar e planit të Serbisë, i cili është përpiluar në qershor të vitit 1998, nëse jo edhe më herët. Ndërkombëtarët duhet të bëjnë HETIME rreth kolonializmit të Kosovës që nga viti 1913, hetime rreth masakrave, dëbimeve me dhunë dhe gjenocidit që nga viti 1913-1999 (Shih: Alice. Mead, "ZËRI", 21.06.2002).

Mësuesi i mësuesve, Qazim Berisha, është emër i shekujve, i cili midis Skillës së HARRESËS, dhe Karibdës së VDEKJES, ka kapërcyer cakun e rrezikshëm, për të realizuar ringjalljen e vet përmes këtyre pak fragmenteve

filozofike, të cilat falë punës së palodhshme të profesor Kurtit arritën ta shohin dritën e botimit, për të na përkujtuar subjektin e Orfeut të lashtësisë i cili përmes TINGUJVE të harpës urtësonte kafshët e egra në pyll. Urojmë që në të ardhmen kjo ringjallje të bëhet më e plotë përmes një monografie duke vjelë tërë të dhënat relevante për rrugën e jetës dhe veprës së profesorit legjendar, që nga periudha e fëmijërisë, mosha e djalërisë, koha e shkollimit fillor dhe të mesëm , koha e veprimtarisë ilegale dhe e luftëtarit të LNÇ-së, periudha e studimeve, koha kur punoi si spiker i parë i Radio Zagrebit dhe redaktor i gjuhës frëngjishte, koha kur punoi si profesor i Matematikës në Gjimnazin e Ogulinit, koha kur punoi në mbledhjen e materialit filologjik për Fjalorin Etimologjik të Gjuhës Shqipe, puna në Gjimnazin e Prizrenit dhe në Fakultetit Filologjik në Prishtinë dhe deri në ditën e 6 prillit, kur u nda nga ne vetëm fizikisht. Po kjo gjë do kërkonte një angazhim tepër serioz dhe dinjitoz.

Kjo përmendore letrare kushtuar profesorit gjenial dhe liridashës Qazim Berisha, rrezatoftë për jetë të jetëve , brez pas brezi, në rrugën tonë të lavdishme deri në realizimin e amanetit të rënëve për liri dhe bashkim kombëtar!

Në fund , duhet të theksojmë se data *6 prill 1999* nuk është ditëvdekja, por ditëlindja e profesorit Qazim Berisha, sepse ai tërë jetën e tij ia kushtoi çështjes së atdheut dhe revolucionit. Ndërkaq, duhet të potencojmë se është meritë e autorit të këtij libri që këto pak shënime kujtimesh, vetëm 10% e tyre, të cilat i shpëtuan dorës gjakatare serboçetnike po e shohin dritën e botimit në dhjetë vjetorin e ndarjes nga jeta të profesor Berishës dhe po e përjetësojnë jetën dhe veprën e tij heroike. Kjo përmendore letrare kushtuar profesorit gjenial dhe liridashës Qazi Berisha, rrezatoftë për jetë të jetëve , brez pas brezi, në rrugën tonë të lavdishme deri në realizimin e amanetit të të rënëve për liri dhe bashkim kombëtar!

Fragment nga Ditari i Luftës, i kujtimeve të vajzës së profesorit Qazim Berisha

Florina (Berisha)
Mullafetaku

Nga ditari
6 prill 99

Më 6 prill më vdiq babai. Mëngjezi i 6 prillit, ora 7, 30 ishte e kobshme për mua, i mbylli sytë përgjithmonë në këtë ditë, njëra prej ditëve të tmerrshme të luftës. Bombardimet e NATO-së vazhdojnë, dhe atë natë u thyen xhamat e dritareve, u bënë copë e grimë, ai ishte në gjumë të thellë apo ndoshta në agoni, nuk e di. Ditët e fundit më tepër rinte në këtë gjendje, nganjëherë mendojsha se kjo ishte më mirë, sepse nuk i ndiente dhembjet e trupit. Mundohesha të shkoj shpesh, gati për çdo ditë, e ushqeja, mirëpo ditën e fundit nuk i shkonte dhe kjo më dhimbte shumë. Të nesërmen nuk e gjeta më gjallë. Më vinte keq pse u keqësua në kohën kur kishim më së shumti nevojë për te, për fjalët e tij, për parashikimet e gjendjes aktuale, që në këto momente më duket aq e tmerrshme dhe pa rrugëdalje. Më kujtohet vera e kaluar, kur luftërat zhvilloheshin nëpër fshatra, ndërsa qytetet ishin pak të trazuara, e frikësuar shpesh e pyetsha se athua do të qetësohet dhe rregullohet sadopak gjendja, e ai duke buzëqeshur thoshte se ajo nuk ishte asgjë, lufta mund të zgjërohet në përmasa më të mëdha, duke i përfshirë të gjitha qytetet me radhë, por jo edhe shkaktimi i luftës ballkanike ose botërore, sepse kjo nuk u shkon interesave të asnjërës palë. Shpesh thoshte se për të fituar pak nevojiten sakrifica të mëdha të popullit shqiptar. Popullit tonë i mungon uniteti, edhe në momentet më të vështira kur kjo i nevojitet më tepër se kurr, bashkimi, njëmendësia, toleranca, ata vazhdonin avazin e vjetër me akuzime, divergjencë mendimesh, e kjo e mundonte shumë. Thoshte se i forti gjithnjë fiton, ndërsa gjendja në të cilën ndodhet populli ynë është rezultat i dobësisë së tij. Këte e tregoi edhe historia, vuajtjet e popullit tonë janë të kohërave më të lashta, me batica dhe zbatica u zvarritën nëpër shekuj dhe tani na u gjetëm në vorbullën e kësaj stuhije, edhe gjeneratat tona duhet paguar , ato që paguan shumëkush para nesh e që ndodhin për shkak të pozitës strategjike që gjindet vendi ynë. Shpesh babai thoshte se lufta nuk filloi në këtë vit, por shumë vite më parë, qysh prej vitit 1981 duke bërë pauza të kohëpaskohshme, ndërsa viti 1998-1999 paraqet një fluks i derdhur nga kupa e mbushur vite me radhë, duke krijuar një rrëmujë të vërtetë. Edhe në kohën kur ishte shumë i sëmuar, kur u mbajtë konferenca e Rambujesë për paqe, konferenca e dytë, thoshte se e githë ajo ishte e pavërtetë, nuk do të jep kurrfarë rezultatesh; dhe ashtu u bë, nuk dha asnjë rezultat, por përkundrazi vazhdoi me të vjetrën. Kur NATO filloi të sulmojë, pushteti serb kryente punët tjera, po bënte spastrimin etnik, gati ¾ e poullsisë shqiptare u dëbuan, ndërsa ¼ mbeten në Kosovë. Prej tyre, rreth 300.000 u dëbuan në Shqipëri, 140.000 në Mal të Zi dhe po aq në Maqedoni. Çka është më e keqja, pritet edhe numri i ri i refugjatëve. Kështu, brenda 1 muaji u dëbuan gjithsej 600.000 – 700.000. Kjo është e tmerrshme. Po çka do të bëhet me ne që kemi mbetur nuk dihet, fati ynë ndoshta është edhe më i zi.

Babain tim e varrosëm me një shpejtësi të madhe – gjendje lufte. Atë ditë ishim prezent vetëm familja jonë e ngushtë, dhe halla me dy vajza. Sa i thjeshtë u bë varrimi i tij, ashtu siç kishte dëshiruar gjithnjë, pa solemnitet, pa pompozitetet e zakonshme që përcjellen rastet e tilla, me një modesti të veçantë që diktonte koha e që rastësisht përputhej me dëshirën e tij. Gjersa e shiqojsha fytyrën e tij të pajetë, e kisha diç më lehtë, sepse dhembjet i pushuan dhe kishte marrë një pamje më të qetë, trupi i tij prehej në amshim, pa vuajtje, pa dhembje. Nga ana, tjetër dëshiroja përsëri ta shoh ashtu siç ka qenë më heret, të bisedojë gjatë, të analizojë gjendjen aktuale që është plagë e vjetër për të gjithë, t'i dëgjojë edhe një herë fjalët e tij, kështillat, analizat, sintezat që dinte aq mirë t'i bëntë, mirëpo nuk mundi, u lodh, ndoshta nuk desha të kuptoj se donte të pushojë përgjithmonë, ishte tepër i lodhur dhe mbahej me mundim të madh, që vetëm ai mund ta bënte. Kishte shumë vullnet të madh për jetë, moral të fortë sa që më vinte çudi se si mund të bënte biseda aq serioze në një gjendje aq të rëndë. Kisha pasë dëshirë të trashëgoj një pjesë të moralit të tij, por fatkeqësisht kjo nuk ndodhi, kam trashëguar vetëm pjesën fizike, ndërsa pjesën psiqike nuk kemi mundur asnjëri të trashëgojmë, ai mbeti mbi të gjithë, unikat, me të gjitha të mirat dhe dobësit, i jashtëzakonshëm në çdo pikëpamje, mënyrës së jetesës, mënyrës së të menduarit, pikëpamjeve të ndryshme jetësore.

Në përkujtim të ...

(6 - prill - 1999)

Jemi mbledhur sot
si për çdo mot
më përkujtimin tënd
do pijmë kafenë për ty
në këtë pranverë
dhe përherë do jemi me ty

Derisa shikoja pontretin tënd
kujtimi imazhin tënd sjell
si femiko shfaqej një jetë e pajetuar
e përvuajtur, e trishtuar
vemdi shembej, nëmohej
~~zemra~~ digjej, përvëlohej
mymzynë e tmerrshme mbolhte
Kosova lotonte
çdo lot ujiste lule e bar me mallëngjim
përdhe turmëm gë ikte më mëngim
vriste lulet kunorë gë hidhnim shtatin si selvi
pa përkëdhelje, pa dashuri, më vetmi
dhembja zemrëm kishte mbrydhur
çdo fjalë ishte e ngurtë

Derisa agu shfaqi agimin
një gramatë lëshoi kushtrimin
munet tundeshin, binin
krater-varreve mihmin
pjesëmarrësit pluhur ngritnin
derisa bëheshim ~~m~~ shkrumb e hi
shpirti yt ~~ik~~ humbi në përjetësi!

Florina (Berisha)
Mullafeto, prill, 2005

VAZHDIM I LIGJËRATAVE TË PROFESORIT QAZIM BERISHA NGA MUAJI KORRIK-GUSHT 1991

LIGJËRATË, 8 korrik 1991:

Ekspertët ushtarak të armatës jugosllave që nga viti 1948 , pas Rezolucionit të Informbyrosë, u specializuan në SHBA , por më vonë, pas viteve të gjashtëdhjeta, edhe në BRSS, dhe dihet se dy superfuqitë e armatosën Jugosllavinë me tërë arsenalin luftarak më modern...

Kosovës po i kërcënohet rreziku nga armata jugosllave, dhe për këtë Shqipëria nuk guxon të rrijë duarkryq, sepse mbi 50% e shqiptarëve jetojnë nën zgjedhën e robërisë serbe-malaze-maqedone...Pas vitit 1981 popullit shqiptarë në Jugosllavi i janë hequr edhe ato pak të drejta të cilat ua garantonte Kushtetuta e vitit 1974, dhe tani në Kosovë po ushtrohet terrori dhe diskriminimi më i zi i cili po ia kalon edhe aparteidit Jugafrikan....Serbia po i armatos me armët më moderne gjithë kolonët serbomalazez në Kosovë, dhe bandat ultraçetnike paramilitare vetëm po presin çastin për të masakrua shqiptarët e paarmatosur...Nënat e Ulqinit protestuan që bijtë e tyre të mos i dërgojnë në shërbimin ushtarak në Armatën jugosllave për t'i bërë mish për top në frontet e luftimeve në Kroaci...

Që nga **2 korriku 1990** e këtej me hapjen e ambasadave italiane, dhe vendeve tjera , Shqipërisë iu dha një goditje e rëndë , sepse komploti ishte përgatitur me decenie të tëra si revansh-hakmarrje për gjithë atë qëndresë heroike të pushtetit popullor shqiptar përballë rrethimit të egër imperialist-revizionist... Në këtë kontekst Kosova po e luan **rolin e varrtarit potencial,** sepse në vend që të përgatitet për çlirim dhe dekolonizim nga

krijesa artificiale Jugosllave ajo po merret me formimin e partive politike të cilat po regjistrohen në Beograd te Ministri i Drejtësisë, Vllado Kumbovski, dhe asnjëra prej këtyre partive plu

raliste kozmopolite nuk e ka në programin e saj **ÇLIRIMIN E KOSOVËS me vise...** Tani në Serbi në pushtet kanë ardhë stërçetnikët e Millosheviqit dhe vojvodë Sheshelit të cilët mezi presin për të bërë gjakderdhje mbi shqiptarët e Kosovës, por hë për hë ata duan t'i pastrojnë hesapet në Kroaci dhe Bosnjë...

LIGJËRATË, 15 korrik 1991:

Vetëvrasjet më të mëdha sot po bëhen në vendet me standard të lartë ekonomik...Por ky fenomen nuk ekziston në Shqipëri...

Që nga viti 1715 Suedia nuk ka hy në luftë...Poashtu edhe Danimarka me shekuj nuk ka hy në luftë...Ndërsa Norvegjia më 1812 u bë shtet i pavarur pa luftë me sunduesit suedez të cilët në parlamentin e Mbretërisë suedeze të gjithë votuan për ta pavarësua **Norvegjinë, ndërsa deputetet e kombësisë norvegjeze** të gjithë votuan për të qëndrua edhe më tej nën sundimin e suedezëve...!?

Finlanda për 203 vjet me radhë ishte nën sundimin rus (1715-1918)... Edhe Finlanda e cila kishte jetua 500 vjet nën sundimin e Suedisë është rast karakteristik, sepse edhe këtu nuk u derdh gjaku për të arritur deri te pavarësia, dhe për këtë ndikuan tre faktorë:

1. **Faktori objektiv** (i jashtëm) , sepse shpërtheu ***REVOLUCIONI i tetorit në Rusi më 1918..,*** carizmi kapitulloi, dhe në Kushtetutën sovjetike ishte garantuar e drejta e vetëvendosjes deri në shkëputje...

2. **Faktori subjektiv** (i brendshëm) bëri mrekulli, sepse të gjitha shtresat dhe klasat u bënë një për ta fitua pavarësinë;
3. Faktori i tretë është **faktori gjeostrategjik,** sepse Finlanda është jashtë gardhit dhe nuk ka pozitë gjeostrategjike, dhe se deti Baltik është i mbyllur...

Më 1940 për 3-6 orë armata e kuqe e BRSS-së i okupoi Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë të cilat ishin nën sundimin Suedez...Me marrëveshjen Stalin-Mollotov –Ribbentrop më 1939 ishin marrë vesh për këtë, dhe kështu armata e kuqe i pushtoi këtØ tri vende si pika shumë strategjike për ta mbrojtur Leningradin...

Gruzianët e kishin shtetin 2000 vjet para rusëve, dhe me kulturë e shkrim ishin të ngjashëm me kulturën dhe shkrimin e persianëve , siç është të na rasti i grekëve të lashtë...

Grekët e morën shkrimin prej palestëve - fenikasëve... Dyndja e popujve të Azisë Qendrore në mesjetë nën udhëheqjen e Atilës...KAUKAZI ishte PORTA e dyndjeve të popujve në relacionin Azi-Evropë dhe Evropë-Azi...

GABELËT-e kanë ruajtur gjuhën pak a shumë prej nga kanë ardhur, ndërsa MAGJUPËT e kanë marrë gjuhën e atij vendi në të cilin janë ngulitur...KARAVLLAHËT bredhin nga gjashtë muaj si nomadë, se ata kanë ardhur prej Indisë, përmes Rusisë (Shih-Novelën e Maksim Gorkit-MAKARÇUDRA, bajraktari-karavllah, Aleks M. Pjeskov...).

Evropa me heshtjen e saj e ndihmoi Jugosllavinë për ta shkatërrua REVOLUCIONIN DEMOKRATIK në Shqipëri ... Dhe kjo u bë në dy fronte- me përgatitjen e Ahmet Zogut me ekipin e Kryezinjve që ta rrëzojnë Qeverinë demokratike të Fan Nolit dhe Bajram Currit, dhe nga ana tjetër Armata jugosllave organizoi sulmin mbi forcat e Lëvizjes çlirimtare - kaçake të Azem dhe Shotë Galicës, duke e sulmuar nga të gjitha anët me

tërë arsenalin e artilerisë së rëndë, siç pohon kryeçetniku Dragisha Vasiq në librin e tij - **DVA MJESECA NA JUGOSLLOVENSKOM SIBIRU**- Dy muaj në Sibirin jugosllav)...

Por te ne nuk janë bërë analiza të mirëfillta rreth **LUFTËS GUERILE....**

Pjesa më e madhe e fshatarësisë dhe tërë klasa punëtore janë majtistë, janë për barazi dhe socializëm...Shqipëria në mënyrë INDIREKTE ka kontribuar në afrimin e Kinës me SHBA-në, sepse intensivisht ishte përfaqësuese e Republikës së Kinës në OKB për 10 vite me radhë deri sa Kina u pranua në OKB më 1974...Dhe deri tani amerikanët ishin mirënjohës për rolin e Shqipërisë si STABILIZATOR në Ballkan, dhe nuk ka lejua që ta sulmojë askush...sepse përzënia e bazave ruse nga Sazani e Pashalimani ndikoi në zhbllokimin e bazave amerikane në bregdetin Italian duke ia kursye kështu SHBA-ve miliarda dollarë në vit...Amerika i dha urdhër Greqisë me e ndërpre gjendjen e luftës me Shqipërinë(1940-1970) dhe me e njohtë shtetin shqiptar, sepse deri atëherë Greqia nuk kishte kurrfarë marrëdhëniesh me Shqipërinë, as politike, por as ekonomike për 30 vjet me radhë...I vetmi shtet në Evropë në të cilin Kina kishte mbështetje pa asnjë rezervë ishte Shqipëria...Edhe Niksoni, kryetari i Amerikës, shkoi në Kinë me ngrënë pilaf përmes Shqipërisë...Por pas vitit 1975, pas vdekjes së Mao Ce Dunit, dhe ardhjes në pushtet të bandës së katërshes(aty ishte edhe gruaja e Mao Ce Dunit) marrëdhëniet shqiptaro-kineze morën tatëpjetën...Vetëm 8 vjet zgjati REVOLUCIONI KULTUROR NË KINË, se po të kishte zgjatur më shumë Kina kishte me mbarua...Ndërkaq në Shqipëri ky revolucion zgjati 24 vjet (1966-1990), dhe po supozojmë se sikur të kishte zgjatur ky REVOLUCION edhe 10 vjet nën rrethanat e një bllokade të hekurt ekonomike edhe Shqipëria kishte me

mbarua...Shqipëria-ishte Kina e Evropës, dhe Kina-Shqipëria e Azisë...Kina e sundoi 500 vjet Indokinën, bashkë me Vietnamin, dhe për këtë vietnamezët i konsiderojnë kinezët siç i konsiderojmë ne turqit...Vietnamezët janë popull luftarak dhe 16 vjet luftuan me Francën, deri në vitin 1954 dhe pas kapitullimit të kolonizatorëve francezë në **Dien Bien Fu** luftën e vazhduan amerikanët deri në vitin 1975 kur Vietnami Verior e fitoi pavarësinë pas 15 vjet lufte heroike, dhe amerikanët u tërhoqën me faqe të zezë...Kështu pas 31 vjet luftë e pabarabartë me superfuqinë botërore Vietnami pagoi një çmim shumë të lartë me 3 milion viktima dhe çdo pëllëmbë toke ishte bërë shkrumb e hi, por arriti të bashkohet me Vietnamin e Jugut, dhe vija e demarkacionit-kufiri përmes paraleles 17 u zhduk përgjithmonë...**Dhe krahasoni paqen tonë në ROBËRI, dhe ëndrrat që po i shohin këta betera me këto parti politike, që të gjitha janë-DALLAVERE, sepse lirinë askush nuk ta falë, por duhet ta fitojmë ashtu siç e fitoi populli heroik vietnamez...**

SERBIA i ka punët ngushtë, sepse ajo po lufton për ekzistencë, sepse nuk ka dalje në det, dhe është sikur me pasur shtëpi, por mos me pasur derë të oborrit...dhe ka pozitë gjeostrategjike sepse përmes magjistrales Selanik-Shkup (Lugina e lumit Vardar) - Beograd-Budapest lidhet Azia me Evropën, dhe përveç kësaj duhet ta dimë se Serbia është subjekt ndërkombëtar që nga Kongresi i Berlinit(1878) qe 120 vjet..., ndërsa Shqipëria u pranua si subjekt ndërkombëtar më 1912, dhe kjo e sakatosur me 70% të territorit jashtë shtetit amë...

Jugosllavia u formua më 1918 në Zagreb duke i falënderua priftit katolik Shtrosmajerit, sepse kroatët menduan se kanë hasap me u bashkua me serbët...Deri më 1917 me Nikolla Pashiqin Serbia ishte kundër formimit të Jugosllavisë, sepse ideologjia që nga

Garashanini e këtej bazohej në projektin hegjemonist të Serbisë së Madhe duke përfshi edhe Dalmacinë...Faktori i jashtëm ndikoi në Ballkan me depërtimin e katolicizmit me synim që të shtrihej deri në Detin e Zi...

Me ndarjen e Jugosllavisë ndahen edhe sferat e interesit, sepse gjermanëve u hiqet qafe Amerika...Shtrausi gjatë vizitës në Shqipëri tha se ne kemi çdo gjë, por lirinë nuk e kemi...Ai bisedoi se si mund të arrijmë marrëveshje për të blerë në Shqipëri krom, naftë, hekur, uran, sepse ato gjera nuk i disponon Gjermania...

Bajraktarët e revolucionit duhet të kenë kujdes e të mos bëhen shumë konservativë, duke mos shikua se sa është ora, sepse shumë lehtë nga revolucionari mund të shndërrohesh në kundërrevolucionar, nëse e vazhdon GJUMIN deri në drekë... sepse pikërisht kjo e mirë, ky gjumë i ëmbël bëhet VDEKJEPRURËS, dhe këto janë ligjet e rrepta të NËNËS DIALEKTIKË e cila secilit i jep copën që meriton...Edhe lakrat rasor që janë ilaç midis dimrit, një muaj pas Shën Gjergjit bëhen HELËM...Parimet janë vartësi.., sepse me qenë TRIM, s' do të thotë me qenë budalla...

DOGMATIZMI është i rrezikshëm, sepse duhet me qenë i aftë për t'i ndihmua edhe vetvetes, por edhe të tjerëve...

Profesor, çfarë mund të na thuani më shumë për Lidhjen Demokratike të Kosovës-LDK-në?

LDK-ja është lidhje e partive por pa një traditë historike, e formuar këtu e një vit e gjysmë më parë, me një laramani të madhe, me shumë mosmarrëveshje, dhe që në zanafillë i mungon rrënja...Edhe para 100 vjetësh u formua Lidhja shqiptare e Prizrenit, me Abdyl Frashrin në krye, por me ata konzervativistë ishte si

nata me ditë, dhe mendonin se është më mirë të kishim një Autonomi nën një shtet të huaj, sesa nën shumë shtete(1878-1918), pra me jetua në të njëjtën Perandori, në të njëjtin burg, në të njëjtin varr, por së bashku, e jo në shumë BURGJE...

Që nga koha e Ilia Garashaninit(1844) e deri sot më së shumti kanë punua Serbia e Jugosllavia që shqiptarët të bashkohen nën Serbi dhe Jugosllavi, por edhe pas Luftës së Dytë Botërore vazhdohet me të njëjtin avaz, por nën parullën-bashkim-vëllazërim, që do të thotë-**bratski zagërlaj- smrtonosni zagrlaj (përqafim vëllazëror-VDEKJEPRURËS)...**

Rusia-kërthiza e Serbisë, sepse përmes Serbisë Rusia i mbron interesat e saj në Ballkan...Dy parëve iu intereson Jugosllavia, edhe kështu siç është me zorrë nëpër këmbë, sepse Serbia ka shumë përparësi, me katër vota...

LIGJËRIME, 18 korrik 1991:

Shqipëria për ne është gjëja më e shenjtë, dhe nëse ne i shohim atje vetëm burgjet, i kujtojmë vetëm të zezat, vetëm privacionet, vuajtjet, disiplinën e rreptë etj. kjo do të thotë se jemi duke e mashtrua vetveten, sepse deri sot askush nuk ka bërë shaka, (hangarë), me Shqipërinë, bile edhe armiku është bindur se Shqipëria është-**ARRË E FORTË...**Ne i kemi katër kisha, katër religjione të ndryshme, por asnjërën nuk e kemi me ideologji kombëtare, por kozmopolite, dhe kështu pothuaj jemi **i VETMI VEND NË BOTË që ka shtet, por nuk ka kishë kombëtare!?** Pashko Vasa na ka lënë manifestin me poemën-O MOJ SHQIPNI E MJERA SHQIPNI, se **FEJA E SHQIPTARIT ËSHTË SHQIPTARIA...**Përparësia e gjithë këtij mozaiku religjioz duhet të përdoret si dëshmi se ne nuk jemi të lidhur vetëm për një civilizim, por kësaj mortaje ne përherë ia kemi parë sherrin...Të marrim si shembull gjermanët të cilët i kanë vetëm dy kisha, dy religjione,

katolikë dhe protestant, por sa shumë ia kanë parë sherrin, po ne që i kemi katër religjione...Bizmarku që ishte Protestant hyni në luftë me Habzburgët(katolikë)...Borgjezia e nxori nga gjiri i saj një Hitler, një hipokrizi e madhe, dhe në skenë del nacional fashizmi, botimi gjerman i FASHIZMIT...Çetnikizmi sot ka elemente naziste me ato aradhet paraushtarake çetnike, të cilat e kanë zanafillën që nga viti 1903, ndërsa njësite të tilla naziste u formuan edhe në Gjermani 20 vjet (më 1923) pas aradheve çetnike...dhe të tilla njësite formoi edhe Xhafer Deva gjatë okupimit gjerman që kanë vra e kanë pre në kuadër të Gestapos-policia e fshehtë...

Profesor, kemi dëgjuar edhe për oficerin Shaban Basha nga Peja, çfarë mund të na thoni më shumë për të?

Shaban Basha e kishte të kryer akademinë ushtarake në Itali, në Bergamo, me gradën kapiten, dhe pastaj qysh gjatë studimeve në shkollën e oficerëve ishte rekrutua, dhe iu dha detyra me u inkuadrua dhe me i përcjellë brigadat internacionaliste në Luftën e Spanjës më 1936, por mbetet enigmë për të ditur se cila ishte detyra e tij...por edhe e Mehmet Shehut..., sepse edhe në Francë nuk u internuan, ndërsa kur e pushtoi Italia Shqipërinë Shaban Basha u bë perfekt në Shkodër, dhe pastaj sekretar i komitetit fashist...Edhe Mehmet Shehu ishte në internim në Francë, bashkë me Velko Vllahoviqin, por edhe për këtë nuk e dimë saktësisht se cili ishte roli i tij dhe detyrat e tij, por dihet se Franca Veriore kapitulloi në qershor 1940, por nuk dimë si arriti Mehmet Shehu deri në Itali...dhe pastaj të inkuadrohet në brigadat partizane, deri edhe komandant i Brigadës së Parë...

Edhe rasti i oficerit **Xhafer Kodra** nga Dibra është shumë domethënës...pasi e kreu gjimnazin në Shkodër

e kreu edhe akademinë ushtarake, por e likuiduan, dhe vdiq në Parisë nga plagët e rënda...Babai i tij ishte milioner...U vranë edhe shumë të tjerë në luftën e Spanjës si Asim Vokshi, Xhemail Kada, Teni Konomi, Urfi Agolli, Zef Hoti, Ramiz Varvarica e shumë të tjerë, por shpëtuan Shaban Basha, Mehmet Shehu etj.

ARSIMIM do të thotë –aftësim për filtrimin e gjerave, për të mos i marrë gjerat e përcipta, formale, si gjera esenciale, thelbësore...Arra nuk hahet pa ia qëruar edhe dy mbështjellësit e mëparshëm...Ne po i marrim gjerat kuturu, të rrumbullakuara, dhe po i barasvlerësojmë si komunistët si antikomunistët, dhe për të qenë turpi edhe më i madh po shkojnë deri aty sa po thonë se **Enver Hoxha është si Millosheviqi?!**Pse e thonë këtë broçkull? E thonë sepse kanë hesap...Edhe vojvodë Shesheli, kryeçetniku ka qenë anëtar i Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë...Dhe mos të harrojmë se **çdo kryengritje nuk është revolucion, sepse revolucionin nënkupton përmbysjen radikale e rendit të mëparshëm ekonomiko-shoqëror...**

Elementet komuniste e kanë zanafillën qysh para 10.000 vitesh...sepse në esencën e secilës FAMILJE funksionon elementi KOMUNIST-punon sipas aftësive dhe merr sipas nevojës,,,siç e kemi rastin e fëmijëve të cilët ushqehen, por nuk kanë prodhua të mira materiale, por askush nuk iu thotë ikni nga familja se nuk keni punua asgjë...Kur themi - u shkatërrua KOMUNIZMI d.m.th. e vramë vetveten, që do të thotë se paska pasur komunizëm- ndarja dhe realizimi i të ardhurave sipas parimit komunist-secilit punon sipas aftësive dhe merr sipas nevojës..Ose çfarë të themi për familjen, kooperativën patriarkale me 30, 40 dhe 60 anëtarë të familjes? Sot për fyerjen më të rëndë po e përdorin fjalën KOMUNIST, e dihet se edhe krishtenizmi fillestar kishte elemente komuniste, p.sh. Kur thuhet-mos me ia dashtë të keqën askujt (Uti pictat)...Kur ecim vetëm nëpër tepih, këmba çoroditet, shmoklavet, por

edhe vetëm nëpër ferra këmba shkatërrohet, nuk është e mundur...Teoria pa praktikën është e vdekur, praktika pa teori është e verbër, thoshte Lenini...E kundërta e fashizmit është komunizmi...**Dashuria ndaj vetvetes VËRTETOHET përmes dashurisë ndaj të TJERËVE...**

EGOIZMI POZITIV është i domosdoshëm, sepse nuk mund të ecim përpara pa ambicien për ta tejkalua tjetrin, por me kusht me e ruajt DINJITETIN E TJETRIT, dhe kjo nuk shihet askund më mirë se sa në fushën e gjimnastikës, sportit...Nuk mund të mësosh not në tepih, por duke u futur në ujë, basen, lumë, det, pra duke u fundosur, dhe duke mësuar not, dhe këtu vjen në shprehje elementi pozitiv i egoizmit...dhe nëse absolutizohet ky element, atëherë vjen në shprehje ana NEGATIVE e egoizmit, i cili mund të kalon në formën më ekstreme-RACIZËM, por edhe e mira nëse absolutizohet kthehet në të kundërtën e saj, por edhe revolucioni kthehet në kundërrevolucion, ose NACIONALIZMI kthehet në NACIONAL-FASHIZËM, dhe pastaj me fitoren e këtij nacionalfashizmi të Adolf Hitlerit shkojnë edhe 6 milionë gjermanë, ndërsa forcave aleate u erdh FITORJA bashkë me 48 milionë viktima...

Jugosllavia thoshte se unë e hoqa kafshatën nga goja për ta ndihmua Shqipërinë për tre vjet, deri në vitin 1948, por përmes BRSS, dhe sa ishte kjo ndihmë reale, kur dihet se në Kosovë ata po i merrnin të ashtuquajturat "TEPRICA”...Dhe sa ishte buxheti i Shqipërisë në atë kohë? Vetëm sa kushton një kafjall, një shujtë e mëngjesit në BRSS, ose sa hanë minjtë në BRSS, d.m.th. 30 milionë dollarë...Deri më 1962 BRSS e ndihmoi Shqipërinë, por pastaj pas shkatërrimit të marrëdhënieve e ndihmoi Kina, deri në vitin 1975, ndërkaq që 15 vite Shqipëria po mbështetet tërësisht në forcat e veta...Revolucioni po vazhdon dhe gjithnjë duhet të investohet derisa të jep KOKËRR si te

ULLIRI, të cilin duhet ta kultivojmë 50 vite për t'i marrë kokrrat e para, dhe pastaj ULLIRI të jep kokrra për 2000 vjet me radhë...Por nëse nuk mirëmbahet ai trung ULLIRI, nuk ripërtërihet, atëherë do degjenerohet, çoroditet...Vetëm një kulturë nëse e kultivoni p.sh. kallamin e sheqerit, siç e kemi rastin me Kubën, atëherë kjo nuk është mirë se je i varur...Por baza më e madhe tokësore është në Gjirin e Derrave, në Guatanamo, sepse aty u bë agresion, e sot në ato baza punojnë kubanët, dhe e kompensojnë pjesën e turizmit...Më 1896 filloi faza e parë e revolucionit në Kubë, ndërsa organizimi i Kubës përmes BRSS dështoi në Gjirin e Derrave, dhe spiunazhi rus , më i forti në botë, e mundi informatikën e CIA-s, dhe NKVD-ja ruse e kishte rrjetën e spiunazhit më të suksesshmen në botë, dhe sidomos pas lansimit të satelitit më 1958 me Jurij Gagarinin....300 diversantë i lëshoi me parashutë shërbimi i CIA-s dhe Intelixhens Sevisit anglez, por agjenti rus që kishte komandën brenda shërbimit të CIA-s, ua dha koordinatat dhe kohën e saktë të aterrimit të forcave të Sigurimit shqiptar dhe ushtria shqiptare i likuidoi të gjithë, bile shumë prej diversantëve u vranë ende pa e prekë me këmbë tokë shqiptare...E njëjta gjë ndodhi edhe në Gjirin e Derrave dhe asnjë diversant nuk shpëtoi i gjallë...

Gastarbajterët sot i kemi me shati, mercenar,punëtorë të përkohshëm...Gast-gost-mysafir, dhe dihet se kemi mercenarë të shpatës, të pushkës dhe të shatit...

Kushtetuta e vitit 1974 ishte një kontradiktio in adjecto, sepse nuk ishte formulim dialektik, i arsyeshëm...Më i madhi absurd në atë Kushtetutë ka qenë se **secili e ka marrë paragrafin e kushtetutës sipas dëshirës, dhe nga tri këndvështrime: nga këndvështrimi i Federatës Jugosllave, nga këndvështrimi i Serbisë dhe nga këndvështrimi i Kosovës...**dhe po del puna e Kushtetutës si ajo puna e gjyshes që ka parë ëndrra natën ato që i ka dëshirua

ditën...Qëllimi- që ne shqiptarët meqë nuk arritën të na shfarosin, atëherë të na shpërngulin me dhunë, por të gjitha këto paradokse tona edhe pse ishin të planifikuara nga kolonizatori, megjithatë nuk arritën të realizohen 100%...**Kushtetuta e vitit 1974 ishte parapërgatitje për KONFEDERATËN BALLKANIKE...**Serbia nuk ka ushtri të vetën, por ushtria e Federatës është tërësisht nën komandën e Serbisë...Por edhe brenda shtabit madhor të Armatës Jugosllave të gjithë nuk pajtohen me idenë dhe synimet e çetnikëve, dhe sidomos ata nga Uzhica, sepse pothuaj se nuk ka familje e cila nuk e ka së paku një të vrarë gjatë luftës botërore, ndërsa çetnikët e dëshirojnë ruajtjen e Jugosllavisë si SERBOSLLAVI...Voisllav Shesheli e njeh si gjeneral vetëm atë i cili e ndihmon programin e memorandumit (1986) i cili e ka bazën në Kushtetutën e Serbisë të kohës kur Serbia kishte ushtri...Serbët i llogarisin si humbës në vitin 1918- kroatët, sllovenët, boshnjakët, ndërsa vetveten e konsideronin si fitimtar sepse vetëm ata kishin hyrë në luftë si shtet i cili ka luftua kundër Perandorisë Austrohungareze...Bile ata shkonin aq larg sa sllovenët i quanin serb të sllovenizuar, krotët-serbë të kroatizuar dhe shqiptarët-serbë të shqiptarizuar (poarbanasheni serbi) ?! Humanizëm nuk mund të ketë deri sa nuk e marrim vesh se nuk mund t'ia shohim hairin vetvetes pa ia pa hairin edhe të tjerëve, siç është rasti i Zvicrës, Suedisë, sepse këta shovinizmat e sotëm janë dobësi të brendshme, sepse secili po synon me e sundua tjetrin, por jo edhe me qenë të barabartë. Por duhet të jemi objektivë dhe të shohim realisht se edhe neve **nuk jemi në nivel, sepse ne e kemi FAJIN më të madh që jemi të DOBËT**. I forti më i madh është ai i cili edhe është i fortë, por edhe është i **DREJTË...**

Mendimi strategjik se jemi më të mirët nuk qëndron kur vëllain e vet e pret në qafë, prandaj së pari duhet t'i shohim të **ZEZAT TONA,** e pasta ta gjejmë vendin që

na takon objektivisht...A. Vllasi po thotë se nuk jemi për Republikën marksiste-leniniste...

Po mirë profesor, po pse nuk u bisedua rreth Shqipërisë në bisedimet e Jalltës më 1945?

Shqipëria nuk ishte temë e bisedimeve sepse **RREZISTENCA shqiptare ishte origjinale,** ishte autoktone, sepse asnjë ushtarë i ushtrive aleate nuk e shkeli tokën shqiptare si çlirimtar, dhe ata e kanë ditë se nuk mund të bëjnë lojë me Shqipërinë, dhe këtë punë të ndarjes siç u veprua me Jugosllavinë, Greqinë, Bullgarinë etj, dhe punën tonë e lanë për më vonë...Tani epilogu i gjithë këtyre ngjarjeve ende nuk po dihet përfundimisht, **loja po vazhdon, por siç po shihet, Shqipëria po e lëshon FRONTIN në zhvillimin e mëtutjeshëm të revolucionit autentik me forca të veta...**Ramiz Alia ende është një person me të cilin bota po flasin seriozisht, dhe sikur kjo puna e pluripartizmit të kishte mbetur për më vonë do ishte bërë kataklizëm?!...

Profesor, në cilin drejtim duhet të orientohet energjia e popullit pas pajtimit të gjaqeve dhe ngatërresave?

Po, mos të harrojmë se energjia edhe deri tani ka shkua shumë dëm, sepse **jemi marrë me pasojat, e jo me shkaktarin, d,m.th. nuk jemi marrë me okupatorin,** por me vetveten, dhe kështu ia kemi lënë duart e lira okupatorit të luaj me ne si të dojë, në vend që neve të gjithë të bëjmë rezistencë AKTIVE, pa u ndalur as protestat, as grevat, as kryengritja e armatosur, si shkalla më e lartë e rezistencës aktive., pra duke e shtrëngua rripin, parapërgatitje psikologjike e masave për luftë, me daljen e njësiteve të vullnetarëve të luftës guerile, partizane, çdo ditë e çdo orë, pa u ndalur, jo me

hope, dhe pa u mbështetur në asnjë faktor të jashtëm si tutelë, por vetëm si aleat, dhe kështu duke e ruajtur kokën njëherësh me e shitë me çmimin më të lart, si OSO KUKA në kullë të barotit në Vraninë, e jo si Esat Toptani...Vetëm pasi të kalojë një kohë, pasi të kemi në **dispozicion distancën kohë, do të arrijmë të vlerësojmë se cili ishte në të vërtetë filan-filani,** sepse shteti okupator i ka mekanizmat e vetë perfidë dhe infiltron me mijëra elementë të shitur...

M. Gjillasi në parathënien e librit të Dimitrije Tucoviqit-Serbia dhe Shqipëria, veç tjerash tha se-

Tucoviqi ia zbardhi fytyrën popullit serbë..
Deviza jonë duhet të jetë:
Me luftua duke mësuar,
Me mësua duke luftuar,
Me fitua duke humbur,
Me humbur duke FITUAR

DEMOKRACIA nënkupton-respektimin e vetvetes përmes vetvetes, dhe respektimin e tjetrit përmes vetvetes, , sepse ai i cili skllavëron tjetrin edhe vet është i skllavëruar, sepse për me e pasur një të mirë duhet ta meritosh, pra duhet ta humanizojmë vetveten, duhet ta shartojmë, ta natyralizojmë njeriun, **por të gjitha këto janë vetëm UTOPI, fraza nëse nuk arrijmë ta ndryshojmë botën përmes revolucionit, dhe jo vetëm ta shpjegojmë, sepse me ndryshimin e rrethanave ndryshojnë edhe marrëdhëniet në prodhim dhe gjithë superstruktura shtetërore e shoqërisë...**
Në **MUKJE** kishim raportin e pjesëmarrësve 12 me 12, dhe kjo ishte një DIVERZION me e shua revolucionin, mos me i sulmua italianët,, dhe pas kapitullimit të Italisë, mos me i sulmua gjermanët...dhe pastaj me u mbështetur te forcat angleze, dhe shqiptarët nën Jugosllavi të bashkohen me Shqipërinë përmes anglezëve, gjera këto të pamundshme...Ballistat si

spekulator, që dikush tjetër me ua sjellë LIRINË... Njësitet e Xhafer Devës në Pejë kanë vrarë më së shumti të rinj të cilët ishin në listat e zeza fashiste, dhe në **këto lista isha edhe unë, dhe përpak më shkoi koka**, dhe po të më kishin vrarë lule e dritë, por do më kishin sakatua, do të thotë më kishin vrarë shumëfish...217 vetë i therën me bajoneta... **Shaban Palluzhën për me e komprometua e quajtën BALLIST, kur dihet se qëllimet e Ballit Kombëtar kanë qenë si te Drazha Mihajloviqit, dhe dihet se asnjë ballist nuk ka vuajtur nëpër burgjet italiane e gjermane, ashtu siç nuk kishin vuajtur as çetnikët e Drazha Mihajloviqit...**

ALBUM FOTOGRAFISHË NGA JETA
E PROFESOR QAZIM BERISHËS

Qazim Berisha gjatë kohës kur ishte nxënës i gjimnazit, qershor 1943

Qazim Berisha gjatë kohës kur ishte në shërbimin ushtarak në Pulë në vitin 1950

Dy motrat, Shahbazja dhe Shyqeria - Sheqerja, gjatë kohës kur ishin në konviktin e jetimores

Qazim Berisha me shokët e studimeve të fotografuar para Teatrit në Zagreb më 1947

Profesor Qazim Berisha me nusen e tij, Nefizen, Prizren 2.01.1955



Profesor Qazim Berisha gjatë kohës kur punonte në Gjimnazin e Prizrenit

Profesor Qazim Berisha gjatë kohës kur ishte në ekskursion më 18.01.1958, në Itali

Profesor Qazim Berisha, moment gjatë ligjërimeve në orën e matematikës në gjimnazin e Prizrenit

Prizren, 1961: Profesor Qazim Berisha me një grup nxënësish
të gjimnazit



Prizren, 1965: Prof. Qazim Berisha me kolektivin e arsimtarëve
të gjimnazit





Bellobrad, 1992: Moment nga një shetitje në Bellobrad të Opojës, me autorin e librit.



Bellobrad, 1992: Profesor Qazimi, piktori Sabir Krasniqi dhe autori



Prizren, 1985: Profesor Qazim Berisha me autorin



Rizan Gjogjaj, i burgosur politik nga Vërmica e Prizrenit





Thesari më me vlerë që kishte në jetë Qazim Berisha ishte biblioteka e tij e pasur me mijëra vëllime librash

Biblioteka e
prof. Qazim Berishës

Miku i shtrenjtë i familjes së Qazim Berishës, piktori akademik Hamdi Bardhi me bashkëshorten e Qazimit, Nefizen dhe kunatën Sheqeren

Vraniq i Therandës,prof. Qazim Berisha gjatë një vizite në familjen e Salih Bashës bashkë me prof. Shefki Muqajn





Profesori Qazim Berisha edhe në ditët e fundit të jetës së tij na tregonte se populli ynë duhet të bëhet grusht dhe jo të jemi një nga një, por të bashkuar si një grusht dhe t'ia thyejmë dhëmbët armikut dhe t'i japim mësim se nuk ka hesap me na mbajtur nën zgjedhën e robërisë.



Pikturë e profesorit Qazim Berisha
të cilën e pikturoi piktori
Akademik Budim Berisha



Portret kushtuar profesorit Qazim
Berisha nga piktori dhe miku i
shtrenjtë Sabir Krasniqi

Familja e profesor Qazim Berishës

Autori në familjen e profesorit Qazim Berisha



Nxënësit dhe profesorët e gjimnazit në njëvjetorin e rënjes së prof. Qazim Berishës

Prizren, 6 prill 2000
Homazhe në njëvjetorin e prof. Qazim Berishës

Vajzat e profesor Qazim Berishës bëjnë homazhe: Tringa, Florina dhe Afërdita me Vatrën e vogël, dhe nipi...

P Ë R M B A J T J A

B I O G R A F I A 5

PROFESORI HERO – QAZIM BERISHA, FLAKADAN I PASHUAR QË LA GJURMË TË PASHLYERA NË MENDJEN DHE ZEMRËN E POPULLIT MARTIR 5

FRAGMENTE NGA SHËNIMET QË I KA MARRË AUTORI NGA PROFESORI QAZIM BERISHA QË NGA VITI 1982, NJË PJESË E TË CILAVE (RRETH 90%) Të KONFISKUARA NGA POLICIA JUGOSLLAVE BASHKË ME TËRË FONDIN E BIBLIOTEKËS DHE DORËSHKRIMEVE E DOKUMENTEVE TJERA, MË 5 QERSHOR 1999, KUR AUTORI I KËTIJ LIBRI U ARRESTUA DHE U PERSEKUTUA NË BURGUN E PRIZRENIT NGA OKUPATORI FASHIST JUGOSLLAV 23

FRAGMENTE KUJTIMESH TË AUTORIT NGA LIGJËRIMET E PROFESORIT QAZIM BERISHA 362

KUJTIME TË TË TJERËVE PËR PROFESORIN QAZIM BERISHA 505

ALI ALIU-KELMENDI:
PROFESOR QAZIM BERISHA, PERSONALITET FLAMUR, ENCIKLOPEDI E GJALLË, FILOZOF I VËRTETË, HERO I ARSIMIT DHE SHKOLLËS SHQIPE 505

Bislim Elshani:
QAZIM BERISHA OSE SOKRATI I PRIZRENIT 510

Shefki Muçaj:
PROFESOR QAZIM BERISHA-URAGAN I SHPIRTIT TË POPULLIT- BUÇET E RIBUÇET STUHISHËM 517

Afrim Morina:
BASHKIMI FORCON ATDHEUN (Concordia patria firmat) 521

Behxhet Berisha:
LIGJËRIMET E PROFESORIT QAZIM BERISHA ISHIN MË TË FORTA SE KRISMAT E GJITHË TOPAVE TË SERBISË 528

Ali Kurti:
PROF. QAZIM BERISHA , NJË DIOGJEN SHQIPTAR, NJË LUFTETAR I PAEPUR PËR LIRI DHE BASHKIM KOMBËTAR 532

Florina Berisha: NGA DITARI 538

VAZHDIM I LIGJËRATAVE TË PROFESORIT QAZIM BERISHA NGA MUAJI KORRIK-GUSHT 1991 541

ALBUM FOTOGRAFISHË NGA JETA E PROFESORIT QAZIM BERISHËS 557